



UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I DREJTËSISË



Provat dhe procesi i të provuarit në procesin penal

DOKTORANT:
ARIAN NDOJA

UDHËHEQËS:
Prof. dr. ARTAN HOXHA

TIRANË
2019

PROVAT DHE PROCESI I TË PROVUARIT NË PROCESIN PENAL

©: Të gjitha të drejtat janë të autorit.

Ky punim shkencor është formatuar në bazë të kërkesave të Rregullores së Rektoratit “Për Organizimin e Programeve të Studimit të Doktoratave”, miratuar në Mbledhjen e Senatit Akademik të Universitetit të Tiranës, me vendimin nr. 20, dt. 13.11.2008.

Falënderime

Dëshiroj të shpreh mirënjohjen time të sinqertë për të gjithë miqtë, dashamirësit dhe kolegët, për ndihmën dhe inkurajimin e vazhdueshëm, që ka qenë një stimul i madh për përfundimin e këtij punimi.

Një falënderim të veçantë dëshiroj t’i rezervoj udhëheqësit tim shkencor, prof. dr. Artan Hoxhës, për përkrahjen dhe mirëkuptimin e tij të vazhdueshëm, për ndihmën, inkurajimin, sugjerimet e vërejtjet e tij! E falënderoj, gjithashtu, për gatishmërinë e tij për të diskutuar çdo problem të hasur gjatë finalizimit të këtij punimi!

Gjithashtu, një falënderim tjetër shkon për të gjithë Profesorët e Fakultetit të Drejtësisë të Universitetit të Tiranës, anëtarë të Departamentit Penal të këtij Fakulteti, prof. dr. Sokol Mëngjesin, prof. dr. Altin Sheganin dhe prof. asoc. Klodian Skënderajn për nxitjen, mbështetjen dhe këshillat që më kanë dhënë gjatë përgatitjes së këtij punimi, me qëllim që të arrinte një nivel sa më të mirë profesional!

Së fundmi, jo për nga rëndësia, dua të falënderoj familjen time, e cila ka qenë një motivim i veçantë për mua, duke më ndihmuar në punën time për arritjen deri në fund të procesit të doktoraturës dhe realizimin me sukses të këtij punimi, i cili ka kërkuar kohë dhe angazhim të gjatë!

PROVAT DHE PROCESI I TË PROVUARIT NË PROCESIN PENAL

PËRMBAJTJA

HYRJE	4
OBJEKTI I KËRKIMIT SHKENCOR	8

KAPITULLI I

VËSHTRIM HISTORIK NË LIDHJE ME PROVAT DHE PROCESIN E TË PROVUARIT SIPAS PARASHIKIMEVE LIGJORE SHQIPTARE NDËR VITE	9
--	---

1.1. Procedura gjyqësore dhe procesi i të provuarit në të drejtën zakonore shqiptare...	9
1.2. Procedura gjyqësore dhe procesi i të provuarit sipas legjislacionit otoman, Sheriati	13
1.3. Procedura gjyqësore penale dhe procesi i të provuarit gjatë viteve 1912-1953 ...	16
1.4. Procesi i të provuarit dhe provat penale sipas K. Pr. Penale të vitit 1953	21
1.5. Provat penale dhe procesi i të provuarit sipas Kodit të Procedurës Penale të viteve 1979-1992.....	22
1.6. Parashikimet e Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut për të drejtën e provës dhe procesin e të provuarit.....	26

KAPITULLI II

KONCEPTI I PROVAVE PENALE DHE I PROCESIT TË TË PROVUARIT	30
---	----

2.1. Koncepti i provave dhe përkufizimet doktrinale të familjeve të ndryshme ligjore në lidhje me provat penale. Pasqyrimi i ndryshimeve sipas ligjit nr. 35/2017, dt. 30.03.2017	30
2.2. Procesi i të provuarit dhe fazat e tij	40
2.2.1. Marrja e provës.....	40
2.2.2. Shqyrtimi dhe verifikimi i provave	48
2.2.3. Çmuarja e provës dhe vlerësimi në procesin penal	50
2.3. Papërdorshmëria dhe pavlefshmëria e provave	53
2.3.1. Papërdorshmëria e provave në Procesin Penal	53
2.3.2. Pavlefshmëria e akteve procedurale në procesin penal	65
2.4. Objekt i të provuarit në procesin penal – (Thema Probandi).....	78

KAPITULLI III

LLOJET E PROVAVE PENALE DHE BURIMET E TYRE	92
---	----

3.1. Llojet e provave penale sipas ndarjeve doktrinale	92
3.2. Llojet e provave penale në procesin penal	104
3.2.1. Dëshmia.....	105
3.2.2. Kundërshtimi i dëshmisë	120
3.2.3. Pyetja e të pandehurit	122
3.2.4. Thëniet e palëve private.....	125
3.2.5. Ballafaqimet	126

PROVAT DHE PROCESI I TË PROVUARIT NË PROCESIN PENAL

3.2.6. Njohjet	128
3.2.7. Eksperimenti.....	135
3.2.8. Ekspertimi.....	136
3.2.9. Dokumentet	145

KAPITULLI IV

MJETET E KËRKIMIT TË PROVAVE DHE PROCESI I ÇMUARJES DHE VLERËSIMIT TË TYRE NË PROCESIN PENAL.....

4. Mjetet e kërkimit të provave dhe procesi i çmuarjes dhe vlerësimit të tyre në procesin penal. Llojet dhe rëndësia e tyre në të drejtën procedurale penale dhe procesin penal. Mënyrat e marrjes së provave dhe përshkrimit të tyre në aktet procedurale	151
4.1. Këqyrja.....	152
4.2. Kontrolllet	160
4.3. Sekuestrimet.....	165
4.4. Përgjimet	172
4.5. Një vështrim mbi Ligjin Nr. 10 192, datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë” (ndryshuar me ligjin nr. 24/2014, datë 20.3.2014, nr. 70/2017, datë 27.4.2017), dhe barra e provës sipas këtij ligji	189

KAPITULLI V

VESHTRIM KRAHASUES I LEGJISLACIONEVE TË HUAJA LIDHUR ME PROVAT DHE PROCESIN E TË PROVUARIT

5.1. Vështrim krahasues me ligjin italian.....	194
5.2. Legjislacioni sipas të drejtës procedurale penale anglosakson mbi provat dhe procesin e të provuarit	199
5.3. Studimi i legjislacionit sipas të drejtës procedurale penale franceze.....	202
5.4. Studimi i legjislacionit sipas të drejtës procedurale penale kosovare mbi provat dhe procesin e të provuarit	206
Konkluzione dhe Rekomandime.....	211
Bibliografia	215
Abstrakt	220

HYRJE

E Vërteta dhe Drejtësia nuk kanë një mbiemër.

Ky është një postulat shumë i lashtë që shpreh shumë mirë dhe qartë se çfarë misioni fisnik dhe i vështirë është realizimi dhe dhënia e drejtësisë.

Mungesa e njehsimit të mbiemrit të atij që e thotë të vërtetën, apo bën drejtësi me arritjen në konkluzionin se kjo është e vërteta objektive dhe drejtësia është dhënë në një rast të caktuar, na lë të kuptojmë se kemi të bëjmë me një proces që bazohet në parime e rregulla specifike, që duhen zbatuar për të shkuar tek e vërteta objektive, dhe që zbulimi i të vërtetës dhe realizimi i dhënies së drejtësisë nuk mund të jenë thjesht produkt i punës, i bindjes personale të një individi me një emër dhe mbiemër të caktuar.

- Të jetosh me nder.

- Të mos i bësh dëm tjetrit.

- Secili të marrë atë që i takon (Ulpiani¹).

Këto parime tregojnë më së miri se detyra dhe misoni i një gjyqtari apo prokurori është të përcaktojë për aq sa mundet, nëpërmjet rindërtimit të faktit të ndodhur, të vërtetën objektive, pa u bazuar në hamendësime, paragjykime dhe rrethana subjektive që e ndikojnë atë në përcaktimin e rastit konkret.

“Një shoqëri që paragjykimin e kthen në arsye, nuk është në rrugën e mbarë”, - thotë Volteri, filozofi i njohur gjerman (François-Marie Arouet, De Voltaire, 21.11.1694-30.05.1778).

Në përcaktimin e së vërtetës objektive mbi bazën e provave dhe një procesi të rregullt ligjor na ndihmojnë shumë degë të së drejtës, si dhe shkenca e disiplina të ndryshme shkencore, por baza e këtij procesi është e drejta penale me dy nga tre nëndarjet e saj, pikërisht me të drejtën penale dhe të drejtën procedurale penale.

Detyra bazë e legjislacionit procedural penal për subjektet e procedimit penal është që të përcaktojë nëse fakti i marrë për shqyrtim përbën ose jo vepër penale. Kush është autori i kryerjes së kësaj vepre penale? Cili është roli dhe shkalla e përgjegjësisë së tij dhe sanksioni penal, që do zbatohet në lidhje me këtë vepër penale të kryer.

Ky proces i vërtetimit të një fakti juridik, me të cilin ligji penal passjell lindjen e të drejtave dhe detyrimeve për subjektet e një procedimi penal, kalon nëpër disa faza të rëndësishme, nga të cilat veçojmë procesin e marrjes së provave dhe analizimit e çmuarjes së tyre.

Përpara së të merret një vendim përfundimtar për zgjidhjen e një rasti juridiko-penal duhet që subjektet procedurale, në bazë të parimeve të sistemit procedural që përcakton mënyrën e rindërtimit të faktit të ndodhur, të respektojnë në mënyrë rigoroze rregullat për përcaktimin e saktë të objektit të të provuarit, burimeve të provave, llojeve të provave, rregullat për dokumentimin e mënyrës së marrjes së provave nëpërmjet mjeteve të kërkimit të tyre, dokumentimin në mënyrë të saktë të rezultateve të arritura

¹ Tria praecepta iuris sunt: “Honeste videre -Alterum non laedere - Suum Cuique tribuere”, Gnaeus Domitius Annianus Ulpianus; c. 170 – 223.

nëpërmjet përdorimit të një mjeti të caktuar kërkimi prove, çmuarjen e saktë të provave në varësi të shkallës së afërsisë së tyre me objektin e të provuarit, vlerësimin sasior të tyre.

Qëllimi kryesor dhe më i rëndësishëm i legjislacionit penal, që përcaktohet dhe në përmbajtjen e tij, është padyshim vërtetimi i të gjitha rrethanave të faktit juridik penal, në mënyrë të saktë dhe të plotë nga subjektet e së Drejtës Procedurale Penale për konstatimin dhe zbulimin e të vërtetës.

E vërteta, siç është theksuar te parimi i kërkimit të së vërtetës në procedurë penale, nënkupton vërtetimin e plotë të të gjitha rrethanave të faktit juridik, nga të cilat varet zbatimi i së drejtës penale materiale dhe procedurale, duke e përputhur gjendjen faktike të vërtetuar në procedurën penale me ngjarjen reale nga e kaluara, e cila kualifikohet si vepër penale.

S'ka dyshim se për gjetjen e së vërtetës në procedurë penale, gjykata, por dhe organi i akuzës (në rastet e mosfillimit, kërkesës për pushimin e çështjes, ose akuzës për kundravajtjet, vendimin e pezullimit), duhet që, nëpërmjet një analize gjithëpërfshirëse të provave, duke respektuar formën e parashikuar procedurale, të bëjë përpjekjet maksimale që me saktësi të plotë t'i vërtetojë faktet, të cilat janë të rëndësishme për zbardhjen dhe zgjidhjen e çështjes.

Zbulimi i së vërtetës, që arrihet gjatë fazës së hetimeve paraprake ose gjatë gjykimit, nëpërmjet procesit të kërkimit, marrjes, shqyrtimit dhe çmuarjes së provave është i domosdoshëm për procesin, pasi ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në vlerësimin dhe krijimin e bindjes së brendshme të prokurorit ose gjyqtarit në vendimmarrjen e tyre.

E vërteta na shfaqet në tri forma, sipas Paolo Toninos dhe Karlota Kontit, që sipas nesh kanë të drejtë: **“E vërteta absolute, e vërteta epistemologjike dhe e vërteta procedurale.”** (Paolo Tonino & Carlotta Conti).

Tek e vërteta absolute, duhet të kemi parasysh se ajo është tashmë një fakt i humbur, që ne nuk e materializojmë, siç ka ndodhur, por përpiqemi ta rindërtojmë sa mundemi. Ajo e vërtetë është e vërtetë historike, që nuk mund të përsëritet më siç ka ndodhur në atë moment dhe të përpiqesh ta realizosh, siç ka ndodhur, është vërtetë një utopi (Albert Einstein, 14.03. 1879 – 18.04. 1955, Teoria e relativitetit).

Tek e vërteta epistemologjike mbështetemi në të gjitha të dhënat e përfuara në bazë mendimesh shkencore teorike, marrje të dhënash në të gjitha llojet e mënyrat, por pa iu nënshtruar rregullave të procesit.

Tek e vërteta procedurale duhet të kemi parasysh se ndodhemi përpara asaj të vërtete, e cila, e kushtëzuar nga mënyra se si merren provat në një proces penal, ku forma është parakusht i rëndësishëm për vlefshmërinë e akteve ku janë fiksuar këto prova, si dhe arrijen e një konkluzioni të sakte për faktin juridiko-penal.

Pavarësisht se në këtë punim shkencor ne i përmendim këto nëndarje, në procesin penal jemi të detyruar që të provojmë të vërtetën që rrjedh nëpërmjet provave të marra në mënyrë të ligjshme dhe, në këto kushte, e vërteta procedurale është ajo e vërtetë, e cila është objektivisht larg së vërtetës absolute, por që, në fund të fundit, është sinteza e punës së një grupi subjektsh procedurale, të cilët, të përfaqësuar nga individë me

PROVAT DHE PROCESI I TË PROVUARIT NË PROCESIN PENAL

njohuri të shëndosha ligjore e shkencore, passjellin arritjen në konkluzione ligjore e logjike dhe marrjen e vendimeve të drejta në rastet që u paraqiten për zgjedhje.

Mënyra se si arrihet tek e vërteta objektive përbën një ndarje të madhe konceptuale në të drejtën procedurale penale, pasi, nga kjo mënyrë që aplikohet për të arritur tek e vërteta, përcaktohet disiplinimi i procesit të të provuarit.

Nisur nga dallimet në disiplinimin e procesit që, në mjaft raste është i ndryshëm, bëhet dhe ndarja mes sistemeve të ndryshme procedurale, që aplikohet në vende të ndryshme, atij inkuizitor dhe akuzator.

Sistemi ynë procedural, dy dekada më parë, ka pësuar ndryshime rrënjësore, të cilat hodhën bazat e garantimit të procesit penal për sa i përket të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, pavarësisë së sistemit gjyqësor, sigurimin e zbulimit të së vërtetës në proces gjyqësor, nëpërmjet parimit të kontradiktoritetit, barazisë së armëve etj.

Nga një proces në thelb inkuzitor, ku prokurori gëzonte të drejtën e marrjes dhe formalizimit të provës gjatë hetimeve, ku procesi i shkruar mbizotëronte mbi atë me gojë, ku mbrojtja ishte inekzistente dhe ku gjyqtari njihej me tërësinë e akteve të hetimeve paraprake, që para gjykimit, u kalua në një sistem krejt të ri.

Sistemi aktual i procedimit penal, i mishëruar në Kodin e Procedurës Penale në vitin 1995 dhe ndryshimet përkatëse, si dhe jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, tashmë i përket atyre modeleve që garantojnë në një standard mjaft të lartë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut.

Në analizë dhe të dispozitave të Kodit të Procedurës Penale, procesi ynë penal nuk është një proces i pastër akuzator. Duke qenë i gërshetuar me elemente të rëndësishme me natyrë inkuzitore, ai më tepër i përket modelit të përzier të procedurës.

Kjo sepse procesi ynë penal përmban në vetvete disa elemente, që përbëjnë shmangie të hapur nga filozofia akuzatore e procedimit.

Prania e disa elementeve inkuzitor, në procesin tonë penal, në disa raste ka ardhur si rezultat i sistemit procedural italian, model të cilin ligjvënësi ynë ka adoptuar, por në disa raste të tjera ka ardhur si pasojë e vështirësisë për t'u shkëputur nga tradita shumëvjeçare e sistemit penal të kaluar.

Megjithatë, natyra në thelb akuzatore e procesit tonë penal nuk mund të mohohet, pasi ai është i konceptuar mbi bazën e parimeve themelore akuzatore, si: barazia e palëve, metoda dialektike e tezave të kundërta për të arritur tek e vërteta procedurale, formimi i provës në debatin gjyqësor etj.

Këto parime të parashikuara nga ligjvënësi udhëheqin procesin e rregullt ligjor dhe ndihmojnë subjektet e procedimit penal në zbulimin e të vërtetës, duke përbushur dhe ezauruar në këtë mënyrë funksionin dhe qëllimin primar të sistemit gjyqësor, atë të dhënies së drejtësisë. Dhënia e drejtësisë është një proces kompleks dhe Abraham Lincoln u jepte juristëve këtë këshillë:

“Ji i vendosur të jesh i ndershëm në çdo rast dhe, nëse në gjykimin tënd nuk mund të jesh një jurist i ndershëm, ji i vendosur të jesh i ndershëm pa qenë jurist. Zgjidh një profesion tjetër” (Abraham Lincoln, 12. 02. 1809 –15.04. 1865).

Gjithsesi, procesi i të provuarit dhe zbulimi i së vërtetës është një proces që mbart në vetvete shumë probleme, pasi është një proces kompleks, delikat dhe i vështirë.

PROVAT DHE PROCESI I TË PROVUARIT NË PROCESIN PENAL

Gjatë trajtimit të kësaj teme do të ndalemi dhe të përpiqemi të analizojmë në aspektin doktrinar, por dhe juridik, jo vetëm fazat që kalon dhe kushtet që kërkon ligji për formimin e provës dhe procesin e të provuarit, por duke i ilustruar me praktikë gjyqësore, dhe problematikat që janë hasur në praktikë gjatë viteve në këtë drejtim.

Nisur nga fakti që Kodi i Procedurës Penale, tashmë, ka pësuar ndryshime të mëdha me ligjin nr: 35/2017, të cilat kanë hyrë në fuqi dhe po zbatohen. Ndryshimet e reja jemi munduar t'i integrojmë gjatë trajtimit të temës, duke i përditësuar me praktikën gjyqësore për aq sa kanë gjetur zbatim gjatë kësaj kohe.

OBJEKTI I KËRKIMIT SHKENCOR

Qëllimi kryesor dhe më i rëndësishëm i legjislacionit penal, që përcaktohet dhe në përmbajtjen e tij, është padyshim vërtetimi i të gjitha rrethanave të faktit juridik penal, në mënyrë të saktë dhe të plotë nga subjektet e të Drejtës Procedurale Penale për konstatimin dhe zbulimin e së vërtetës.

QËLLIMI I TEMËS

Qëllimi i këtij punimi shkencor është dhënia e një analize të detajuar të konceptit të provave dhe procesit të të provuarit në procesin penal.

Në këtë mënyrë, tema fillon me një trajtim të përgjithshëm të konceptit të provave dhe procesin e të provuarit në procesin penal dhe zhvillimin historik të evolucionit të kuptimit të tyre. Në këtë kapitull do të paraqitet në mënyrë të detajuar metamorfoza e evoluimit të legjislacionit procedural, vështrim historik në lidhje me provat dhe procesin e të provuarit, sipas parashikimeve ligjore shqiptare.

Kapitulli i dytë merr në shqyrtim dhe analizë të thellë konceptin e provave dhe procesin e të provuarit. Duke i dhënë një shpjegim të zgjeruar nenit 149 i K. Pr. Penale, i cili ka përcaktuar dhe kuptimin e provës dhe duke pasqyruar e ndryshimet e fundit në Kodin e Procedurës Penale. Janë analizuar të gjitha parashikimet ligjore në lidhje me përcaktimin e definicionit të provave dhe procesit të provave në gjykim penal.

Kapitulli i tretë merr përsipër të trajtojë mjetet e kërkimit të provave dhe mënyrat e marrjes së provave. Mjetet për kërkimin e provës nuk janë në vetvete burim i bindjes provuese, por krijojnë mundësinë që, nëpërmjet përdorimit të tyre, të merren objekte, materiale, gjurmë ose deklarime që shërbejnë si rezultate provuese të rrethanave të faktit, ose sipas rastit dhe të fajësisë, ose pafajësisë së të pandehurit.

Kapitulli i katërt vijon me një analizë të Kodit të Procedurës penale aktuale dhe parashikimet e tij në lidhje me provat, mjetet e kërkimit të provave dhe procesin e çmuarjes dhe vlerësimit të tyre. Problemet e hasura në praktikën gjyqësore të përditshme.

Kapitulli i pestë do të trajtojë vështrimin krahasues të legjislacioneve të huaja lidhur me provat dhe procesin e të provuarit.

Në përfundim, punimi do të arrijë në konkluzione, të cilat do të jenë rezultat i hulumtimit të thellë mbi provat dhe procesi i të provuarit në procesin penal, përfundime të cilat do të jenë të dobishme për një kategori të caktuar të operatorëve të drejtësisë.

KAPITULLI I

VËSHTRIM HISTORIK NË LIDHJE ME PROVAT
DHE PROCESIN E TË PROVUARIT SIPAS PARASHIKIMEVE
LIGJORE SHQIPTARE NDËR VITE

Objekt i këtij punimi janë provat dhe procesi i të provuarit në procesin penal, të cilat vlerësojmë t'i shqyrtojmë sipas historikut të procedurës penale, që nga parashikimet e së drejtës zakonore shqiptare, deri në pasqyrimin e ndryshimeve të legjislacionit penal dhe procedural penal pas ndryshimeve të thella politike dhe social-ekonomike që ndodhën në Shqipëri në vitet '90-të.

Miratimi i Kodit të Procedurës Penale të ri në vitin 1995 u bazua në parime demokratike, sipas modelit të kodeve procedurale penale të shteteve të përparuara evropiane. Me hyrjen në fuqi të Kodit të Procedurës Penale, provat dhe procesi i të provuarit mori një konceptim të ri.

**1.1. PROCEDURA GJYQËSORE DHE PROCESI I TË PROVUARIT NË TË
DREJTËN ZAKONORE SHQIPTARE**

E drejta zakonore shqiptare e ka burimin e saj nga populli dhe është krijuar si një nevojë e domosdoshme për të vepruar sipas një qëllimi të caktuar, mbi bazën e arsyes dhe vullnetit të mirë. Vetë shoqëria ka mundur krijimin e rregullave të caktuara të sjelljes, aplikimi i vazhdueshëm i të cilave u siguroi cilësinë e normës zakonore.

E drejta zakonore shqiptare përbënte një sistem të plotë juridik me norma me karakter statutor, norma të së drejtës familjare, civile, penale, procedurale mbi bazën e të cilave mbështetej ecuria e jetës dhe veprimi të popullit shqiptar sipas krahinave të caktuara².

Kështu, janë kodifikuar tërësi të caktuara normash zakonore të njohura me emërtime të ndryshme, si: Kanuni i Lekë Dukagjinit, Kanuni i Skënderbeut, Kanuni i Pukës, Kanuni i Lumës dhe Kanuni i Labërisë, i njohur ndryshe nga etnografi Rrok Zojsi si Shartet e Idriz Sulit. Këto norma zakonore janë konsideruar shpeshherë dhe Kanuni i Veriut, Kanuni i Gegës, Kanuni i Vjetër³.

Kanuni është e drejta shqiptare, Jus Albanicae, e pashkruajtur, por e ruajtur me fanatizëm nga populli; është një vepër me vlera të mëdha juridike, etiko-morale, kulturore dhe historike⁴.

Pavarësisht disa ndryshimeve që ekzistojnë ndërmjet tyre, të cilat i atribuohen veçorive të zhvillimit historik të çdo territori të caktuar, vlen të theksohet se Kanuni i Veriut, i Shqipërisë së Mesme dhe i Jugut, në thelbin e tyre janë deri-diku të ngjashëm me njëri-tjetrin, duke u karakterizuar nga uniteti dhe diversiteti.

Sipas konkluzionit të prof. dr. Ismet Elezi,⁵ në vështrimin krahasues të normave zakonore procedurale të Kanunit të Labërisë, në përmbajtje, shpeshherë dhe në formë,

² Historia e shtetit dhe së drejtës në Shqipëri, 1994, f. 5.

³ E. Sahiti, Argumentimi në procedurën penale, 2006, f. 61.

⁴ L. ALIA, <http://www.nacionalalbania.al/2012/09/kanuni-kodi-i-se-drejte-zakonore-shqiptare/>

⁵ I. Elezi, E drejta zakonore e Labërisë, 1994, f. 195.

PROVAT DHE PROCESI I TË PROVUARIT NË PROCESIN PENAL

janë të njëjta me normat e Kanunit të Lekë Dukagjinit, Kanunit të Skënderbeut dhe të kanuneve të tjera, gjë që dëshmon dhe një herë për karakterin e tyre mbarëshqiptar dhe në fushën e procedurës penale.

Të njëjtin qëndrim ka shprehur edhe A. Meksi në studimet e tij rreth krahinave autonome

shqiptare gjatë pushtimit osman se: *Të gjitha këto kamune ose pjesë të tyre, që i përgjigjen strukturës ekonomike shoqërore të kushteve politike të kohës, që ishin të njëjta pothuajse në të gjithë Shqipërinë nuk kanë ndryshuar midis tyre në vijat kryesore, gjë që vërteton bashkimin e popullit tonë, pa dallim krahine dhe feje, që në kohët më të vjetra⁶.*

Por në një vështrim krahasimor të këtyre kodifikimeve, përveç ngjashmërive si në formë, ashtu dhe në përmbajtje, ajo çka të bie në sy është mungesa e institucioneve të caktuara procedurale dhe e mjeteve materiale të përbashkëta për zgjidhjen e konflikteve, duke ia lënë këtë barrë shpeshherë iniciativës private.

Vlen të theksohet se Kanuni ishte një ligj për të gjithë dhe përmbi të gjithë palët, pasi parashikonte sanksione për të gjithë ata që e shkelnin atë, pavarësisht pozicionit social dhe ekonomik që ata kishin në vendin ku jetonin.

Të gjithë popujt në një shkallë të caktuar të zhvillimit e kanë njohur institutin e gjyqit popullor, në të cilin tërë populli ose një pjesë e tij ka gjykuar një çështje penale konkrete. Gjyqi në fjalë është përbërë nga gjyqtarë joprofesionistë të rekrutuar nga radhët e popullit. Ai ka zgjidhur konfliktet duke vendosur njëkohësisht, si për çështje faktike (çështjen e ekzistencës së veprës penale dhe përgjegjësisë së të pandehurit), ashtu dhe për çështjen juridike të zbatimit të së drejtës (shqiptimit të sanksionit⁷).

Në rastin e popullit shqiptar, rolin e gjykatës popullore e ka luajtur *Këshilli i Pleqve*, i cili në literaturë shkruhet se pleqëria ndahet në *Pleqni të madhe* dhe *Pleqni të vogël*, duke e kuptuar kuvendin fisnor në rastin e pleqnisë së madhe dhe *ad hoc* si Pleqni të vogël.⁸

Kuvendi ishte mbledhje e krerëve të fiseve të një krahine, bajraku ose shumë bajraqeve, për të biseduar një çështje ose për të lidhur një marrëveshje, ku, në përgjithësi, kishte karakter legjislativ, pra për çështje të përgjithshme.

Pleqnia e vogël ishte kryesisht si një organ i posaçëm gjyqësor, që zgjidhte çështje konkrete mes dy palëve.

Anëtarët e Pleqnisë ishin kryesisht njerëz të cilët njiheshin nga populli si të pjekur, të mençur, të ndershëm dhe të urtë. Procedura që zbatonte Pleqnia kishte karakteristikat e një procedure akuzuese dhe me karakter publik.

Detyra e Pleqnisë dhe e kryefamiljarëve nuk ishte të bënte ligje dhe rregulla të reja, por të interpretonte faktet për secilin rast në veçanti, në bazë të ligjeve, rregullave dhe normave të vjetra të Kanunit, që ata i ruanin si thesar të çmuar në kujtesën e tyre të hekurt⁹.

⁶ V. Meksi, Autonomia lokale e krahinave shqiptare gjatë pushtimit osman, 1965, f. 115.

⁷ E. Sahiti, Argumentimi në procedurën penale, 2006, f. 62.

⁸ K. Nova, Zhvillimi historik i gjyqimit në Shqipëri.

⁹ L. ALIA, <http://www.nacionalalbania.al/2012/09/kanuni-kodi-i-se-drejtjes-zakonore-shqiptare/>

PROVAT DHE PROCESI I TË PROVUARIT NË PROCESIN PENAL

*Ajo, sipas rregullit, investohej nëpërmjet padisë gojore të të dëmtuarit ose përjashtimisht nëpërmjet padisë ex officio në rastet kur autori i veprës penale kapej në flagrancë dhe fillonte me një shqyrtim gjyqësor publik*¹⁰. Hetimet në procedurë të Pleqnisë i kryente një hetues privat, i cili, si për Pleqinë, përveç rasteve të rralla, si dhe për të tjerët, ishte anonim. Parimet kryesore mbi bazën e të cilave zhvillohej procedura “gjyqësore” nga Pleqnia ishin parimi gojor, kontradiktor dhe i drejtpërdrejtë, marrja dhe shqyrtimi i provave.

Referuar normave të Kanunit të Lekë Dukagjinit¹¹, ndër llojet e provave dhe mjetet e kërkimit të tyre, të cilat paraqiten më së shumti, në procedurën e Pleqnisë bëjnë pjesë: *pohimi i të pandehurit, dëshmia e dëshmitarit, mendimi i ekspertit, kapucari, ndjekja e gjurmëve, njohja e sendit, këqyrja e vendngjarjes, flagranca, shkresat dhe Beja*.

Në procedurën penale, barra e provës i takonte akuzuesit, cili, krahas deklarimeve gojore para

Pleqnisë, duhej të paraqiste dhe provat konkrete ku e mbështeste akuzën e tij. Në raste të veçanta, barra e provës mund t’i kalonte dhe të pandehurit.

Në procedurën e *Pleqnisë* verifikohej a ekzistonte **pohimi i të pandehurit**, i cili merrte për sipër autorësinë e veprës penale dhe, po qe se ai mungonte, *Pleqnia* autorizonte në marrjen e provave të tjera. Sipas Kanunit të Lekë Dukagjinit¹², *Pleqnia* kishte mundësi ta pyeste të pandehurin, por duhet të theksohet fakti se kjo nuk mund të bëhej nën ndikimin e dhunës fizike apo psikologjike për nxjerrjen e pohimit nga i pandehuri.

Në të vërtetë, *Pleqnia* nuk verifikonte saktësinë e pohimit, por në momentin e paraqitjes së tij e konsideronte fajin të konsumuar dhe të provuar tërësisht. Duke u përjekur në gjetjen e së vërtetës, ndodhte që *Pleqnia* ta merrte pohimin me rezervë, sidomos kur ekzistonte mundësia që i pandehuri të kishte paguar dikë tjetër për kryerjen e veprës penale, ose kur i pandehuri pohonte kryerjen e veprës, ndërkohë që mund të ishte kryer nga dikush tjetër¹³. Kjo ndodhte zakonisht në rastet e gjakmarrjes.

Si provë provuese në procedurën e Pleqnisë paraqiteshin dhe **dëshmitarët**. Si dëshmitarë mund të ishte çdo mashkull madhor, pa të meta mendore dhe fizike. Gratë dhe fëmijët nuk mund të ishin dëshmitarë në gjykim. Nuk mund të ishin, gjithashtu, dëshmitarë as personat që kishin humbur nderin qytetar ose ushtarak, domethënë qytetarët e bojkotuar edhe ata infam¹⁴. Dëshmitarin, si rregull, mund ta propozonte çdo palë në konflikt, por mund të thirrej dhe kryesisht nga ana e Pleqnisë.

Vlen për t’u theksuar se prova me dëshmitarë, në të drejtën zakonore, përdorej më së shumti në konfliktet dhe mosmarrëveshjet e natyrës civile sesa ato penale, dhe njihej më tepër si mjet mbrojtës për të pandehurin, pasi kishte një angazhim dhe solidarizim farefisnor e shoqëror për mbrojtjen e tij, pra nuk kishte rol akuzues. Në rast të kundërt, kjo konsiderohej si “tradhti”.

Eksperti paraqitej si mjet tjetër i provës për shkak të njohurive të posaçme në fusha të caktuara, i cili e jepte mendimin në bazë të njohurive profesionale dhe përvojës që

¹⁰ E. Sahiti, Argumentimi në procedurën penale, 2006, f. 66.

¹¹ Kanuni i Lekë Dukagjinit, At Shtjefën Gjeçovi, 2001.

¹² K. Nova, E drejta zakonore shqiptare, 1989.

¹³ E. Sahiti, Argumentimi në procedurën penale, 2006, f. 73.

¹⁴ K. Nova, E drejta zakonore shqiptare, 1989, f. 65.

kishte fituar. Megjithatë, ekspertimin e ushtronin persona të cilët nuk ishin profesionistë të duhur dhe, si rrjedhojë, ekspertimi në procedurën e *Pleqnisë* ishte i thjeshtë.

Provë tjetër e rëndësishme e parashikuar në Kanunin e Lekë Dukagjinit, ishte dhe **kapucari** ose “këpucëgrisuri¹⁵”, sipas kanunit të Labërisë. Këpucar ishte personi i cili luante rolin e një hetuesi, të cilin e angazhonte paditësi për interesat e tij me qëllim kërkimin dhe zbulimin e autorit të veprës penale. Detyra e këpucarit ishte hetimi i çështjes, grumbullimi i provave dhe argumentimi i fajësisë së personit i cili akuzohej. Këpucari i parashtronte provat e grumbulluara në Gjyqin e Pleqve¹⁶.

Si mjet provues që vërtetonte plotësisht përgjegjësinë penale të autorit dhe, që në këtë rast, *Pleqësia* vlerësonte se nuk kishte nevojë për hetime e prova të tjera ishte **kapja në flagrancë** e autorit të veprës penale.

Kjo ndodhte në rastet kur autori i veprës penale kapej nga i dëmtuari apo persona të tjerë gjatë kryerjes së veprës ose menjëherë mbas saj dhe këta kishin të drejtë ta mbanin të lidhur, derisa ta dorëzonin tek autoritetet përkatëse për gjykimin publik të tij¹⁷.

Ndjekja e gjurmëve paraqitet si mjet provues më së shpeshti te veprat penale që kishin të bënin me vjedhjen, kryesisht te: vjedhja e mallit, bagëtisë, vjedhja e drurëve në pyll etj. Por si mjet prove, ndjekja e gjurmëve përdorej dhe në rastin e kryerjes së një vrasjeje, dhe, në këtë rast, Pleqnia mund të dilte vetë, ose të caktonte persona të besuar në ndjekjen e gjurmëve të autorit të veprës, duke marrë si pikë referimi vendin e ngjarjes.

Pronari i sendeve të vjedhura, ose i dëmtuari nga vrasja apo lëndimet trupore, vetë ose me ndihmën e personave të tjerë, fiksonte gjurmët dhe shenjat e tjera të dukshme, më pas i paraqiste si prova në dëshminë e tij para Pleqnisë.

Një mjet i provës është dhe **njohja e sendit** të vjedhur, i cila gjendet në dorën e tjetërkujt. Me atë rast, pronari i sendit të vjedhur kërkon që t’i argumentohet se në çfarë mënyre i ka rënë në dorë sendi apo gjëja. Kështu veprohet, derisa të mos paraqitet personi, i cili nuk është në gjendje të provojë bazën juridike dhe mënyrën e sigurimit të sendit kontestues¹⁸.

Në ndryshim nga këto mjete të të provuarit, të cilat nuk kishin një ndarje procedurale civile apo penale, **këqyrja e vendit të ngjarjes** ishte e parashikuar në normat e KLD-së specifikisht për çështje penale. Kjo mënyrë e të provuarit të faktit përdorej në ato raste kur Pleqnia e kishte të vështirë pasqyrimin dhe përfytyrimin e saktë të ngjarjes vetëm nëpërmjet provave të paraqitura para saj dhe për këtë arsye ajo praktikonte daljen e saj në vendin e ngjarjes. Kjo praktikë ishte me rëndësi për vërtetimin e drejtë të fakteve dhe dhënien e një gjykimi të saktë.

Shkresa, në cilësinë e provës materiale, gjen përdorim të paktë në normat e së drejtës zakonore, pasi vetë zhvillimi kulturor dhe arsimor i popullit tonë ishte i prapambetur në krahasim me vendet perëndimore dhe veprimet juridike rrallëherë kryheshin të formalizuara në formë shkresore. Procedura gjyqësore e të provuarit mbështetej

¹⁵ Historia e shtetit dhe së drejtës në Shqipëri, 2001, f. 279.

¹⁶ H. Islami, Demokratizimi i legjisllacionit penal, 2000, f. 10.

¹⁷ I. Elezi, E drejta zakonore shqiptare, 2001.

¹⁸ E. Sahiti, Argumentimi në procedurën penale, 2006, f. 79.

kryesisht tek fjala e dhënë ndërmjet palëve, dëshmitarët dhe tek deklaratimet të cilat bëheshin para Pleqnisë.

Në tërësinë e provave që përdoreshin në procedurën e Pleqnisë, Kanuni i Lekë Dukagjinit, krahas këtyre mjeteve racionale të provës dhe procesit të të provuarit, si mjet prove njihet dhe **benë**. Beja apo “Porota”,¹⁹ kryesisht, kishte karakter fetar dhe trajtohej me respekt nga palët ndërgjyqëse, duke e liruar nga dyshimi të akuzuarin.

Beja bëhej me **dorën mbi gur, mbi Kryq e mb’Ungjill, mbi kokën e një djali** dhe sipas një procedura të caktuar ceremoniale, e cila, në rast se nuk respektohej, e bënte atë të pavlefshme. Beja lejohej kur nuk kishte prova të tjera dhe zbatohesh për të pastruar figurën e të akuzuarit nga vepra penale.

Rregullat e Kanunit të Lekë Dukagjinit lidhur me provat, mjetet e provës, si dhe me procedimet e tyre janë karakteristike kryesisht për kushtet e zhvillimit të krahinave malore. Megjithatë, në vështrimin krahasues që studiues të ndryshëm i kanë bërë dispozitave normuese të Kanuneve të tjera, që vepronin në territore të ndryshme të Shqipërisë, të bie në sy ngjashmëria e këtyre kodifikimeve, duke treguar karakterin origjinal të popullit tonë.

Duke ju bashkuar mendimit të shumë studiuesve, të cilët i kanë analizuar me hollësi këto norma zakonore, mund të themi me bindje se **Kanuni ishte dhe ka funksionuar si Kushtetuta e shqiptarëve**.

1.2. PROCEDURA GJYQËSORE DHE PROCESI I TË PROVUARIT SIPAS LEGJISLACIONIT OTOMAN, SHERIATI

Si pasojë e pushtimit turk për gati 5 shekuj, në shtetin shqiptar u vendos dhe filloi të funksionojë legjislacioni otoman, ose siç quhej ndryshe “**E drejta e Sheriatit ose Fikhut**”²⁰. E drejta e Sheriatit përbëhet prej një sërë burimesh, të cilat jurisprudenca islame, sipas rregullit, i radhit në burime themelore dhe në burime plotësuese.

Burim themelor i pakontestueshëm është Kur’ani, ndërsa si burime plotësuese mund të përmendim: el-istihsan, el-istihlah (maslaha) dhe el-urf²¹.

Legjislacioni otoman, pavarësisht se mbronte interesat e pushtuesve turq, nuk binte ndesh as me parimet dhe interesat e shtresës feudale vendase, duke ushtruar ndikimin e tyre edhe në të drejtën tonë zakonore. Por në raste të caktuara, e drejta zakonore vendase gjente zbatim në hapësirë dhe në kohë.

Ky legjislacion, i cili konsiderohej si shprehje e vullnetit të Zotit, ka funksionuar deri në fund të shekullit 19-të, dhe si karakteristikë kishte papërcaktueshmërinë e dënimeve të cilat jepeshin nga Kadiu²², sipas bindjes se tij.

Në disa qytete dhe fshatrat rreth tyre u krijuan gjykatat e Kadiut, që vepronin sipas rregullave të Kuranit dhe kishin si objekt gjykimi çështjet e rëndësishme që lidheshin me interesat e administratës osmane, por të pavarura nga gjykimet ushtarake²³.

¹⁹ Kanunit, At Shtjefën Gjeçovi, 2001, nenet 1044-1078.

²⁰ H. Islami, Demokratizimi i legjislacionit penal, 2000, f. 12.

²¹ E. Sahiti, Argumentimi në procedurën penale, 2006, f. 29.

²² I. Elezi, Zhvillimi historik i legjislacionit penal në Shqipëri, 1997, f. 14.

²³ H. Islami, Demokratizimi i legjislacionit penal, 2000.

Në këtë periudhë, si organe hetimi njiheshin “Organet e Sherries, Këshilli i Sherijes”, të cilave, sikurse dhe organeve të administratës ushtarake, u njiheshin drejta të kryenit hetime e të grumbullonit prova, të cilat konsideroheshin të tilla nga ana e Kadiut në gjykimin e çështjes.

Në bazë të këtij sistemi, procedimi penal fillonte vetëm me kërkesën e të dëmtuarit dhe procedura e gjyimit ishte e thjeshtë, pa formalitete të caktuara. Gjykimi zhvillohej nën drejtimin e Kadiut, i cili vepronte si gjyqtar i vetëm dhe kishte kompetenca të shumta, vendimet e të cilit ishin të formës së prerë²⁴.

Sipas normave procedurale penale të Sheriatit, si prova të rëndësishme konsideroreshin: *pohimi i të akuzuarit - ikrar, dëshmia e dëshmitarit - shehade, shkresat, eksperti - sahibul mesail dhe betimi - jemin*.

Pohimi i të pandehurit²⁵ madhor (mukallef) dhe të shëndoshë nga mendja (akil) konsiderohet si provë e plotë dhe nuk ishte më e nevojshme të merreshin prova të tjera. I pandehuri duhej të përsëriste para Kadiut pohimin e tij në intervale të caktuara kohore, në mënyrë që atë ta pranonte Kadiu si provë e saktë. Kjo mënyrë e pohimit bëhej me qëllim që të pandehurit t’i lihej kohë të mendonte pasojat që i shkaktonte pohimi i tij i dhënë në procedurë gjyqësore dhe që, eventualisht, ta tërhiqte pohimin²⁶.

Një vend të rëndësishëm në procesin e gjyimit zë **Dëshmia e dëshmitarit**. **Dëshmia**²⁷ nënkuptonte deklarin e një personi para Kadiut në prezencë të palëve, me qëllim argumentimin e së drejtës së dikujt dhe jepej nëpërmjet perceptimeve personale të dëshmitarit. Këto perceptime duhej të ishin realizuar nëpërmjet shqisave të shikimit ose të dëgjimit, dhe jo sipas hamendjes.

Dëshmia ishte paraparë si detyrim, të cilin dëshmitari duhet ta përmbushte, kur i kërkohej. Me qëllim shmangien e dëshmimeve të rreme, në të drejtën e Sheriatit hasim një instrument specifik të quajtur “Tezkije” (dëlirje-kullim i dëshmitarit²⁸), cili ka të bëjë me verifikimin e të dhënave për verifikimin e përsosur të dëshmitarit para se Kadiu të merrte dëshminë e tij. Në procesin e të provuarit në të drejtën e Sheriatit, më së shumti, kërkohej dëshmia e dy dëshmitarëve, të cilët, para se të jepnin dëshminë e tyre, duhej të betoheshin në Zot para Kadiut se nuk po jepnin dëshmi të rreme.

Betimi si provë në të drejtën e Sheriatit ishte dy llojesh:

- *së pari*, ai nënkuptonte zotimin e një individi se do të kryente ose jo një veprim (*jemini mun’ akide*)²⁹;

- *së dyti*, me anë të Be-së synohej të përforcohej një deklaratë, beja e cila jepej për të përforcuar një deklarin mund të ishte *jemini gamus* dhe *jemini lagv*;

Beja duhej të bëhej para Kadiut në kushtet kur njëra palë nuk dispononte prova të mjaftueshme për të rrëzuar pretendimin e palës tjetër. **Beja** zbatoheshin vetëm për të akuzuarit për vjedhje dhe, kur i akuzuari e pranonte fajin, nuk kishte më nevojë për prova të tjera. **Beja** bëhej gjithmonë në ambiente të shenjta.

²⁴ Historia e shtetit dhe së drejtës në Shqipëri, 1984, f. 28-29.

²⁵ G. Gjika, Institucionet osmane dhe pashallëqet feudale shqiptare, 2001.

²⁶ E. Sahiti, Argumentimi në procedurën penale, 2006, f. 41.

²⁷ K. Nova, E drejta zakonore në Shqipëri, 1989.

²⁸ E. Sahiti, Argumentimi në procedurën penale, 2006, f. 43.

²⁹ E. Sahiti, Argumentimi në procedurën penale, 2006, f. 44-45.

Sa u përket **shkresave**, duhet thënë se ato më tepër përdoren si prova në procedurë gjyqësore, në procedurë civile dhe janë përdorur pak në proceset penale të asaj kohe, për shkak dhe të formimit kulturor e intelektual të shoqërisë në atë kohë.

Pavarësisht nga tipologjia e mosmarrëveshjes për të sqaruar çështjen që kërkonte njohuri të posaçme, Kadiu mund të thërriste ekspertë dhe përkthyes.

Në fund të shekullit 19-të, krahas normave të Sheriatit dhe atyre zakonore shqiptare, edhe në vendin tonë u ndërmorën reforma të rëndësishme për zhvillimin e shtetit dhe së drejtës, të cilat njihen në histori si Reformat e Tanzimatit. Kjo periudhë përkon me nxjerrjen e Kanunameteve (Kodet), pasi në vitin 1878 u miratuan për herë të parë Kodi Penal dhe Kodi i Procedurës Penale³⁰.

Këto kode u ndërtuan sipas modeleve të legjislacionit penal francez të vitit 1810. Legjislacioni penal otoman kishte një shmangie të theksuar nga normat e Sheriatit, ishte i plotë me institutet e pjesës së përgjithshme dhe figurat e veprës penale.

Këto Kode përshtatën sistemin procedural të përzier dhe sanksionuan për herë të parë parimin e ndarjes së pushteteve, të paanshmërisë së gjyqtarëve, të barazisë së palëve, mbrojtjes me avokat, parimin e një gjykimi të hapur, çmuarjes së provave sipas bindjes së brendshme të gjyqtarit³¹ etj.

U krijua sistemi i gjykatave shtetërore (nizamijet), të cilat vepronin në bazë të normave të Kodit të Procedurës Penale Otomane, duke vepruar për një kohë shumë të gjatë deri pas çlirimit të vendit.

Ky legjislacion procedural penal shënonte një hap të rëndësishëm drejt përparimit të shoqërisë, duke pësuar një shmangie nga normat e Sheriatit dhe tashmë me orientim sipas modelit demokratik perëndimor. Ai ishte i plotë me të gjitha normat dhe institutet e një legjislacioni modern. Si prova në procesin penal parashikoheshin:

- thëniet e dëshmitarëve;
- deklaratimet e të akuzuarit;
- provat materiale e ato shkresore;
- ekspertimi teknik.

Gjithashtu, si provë mund të shërbente dhe çdo njoftim që lidhej me veprën penale, autorin, pasojën dhe çdo dokument që shërbente për të zbuluar të vërtetën. Për marrjen e administrimit të provave në këtë Kod³² parashikoheshin në mënyrë të qartë të drejtat dhe detyrimet e subjekteve që ushtronin ndjekjen penale për gjetjen e administrimit të provave.

Si mjete të kërkimit të provave, Kodi përcaktonte:

- kontrollin e personave;
- këqyrjen e vendit të ngjarjes;
- kontrollin e vendbanimit të vendeve të tjera;
- sekuestrimet.

³⁰ I. Elezi, Zhvillimi historik i legjislacionit penal në Shqipëri, 1997, f. 18.

³¹ H. Islami, Demokratizimi i legjislacionit penal, 2000.

³² Kodi i Procedurës Penale, 1878.

Procedura Penale Otomane në fuqi në Shqipëri.

PROVAT DHE PROCESI I TË PROVUARIT NË PROCESIN PENAL

Sipas legjislacionit procedural penal otoman, organet që ushtronin ndjekjen penale ishin:

- prokurori, i cili në raste të caktuara i drejtonte vetë hetimet;
- gjyqtari hetues;
- policia gjyqësore.

Në përfundim të hetimeve, çështja dërgohej tek prokurori, i cili kishte kompetenca të plota për të vendosur kalimin e çështjes në gjykatë ose pushimin e saj³³. Veprime procedurale kryenin edhe nënprefektët, kryetarët e bashkive, komunave, rojtarët e fshatit, pyjeve etj., por ata kishin kompetenca të kufizuara hetimore në raport me prokurorin apo gjyqtarin hetues.

Përveç rregullave procedurale lidhur me mënyrën e kryerjes së këtyre veprimeve hetimore, marrjes së provave, administrimit të tyre, apo dhe të sendeve të sekuestruara, etj., në këtë Kod parashikohej edhe pavlefshmëria e këtyre veprimeve, pavlefshmëria e akteve, si dhe të vendimeve të marra nga organet kompetente lidhur me procedurën e ndjekur.

1.3. PROCEDURA GJYQËSORE PENALE DHE PROCESI I TË PROVUARIT GJATË VITEVE 1912-1953

Pavarësisht shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë nga sundimi otoman, praktikisht ishte e vështirë shmangia e menjëhershme e ndikimit të normave ligjore otomane, të cilat ishin zbatuar për 5 shekuj me radhë në vendin tonë. Vetë zhvillimi ekonomik-kulturor, si dhe ai politik i vendit tonë, ku sundonin ende marrëdhëniet feudale, me gjithë përpjekjet e mëdha për organizimin e drejtësisë, funksionimi i shtetit ishte pothuajse i paralizuar.

Për këtë arsye, edhe qeveria e sapokrijuar e shtetit të ri shqiptar, me vendim *necessitatis causa*,³⁴ u detyrua të vazhdonte të zbatonte legjislacionin ekzistues otoman deri në krijimin e legjislacionit të plotë shqiptar sipas adaptimeve bashkëkohore. Gjykatat vazhduan të ndiqnin rregullat e organizimit gjyqësor të Perandorisë Osmane dhe zbatonin ligjet materiale e procedurale turke mbi mjetet e kërkimit të provave, provat penale dhe procesin e të provuarit.

Një ndër aktet e para që miratoi Qeveria e Vlorës në sistemin e drejtësisë ishte Ligji dt. 10.05.1913 “Për organizimin gjyqësor”, apo siç quhet ndryshe “Kanuni i Zhurisë”. Mori këtë emërtim, për shkak të mënyrës së organizimit të procesit gjyqësor, i cili u parashikua të bëhej me Juri. Sipas Kanunit të Zhurisë³⁵, jepej nocioni i **Fajit** si vepër penale, e cila ka si bazë filozofike mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut. Sipas tij bëhet një ndarje e veprave penale në tri lloje, duke iu përshtatur legjislacionit penal të shteteve perëndimore:

- fajet të dëmeve (kundravajtje);
- fajet e vështira (delikte);

³³ H. Islami, Demokratizimi i legjislacionit penal, 2000, f. 13.

³⁴ N. Papuli, Organizimi i shtetit të parë shqiptar, Drejtësia Popullore, Nr. 5, 1962.

³⁵ I. Elezi, Kanuni i Zhurisë, Jeta Juridike, 2007, f. 7.

- fajet e shëmtimeve (krime).

Kjo procedurë e gjykimit me juri u përdor vetëm në një çështje të Elbasanit dhe më vonë u suprimua, pasi populli ynë nuk ishte i përgatitur për të përfaqësuar me juri³⁶.

Karakteristikat kryesore të zhvillimit të gjyqit mund të përmbledhen në³⁷:

1. I gjithë procesi zhvillohet sipas një rendi të caktuar, ku i lihet hapësirë e gjerë, liri e të drejta pjesëmarrësve të barabartë në proces, në radhë të parë të pandehurit, të shfaqë mendimet e tij lirisht dhe të mbrohet pa kufizime nga ai vetë apo avokati i tij.
2. U njihet e drejta pleqve të jurisë të bëjnë pyetje e të sqarojnë rrethanat e ngjarjes e personalitetin e të akuzuarit.
3. U garantohet fshehtësia pleqve të jurisë, të tërhiqen në dhomë të veçantë, larg çdo ndërhyrjeje nga jashtë, të shqyrtojnë me kujdes çështjen, të diskutojnë lirshëm dhe të japin votën e tyre të fshehtë për dënimin e autorit.
4. Vendimi i pleqve të jurisë shpallet nga kryetari i jurisë në prani të gjykatës, prokurorit, të pandehurit e pjesëmarrësve të tjerë në procesin gjyqësor.

Karakteristikë e Kanunit të Zhurisë është dhe **Gjykimi pa shfaqje** (në mungesë)³⁸ i parashikuar në pjesën e katërt të tij, duke përcaktuar shprehimisht rregulla të qarta procedurale për zhvillimin e këtij procesi gjyqësor, duke përcaktuar të drejtat dhe detyrimet e të akuzuarit dhe përfaqësuesit të tij, si dhe të drejtën e ankimit të vendimit. E drejta e ankimit të vendimit të dënimit ishte e kushtëzuar me faktin, nëse i akuzuari ishte i burgosur apo jo. Për një të akuzuar për të cilin ishte dhënë vendimi në mungesë, për shkak se ai ndodhet i arratisur, nuk pranohej ankimi nga gjykata.

Pavarësisht se sipas këtij ligji u vendos që gjykimet të bëhen në gjuhën shqipe, ky vendim nuk u zbatua menjëherë, për shkak të mosnjohjes së gjuhës së shkruar shqipe nga ana e gjyqtarëve. Kanuni i Zhurisë, edhe pse me jetëgjatësi të shkurtër në aplikimin e normave të tij, la gjurmë historike në sistemin gjyqësor shqiptar dhe për këtë fakt, edhe sot, data 10 maj vazhdon të kremtohet si Dita e Drejtësisë Shqiptare.

Më datë 10 prill 1914, u hartua nga ana e Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit, i cili ishte ngarkuar nga Konferenca e Ambasadorëve të Londrës, ligji i parë kushtetues “Mbi statusin organik të Shqipërisë”. Sipas normave të këtij Statuti, sistemi gjyqësor organizohej sipas këtyre hallkave: “Në bazë të Statutit të vitit 1914, që është dhe ligji i parë kushtetues i shtetit shqiptar, sistemi gjyqësor, përbëhej nga Këshilli i Pleqve, Gjyqtarët e paqit, Gjykatat e Shkallës së Parë dhe Gjykatat e Apelit. Gjykatat e Shkallës së Parë gjykonin me një gjyqtar dhe dy anëtarë joprofesionistë, si dhe ishin instancia Apeli për vendimet e Gjykatave të paqit.³⁹”.

Në vitin 1915, me ardhjen në fuqi të Esat Pashë Toptanit, u parashikua dhe një gjyq tjetër pa marrë parasysh organizimin gjyqësor sipas Statutit.

Ky organizim i sistemit gjyqësor pësoi disa herë ndryshime në vitet në vazhdim, duke u përshtatur sistemeve gjyqësore të pushtesve të huaj. Kështu, pas pushtimit austro-

³⁶ I. Elezi, Zhvillimi historik i legjisllacionit penal në Shqipëri, 1998, f. 38.

³⁷ I. Elezi, Kanuni i Zhurisë, Jeta Juridike, 2007, f. 13.

³⁸ I. Elezi, Kanuni i Zhurisë, Jeta Juridike, 2007, f. 13.

³⁹ H. Islami, Demokratizimi i legjisllacionit penal, 2000.

PROVAT DHE PROCESI I TË PROVUARIT NË PROCESIN PENAL

hungareze në vitin 1916 u organizuan Gjykata e Shkallës së Parë në nënprefektura dhe një Gjykatë Apeli në qytetin e Shkodrës, duke vënë në zbatim Ligjin e Paqit.

Gjyqet penale shqyrtoheshin prej gjykatave ushtarake sipas rregullave të luftës. Pas pushtimit nga Italia, kryesisht të pjesës jugore të vendit, në maj të vitit 1919, sistemi gjyqësor pësoi një degradim dhe nuk vepronin as gjykatat civile, as ato penale. U riorganizuan Gjykatat paqtuese në qarqet e Durrësit, Elbasanit, Beratit e Shkodrës dhe Gjykatat e Diktimit, ndërsa në zonat malore vazhdonte të zbatoheshin drejta zakonore penale. Riorganizimi i sistemit gjyqësor filloi pas Kongresit të Lushnjës, me shpalljen e Dekretit të Këshillit të Naltë, dt. 11.01.1921, sipas të cilit sistemi gjyqësor përbëhej nga 18 Gjykata paqtuese, 7 Gjykata të Shkallës Parë dhe një Gjykatë diktimi me qendër në Shkodër.⁴⁰

Ky organizim pësoi përsëri ndryshime me ligjin e dt. 27.01.1923, i cili tashmë përbëhej nga Gjykata paqtuese, Gjykatat fillore dhe Gjykata e Diktimit, e cila u zhvendos me qendër në Tiranë.

Gjatë viteve '20-të, shteti shqiptar miratoi një sërë aktesh ligjore dhe nënligjore që përmbanin norma me karakter penal dhe procedural penal. Si akte të rëndësishme nënligjore përmendim: "Rregulloren e detyrave të policisë", miratuar nga Ministri i Brendshëm, dt. 20.02.1921, në të cilën u bënë parashikime të karakterit procedural penal për policinë gjyqësorë, kryesisht për mjetet e kërkimit të provave, manualin "Mbi hetimet fillimtare"⁴¹, me autor Josif Haxhimima, i cili ishte i detyrueshëm për zbatim për të gjitha organet e policisë, hetuesisë dhe prokurorisë, "Rregulloren e përkohshme nr. 289" dt. 9.03.1920 për ngritjen e Komisioneve të Nënprefekturave, të cilat do të ndëshkonin fajtorët sipas zakoneve të vendit, *Ligja ndëshkimore nr.1089 për fajet politike dt. 27.04.1920, i cili parashikonte një sërë figurash të krimit kundër shtetit.*

Me hyrjen në fuqi të Dekret-ligjit⁴² dt. 02.05.1925 "Për organizimin e gjykatave të drejtësisë", sistemi gjyqësor u organizua sipas ndarjes administrative të atëhershme. Në çdo nënprefekturë u ngritën gjykatat e shkallës së parë, ndërsa gjykatat e apelit u ngritën në qendrat e prefekturave, si dhe një gjykatë diktimi me qendër në Tiranë, e cila ndahej në dy degë: civile dhe penale. Ky dekret-ligj përcaktonte si subjekte procedurale që ushtronin ndjekjen prokurori dhe gjyqtari hetues.

Më pas, ky organizim u ndryshua me miratimin e Statutit Themeltar të Mbretërisë⁴³ Shqiptare më dt. 1 dhjetor 1928, i cili në aktin 118 parashikonte se: *Organizimi, të drejtat dhe kompetencat e gjyqeve caktohen me ligj*". Mbi bazën e këtyre përcaktimeve Kushtetuese u miratuan dhe një sërë ligjesh në fushën e drejtësisë. Me Ligjin⁴⁴ "Mbi organizimin e Drejtësisë" dt. 07.02.1929, ku u krijuan Gjyqet e paqit në nënprefektura, Gjykatat e shkallës parë, të cilat ndaheshin në Gjykatat fillore dhe Gjykatat kolegjiale, si dhe Gjykata e diktimit me qendër në Tiranë. Me ligj të veçantë u krijuan dhe gjykimet e posaçme, marrë si model nga legjislacioni italian.

⁴⁰ H. Islami, Demokratizimi i legjislacionit penal, 2000, f. 14.

⁴¹ J. Haxhimima, Mbi hetimet fillimtare, Mbrothësia.

⁴² Fletorja Zyrtare Nr. 19 dt. 11.05.1925.

⁴³ Statuti themeltar i Mbretërisë së Bashkuar, 1997, kap. 3, pjesa 4, f. 20.

⁴⁴ Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 6 të vitit 1929.

PROVAT DHE PROCESI I TË PROVUARIT NË PROCESIN PENAL

*Sipas këtij ligji bëhej gjykimi drejtpërsëdrejti për faje flagrante dhe dekret penal për delikte dhe kundravajtje të lehta që dënoheshin me gjobë ose burgim deri në një muaj.*⁴⁵

Me dekretin e dt. 03.06.1928, gjatë qeverisjes së mbretit Zog, u hartua dhe miratua Kodi Penal Shqiptar dhe Ligji “Mbi aplikimin e Kodit Penal”⁴⁶, të cilat hynë në fuqi më dt. 01.12.1928. Gjithashtu, u miratuan dhe Ligji “Për organizimin e gjykatave të drejtësisë”, dt. 01.04.1929, Ligji “Për ushtrimin e avukaturës”, i dt. 05.06.1931 etj.

Kodi Penal Shqiptar zëvendësoi Kodin Penal Otoman të vitit 1878, duke u përshtatur në legjislacionin perëndimor, kryesisht atë italian, të vitit 1889. Për disa institute që nuk parashikoheshin në Kodin Penal Italian u përdoren si modele kodet penale të shteteve evropiane, konkretisht:

- dënimi me kusht;
- lirimi para kohe me kusht i të dënuarit;
- qortimi gjyqësor;
- pagimi vullnetar i gjobës për kundravajtje etj.⁴⁷

Hetimet drejtoheshin nga ana e prokurorëve të shtetit, të cilët vareshin nga Kryeprokurori i Shtetit, dhe të gjithë prokurorët vareshin nga Ministri i Drejtësisë. Hetimet kryheshin nga gjyqtarët hetues, të cilët në përfundim ia dërgonin të gjitha materialet hetimore Prokurorit të Shtetit. Prokurori më pas vendoste për mënyrën e përfundimit të hetimeve: nëse e dërgonte për gjykim, formulonte akt-gjykimin, në të cilin pasqyronte edhe provat, mbi të cilat e bazonte akuzën konkrete.

Karakteristikë e veçantë e Kodit Penal ishte se në të u parashikuan mjaft dispozita procedurale penale, të cilat normonin e rregullonin institute të së drejtës procedurale penale. Në nenet e këtij kodi parashikohej dhe përcaktohej qartë përgjegjësia penale e dëshmitarëve, kallëzuesve, ekspertëve e dragomanëve (përkthyesit) për kryerjen e një ekspertimi, dhënien e dëshmisë, kallëzimin apo përkthimin e rremë⁴⁸.

Me mjaft rëndësi ishin parashikimet e bëra përmbajtje të këtij kodi, ku përjashtohej nga detyrimi, dëshmitari për të dëshmuar, fakte e rrethana prej të cilave rezulton përgjegjësia e tij penale apo ndaj personave që ishin gjini e afërt me dëshmitarin. Sipas Statutit Themeltar të Mbretërisë Shqiptare⁴⁹ u sanksionua gjithashtu edhe detyrimi i gjykatave për arsyetimin e vendimeve gjyqësore, si dhe dhënien e tyre bazuar në ligj e në prova.

Gjatë kësaj periudhe, rol të rëndësishëm ka luajtur Gjykata e Diktimit dhe sidomos vendimet e Këshillit të Përgjithshëm të Gjykatës së Diktimit, të cilat, nëpërmjet interpretimeve që bëri këshilli, krijuan praktikë gjyqësore të detyrueshme për t'u zbatuar nga shkallët e tjera të gjyqësorit në çështje analoge⁵⁰.

Përmitësimet në Legjislacionin Procedural Penal të kësaj periudhe u bënë dhe me procedurën penale ushtarake për kohë paqeje. Kështu, më 19.06.1932 u miratua Kodi

⁴⁵ H. Islami, Demokratizimi i legjislacionit penal, 2000.

⁴⁶ Miratuar nga Dhoma Legjislative në dt. 28.05.1927.

⁴⁷ I. Elezi, Zhvillimi historik i legjislacionit penal në Shqipëri, 1998, f. 41.

⁴⁸ Nenet 239, 240 të K. Penal të vitit 1928.

⁴⁹ Statuti Themeltar i Mbretërisë së Bashkuar, 1997.

⁵⁰ F. Elezi, Punim shkencor mbi provat në procesin penal, f. 19.

PROVAT DHE PROCESI I TË PROVUARIT NË PROCESIN PENAL

Penal Ushtarak, i cili edhe ky u ndërtua sipas modelit italian⁵¹. Gjithashtu, u miratuan dhe një sërë ligjesh me karakter procedural, si Ligji “Mbi aplikimin e Kodit Penal”, Ligji “Mbi ndjekjen dhe gjykimin e nëpunësve të shtetit”, Ligji “Mbi disa gjykime të posaçme në çështje penale” etj.⁵². Sipas Ligjit “Mbi përmirësimin e dispozitave procedurale dhe të ligjit të përbarimit në fuqi” të vitit 1937 u njoh e drejta e prokurorit për rekurse kundër vendimeve të pafajësisë për krimet.

Përmbajtja e Kodit Penal dhe ligjeve penale që dolën gjatë regjimit të mbretit Zog, ishin një armë e fuqishme në duart e shtetit të asaj kohe dhe duhet thënë se luajtën një rol të madh në luftën kundër kriminalitetit në përgjithësi⁵³.

➤ Pas pushtimit nga Italia, në 7 prill 1939, ajo që të bie në sy është se organizimi gjyqësor u la ai që ishte, ashtu sikurse dhe formalisht u la në fuqi dhe Kodi Penal i vitit 1928, por krahas tij u miratuan ligje penale në funksion dhe mbrojtje të interesave të pushtuesve siç ishte dhe Dekreti i Mëkëmbësit të Përgjithshëm të Perandorit në Shqipëri Nr. 288, “Mbi deliktet kundër personalitetit shtetëror⁵⁴”, dt. 31.12.1939.

Sipas këtij dekreti u ngritën Gjykatat Ushtarake të fuqive të armatosura, të cilat e kryenin veprimtarinë procedurale sipas legjislacionit procedural të pushtuesit. Hetimi i veprave penale në kompetencë të gjykatës ushtarake kryhej nga organet e specializuara të karabinierisë, policisë militare, si dhe ato të administratës ushtarake, ndërsa organet ekzistuese të hetimit vazhduan ta ushtronë aktivitetin e tyre si më parë⁵⁵.

Atributet e policisë gjyqësore për kryerjen e veprimeve të para hetimore, duke përdorur mjetet e kërkimit provave dhe marrjen e tyre u parashikuan në Dekretin “Mbi trupën e armatosur të policisë”, dt. 31.08.1939, i cili u ndryshua tre vjet më pas me Dekret-ligjin “Mbi atributet e autoriteteve me funksione policie”.

Në këtë Dekret-ligj parashikoheshin si subjekte procedurale, që kishin të drejtë të kryenin veprime të para hetimore edhe kryetarët e komunave, rojet e burgjeve, bashkive, pyjeve, tagrambledhësit.

Pas kapitullimit të Italisë dhe pushtimit nazist në zonat e çliruara, apo që zotëroheshin nga forcat nacionalçlirimtare, u organizuan e funksionuan edhe gjyqet partizane, të cilat gjykonin pa ndonjë procedurë të përcaktuar dhe zbatonin vetëm udhëzimet e nxjerra nga komandat ushtarake. Objekt i këtyre gjykimeve ishin kryesisht vepra të tilla, si: tradhtia, dezertimi, spiunimi, vjedhja e plaçkitja, vrasja, si dhe krimet kundër Luftës Nacionalçlirimtare⁵⁶.

Burim kryesor dhe i parë i së drejtës penale pas çlirimit ishte Rregullorja e Këshillave Nacionalçlirimtarë, e cila u miratua në Rezolucionin e Konferencës së Pezës e dt. 16.09.1942, sipas së cilës:

Në zonat e çliruara, Këshillat Nacionalçlirimtarë kishin detyrë: të mbanin rregullin, qetësinë, të luftonin kundër tradhtarëve, të kontrollonin qarkullimin e personave, të

⁵¹ I. Elezi, Zhvillimi historik i legjislacionit penal në Shqipëri, 1998, f. 46.

⁵² Ligji “Mbi ndjekjen penale e gjykimin e kundra nëpunësve civil të shtetit”; Ligji “Mbi pushimin e përvjetshëm të gjyqeve të drejtësisë”.

⁵³ I. Elezi, Zhvillimi historik i legjislacionit penal në Shqipëri, 1998, f. 49.

⁵⁴ I. Elezi, Zhvillimi historik i legjislacionit penal në Shqipëri, Flerore Zyrtare Nr.14 (dt. 29.01.1940), 1998, f. 57.

⁵⁵ F. Elezi, Punim shkencor mbi provat në procesin penal, f. 2.

⁵⁶ H. Islami, Demokratizimi i legjislacionit penal, 2000, f. 16.

PROVAT DHE PROCESI I TË PROVUARIT NË PROCESIN PENAL

*luftonin kriminalitetin, për disa konflikte këshillat bënin gjyqe dhe veçanërisht pajtonin gjaqe, sidomos për sa kohë do të ishte pushtuesi në vendin tonë*⁵⁷.

Për këtë periudhë nuk mund të flitet për legjislacion procedural në kuptimin e mirëfilltë të tij. Më 16 nëntor 1944 u miratua dhe “Rregullorja mbi funksionimin e gjyqeve ushtarake”, sipas të cilës gjyqtari nuk ishte i lidhur nga provat, por e jepte vendimin sipas gjykimit të lirë. Masa e sigurimit jepej nga prokurori bashkë me kryetarin ose një anëtar i këshillit gjyqësor⁵⁸.

Miratimi i Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë më dt. 14.03.1946, shërbeu si burim kryesor i legjislacionit penal e procedural penal. Në bazë të këtyre parimeve kushtetuese u shpall Ligji nr. 382, dt. 24.12.1946 “Mbi dispozitat e përgjithshme penale”, të cilat, edhe pse karakterizoheshin nga norma me karakter demokratik, nuk u zbatuan në praktikë, përkundrazi, metodat e përdorura në mjaft raste u bënë në shkelje të hapur të drejtave dhe lirive të njeriut⁵⁹.

Gjithashtu, gjatë kësaj periudhe u miratuan një sërë ligjesh me karakter penal dhe procedural penal për krime të ndryshme në fusha të caktuara, të cilat kryesisht mbronin shtetin dhe jo individin.

1.4. PROCESI I TE PROVUARIT DHE PROVAT PENALE SIPAS K. PR. PENALE TË VITIT 1953

Kodi i Procedurës Penale i miratuar më datë 30.03.1953 ka vepruar për një kohë relativisht të gjatë deri në miratimin e ndryshimeve të këtij kodi në fillim të viteve '80. Në dispozitat e këtij kodi u përcaktuan për herë të parë rregullat procedurale në procesin penal, por që kishin më tepër karakter inkuizitor. Kjo periudhë është karakterizuar nga shkelje të rënda të të drejtave të pandehurve; ushtrimi i dhunës fizike e psikike aplikohet rëndom gati në të gjitha proceset hetimore.

Dispozitat procedurale mbi provat nuk jepnin një nocion të qartë të kuptimit të provave. Në nenin 60 e vijues të tij përcaktohej kuptimi i provave penale, si dhe llojet e provave që shërbenin në procesin e të provuarit në procedurë penale.

Konkretisht, Kodi i Procedurës Penale i vitit 1953 ka parashikuar këto lloje provash: *thëniet e dëshmitarëve, të pandehurve, mendimet e ekspertëve, provat materiale e dokumentet me shkrim, si dhe procesverbalet e veprimeve hetimore e gjyqësore*. Përgjimet, vëzhgimet, fotografimet dhe filmimet e fshehta, ndonëse aplikoheshin nga ana e organeve të gjurmimit dhe hetimit, nuk parashikoheshin si burime apo prova në procesin penal.

Këto mjete kërkimi provash aplikoheshin nga hetuesia e sigurimit të shtetit dhe organet e gjurmimit për krimet kundër shtetit e njoftimet; provat që rezultojn nuk mund të përdorreshin në procesin penal. Aplikimi i këtyre burimeve bëhej në kuadrin e

⁵⁷ I. Elezi, Zhvillimi historik i legjislacionit penal në Shqipëri, 1997, f. 65.

⁵⁸ H. Islami, Demokratizimi i legjislacionit penal, 2000, f. 17.

⁵⁹ I. Elezi, Zhvillimi historik i legjislacionit penal në Shqipëri, 1997, f. 82.

PROVAT DHE PROCESI I TË PROVUARIT NË PROCESIN PENAL

veprimtarisë operative, të fshehtë; ato rregulloheshin me akte nënligjore të nxjerra nga Ministria e Brendshme, si dhe vendime të Byrosë Politike të partisë-shtet⁶⁰.

Në kapitullin XII të pjesës së dytë të këtij kodi⁶¹ parashikoheshin rregullat procedurale të pyetjes së dëshmitarëve, rastet e papajtueshmërisë së dëshmitarit (me të meta fizike e psikike), deklaratimet e të pandehurit dhe gjithashtu parashikohej e rregullohej ekspertimi si provë në procesin penal. Kjo mënyrë e të provuarit bëhej në rastet kur kërkoheshin njohuri të posaçme në fusha të caktuara.

Kontrollet, sekuestrimet e këqyrjet kryheshin nga hetuesi pa kurrfarë rregullash procedurale e garancish për personat që cenoheshin nga këto mjete kërkimi. Nga hetuesi disponohej lirisht dhe pa asnjë kufizim me vendim për kryerjen e tyre. Rezultatet e kontrolleve, kryerja e sekuestrimeve pasqyroheshin në procesverbalet përkatëse të përpiluara nga hetuesi, në prani të personave të besuar.

Aktet ligjore të nxjerra gjatë viteve '60-të, sollën një "kthim mbrapa në kohë", të dukshme në marrëdhëniet procedurale penale dhe në vetë proceset penale, në shkëlqje të rëndë të të drejtave procedurale të personave të akuzuar e duke i hapur rrugë arbitraritetit dhe abuzimit. Sipas këtyre dispozitave ligjore ju dha më shumë përparësi organeve të hetimit, duke mënjeluar rolin e prokurorisë gjatë procesit të hetimit të veprave penale dhe mbledhjes së provave.

Gjykatat e fshatrave, qyteteve dhe lagjeve u krijuan për herë të parë si hallka të sistemit gjyqësor, kompetencat e të cilave u përcaktuan me ligjin "Mbi organizimin gjyqësor" që hyri në fuqi më 1 tetor 1968. Këto gjykata i zhvillonin proceset me një procedurë të thjeshtë⁶².

Një çështje penale mund të fillonte me kërkesën e prokurorit, nga organizatat shoqërore, këshillat popullore ose dhe nga organet e policisë. Një kërkesë e tillë i jepte të drejtë gjykatës të fillonte çështjen penale ose kundërvajtjen. Hetimet paraprake në këtë rast bëheshin nga vetë gjykata, duke pyetur të paditurin ose të akuzuarin, dhe personat që mund të jepnin sqarimet e duhura. Vetëm në rastet kur nevojiteshin hetime më të plota ua dërgonte çështjen për hetim organeve të policisë, e cila kishte kompetencë për kryerjen e hetimeve dhe mbledhjen e provave të tjera. Shpjegimet e personave që gjykohen, si dhe provat e nevojshme për sqarimin e çështjes merreshin gjatë zhvillimit të gjykimit, të cilat pasqyroheshin në një procesverbal⁶³.

1.5. PROVAT PENALE DHE PROCESI I TË PROVUARIT SIPAS KODIT TË PROCEDURËS PENALE TË VITEVE 1979-1992

Thellimi i vazhdueshëm i luftës së klasave, përqendrimi i pushtetit në duart e Partisë së Punës, lufta kundër burokratizimit dhe liberalizimit diktoi nevojën e rishikimit të normave ligjore, që rregullonin legjislacionin penal dhe procedural penal të RPSSH-së.

⁶⁰ F. Elezi, Punim shkencor mbi provat në procesin penal, f. 26.

⁶¹ Kodi i Procedurës Penale, nenet 160-172.

⁶² Mbi organizimin dhe kompetencat e gjykatave të fshatrave, qyteteve dhe lagjeve të qyteteve, 1969, nenet 14 e vijues.

⁶³ Mbi organizimin dhe kompetencat e gjykatave të fshatrave, qyteteve dhe lagjeve të qyteteve, 1969, nenet 14 e vijues.

PROVAT DHE PROCESI I TË PROVUARIT NË PROCESIN PENAL

Kodi Penal u miratua me Ligjin nr.5591, dt. 15.06.1977, ndryshuar me ligjin nr. 6300, dt. 27.03.1981 dhe shprehte vullnetin e klasës punëtore si një armë e fuqishme e diktaturës së proletarietit. Legjislacioni penal kishte si detyrë dhe qëllim të ndihmonte në ndërtimin e plotë të socializmit dhe edukimin e masave me frymën e respektimit të ligjit⁶⁴.

Kodi i Procedurës Penale miratuar me ligjin nr. 6069, dt. 25.12.1979 hyri në fuqi në dt. 01.04.1980, ndryshuar me Ligjin nr. 6300, dt. 27.03.1981. Ai zëvendësoi Kodin e mëparshëm të Procedurës Penale të vitit 1953 dhe ishte i ndarë në pjesën e përgjithshme dhe pjesën e posaçme. Ashtu sikurse Kodi Penal, dhe ky kod shprehte vullnetin e klasës punëtore dhe ishte mjet i rëndësishëm i diktaturës së proletarietit, duke caktuar rregulla të qarta për hetimin dhe gjykimin e çështjeve penale⁶⁵.

Kufizimi i kompetencave dhe shmangia e prokurorisë nga procedura e hetimit të veprave penale, tashmë u kodifikua plotësisht në dispozitat procedurale të këtij kodi, duke përcaktuar se organi që zhvillon hetimet për çështje penale është **hetuesia**⁶⁶. Hetuesi kishte kompetenca të plota në drejtimin dhe zhvillimin e hetimeve për zbulimin e veprës dhe të fajtorit, si dhe në marrjen e çdo vendimi.

Kuptimi i provave parashikohej në Kreun III të kodit, në nenet 15 e vijues të tij. *Provë do të konsideroheshin të gjitha të dhënat që merreshin në formën e parashikuar nga ky kod dhe që vërtetojnë kryerjen ose jo te veprës penale, fajësinë ose pafajësinë e personit, shkallën e përgjegjësisë dhe personalitetin e tij, si dhe pasojën e ardhur nga vepra penale*⁶⁷.

Të drejtën për të kërkuar dhe marrë prova nga çdo organ shtetëror, organizatë shoqërore, si dhe nga çdo individ e kishte vetëm gjykata dhe hetuesia.

Si burime të provave në bazë të kodit të procedurës penale të RPSSH-së konsideroheshin: *Thëniet e të pandehurve, thëniet e dëshmitarëve, ekspertimi, provat materiale dhe dokumentet.*

Pyetja e të pandehurve dhe thëniet e tyre kishin të njëjtën vlerë si provat e tjera. Ata pyeteshin, pasi u ishte njoftuar akuza, brenda 24 orëve nga njoftimi i vendimit për marrjen si i pandehur. Pyetja e të pandehurit bëhej nga organi i hetuesisë pa asnjë rregull procedural në shkelje të të drejtave themelore të individit, duke i mohuar të drejtën e mbrojtjes me përfaqësues ligjor dhe vetëm për personat e mitur nën moshën 16 vjeç lejohej prania e një arsintari ose personi tjetër, por edhe kjo, kur çmohej e nevojshme. Gjatë procesit të marrjes në pyetje të të pandehurit mbaheshin procesverbale, në të cilat shënoheshin pyetjet e hetuesit, si dhe përgjigjet e të pandehurit. Ky procesverbal i bashkohej në cilësinë e provës materiale dosjes së hetimit të çështjes⁶⁸.

Dëshmitar mund të thirrej çdo person që kishte dijeni për veprën penale ose autorin e saj. Ai dëshmonte para gjykatës ose organit të hetuesisë. Në dëshminë e tij, ai duhej të bazohej në fakte dhe rrethana të cilat ishte i detyruar të tregonte edhe burimin e tyre,

⁶⁴ Kodet e Republikës së Shqipërisë, 1982, f. 401 e vijues.

⁶⁵ Kodet e Republikës së Shqipërisë, 1982, f. 547 e vijues.

⁶⁶ Kodi i Procedurës Penale, 1982, neni 7.

⁶⁷ Kodi i Procedurës Penale, 1982.

⁶⁸ Kodi i Procedurës Penale, nenet 22, 1982.

PROVAT DHE PROCESI I TË PROVUARIT NË PROCESIN PENAL

përndryshe dëshmia e tij nuk mund të konsiderohej si provë. Dëshmitarët pyeteshin veç e veç dhe gjatë këtij procesi mbahej procesverbal nga ana e hetuesit të çështjes⁶⁹.

Ekspertimi si provë në procesin penal kërkohej kur, për sqarimin e fakteve dhe rrethanave të çështjes, nevojiteshin njohuri të posaçme në fusha të caktuara, si: shkencë, art, teknikë. Kryerja e ekspertimit bëhej me vendim të gjyqtarit të vetëm ose të hetuesit të çështjes. I pandehuri kishte të drejtë që të kërkonte përjashtimin e ekspertit ose të caktonte dhe vetë ekspertë të tjerë. Ekspertimet kryheshin nga specialistë të institucioneve shtetërore, të cilët kishin njohuri të posaçme teknike e shkencore. Përveç konkluzioneve të cilat ishin të detyrueshme të jepeshin me shkrim, ekspertët mund të merreshin dhe në pyetje gjatë gjykimit të çështjes penale⁷⁰.

Krahas këtyre, si prova në procesin penal konsiderohehin *sendet dhe dokumentet*, të cilat kishin shërbyer si mjete për kryerjen e veprës penale ose kishin qenë objekt i veprimeve të të pandehurit. Këto konsiderohehin si *prova materiale* dhe i nënshtrohehin hetimit të plotë, si nga gjykata, ashtu dhe nga hetuesia.

Provat materiale përshkruheshin hollësisht në procesverbal dhe i bashkoheshin dosjes së hetimit të çështjes. Në përfundim të gjykimit të çështjes, në vendimin përfundimtar përcaktohej dhe se çfarë do të bëhej me provat materiale, të cilat, sipas rastit, ose kalonin nën administrimin e shtetit, ose zhdukeshin, ose, në raste të rralla, mund t'ju ktheheshin personave që ju përkisnin.

Si prova materiale konsiderohehin dhe të gjitha *dokumentet, procesverbalet e veprimeve hetimore dhe gjyqësore* të mbajtura për çështjen penale, si dhe çdo dokument tjetër i përpiluar me shkrim, në të cilin pasqyroheshin fakte dhe rrethana, të cilat kishin rëndësi për çështjen. Në cilësinë e provës në procesin penal ishte parashikuar dhe *përktlyesi*, i cili thirrej nga gjykata ose hetuesi në rastet kur i pandehuri nuk dinte gjuhën shqipe, apo kur dokumentet ishin në gjuhë të huaj⁷¹.

Ashtu sikurse e cituam dhe më lart, ajo çka të bie në sy në dispozitat procedurale të këtij kodi është se e gjithë procedura hetimore, formulimi i aktakuzës, vendimi i fillimit ose pushimit të një çështjeje penale dhe dërgimi i të pandehurit në gjykatë ishin kompetencë e *Organit të Hetuesisë*, duke e lënë Prokurorinë në një rol pasiv dhe duke e veshur vetëm me kompetencat e një kontrollori të veprimtarisë procedurale.

Për realizimin e këtyre detyrave, prokurori kishte të drejtë të njihej në çdo kohë me të gjithë materialin e çështjes nën hetim, si dhe kishte të drejtë të asistonte gjatë veprimeve hetimore që bënte hetuesi. Megjithëse ky kod pësoi ndryshime me kalimin e viteve, në thelb nuk e ndryshuan karakterin dhe përmbajtjen e tij.

Ndryshimet politike pas viteve '90-të sollën nevojën për ndryshime thelbësore dhe në legjislacionin aktual, duke u përshtatur tashmë dhe me këto ndryshime demokratike në vend. Bazuar në Ligjin Themeltar nr. 7491, dt. 29.04.1991 "Për dispozitat kryesore Kushtetuese⁷²" u bënë ndryshime të rëndësishme me Ligjin nr. 7536, dt. 17.12.1991 "Për disa ndryshime në K. Pr. Penale⁷³". U shfuqizuan të gjitha dispozitat procedurale

⁶⁹ Kodi i Procedurës Penale, nenet 80-81, 1982.

⁷⁰ Kodi i Procedurës Penale, nenet 25-26, 1982.

⁷¹ Kodi i Procedurës Penale, neni 27.

⁷² Fletorja Zyrtare Nr.4, dt.17.7.1991.

⁷³ Ligji nr.7536, dt. e Aktit:17.12.1991, dt. e Miratimit:17.12.1991, Flet. Zyrtare Nr.10, F. 435.

penale me karakter politik e klasor, duke u përcaktuar bazat dhe parimet e legjislacionit procedural penal me karakter demokratik⁷⁴.

Në ndryshimet që iu bënë Kodit të Procedurës Penale u bënë rregullime edhe sa i takon provave dhe mjeteve të kërkimit të provës, duke rritur garancinë procedurale të personave të proceduar. Sipas nenit 63/1 të KPP të vitit 1992, u përcaktua se organi që ka të drejtë të fillojë çështjen penale është prokurori, i cili ka gjithashtu të drejtë për kryerjen e veprimeve procedurale.

Është detyrë e hetuesit dhe e prokurorit të kryejnë hetime të plota dhe të gjithanshme për vërtetimin veprës dhe përgjegjësinë penale. Në K. Pr. Penale u sanksionuan disa kërkesa të rëndësishme procedurale, si: *respektimi i ligjshmërisë, objektiviteti, plotësia, ngjashmëria dhe karakteri jopublik i hetimeve*⁷⁵.

Si prova në procesin penal parashikoheshin: *pyetja e të pandehurit*, por në ndryshim nga kodet e mëparshme tani njihej e drejta e mbrojtjes me avokat dhe, gjatë marrjes në pyetje, prokurori ishte i detyruar të zbatonte disa kritere procedurale. *Pyetja e dëshmitarëve, ballafaqimi*, që nënkuptonte pyetjen e dëshmitarëve në prani të të pandehurit. Pyetjet që mund t'i drejtoheshin dëshmitarit ndaheshin në: pyetje plotësuese, pyetje ndihmëse dhe pyetje kontrolluese.

Paraqitja për njohje, e cila kryhet për të konstatuar nëse një person që pyetet është në gjendje të njohë një person apo send për të cilin ka folur në dëshminë e tij; *ekspertimi*, kur kërkohen njohuri të posaçme në fusha të caktuara. *Kontrolli*, që konsiston në marrjen e objekteve që kanë rëndësi në zbardhjen e çështjes dhe zbulimin e autorëve të veprës penale.

Sekuestrimi - këqyrja e vendit të ngjarjes, e personave të gjallë apo kufomave, e dokumenteve apo objekteve, të cilat kanë rëndësi si provë në çështjen penale. *Eksperimenti hetimor* - që kryhet për të verifikuar saktësinë e një prove nëpërmjet riprodhimit artificial të ngjarjes apo rrethanave të ndryshme të saj.

Sekuestrimi - me anë të cilit merren objekte që kishin lidhje me çështjen në gjykim.

*Këqyrja - veprimi procedural për të zbuluar dhe fiksuar gjurmët e veprës penale*⁷⁶.

Gjatë gjykimit të një çështjeje penale, prokurori ka të drejtën e pretencës, e cila, nga pikëpamja e ndërtimit, duhet të jetë e përbërë nga këto elemente: 1. *çmuarja e çështjes*; 2. *analiza dhe çmuarja e provave*; 3. *cilësimi juridik i veprës*; 4. *të kërkojë deklarimin e fajësisë të të akuzuarit nga gjykata*.

Ndryshimet demokratike në vend diktuan nevojën e pasqyrimeve të herëpashershme të këtyre ndryshimeve dhe në legjislacionin penal dhe procedural penal gjatë viteve në vazhdim, me qëllim shmangien totalisht të karakterit inkuizitor dhe pabarazisë së palëve në të gjitha fazat e procesit penal, sidomos gjatë hetimit, duke vendosur në themel të tyre mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, si dhe respektimin e parimeve të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut, ndryshime të cilat do të trajtohen gjatë zhvillimit të kësaj teme.

⁷⁴Ligji "Për disa ndryshime në Kodin e Procedurës Penale në Republikën e Shqipërisë", nr. 7536, dt. 17.12.1991.

⁷⁵Përmbledhje leksionesh për Fakultetin e Drejtësisë, f. 24.

⁷⁶Përmbledhje leksionesh për Fakultetin e Drejtësisë.

1.6. PARASHIKIMET E KONVENTËS EVROPIANE PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE TË NJERIUT PËR TË DREJTËN E PROVËS DHE PROCESIN E TË PROVUARIT

E drejta e provës është një e drejtë absolutisht aq e rëndësishme, saqë nuk mund të mendohej që të mos ishte mbrojtur nga Kushtetuta dhe nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Sipas Kushtetutës⁷⁷ tonë, ajo gjendet e harmonizuar dhe e trajtuar mjaft mirë tek pjesa hyrëse e saj dhe parimet e përgjithshme.

Në nenin 3 të saj parashikohet, ndërmjet të tjerash, se të drejtat dhe liritë e individit janë baza e shtetit tonë që ka për detyrë t'i respektojë dhe t'i mbrojë ato.

Në nenin 4 parashikohet, shprehimisht, se e drejta përbën bazën dhe kufijtë e veprimtarisë së shtetit, çfarë do të thotë se parashikohet edhe ekzistenca e të ashtuquajturit shtet ligjor dhe shtet i së drejtës.

Ligjet që dalin në përputhje me Kushtetutën dhe aktet ndërkombëtare duhet të respektojnë parimet bazë të shtetit të përcaktuara në Kushtetutë dhe në fund, nga perceptimi i ndryshëm që subjektet kanë për dispozita ligjore të caktuara, ata i drejtohen Gjykatës, si instanca e fundit që bën diferencimin dhe saktësimin e qëllimin të ligjit.

Në pjesën e dytë të saj, kapitulli I, Kushtetuta, duke filluar që nga neni 15/1 i saj, 16/1, 17, 18 parashikon rëndësinë e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut për shtetasit shqiptarë, si dhe për shtetasit e huaj, personat pa shtetësi në territorin e R. Shqipërisë dhe për aq sa është e mundur edhe për personat juridikë për aq sa përputhen qëllimet e përgjithshme të këtyre personave me thelbin e këtyre të drejtave, lirive dhe detyrimeve. Në nenin 17 të saj, Kushtetuta parashikon kufizimet që mund t'u bëhen të drejtave dhe lirive themelore të njeriut për interes publik, ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Në nenin 18 të saj parashikohet parimi i barazisë përpara ligjit që shpeshherë ngatërrohet në praktikë, pasi nënkupton që të gjithë subjektet janë të barabartë përpara ligjit, ndërkohë që vetë ligji bën diferencimet përkatëse për kategori të veçanta të subjekteve, ndaj barazia përpara ligjit duhet kuptuar si barazi e personave të së njëjtës kategori ligjore dhe jo e çdo individ në çfarëdo kategorie qoftë ai i klasifikuar ligjërisht. Në kapitullin e dytë të pjesës së dytë të saj parashikohen liritë dhe të drejtat vetjake, ku mes këtyre parashikimeve veçojmë nenin 25 që ndalon ushtrimin e torturës, dënimit apo trajtimit mizor, çnjerëzor dhe poshtëruës. Ndalimi i torturës është detyrim kushtetues, konvencional dhe ligjor, pasi, nëpërmjet përdorimit të saj, nuk mund të merret asnjë provë në procesin penal dhe, në fund të fundit, ajo është dënueshme edhe penalisht.

Në nenin 27 të Kushtetutës parashikohet mundësia e privimit të lirisë, përveçse në rastet dhe procedurat e parashikuara me ligj. Në këtë rast, në referim edhe të dispozitave ligjore përkatëse nuk mund të ketë kufizim të lirisë, pa pasur dyshim të arsyeshëm të bazuar në prova.

⁷⁷ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.

PROVAT DHE PROCESI I TË PROVUARIT NË PROCESIN PENAL

Në nenin 28 të saj parashikohet e drejta e çdo personi që i hiqet liria për t'u njoftuar menjëherë në gjuhën që ai kupton për shkaqet e kësaj mase, e drejta e mbrojtjes, dalja përpara gjykatës për të shqyrtuar kufizimin, e drejta e ankimit ndaj vendimit për caktimin e kufizimit etj., që në vetvete të referojnë tek dispozitat procedurale përkatëse që sanksionojnë sa më sipër, pra duhet të kemi proces, duhet të kemi prova që të merren kufizime të tilla.

Në nenin 30 parashikohet prezumimi i pafajësisë, parim shumë i rëndësishëm në të drejtën penale dhe procedurale penale.

Në nenin 31 të Kushtetutës janë të shprehura shumë nga të drejtat që ka një individ, i cili procedohet penalisht. Aty shikohet mjaft qartë se janë të përshkruara në mënyrë të hollësishme dhe të detajuar e drejta e mbrojtjes, parimi i procesit të rregullt ligjor, kontradiktoriteti, parimi i ligjshmërisë.

Në nenin 32 të saj, Kushtetuta parashikon se askush nuk mund të detyrohet të dëshmojë kundër vetes apo familjes së tij, si dhe as të deklarohet fajtor në bazë të të dhënave të mbledhura në mënyrë të paligjshme.

Ky është një parashikim shumë i rëndësishëm, pasi në këtë mënyrë saktësohet se procesi i të provuarit nuk mund të bazohet në thëniet e të pandehurit, as thëniet e tij nuk mund të merren jashtë vullnetit të lirë të tij, si dhe provat e marra në kundërshtim me ligjin nuk mund të përdoren. Gjatë trajtimit të temës, këtë fakt do e shtjellojmë me hollësi, sepse ka të bëjë me parimin e teorisë procedurale mbi papërdorshmërinë e provës, pavlefshmërinë e aktit të marrjes së saj dhe shtrirjen edhe të efekteve mbi provat e veprimet e tjera që vijnë pas marrjes së një prove të paligjshme.

Në nenin 33 parashikohet e drejta për t'u dëgjuar përpara se të gjykohet, si e drejta e shtetit për të vazhduar procedimin penal edhe në mungesë të personit të akuzuar që i fshihet drejtësisë. Nëpërmjet sanksionimit të këtij parimi dhe kësaj të drejte parashikohet e drejta për të pasur një proces të rregullt ligjor dhe ushtrimin e të gjitha të drejtave që kërkon procesi. Në rastin tonë, e drejta për të kundërshtuar provat dhe për të kërkuar marrjen e provave të reja, apo paraqitja e tyre.

Në nenin 37 të saj, Kushtetuta parashikon ndalimin për kryerjen e kontrollove të banesës dhe mjediseve që njehsohen me to, përveç rasteve të parashikuara me ligj. Në varësi edhe të dispozitave procedurale këtu bëhet fjalë për kontrollet që bëhen për gjetjen e provave në një procedim, sepse, për kërkimin e një personi ndaj të cilit ka një akt për kufizim lirie, një gjë e tillë është e pakufizuar.

Në Konventën Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut⁷⁸, e drejta e provës është e sanksionuar në Nenin 6/3 germa d. Kjo dispozitë afirmon barazinë e armëve në proces, ku të dyja palët, si akuzuesi, ashtu dhe mbrojtja kanë të njëjtat të drejta dhe të njëjtat mundësi si në paraqitjen, ashtu dhe në kundërshtimin e debatimin e provave. Pavarësisht faktit se neni i sipërcituar bën fjalë për provën me dëshmitarë, nuk vihet në dyshim se interpretimi duhet të mos jetë i ngushtuar.

Vetë Gjykata Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut ka interpretuar se dispozita e paragrafit 3/d, të Nenit 6 të Konventës duhet të shihet si një disiplinim i

⁷⁸ Konventa Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut, neni 6.

barazisë procedurale në fushën e provës dhe që përfshin çdo lloj prove e jo vetëm atë me dëshmitar.

Sipas jurisprudencës së Strasburgut, e drejta e provës përfshin si të drejtën “e mbrojtjes duke provuar”, pra të drejtën e paraqitjes së provave, ashtu dhe “të drejtën për të debatuar dhe kundërshtuar provat në ngarkim”. Gjykata Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut e ka parë të drejtën për të paraqitur prova si të rëndësishme, saqë mosarsyetimi i vendimit, që nuk pranon paraqitjen e provave përbën shkelje të Nenit 6 të Konventës. Gjithashtu, vëmendje i është kushtuar dhe monitorimit të praktikës për sigurimin e dialektikës në procesin provues. Gjykata në më shumë se një rast ka afirmuar se të pandehurit duhet t’i jepet një mundësi e përshtatshme për të kundërshtuar një dëshmitar kundër tij. Madje, kjo duhet të zbatohet jo vetëm për kundërshtimin e një “dëshmitari” në kuptimin e ngushtë të termit, por dhe për kundërshtimin e një të bashkëpandehuri, i cili ka bërë deklaratat kundër të akuzuarit.

Megjithëse të drejtën për *cross-examination*, Konventa (ashtu siç bën dhe Kushtetuta jonë në nenin 31/d) e referon me “dëshmitarin”, dhe të bashkëpandehurit për qëllime të Konventës nuk janë dëshmitarë, është e padiskutueshme se kjo e drejtë duhet t’i garantohet të pandehurit në ato raste kur deklarimet përdoren ndaj këtij të fundit.

Megjithatë, edhe në rastet kur i pandehuri nuk ka patur mundësi të kundërshtojë dëshmitarin në ngarkim të tij, kjo nuk do të sillte në mënyre automatike shkeljen e të drejtave të tij të mbrojtura nga Neni 6.

Kështu, Gjykata Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut ka arsyetuar se nuk kemi shkelje të Nenit 6 të Konventës, kur ligji autorizon përdorimin për të konkluduar lidhur me fajësinë ose jo të të pandehurit, të deklaratave të dhëna në hetimet paraprake nga të bashkëpandehur të tjerë, të cilët më vonë shfrytëzojnë të drejtën për të mos folur. Sipas Gjykatës, shkelja e parimit të kontradiktorialitetit duhet parë në tërësi dhe nuk kemi shkelje të këtij parimi në të gjitha ato çështje ku i akuzuari, megjithëse në asnjë fazë të procedimit nuk ka patur mundësi për të kundërshtuar dëshmitarin, është dënuar mbi bazën e një procesi provues, i cili nuk mbështetet vetëm mbi këto deklarime, pasi këto të fundit përdoren vetëm për të mbështetur elemente të tjerë provues të marrë sipas parimit të kontradiktorialitetit.

Ndërkaq, ndërsa e drejta për të paraqitur dhe për të kundërshtuar provat e paraqitura është e drejtë e garantuar në mënyrë të plotë nga Konventa, çështja e provave të siguruar në mënyrë të paligjshme pëson një fraksion në jurisprudencën e vetë Gjykatës, fraksion i cili diktohet ekskluzivisht nga fusha e veprimit të Nenit 6 të Konventës, i cili, siç dhe do ta shohim, nuk garanton në mënyrë të plotë evitimin e provave të paligjshme në proces.

Në këtë kontekst, nuk mund të mungonin në praktikën e Gjykatës së Strasburgut çështjet lidhur me pretendimet mbi paligjshmërinë e provave. Në shumë vendime të saj, kjo gjykatë ka arsyetuar se çështja e përdorshmërisë apo jo të provave është mbi të gjitha një çështje që rregullohet nga ligji vendas dhe në këtë linjë i takon gjyqtarit vendas të vlerësojë provat e paraqitura para tij.

Më konkretisht, ajo ka arsyetuar se “pranimi i provave rregullohet kryesisht nga rregullat e legjislationit të brendshëm dhe si rregull janë gjykatat kombëtare ato që

PROVAT DHE PROCESI I TË PROVUARIT NË PROCESIN PENAL

duhet të vlerësojnë provat. Detyra e institucioneve të Konventës është të sigurojë që procesi në tërësinë e tij, përfshirë dhe mënyrën se si janë marrë provat, të ketë qenë i rregullt” ().

Në çështjen Schenk kundër Zvicrës,⁷⁹ gjithashtu, kjo gjykatë ka sqaruar se “Ndërsa neni 6 i Konventës garanton të drejtën për një gjykim të drejtë, ai nuk vendos asnjë rregull lidhur me pranueshmërinë e provës, e cila është në mënyrë parësore një çështje e rregulluar nga ligji kombëtar”. Për rrjedhojë, detyra kryesore e Gjykatës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut është të kontrollojë nëse procedimi në kompleks vjen në përputhje me Konventën dhe parimet e saj, duke përfshirë dhe mënyrën se si kanë qenë marrë provat.

⁷⁹ Schenk kundër Zvicrës, 12. 07. 1988, § 45.

KAPITULLI II

KONCEPTI I PROVAVE PENALE DHE I PROCESIT TË TË PROVUARIT

2.1. Koncepti i provave dhe përkufizimet doktrinale të familjeve të ndryshme ligjore në lidhje me provat penale. Pasqyrimi i ndryshimeve sipas ligjit nr. 35/2017, dt. 30.03.2017

KUPTIMI I PROVËS SIPAS PROCEDURËS PENALE

Neni 149 i K. Pr. Penale (sipas ndryshimeve me ligjin 35/2017, dt. 30.3.2017⁸⁰) parashikon se:

1. *Prova janë njoftimet mbi faktet e rrethanat që lidhen me veprën penale, që merren prej burimeve të parashikuara në ligjin procedural penal, në përputhje me rregullat e caktuara prej tij dhe që shërbejnë për të vërtetuar kryerjen ose jo të veprës penale, pasojat e ardhura prej saj, fajësinë ose pafajësinë e të pandehurit dhe shkallën e përgjegjësisë së tij.*

2. *Kur kërkohet një provë që nuk rregullohet me ligj, gjykata mund ta marrë, nëse prova vlen për të vërtetuar faktet dhe nuk cenon lirinë e vullnetit të personit. Gjykata vendos për marrjen e provës pasi dëgjon palët mbi mënyrën e marrjes së saj.*

Përpara se të bëjmë trajtimin ligjor e doktrinar të kësaj dispozite në lidhje me provat dhe përkufizimin e tyre, po paraqesim në mënyrë gjuhësore se si parashikohen në Fjalorin e Gjuhës së Sotme Shqipe këto terma.

Arsyeja e thjeshtë e këtij referimi është se interpretimi gramatikor është ndër llojet e interpretimeve të efektshme të ligjit për nga radha.

NJOFTIM m.⁸¹

1. *Veprimi sipas kuptimeve të foljeve NJOFTOJ, NJOFTOHEM.*

2. *Kuntim a lajm që na jepet për diçka, ajo që na njoftohet; të dhëna që na bëhen të njohura. Njoftime të përditshme. Vijnë njoftime. Japin njoftime me radio. Iu drejtua për njoftime më të hollësishme.*

3. *Kryes. Të dhëna, zakonisht, burimore, rreth dikujt a diçkaje; njohuri rreth një çështjeje. Njoftime të tërthorta (të përpikta). Njoftime bibliografike. Njoftimet që marrim nëpërmjet shqisave.*

4. *Dijeni. Sa për njoftim. S'kam njoftim. Marr njoftim.*

Siç vihet re, në kuptimin gjuhësor ajo që neve na intereson në sqarimin e saktë të termave gjuhësorë të përdorur nga ligjvënësi tek neni 149 i K. Pr. Penale është perceptimi që duhet të kemi për çdo term. Më pas, në përputhje me parashikimet ligjore specifike, nëpërmjet deduksionit të arrijmë tek ajo që është e veçanta që kërkojmë në procedurën penale gjatë marrjes e shqyrtimit të provave. Pra, me njoftim kuptojmë çdo të dhënë që ne si organ procedues marrim për faktin juridiko-penal, që ligji na ngarkon

⁸⁰ Neni 149 i Kodit të Procedurës Penale, i ndryshuar me ligjin nr. 35/2017, FZ. 5.5.2017.

⁸¹ Fjalor i Gjuhës së Sotme Shqipe, <http://www.fjalori.shkenca.org/>

PROVAT DHE PROCESI I TË PROVUARIT NË PROCESIN PENAL

ta trajtojmë në përputhje me kushtet e parashikuara në të drejtën penale dhe rregullat e përcaktuara në procedurën penale.

FAKT m⁸².

1. *Ngjarje a veprim që ka ndodhur në të vërtetë; diçka që ekziston objektivisht e realisht, diçka që është e vërtetë. Fakt i njohur (i pakundërshtueshëm). Fakt historik. Fakt gjuhësor. Është fakt.*

2. *Dëshmi a diçka tjetër që njihet e pranohet si e vërtetë dhe shërben për të argumentuar, për të provuar a për të kundërshtuar një mendim, një tezë etj. Ose për të arritur një përfundim. Fakt konkret (i gjallë). Grumbullimi (sistemimi) i fakteve. E bind me fakte. Provoj me fakte.*

3. *Drejt. Dëshmi e vërtetë, diçka që dihet a që është provuar dhe sillet në gjyq për të mbështetur akuzën ose për ta kundërshtuar atë. Fakt juridik.*

**Në fakt libr. - në të vërtetë.*

Nga ky përkufizim i gjuhëtarëve vëme re se si na ndihmon interpretimi gjuhësor në perceptimin e drejtë të një fjale dhe studimin e fenomenit që ajo prezanton dhe së fundmi për të kuptuar se çfarë ka dashur ligjvënësi të shprehë nëpërmjet përdorimit të kësaj fjale.

Në këtë këndvështrim na rezulton se fakti në kuptimin gjuhësor qenka një ngjarje, një veprim që ka ndodhur, diçka që ekziston objektivisht e realisht, që është fakt i njohur i pakundërshtueshëm, fakt konkret, fakt historik, fakt juridik. Nga ky interpretim sigurisht që nuk lidhemi me kuptimin e ngushtë juridiko-penal të faktit penal të kryer nga një person i caktuar, që do t'i nënshtrohet rregullave të procesit, për përcaktimin e përgjegjësisë penale të tij.

Për gjuhëtarët, *fakt* është çdo ngjarje që ndodh, qoftë kjo dukuri njerëzore apo dhe dukuri natyrore. E njëjta gjë vlen edhe për organet proceduese, deri në përcaktimin se çfarë lloj ngjarjeje është me përjashtimin e vetëm nëse fakti është dukuri njerëzore e kryer me faj, qoftë nëpërmjet veprimit ose mosveprimit, apo dukuri natyrore që rrjedh prej veprimit ose mosveprimit me faj të individit madhor e të përgjegjshëm. Ligji u ngarkon detyrën organeve proceduese të përcaktojnë mbi bazën e parimit të autonomisë së përgjegjësisë penale, llojin e masën e dënimit për autorin e kryerjes së veprës penale. Bazuar në parimin e gjetjes dhe zbulimit të së vërtetës, vetë teoria e të drejtës procedurale faktet i ndan në fakte relevante juridike, fakte irelevante (indicie) dhe fakte ndihmëse. Tek faktet relevante futen ato fakte që lidhen drejtpërsëdrejti me të vërtetën, pra ato fakte që kanë ekzistuar dhe lidhen drejtpërsëdrejti me zbatimin e procedimit penal nga ana e organeve proceduese, pra ushtrimin e ndjekjes penale.

Në këtë drejtim edhe provat që i provojnë këto fakte që ne do t'i trajtojmë më poshtë janë ato prova që janë të drejtpërdrejta.

Faktet irelevante janë ato fakte që vërtetohen në mungesë të provave direkte apo të drejtpërdrejta.

Natyra e vetë procesit penal, në vetvete, është më e vështirë, pasi subjektet e procedimit penal dhe kryesisht i pandehuri e vë në vështirësi organin procedues në çdo fazë me

⁸² Fjalor i Gjuhës së Sotme Shqipe, <http://www.fjalori.shkenca.org/>

alibitë dhe kundërshtimet e tij për të vërtetuar faktin dhe për ta shtyrë organin procedues të gabojë e të shkojë në lajthim, kjo për vetë faktin se ndëshkimi penal, dënimi, në vetvete, e prek atë drejtpërsëdrejti në lirinë e tij, psikologjinë, emrin e reputacionin social, ekonominë dhe pasurinë e tij.

Pra, faktet irelevante bazohen në provat indirekte dhe përipiqen ta rindërtojnë objektivisht faktin real mbi bazën e besueshmërisë dhe jo bindjes absolute. Faktet irelevante quhen ndryshe në doktrinë, por edhe në terminologjinë e përdorur nga ligjvënësi, edhe si *indicie*. Në vetvete, indiciet janë prova indirekte që shërbejnë për gjetjen dhe zbulimin e provave direkte dhe në arritjen e konkluzioneve logjike e racionale nga organet proceduese për faktet relevante.

Indiciet kanë karakter të dyfishtë, sepse shfaqen edhe si fakte dhe, nga ana tjetër, shfaqen si prova indirekte për vërtetimin e fakteve të tjera relevante, pra si burime provash. Faktet ndihmëse janë kategoria e tretë e ndarjes së fakteve dhe kanë të bëjnë me ato fakte që ndihmojnë në gjetjen e zbulimin e rrethanave të kryerjes së veprës penale, pra vërtetimit të faktit juridiko-penal.

RRETHANË⁸³

*Kushte të veçanta, në të cilat ndodh diçka ose që shoqërojnë një ngjarje dhe që ndikojnë në zhvillimin e saj; anë e veçantë e një ngjarjeje, e një çështjeje. Rrethana lehtësuese. drejt. kushtet që e lehtësojnë dënimin e një të pandehuri. Rrethana rënduese. drejt. kushtet që e rëndojnë dënimin e një të pandehuri. Rrethanat e ngjarjes. Në çdo rrethanë. Ndodhi në rrethana të paqarta. 2. kryes. Kushte që përcaktojnë gjendjen e diçkaje a të dikujt; gjendje. Rrethanat politike (ekonomike). Rrethana familjare (shoqërore). Sipas rrethanave. Në rrethanat e sotme. Përfiton nga rrethanat. Ndryshojnë rrethanat. E detyrojnë rrethanat. * Plotës i rrethanës gjuh.*

Nga ky përkufizim gjuhësor vëmë re edhe ndryshimin mes faktit dhe rrethanës, pasi është vetë ligjvënësi që përcakton shprehimisht në nenin 149 të Kodit të Procedurës Penale termin *rrethanë* më vete nga fakti dhe që, në kuptimin procedural, na bën të kuptojmë se disa rrethana na shërbejnë për të kuptuar se si ka ndodhur një fakt juridiko-penal, ndërsa disa rrethana shërbejnë më pas për të kryer edhe funksione të tjera provuese jo më në drejtim të faktit juridiko-penal, por për sa i përket kushteve dhe trajtimit të një personi në fazën e përcaktimit të dënimit penal, ose mënyrës së vuajtjes së tij.

E themi këtë gjë, pasi në procesin procedural penal kemi të bëjmë me gjykime kërkesash në fazën e hetimit paraprak, gjykime themeli, gjykime në fazën e ekzekutimit të vendimit, si dhe gjykime kërkesash në kuadrin e marrëdhënieve juridiksionale me jashtë, që kanë regjime të ndryshme trajtimi juridik nga vetë Kodi i Procedurës penale, në lidhje me mënyrën e inicimit, formimin e trupit gjykues që i merr në shqyrtim, vlerën e tyre në procesin e vendimtarjes së gjykatës.

⁸³ Fjalori i Gjuhës së Sotme Shqipe, <http://www.fjalori.shkenca.org/>

VËRTETË f.⁸⁴

1. Diçka që është e vërtetë, ajo që përputhet me realitetin; fakt a diçka tjetër që nuk mund të hidhet poshtë, që nuk mund të mohohet, që është vërtet i tillë; diçka që është e sigurt dhe e saktë; kund. gënjeshtër. E vërtetë e pamohueshme. Tha (tregoi) të vërtetën. Mbroj të vërtetën. E mbuloi (e fshehu, e shtrembëroi) të vërtetën. Si është e vërteta? E nxori në shesh të vërtetën. Doli në shesh e vërteta. Ia tha të vërtetën në sy. Më mirë një e vërtetë e hidhur se një gënjeshtër e ëmbël. fj.u.
 2. Gjendja reale, kushtet e vërteta që na rrethojnë; realiteti objektiv. E vërteta në jetë. Përshkruan të vërtetën.
 3. filoz. Dije që e pasqyron drejt realitetin objektiv në ndërgjegjen e njerëzve, dije që përputhet me realitetin dhe është provuar në praktikë. E vërteta absolute, dije e plotë, e gjithanshme dhe përfundimtare për realitetin objektiv, që nuk ndryshon me zhvillimin e mëtejshëm të dijeve dhe të praktikës. E vërteta objektive, dije që përputhet me realitetin objektiv, që nuk varet nga subjekti dhe është vërtetuar nga praktika. E vërteta relative, dije objektivisht e drejtë për realitetin, po jo e plotë, që me kalimin e kohës saktësohet, bëhet më e thellë e më e plotë.
 4. Ide a tezë që shtjellohet ose që arrihet nga një shkencë e caktuar, që pasqyron drejt realitetin objektiv dhe vërtetohet nga praktika e nga përvoja e njeriut; gjykim a mendim i shëndoshë që përputhet me realitetin ose me faktet reale. E vërteta historike. E vërteta matematike.
 5. Diçka që është e drejtë, e mirë dhe në përputhje me moralin; ajo nga e cila njeriu duhet të udhëhiqet në punën dhe në veprimet e tij; e drejta.
Rruga e së vërtetës, rruga e drejtë, rruga që të çon drejt së mirës e së drejtës. Jeton (rron) me të vërtetën, jeton ndershmërisht, me drejtësi. Shkoftë kohë e shkoftë mot, e vërteta del më not. fj.u. e vërteta del kurdoherë në shesh.
- * Me të vërtetë vërtet. Ç'është e vërteta (e drejta...) fj. ndërm. përdoret për të theksuar atë që thuhet, me kuptimin "në të vërtetë, pa dyshim; sigurisht". Të them (të themi) të vërtetën fj. ndërm. përdoret për të theksuar më shumë vërtetësinë e asaj që thuhet, me kuptimin "sigurisht, vërtet". E shikon të vërtetën në sy, i vlerëson gjërat ashtu siç janë, i sheh gjërat drejt. Ia tha të katër të vërtetat në sy - ia tha gjërat hapur, nuk i fshehu asgjë, ia tha copë të gjitha.

VËRTETË mb.⁸⁵

1. Që përputhet me gjendjen e gjërave ashtu siç janë, që i përgjigjet realitetit objektiv, që e paraqet diçka ashtu siç është në jetë; që nuk të ngjall asnjë dyshim, i sigurt e i saktë; që përmban në vetvete të vërtetën, që mbështetet në të vërtetën; kund. i gënjeshtërt; i rremë. Lajm i vërtetë. Ngjarje e vërtetë. Tregim i vërtetë. Emri i vërtetë. Është e vërtetë. Tregoi fytyrën e vërtetë.
2. Që i përmbahet fort asaj që thotë, besnik gjer në fund ndaj dikujt a diçkaje, i hapur, i çiltër e i vendosur; i tillë siç duhet të jetë, që përbën në vetvete shembullin më të

⁸⁴ Fjalori i Gjuhës së Sotme Shqipe (me rreth 40.000 fjale) <http://www.fjalori.shkenca.org/>

⁸⁵ Fjalori i Gjuhës së Sotme Shqipe, <http://www.fjalori.shkenca.org/>

PROVAT DHE PROCESI I TË PROVUARIT NË PROCESIN PENAL

mirë të diçkaje, jo i shtirur; i drejtë; kund. i rremë. Revolucionar i vërtetë. Burrë (njeri) i vërtetë. Mik i vërtetë. Unitet i vërtetë. Miqësi (dashuri) e vërtetë.

Kjo është rruga e vërtetë.

3. Që ka të gjitha vetitë a cilësitë e duhura; i pastër, i thjeshtë; natyror. Ar i vërtetë. Qelibar i vërtetë. Verë e vërtetë. Lesh i vërtetë.

4. Që vjen nga një burim i njohur, që është siç është bërë në fillim, jo i kopjuar, original. Dorëshkrimi i vërtetë. Dokument i vërtetë. Tabloja e vërtetë e piktorit.

5. Që është provuar shkencërisht a që është vërtetuar nga praktika. Teori e vërtetë. Përfundim i vërtetë.

*** Në kuptimin e vërtetë të fjalës shih te FJAL/Ë,~A.**

Po i referohemi edhe këtij përkufizimi gjuhësor në lidhje me të vërtetën për të vetmen arsye të shëndoshë dhe bazike për sistemin procedural penal, pasi detyra jonë është të zbulojmë të vërtetën për aq sa mundemi, nëpërmjet rindërtimit të faktit, ngjarjes, nëpërmjet provave të marra në mënyrë të ligjshme.

Me termin gjuhësor e vërtetë dhe me detyrën procedurale të zbulimit të saj nga gjykata, teoria e të drejtës ka nxjerrë disa konkluzione të rëndësishme, që kanë të bëjnë me të vërtetën filozofike dhe atë procedurale, të vërtetën materiale dhe atë formale, si dhe ndryshimet mes tyre.

E vërteta në kuptimin filozofik është konkluzion në lidhje me ndodhjen e faktit, pra pasqyrim besnik i realitetit, ndërsa në kuptimin procedural është arritja tek niveli më i lartë i bindjes në lidhje me faktin, realitetin bazuar në prova.

Nisur nga kjo e fundit edhe në varësi të sistemeve të aplikuara procedurale, si dhe nga rezultatet e arritura, ka lindur edhe ndarja mes të vërtetës materiale, që bazohet në teorinë ligjore pozitive të provave dhe atë formale, që bazohet në teorinë ligjore negative, ku në bazë të përlllogaritjes matematikore të shumës së provave pro apo kundër vërtetohet ose jo akuza ndaj një personi.

Në rastin e së vërtetës materiale, organit procedues i intereson që e vërteta të përputhet sa më shumë me të vërtetën historike që ka ndodhur realisht në të kaluarën dhe që ne si organ procedural po përpiqemi ta rindërtojmë, ndërsa tek e vërteta formale, gjykatat shqetësohen që e vërteta që rrjedh nga procesi të jetë në përputhje me provat që dalin nga procesi dhe jo thjesht, nëse kjo e vërtetë përputhet ose jo me të vërtetën historike apo absolute siç ka ndodhur fakti real.

Pra, në rastin e të vërtetës materiale, gjykatës i intereson fakti objektiv real si ka ndodhur, ndërsa në rastin e dytë, procedura e vërtetimit të faktit bazohet vetëm në provat që merren në proces, pavarësisht nëse ato vërtetojnë faktin real siç ka ndodhur.

Ky është edhe dallimi i drejtë që bëjnë teoricienët italianë të përmendur më parë në këtë trajtim, të cilët thonë se e vërteta procesuale është jo rrallë e ndryshme nga e vërteta absolute dhe ajo epistemologjike.

Sigurisht që kjo është karakteristikë e sistemeve akuzatore, ku të vërtetën e bazojnë në lidhje me provat e marra në proces, që i nënshtrohen kontradiktoritetit të palëve dhe gjykata luan rolin e arbitrit. Megjithatë, edhe pse sistemi akuzator i pastër luan këtë rol, në shumë vende, nisur nga parimi i zbulimit të së vërtetës, gjykatës i është dhënë

mundësia e marrjes në mënyrë aktive e provave kryesisht (neni 367 i K. Pr. Penale). Gjithsesi, vendimi gjyqësor i formës së prerë mbetet e vërteta reale për organet proceduese dhe subjektet e përfshira në procedimin penal, parim i njohur që në lashtësi (*res iudicata pro veritate habetur*).

PROVË f.⁸⁶

1. *E dhënë që sillet për të vërtetuar, për të mbrojtur ose për të hedhur poshtë diçka; dëshmi, fakt, argument. Provë bindëse (e gjallë). Provë lëndore (materiale). drejt. E vërtetoi me prova. Ka dhënë prova zotësie. E liruan për mungesë provash.*
2. *Copë e vogël që merret nga diçka për analizë a për eksperiment; diçka që mbahet a ruhet si mostër. E mori (e mban) për provë.*
3. *Vërtetim në praktikë i të dhënave të diçkaje që duam ta njohim a ta studiojmë më thellë e në kushte të caktuara; eksperiment që bëhet për të marrë të dhëna për diçka ose për ta vërtetuar atë. Prova e parë (e dytë...). Provë laboratorike. Prova e fortësisë. Bëri një provë.*
4. *Veprim paraprak që bëhet për të kontrolluar saktësinë a masën e diçkaje, para se ta përfundojmë (për një petk, për një vegël që prodhohet etj.). Prova e parë (e dytë...). Bëri provë kostumin.*
5. *Tërësia e veprimeve ose shfaqja që bëhet për të kontrolluar shkallën e përgatitjes a të gatishmërisë para se të ndërmerret një punë, të jepet shfaqja e rregullt etj. Provë gatishmërie. Prova e përgjithshme. Salla e provave. Ishte vetëm një provë. Kanë provat.*
6. *Diçka e vështirë që duhet ta bëjë dikush për të parë aftësitë e tij para se t'i ngarkohet një detyrë me përgjegjësi; gjendje e vështirë, fatkeqësi etj. që dikush duhet ta përballojë dhe që vërteton qëndrueshmërinë e tij; sprovë. Provë e vështirë. Prova e zjarrit. Vite prove. Kishte kaluar sa e sa prova. I bëri ballë çdo prove. E vuri në provë dikë - e provoi.*
7. *vjet. Provim. E mori në provë.*
8. *mat. Veprimi me të cilin vërtetojmë se një llogaritje është e përpiktë. Prova e mbledhjes (e zbritjes, e shumëzimit, e pjesëtimit). Bëri provën.*

*** Gur prove libr. parimi a kriteri themelor që shërben për të provuar qëndrimin ndaj diçkaje.**

Në kuptimin gjuhësor shikohet mjaft qartë lidhja dhe vazhdimësia që ndjekin gjuhëtarët në përkrahimin e termit dhe që na lehtëson edhe ne në kuptimin e përdorimit të termit në jetën e përditshme nga përvoja e perceptimit human të popullit tonë.

Në aspektin juridik, ne jemi të interesuar që të bëjmë edhe dallimin mes asaj që e konsiderojmë provë, si dhe kuptimin e saj teorik dhe shkencor.

Sipas proceduralistëve shqiptarë: *Provat janë të dhëna, të cilat kontribuojnë në*

⁸⁶ Fjalori i Gjuhës së Sotme Shqipe, <http://www.fjalori.shkenca.org/>

saktësimin e së vërtetës, por që të kenë vlerë duhet të merren prej burimeve të parashikuara në ligj⁸⁷.

Dhimitër Lara⁸⁸ e përcakton provën në procesin penal si një instrument apo mjet njohjeje, që funksionon menjëherë dhe i paraqitet gjykatës për vërtetimin e ekzistencës së veprës penale dhe që e ka kryer i pandehuri.

Shumica e zbatuesve të kodit e mendojnë provën si bashkësinë e rregullave që diktojnë ato fakte që mund të vërtetohen në gjykatë, materialet që mund të paraqiten përpara gjykatës për të vërtetuar këto fakte dhe formën me të cilën këto materiale duhen paraqitur përpara gjykatës.

Paulo Tonini⁸⁹ në librin e tij “Il Diritto delle prove penali” ka thënë: *Prova mund të përkufizohet si një vlerësim i një fakti të njohur (p. sh. deklarata e dëshmitarit), nga e cila rrjedh ekzistenca e një fakti që ka ndodhur në të kaluarën, që modalitetet dhe mënyra e përfutimit të saj duhet të bindin gjyqtarin.*

Kuptimin e provës, krahas parashikimit të Kodit të Procedurës Penale e ka dhënë gjithashtu dhe prof. Ejup Sahiti⁹⁰ në librin “Argumentimi në Procedurën Penale”. Sipas tij, *prova është burim njohurish për faktet që vërtetohen në procedurën penale, të cilat i përdor organi që i vërteton ato.*

Ndërsa sipas Common Law: *Provat mund të përkufizohen në terma të përgjithshëm si çdo material që ka mundësinë të ndryshojë gjendjen e besimit të hetuesve, në lidhje me çdo sugjerim faktik që duhet gjykuar dhe që është tema e debatit.*

Disa nga përfaqësuesit më në zë të sistemit Common Law, si p.sh. Xheremi Benthëm, (Jeremy Bentham), megjithëse shumë të interesuar pas shkencës së provave, faktikisht janë kundër gjithë konceptit të një ligji për provat. Benthëm i shikonte normat që rregullojnë provat më tepër si një kufizim artificial i shkencës që trajton provat, të shpikur prej avokatëve për qëllime të pandershme dhe të rritjes së mundësisë për marrjen e pagesave dhe të pamundësisë për njerëzit e thjeshtë për të kuptuar kompleksitetin e ligjit. Benthëm e pa sjelljen e avokatëve si pengesën më të rrezikshme për t'u korrigjuar.

Sipas Xhon Smibert (Jon Smibert): *Prova është mjet për vërtetimin e drejtpërdrejtë të fajësisë ose tregon drejtpërsëdrejti se dikush është lënduar nga krimi. Disa prova të tjera sugjerojnë se dikush mund të jetë fajtor ose provojnë diçka që mbështet një teori se dikush është fajtor*⁹¹.

Një tjetër dimension i provës është të mendosh se çfarë provon ajo. Disa prova shërbejnë si provë e drejtpërdrejtë e fajësisë ose tregojnë drejtpërsëdrejti se dikush është lënduar nga krimi. Disa prova të tjera sugjerojnë se dikush mund të jetë fajtor, ose provojnë diçka që mbështet një teori se dikush është fajtor.

Akinshtain (Peter Achinstein⁹²) i përkufizon provat si vijon: *Prova E është fakt i mundshëm për hipotezën H, atëherë dhe vetëm atëherë kur: 1) E është e vërtetë; 2) E*

⁸⁷ Procedura Penale (Halim Islami, Artan Hoxha, Ilir Panda), 2010, f. 199.

⁸⁸ Dh. Lara, Koment mbi Kodin e Procedurës Penale, 2010, f. 501.

⁸⁹ P. Tonini, Il Diritto delle prove penali, 2012.

⁹⁰ E. Sahiti, Argumentimi në Procedurën Penale, 2006.

⁹¹ J. Smibert, Parimet e provave, Departamenti i Drejtësisë i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, <http://www.brrln.org/uploads/documents/219/alb.pdf>

⁹² P. Achinstein, <https://link.springer.com/article/10.1007/s11191-011-9405-9>, 2012.

nuk e bën të domosdoshme H-në; 3) probabiliteti i H-së mbi E-në është themelor; dhe 4) probabiliteti i një lidhjeje më shpjeguese mes H-së dhe E-së është themelor.

Sigurisht, teza e ngritur prej Akinshtainit është më shumë një përkufizim logjik, sesa ligjor, i përshtatshëm për hetime shkencore të çfarëdolloj tipi që mund të përdoret nga studiues të kodit.

Bayer-i e përkufizon provën: *Burim nga i cili organi procedues fiton bindjen se fakti të cilin ai kërkon të vërtetojë ekziston apo nuk ekziston*⁹³.

Kuptimi i provave në procesin penal parashikohet në Kodin tonë të Procedurës Penale⁹⁴ në nenin 149 të tij. Kjo dispozitë jo vetëm pasqyron, por përcakton kushtet dhe kriteret ligjore që duhet të respektohen që një provë të konsiderohet e tillë në procesin penal. Kështu, në interpretim të këtij neni, konsiderohen si prova:

1. *Provat që parashikohen në mënyrë të drejtpërdrejtë në Kodin e Procedurës Penale, të cilat janë: dëshmia, ballafaqimi, paraqitja për njohje, eksperimenti, ekspertimi dhe provat materiale, provat dokumentare.*
2. *Rezultatet me vlerë provuese që dalin nga mjetet e përdorura për kërkimin e provës.*
3. *Provat që nuk kanë rregullim ligjor mund të merren nga gjykata nëse vlejnë për të vërtetuar faktet dhe, nëse nuk cenojnë lirinë dhe vullnetin e personit. Në këtë rast, gjykata vendos pasi ka dëgjuar palët mbi mënyrën e marrjes së saj.*

Në interpretim literal, por dhe juridik (referuar praktikës gjyqësore të mbajtur gjithë këto vite), me termin *provë* do të kuptohet çdo njoftim të marrë mbi rrethana dhe fakte që janë të lidhura me veprën penale, pasojat e veprës penale, autorin e veprës penale, përgjegjësinë penale të tij, shkallën e rolin e tij në kryerjen e veprës, që merren prej burimeve të parashikuara në Kodin Procedural Penal në përputhje me përcaktimet e bëra prej tij, që vërtetojnë kryerjen ose jo të veprës penale, fajësinë ose pafajësinë dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit.

Sipas nesh, elementi PROVË është informacioni (si e dhënë e parë) që merret nga një burim i provës dhe që nuk është ende e vlerësuar nga ana e prokurorit ose nga ana e gjykatës.

Ndërkohë, rezultati provues është sinteza e mendimit dhe perceptimit të provës në lidhje me faktin juridiko-penal që i është nënshtuar debatit gjyqësor, të cilin gjykata e merr parasysh dhe që e trajton në arsyetimin e vendimit të saj.

Për të shmangur paqartësitë, në mënyrë që të kuptohet dhe më mirë disiplina e provave penale, në mendojmë që është e nevojshme të qartësohen disa nocione bazë.

Së pari, vlerësojmë se është e nevojshme t'u japim përgjigje pyetjeve se çfarë do të kuptojmë me termat: *fakt, burim të provës, mjete të provës dhe elemente të provës.*

Dr. Bogdan Sestic në librin "Logika i naucna metodologjase" ka shkruar se: **Fakt është ekzistenca objektivo-reale e ndonjë sendi, dukurie, procesi, ndodhie, cilësie ose raporti i vërtetuar në mënyrë mendore perceptuese**⁹⁵.

Ndërsa sipas Bayer-it me termin **fakt** duhet të përkufizojmë: *Të gjitha dukuritë reale*

⁹³ Bayer, f. 16.

⁹⁴ Kodi i Procedurës Penale, neni 149.

⁹⁵ Bogdan Sestic, "Logika i naucna metodologjase", 1962.

*në të cilat gjenden kushtet e së drejtës penale materiale për aplikimin e sanksioneve penale, në rastin konkret dhe kushtet e së drejtës procedurale për zhvillimin e procedurës penale dhe kryerjen e veprimtarisë procedurale quhen fakte.*⁹⁶

Prof. dr. Sokol Mëngjesi e përkufizon termin **fakt** si: *Ngjarje apo situatë, si dhe çdo gjendje e botës së jashtme apo asaj të brendshme që i referohet së tashmes apo të shkuarës dhe që mund të vërtetohet.*⁹⁷

Sipas prof. dr. Ejup Sahiti: *Nocioni fakt ka kuptimin e një ngjarje, ndodhie apo fragmenti të realitetit objektiv, të cilat janë objekt i të oprovuarit në procedurë penale*⁹⁸.

Jon Smibert në përmbledhjen e tij lidhur me “Parimet e provave” argumenton se: **Faktet ose informata përbëjnë bazën për dyshimin se i pandehuri e ka kryer krimin. Baza duhet të jetë “objektive”, që nënkupton se çdo person i arsyeshëm do të arrinte në përfundimin se faktet apo informacioni e mbështesin atë konkluzion**⁹⁹.

Mendimi im është se termin “fakt penal” mund ta përkufizojmë si një dukuri natyrore që lidhet me sjelljen njerëzore, ose sjelljen njerëzore që njofton elemente provues të veprimeve ose mosveprimeve njerëzore, dhe që kualifikohen nga ligjvënësi në Kodin e Penal si vepër penale.

Gjithsesi, në kushtet që ligjvënësi nuk ka parashikuar ndonjë përkufizim specifik, përkufizimet e mësipërme ngelin subjektive dhe të marra më shumë për efekt studimi doktrinal të së drejtës procedurale penale. Ajo që mund të vëmë në evidencë për konceptin e termin “fakt” është gabimi që bëjnë palët ose gjykata kur e vlerësojnë si të vërtetë ose të rremë. Në vlerësimin tonë, një fakt nuk mund të vlerësohet as si i vërtetë, as si i rremë, pasi në vetvete ai mundet thjesht të ketë ndodhur ose jo.

Pretendime të palëve për ndodhjen e një fakti penal ose jo mund të ketë nga më të ndryshmet, që mund të rezultojnë të vërteta ose të rreme, ndërsa për gjykatën ka vetëm fakte që kanë ndodhur ose jo, pasi në përfundim të një procesi të rregullt ligjor për marrjen, çmuarjen dhe analizimin e provave, gjykata arrin në përfundimin, nëse fakti ka ndodhur ose jo dhe më pas se kush e ka kryer këtë fakt, cila është lidhja e tij me një ose disa persona konkretë, që duhet ose jo të mbajnë përgjegjësi penale e të dënohen në lidhje me këtë fakt.

Ky konkluzion logjik bazohet edhe në parimin e pavarësisë së gjykatës, që është organi që realizon dhënien e drejtësisë nëpërmjet zbulimit të së vërtetës në fund të procesit gjyqësor, që zhvillohet në bazë të parimeve dhe kritereve ligjore të normuara specifikisht në legjislacionin procedural.

Për efekt vlefshmërie dhe përdorshmërie në procesin gjyqësor, në respektim dhe të të drejtave të mbrojtura nga *Kushtetuta*¹⁰⁰, *Konventa Evropiane e Mbrojtjes së të Drejtave të Njeriut*¹⁰¹, por dhe K. Pr. Penale, provat detyrimisht duhet të merren prej burimeve të ligjshme, në mënyrën e parashikuar nga ligji procedural penal dhe t’i nënshtrohen shqyrtimit gjyqësor nëpërmjet procesit të verifikimit, vlerësimit e çmuarjes së tyre.

⁹⁶ V. Bayeri, marrë nga libri “Argumentimi në Procedurën Penale”, Ejup Sahiti.

⁹⁷ S. Mëngjesi & K. Skënderaj, “Analiza e veprës penale të mashtrimit”, f. 131.

⁹⁸ E. Sahiti, Argumentimi në Procedurën Penale, 2006, f. 99.

⁹⁹ J. Smibert, J. D., LL. M. (Lond.), <http://www.brrln.org/uploads/documents/219/alb.pdf>

¹⁰⁰ Kushtetuta e R. Sh., neni 30 e vijues.

¹⁰¹ Neni 5, 6 i KEDNJ-së.

Burimet e provës shërbejnë për marrjen e të dhënave në lidhje me faktin juridiko-penal dhe formalizimin e tyre në akte procedurale. Marrja e këtyre të dhënave sigurisht që kërkon dhe instrumentet përkatëse ligjore.

Këto instrumente, me anë të të cilave kjo provë e marrë nga burimet e përcaktuara me ligj futet në proces për t'iu nënshtruar debatit dhe çmuarjes së tyre, quhen **mjetet e provës**.

Elementi i provës është rezultati i përfutur nga dy hapat e mësipërm, ku burimi i provës i futur në proces sipas një forme dhe procedure të caktuar, vjen përpara gjykatës, por nuk është vlerësuar akoma nga ajo. Në vijim, në analizë të dispozitave të Kodit të Procedurës Penale dhe të përgjigjes së pyetjes së ngritur pak më sipër, *burimet e provës janë njerëzit, sendet dhe vendet që pasqyrojnë një element të provës*.

Vepra penale, si çdo fakt njerëzor, lë gjurmë si në kujtesën e njerëzve të cilët e kanë perceptuar, ashtu si në sendet që kanë qenë në vendet në të cilat ka ndodhur. Njerëzit, sendet, vendet si veprimet e ndryshme janë burimet nga të cilat mund të nxirren njoftime të dobishme për të rindërtuar një fakt të së kaluarës.

Vitet e fundit, në praktikë, por dhe në radhët e zbatuesve të kodit është futur një "nacion i ri", i paparashikuar nga Kodi i Procedurës Penale, ai i mjetit të provës. Ky nocion rrjedh nga *e drejta procedurale penale italiane*¹⁰², e cila, duke i qëndruar strikte parimit të formimit të provës gjatë procesit gjyqësor, parashikon se palët paraqesin mjete të provës në proces, për të cilat më pas është gjykata që disponon nëse marrin vlerën e provës ose jo.

Termi provë në teorinë e së drejtës procedurale penale italiane¹⁰³ përdoret për të shprehur burimin e provës, ku futen: sendet, vendet dhe njerëzit, mjet i provës, element i provës, rezultati i provës (sistemi akuzator, prova që i nënshtrohet debatit gjyqësor). Prova formohet para gjykatës dhe administrohet prej saj në seancë gjyqësore, me përjashtim të atyre që janë të ndaluara me ligj¹⁰⁴.

Në doktrinë rezultojnë vlerësime të ndryshme për mjetet e provës dhe përkufizimet e tij. Mjeti i provës nuk ka përmbajtje të njëjtë tek autorët e procedurës penale.

Për Ejup Sahitin¹⁰⁵ *në një pjesë të teorisë me termin mjet i provës kuptohen provat me të cilat vërtetohen faktet. Një pjesë tjetër, me këtë term, pikësepari kupton burimin, nga i cili rrjedh prova-transmetuesin e saj, duke i kuptuar nganjëherë me të dhe provat. Një numër i proceduralistëve nuk i kushton kujdes dhe rëndësi përcaktimit të termit, por me të kuptojnë si provat, ashtu dhe burimet e provave. Sipas tij, mjeti i provës paraqitet si burim i provës, i cili kontribuon për ndriçimin e së vërtetës dhe autorin e saj.*

*Provat nuk ekzistojnë në vakum, - shprehet Smibert*¹⁰⁶. - *Burimi i provave shpesh jep pasojë në perceptimin e provave ose sa shumë këto prova e mbështesin ose dëmtojnë teorinë që ka prokurori për çështjen. Burimet e ndryshme të provave mund të mbështesin dhe njëri-tjetrin. Këto burime të ndryshme mund të përfshijnë: dëshmitarë, dokumente, prova fizike dhe lloje të tjera të provave.*

¹⁰² Kodi i Procedurës italiane, neni 187.

¹⁰³ P. Tonino & C. Conti, Il diritto delle prove penali, 2012.

¹⁰⁴ A. Shegani, E drejta penale e krahasuar, f 195.

¹⁰⁵ E. Sahiti, Argumentimi në Procedurën Penale, f. 106-114.

¹⁰⁶ J. Smibert, J. D., LL. M. (Lond.) ,<http://www.brrln.org/uploads/documents/219/alb.pdf>

Sipas prof. Islamit: *Burimet e provave janë mjete që garantojnë gjetjen e së vërtetës në procesin penal*¹⁰⁷.

Më konkret në konkluzionin e tij paraqitet Dhimitër Lara, duke e përcaktuar: *Burimin si vetë prova e cila nuk është nxjerrë ende në pah, por nga nxitja dhe provokimi bëhet i mundur dhe shfaqja e saj*¹⁰⁸.

Në shqyrtim të kësaj teme, me “mjet të provës” do të kuptojmë instrumentin procedural me të cilin përfitohet në proces një element i provës, që do të thotë një informacion që shërben për vendimin. Mjetet e provës mund të përdoren lirisht nga palët për të vërtetuar fakte objekt akuze apo pretendimet që mund të fajësojnë apo shfajësojnë të pandehurin.

2.2. PROCESI I TË PROVUARIT DHE FAZAT E TIJ

Procesi gjyqësor është riprodhim i një mosmarrëveshjeje (shkelje të ligjit penal), që ka ngjarë dhe mundësia e aftësia e palëve për të riprodhuar elementet thelbësore të saj me anë të provave të paraqitura.

Procesi provues është rregulluar nga KPP-ja në momentet kyçe të kërkimit, marrjes, pranimit dhe vlerësimit të provës. E drejta për të paraqitur prova tregon mundësinë që kanë palët në proces për të provuar atë çka pretendojnë. *Ky proces që ka si qëllim zbulimin e së vërtetës dhe vërtetimin e rrethanave të faktit. Ai kalon tri faza procedurale: 1. marrja e provës, 2. shqyrtimi dhe verifikimi i provës, 3. çmuarja e provës*¹⁰⁹.

2.2.1. MARRJA E PROVËS

Faza e parë e procesit të të provuarit është **marrja e provës**. Marrja e provës nënkupton gjetjen, zbulimin dhe fiksimin procedural të tyre. Këto tre elemente duhen parë në lidhje të ngushtë me njëri-tjetrin, pasi kanë rëndësi si për vlerën e provës, ashtu dhe për ruajtjen e tyre¹¹⁰.

Të zbulosh një provë do të thotë të konstatosh se ekziston dikush, i cili di diçka për të dhënat, me ndihmën e të cilave vërtetohet ekzistenca apo mosekzistenca e ndonjë fakti juridik relevant; të konstatosh se ekziston ndonjë gjurmë apo ndonjë objekt, i cili do të shërbejë si provë në procedurën penale¹¹¹.

Mbledhja e provave ndikon në vlerësimin e probabilitetit se diçka është e vërtetë, e bazuar në fakte të njohura.

Gjetja dhe zbulimi i provave mund të bëhet nga të gjitha palët e përfshira në procesin penal dhe shoqërohet gjatë gjithë këtij procesi, ndërsa fiksimi procedural i tyre bëhet nga organet kompetente vetëm pasi të jenë zbuluar këto prova.

¹⁰⁷ H. Islami & al, Procedura penale, f. 200.

¹⁰⁸ DH. Lara, Komentari mbi Kodin e Procedurës Penale, f. 505.

¹⁰⁹ H. Islami, A. Hoxha, I. Panda, Procedura Penale, f. 201.

¹¹⁰ H. Islami, A. Hoxha, I. Panda, Procedura Penale, f. 202.

¹¹¹ E. Sahiti, Argumentimi në Procedurë Penale, f. 193.

PROVAT DHE PROCESI I TË PROVUARIT NË PROCESIN PENAL

Organet proceduese gjatë procesit të marrjes së provave në çdo fazë të tyre, duhet të udhëhiqen nga detyrimi për respektimin e parimeve kushtetuese dhe procedurale, si dhe zbatimin e parashikimeve ligjore të KEDNJ-së për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor.

Gjykata Evropiane e Mbrojtjes së Drejtave të Njeriut në praktikën e saj gjyqësore shprehet se Konventa ka përcaktuar disa udhëzues të rëndësishëm në përcaktimin rast pas rasti të mënyrës së marrjes së provave dhe përdorimit të tyre.

Gjykata Kushtetuese në vendimin Nr. 07¹¹², dt. 27.04.2005 është shprehur se: *Legjislacioni ynë procedural penal, doktrina, si dhe jurisprudenca gjyqësore e kanë trajtuar gjerësisht mënyrën e marrjes së provave si një aspekt i rëndësishëm i procesit. Marrja e provave, sipas Kodit të Procedurës Penale, merr një kuptim të ri bazuar në sistemin akuzator, duke ndryshuar metodën e të proceduarit në lidhje me marrjen e provave në shqyrtimin gjyqësor, duke hequr dorë përfundimisht nga të gjitha ato norma, të cilat sanksiononin pabarazinë e palëve në procesin penal në disfavor të individit dhe të të drejtave të tij. Provat paraqiten dhe marrin vlerën e tyre në debatin gjyqësor. Dispozitat e këtij kodi kanë ndryshuar rrënjësisht mënyrën e procedimit penal në të gjitha fazat e tij, prandaj, mosrespektimi i dispozitave ligjore të vendosura për aktet e procedimit shërben njëkohësisht dhe si shkak pavlefshmërie që ndikon drejtpërdrejt mbi ecurinë e procesit gjyqësor.*

Po kështu, kjo Gjykatë shprehet se: *Mënyra e marrjes së provave ka rëndësi thelbësore për zhvillimin e drejtë të procesit gjyqësor penal. Marrja dhe pranimi i saj nga trupi gjyqësor në mënyrë të paligjshme nuk mund të mos nënkuptojë, që procesi ishte i parregullt¹¹³.*

Me ndryshimet e fundit të Kodit të Procedurës Penale jepet një përcaktim më i gjerë i konceptit të provave, çka në përmbajtjen e nenit 8/a¹¹⁴ të K. Pr. Penale (*Shtuar me Ligjin nr. 35/2017, dt. 30.3.2017*) parashikohet se:

1. Faktet në procesin penal provohen me çdo provë, me kusht që ato të mos cenojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut.
2. Organi procedues duhet të mbledhë dhe të shqyrtojë si provat që fajësojnë të pandehurin, ashtu edhe ato që janë në favor të tij.

Në përputhje me dispozitat e K. Pr. Penale, prova mund të merret gjatë hetimeve paraprake nga organi i akuzës, si dhe gjatë gjykimit nga ana e gjykatës.

❖ *Marrja e provave gjatë hetimeve paraprake*

K. Pr. Penale në nenin 151/1¹¹⁵ parashikon se: *Gjatë hetimeve paraprake, provat merren nga organi që procedon, sipas rregullave të caktuara në këtë Kod.*

Në interpretim të kësaj dispozite, gjatë fazës së hetimeve paraprake, pasi konstatohet kryerja e një vepre penale, organet proceduese, prokuroria dhe policia gjyqësore, me

¹¹² Vendimi nr. 7, dt. 27.04.2005 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

¹¹³ Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr. 14, dt. 03.05.2011.

¹¹⁴ Kodi i Procedurës Penale, neni 8, shtuar me ligjin nr. 35/2017, dt. 30.3.2017.

¹¹⁵ Kodi i Procedurës Penale, neni 151.

PROVAT DHE PROCESI I TË PROVUARIT NË PROCESIN PENAL

anë të mjeteve të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale fillojnë hetimin për zbulimin, marrjen dhe administrimin e provave, të cilat shërbejnë për zbulimin e rrethanave të kryerjes së kësaj vepre dhe autorët e saj.

Rëndësia e ndërmarjes së veprimeve procedurale në këtë fazë mbështetet në:

- sigurimin e provave kualitative materiale;
- sigurimin e ushtrimit real dhe pa pengesa të të drejtave, të cilat u njihen subjekteve procedurale;
- në arritjen e rezultateve më të mira procedurale në mënyrë efikase¹¹⁶.

Prandaj faktet dhe provat duhet të shihen si mjete ndihmëse që ndihmojnë në përmirësimin e saktësisë dhe probabilitetit të një historie. Prokurori mund të fokusohet në gjetjen e dëshmisë, që përmirëson probabilitetin se i pandehuri është fajtor për krimin. Ndërsa i pandehuri mund të përqendrohet tek provat që rritin probabilitetin ose që i bëjnë provat e prokurorit të duken më pak të sigurta apo të besueshme.

Çdo provë që zhvillohet gjatë një hetimi dhe pastaj paraqitet në gjykatë ka cilësi të brendshme që ndërliken me prova të tjera, me pohime, me konkluzionet e përkohshme dhe me objektivat përfundimtare të çështjes. Provat mund të jenë relevante, të besueshme dhe të kenë fuqi provuese¹¹⁷.

Veprimet procedurale-penale zakonisht ndërmerren në selinë e organit, i cili kryen veprimin. Gjatë hetimit, veprimet procedurale-penale mund të ndërmerren edhe në tjetër vend, në varësi nga rrethanat konkrete.

Mbledhja e provave gjatë veprimeve hetimore realizohet nga marrja në pyetje e të pandehurit, marrja në pyetje e dëshmitarit, ekspertiza, kontrolli i vendit të ngjarjes, identifikimi i personave, sendeve dhe konfiskimi i përkohshëm i tyre.

Duhet thënë se organet hetimore, përveç këtyre mjeteve për kërkimin dhe marrjen e provës, mund të përdorin dhe mjete të tjera me karakter të fshehur, si përgjimet telefonike apo kompjuterike, përdorimi i pajisjeve për gjurmim, fotografimet, incizimet etj.

Të gjitha veprimet procedurale të kryera gjatë kësaj faze duhet të pasqyrohen dhe të dokumentohen nga organet proceduese sipas mënyrës dhe formës së parashikuar në ligj. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë në Vendimi Nr. 702, dt. 31.10.2007, lidhur me detyrimin e respektimit të kërkesave të ligjit për marrjen e provave dhe dokumentimin e tyre arsyeton se: *Dokumentimi i veprimeve për marrjen e provave është i detyrueshëm për t'u zbatuar nga organet e procedimit penal në çdo fazë të tij (në gjykim apo hetime paraprake), në të cilat është e lejueshme marrja dhe administrimi i provave¹¹⁸.*

Mbi bazën e provave të marra gjatë hetimeve paraprake, prokurori i çështjes, pas shqyrtimit dhe verifikimit të tyre, vendos mbi mënyrën e përfundimit të hetimeve në procedimin penal dhe akuzën konkrete që do të ngrihet.

¹¹⁶ E. Sahiti & R. Murati & Xh. Elshani, f. 90.

¹¹⁷ J. Smibert, J. D., LL. M. (Lond.), <http://www.brrln.org/uploads/documents/219>.

¹¹⁸ Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, Vendimi Nr. 702, dt. 31.10.2007.

*Përveç kësaj, funksioni i hetimit është edhe mbledhja e provave, gjë që nuk do të mund të përsëritej në shqyrtimin gjyqësor, apo prezantimi i tyre do të gërshetohej me vështirësi të përmasave të mëdha*¹¹⁹.

Respektimi i kërkesave të përgjithshme dhe të veçanta të ligjit në marrjen e provave gjatë kësaj faze paraqitet me rëndësi thelbësore, pasi ndikon në vlefshmërinë e përdorueshmërinë e këtyre provave gjatë shqyrtimit gjyqësor.

GJEDNJ-ja në çështjen Schenk kundër Zvicrës¹²⁰ shprehet se “Pranimi i provave të marra në mënyrë të paligjshme në vetvete nuk shkel Nenin 6, por Gjykata u shpreh se mund të rezultojë në padrejtësi në lidhje me faktet e një çështjeje të caktuar.”

Për respektimin e këtyre parimeve të rëndësishme, që duhet të shërbejnë si themele për procesin e rregullt ligjor, Gjykata Kushtetuese në vendimin Nr. 57 datë 21.12.2012¹²¹, është shprehur se “Sipas jurisprudencës kushtetuese, marrja e provave në mënyrë të ligjshme përbën një aspekt të rëndësishëm të respektimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe nga neni 6 i KEDNJ-së. Në këtë drejtim, detyra e Gjykatës është të vlerësojë nëse procesi si i tërë, duke përfshirë edhe mënyrën e marrjes së provave, ka qenë i drejtë. Parimi bazë kushtetues që lidh provat me procesin e rregullt është i sanksionuar në nenin 32/2 të Kushtetutës, sipas të cilit askush nuk mund të deklarohet fajtor mbi bazën e të dhënave të mbledhura në mënyrë të paligjshme.”

Pyetja që lind natyrshëm kur trajtojmë temën e fazës së marrjes së provave është se “Çfarë vlere procedurale kanë deklaratimet e marra gjatë fazës së hetimeve paraprake? Shërbejnë si akte procedurale, nëpërmjet të cilave organi i akuzës ushtron kompetencat e parashikuara nga ligji, apo shërbejnë si prova?”

Në kushtet aktuale që nuk parashikohen as në seksionin e provave dhe mjeteve të marrjes së provës është shumë e vështirë që t’i japësh një përkufizim specifik juridiko-procedural penal deklarimeve si veprime procedurale.

Ka juristë që mendojnë se deklaratimet e dhëna përpara oficerit të policisë gjyqësore ose prokurorit janë prova. Ky qëndrim i tyre nisët nga vlera procedurale që legjislatori i ka njohur këtyre akteve procedurale të përpiluara gjatë fazës së hetimeve, në nenet 362 dhe 369¹²² të Kodit. Këto dispozita parashikojnë se:

.....Deklarimet e dhëna para prokurorit ose policisë gjyqësore mund të vlerësohen si provë, nëse ato lidhen me prova të tjera që konfirmojnë vërtetësinë e tyre.

...Leximi i deklarimeve të bëra nga shtetasi shqiptar ose i huaj, banues jashtë shtetit, mund të bëhet në qoftë se ai është thirrur dhe nuk është paraqitur ose, kur nuk gjendet, me gjithë kërkimet e bëra nga policia gjyqësore.

Në qoftë se do t’i referohemi doktrinës procedurale penale italiane, deklaratimet do të konsiderohen si mjete të provës. E Drejta Procedurale Italiane e ndërtuar në bazë të parimeve të një sistemi të pastër akuzator ka parashikuar se palët në procesin gjyqësor penal paraqesin përpara gjykatës mjete të provës, të cilat vlerësohen për t’u marrë,

¹¹⁹ E. Sahiti & R. Murati & Xh. Elshani.

¹²⁰ E drejta për një proces të drejtë gjyqësor. Një udhëzues për zbatimin e Nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (2001), www.humanrights.coe.int.

¹²¹ Vendimi i Gjykatës Kushtetuese, nr. 57, dt. 21.12.2012.

¹²² Kodi i Procedurës Penale, neni 362 dhe 369.

shqyrtuar apo vlerësuar në seancë gjyqësore. Me mjete të provës, siç dhe kemi përcaktuar në fillim të këtij punimi, E Drejta Procedurale Penale Italiane ka përcaktuar ato mjete procedurale, të cilat bëjnë të mundur përfundimin në proces një element të provës. Sipas të Drejtës Procedurale Penale, element i provës është informacioni (si e dhënë e parë) që merret nga një burim i provës dhe që nuk është ende e vlerësuar nga ana e gjyqtarit.

Gjykata Kushtetuese, edhe pse kodi ynë në këtë seksion ndryshon nga Kodi Italian, ka vazhduar në jurisprudencën e saj me qëndrimin se prova merret në gjykim dhe deklarimet e dhëna gjatë fazës së hetimeve paraprake nuk i ka konsideruar si prova. Më konkretisht, në vendimin Nr.19¹²³, dt. 18.09.2008, Gjykata Kushtetuese, ndër të tjera është shprehur se:

Sipas kuptimit të Kodit të Procedurës Penale, deklarimet e bëra para prokurorit ose policisë gjyqësore nuk përbëjnë prova në vetvete. Në rastin e kundërshtimit të këtyre thënieve në gjykatë, në kuptim të nenit 362 të Kodit të Procedurës Penale, ato nuk janë provë, por vlerësohen nga gjykata për të përcaktuar besueshmërinë e personit të pyetur....

..Parimi i procesit të rregullt përfshin edhe të drejtën e palëve për të njohur dhe për të komentuar çdo provë apo vërejtje që i është paraqitur trupit gjykues, pavarësisht prejardhjes së tyre...

Gjithsesi mendoj se dispozitat e Kodit të Procedurës Penale kanë nevojë për një përcaktim me specifik për sa i përket termit “marrje e provës” dhe me parashikimin aktual të tij, mendimet e mësipërme janë thjesht një vlerësim subjektiv i joni i dhënë me shumë për efekt studimi të fazës së “marrjes së provës”.

❖ **Marrja e provave gjatë shqyrtimit gjyqësor**

Sikurse cituam më lart, marrja e provave kryhet dhe gjatë fazës së shqyrtimit gjyqësor nga ana e gjykatës. Në fakt, në referim të parimeve tashmë të njohura që karakterizojnë procesin gjyqësor penal të sistemit akuzator, prova formohet, administrohet dhe vlerësohet në procesin gjyqësor. Nëpërmjet respektimit të parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, të garantuara shprehimisht në nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, synohet dhe realizimi i një debati real ndërmjet akuzës dhe mbrojtjes, gjë që ndikon pozitivisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë në zbulimin e së vërtetës dhe dhënien e drejtësisë nga gjykata me objektivitet e paanësi.

Provat në gjykim merren nga gjykata mbi kërkesën e palëve. Palëve u takon unanimisht fuqia për të kërkuar dhe për të kundërshtuar marrjen e provës. Kompetencat e palëve janë të rregulluara me ligj dhe në mënyrë të tillë, që palët të mos abuzojnë me këtë të drejtë.

¹²³ Vendimi i Gjykatës Kushtetuese, nr.19, dt. 18.09.2008.

Neni 356 i K. Pr. Penale ka parashikuar se: *Prokurori ose i dëmtuari akuzues parashtron në mënyrë të përmbledhur faktet objekt akuze dhe tregon provat që kërkon të shqyrtohen.*

Sipas radhës, mbrojtësi i të pandehurit, përfaqësuesit e paditësit dhe të paditurit civilë tregojnë faktet që synojnë të provojnë dhe kërkojnë marrjen e provave.

Kodi i Procedurës Penale, krahas momentit procedural të paraqitjes së kërkesave për prova nga ana e palëve, ka parashikuar dhe detyrimin e gjykatës për t'u shprehur me vendim mbi marrjen e provave. Neni 357 i K. Pr. Penale parashikon se:

1. Gjykata, pasi dëgjon palët, jep vendim për marrjen e provave. 2. Gjatë shqyrtimit gjyqësor, palët mund të bëjnë pretendime lidhur me marrjen e provave. Gjykata mund të revokojë me vendim marrjen e provave që dalin të panevojshme ose të pranojë marrjen e provave që kanë qenë refuzuar.

Përveç parashikimeve të kësaj dispozite, gjykata ka detyrimin ligjor që të vendosë të mos marrë prova, të cilat janë të ndaluara nga ligji ose kur këto prova janë të panevojshme dhe nuk kanë asnjë lidhje me zgjidhjen e çështjes dhe objektin e gjykimit. Për shkak të parimeve të përcaktuara në Kushtetutë, Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Ligjit Procedural Penal, marrja e provave bëhet nga gjykata në seancë gjyqësore në praninë e detyrueshme të palëve, të pandehurit dhe mbrojtësit të tij, përveç rasteve kur vërtetohet se i pandehuri ka marrë dijëni efektivash mbi zhvillimin e procedimit kundër tij, si dhe vullnetarisht e në mënyrë të qartë heq dorë për të marrë pjesë në proces.

Pikërisht, për praninë e palëve, në zhvillim të jurisprudencës së saj, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka theksuar se: *... e drejta e një personi të akuzuar, për të qenë i pranishëm në seancën dëgjimore të akuzave të ngritura kundër tij është thelbësore për një proces të drejtë.*¹²⁴

*...Një gjyq penal në mungesë të të akuzuarit apo të një pale mund të lejohet në disa rrethana përjashtuese, nëse autoritetet kanë vepruar me kujdes, por nuk kanë mundur të vënë në dijeni personin përkatës për ta marrë në seancë dhe mund të lejohet në interesat e ushtrimit të drejtësisë në disa raste sëmundjesh.*¹²⁵

*Është e një rëndësie thelbësore që i akuzuari duhet të jetë i pranishëm në seancë, sepse ai ka të drejtën të dëgjohet, por edhe sepse ai ka nevojë t'i verifikojë gjykatës vërtetësinë e thënieve të tij dhe t'i krahasojë këto me të palës tjetër ose dhe të dëshmitarëve. Ligjvënësi duhet të jetë në gjendje të mos nxisë mungesa të pajustificueshme*¹²⁶.

Neni 359 i K. Pr. Penale ka përcaktuar dhe radhën e marrjes së provave në gjykim dhe më konkretisht: *Hetimi gjyqësor fillon me marrjen e provave të kërkuara nga prokurori ose i dëmtuari akuzues dhe vazhdon me provat e kërkuara nga i pandehuri, mbrojtësi dhe palët e tjera.*

Në interpretim të dispozitave të mësipërme, fillimisht merren provat e kërkuara nga prokurori ose i dëmtuari akuzues dhe më pas procedohet me marrjen e provave të kërkuara nga palët që akuzohen. Detyrimi që ka parashikuar ligjvënësi që fillimisht

¹²⁴ Ektabani kundër Suedisë 1988; Vaundelle kundër Francës 2003.

¹²⁵ Colozza kundër Italisë, 22. 01. 1985.

¹²⁶ Geyseghem kundër Belgjikës 1999.

PROVAT DHE PROCESI I TË PROVUARIT NË PROCESIN PENAL

procedohet me marrjen e provave të akuzuesit, lidhet me barrën e të provuarit (*onus probandi*) që ka prokurori apo i dëmtuari akuzues për të provuar para gjykatës akuzën që ai ka ngritur ndaj të pandehurit. Më pas procedohet me marrjen e provave nga i pandehuri apo mbrojtësi i caktuar prej tij, dëshmitarët, ekspertët.

Megjithatë, prova nuk është një e drejtë e rezervuar ekskluzivisht vetëm ndaj palëve. Krahas parashikimit të sipërpërmendur, në K. Pr. Penale është parashikuar dhe e drejta e gjykatës që, edhe kryesisht, të disponojë me vendim për marrjen e provave penale të reja, të cilat lidhen me objektin e të provuarit dhe zgjidhjen e drejtë të çështjes, dhe nuk janë kërkuar nga palët.

Kështu, neni 367 i K. Pr. Penale ka parashikuar se: “Pas marrjes së provave të kërkuara, gjykata, në qoftë se është e nevojshme, mund të bëjë pyetje shtesë dhe të disponojë, edhe kryesisht, marrjen e provave të reja. Kur nuk është e mundur të procedohet në të njëjtën seancë, ndërpritet gjykimi dhe caktohet data e seancës së re”.

Sipas Vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, *kur gjatë gjykimit të çështjes del domosdoshmëria e marrjes së një prove të re, qenia e së cilës del gjatë shqyrtimit gjyqësor, gjykata mund dhe duhet të vendosë ta marrë atë, nëse vlen për të vërtetuar faktet që pretendohen dhe lidhen me objektin e të provuarit...*¹²⁷

Kjo dispozitë parashikon rolin aktiv të gjyqtarit nëpërmjet ndërhyrjes së tij në procesin gjyqësor, i cili dhe *ex officio* vendos marrjen e provave, kur kjo është e nevojshme për dhënien e një vendimi të drejtë. Roli aktiv i gjykatës është krejtësisht i përligjur me qëllimin për të plotësuar atë boshllëk të krijuar nga mungesa e përkushtimit të palëve për të paraqitur të gjitha provat e mundshme. Ky pushtet në marrjen e provave të reja nga gjykata, bën pjesë në detyrën e lënë nga legjislatori për rindërtimin e rrethanave të faktit, zbulimit të së vërtetës dhe ka si funksion plotësimin e mungesës së elementeve të mjaftueshëm provues për të vendosur. Kuptimi konceptual i “provës së re” është domethënëse jo për faktin që prova duhet të ketë dalë apo të jetë zbuluar më vonë se ato të paraqitura nga palët, por thjesht nënkupton provën e pakërkuar më parë nga palët.

Lidhur me zbatimin e këtij parashimi ligjor, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë në vendimin Nr. 42 datë 22.01.2003¹²⁸, arsyeton se ...*në bazë të nenit 367 gjykata ka qenë e detyruar që, për të arritur në përfundim të drejtë e të paanshëm, të kërkonte dhe merrte dëshminë e personave që kishin kryer kapjen në flagrancë të të gjykuarit.*

Ndërsa në Vendimin Nr. 447,¹²⁹ dt. 18. 07. 2002, është shprehur se :... *Del qartë se hetimi e gjykimi i çështjes nuk është bërë i plotë e i gjithanshëm, fakt ky që ka influencuar në marrjen e vendimeve. Në dosje ndodhet akti i ekspertimit që nuk është administruar e nuk i është nënshtruar diskutimit të palëve, por që nga përmbajtja e tij dalin mjaft të dhëna që bëjnë fjalë për qëndrime e veprime në kundërshtim me përmbushjen e rregullt të detyrës së të gjithë të pandehurve.*

Është e nevojshme që çështja të rigjykohet për sqarimin e shumë problemeve që lidhen me akuzat ndaj të pandehurve, por që nuk janë trajtuar në gjykim dhe në vendimet e gjykatave. Kështu, është e domosdoshme se krahas problemeve që u trajtuan, të thirret

¹²⁷ Vendimi Nr. 62, dt. 14.02.2007, i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

¹²⁸ Vendimi Nr. 42, dt. 22.01.2003, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë.

¹²⁹ Vendimi nr. 447, dt. 18.07.2002, i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

PROVAT DHE PROCESI I TË PROVUARIT NË PROCESIN PENAL

për t'u pyetur eksperti R. Saraçi për të ballafaquar konkluzionet e tij me ato të nxjerra nga grupi i inventarizimit. Duhet të thirret eksperti i densitetit për të sqaruar problemet që kanë dalë në gjykim. Gjithashtu, duhet të kërkohet nga prokurori që të paraqesë prova për të sqaruar problemin e gjetjes së vajgurit në cisterna në një kohë që ka pasur furnizim vetëm me naftë, të sqarohet me provat që duhet të paraqesë prokuroria problemi i kontatorit që rezultoi në prishur, se kur është prishur e ç'pasoja kanë ardhur, si dhe nëse është konstatuar ky fakt nga të pandehurit që ishin anëtarë të grupit të inventarizimit. Njëkohësisht, meqë ka dalë se ka falsifikime lidhur me densitetin të bëhet ekspertimi grafik për të arritur në përfundimin se prej kujt është falsifikuar akti i inventarizimit.

Në po këtë kontekst, e drejta për të marrë prova të reja mund të ushtrohet nga gjyqtari në çdo rast që ai e çmon të nevojshme për të krijuar bindjen e tij të brendshme kur provat që kanë ofruar palët kanë qenë të pamjaftueshme për të krijuar një gjë të tillë. Pushteti i gjyqtarit në marrjen e provave të reja *ex officio* nuk përfshin dhe mundësinë për të lejuar leximin e akteve që ekzistojnë në fashikullin e gjykimit, pasi nuk duhet ngatërruar instituti i provave të reja me institutin e leximeve të lejueshme. Pra, nuk mund të zbatohet neni 367 i marrjes së provave të reja për të lejuar leximet e akteve, kur kjo gjë parashikohet nga vetë neni 369 i kodit.

Natyrshëm lind pyetja: "A duhet të vendosë gjyqtari marrjen e një prove, të cilën me kërkesë të palëve ka refuzuar ta marrë?". Kjo, sipas nesh, varet nga arsyet që gjyqtari i ka deklaruar si të papranueshme provën e kërkuar nga pala përkatëse. Në qoftë se kanë qenë arsye të tilla që lidhen me paligjshmërinë e këtyre provave, atëherë ai s'mund të vendosë marrjen e tyre përderisa paligjshmëria e marrjes është e evidente. Por, nëse arsyeja ka qenë e tillë, që prova nuk kishte lidhje me çështjen në gjykim gjatë momentit të kërkimit dhe gjatë debatit gjyqësor është provuar rëndësia e fakteve relevante, që njofton, atëherë gjyqtari nuk ka pse mos të vendosë marrjen e saj, nëse ajo është e domosdoshme për të dhënë një vendim të drejtë.

Në fund, duhet të theksohet fakti se ndërhyrja e gjyqtarit sipas nenit 367 në fazën e formimit të provës është vetëm me karakter plotësues e dytësor dhe asnjëherë nuk ka qëllim të zëvendësojë pushtetin e palëve. Në sistemin tonë procedural, gjyqtari ka një pushtet jo krejt pasiv në drejtimin e procesit provues, me qëllim për të plotësuar atë boshllëk të krijuar nga mungesa e përkushtimit të palëve për të paraqitur të gjitha provat e mundshme. Në këtë mënyrë, gjyqtari vendos marrjen e provave të reja, duke patur si kriter primar nevojën absolute për plotësimin e procesit të marrjes së provave të dala gjatë debatit gjyqësor. Pushteti i gjyqtarit në marrjen e provave të reja bën pjesë në detyrën e gjyqtarit për rindërtimin e së vërtetës dhe ka funksion të plotësojë mungesën e elementeve të mjaftueshëm provues për të vendosur.

Për sa i përket të pandehurit, Kodi i Procedurës Penale i ka njohur të drejtën të bëjë deklaratime, të cilat ai i vlerëson të përshtatshme në çdo fazë të shqyrtimit gjyqësor, me kusht që këto deklaratime t'i përmbahen objektit të gjykimit.

Një përcaktim i tillë nga ana e ligjvënësit është bërë në nenin 358/1 të Kodit të Procedurës Penale që parashikon: *Kryetari i bën të ditur të pandehurit se ai ka të drejtë të bëjë në çdo fazë të shqyrtimit gjyqësor deklaratimet që çmon të përshtatshme. Kur gjatë*

deklarimeve i pandehuri nuk i përmbahet objektit të akuzës, kryetari e paralajmëron dhe, kur ai vazhdon, i heq të drejtën e fjalës.

Marrja dhe dokumentimi i provave nga ana e subjekteve të njohura nga E Drejta Procedurale Penale, parashikohet në mënyrë të detyrueshme në dispozitat e KPP-së, të cilat parashikojnë kërkesa të përgjithshme dhe specifike të detyrueshme për t'u zbatuar në marrjen dhe administrimin e provës. Nëse provat janë marrë jo sipas kërkesave të ligjit dhe të padokumentuara, ato konsiderohen të vesuara dhe, sipas rastit, mund të konstatohen si të papërdorshme.

2.2.2. SHQYRTIMI DHE VERIFIKIMI I PROVAVE

Ndërsa gjetja dhe marrja e provave mund të bëhet nga të gjitha palët e përfshira në procesin penal dhe shoqërohet gjatë gjithë këtij procesi, fiksimi procedural i tyre bëhet nga organet kompetente, vetëm pasi të jenë zbuluar këto prova.

Pas fiksimit procedural të tyre, sipas formës dhe mënyrës së parashikuar nga ligji, kalohet në një fazë tjetër procedurale, e cila është Shqyrtimi dhe Verifikimi i tyre. Ky proces, i cili realizohet nga organet kompetente, bëhet duke analizuar përmbajtjen e secilës provë, si dhe duke përcaktuar raportin e saj ndaj faktit juridik penal kontestues¹³⁰.

Gjykata, pas vendimit për marrjen dhe administrimin e provës, duhet të marrë në shqyrtim dhe të realizojë verifikimin e plotë të saktësisë së tyre. Nëpërmjet këtij procesi arrihet të vlerësohet e përcaktohet vërtetësia e provave, si dhe formimi i bindjes së brendshme të gjykatës, mbi bazën e të cilave do të jepet dhe vendimi i fajësisë apo pafajësisë së të pandehurit. Kërkesa ligjore për shqyrtim dhe verifikim të provës në shqyrtimin gjyqësor, gjithashtu ka për qëllim që të përjashtojë përdorimin e provës së papranueshme.

Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut e çmon mënyrën, në të cilën trajtohen provat si një çështje të rëndësishme në marrjen e vendimit, nëse një gjyq ka qenë i drejtë apo jo¹³¹.

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë është shprehur se: *...Gjykata e Apelit, përsëri në rigjykim, jo vetëm që nuk ka mundur, por dhe nuk bën analizë për përcaktimin e vërtetësisë dhe fuqisë provuese të materialeve të paraqitura.*

Shqyrtimi i provave përbën elementin kryesor në marrjen e provave që lidhet me objektivitetin e atij shqyrtimi, për të krijuar bindjen tek gjykata pas atij shqyrtimi, gjë që përbën edhe parimin themelor për një proces të rregullt ligjor. Gjykata, në çdo proces, gjithë vëmendjen (duke zbatuar kërkesat procedurale) duhet ta përqendrojë në marrjen, shqyrtimin dhe administrimin e provave të paraqitura nga palët, duke çmuar fuqinë provuese të secilës prej tyre.

Procesi i shqyrtimit dhe verifikimit të provave duhet parë dhe realizuar si analizë e mirëdetajuar edhe në raport me provat e tjera, duke mos i dhënë vlerë të paracaktuar asnjërës nga provat e marra në shqyrtim. Ky detyrim është themelor për gjykatën në

¹³⁰ E. Sahiti & R. Murati, f. 252.

¹³¹ Çështja Van Mechelen & al kundër Vendeve të Ulëta, 18 mars 1977.

gjykimin e çështjes dhe sidomos në lidhje me fajësinë e të akuzuarve për kryerjen e veprës penale.

...gjykata i ka dhënë vlerë të paracaktuar shpjegimeve të mëpasshme të së gjykuarës Brikena Taku, me të cilat ajo ka mohuar atë çka kishte deklaruar përpara oficerit të policisë gjyqësore në datën 29 tetor 2007 dhe kjo provë, nga Gjykata e Apelit, nuk është çmuar në harmoni edhe një sërë provash të tjera të shqyrtuara gjatë gjykimit të çështjes në shkallë të parë, prova të cilat vërtetohin fajësinë e të gjykuarit¹³².

Çdo provë ka veçoritë e saj, në bazë të të cilave përcaktohen kushtet që duhen respektuar në marrjen e tyre, por në çdo rast vlera dhe fuqia provuese e provave varet nga rezultatet e verifikimit të tyre, nga sqarimi i plotë i kontradiktave dhe dyshimeve që mund të lindin. Mënyrat e verifikimit të provave janë nga më të ndryshmet dhe zbatimi i drejtë i tyre garanton kontrollin e saktësisë dhe vërtetësisë së njoftimeve që japin provat në procesin penal. Dispozitat 3/2, 152 dhe 380 të K. Pr. Penale ngarkojnë gjykatën me detyrimin për të shqyrtuar dhe verifikuar çdo provë në seancë gjyqësore drejtpërsëdrejti në mënyrë që të qartësojë çdo kontradiktë dhe dyshim që mund të ketë lindur me njoftimin e dhënë nga një provë ose disa prova.

Gjykata e Lartë, në praktikën e saj gjyqësore, edhe më parë është shprehur se: *Përcaktimi i vërtetësisë së provës që është vënë si kusht nga ligjvënësi për të pasur një proces ligjor çmuarje të saj, nënkupton verifikimin se ku konsiston lidhja e rrethanës apo objektit material konkret me objektin e të provuarit në çdo gjykim konkret¹³³.*

Gjykatat nuk kanë bërë asnjë analizë e verifikim rreth fakteve kriminale të paraqitura në kallëzim, si për rrethanat e largimit të saj nga banesa, ekspertimin mjeko-ligjor të saj, djegien me cigare që i është bërë apo injektimin në trup të lëndëve narkotike, si dhe nuk i kanë kushtuar asnjë rëndësi personalitetit të së dëmtuarës Blerina dhe raportit të tij me vërtetësinë e deklarimeve të saj. Po ashtu, nuk është verifikuar vërtetësia e thënieve në lidhje me djegien me cigare, që i gjykuari Luan pretendohet t'i ketë bërë të dëmtuarës¹³⁴.

Legjislacioni procedural, por edhe praktika gjyqësore ka përcaktuar se vendimi i gjykatës duhet detyrimisht që jo vetëm të bazohet në provat e marra, por këto prova duhet t'i jenë nënshtruar procesit të shqyrtimit dhe verifikimit të tyre në seancë gjyqësore në mënyrë të drejtpërdrejtë, ashtu dhe vlerësimit sipas bindjes së lirë të tij.

Parimi i vlerësimit të lirë të provave nënkupton që gjykata vlerëson provat e paraqitura në pajtim me logjikën e saj dhe analizën psikologjike, në bazë të ligjshmërisë së mendimit njerëzor dhe në bazë të përvojave. Me këtë rast, gjykata nuk është e lidhur për rregullat ligjore, të cilat, apriori, do të përcaktonin vlerën e disa provave¹³⁵.

Faktet në të cilat mbështetet vendimi i gjykatës duhet të vërtetohen në mënyrë të plotë dhe autentike. Gjykata nuk mund ta bazojë vendimin e saj në prova të paverifikuara e për më tepër të japë vendim fajësie, dënimi. Por ky proces realizohet edhe nëpërmjet marrjes së provave të reja kryesisht, të cilat do të ndihmonin në analizën e trupit të provave të paraqitura në tërësi. *...kur gjatë gjykimit të çështjes del domosdoshmëria e marrjes së*

¹³² Vendimi 850, dt.29.09.2010, i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

¹³³ Vendimi nr. 25, dt. 15.01.2003, i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

¹³⁴ Vendimi nr. 811, dt. 15.09.2010, i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

¹³⁵ Prof. dr. sc. Hajrija Sijerçiq – Çoliq Mr. sc. Haris Halilović, fq. 26.

PROVAT DHE PROCESI I TË PROVUARIT NË PROCESIN PENAL

një prove (dëshmie) të re, qenia e së cilës del gjatë shqyrtimit gjyqësor, gjykata mund të vendosë ta marrë atë nëse vlen për të vërtetuar faktet që pretendohen...¹³⁶.

Në vendimin (849), dt. 29.09.2010, Kolegji Penal i Gjykatës së lartë shprehet: *Për të marrë vendimin, kjo gjykatë nuk ka përdorur prova të tjera veç atyre që janë marrë e verifikuar në shqyrtimin gjyqësor, asnjë prove nuk i është dhënë vlerë e paracaktuar dhe gjykata i ka çmuar provat mbi bazën e bindjes së formuar pas shqyrtimit të tyre në tërësi¹³⁷.*

Verifikimi i provave të paraqitura në proces për autenticitetin dhe besueshmërinë e tyre realizohet nëpërmjet disa proceseve, si: dëshmisë, ballafaqimit, ekspertimit, procesit të njohjes, ekzaminimit dhe krahasimit të provave materiale, si dhe me çdo mjet tjetër të parashikuar shprehimisht në ligj dhe i marrë nga burime të ligjshme.

Edhe sipas të drejtës procedurale kosovare, realizimi i qëllimit të procedurës penale, i shprehur në nenin 1 të KPP-së, që të mos dënohet askush i pafajshëm dhe që fajtorit t'i jepet sanksioni penal në kushtet e parashikuara me Kod Penal dhe në bazë të procedurës së zbatuar sipas ligjit, kërkon vërtetimin e fakteve të shumta. Gjykata dhe organet shtetërore që marrin pjesë në procedurën penale kanë për detyrë që t'i vërtetojnë saktë dhe plotësisht faktet që kanë rëndësi për marrjen e vendimit të ligjshëm.¹³⁸

2.2.3. ÇMUARJA E PROVËS DHE VLERËSIMI NË PROCESIN PENAL

Çmuarja e provave, si faza e tretë dhe përfundimtare e procesit të të provuarit është sanksionuar në nenin 152 të KPP-së (Ndryshuar pika 1, me Ligjin nr. 35/2017, dt. 30.3.2017.).

1. Asnjë provë nuk ka vlerë të paracaktuar nga ligji. Gjykata, pas shqyrtimit të provave në tërësi, çmon vërtetësinë dhe fuqinë provuese të tyre, duke argumentuar arsyet ku është mbështetur për të krijuar bindjen e saj.

2. Ekzistenca e një fakti nuk mund të nxirret nga indiciet, përveçse kur këto janë të rëndësishme, të sakta dhe në përputhje me njëra-tjetrën.

3. Deklarimet e bëra nga i bashkëpandehuri në të njëjtën vepër penale ose nga personi i marrë si i pandehur në një procedim që lidhet me të, vlerësohen në unitet me provat e tjera që konfirmojnë vërtetësinë e tyre. Nuk është gjë tjetër veçse përcaktimi i vërtetësisë së provës, sipas bindjes së gjyqtarit, dhe vendosja e raporteve të drejta justifikuese mes fuqisë provuese të tyre dhe rezultatit final (vendimit) brenda kufijve dhe diskrecionit ligjor që ju njeh legjislacioni në fuqi.

Nga interpretimi i kësaj dispozite, vetë procesi i çmuarjes së provave është rezultat dhe i formimit të bindjes së brendshme të gjyqtarëve pas shqyrtimit të provave dhe fuqisë provuese të tyre për përcaktimin e sanksionit penal.

Mbledhja dhe verifikimi i provave nga organet proceduese dhe palët pjesëmarrëse në proces paraqesin anën e jashtme të procesit të të provuarit, ndërsa veprimtaria mendore

¹³⁶ Vendimi Nr. 154, datë 29.03.2006, i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

¹³⁷ Vendimi 849, dt. 29.09.2010, i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

¹³⁸ Prof. dr. sc. Ejup Sahiti / Prof. dr. sc. Rexhep Murati /Mr. Xhevdet Elshani.

e logjike për zbulimin e së vërtetës lidhur me veprën penale, përbëjnë anën e brendshme të këtij procesi.

Çmuarja e provave është proces operimi mendor i ndërlikuar për realizimin e të cilit, përveç njohurisë së ligjshmërisë së mendimit logjik, është e domosdoshme edhe njohja e psikologjisë gjyqësore, e cila merret me studimin e ligjshmërive rreth formimit dhe manifestimit të vetëdijes së pjesëmarrësve proceduralë. Bindja e brendshme është rezultat dhe produkt i veprimtarisë juridike, intelektuale e tekniko-shkencore të gjyqtarit dhe prokurorit e përfutur nga analizimi i plotë i rrethanave dhe fakteve të paraqitura gjatë shqyrtimit gjyqësor¹³⁹.

Vlerësimi i drejtë i provave duhet të jetë detyrë dhe rezultat i punës së gjykatës, e cila i analizon provat sipas parimit të drejtpërdrejtë dhe parimit kontradiktor. Në vlerësimin e provave në detyrë të drejtpërdrejtë nga ana e gjyqtarit, funksioni i tij bëhet më përgjegjës.

Praktika gjyqësore është e pasur me vendime të Gjykatës së Lartë për sa i përket detyrimit të gjykatave të faktit të respektojnë parimin e sanksionuar nga neni 152 i K. Pr. Penale. Kështu, në vendimin Nr. 280¹⁴⁰, dt. 04.06.2008, Kolegji i Gjykatës së Lartë është shprehur se:

Një vendim gjyqësor nuk mund të jetë i plotë vetëm me parashtrimin e faktit siç e pranon gjykata dhe paraqitjen e provave të akuzës. Në të duhet bërë analizë e plotë e provave, pranimi apo jo i pretendimeve të të gjykuarve dhe arsytimi për qëndrimin që mban gjykata, si dhe arsye të plota përse nuk pranohen provat e paraqitura nga të gjykuarit. ...Në rigjykimin e çështjes, Gjykata e Apelit Tiranë, duhet të zbatojë kërkesat ligjore të nenit 152 të K. Pr. Penale për çmuarjen e provave, të marrë e analizojë gjithë pretendimet e kërkesat e të pandehurve, të përsërisë shqyrtimin gjyqësor për të bërë të mundur arritjen në një përfundim të drejtë për zgjidhjen e çështjes.

Mirëpo, procesi i çmuarjes së lirë të provave nuk duhet konfunduar me procesin e vlerësimit të provave, i cili është proces që bazohet në parimin e së vërtetës materiale pas shqyrtimit dhe verifikimit të drejtpërdrejtë të materialit provues. Ndërsa procesi i çmuarjes së lirë të provave paraqitet si rezultat i vlerësimit të bindjes së lirë të gjykatës, bindje të cilën ajo e ka krijuar me rastin e zbatimit të procesit të marrjes së provave. Bindja e brendshme mund të jetë objektive dhe subjektive. Ana objektive qëndron në faktin se ajo krijohet mbi bazën e të dhënave që grumbullohen sipas burimeve të parashikuara në ligj dhe që përbëjnë fakte dhe rrethana që kanë ndodhur objektivisht. Për sa i përket anës subjektive ajo qëndron në faktin se ajo është bindje personale e personit që merret me procedimin dhe që krijohet në bazë të provave. Bindja e brendshme duhet t'u përmbahet disa parimeve, respektimi i të cilave e çon gjykatën në një zgjidhje të saktë të çështjes dhe përfundimisht të fajësisë apo pafajësisë së të pandehurit.

Në vendimin Nr.1¹⁴¹, dt. 10.01.2011, Gjykata e Lartë është shprehur se: *Në zbatim të Nenit 152/1 të këtij Kodi, gjykatat kanë përcaktuar drejt vërtetësinë dhe fuqinë provuese*

¹³⁹ E. Sahiti & R. Murati & Xh. Elshani, Komentari Kodi i Procedurës Penale, f. 672.

¹⁴⁰ Vendim i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, nr. 280, dt. 04.06.2008.

¹⁴¹ Vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, nr. 1, dt. 10.01.2011.

të provave, duke ia nënshtruar çdo prove shqyrtimit nga ana e saj, pa i dhënë atyre vlerë të paracaktuar. Çmuarja e provave është bërë nga gjykatat në përputhje me dispozitën e mësipërme, sipas bindjes së formular pas shqyrtimit të tyre në tërësi dhe nxjerrjes së konkluzioneve të drejta në lidhje me to.

Bindja e brendshme e gjyqtarit është rezultat i analizës dhe verifikimit të hollësishëm të secilës provë, përputhjeve dhe kontradiktave që kanë mes tyre. Ajo fillon të krijohet dhe arrihet shkallë-shkallë gjatë marrjes, shqyrtimit dhe verifikimit të provave. Krijohet në mënyrë spontane nga dëgjimi i dëshmitarëve, të pandehurit, ekspertëve, si dhe nga njoftimet që japin në tërësi të gjitha provat. Bindja e brendshme gjithashtu duhet të bazohet në konkluzionet e nxjerra nga një hetim i gjithanshëm dhe objektiv i çështjes, duke argumentuar në arsyetimin e vendimit se si ka ardhur gjykata deri te bindja konkrete. *Kjo mënyrë paraqet teorinë progresive të çmuarjes së lirë të provave.*

Në vlerësimin dhe çmuarjen e provave, gjykata e ka të detyrueshme të respektojë parimet themelore të sanksionuara në Kushtetutë, Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe KPP-së për garantimin e një procesi të rregullt ligjor. Kështu, gjatë këtij procesi, gjykata, përveç parimit të bindjes së lirë në vlerësimin e provave, duhet të mbajë parasysh dhe parimin e prezumimit të pafajësisë së të pandehurit, të kontradiktoritetit, të ligjshmërisë së provave, të barazisë së armëve.

Neni 30 i Kushtetutës¹⁴² dhe neni 4 i K. Pr. Penale parashikojnë se *kushdo quhet i pafajshëm, përderisa nuk i është provuar fajësia me vendim të formës së prerë.*

Respektimi i parimit të prezumimit të pafajësisë nga Gjykata Kushtetuese, si dhe ajo e Strasburgut është konsideruar si element i rëndësishëm i parimit të një procesi të rregullt ligjor.

Gjykata Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut, në vendimin e saj të datës 10 shkurt 1995¹⁴³, çështja Allent de Ribemont kundër Francës, ndër të tjera arsyeton: *Prezumimi i pafajësisë i parashikuar në paragrafin e 2 të nenit 6 është një ndër elementet e një procesi penal të drejtë siç kërkohet nga paragrafi 1 (shih veçanërisht vendimin Deweer kundër Belgjikës, datë 20 shkurt 1980). Ky parim shkelet në qoftë se një vendim gjyqësor lidhur me një person të akuzuar për kryerjen e një vepre penale pasqyron një mendim paraprak se ai është fajtor, kur fajësia e tij nuk është provuar ende në bazë të ligjit. Madje, edhe nëse nuk ka ende një konstatim formal, ka shkelje, dhe kur gjatë arsyetimit del se gjyqtari e konsideron të pandehurin fajtor.*

Ndërsa, në vendimin nr.19¹⁴⁴, datë 18.09.2008, të Gjykatës Kushtetuese citohet se: *Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) është shprehur se prezumimi i pafajësisë kërkon, ndër të tjera, që kryerja e detyrave nga anëtarët e një gjykate, nuk duhet të fillojë me idenë e paracaktuar se i akuzuari e ka kryer veprën për të cilën akuzohet, se barra e provës i takon prokurorit dhe çdo dyshim duhet të jetë në favor të të akuzuarit. Është detyrë e prokurorit që të informojë të akuzuarin për çështjen kundër tij, në mënyrë që ai të mund të përgatisë e paraqesë mbrojtjen dhe të kundërshtojë provat, të cilat mjaftojnë për ta dënuar atë. Parimi i prezumimit të pafajësisë mund të*

¹⁴² Kushtetuta e RSH-së, neni 30.

¹⁴³ Allent de Ribemont kundër Francës.

¹⁴⁴ Vendimi i Gjykatës Kushtetuese, nr. 19, datë 18.09.2008.

PROVAT DHE PROCESI I TË PROVUARIT NË PROCESIN PENAL

shkelet edhe në mungesë të një deklarimi formal; njafton të ekzistojë një arsyetim, i cili të sugjerojë se gjykata e konsideron të akuzuarin si fajtor, si edhe kur barra e provës kalon nga prokurori te mbrojtja (Shih vendimet e GJEDNJ-së Minelli kundër Zvicrës; John Murray kundër Mbretërisë së Bashkuar, 8 shkurt 1996; Telfner kundër Austrisë 20 qershor 2001)...

Në Vendimin Nr.97¹⁴⁵, datë 20.03.2013, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë është shprehur se: *Nga aktet dhe provat e shqyrtuara rezulton se të dy gjykatat e faktit i kanë bazuar vendimet e tyre vetëm në një provë të vetme, siç janë bisedat telefonike, të cilat, sipas vlerësimit të gjykatave të faktit, janë zhvilluar ndërmjet të gjykuarve dhe pa i analizuar ato me asnjë provë tjetër, direkte ose indirekte, që provon fajësinë e të pandehurve, duke vepruar kështu në kundërshtim me kërkesat e pikës 1 të nenit 152 të Kodit të Procedurës Penale, duke i dhënë kësaj prove vlerë të paracaktuar...*

..Duke iu referuar akteve dhe provave që ndodhen në dosjen gjyqësore, por duke iu referuar sidomos arsytimit të vendimeve të gjykatave të faktit, konstatohet se nuk ekziston asnjë provë direkte ose indirekte që të tregojë që këto biseda telefonike janë zhvilluar nga të gjykuarit, por nga këto gjykata është prezumuar, pa pasur prova, si dhe pa i analizuar ato, madje edhe pa i përmendur, se këto biseda janë zhvilluar nga të gjykuarit, duke vepruar kështu në kundërshtim me kërkesat e nenit 380 të Kodit të Procedurës Penale...

Një faktor tjetër i rëndësishëm për një vlerësim të drejtë të provave është edhe përvoja e gjyqtarit. Gjyqtari duhet të posedojë edhe disa njohuri themelore edhe nga disiplina shkencore, pasi në procesin e çmuarjes së lirë të provave, bindja e tij duhet të bazohet edhe në të dhëna të tilla. Për të bërë vlerësimin e një prove, çdo gjyqtar mbështetet qoftë në analizën logjike të provës, qoftë në analizën teknike të saj, analizë kjo që realizohet me aplikimin e metodave teknike dhe shkencore për zbulimin dhe çmuarjen e vlerës provuese të tyre, me të cilat merret kriminalistika.

Kështu, në mënyrë përmbledhëse, mund të themi se gjykata limitohet në bindjen e saj të brendshme në respektim të parimeve kushtetuese, kërkesave ligjore, rrjedhës logjike dhe arsytimit të drejtë. Jashtë këtyre parametrave, gjykata, pavarësisht nga ekzistenca e parimit të bindjes së brendshme, nuk mund të dalë.

2.3. PAPËRDORSHMËRIA DHE PAVLEFSHMËRIA E PROVAVE

2.3.1. Papërdorshmëria e provave në Procesin Penal

Me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 35/2017, datë 30.3.2017,¹⁴⁶ në Kreun I të Titullit IV të pjesës i janë reflektuar disa ndryshime që lidhen me lirinë e provave dhe çmuarjen e tyre në procesin penal.

Në përputhje me nenin 8/a të K. Pr. Penale, ndryshimet e pësuara në nenin 149 të K. Pr. Penale normojnë rënien e parimit të taksativitetit të llojet të provave të përcaktuara shprehimisht në ligj.

¹⁴⁵ Vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, nr. 97, datë 20.03.2013.

¹⁴⁶ Ligji nr. 35/2017, datë 30.3.2017.

PROVAT DHE PROCESI I TË PROVUARIT NË PROCESIN PENAL

Nëpërmjet këtij përcaktimi të bërë në këtë dispozitë vihen re dy parime kryesore:

1. *ligjshmëria,*
2. *objektiviteti.*

Që një provë të jetë e vlefshme¹⁴⁷ për t'u marrë, administruar dhe vlerësuar në procesin penal, ajo duhet detyrimisht të plotësojë njëkohësisht tre elementet e mëposhtëm në mënyrë kumulative;

1. *Të njoftojë rrethana dhe fakte të ekzistencës së një veprë penale, kryerjes ose jo të veprës penale, pasojat e ardhura prej saj, fajësinë ose pafajësinë e të pandehurit dhe shkallën e përgjegjësisë së tij.*
2. *Të jenë marrë prej burimeve të njohura e parashikuara nga ligji procedural penal.*
3. *Të jenë marrë sipas rregullave të parashikuara nga ligji procedural, por edhe jashtë rasteve të provave të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale.*

Në rastet e paragrafit të dytë të nenit 149 rezulton se prova nuk duhet të cenojë lirinë e vullnetin e personit. Në këtë këndvështrim duhet të dëgjohen palët në lidhje mbi mënyrën e marrjes së saj. Në këtë rast vlen të theksohet se ligjvënësi ka parashikuar me këtë ndryshim se gjykata në përmbushjen e detyrës së saj kryesore të realizimit dhe dhënies së drejtësisë, mund të marrë prova të cilat nuk parashikohen shprehimisht në ligj, duke ruajtur standardet e sipërcituara. E vetmja dilemë në formën se si është ndërtuar dispozita do të ishte nëse gjykata vetë me iniciativë do të mund të merrte një provë të tillë pa marrë mendimin e palëve, pra ta merrte si provë kryesisht.

Njëkohësisht, që një provë të jetë e vlefshme, përveç elementeve ligjorë të sipërcituara, secila pjesë e provës duhet të ketë dhe tri karakteristika kryesore, pavarësisht burimit ose llojit.

- *Karakteristika e parë e provës është relevanca ose substanca. Relevanca e provës varet krejtësisht nga ajo se çfarë duhet të vërtetohet.*
- *Karakteristika e dytë është besueshmëria e provës. Kjo përshkruan nëse prova duhet të besohet apo të konsiderohet e saktë.*
- *Karakteristika e fundit është forca provuese ose pesha e provës. Forca provuese përshkruan se sa bindëse është prova brenda trupit të provës në një çështje të caktuar.¹⁴⁸*

Në analizë të kushteve të përcaktuara në nenin 149 të KPP-së, lidhur me kushtin e parë të sipërcituar sipas Kodit të Procedurës Penale është e domosdoshme që njoftimet të pasqyrojnë rrethana dhe fakte të veprës penale dhe të autorësisë së saj që të konsiderohen prova penale të rëndësishme për t'u marrë, administruar dhe vlerësuar në proces.

Nëse rrethanat dhe faktet e njoftuara nuk vlerësohen si objekt të të provuarit në procesin penal, ato nuk mund të konsiderohen provë penale, edhe pse mund të jetë marrë nga burimet dhe sipas rregullave të përcaktuara nga Kodi i Procedurës Penale. Këtë qëndrim ka mbajtur dhe praktika gjyqësore, duke mos i marrë në administrim, me arsyetimin se i mungon lidhja me objektin e të provuarit.

¹⁴⁷ Përcaktimi i Kushtetutës sipas neneve 30, 31, 32, 33 dhe 42; K. E. Dr. të Njeriut në nenet 3, 5 dhe 6, si dhe Pakti Ndërkombëtar i të Drejtave Civile dhe Politike në nenet 14 dhe 15.

¹⁴⁸ A. D. Schum & W. Twining, *Analysis of Evidence*, f. 60-71.

PROVAT DHE PROCESI I TË PROVUARIT NË PROCESIN PENAL

Në vendimin unifikues nr.6¹⁴⁹, datë 11.10.2002, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë janë shprehur se:

..Si shkresat, dokumentet, ashtu edhe objekte të natyrës materiale, për t'u paraqitur si shkak për rishikimin e vendimit duhet të plotësojnë bashkërisht dy kushte: së pari, të kenë dalë ose të jenë zbuluar, pasi vendimi kishte marrë formë të prerë dhe së dyti, nga pikëpamja e formës procedurale, të jenë prova, në kuptimin që i jep provës ligjvënësi në dispozitën e nenit 149 të Kodit të Procedurës Penale.

Fakti që, pasi janë lëshuar, ato u autentifikuan nga ana e një noteri, ashtu edhe sikurse ato të ishin redaktuar tërësisht prej tij (noterit) nuk sjell asnjë ndryshim në ato që u thanë më lart, pasi deklarimet e bëra para një noteri nuk u japin atyre cilësinë e provës në kuptimin e nenit 149 të K. Pr. Penale.

Në lidhje me këtë vendim unifikues duhet të vëmë në dukje se me parashikimet e bëra, së fundmi, në ndryshimet e Kodit të Procedurës Penale është parashikuar në nenet 8/a dhe 149/2 edhe mundësia e marrjes së provave të tjera jashtë atyre të parashikuara shprehimisht në Kodin e Procedurës Penale, me kusht që të pyeten palët për to dhe të mos cenojnë lirinë e vullnetin e personave. Në këto kushte duhet thënë se parimi i taksativitetit të llojeve të provave ka rënë dhe forma si parakusht për vlefshmërinë e përmbajtjes është vënë në diskutim.

Sipas praktikës gjyqësore¹⁵⁰, në shumicën e rasteve për lëshimin e urdhrat të mbrojtjes ndaj dhunës së ushtruar nga njëri bashkëshort, gjyqtarët janë mbështetur vetëm në prova shkresore.

Mosparaqitja e provave shkresore gjatë këtij gjykimi nuk duhet trajtuar si shkak për rrëzimin e kërkesës, por dhënia e vendimit duhet bërë edhe mbi bazën e përshkrimit të rrethanave të deklaruara nga kërkuesi, si dhe bindjes së vetë gjyqtarit¹⁵¹.

Kusht i dytë për vlefshmërinë dhe përdorshmërinë e provave në procesin penal është që ato të jenë marrë prej burimeve të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale.

Ashtu siç e përmendëm edhe më lart, instituti i papërdorshmërisë është ndalimi absolut nga ana e gjykatës për të marrë, vlerësuar dhe për të vendosur në themel të një vendimi gjyqësor një akt provues, të marrë në kundërshtim me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale. Ky ndalim përkthehet në një sërë garancish që i jepen të pandehurit në proces, të cilat deprimojnë në Kodin e Procedurës Penale nga parimet themelore të parashikuara në Kushtetutë dhe në Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut.

Vendimi unifikues Nr.6¹⁵², datë 11.10.2002,*Ato, jo vetëm që duhet të përmbajnë njoftime mbi faktet e rrethanat që lidhen me veprën penale, për të cilat është deklaruar fajtor dhe dënuar personi, por edhe të jenë marrë nga njëri prej burimeve të parashikuara në ligjin procedural penal, në përputhje me rregullat e caktuara prej tij dhe që shërbejnë për të vërtetuar moskryerjen prej tij të veprës penale, kërkesa këto që nuk i plotësojnë deklaratat e paraqitura si shkak për rishikim në rastin konkret.*

¹⁴⁹ Vendimi unifikues nr.6, datë 11.10.2002, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

¹⁵⁰ Vendimi i Gj. Shk. I, Tr., nr. 7465, dt 23.09.2009.

¹⁵¹ A. Anastasi, Procesi i rregullt ligjor gjatë zbatimit të ligjit; Për masa ndaj dhunës në familje, f. 15.

¹⁵² Vendimi unifikues Nr.6, datë 11.10.2002, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

Por edhe marrja e provave duhet t'i nënshtrohet disa kriterëve ligjore, me qëllim që të kenë vlerë përdorueshmërie gjatë një procesi penal.

Neni 151 i KPP-së përcakton se:

1. *Gjatë hetimeve paraprake, provat merren nga organi që procedon, sipas rregullave të caktuara në këtë Kod.*
2. *Në gjykim, provat merren me kërkesën e palëve. Gjykata vendos menjëherë, duke përjashtuar provat e ndaluara nga ligji dhe ato që janë haptazi të panevojshme.*
3. *Provat e marra në shkelje të ndalimeve të parashikuara nga ligji nuk mund të përdoren. Papërdorshmëria e provave ngrihet kryesisht në çdo gjendje dhe shkallë të procedimit.*

Referuar parashikimit të kësaj dispozite, në analizë dhe të **kushtit të tretë** të nenit 149 të KPP-ë edhe pa kërkesë të palës, prokurori ose gjyqtari nuk duhet t'i përdori provat e marra në shkelje të ndalimeve që parashikon ligji. Pra, përdorimi i provave të marra gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk është i pakushtëzuar.

Për sa i përket interpretimit lidhur me terminologjinë e përdorur, mendojmë se parashikimi “në shkelje të ndalimeve të parashikuara nga ligji”, përkthehet në një sërë garancish që i jepen të pandehurit në proces, garanci të cilat jo domosdoshmërisht duhet të jenë në ligjin përkatës që rregullon procesin penal, por mund të ndeshen dhe në ligje të tjera apo parime themelore të parashikuara edhe në Kushtetuta apo Konventa Ndërkombëtare¹⁵³.

Ligjvënësi kur ka sanksionuar termin “të parashikuara nga ligji” nuk ka preferuar të shprehet në mënyrë përjashtuese me termin “të parashikuara nga ky ligj” jo vetëm sepse garancitë e të drejtat e njeriut nuk fillojnë e mbarojnë vetëm në Kodin e Procedurës Penale, por dhe sepse askush nuk mund t'i heqë efektin e “self executing” ligjit themelor të shtetit, Kushtetutës apo Konventave të ratifikuara dhe të shmangë sanksionin e papërdorshmërisë për një provë që shkel këto të fundit.

Gjithashtu, duhet të theksojmë se parashikimi i ndalimeve ligjore nuk duhet kuptuar vetëm në marrjen e një prove, e cila, në thelbin e saj, është e paligjshme, por edhe në marrjen në kundërshtim me rregullat e procesit provues të një prove, e cila në themel të saj është e ligjshme.

Sa u tha më sipër mbështetet dhe në paragrafin e dytë të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë¹⁵⁴, i cili në nenin 32/2 të tij ka përcaktuar se: “Askush nuk mund të deklarohet fajtor mbi bazën e të dhënave të mbledhura në mënyrë të paligjshme.”.

Në bazë të KEDNJ-së, gjykata ka për detyrë të vlerësojë në tërësi, nëse procedura lidhur me mënyrën si u siguruan provat ishte e drejtë.

Çdo provë që zhvillohet gjatë një hetimi dhe pastaj paraqitet në gjykatë ka cilësi të brendshme që ndërliiden me prova të tjera, me pohime, me konkluzionet e përkohshme dhe me objektivat përfundimtare të çështjes.

Para se një prokuror apo avokat të fillojë të mbledhë provat, ai duhet të jetë mjaft mirë në dijeni të asaj që duhet të provojë. Secila vepër penale mund të shpërbëhet në

¹⁵³ Neni 6 i Konventës.

¹⁵⁴ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 32/2.

*elemente që duhet të provohen dhe shpeshherë duhet të përdoren burime të ndryshme provash që të vërtetohet çdo element më vete*¹⁵⁵.

Respektimi i dispozitave të parashikuara nga Kodi i Procedurës Penale në marrjen e provave është trajtuar dhe nga Gjykata Evropiane e Mbrojtjes së të Drejtave të Njeriut si pjesë përbërëse e procesit të rregullt ligjor, e cila ka theksuar se për të përcaktuar nëse procesi ka qenë i rregullt, duhet kontrolluar nëse e drejta e mbrojtjes është respektuar dhe duhet verifikuar në veçanti nëse kërkuesit i është dhënë mundësia për të vënë në dyshim autenticitetin e provave dhe duke kundërshtuar përdorimin e tyre. GJEDNJ-ja është shprehur se nuk i takon kësaj gjykate të përcaktojë nëse lloje të caktuara provash, p.sh. ato të marra në mënyrë të kundraligjshme, duhet të përdoren apo jo nga gjykatat kombëtare. *Çështja që shtrohet për zgjidhje në këtë rast ka të bëjë nëse i gjithë procesi në tërësi, duke përfshirë edhe mënyrën e marrjes së provave, ishte i drejtë.*¹⁵⁶

*Në këtë rast duhet të hetohet “paligjshmëria” e pretenduar dhe kur ajo cenon një të drejtë të parashikuar në Konventë, duhet të përcaktohet natyra e shkeljes.*¹⁵⁷

GJEDNJ-së i është kërkuar të shprehet në lidhje me vlefshmërinë e akteve apo papërdorshmërinë e provave, kur këto të fundit janë marrë në shkelje të të drejtave themelore. E drejta për të heshtur dhe për të mos u vetakuzuar duhet të konsiderohen si “zemra e parimit të procesit të rregullt ligjor”. Kjo e drejtë konsiston kryesisht në të drejtën për të mos dhënë deklarime dhe nuk shtrihet në marrjen e provave me detyrim, si p.sh. dokumente, mostra të ADN-së etj.¹⁵⁸

Kështu, në çështjen *Schenk kundër Zvicrës, pranimi i provave të marra në mënyrë të paligjshme në vetvete nuk shkel Nenin 6, por Gjykata u shpreh se mund të rezultojë në padrejtësi në lidhje me faktet e një çështjeje të caktuar.*

Në këtë çështje që kishte lidhje me përdorimin e një regjistrimi të paligjshëm për sa kohë që nuk u urdhërua nga gjyqtari i hetimit, Gjykata u shpreh se nuk kishte pasur shkelje të Nenit 6 (1), meqë mbrojtja ishte në gjendje që të kundërshtonte përdorimin e regjistrimit dhe se kishte prova të tjera që mbështesnin dënimin e të akuzuarit.

Në referim të jurisprudencës së GJEDNJ-së për të vlerësuar nëse neni 6/1 i KEDNJ-së është shkelur, kjo do të varet nga disa faktorë si: a) nëse prova e pretenduar e paligjshme është debatuar në seancë gjyqësore; b) nëse ajo është e vetmja provë ku është bazuar akuza; c) nëse prova është marrë duke cenuar vullnetin e personit; d) nëse provat kanë të bëjnë me një krim që është kryer si rezultat i veprimeve të autoriteteve publike pa të cilat krimi nuk do të ishte kryer; e) kur nga autoritetet publike është cenuar e drejta e personit për të mos u vetakuzuar.¹⁵⁹

Tek çështja e Teixeira kundër Portugalisë, gjykata vuri në dukje se detyra e saj nuk ishte që të vendoste nëse deklaratat e dëshmitarëve ishin pranuar në mënyrën e duhur,

¹⁵⁵ J. Smibert, J. D., LL. M. (Lond.) <http://www.brrln.org/uploads/documents/219/alb.pdf>

¹⁵⁶ Vendimi i GJEDNJ-së “Van Mechelen dhe të tjerë kundër Holandës”, datë 18 mars 1997.

¹⁵⁷ Vendimi i GJEDNJ-së “P. G dhe J. H kundër Mbretërisë së Bashkuar”, datë 25 shtator 2001.

¹⁵⁸ Vendimi i GJEDNJ-së “Schenk kundër Zvicrës”, datë 12.07.1988. “Khan kundër Mbretërisë së Bashkuar”, datë 12 maj 2000.

¹⁵⁹ Opinioni i CFR-CDF 2003, Opinion on the status of illegally obtained evidence in criminal procedures in the Member States of the European Union.

por që të siguronte nëse procesi si një i tërë, duke përfshirë mënyrën në të cilën u mor prova, ishte i drejtë¹⁶⁰.

Vlen për t'u theksuar se GJEDNJ-ja mban qëndrim të qartë për përdorimin e provave të marra në kundërshtim me nenin 3 të KEDNJ-së. Gjykata ka konfirmuar se, edhe në rastet më të rënda, siç mund të jetë lufta kundër terrorizmit dhe krimi i organizuar, *Konventa e ndalon në mënyrë absolute përdorimin e torturës dhe akteve çnjerëzore, pavarësisht sjelljes së personit.*¹⁶¹

Doktrina e së drejtës dhe jurisprudenca e GJEDNJ-së kanë dalluar dy nivele papërdorshmërisë së provave, të cilat, nisur nga intensiteti i shkeljes në të drejtat themelore të njeriut në marrjen e tyre dhe pasojat e tyre në procesin e të provuarit ndahen në papërdorshmëri patologjike dhe papërdorshmëri fiziologjike.

Standardet që lidhen me mënyrën e marrjes së provave i ka trajtuar gjerësisht në jurisprudencën e saj edhe Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), duke u shprehur në mënyrë të qëndrueshme se provat e marrë në kushtet e shkeljes së Nenit 3 të KEDNJ-së përbëjnë papërdorshmëri patologjike dhe si të tilla nuk mund të përdoren në procesin penal. Papërdorshmëritë e kësaj natyre godasin, para së gjithash, provat e marra në shkelje të vlerave absolute të mbrojtura nga Kushtetuta dhe KEDNJ-ja, sikundër janë pohimet e marra nën torturë apo si rezultat i një trajtimi çnjerëzor ose poshtëruës.

Sipas GJEDNJ-së, në çështjen Kaçiu dhe Kotorri kundër Shqipërisë¹⁶², ku gjykata vërejtë se *pohimet vetakuzuese të kërkuesit të parë, të marra si rezultat i dhunës policore dhe pa praninë e mbrojtësit, në kohën kur ai ndodhej në kushtet e kufizimit të lirisë, duke qenë se ishin edhe prova e vetme e fajësisë në ngarkim të tij, e bëjnë procesin të parregullt, në tërësinë e tij.*

Procesi bëhet i parregullt edhe për shkak se atribuimet e tij akuzuese, të cilat ishin prova vendimtare e fajësisë së kërkuesit të dytë, ishin marrë nëpërmjet ushtrimit të dhunës. Pra, Gjykata e Strasburgut pranoi shkeljen e neneve 3 dhe 6§1 të Konventës. Ky shembull është rasti tipik për ilustrimin e papërdorshmërisë patologjike të provës së marrë në shkelje të vlerave, për të cilat Konventa ka normuar ndalime të natyrës absolute. Një interpretim më realist nisët nga parakushti që papërdorshmëria nuk ka të bëjë me çfarëdolloj cenimi të disiplinës që rregullon marrjen e provave, por sanksionon vetëm dhe përjashtimisht marrjen e provave "të ndaluara nga ligji".

Sipas GJEDNJ-së, në çështjen Jalloh vs Germany, gjykata është shprehur se *ka pasur shkelje të Nenit 3 dhe 6 të KEDNJ-së lidhur me mënyrën e marrjes së provës, pasi çdo ndërhyrje në integritetin fizik të një personi të kryer me qëllim të marrjes së provave duhej të ishte subjekt i shqyrtimit të rreptë. Autoritetet gjermane e kishin nënshtruar kërkuesin para një ndërhyrje të rëndë të integritetit të tij fizik dhe mendor kundër vullnetit të tij. Ata e kishin detyruar atë të merrte substanca psikotrope, jo për shkaqe terapeutike, por për të marrë dëshmi që mund të merrnin me të njëjtën vlerë provuese me metoda më pak të rrezikshme. Mënyra në të cilën u krye injektimi i medikamenteve*

¹⁶⁰ Vendim i GJEDNJ-së, Teixeira kundër Portugalisë.

¹⁶¹ Vendim i GJEDNJ-së, Chahal kundër Mbretërisë së Bashkuar, datë 15 nëntor 1996.

¹⁶² GJEDNJ-ja në çështjen Kaçiu dhe Kotorri kundër Shqipërisë.

PROVAT DHE PROCESI I TË PROVUARIT NË PROCESIN PENAL

kishte ngjallur te kërkuesi ndjenjen e frikës, ankthit dhe inferioritetit, të cilat ishin në gjendje të poshtëronin. Për më tepër, procedura kishte sjellë rreziqe për shëndetin e aplikantit. Edhe sikur të mos kishte qenë qëllimi i autoriteteve për të shkaktuar dhimbje dhe vuajtje ndaj kërkuesit, provat ishin marrë megjithatë nga një masë që shkeli një nga të drejtat themelore të garantuara nga Konventa. Interesi publik në sigurimin e dënimit të aplikantit nuk mund të justifikonte lejimin e provave të marra në atë mënyrë që të përdroreshin në gjykim. Prandaj, përdorimi i provave të drogave të marra nga organi procedues në mënyrë të dhunshme ndaj ankuesit, e kishte bërë gjykimin e tij si tërësi të padrejtë¹⁶³.

Në çështjen Gäfgen kundër Gjermanisë, GJEDNJ-ja shprehet se: *Për përdorimin në proces të provave materiale të siguruara drejtpërdrejt me anën e keqtrajtimeve, GJEDNJ-ja ka çmuar se provat materiale të siguruara me anë të akteve të dhunës nuk duhet asnjëherë, cilado qoftë vlera e tyre bindëse, të merren si referencë për të provuar fajësinë e personit.*

Neni 3 i Konventës përmban një të drejtë absolute, ndaj nuk mund të peshohen interesa të tjera kundër saj, si serioziteti i veprës penale apo interesi publik për ndjekjen efektive penale, sepse një gjë e tillë do të cenonte natyrën e saj absolute. Sipas qëndrimit të GJEDNJ-së, as mbrojtja e jetës së njeriut, as sigurimi i dënimit penal nuk mund të arrihen duke komprometuar mbrojtjen e së drejtës absolute për të mos iu nënshtuar keqtrajtimit të parashikuar nga neni 3. Përdorimi i provave të tilla, të përfutuara në saje të shkëljes së njëres prej të drejtave absolute që përbëjnë thelbin e konventës, shkakton gjithmonë dyshime të forta lidhur me rregullsinë e procesit, edhe nëse pranimi i këtyre provave nuk ka qenë vendimtar për dënimin e të dyshuarit. Si rrjedhojë, gjykata, në lidhje me pohimin e krimtut si të tillë, çmoi se pranimi i deklarimeve të përfutuara me anë të akteve të torturës apo me anë të keqtrajtimeve të tjera në kundërshtim me nenin 3 e kishte bërë procesin në tërësi të parregullt. Ajo ka shtuar se ishte kështu pavarësisht nga vlera bindëse e deklaratave dhe pavarësisht se pranimi i këtyre deklaratave kishte qenë ose jo vendimtar për verdiktin e fajësisë që ishte dhënë ndaj aplikantit.

Një rast shumë interesant me rëndësi për t'u përmendur është edhe rasti Svetina kundër Sllovenisë, datë 22/05/2018, në të cilin ankuesi pretendonte shkelje të nenit 6 dhe nenit 8 të KEDNJ-së, për shkak se përgjimi i bisedave telefonike në telefonin e tij vinte si rezultat i këqyrjes së telefonit dhe bisedave të tij hyrëse dhe dalëse të viktimës në vendin e ngjarjes, pa autorizimin e gjykatës. Pra, ankuesi pretendonte se numri i tij i telefonit dhe bisedat e para me viktimën ishin marrë në kundërshtim me të drejtën kushtetuese për fshehtësinë e korrespondencës, ndërsa përgjimi i mëvonshëm i telefonit të tij ishte kryer në bazë të autorizimit të gjykatës.

Në këtë rast, gjykata u shpreh se *këqyrja e telefonit të viktimës dhe marrja nga kjo këqyrje e numrit të telefonit të ankuesit ishte në kundërshtim me të drejtën kushtetuese të "fshehtësisë së korrespondencës", por kjo shkelje nuk kishte qenë thelbësore dhe se vërtetë këqyrja kishte shërbyer si mjet për të arritur tek përgjimi i mëvonshëm, por të dhënat lidhur me veprën penale të kryer nga ankuesi nuk janë marrë nga këqyrja, por*

¹⁶³ Vendim i GJEDNJ-së, Jalloh vs Germany.

PROVAT DHE PROCESI I TË PROVUARIT NË PROCESIN PENAL

nga përmbajtja e bisedave të dala nga përgjimi. Vetë këqyrja e telefonit (e kryer në kundërshtim me kushtetutën) nuk ishte thelbësore për gjykimin, por provë e rëndësishme ishte përmbajtja e bisedave të marra nga një përgjim i autorizuar nga gjykata¹⁶⁴.

Në çështjen e Unterpetinger kundër Austrisë¹⁶⁵, pranimi i thashethemeve si prova në parim nuk është në kundërshtim me garancitë e procesit të drejtë, por, nëse nuk ka mundësi për të bërë hetime, kjo mund ta bëjë gjyqin të padrejtë, nëse dënimi bazohet tërësisht ose kryesisht në prova të tilla. Megjithatë, përdorimi si provë e deklaratave të përdoruara në fazën paragyqësore nuk është në vetvete në kundërshtim me Nenin 6, për sa kohë që të respektohen të drejtat e palës mbrojtëse.

Përveç provave të paraqitura nga palët, gjykata mund të marrë prova edhe kryesisht. Gjykata i çmon provat duke përcaktuar saktësinë, vërtetësinë, si dhe fuqinë provuese të tyre, pas shqyrtimit të tyre në tërësi.

Komisioni Evropian i të Drejtave të Njeriut ka deklaruar se, sipas nenit 6: *Një gjykatë duhet të japë arsye për të cilat vendos që të mos thërrasë për të dhënë dëshmi ata dëshmitarë, të cilët janë kërkuar shprehimisht për t'u marrë në pyetje.*

GJEDNJ-ja arriti në një përfundim të ngjashëm në çështjen Vidal¹⁶⁶ kundër Belgjikës. Në atë çështje, përveç deklaratave verbale të të dy të pandehurve, apeluesi (i cili më parë ishte deklaruar i pafajshëm nga Gjykata e Shkallës së Parë pas dëshmisë së disa dëshmitarëve) u dënua nga një Gjykatë Apeli, bazuar vetëm në provat e dosjes, pa thirrur dëshmitarët që mbrojtja i kishte kërkuar për t'i marrë në pyetje. Gjykata arriti në përfundimin se Gjykata e Apelit refuzoi marrjen e dëshmitarëve në heshtje të plotë dhe në këtë mënyrë bëri një gjykim jo të drejtë sipas parashikimeve të shprehura nga neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut.

Megjithëse gjykata gjykoi se gjykata vendëse ishte përqendruar në mosdhënien e arsyeve të refuzimit, kjo çështje mund të kuptohet edhe si e tillë që GJEDNJ-ja vuri në dyshim vetë vendimin, i cili përjashtonte marrjen e dëshmive që mund të siguronin prova në favor të të pandehurit, i cili më pas u dënua me katër vjet burgim për një krim të rëndë.

Respektimi i këtij parimi si një ndër kriteret e vlerësimit të procesit të rregullt ligjor është trajtuar dhe nga Gjykata Kushtetuese në praktikën e saj gjyqësore.

Bazuar në dispozitat procedurale, në gjykim, provat merren me kërkesën e palëve dhe prova nuk mund të përdoret kur është marrë në shkelje të ndalimeve të parashikuara nga ligji. Mënyra e marrjes së provave ka rëndësi thelbësore për zhvillimin e një procesi të drejtë penal, pasi sigurimi i paligjshëm i provës dhe pranimi i saj nga trupi gjykues, e bën procesin të parregullt nga pikëpamja kushtetuese¹⁶⁷.

...Gjykatat do të dëmtonin rëndë parimin e dhënies së drejtësisë në rast se ato do ta mbështesnin vendimin e tyre në prova të marra në mënyrë të kundërligjshme¹⁶⁸.

¹⁶⁴ Vendim i GJEDNJ-së, Svetina kundër Sllovenisë, datë 22/05/2018.

¹⁶⁵ Vendim i GJEDNJ-së, Unterpetinger kundër Austrisë.

¹⁶⁶ Vendim i GJEDNJ-së, Vidal kundër Belgjikës.

¹⁶⁷ Vendimi i Gjykatës Kushtetuese, nr.7, datë 27 prill 2005, nr. 9, datë 26.02.2015.

¹⁶⁸ Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të RSH-së, nr.84, datë 12.07.2012.

PROVAT DHE PROCESI I TË PROVUARIT NË PROCESIN PENAL

Gjithashtu, Gjykata Kushtetuese në Vendimin Nr. 57, datë 21.12.2012¹⁶⁹, është shprehur se: *Sipas jurisprudencës kushtetuese, marrja e provave në mënyrë të ligjshme përbën një aspekt të rëndësishëm të respektimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe nga neni 6 i KEDNJ-së. Në këtë drejtim, detyra e gjykatës është të vlerësojë nëse procesi si i tërë, duke përfshirë edhe mënyrën e marrjes së provave, ka qenë i drejtë. Parimi bazë kushtetues që lidh provat me procesin e rregullt është i sanksionuar në nenin 32/2 të Kushtetutës, sipas të cilit askush nuk mund të deklarohet fajtor mbi bazën e të dhënave të mbledhura në mënyrë të paligjshme. Për të përcaktuar nëse procesi ka qenë i rregullt, duhet kontrolluar nëse e drejta e mbrojtjes është respektuar dhe duhet verifikuar në veçanti nëse kërkuesit i është dhënë mundësia për të vënë në dyshim autenticitetin e provave dhe kundërshtuar përdorimin e tyre.*

Pra, prova duhet në kuptimin objektiv të provojë një fakt që ka lidhje me objektin e të provuarit të akuzës dhe fajësisë së një personi, dhe nuk duhet të jetë shprehimisht e ndaluar me ligj

Në këtë kuptim rezulton se edhe ajo hije dyshimi që ka ekzistuar deri më tani në lidhje me formën si kusht paraprak për vlefshmërinë e përmbajtjes, tashmë është saktësuar me ligj dhe organi procedues, bazuar në këtë dispozitë dhe në nenin 149/2 të KPP-së mund të marrë edhe prova, që nuk rregullohet shprehimisht me ligj, mjafton që ajo të jetë në përputhje me lirinë e vullnetit të personit dhe palët të mos kenë kundërshtime në lidhje me këtë fakt

Ndërsa çdo provë tjetër që nuk rregullohet shprehimisht në ligj mund të merret nga gjykata, kur nuk bie në kundërshtim me të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe lirinë e vullnetit të personit. Pra, në këtë dispozitë, si dhe në dispozitat 149, 150, 151 të KPP-së duhet të bëhet dallimi mes provave që nuk rregullohen me ligj dhe provave që ndalohen me ligj.

Në rastin e parë, ato mund të merren nga gjykata, pasi dëgjoen palët në lidhje me mënyrën e marrjes së tyre dhe, në rastin e dytë, ato nuk mund të përdoren, pasi janë të ndaluara shprehimisht me ligj dhe papërdorshmëria mund të ngrihet kryesisht në çdo gjendje e shkallë të procedimit. Në të kundërt, përdorimi i këtyre provave juridikisht të pavlefshme do ta bënte gjithë procesin nul.

Gjatë procesit gjyqësor, provat zakonisht paraqiten me kërkesën e palëve. Gjykata vendos për pranueshmërinë e provave përmes një urdhri, duke përjashtuar provat e ndaluara nga ligji ose ato që janë haptazi të panevojshme.¹⁷⁰

Sipas Jon Simbert: *Gjetja e provave që kundërshtojnë provat direkte ose vënë në pikëpyetje cilësitë e tyre, është një mënyrë e fortë për të kundërshtuar trupin kryesor të provave. Kur nuk i ka këto prova, juristi duhet të vërë në pikëpyetje në mënyrë kritike cilësitë e provave të paraqitura nga pala kundërshtare. Kur cilësitë e provave shqyrtohen në mënyrë më kritike, kjo gjë e ndihmon gjykatën të vlerësojë provat më mirë dhe të gjykojë rastin¹⁷¹.*

¹⁶⁹ Gjykata Kushtetuese, Vendimi Nr. 57, datë 21.12.2012.

¹⁷⁰ Kodi i Procedurës Penale, neni 151, pika 2.

¹⁷¹ J. Smibert, J. D., LL. M. (Lond.) <http://www.brrln.org/uploads/documents/219/alb.pdf>

PROVAT DHE PROCESI I TË PROVUARIT NË PROCESIN PENAL

Një Gjykatë Apeli duhet të çmojë provat e paraqitura në gjykimin e shkallës së parë dhe mund të plotësojë, në raste të veçanta, përfundimet në të cilat ka arritur gjykata në lidhje me faktet¹⁷².

Kështu, në varësi të natyrës së çështjes dhe të shkaqeve të ankimit, Gjykata e Apelit mund të mbështetet në provat e marra gjatë gjykimit në shkallën e parë, të urdhërojë përsëritjen e shqyrtimit gjyqësor, tërësisht ose pjesërisht dhe gjithashtu të marrë prova të reja, me kërkesën e palëve ose kryesisht¹⁷³.

Në Vendimin Nr. 1331¹⁷⁴, datë 21.12.2012, Gjykata e Apelit Tiranë, ndër të tjera është shprehur se: *Me të drejtë, Gjykata e Shkallës së Parë ka cilësuar si të papërdorshme rezultatet e përgjimit të komunikimeve telefonike hyrëse dhe dalëse të të pandehurve të këtij gjykimi të vlerësuara, lejuara apo zgjatura nga gjykata sipas vendimeve respektive gjyqësore të përfshira në fashikullin e gjykimit (vendimi Nr. 100, akti datë 12.09.2009; vendimi Nr. 100/11, akti datë 06.11.2009), pasi nuk janë respektuar dispozitat procedurale penale në lidhje me përgjimin e fshehtë të komunikimeve telefonike.*

Në kushtet kur transkriptet e përgjimit fillestar telefonike, sipas vendimit nr. 100 akti, dt. 12.09.2009, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë janë të papërdorshme, ato nuk mund të kenë cilësimë procedurale të provës në drejtim të vërtetimit të akuzës për t'u përdorur në lejimin, vlefshimin apo zgjatjen e përgjimeve vijuese (vendimet nr. 100/1 akti – nr. 100/11 akti), çka konsiderohen dhe këto të fundit “përgjime të paligjshme” dhe rezultatet e tyre “të papërdorshme” për arsye të lejimit të përgjimit në mungesë të provave të akuzës (neni 221/1 i KPP-së).

Në vendimin Nr.571¹⁷⁵, datë 17.12.2008, Gjykata e Lartë arsyeton se: *Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë gjen të drejtë konkluzionin e Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda, pasi, siç edhe ajo arsyeton, vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda ka në themel të tij deklarime të shtetasve të huaj gjatë fazës së hetimeve paraprake, pa ezauruar thirrjen e tyre në gjykim në kuptim të nenit 167/a të KPP-së, pra mbështetet në prova të papërdorshme në kuptim të nenit 151/4 të K. Pr. Penale.*

Pra, me të drejtë, Gjykata e Lartë i ka konsideruar si të papërdorshme deklaratimet e shtetasve gjatë hetimeve paraprake. Ato janë të papërdorshme jo për faktin, sepse janë një provë e paligjshme, por thjesht për faktin, sepse janë futur në gjykim pa respektuar një iteracion të përcaktuar ligjërisht, ashtu siç arsyeton gjykata “pa ezauruar thirrjen e tyre në gjykim në kuptim të nenit 167/a të K. Pr. Penale.”

Për sa më sipër, duhet të theksojmë se instituti i papërdorshmërisë prek të gjitha ato njoftime të rrethanave të faktit, të cilat, jo vetëm në thelbin e tyre janë të paligjshme, por edhe në marrjen në kundërshtim me rregullat e procesit provues të një akti provues, i cili në themel të tij është i ligjshëm.

Jo më kot, legjislatori ka parashikuar se nuk janë imune ndaj institutit të papërdorshmërisë dhe shumë akte të cilat nuk janë të ngritura në rangun e provës e që, megjithatë, njoftojnë rrethana të faktit juridik penal.

¹⁷² KPP, neni 152. Shih gjithashtu Komentarin e KPP-së, f. 496-497 .

¹⁷³ KPP, neni 427. Komentari i KPP-së, f. 550.

¹⁷⁴ Vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë, nr. 1331, datë 21.12.2012.

¹⁷⁵ Vendimin i Gjykatës së Lartë, Nr.571, datë 17.12.2008

PROVAT DHE PROCESI I TË PROVUARIT NË PROCESIN PENAL

Për shembull, megjithëse përgjimi është mjet për kërkimin e provës, neni 226 i Kodit të Procedurës Penale parashikon se: *Rezultatet e përgjimit nuk mund të përdoren kur janë bërë jashtë rasteve të lejuara nga ligji ose kur nuk janë respektuar dispozitat e këtij seksioni. 2. Nuk mund të përdoren përgjimet e bisedave ose të komunikimeve të atyre që janë të detyruar të ruajnë sekretin, për shkak të profesionit apo detyrës, me përjashtim të rasteve kur këta persona kanë deponuar mbi të njëjtat fakte ose i kanë përhapur në ndonjë mënyre tjetër. 3. Gjykata urdhëron asgjësimin e dokumentacionit të përgjimeve që ndalohet të përdoren, me përjashtim të rasteve kur përbëjnë provë materiale.*

Kolegji i Gjykatës së Lartë në vendimin Nr. 124¹⁷⁶, datë 28.04.2014, ndër të tjera është shprehur se: *Në Kodin e Procedurës Penale janë përkufizuar “mjetet e kërkimit të provës”, kategori në të cilën bëjnë pjesë, ndër të tjera, edhe përgjimet. Dallimi me llojet e provës qëndron në faktin se, këto të fundit, karakterizohen nga aftësia për t’i ofruar gjykatës rezultate provash, të cilat janë drejtpërsëdrejti të përdorshme gjatë procesit të vendimmarrjes së gjykatës. Aftësia provuese e llojeve të provës krijohet në momentin e formimit dhe të përfutimit të llojit të provës. Ndërsa mjetet e kërkimit të provës, sikundër janë edhe përgjimet, nuk janë në vetvete burim bindjeje, porse ato mundësojnë përfutimin e deklaramëve që kanë aftësi provuese për procesin penal. Nëpërmjet mjeteve të kërkimit të provës, futen në proces elemente të provave që kanë ekzistuar më parë, në raport me momentin e formimit apo të përfutimit të llojit të provës.*

Për lejimin e mjetit procedural të përgjimeve në procedimin penal, janë të nevojshme disa kushte themelore *sine qua non*, mosrespektimi i të cilave sjell si pasojë papërdorshmërinë e rezultateve të përfutura nga përgjimet. Këto kushte janë: përcaktimi i qartë i kufirit të dënimit penal të veprës penale për të cilën procedohet; pra, nëse kemi të bëjmë me një vepër penale, e cila është e parashikuar shprehimisht në kufirin e lejimit të këtij lloji mjeti të kërkimit të provës nga ligji, subjekti i legjitimuar për të kërkuar deponimin e përgjimeve, subjekti që disponon përgjimet, subjekti pasiv i interesuar, akti i motivuar që disponon mbi përgjimet, përcaktimi i llojit të përgjimeve dhe i objektivit të tyre, parashtrimi i arsyeve të domosdoshmërisë së përgjimit për vazhdimin e hetimeve, prania e provave të mjaftueshme për vërtetimin e akuzës, procedura e përgjimit, kohëzgjatja, ekzekutimi i tyre, dokumentimi përkatës i veprimeve interceptive, si dhe eventualisht ankimi edhe e drejta e palëve për t’u konsultuar me rezultatet e përgjimeve.

Dhe indiciet nuk janë prova në kuptimin që i jep Kodi i Procedurës këtyre të fundit, por edhe këto preken nga instituti i papërdorshmërisë, pasi në nenin 152 të Kodit të Procedurës Penale parashikohet se: *Ekzistenca e një fakti nuk mund të nxirret nga indiciet, përveçse kur këto janë të rëndësishme, të sakta dhe në përputhje me njëra-tjetrën.*

Duke qenë se indicia nuk është provë, mund të lindë pyetja, nëse mbi të mund të operojë sanksioni i papërdorshmërisë ose thënë më qartë, nëse është e vërtetë se një provë e papërdorshme nuk mund të jetë provë. A mundet të shërbejë ajo si indicie?

¹⁷⁶ Vendim i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, nr. 124 datë 28.04.2014.

Në këndvështrimin tonë, pyetja e mësipërme duhet të marrë përgjigje negative. Neni 151/3¹⁷⁷ i K. Pr. Penale ndalon në mënyrë kategorike e të pakapërcyeshme, që ato mjete të provës që janë goditur nga sanksioni i papërdorshmërisë, të bëhen të dobishme nga ana provuese, pra të vendosen në themel të një vendimi gjyqësor. Papërdorshmëria është një sanksion i tillë procedural që përjashton çdo vlerë provuese të mjetit të provës, duke e nxjerrë atë plotësisht jashtë procesit dhe jo duke e ulur thjesht rangun e provës në indicie.

Është e logjikshme që bindja e gjyqtarit nuk mund të bazohet as minimalisht në të dhëna të mbledhura në mënyrë të paligjshme, qofshin këto prova ose indicie. Siç e kemi përshkruar edhe më lart, kjo është shprehimisht e ndaluar në dispozita kushtetuese, neni 32/2 i Kushtetutës së RSH-së.

Referuar dispozitave dhe vendimit të gjykatës të sipërcituar, arrijmë në konkluzionin se e papërdorshmja ka të bëjë me ndalimin e përdorjes së një akti që përmban rrethana të faktit juridik penal, në kushtet që është marrë në kundërshtim me dispozitat e akteve normative në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

I vetmi rast që Kodi i Procedurës Penale ka parashikuar papërdorshmërinë për një akt i cili në thelb nuk është akt procedural provues, është rasti i neni 283/3 të tij, në të cilin përcaktohet se: *Kallëzimet anonime nuk mund të përdoren, me përjashtim të rasteve të parashikuara nga neni 195.*

Por, dhe në këtë rast, ne mendojmë se legjislatori i referohet papërdorshmërisë së rrethanave të faktit që njofton kallëzimi dhe jo kallëzimit si akt për të iniciuar procedimin penal.

Megjithatë, ajo që është e diskutueshme është fakti nëse papërdorshmëria pengon shfrytëzimin procedural apo edhe atë ekstra-procedural të provës. Pra, në qoftë se mbi provën e papërdorshme mund të merret një spunto hetimore, apo të përdoret informacioni që ajo përmban për qëllime të hetimit. Nga njëra anë është ajo pjesë e juristëve të cilët mendojnë se nga prova e papërdorshme nuk duhet të merret asnjë informacion hetimor, pasi kjo do të zbehte në mënyrë të dukshme qëllimin e papërdorshmërisë si institut. Nga ana tjetër, ekziston mendimi se një provë e papërdorshme nuk arrin qëllimin final të saj për të qenë pjesë e një vendimi gjyqësor, por fare mirë mund të shërbejë si një orientim për veprime të tjera hetimore nga ana e prokurorisë.

Në praktikën gjyqësore është mbajtur qëndrimi se papërdorshmëria e një prove nuk shmang shfrytëzimin e saj nga ana e prokurorisë për nisje të hetimeve, kur këto mund të nisin dhe *ex-officio*. Qëndrim i tillë është mbajtur dhe nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë¹⁷⁸, i cili, duke pranuar papërdorshmërinë e një prove, nuk mohoi faktin e një shfrytëzimi të saj nga ana e prokurorisë për nisjen e hetimeve.

Vërtet videokaseta shërben si bazë për fillimin e çështjes penale, por ajo nuk mund të shërbejë si provë, ku të bazohet dyshimi i arsyeshëm ndaj të akuzuarve. Kjo do të thotë se organi i akuzës mbi bazën e saj duhet të kishte paraqitur prova të tjera në përputhje me ligjin procedural.

¹⁷⁷ Kodi i Procedurës Penale, neni 151.

¹⁷⁸ Vendimi nr. 37,¹⁷⁸ datë 08.04.2004, i Kolegjit Penal i Gjykatës së Lartë.

2.3.2. PAVLEFSHMËRIA E AKTEVE PROCEDURALE NË PROCESIN PENAL

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, që ka si mision kryesor evidentimin, promovimin dhe ruajtjen e vlerave themelore demokratike, si dhe sigurimin e stabilitetit, parashikon se subjektet e procedimit penal duhet t'i ushtrojnë kompetencat e tyre, duke respektuar, por dhe garantuar të gjitha të drejtat procedurale të të pandehurit. Si ligji themelor i shtetit, Kushtetuta i detyron këto subjekte që aktet procedurale, me të cilat i ushtrojnë kompetencat e tyre, t'i përpilojnë në kuadër dhe në bazë të normave kushtetuese.

Ky akt suprem, përmbajtja e dispozitave e të cilit nuk mund të mënjanohet, së bashku me Kodin e Procedurës Penale sanksionojnë garantimin e zhvillimin e një procesi gjyqësor strikt, të disiplinuar dhe të kontrolluar në respektim të parimit të procesit të rregullt ligjor. Natyrisht, që të respektohen këto rekuizita të vendosura nga ligjvënësi në këto akte normative, referuar dhe parimit të taksativitetit, është e nevojshme që subjektet e procedimit penal të tregohen profesionalisht të kujdesshëm në përpilimin e akteve procedurale, në të kundërt veprimtaria e tyre procedurale mund të veçohet, pra të preket ose nga sanksioni i pavlefshmërisë, ose nga ai i parregullsisë.

Praktika gjyqësore, por dhe studiuesit në radhët e tyre, kanë mbajtur qëndrime të ndryshme dhe shpeshherë konfonduese në lidhje me dallimin që ekziston ndërmjet një akti juridik të pavlefshëm, të parregullt dhe me një procedural juridik të vlefshëm.

Mendojmë që fillimisht, për të përcaktuar dallimin midis tyre të trajtojmë elementet e vlefshmërisë së një akti procedural, në mënyrë që jo vetëm të arrijmë të krijojmë një përkufizim ligjor të aktit procedural të vlefshëm, por edhe të përcaktojmë karakteristikat e tij dalluese me aktin e pavlefshëm ose të parregullt. Kështu, që akti të prodhojë efekte juridike dhe të jetë efektiv, duhet të jetë juridikisht ekzistues, i përkryer, pra të jetë përpiluar në përputhje me përcaktimet ligjore dhe të bëhet menjëherë, në përputhje me ligjin, për arsye të vazhdimësisë procedurale. Në analizë të elementeve të cituar, arrijmë në konkluzionin se akti procedural i vlefshëm është instrumenti ligjor i parashikuar nga ligji, që përdoret nga ana e subjekteve të procedimit penal për arritjen e një qëllimi të caktuar procedural. Pra, akti procedural i vlefshëm, është akti juridikisht ekzistues, i përsosur nga ana formale dhe në gjendje për të arritur efektet që ka për qëllim për të prodhuar.

Analiza e mësipërme na ndihmon jo vetëm për të kuptuar rekuizitat e vlefshmërisë së aktit procedural, por për të kuptuar dhe më mirë rastet kur një akt preket nga sanksioni i pavlefshmërisë. Kështu, preket nga sanksioni i pavlefshmërisë çdo akt procedural i vesuar, i cili nuk është marrë konform kritereve ligjore të vendosura nga ligjvënësi. Edhe pse ligjvënësi, për hartimin dhe miratimin e Kodit të Procedurës Penale aktuale, i është referuar modelit italian që njeh tre modele pavlefshmërie, në ndryshim nga ai ka vendosur të parashikojë në nenet 128 dhe 129 vetëm dy lloje pavlefshmërie: atë të pavlefshmërisë absolute dhe pavlefshmërinë relative. Dallimi në ndarjen midis dy llojeve të pavlefshmërisë, qëndron, së pari, në rëndësinë e dispozitës së shkelur; së dyti,

PROVAT DHE PROCESI I TË PROVUARIT NË PROCESIN PENAL

në faktin që një akt i konstatuar si absolutisht i pavlefshëm nuk mund të bëhet i vlefshëm dhe, së treti, në faktin që pavlefshmëria absolute mund të ngrihet dhe *ex officio*.

Më konkretisht, Kodi i Procedurës Penale ka parashikuar si tepër të rënda, dhe që pasjellin pavlefshmërinë absolute, shkeljen e atyre dispozitave që përcaktojnë:

- *kushtet për të qenë gjyqtar në çështjen konkrete dhe numrin e gjyqtarëve që janë të domosdoshëm për formimin e kolegjeve të caktuara në këtë Kod;*
- *të drejtën e prokurorit për ushtrimin e ndjekjes penale dhe pjesëmarrjen e tij në procedim;*
- *thirrjen e të pandehurit ose praninë e mbrojtësit kur ajo është e detyrueshme.*

Prima facie, kjo dispozitë jep një parashikim të përgjithshëm, duke e lënë në dorë të zbatuesve të kodit, gjetjen, interpretimin dhe ngritjen e pavlefshmërisë absolute rast pas rasti. Ajo që mund të konstatojmë është se ligjvënësi, pavlefshmërinë absolute, e lidh me shkeljen e atyre dispozitave që rregullojnë ushtrimin e funksioneve të subjekteve të procedimit penal, pra të gjyqtarit, prokurorit dhe garantimin e të gjitha të drejtave që i parashikon ligji të pandehurit dhe mbrojtësin e tij.

Kodi i Procedurës Penale në nenin 15¹⁷⁹ parashikon se:

1. *Gjyqtari që ka dhënë ose që ka marrë pjesë në dhënien e vendimit në një shkallë të procedimit nuk mund të ushtrojë funksionet e gjyqtarit në shkallët e tjera, as të marrë pjesë në rigjykim pas prishjes së vendimit.*
2. *Nuk mund të marrë pjesë në gjykim gjyqtari që ka vleftësuar masën e sigurimit ose çdo kërkesë tjetër të prokurorit të paraqitur gjatë hetimit paraprak në të njëjtin procedim.*
3. *Nuk mund të ushtrojë në të njëjtin procedim detyrën e gjyqtarit ai që ka qenë prokuror ose që ka kryer veprime të policisë gjyqësore ose që ka qenë mbrojtës, përfaqësues i një pale ose dëshmitar, ekspert ose që ka paraqitur një kallëzim, ankim, kërkesë për procedim ose që ka dhënë apo ka marrë pjesë në dhënien e vendimit për autorizimin e procedimit.*

Në nenin 16¹⁸⁰ të K. Pr. Penale parashikon se: *Në të njëjtin procedim nuk mund të marrin pjesë si gjyqtarë personat që janë ndërmjet tyre ose me pjesëmarrësit në gjykim: bashkëshortë, gjini e afërt (të paralindur, të paslindur, vëllezër, motra, ungjër, emta, nipër, mbesa, fëmijë të vëllezërve dhe të motrave) ose krushqi e afërt (vjuhërr, vjuhërrë, dhëndër, nuse, kumatë, thjeshtri, thjeshtra, njerku e njerka).*

Këto dispozita ligjore synojnë parandalimin e gjyqtarit në paragjykimin e fakteve objekt akuze dhe të çdo elementi tjetër që mund të shkojë si në interes të të pandehurit, ashtu dhe në interes të akuzës. Për këtë arsye, ai nuk duhet të njihet që në fazën e hetimeve paraprake me faktet dhe provat, ato duhet t'i paraqesin palët në seancën gjyqësore në barazi të plotë midis tyre në respektim dhe të parimit të kontradiktoritetit. Kjo është arsyeja që neni 15 kufizon të drejtën e pjesëmarrjes në gjykimin e themelit gjyqtarin që ka vlerësuar masën e sigurimit dhe përgjithësisht çdo kërkesë të prokurorit në fazën e hetimeve paraprake, me qëllim që të sigurohet paanësia e tij në gjykimin e themelit, si element shumë i rëndësishëm i procesit të rregullt ligjor.

¹⁷⁹ Kodi i Procedurës Penale, neni 15, fq. 12.

¹⁸⁰ Kodi i Procedurës Penale, Neni 16, fq. 13.

Formimi i trupit gjykues dhe plotësimi i rekuizitave ligjore për të qenë gjyqtar është trajtuar dhe nga Gjykata e Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut, e cila, në vendimin Hauschild kundër Danimarkës, datë 24.05.1989,¹⁸¹ konstatoi cenim të nenit 6 të Konventës, për shkak se gjyqtari që kryesoi trupin gjykues në shkallë të parë dhe gjyqtarët që e shqyrtuan çështjen në apel, ishin investuar në fazat e mëparshme të procedimit duke disponuar mbi lirinë personale të kërkuesit.

Gjykata jonë Kushtetuese, në Vendimin Nr. 12¹⁸², datë 13.04.2007, është shprehur se: *është e papranueshme, që një gjyqtar që ka marrë pjesë në dhënien e një vendimi në një shkallë të mëparshme të gjykimit (në rastin konkret në Gjykatën e Apelit), të jetë sërish në përbërje të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë që do të shqyrtojë e vlerësojë shkaqet e rekursit që janë pikërisht edhe kundër këtij vendimi. Në rastin konkret, dyshimi i kërkuesve për njëanshmëri në shqyrtimin e çështjes në Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë të mbledhur në dhomën e këshillimit është i drejtë. Një nga gjyqtarët në përbërje të këtij kolegji ka marrë pjesë më parë në trupin gjykues në Gjykatën e Apelit Durrës, i cili ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, që ka gjetur fajtorë dhe dënuar kërkuesit respektivisht me 8 vjet dhe 10 vjet burgim. Madje, në këtë rast, ky gjyqtar kishte qenë edhe relator i çështjes. Mbi këtë bazë, duhej të ishte mënjeluar pjesëmarrja e këtij gjyqtari në Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë të mbledhur për shqyrtimin e rekursit të kërkuesve. Vetë të gjykuarit apo mbrojtësit e tyre nuk e kanë pasur dhe as nuk mund ta kenë mundësinë ta kërkojnë këtë në këtë fazë të shqyrtimit të çështjes në Gjykatën e Lartë, pasi ata nuk janë të pranishëm.*

Në Vendimin Nr. 104¹⁸³, datë 27.02.2008, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë në lidhje me pavlefshmërinë absolute se nuk janë parashikuar kushtet për të qenë gjyqtar, ndër të tjera, janë shprehur se: *Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë çmon se vendimi i Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda dhe vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda janë marrë në zbatim të gabuar të ligjit dhe si të tillë ato duhet të prishen. Në vështrim të nenit 15/2 të K. Pr. P., gjyqtarët që morën pjesë në seancën e sigurimit të provës (dëshmisë) nga e dëmtuara Arbana Dalipi, nuk mund të ishin pjesë e trupit gjykues që do të gjykonte çështjen e themelit në ngarkim të të gjykuarit, ku do të vlerësohej në cilësinë e provës edhe dëshmia e të dëmtuarës. Gjykimi i kërkesave të prokurorit gjatë hetimit paraprak të të njëjtit procedim është parashikuar në dispozitën e lartpërmendur si një nga rastet për papajtueshmërinë e funksionit të gjyqtarit në gjykimin e çështjes së themelit.*

Duke bërë një interpretim të gabuar të dispozitës së nenit 15 të K. Pr. P., vërehet se gjyqtari i vetëm i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda me vendimin nr. 90, datë 28.12.2005, e ka rrëzuar kërkesën e paraqitur nga mbrojtja për përjashtimin e gjyqtarëve me arsyetimin se ajo është paraqitur jashtë afatit të parashikuar nga neni 19. Në vlerësim të nenit 17/1, germa "e" të K. Pr. P., në rastin konkret, gjyqtarët kanë qenë përpara një papajtueshmërie të shprehur posaçërisht në ligj, e ndryshme kjo nga cenimi i pozitës së paanshmërisë në gjykimin e çështjes për shkaqe të karakterit

¹⁸¹ Hauschild kundër Danimarkës, datë 24.05.1989.

¹⁸² Vendimi Nr.12, datë 13.04.2007, i Gjykatës Kushtetuese.

¹⁸³ Vendimi Nr. 104, datë 27.02.2008, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë.

PROVAT DHE PROCESI I TË PROVUARIT NË PROCESIN PENAL

subjektiv që mund të rezultojnë gjatë gjykimit të çështjes, të cilat parashikohen në nenin 18/2 të K. Pr. P.

Ky arsyetim i gabuar nuk është korrigjuar nga Gjykata e Apelit për Krime të Rënda, që e ka lënë të pacenuar këtë vendim. Për sa më lart, duke iu referuar nenit 128/1, pika "a" të K. Pr. P., vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda dhe vendimi i Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda janë të pavlefshme, pasi, gjatë gjykimit të çështjes, janë lejuar shkelje të rënda të dispozitave procedurale penale, që kanë të bëjnë me përbërjen e trupit gjykues, gjë që ka sjellë si pasojë cenimin e procesit të rregullt ligjor.

Siç mund dhe të konstatohet, parashikimet e neneve 15 dhe 16 të Kodit të Procedurës Penale janë të detyrueshme për t'u zbatuar nga gjykata gjatë gjykimit të procedimit penal, në të kundërt, ashtu siç është shprehur dhe Gjykata Kushtetuese dhe Gjykata Evropiane e Mbrojtjes së të Drejtave të Njeriut në jurisprudencën e krijuar, do të cenonin rëndë elementet e procesit të rregullt ligjor të parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe 6 i Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut.

Akte të tjera të cilat preken nga sanksioni i pavlefshmërisë absolute referuar dhe nenit 128/1/b, janë dhe aktet të cilat kufizojnë të drejtën e prokurorit për ushtrimin e ndjekjes penale dhe pjesëmarrjen e tij në procedim. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, në nenin 148, parashikon se: *Prokuroria ushtron ndjekjen penale, si dhe përfaqëson akuzën në gjyq në emër të shtetit.*

Referuar këtij parashikimi, prokurori është subjekt i vetëm i procedimit penal që ka të drejtë të formulojë akuzë dhe të vlerësojë nëse, në përfundim të hetimeve, çështja duhet të dërgohet për gjykim apo duhet të pushohet. Për këtë arsye, është absolutisht i pavlefshëm çdo disponim i palëve në proces, edhe i gjyqtarit, në drejtim të cenimit të së drejtës dhe nismës së tij për të përmbushur funksionin akuzues. Në Vendimin Nr. 287, datë 15.03.2007, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, ndër të tjera, është shprehur se:

Sikurse u përmend, nuk është marrë vendim nga prokurori për shfuqizimin e vendimit të pushimit të procedimit penal në ngarkim të Gazmend Hoxhallarit dhe, për pasojë, ndaj tij nuk mund të vazhdohej procedimi, por gjykatat nuk e kanë vlerësuar këtë moment procedural shumë të rëndësishëm dhe kanë vendosur dënimin e një personi, çështja penale në ngarkim të të cilit ishte pushuar me vendim të prokurorit. Në Gjykatën e Apelit, mbrojtësi e ka paraqitur këtë pretendim duke kërkuar që të mos vazhdohej gjykimi i çështjes përderisa nuk ishte shfuqizuar vendimi i pushimit, por ky pretendim nuk është marrë parasysh, përveç të tjerash, edhe me arsyetimin se, të gjitha vendimet e marra në fazën e hetimeve paraprake, pavarësisht nga mendimi i prokurorit të çështjes, duhet të miratohen nga titullari i prokurorisë, në të kundërtën ai s'ka asnjë efekt, ndaj edhe në rastin në shqyrtim, deri sa vendimi nuk është miratuar nga titullari, hetimet kanë vazhduar dhe kanë përfunduar duke u sjellë për gjykim të pandehurit, arsyetim ky i pabazuar në ndonjë dispozitë të K. Pr. Penale.¹⁸⁴

¹⁸⁴ Vendimi Nr. 287, datë 15.03.2007, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë.

PROVAT DHE PROCESI I TË PROVUARIT NË PROCESIN PENAL

Në bazë të nenit 24 të K. Pr. Penale (funksionet e prokurorit), prokurori ushtron ndjekjen penale, bën hetime, kontrollohen hetimet paraprake, ka të drejtë të mos fillojë ose të pushojë procedimin penal dhe nuk bëhet fjalë për titullarin e prokurorisë. Vetëm në pikën 4 theksohet se, urdhrat dhe udhëzimet e prokurorit më të lartë janë të detyrueshme për prokurorin më të ulët dhe, në pikën 5, i jepet e drejta prokurorit më të lartë të vendosë ndryshimin ose shfuqizimin e vendimeve të marra nga prokurori më i ulët me ankim, ose kryesisht.

Duhet kuptuar drejt se cilësia e të pandehurit ruhet deri në përfundimin e procedimit penal, që do të thotë deri në momentin që merret vendimi i pushimit, i pafajësisë ose i dënimit të tij. Në rastet kur vendoset pushimi i procedimit apo i jepet pafajësi, personi rifiton të gjitha të drejtat dhe cilësia e tij si i pandehur rimerret vetëm në rastet kur shfuqizohet vendimi i prokurorit për pushimin e çështjes. Ndodhur para një vendimi për pushimin e procedimit penal në ngarkim të të pandehurit Gazment Hoxhallari, i pashfuqizuar nga prokurori, procedimi ndaj tij nuk mund të vazhdonte e, duke qenë se ky pretendim ka vazhduar, të gjitha aktet janë absolutisht të pavlefshme.

Të pavlefshme, ashtu siç rezulton dhe nga interpretimi literal i pjesës së dytë të nenit 128/1/b, janë dhe të gjitha aktet për përpilimin e të cilave nuk është respektuar e drejta e prokurorit për të marrë pjesë në procedimin penal.

Ky parashikim aktual ka krijuar jo pak herë diskutime në praktikë, sidomos në rastet kur seanca gjyqësore, pavarësisht arsyeve që mund të paraqiten, shtyhet me kërkesë të prokurorit. Disa juristë, përfshirë këtu dhe gjyqtarë, mendojnë se ky parashikim në respektim dhe të parimit të ekonomisë gjyqësore duhet të ndryshohet, duke e lënë më fakultative të drejtën e prokurorisë për të marrë pjesë e përfaqësuar akuzën në procesin gjyqësor.

Ky mendim i tyre lind jo vetëm nga parashikimet e Kodit të Procedurës Penale Italine, por gjithashtu nga fakti se prokurori i çështjes mundet lehtësisht të zëvendësohet me urdhër të titullarit të prokurorisë nga një prokuror tjetër, duke mos penguar në këtë mënyrë dhe zhvillimin normal të procesit gjyqësor. Në vlerësimin tonë, ky përcaktim është në përputhje të plotë me nenin 148 të Kushtetutës dhe nuk ka nevojë të ndryshohet, pasi legjislatori e ka parashikuar në mënyrë që organi i akuzës të jetë pazgjithshmërisht i lidhur me procesin penal. Në këtë formë, prokurori si përfaqësues i akuzës dhe shtetit është i detyruar jo vetëm të jetë prezent në çdo seancë gjyqësore, por edhe të mbajë qëndrim të shprehur lidhur me çështjet objekt-shqyrtimi gjyqësor nga ana e gjykatës.

Së fundmi, ashtu siç përmendëm më sipër në citimin e nenit 128/1 të Kodit të Procedurës Penale, ligjvënësi ka parashikuar pavlefshmërinë e akteve procedurale dhe në rastet kur nuk respektohen dispozitat për thirrjen e të pandehurit dhe praninë e mbrojtësit kur është e detyrueshme. Njoftimi i të pandehurit dhe garantimi i një mbrojtje efektive janë parime të cilat udhëheqin zhvillimin e procesit penal të sanksionuara në nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut. Në zbatim të këtij parimi, GJEDNJ-ja, në disa vendime (shih GJEDNJ 22

PROVAT DHE PROCESI I TË PROVUARIT NË PROCESIN PENAL

shtator 1994 Lala c/ Pays-Bas, 24.03.2005, Stoichkov c/Bulgarie)¹⁸⁵, ka theksuar se: *Prania e të pandehurit ka rëndësi të madhe për procesin penal të rregullt, ligjor dhe të drejtë, duke shtuar se detyrimi për t'i garantuar të akuzuarit të drejtën për të qenë i pranishëm...është një prej elementeve kryesor të nenit 6.*

Gjithashtu, gjykata e Strasburgut, në vendimin Ascitutto kundër Italisë¹⁸⁶, është shprehur se: *Gjykata kujton që prania e të pandehurit merr rëndësi kapitale në interes të një procesi penal të barabartë dhe të drejtë. Neni 6, i lexuar si një i tërë, i njeh pra të akuzuarit të drejtën për të marrë pjesë realisht në procesin e tij... Është e një rëndësie vendimtare për barazinë e sistemit penal që i akuzuari të mbrohet në mënyrë të përshtatshme si në shkallë të parë, ashtu dhe në apel.*

Respektimi i dispozitave për njoftimin dhe thirrjen e të pandehurit është trajtuar dhe nga Gjykata jonë Kushtetuese, e cila, duke e interpretuar si parim kushtetues në disa vendime të saj, ka krijuar një jurisprudencë të konsoliduar e detyrueshme për t'u zbatuar nga subjektet e procedimit penal. Kështu, në vendimin Nr. 13¹⁸⁷, datë 10.06.2005, është shprehur se:

Gjykata Kushtetuese ka arritur në përfundim se, Gjykata e Lartë, krahas parimeve të tjera, është e detyruar të respektojë kontradiktoritetin e barazinë e palëve në gjykim. Zbatimi i këtyre parimeve në gjykimin penal kërkon që i pandehuri, i mitur, nëpërmjet mbrojtësit të tij, të paraqitet e të dëgjohet njëllë si prokurori. Zbatimi me korrektësi i këtyre parimeve do të përjashtonte disavantazhin e një pale ndaj tjetrës. Në çështjen konkrete, nga Gjykata e Lartë, i ka shkelur parimet edhe pse shqyrtohej një rekurs që, nëpërmjet ndryshimit të vendimeve të shkallëve të tjera të gjyimit, rëndonte pozitën e të pandehurit të mitur.

Gjithashtu, në Vendimin 07¹⁸⁸, datë 19.02.2007, Gjykata Kushtetuese, është shprehur se: *Në vendimin nr. 24, datë 26.10.2005, kjo Gjykatë ka theksuar se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë nuk duhej ta zhvillonte gjykimin pa shqyrtuar dhe administruar shkaqet e mosparaqitjes së përfaqësuesit të të akuzuarit dhe pa i dhënë atij mundësi për të realizuar mbrojtjen ligjore. Gjykata Kushtetuese rithekson se, në aspektin e garantimit të procesit të rregullt ligjor, është detyrë e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, krijimi i kushteve dhe marrja e masave të nevojshme që seanca gjyqësore të zhvillohej në prani të avokatit, me qëllim që i gjykuari të mos preket nga pasojat e një procesi të zhvilluar pa pjesëmarrjen e avokatit të tij. Në këto rrethana, Gjykata Kushtetuese çmon se vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë është i papajtueshëm me Kushtetutën, pasi është rrjedhojë e një procesi të parregullt ligjor, ku kërkuesit i është shkelur e drejta e mbrojtjes. Kjo e drejtë, si një element i rëndësishëm i procesit të rregullt ligjor, është e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.*

Së fundmi, Gjykata Kushtetuese, në Vendimin 05¹⁸⁹, datë 04.03.2008, është shprehur se: *Gjykimi në Gjykatën e Lartë, në dallim nga procedurat strikte të gjyimit që*

¹⁸⁵ Vendim i GJEDNJ-së Lala c/ Pays-Bas, 24.03.2005, Stoichkov c/Bulgarie.

¹⁸⁶ Vendim i GJEDNJ-së, Ascitutto kundër Italisë.

¹⁸⁷ Vendimi Nr. 13, datë 10.06.2005, i Gjykatës Kushtetuese.

¹⁸⁸ Vendimi 07, datë 19.02.2007, Gjykata Kushtetuese.

¹⁸⁹ Vendimin 05, datë 04.03.2008, Gjykata Kushtetuese.

PROVAT DHE PROCESI I TË PROVUARIT NË PROCESIN PENAL

zhvillohen në gjykatat e zakonshme, ka si veçori paraqitjen vetëm të argumenteve ligjore. Komplexiteti i procedurave të gjykimit në Gjykatën e Lartë konfirmohet edhe nga dispozitat ligjore që sanksionojnë, se palët duhet të përfaqësohen në këtë gjykim nga avokati. Prandaj, shqyrtimi nga Gjykata e Lartë, kryesisht i çështjeve të ligjit, jo vetëm që e justifikon plotësisht përfaqësimin me avokat në seancat dëgjimore, por, për më tepër, bëhet i domosdoshëm për garantimin në favor të të pandehurit të një mbrojtjeje efektive dhe profesionale.

Nisur nga specifika e rastit në shqyrtim, kur çështja gjykohej mbi bazën e rekursit të paraqitur nga prokurori, i cili kishte kërkuar rëndimin e pozitës së të pandehurit dhe faktit që as i pandehuri dhe as avokati nuk ishin të pranishëm në gjykim, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë nuk duhej të zhvillonte gjykimin pa i dhënë mundësi palës së akuzuar për të realizuar mbrojtjen ligjore. Në aspektin e garantimit të procesit të rregullt ligjor, për Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë dilte e domosdoshme marrja e masave në mënyrë që të mos lejonte zhvillimin e seancës në mungesë të përfaqësuesit të interesave të të pandehurit, sepse ishte e vetmja mënyrë që i pandehuri, përmes figurës përfaqësuese të avokatit, të realizonte të drejtën për t'u mbrojtur.

E udhëhequr nga parashikimet e Kushtetutës, Konventës, Kodit të Procedurës Penale, por dhe të jurisprudencës së sipërcituar, Gjykata e Lartë ka konstatuar dhe më pas shpallur si absolutisht të pavlefshme aktet procedurale të përpiluara nga organi i akuzës, në të cilën nuk është respektuar e drejta e të pandehurit dhe mbrojtësit për t'u thirrur.

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë,¹⁹⁰ është shprehur se: Në nenet 140, 141, 142 të ligjit procedural parashikohet në mënyrë të detajuar se si realizohet njoftimi i akteve të të pandehurit të lirë apo edhe atij që është jashtë shtetit. Është detyrimi i gjykatës që të bëjë të mundur njoftimin e akteve të të pandehurit. Në lidhje me mënyrën e njoftimit, Gjykata Kushtetuese, në vendimin nr. 30, datë 17.06.2010, është shprehur se:

...Dispozitat procedurale për njoftimet vendosin një rend të caktuar për mënyrën e njoftimit të akteve për të pandehurin, prandaj duhet respektuar rendi sipas preferencës ligjore për këtë qëllim. Me këtë detyrim të organeve përkatëse shtetërore, për të njoftuar në mënyrë rigoroze të pandehurin dhe për të provuar se ai i fshihet drejtësisë, është e lidhur e drejta e tij për të marrë pjesë në gjykim, si dhe e drejta e gjykatës për të vendosur për gjykimin e tij në mungesë kur janë respektuar në mënyrë rigoroze dispozitat për njoftimin. Në bazë të akteve të ndodhura në dosjen gjyqësore, rezulton se, sekretaria e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nuk i ka njoftuar ankimin të pandehurit; ajo ia ka dorëzuar atë mbrojtësit të të pandehurit, i cili ka pasur tagra vetëm për ta mbrojtur në gjykimin në shkallë të parë. Pra, sekretaria e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nuk ia ka njoftuar aktin e ankimit të pandehurit, duke mos respektuar dispozitat për njoftimin, nenet 140, 141 e 142 të KPP-së.

Gjithashtu, në vendimin Nr. 125¹⁹¹, datë 15.07.2015, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë citohet se: *Në Kodin e Procedurës Penale është parashikuar gjykimi in absentia*

¹⁹⁰ Vendimin Nr. 85, datë 20.05.2015 Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë.

¹⁹¹ Vendimi Nr. 125, datë 15.07.2015, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

PROVAT DHE PROCESI I TË PROVUARIT NË PROCESIN PENAL

në bazë të garancive të forta procedurale. Për të përmbushur parametrat e një gjykimi të rregullt ligjor duhet të garantohet, para së gjithash, njoftimi rigoroz sipas rregullave procedurale penale i të pandehurit për procesin që po zhvillohet kundër tij. Gjykata, në bazë të zbatimit strikt të rregullave të njoftimit dhe, pasi të ketë verifikuar zbatimin e formave të njoftimit, mund të arrijë në konkluzionin se i pandehuri ka hequr dorë vullnetarisht nga pjesëmarrja në të dhe të vazhdojë gjykimin në mungesë. Mosrespektimi i rregullave të njoftimit sjell pavlefshmëri absolute të procesit dhe të vendimit përfundimtar në bazë të nenit 128/1, germa "c" të K. Pr. Penale dhe në pamundësi të riparimit të pasojës që shkakton kjo lloj pavlefshmërie sipas paragrafit të dytë të nenit të sipërcituar, çështja do të rigjykohet. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë konstaton se, nga ana e të dyja gjykatave, nuk janë mbajtur parasysh rregullat për njoftimin e të pandehurit në mungesë, Agim Rrapushi, të vendimit penal dhënë kundër tij në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier, të parashikuar nga neni 140 i Kodit të Procedurës Penale. Pasoja e mosmbajtjes parasysh të këtyre rregullave nga ana e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, dhe konkretisht sekretarisë së gjykatës, passjell dhënien e formës së prerë të këtij vendimi, duke cenuar të drejtën për ushtrimin e të drejtës së ankimit. Pavarësisht se formalisht nga ana e sekretarisë i është dhënë forma e prerë këtij vendimi, për shkak të pavlefshmërisë së njoftimit të vendimit, i gjykuari efektivisht nuk ka marrë dijeni dhe nuk është mundësuar për të ushtruar të drejtën e ankimit. Në bazë të akteve rezulton se, gjykata kishite detyrimin ligjor në bazë të nenit 140 të K. Pr. Penale, që të njoftonte të gjykuarin për të marrë dijeni mbi vendimin e rezultuar gjatë procesin penal të zhvilluar kundër tij. Në këtë rrethanë, njoftimi i vendimit duhet të bëhej sipas rregullave procedurale për të pandehurin në gjendje të lirë, sipas nenit 140 të Kodit të Procedurës Penale. Në referim të kësaj dispozite rezulton se, vendimi duhet t'i dorëzohet personalisht të pandehurit dhe, nëse kjo nuk është e mundur, atëherë ajo i dorëzohet personave që bashkëjetojnë me të ose në vendin e punës. Në rast se njoftimi nuk mund të realizohet në këtë mënyrë, atëherë procedohet me kërkimin në vende të tjera nëpërmjet policisë gjyqësore. Në rast se edhe në këtë mënyrë nuk është bërë i mundur njoftimi, siç përcakton kjo dispozitë në paragrafin e katërt, akti depozitohet në qendrën administrative të lagjes apo të fshatit ku i pandehuri banon ose punon. Vetëm pasi të jenë respektuar këto procedura, gjykata mund të procedojë me deklarinimin e mungesës së të pandehurit, duke i caktuar një mbrojtës kryesisht. Mosrespektimi i këtyre procedurave për njoftimin passjell pavlefshmërinë e njoftimit sipas nenit 143 të Kodit të Procedurës Penale dhe, për pasojë, kjo pavlefshmëri e konstatuar sjell si pasojë rivendosjen në afat të të gjykuarit në mungesë për të ushtruar të drejtën e tij të ankimit.

Me paraqitjen e përmbledhur të jurisprudencës së gjykatës evropiane edhe vendase, lidhur me rëndësinë e pranisë së të pandehurit në proces dhe të mbrojtjes së tij efektive, të garantuara nga neni 6 i konventës, i japim fund trajtimit të kapitullit të pavlefshmërisë absolute të akteve procedurale për të kaluar në temën e pavlefshmërisë relative dhe të ndikimit të rëndësisë së tyre në procesin tonë penal.

Neni 129 i Kodit të Procedurës Penale parashikon se:

PROVAT DHE PROCESI I TË PROVUARIT NË PROCESIN PENAL

1. *Pavlefshmëritë e ndryshme nga ato të parashikuara nga neni 128, mund të deklarohen mbi kërkesën e palëve.*
2. *Pavlefshmëria lidhur me aktet e hetimeve paraprake dhe me ato të kryera për sigurimin e provës duhet të kundërshtohet para se të fillojë shqyrtimi gjyqësor.*
3. *Pavlefshmëria e vërtetuar në gjykim mund të kundërshtohet bashkë me ankimin kundër vendimit përfundimtar.*
4. *Afatet për të ngritur ose për të kundërshtuar pavlefshmërinë nuk mund të zgjaten.*
5. *Kur pala është e pranishme, pavlefshmëria e një akti duhet të kundërshtohet para se ai të bëhet ose, kur kjo nuk është e mundur, menjëherë pasi është bërë.*

Ajo që është lehtësisht e konstatueshme në këtë dispozitë është fakti që ligjvënësi, në ndryshim nga pavlefshmëria absolute, nuk na jep një përkufizim dhe nuk parashikon rastet e akteve procedurale që veshen nga pavlefshmëria relative. Ne besojmë se ligjvënësi në këtë zgjedhje, i udhëhequr nga parimi i taksativitetit, ka parashikuar në mënyrë eksplicite në dispozitat e tjera të kodit rastet që prekin pavlefshmërinë relative. Nga analiza e këtyre dispozitave dhe nenit 129, konstatojmë se kjo kategori pavlefshmërie, sanksionon shkelje më pak të rëndësishme të aktit procedural penal sesa pavlefshmëritë e natyrës absolute. Kjo kategori e institutit të pavlefshmërisë, nuk u përgjigjet drejtpërsëdrejti kërkesave për të mbrojtur interesat që lidhen me parimet themelore të procesit penal, por nevojës për të sanksionuar shkelje të veçanta procedurale, të cilat mund të ndikojnë në dhënien e vendimit.

Ashtu siç parashikohet në nenin 129, paragrafi 1 dhe 2, pavlefshmëria relative ngrihet nga pala e interesuar, duke iu nënshtruar një regjimi që parashikon kufizime lidhur me çastin kohor të ngritjes dhe korrigjimit të tyre, në dallim nga pavlefshmëritë absolute, të cilat, siç u shprehëm më lart, mund të ngrihen dhe kryesisht, në çdo gjendje dhe shkallë të procedimit, që karakterizohen nga pakorrigjueshmëria e tyre. Kalimi i afatit për kundërshtimin e papërdorshmërisë përbën konvalidim të saj. Pra, akti relativisht i pavlefshëm që nuk kundërshtohet prodhon të gjitha efektet juridike të një akti të vlefshëm.

Përpos kësaj, konvalidimi i aktit mund të kryhet dhe në mënyrë të shprehur nga pala, e cila ka legjitimitetin për kundërshtimin e tij, si dhe në mënyrë automatike kur pala ka përfituar nga pasojat e aktit. Neni 130 i Kodit të Procedurës Penale parashikon se:

1. *Me përjashtim të rasteve të parashikuara ndryshe me ligj, pavlefshmëria nuk merret parasysh:*
 - a) *kur pala e interesuar ka hequr dorë shprehimisht nga kundërshtimi i saj ose ka pranuar pasojat e aktit;*
 - b) *kur pala ka përfituar nga e drejta për ushtrimin e së cilës akti i pavlefshëm është urdhëruar më parë.*
2. *Pavlefshmëria e lajmërimeve, komunikimeve dhe njoftimeve nuk merret parasysh në qoftë se pala e interesuar është paraqitur ose ka refuzuar të paraqitet.*
3. *Pala që deklaron se është paraqitur vetëm për të ngritur parregullsinë e aktit ka të drejtën e një afati jo më pak se tri ditë për t'u mbrojtur.*
4. *Gjatë hetimeve paraprake, çmuarja e pavlefshmërisë bëhet nga prokurori.*

PROVAT DHE PROCESI I TË PROVUARIT NË PROCESIN PENAL

Në ndryshim nga pavlefshmëria absolute, ligji lejon dhe konvalidimin e akteve procedurale relativisht të pavlefshme për shkak të rëndësisë së vogël të normës së shkelur e ndërthurur kjo dhe me parimin e ruajtjes sa të jetë e mundur të akteve procedurale ose asaj që quhet ndyshe ekonomi procesuale. Pra, konvalidimi i aktit relativisht të pavlefshëm është një fakt juridik, i cili pason kryerjen e aktit, i cili mundëson që akti procedural të sjellë pasojat të cilat synon, si një akt procedural i vlefshëm.

Interesante për diskutim për këtë çështje është kërkesa e Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda drejtuar Gjykatës Kushtetuese, me objekt shfuqizimin e paragrafit të dytë dhe të katërt të nenit 129. Sipas Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda, dispozita e lartpërmendur, duke përcaktuar se kërkesat për deklarimin e pavlefshmërisë relative të akteve të hetimit paraprak duhen ngritur brenda afatit, që nuk mund të zgjatet “para se të fillojë shqyrtimi gjyqësor”, rezultojnë kontradiktore për sa i përket të drejtës së palëve pjesëmarrëse në procedimin penal, për të kundërshtuar vlefshmërinë relative të atyre akteve të hetimit paraprak që jo domosdoshmërisht janë pjesë e dosjes së gjykimit, të tilla si procesverbalet e mbajtura nga Policia Gjyqësore kur merr të dhëna nga personat që mund të tregojnë rrethana të dobishme për qëllimet e hetimit sipas nenit 297 të KPP-së.

Kjo për arsyen se, duke qenë se në momentin “para se të fillojë shqyrtimi gjyqësor”, këto akte nuk mund të jenë në disponibilitet të gjykatës, ato nuk mund të vlerësohen prej saj.

Sipas Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda, për shkak të parashikimit të afatit prekluziv (për të vlerësuar pavlefshmërinë relative të akteve të hetimit paraprak), nga paragrafi i katërt i nenit 129 të KPP-së, vlerësimi i gjykatës mbi aktet e hetimit paraprak që jo domosdoshmërisht janë pjesë e dosjes së gjykimit, shmanget në mënyrë përfundimtare duke shkaktuar një dëm të pariparueshëm të interesave të palëve, kryesisht të të drejtës së mbrojtjes së të pandehurit. Për këto arsye, Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda ka theksuar se parashikimet e nenit 129, paragrafi i dytë dhe i katërt i KPP-së, cenojnë të drejtën e të pandehurit për një proces të rregullt ligjor.

Gjykata Kushtetuese, me vendimin Nr. 6,¹⁹² datë 16.01.2012, ka shprehur se: *Nuk është ndalur të trajtojë pretendimet e Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda, por është njaftuar vetëm me parashikimet e nenit 68 të ligjit nr. 8577¹⁹³, datë 10.02.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, për të mos pranuar kërkesën për shfuqizimin e paragrafeve të dispozitës. Sipas nenit 68 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, gjykata apo gjyqtari është i detyruar, kur çmon se ligji është antikushtetues, të argumentojë para Gjykatës Kushtetuese ekzistencën e lidhjes së drejtperdrejtë midis ligjit dhe zgjidhjes së çështjes konkrete. Gjykata Kushtetuese ka vërejtur se gjykata referuese, në rastin objekt shqyrtimi, nga pikëpamja juridiko-formale nuk ka argumentuar në lidhje me ekzistencën e lidhjes së drejtperdrejtë ndërmjet normës së shqyrtuar dhe zgjidhjes së çështjes konkrete. Kolegji ka mbajtur qëndrimin se kërkuesi nuk ka arsyetuar pse*

¹⁹² Vendimi Nr. 6, datë 16.01.2012, Gjykata Kushtetuese.

¹⁹³ Ligji nr. 8577, datë 10.02.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”.

vlerësimi i gjykatës mbi pavlefshmërinë e akteve të hetimit paraprak, që nuk janë pjesë e fashikullit të gjykimit, ka cenuar të drejtën e mbrojtjes së të pandehurit e për pasojë të drejtën e tij për një proces të rregullt ligjor. Për pasojë, Gjykata Kushtetuese ka çmuar se dispozita e kundërshtuar si antikushtetuese nuk e pengon gjykatën referuese, që në zbatim të kompetencave dhe attributeve të saj, nëpërmjet interpretimit dhe zbatimit të normave procedurale penale përkatëse, të marrë një vendim për zgjidhjen e çështjes. Do të kishte qenë interesante qëndrimi që do të kishte mbajtur Gjykata Kushtetuese, nëse nuk do të ishte ndalur në analizimin e mosekzistencës së lidhjes ndërmjet dispozitës që kërkohet të shfuqizohet dhe zgjidhjes së çështjes, por t'i kishte analizuar në themel pretendimet e Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda.

Në vlerësimin tonë, dispozita nuk është antikushtetuese, dhe ashtu siç jemi shprehur e më sipër, momenti i ngritjes së pavlefshmërisë relative lidhet me rëndësinë e vogël të dispozitës së shkelur e ndërthurur kjo dhe me parimin e ruajtjes sa të jetë e mundur të akteve procedurale ose asaj që quhet ndyshe ekonomi procesuale.

Në rastin objekt diskutimi, problemi juridik nuk qëndron në kushtueshmërinë e normës juridike, por qëndron në zgjidhjen juridike që i kanë dhënë gjykatat e juridiksionit të zakonshëm zgjidhjes së çështjes.

Ne vlerësojmë se vendimi i ndërmjetëm që nuk i deklaron relativisht të pavlefshme procesverbalet e marrjes në pyetje me pretendimin se nuk janë pjesë e fashikullit gjyqësor, është haptazi i gabuar. Neni 331/c i Kodit të Procedurës Penale parashikon se kërkesa për gjykim e procedimin penal përmban dhe burimet e provës dhe faktet që ato u referohen. Gjithashtu, neni 332 që përcakton fashikullin e gjykimit, parashikon se kërkesës së prokurorit për gjykimin e çështjes si pjesë përbërëse e fashikullit gjyqësor, i bashkohen dhe një sërë aktesh të tjera të parashikuara nga dispozita. Nga interpretimi i kombinuar i këtyre dy dispozitave, procesverbalet e marrjes në pyetje të personave që kanë dijeni për veprën penale janë pjesë e fashikullit gjyqësor, pasi jo vetëm janë mjete të provës që çojnë njoftimet e rrethanave të faktit nga burimi në gjykatë, por kanë dhe funksionin procedural të parashikuar nga neni 362 i Kodit të Procedurës Penale.

Temë tjetër që ka ngjallur shumë diskutime në praktikë është interpretimi i nenit 131/2 të Kodit të Procedurës Penale. Pra, rasti i shpalljes së pavlefshmërisë relative dhe detyra që i lind gjykatës të urdhërojë rinovimin e aktit. Në vlerësimin tonë, ashtu siç jemi shprehur dhe në rastin e konstatimit të papërdorshmërisë së provave, urdhërimi i ribërjes së akteve nuk është një proces detyrues dhe automatik për gjykatën, por udhëhiqet nga nevoja që ka procesi për ribërjen e aktit dhe nga kompetenca që ka kjo e fundit në urdhërimin e ribërjes së aktit.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë, në vendimin Nr. 147¹⁹⁴, datë 01.04.2015, ndër të tjera është shprehur se, *me vendim të ndërmjetëm, ka autorizuar Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnjë, të ribëjë aktet dhe të zëvendësojë aktet procedurale në ngarkim të të pandehurit Armand (Altin) Saraçi. Ky qëndrim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, lënë në fuqi me Vendimin Nr.365, datë 02.07.2015,*¹⁹⁵ të

¹⁹⁴Vendimi Nr. 147, datë 01.04.2015, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë

¹⁹⁵ Vendimi Nr.365, datë 02.07.2015, të Gjykatës së Apelit Vlorë.

PROVAT DHE PROCESI I TË PROVUARIT NË PROCESIN PENAL

Gjykatës së Apelit Vlorë, në vlerësimin tonë është i gabuar, pasi në këtë rast, gjykata ka urdhëruar ribërjen e akteve për të cilat nuk ka kompetencë të disponojë.

Në Vendimin Nr.05¹⁹⁶, datë 12.12.2008, Gjykata e Lartë është shprehur se: *Për sa i përket pavlefshmërisë relative, si e tillë, sipas përmbajtjes së pikës 2 të dispozitës së nenit 129 të Kodit të Procedurës Penale, është edhe pavlefshmëria e akteve që përpilohen nga subjektet e procedimit penal gjatë hetimeve paraprake, sikundër janë edhe fletëthirrja datë 24.11.2008 për t'u njohur me akuzën, Akti datë 27.11.2008 i dërgimit të aktit të akuzës, ftesa datë 04.12.2008, vendimi datë 02.12.2008 për njoftimin me telefon të avokatit për t'u njohur me aktet e procedimit penal dhe ftesa datë 04.12.2008, për t'u njohur me aktet e procedimit penal (që i përkasin të pandehurit), si dhe vendimi për dërgimin e çështjes në gjyq e kërkesa për gjykim të datës 05.12.2008, që u përkasin të dy këtyre personave. Këto akte u deklaruan të pavlefshme që në fillim ose u bënë më pas të pavlefshme me vendimet gjyqësore që u përmendën më lart, për shkak të disponimeve për pavlefshmëri të veprimeve procedurale të mëpasme, parashikuar prej tyre, pavlefshmëri këto të cilat nuk mund të riparohen nga ky Kolegj, sikundër do të argumentohet më poshtë, veç të tjerave, edhe për shkak të vetë sistemit procedural që është pranuar nga ligjvënësi shqiptar, me miratimin e Kodit të Procedurës Penale në fuqi. Këto janë pikërisht shkaqet për të cilat ky Kolegj nuk mund të fillojë shqyrtimin e akuzave që përmban kërkesa për gjykim, tashmë e pavlefshme. Ky Kolegj sjell në vëmendje se, sipas nenit 42/1 të Kushtetutës, veç lirisë dhe pronës, edhe të drejtat e tjera të njohura me Kushtetutë dhe me ligj nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor. Për rrjedhojë, në përfundim, ky Kolegj vë në dukje se: Mangësitë e konstatuara në procedimin penal ndaj personit nën hetim - Lulzim dhe të pandehurit - gjatë fazës së hetimeve paraprake, tregojnë në fakt për një proces jo të rregullt ligjor, të kryer nga Prokuroria e Përgjithshme, proces ky, i cili vuri në lëvizje Gjykatën e Lartë në mënyrë formale dhe që përbën një formë të "aktivizmit gjyqësor". Kështu, duke i deklaruar të pavlefshme aktet procedurale të hartuara nga prokurori në mbështetje të nenit 387/1 të Kodit të Procedurës Penale, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, ka vendosur pushimin e çështjes me arsyetimin që procedimi nuk mund të vazhdojë. Në këndvështrimin tonë, një zgjidhje e tillë është e imponuar nga një mangësi shumë domethënëse që paraqet Kodi i Procedurës Penale në këtë pjesë, pasi ky i fundit nuk i jep një zgjidhje rastit të mësipërm, duke lënë vetëm mundësinë e pushimit të çështjes, zgjidhje e cila është më radikale se ç'duhet. Sipas nesh, zgjidhja më logjike do të ishte kthimi i akteve prokurorit.*

Në këtë logjikë, në varësi të shkallës apo intensitetit të shkeljes së të drejtave të njeriut në procesin e marrjes së provës apo pavlefshmërisë së aktit procedural, ndryshojnë edhe pasojat në drejtim të provave që gjenden në përmbajtjen e aktit. Pavlefshmëria godet vetë aktin procedural.

Fakti që gjykata konstaton se akti është i pavlefshëm, pavlefshmëri e natyrës relative, kjo nuk sjell papërdorshmërinë e provës materiale të marrë si mjet për kërkimin e provës, rezultati i tij është prova materiale në kuptim të Nenit 187 të K. Pr. Penale.

¹⁹⁶Vendimi Nr.05, datë 12.12.2008, Gjykata e Lartë.

PROVAT DHE PROCESI I TË PROVUARIT NË PROCESIN PENAL

Megjithatë, kjo duhet të kryhet me një ndryshim ligjor, pasi me legjislacionin aktual në procesin penal, rastet e vetme kur gjyqtari i kthen aktet prokurorit janë në kushtet e nenit 374 dhe 377 të K. Pr. P. Ndërkohë që kthimi i akteve për shkak të pavlefshmërisë nuk është element i huaj për procesin tonë penal. Po t'i referohemi nenit 442 të K. Pr. P në rastet kur pavlefshmëria e akteve ngrihet në Gjykatën e Lartë, kjo e fundit prish vendimin e rekursuar dhe nuk e kthen çështjen për rigjykim, por ia kthen aktet prokurorit, të cilit i takon të konkludojë lidhur me procedimin e mëtejshëm. Sipas mendimit tonë nuk ka arsye që i njëjti disiplinim të mos veprojë edhe për gjykimin në shkallë të parë, kjo dhe për vetë *non sensin* që krijohet, pasi për të njëjtat kushte kemi dy disponime të ndryshme.

Pra, ndërsa për shkak të pavlefshmërisë të një akti procedural të akuzës Gjykata e Shkallës së Parë pushon çështjen, për të njëjtin shkak (shkak që, ndërkohë, ka sjellë dhe pavlefshmëri të vendimit) Gjykata e Lartë nuk e pushon, por ja kthen aktet prokurorit. Po t'i referohemi dhe procesit penal italian, në këtë të fundit vepron ai që quhet parimi i regresit. Fjala vjen, në rastin kur gjyqtari i seancës përgatitore (G.U.P) konstaton pavlefshmëri të akteve të prokurorit, si p.sh. kërkesës për gjykim, ai deklaron nulitetin dhe ja kthen aktet këtij të fundit, kjo në bazë të nenit 185/c të K. Pr. P italiane.

Në të kundërt, praktika e gjykatave shqiptare, e diktuar nga një mangësi e ligjit, në një rast të tillë vendos pushimin e çështjes duke goditur kështu në mënyrë definitive një procedim penal.

❖ Në një analizë të shkurtër, për analogji, koncepti i provës nuk gjen zbatim vetëm në legjislacionin penal, por edhe atë civil, në mënyrë që t'i mundësojë gjykatës që të bëjë vlerësimin ligjor të fakteve.

Ashtu sikurse KPP-ja, për realizimin e këtij qëllimi, K. Pr. C¹⁹⁷ ofron provën si një mjet provues, e cila sjell të dhëna për ekzistencën ose mosekzistencën e fakteve. K. Pr. C nuk lë hapësirë për debate në lidhje me kuptimin e provës, pasi jep vetë një përkufizim të tillë. Kështu, në dispozitën e 11-të¹⁹⁸ të tij përcaktohet që: "Provat janë të dhëna që merren prej burimeve dhe sipas rregullave të parashikuara në këtë Kod dhe ligje të tjera, të cilat vërtetojnë ose rrëzojnë pretendimet ose prapësimet e palëve ose pjesëmarrësve në proces".

Sipas këtij përkufizimi si dhe nenit 12 të KPC-së, palët që pretendojnë një të drejtë, kanë detyrimin që këto pretendime t'i provojnë me fakte në përputhje me ligjin.

Teoria e çmuarjes së lirë të provave ka gjetur pasqyrim në nenin 29¹⁹⁹ të K. Pr. C, i cili përcakton se: "Gjykata e mbështet vendimin në provat e paraqitura nga palët ose nga prokurori të marra në seancë gjyqësore. Gjykata çmon provat që ndodhen në aktet në bazë të bindjes së brendshme, të formuara nga shqyrtimi në tërësinë e tyre e rrethanave të çështjes".

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë në vendimin nr.34, datë .19.02.2009,²⁰⁰ ka cituar se në gjykimin civil debatohet edhe nëse prova duhet të lejohet t'i nënshtrohen

¹⁹⁷Kodi i Procedurës Civile.

¹⁹⁸Kodi i Procedurës Civile, i ndryshuar me ligjin 35/2017, neni 11.

¹⁹⁹ Kodi i Procedurës Civile, neni 29.

²⁰⁰ Vendim nr. 34, datë 19.02.2009, i Gjykatës së Lartë.

PROVAT DHE PROCESI I TË PROVUARIT NË PROCESIN PENAL

procesit të të provuarit në kuptimin që janë ose jo të domosdoshme e të lidhura me çështjen e gjykimit (neni 213). Në këtë kuptim, gjykata kujdeset në aspektin procedural, në varësi të llojit të provës, edhe për marrjen e tyre në formën e kërkuar nga ligji, pra që të respektohen procedurat lidhur me formën dhe mënyrën e paraqitjes, të administrimit e debatimit rreth provës.

Por, në ndryshim nga procedura penale dhe ajo civile, në të drejtën administrative, ligjvënësi barrën e provës ia ka deleguar organit publik.

Ky detyrim është sanksionuar në mënyrë taksative në nenin 35 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” - ndryshuar me ligjin 39-2017 sipas të cilit:

Organi publik ka detyrimin të provojë ligjshmërinë e aktit administrativ, kontratës administrative dhe të veprimit tjetër administrativ, të nxjerrë jo me kërkesë të paditësit, si dhe faktet që ai ka parashtruar dhe ka vënë në themel të veprimtarisë së kundërshtuar në gjykatë.

Sipas dispozitave të këtij ligji,²⁰¹ paditësi, përveç aktit administrativ që kundërshton, nuk ka detyrim t’i bashkëlidhë padisë akte provuese. Paraqitja e provave duhet të bëhet, në çdo rast, përpara seancës së parë gjyqësore. Në rast se organi publik nuk i paraqet provat deri në datën e seancës gjyqësore, atëherë gjykata, duke vlerësuar provat e tjera dhe rrethanat e çështjes, mund të konsiderojë të provuar faktet e pretenduara nga pala tjetër, për provimin e të cilave janë kërkuar këto prova.

Konkluzioni përfundimtar është se vlerësimi i probabilitetit se diçka është e vërtetë, duhet të jetë i bazuar në fakte të njohura. Procesi i mbledhjes së provave krijon një rrjetë me prova dhe konkluzione përfundimtare, që demonstrojnë fajësinë ose përgjegjësinë e subjektit të veprës penale, të cilat, po të shqyrtohen në mënyrë logjike, rezultojnë në një vendimmarrje të drejtë nga ana e gjykatës.

2.4. OBJEKT I TË PROVUARIT NË PROCESIN PENAL – (THEMA PROBANDI)

Neni 150 i K. Pr. Penale parashikon se: *Janë objekt prove faktet që kanë lidhje me akuzën, fajësinë e të pandehurit, caktimin e masave të sigurimit, dënimin dhe përgjegjësinë civile, si dhe faktet nga të cilat varet zbatimi i normave procedurale.*

*Me objekt i të provuarit kuptojmë tërësinë e fakteve që duhet të vërtetohen për zgjidhjen e drejtë të çështjes penale.*²⁰²Në përcaktimin e këtij objekti, rol të veçantë luan gjykata, pasi ajo përcakton rëndësinë dhe ligjshmërinë e provave të paraqitura.

Nëpërmjet procesi i të provuarit, palët procedurale pjesëmarrëse në një gjykim duhet të vërtetojnë të dhënat duke analizuar prova të ndryshme. Që një fakt të ketë vlerë provuese duhet të ekzistojë lidhja e tij me çështjen.

Së pari: Nëpërmjet rezultateve të provave të marra në proces, gjykatësi rindërton rrethanat e faktit juridik-penal në kohë dhe në hapësirë. Fakti juridik i veprës penale ka

²⁰¹ Neni 21 i ligjit nr. 49/2012 “Për Gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.

²⁰² Procedura penale, Halim Islami, Artan Hoxha, Ilir Panda, botim 2010, fq. 200.

ndodhur në të kaluarën dhe ka të bëjë sigurisht me një fakt të papërsëritshëm (*lost fact*), që mund të njihet vetëm nëpërmjet gjurmëve të lëna në botën e jashtme ose në kujtesën e njerëzve. Duke përdorur instrumentet që konsistojnë në prova të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale, nga këto gjurmë (elemente të provës), gjykata përfton ekzistencën e faktit të së kaluarës.

Së dyti: Objekt i të provuarit në të drejtën procedurale penale janë dhe të gjitha ato njoftime mbi fakte dhe rrethana që vërtetojnë autorësinë e kryerjes së veprës penale, qëllimi dhe motivi i veprës së kryer prej tij.

Faktet e paraqitura para gjykatës, që të jenë në gjendje për të përcaktuar fajësinë e subjektit, duhet që, si nga pikëpamja e formimit të saj, ashtu dhe nga pikëpamja e fuqisë provuese të jetë e saktë dhe bindëse, jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm. Në të kundërt, fuqia e saj provuese mund të konsiderohet përcaktuese vetëm kur ekzistojnë prova dhe rrethana të tjera që shkojnë në të njëjtin drejtim.

Ky konkluzion juridik dhe logjik i këtij procesi rezulton të jetë mishëruar dhe shprehur qartë me ndryshimet e reja të Kodit të Procedurës Penale në nenin 4/2 të tij, ku parashikohet shprehimisht se: *Gjykata jep vendim fajësie kur i pandehuri rezulton fajtor për faktin penal që i atribuohet përtej çdo dyshimi të arsyeshëm.*

GJEDNJ-ja, në jurisprudencën e saj argumenton se nuk mjafton vetëm ekzistenca e një dyshimi të arsyeshëm, por ky dyshim duhet të jetë i provuar në fakte dhe prova.

Sipas saj: *Gjykata duhet ta bazojë arrestimin në fazën e parë të hetimit penal të paktën mbi një nivel të caktuar faktesh ose informacioni për të vërtetuar se është*

*kryer një vepër penale dhe se i ndaluar ka lidhje të mjaftueshme me kryerjen e saj.*²⁰³

Ky standard i vendosur nga GJEDNJ-ja, ka gjetur zbatim dhe në praktikën tonë gjyqësore. Sipas vendimit nr.3, dt.03.01.2002, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë: ... *Për caktimin e masave të sigurimit personal, përfshirë dhe atë të arrestit në burg, duhet që në ngarkim të personit ndaj të cilit kërkohet të merret kjo masë, të ekzistojë jo çfarëdolloj dyshimi, por një dyshim i arsyeshëm, dhe i bazuar në provat që janë administruar në fashikullin e procedimit penal në formën e kërkuar nga ligji deri në momentin e dhënies së vendimit.*²⁰⁴

Dispozitën ligjore, gjykata e zbaton në bazë të analizës së fakteve që ka konstatuar. Nga këto fakte të rëndësishme, objekt prove janë vetëm faktet kontestuese midis palëve. Një rast të tillë do të kishim kur njëra palë pretendon ekzistencën e një fakti, ndërsa pala tjetër e mohon ekzistencën e tij. Faktet që nuk janë kontestuese si rregull nuk përbëjnë objekt prove dhe, si rrjedhojë, nuk kanë nevojë të provohen. Qenia e tyre konstatohet me anë të disponibilitetit të palëve.

*Dyshimi i arsyeshëm përfshin dhe rastet kur personi ka gjasa të kryejë një tjetër vepër penale apo deklarata që i janë bërë të tjerëve se i dyshuari ka për qëllim të vazhdojë të kryejë krime të tjera ose kërcënime ndaj dëshmitarëve.*²⁰⁵

Sipas të drejtës procedurale penale është krijuar një qëndrim, edhe pse jo i unifikuar, që tashmë është kthyer në një parashikim ligjor për gjykatën, të cilin e ka mbajtur në

²⁰³ Vendim i GJEDNJ-së, Murray kundër Mbretërisë së Bashkuar.

²⁰⁴ Vendimi nr.3, dt.03.01.2002, i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

²⁰⁵ Jon Smibert, J. D., LL. M. (Lond.) <http://www.brrln.org/uploads/documents/219/alb.pdf>

PROVAT DHE PROCESI I TË PROVUARIT NË PROCESIN PENAL

vite sistemi gjyqësor kur ka vlerësuar se një provë e vetme nuk mundet të mjaftojë për të vërtetuar në mënyrë të pakontestueshme autorësinë e veprës penale, qoftë kjo dhe provë shkencore.

Në vendimin nr. 135, dt 19.03.2003, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka mbajtur qëndrimin se: *Do të ishte gabim për çdo gjykatë dhe aq më tepër për Gjykatën e Lartë që të pranonte dhe të deklaronte fajtor një person vetëm me deklaratimet e të dëmtuarit, të paharmonizuara edhe me provat e tjera. Pranimi i kundërt do t'i hapte rrugë arbitrarishtet me pasojë shkeljen e të drejtave të individit në procesin penal dhe të vuajnë një dënim të padrejtë.*²⁰⁶

Madje, në zhvillimin e këtij konkluzioni, praktika gjyqësore ka elaboruar një koncept juridik të tillë interesant siç është koncepti i të ashtuquajturës *Drejtësia sasiore*, që lidhet me analizën përfundimtare të provave në favor dhe kundër akuzës, që bëjnë të mundur edhe vendimin përfundimtar të gjykatës, pra bindjes së saj në lidhje me faktin penal dhe personin, ose personat që e kanë kryer atë.

Tashmë ligjvënësi në elementet e hartimit të një vendimi gjyqësor ka përcaktuar qartë edhe detyrimin se nga gjykata duhet të përshkruhen provat pro dhe kundër akuzës së ngritur ndaj të pandehurit dhe jo vetëm ato që kanë lidhje me fajësinë (Neni 383/1 germa “ç” e K. Pr. Penale, ku parashikohet se: *Parashtrimin e përmbledhur të rrethanave të faktit dhe provat mbi të cilat bazohet vendimi, si dhe arsyet për të cilat gjykata i quan të papranueshme provat e kundërta.*)

Po përmendim në mënyrë ilustruese disa nga vendimet e mëparshme të praktikës gjyqësore në lidhje me këtë fakt që solli edhe nevojën e ndryshimeve ligjore të lartpërmendura.

Më konkretisht, në vendimin Nr.876²⁰⁷, datë 21.12.2005, Gjykata e Lartë, ndër të tjera, është shprehur se: *Problemi i të provuarit të akuzës është themelori për çdo proces dhe kjo kërkon një analizë të plotë e të gjithanshme të provave që paraqiten gjatë shqyrtimit gjyqësor, duke mënjimuar mbivlerësimin e çdo prove, gjë që do të dëmtonte procesin gjyqësor. Nuk mund të pranohet fajësia e një personi të akuzuar për kryerjen e një veprë penale vetëm me një provë çfarëdo qoftë ajo edhe nëse është shkencore (sikurse është vepruar me provën e gjurmës së gishtit të të gjykuarit Kujtim Bashkurti), nëse nuk ka prova të tjera që e shoqërojnë atë. Nuk mund të ketë për gjykatën asnjë provë me vlera të paracaktuara e që ta mbështesë vendimin e fajësisë apo pafajësisë vetëm me një provë, pa u harmonizuar ajo me prova të tjera.*

Në Vendimin tjetër të saj nr. 291²⁰⁸, datë 15.03.2007, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, thuhet: *... një provë e vetme e pashoqëruar me prova të tjera apo indicie, nuk mund të shërbejë në arritjen e përfundimit, për fajësinë e të pandehurit.*

Gjithashtu, në Vendimin nr. 218²⁰⁹, datë 14.05.2008, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, thuhet: *...në zbatim të kërkesave të nenit 152 të K. Pr. Penal për të mos i dhënë vlerë të paracaktuar aktit të ri të ekspertimit daktiloskopik si provë, konkluzionet e*

²⁰⁶Vendimi nr. 135, dt. 19.03.2003, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë.

²⁰⁷ Vendimi Nr.876, datë 21.12.2005, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

²⁰⁸ Vendimi Nr.291, datë 15.03.2007, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

²⁰⁹ Vendimi Nr.218, datë 14.05.2008, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

PROVAT DHE PROCESI I TË PROVUARIT NË PROCESIN PENAL

pasqyruara në të duhet t'i nënshtrihen shqyrtimit nga gjykata, në tërësi me të gjitha provat e tjera. Gjatë çmimit të saj si provë, gjurma e gjetur duhet të vlerësohet në raport si me konkluzionet teknike dhe me mekanizmin e mundshëm të lënies së saj.

Të njëjtin qëndrim ka mbajtur dhe Gjykata e Apelit Tiranë, e cila, në Vendimin Nr. 1334,²¹⁰ datë 21.12.2012, ka vlerësuar se:

Në këto rrethana gjendemi në situatën se Prokuroria ka në favor të saj vetëm indicie, të cilat lidhen në mënyrë shumë të dyshimtë me të pandehurit. Për pasojë, këto indicie nuk janë të sakta dhe bazuar në nenin 152/2 të K. Pr. Penale, nuk mund të vlejnjë për të vërtetuar ekzistencën e faktit të pretenduar nga Prokuroria.

Gjykata e Apelit thekson se këto indicie, të palidhura qoftë edhe me një provë direkte apo edhe mes tyre, nuk mund të shërbejnë për të deklaruar fajtorë e më pas për të dënuar të pandehurit Sajmir Lama dhe Elidon Kotorri, për kryerjen e veprave penale të parashikuara nga nenet 140- 25 të Kodit Penal.

Siç u theksua edhe më sipër, është tashmë një qëndrim i konsoliduar i Gjykatës Kushtetuese, Gjykatës së Lartë të RSH-së dhe GJEDNJ-së, se askush nuk mund të deklarohet fajtor me një provë të vetme, qoftë kjo provë edhe shkencore; apo me indicie të palidhura me prova direkte; apo me prova që janë marrë në kundërshtim me ligjin. Ky është një qëndrim gjerësisht i pranuar dhe i konsoliduar ndër vite nga praktika kushtetuese dhe ajo gjyqësore shqiptare.

Nga analizimi i vendimeve të sipërpërmendura, pyetja që me të drejtë shtrohet për diskutim është nëse jemi përpara një prove të vetme dhe në rastet kur nga i njëjti burim prove sigurohen disa njoftime mbi rrethana të faktit juridik penal.

Për shembull, oficeri i policisë gjatë shërbimit arreston në flagrancë një person që është duke kryer një vjedhje. Gjatë gjykimit në cilësinë e provës nga ana e gjykatës janë administruar urdhëri i shërbimit të oficerit të policisë, raporti i shërbimit të përpiluar prej tij, procesverbali i arrestimit në flagrancë dhe deklarimet e dhëna të oficerit gjatë gjykimit. Në këtë rast, gjykata ka administruar një provë të vetme apo disa?

Për këtë rast, këndvështrimet e studiuesve të së Drejtës Procedurale Penale janë të ndryshme. Sipas mendimit tim, gjykata ka administruar vetëm një provë, pasi të gjitha njoftimet janë siguruar nga i njëjti burim prove dhe referuar jurisprudencës së gjykatave të sipërcituar, personi nuk mund të deklarohet fajtor.

Së treti, objekt i provuarit janë dhe të gjitha ato rrethana dhe fakte që ndikojnë në përcaktimin e masës së dënimit në raport me pasojat që kanë ardhur nga kryerja e veprës penale.

Vërtetimi i këtyre rrethanave është i domosdoshëm në caktimin e një mase vendimi sa më të drejtë në vendim. Neni 47²¹¹ i K. Penal ka përcaktuar se: *Gjykata cakton dënimin duke respektuar dispozitat e pjesës së përgjithshme të këtij Kodi dhe kufijtë e dënimeve të parashikuara në ligj për veprën penale. Në caktimin e dënimit ndaj personit, ajo merr parasysh rrezikshmërinë e veprës penale të autorit të saj, shkallën e fajit, si dhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese.*

²¹⁰Vendimi Nr.1334, datë 21.12.2012 i Gjykatës së Apelit, Tiranë.

²¹¹Kodi Penal, neni 47.

PROVAT DHE PROCESI I TË PROVUARIT NË PROCESIN PENAL

Në interpretim të dispozitës së mësipërme, gjykata, në caktimin e masës së dënimit, merr parasysh rrezikshmërinë shoqërore të veprës së të pandehurit, shkallën e fajësisë, si dhe rrethanat lehtësuese e rënduese që kanë konkurruar në rastin objekt gjykimi.

Në këtë rast, gjykata, në caktimin e dënimit, bazohet pikërisht në njoftimet që këto prova japin dhe që lidhen me objektin e të provuarit.

Kështu, në vendimin Nr.190²¹², datë 05.06.2013, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë është shprehur se: *Në lidhje me pretendimet e prokurorit në rekurs për masën e dënimit, ky kolegji vlerëson se ato janë të pabazuara në ligj. Por Kolegji Penal çmon se duhet analizuar ekzistenca e të gjitha rrethanave që i kanë shërbyer të dyja gjykatave në caktimin e masës së dënimit. Në lidhje me caktimin e masës së dënimit, neni 47 i K. Penal parashikon se: “Gjykata cakton dënimin duke respektuar dispozitat e pjesës së përgjithshme të këtij Kodi dhe kufijtë e dënimeve të parashikuar në ligj për veprën penale. Në caktimin e dënimit ndaj personit, ajo merr parasysh rrezikshmërinë e veprës penale të autorit të saj, shkallën e fajit, si dhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese”. Kolegji Penal çmon të marrë në analizë kriteret e sanksionuara në nenin 47 të K. Penal, si më poshtë:*

- rrezikshmërinë e veprës penale, e cila paraqet një rrezikshmëri të lartë shoqërore, duke u nisur nga sanksioni që parashikon dispozita përkatëse (neni 141 i K. Penal), i cili është nga pesëmbëdhjetë gjer në njëzet e pesë vjet burgim ose burgim i përjetshëm. Por rezulton se në kohën e kryerjes së veprës penale i gjykuari ka qenë i mitur dhe sipas nenit 51 të Kodit Penal dënimi i tij nuk mund të jetë më shumë se gjysma e dënimit që parashikon dispozita përkatëse;

- rrezikshmërinë shoqërore të autorit të veprës penale, si personalitetin e të gjykuarit, i cili është i padënuar më parë;

- shkallën e fajit, pasi vepra penale është kryer me dashje direkte, pasi i gjykuari ka parashikuar ardhjen e pasojës, e ka dëshiruar atë dhe me ndërjegje e ka lejuar;

- për sa i takon rrethanave lehtësuese, ky kolegji çmon se ekziston një nga rrethanat e parashikuara nga neni 48, pika “ç” i K. Penal, pasi i gjykuari ka treguar hollësisht mekanizmin e ngjarjes, është treguar i penduar dhe këtë qëndrim e ka mbajtur si gjatë hetimeve paraprake, ashtu edhe në gjykim. Këto rrethana janë të tilla, që justifikojnë masën e dënimit e caktuar nga Gjykata e Apelit Vlorë.

Shembull tjetër nga praktika gjyqësore është Vendimi Nr.90²¹³, datë 13.03.2013, ku është parashikuar se: *Kolegji Penal vëren se legjislacioni ynë penal ka parashikuar kriteret konkrete për sa i përket caktimit të masës së dënimit nga gjykata. Kolegji Penal çmon se ligjvënësi, gjatë hartimit të dispozitave ligjore të Kodit Penal, ka parashikuar dy lloje dispozitash, dispozita të cilat i “propozohen” gjykatës që t’i mbajë parasysh gjatë dhënies së vendimit; dhe ato që janë caktuar si “detyruese” që gjykata duhet t’i ketë parasysh dhe t’i aplikojë ato gjatë dhënies së vendimit... Kolegji Penal vëren se neni 47 si dispozitë penale është ndërtuar në mënyrë të tillë që gjykata duhet ta aplikojë detyrimisht atë (dispozitën) gjatë dhënies së vendimit. Gjithashtu, neni 47, paragrafi i dytë ka parashikuar se në caktimin e dënimit, gjykata duhet të mbajë parasysh, ndër të*

²¹²Vendimi Nr.190, datë 05.06.2013, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë.

²¹³Vendimi Nr.90, datë 13.03.2013, i Gjykatës së Lartë.

tjera, rrethanat lehtësuese dhe rënduese. Bazuar në sa më sipër, Kolegji Penal çmon se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë ka gabuar në caktimin e dënimit, për shkak se ajo duhet të kishte mbajtur parasysh dispozitën penale të nenit 17/2 të K. Penal dhe në përfundim të jepte dënimin në ngarkim të të gjykuarit Reshit Adri, duke e dënuar atë 25 vjet burgim.

Referuar praktikës gjyqësore të ilustruar dhe me shembujt e mësipërm, gjykata në caktimin e dënimit mban parasysh parimin *nemo prudens, luca tecatum est, sed ne pecetur* (pra kryesi duhet të dënohet jo sepse ka gabuar, por që të mos gabojë më).

*Prof. Dr. Sokol Mëngjesi e përkufizon dënimin penal si reagim kundër cenimit të benefiteve juridike, i cili konsiston në privimin e të drejtave dhe lirive të autorit dhe synon rikuperimin e ekuilibrit shoqëror që është çrregulluar*²¹⁴.

Qëllimi që synohet të arrihet, është parandalimi i posaçëm (preventiv special) dhe i përgjithshëm (preventiv gjeneral), edukimi dhe risocializimi i personit.

Pikërisht duke vuajtur pasojat e dënimit, i pandehuri, nëpërmjet parandalimit të posaçëm do të arrijë që të riedukohet dhe rikuperohet moralisht, pasi, duke u ndërgjegjësuar për pasojat e veprimeve kriminale ai do të disiplinojë veprimtarinë e tij brenda kornizave ligjore. Pra ndëshkimi, qoftë fizik, mendor, psikologjik e ekonomik i të pandehurit nëpërmjet dhënies së dënimit jepet, por ai nuk është qëllimi primar në dhënien e vendimit nga Gjykata dhe vetë ligjvënësi nuk e ka pasur këtë qëllim në ndërtimin e dispozitave të Kodit Penal.

Së katërti: Tek objekti i i provës sipas përcaktimit që bën neni 150 i K. Pr. Penale futen edhe faktet të cilat kanë të bëjnë me shkaqet dhe kushtet e kryerjes së veprës penale nga të cilat varet zbatimi i normave procedurale.

Në këtë mënyrë bëhet qartazi edhe dallimi mes provave dhe llojeve të tyre, si dhe fazat e paraqitjes së tyre përpara gjykatës, në raste trajtimi gjyqësor të kërkesave të çfarëdollojshme të palëve në një procedim penal.

Provat duhet të kenë një zinxhir të të menduarit logjik²¹⁵. Një pjesë e provave konstaton një fakt. Prova të tjera konstatojnë fakte të tjera. Së bashku, këto fakte i lejojnë gjyqtarit të arrijë në konkluzione përfundimtare. Në një çështje të thjeshtë, ose në një çështje me prova direkte të gjera, faktet mund t'i lejojnë gjyqtarit të konkludojë fajësinë apo pafajësinë. Në çështjet më të ndërlikuara ose çështjet me dëshmi indirekte, gjyqtari duhet të bëjë më shumë konkludime logjike mes provave të paraqitura dhe objektivit final, si shpallja fajtor e të pandehurit.

Në këtë kuptim, dua të theksoj se gjykatës i paraqiten kërkesa nga viktimat akuzuese, kërkesa në fazën e hetimit paraprak, kërkesa përpara gjyqtarit të seancës paraprake, kërkesa për gjykimin e çështjes në themel, kërkesa në fazën e ekzekutimit të vendimeve penale, kërkesa në lidhje me marrëdhëniet juridiksionale me jashtë dhe natyra e siccilit prej këtyre proceseve është e ndryshme, që lidhet jo me faktin juridiko-penal, por me faza të ndryshme edhe pas vërtetimit të këtij. Për shembull, dokumentet shëndetësore, familjare, shkollore etj., që paraqiten për të pandehurin, në shumicën e rasteve, nuk dëshmojnë faktin e ndodhur juridiko-penal, por shërbejnë për individualizimin e saktë

²¹⁴ Prof. dr. Sokol Mëngjesi, Bazat e doktrinës të së drejtës penale, botim 2016, fq. 23.

²¹⁵ Jon Smibert, J. D., LL. M. (Lond.) <http://www.brlin.org/uploads/documents/219/alb.pdf>

të llojit dhe të masës së dënimit në bazë të parimit të autonomisë së përgjegjësisë penale, ashtu dhe siç mund të shërbejnë për përfitimet e mundshme në fazën e ekzekutimit të vendimit penal.

Së fundmi, janë objekt i të provuarit edhe të gjithë ato rrethana dhe fakte që njoftojnë nevojën e aplikimit të masave të sigurimit. Instituti i masave të sigurimit është padyschim dhe instituti më problematik në zbatimin e tij në praktikë. *Masa e sigurimit personal është një veprim procedural që kufizon ose heq përkohësisht lirinë e personit ndaj të cilit po zhvillohet një procedim penal, me qëllim parandalimin e veprimit të mëtejshme kriminale, përpjekjet që ai mund të bëjë për të vënë në rrezik marrjen e provës apo vërtetësinë e saj, si dhe vendosjen e personit të dyshuar në favor të organit procedues për kryerjen e një hetimi të shpejtë dhe objektiv të çështjes*²¹⁶. Ky kufizim duhet të jetë i përkohshëm dhe shkalla e tij të varet nga nevojat e procesit të hetimit, në qëllimin që e udhëheq për parandalimin e veprimit të mëtejshme kriminale të personit, prishjen apo fshehjen e provave, si dhe të garantimit të shlyerjes së dënimit penal që mund të jepet nga gjykata në procesin e gjyqimit të akuzës në ngarkim të tij. Në mbështetje dhe të argumentit të mësipërm, neni 228²¹⁷ i Kodit të Procedurës Penale ka përcaktuar kushtet për aplikimin e masave të sigurimit.

Sipas nenit 228:

1. *Askush nuk mund t'u nënshtrohet masave të sigurimit personal në qoftë se në ngarkim të tij nuk ekziston një dyshim i arsyeshëm, i bazuar në prova.*
2. *Asnjë masë nuk mund të zbatohet kur ka shkaqe padëmueshmërie ose të shuarjes së veprës penale.*
3. *Masat e sigurimit personal vendosen: a) kur ekzistojnë shkaqe të rëndësishme që vënë në rrezik marrjen ose vërtetësinë e provës; b) kur i pandehuri është larguar ose ekziston rreziku që ai të largohet; c) kur, për shkak të rrethanave të faktit dhe personalitetit të të pandehurit, ka rrezik që ai të kryejë krime të rënda ose të të njëjtit lloj me atë për të cilin procedohet.*

Duke qenë se masat e sigurimit janë një institut shumë i gjerë për t'u trajtuar, për efekt studimi, do të analizojmë vetëm procesin e të provuarit dhe provat për aplikimin e tyre. Nisur dhe nga qëndrimet e ndryshme që mban praktika gjyqësore, pyetjet që natyrshëm shtrohen për diskutim, sot janë:

Çfarë do të kuptojmë me dyshim të arsyeshëm të bazuar në prova të përcaktuara nga ligjvënësi në nenin 228/1?

A është e rëndësishme që organi i akuzës, së bashku me kërkesën për caktimin e masës së sigurimit, të paraqesë prova për vërtetimin e nevojës për aplikim masë siguri?

Provat që duhet të paraqiten si rregull, duhet të jenë të natyrës që, krahas vërtetimit të ekzistencës së veprës penale, të vërtetojnë dhe autorësinë e kryerjes së veprës penale?

A mund të ndikojë vetëm masa e dënimit të veprës penale për caktimin e masës së sigurimit arrest me burg, e pa shoqëruar me prova që vërtetojnë nevojën e caktimit të masës së dënimit (neni 228/3), si kriter jo vetëm për përcaktimin e rrezikshmërisë shoqërore të veprimeve ose mosveprimeve të kryera, por edhe në krijimin dhe formimin

²¹⁶ Halim Islami, A. Hoxha. I. Panda, fq. 340.

²¹⁷ Kodi i Procedurës Penale, neni 228.

e bindjes së brendshme të gjykatës se personi që kërkohet caktim mase sigurimi do t'i shmanget hetimit dhe më pas gjykimit?

Së pari: Për t'i dhënë përgjigje pyetjeve të mësipërme është e nevojshme që fillimisht të analizojmë disa dispozita referuese të Kushtetutës, Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore e atyre të Kodit të Procedurës Penale, duke u fokusuar edhe në jurisprudencën shumë të pasur për këtë fushë të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

Kushtetuta, në parimet e përgjithshme të saj, e më konkretisht neni 15²¹⁸ parashikon se: “të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të padhunueshme dhe qëndrojnë në themel të të gjithë rendit juridik”.

Këto të drejta mund të kufizohen, në përpjesëtim me gjendjen që ka diktuar kufizimin, vetëm me ligj, për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Nga ana tjetër, neni 17²¹⁹ parashikon se “këto kufizime nuk mund të cenojnë thelbin e lirive dhe të të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut”.

Lidhur me garantimin e lirisë së personit, në nenin 27²²⁰ të Kushtetutës parashikohet se “askujt nuk mund t'i hiqet liria, përveçse në rastet dhe sipas procedurave të parashikuara me ligj”. Liria e personit nuk mund të kufizohet, përveçse në rastet e treguara në këtë dispozitë. Ndërmjet rasteve të tjera është ai i parashikuar në shkronjën “c”: “kur ka dyshime të arsyeshme se ka kryer një veper penale, ose për të parandaluar kryerjen prej tij të veprës penale, ose largimin e tij pas kryerjes së saj”.

Në dispozitat vijuese të Kushtetutës, parashikohen garancitë për personin që i nënshtrohet kufizimit të lirisë dhe ndjekjes penale në tërësi.

Ndërmjet të tjerave, në nenin 28²²¹ parashikohet se: *Kushdo, të cilit i hiqet liria, ka të drejtë të njoftohet Për shkaqet e kësaj mase, si dhe për akuzën që i bëhet. Personit, të cilit i është hequr liria, duhet t'i jepet mundësia për realizimin e të drejtave të tij (pika 1). Po kështu, i paraburgosuri ka të drejtë të ankohet kundër vendimit të gjyqtarit. Ai ka të drejtë të gjykohe brenda një afati të arsyeshëm ose të procedohet i lirë përkundrejt një garancie pasurore sipas ligjit (pika 3).*

Në kontekstin e kufizimit të lirisë së personit vlen të evidentohet rëndësia e garancisë kushtetuese se: *Kushdo quhet i pafajshëm përderisa nuk i është provuar fajësia me vendim gjyqësor të formës së prerë.*

Ndërsa në nenin 6²²² të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore sanksionohen parime të përgjithshme për të drejtën e një procesi të rregullt ligjor, garancitë për personin që kufizohet në të drejtën e lirisë personale parashikohen më hollësisht në nenin 5 të saj.

Sipas kësaj dispozite, kufizimi i lirisë legjitimohet vetëm në rrugë përjashtimore dhe ... *në përputhje me procedurën e parashikuar me ligj ...*

²¹⁸Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 15.

²¹⁹Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 17.

²²⁰Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 27.

²²¹Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 28.

²²² Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, neni 6.

Një nga rastet është ai i parashikuar në pikën 1, shkronja “c”: ... kur ka arsye të besueshme për të dyshuar se ai ka kryer një vepër penale ose kur ka motive të arsyeshme për të besuar se është e nevojshme që të pengohet të kryejë një vepër penale, ose të largohet pas kryerjes së saj. Konventa, në pikën 3 dhe 4 ofron disa garanci të tjera thelbësore lidhur me kufizimin e lirisë, pikërisht ato të kontrollit efektiv gjyqësor të ushtruar nga gjykata të pavarura, brenda afateve të shkurtra dhe të arsyeshme.

Sipas nenit 5 të Konventës, synimi kryesor i saj është parandalimi i kufizimit të lirisë së individit nëpërmjet arrestimit apo ndalimit në mënyrë arbitrare nga ana e organeve kompetente.²²³

Në zbatim të këtyre parimeve dhe dispozitave të Kushtetutës e Konventës, Kodi i Procedurës Penale, veçanërisht në Titullin VI “Masat e sigurimit”, parashikon rregulla të hollësishme edhe për masat e sigurimit personal. Nenet 228²²⁴ e 229 parashikojnë kushtet dhe kriteret e përgjithshme për caktimin e masës së sigurimit.

Dispozitat e neneve 27, 28 dhe 30 të Kushtetutës sonë përkojnë me qëllimin dhe interpretimin e nenit 5 të Konventës, e cila, së bashku me nenet 2, 3 e 4 të saj, janë themeli i të drejtave themelore të njeriut për sa i përket mbrojtjes së sigurisë fizike të individit, posaçërisht edhe të lirisë së personit.

Duke interpretuar këto dispozita, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) është shprehur se: *Qëllimi kryesor i tyre është të parandalojnë deprivimin arbitrar ose të pajustificuar të lirisë (Castravet kundër Moldavisë, 2007²²⁵).*

Kontrolli gjyqësor lidhur me veprimet e organit të akuzës që prekin të drejtën e lirisë personale, përbën një element thelbësor të garancisë së parashikuar në pikën 3 të nenit 5 të Konventës kundrejt mundësisë së ushtrimit të kompetencave nga organi i akuzës në mënyrë arbitrare dhe të pabazuar në ligj (*Schiesser kundër Zvicrës, 1979*)²²⁶.

Parimi i kontrollit gjyqësor mishërohet, mes të tjerave, edhe në rastin e caktimit të masave të sigurimit të parashikuar në nenet 228-230 të Kodit të Procedurës Penale, për këtë arsye, gjykata kompetente duhet të shqyrtojë me rigorozitet çështjen në seancë gjyqësore, duke dëgjuar pretendimet përkatëse të prokurorit, të individit ndaj të cilit është kërkuar caktimi i masës së sigurimit ose të mbrojtësit të tij.

Kufizimet e lirisë personale përpara dhënies së vendimit përfundimtar nga gjykata janë të pranueshme nga pikëpamja kushtetuese, me kushtin që t’i jepet zgjidhje trajtimit ndaj të pandehurit duke shmangur çdo zbatim të parimit të fajësisë.

Sipas praktikës së GJEDNJ-së²²⁷, në momentin e shqyrtimit të masave të sigurimit, gjykata nuk e shqyrton çështjen në themel, por mjafton dyshimi i arsyeshëm që personi ndaj të cilit po merret kjo masë e ka kryer këtë vepër penale. Por, gjithsesi, dyshimi i arsyeshëm nuk duhet parë i paargumentuar mbi bazën e atyre provave që janë mbledhur në këtë fazë të hetimit. Barra e provës rëndon mbi akuzën, e cila duhet të ofrojë prova të mjaftueshme për të mbështetur një konkluzion fajësie.

²²³ Vendimi i GJEDNJ-së, Winterwr kundër Holandës, dt. 24.10.1979.

²²⁴ Kodi i Procedurës Penale, nenet 228-229.

²²⁵ Castravet kundër Moldavisë, 2007.

²²⁶ Schiesser kundër Zvicrës, 1979.

²²⁷ Vendimi Barbera, Mssegue’, Jabardo kundër Spanjës.

Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, mbështetur në parimet e normat kushtetuese dhe ndërkombëtare të detyrueshme si më sipër, në kriteret ligjore të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale, pas një analize dhe vlerësimi mbi provat e paraqitura në seancë, gjykata duhet të vendosë nëse objektivi i ekzistojnë kushtet dhe kriteret për aplikimin e masave të sigurimit dhe ka lindur nevoja për kufizimin ose heqjen e lirisë së personit. Në vendimin e saj, Ergadoz kundër Turqisë,²²⁸ GJEDNJ-ja shprehet: *megjithëse dispozita nuk presupozon se organet e hetimit kanë mbledhur prova të mjaftueshme për të ngritur akuzat, gjykata duhet ta bazojë arrestimin e tij në këtë fazë mbi bazën e fakteve dhe informacioneve që kanë lidhje të mjaftueshme se i ndaluari ka kryer një veprë të kundraligjshme.*

Ky qëndrim, në parim, tashmë përbën një praktike të konsoliduar ndër vite të sistemit gjyqësor. Kolegji Penal në Vendimin Nr.489²²⁹, datë 12.12.2000, ka arsyetuar se: *Në kuptim të nenit 228/1 të Kodit të Procedurës Penale për aplikimin e një mase sigurimi kërkohet vërtet një dyshim i arsyeshëm për kryerjen e një veprë penale, por nga ana tjetër, ky dyshim i arsyeshëm duhet të mbështetet në prova dhe nuk duhet të jetë i supozuar.*

Edhe pse tashmë praktika gjyqësore është e konsoliduar, zbatimi në praktikë i masave të sigurimit është një proces shumë problematik, sidomos për sa i përket vlerësimit nga ana e gjykatës e rrezikut të ikjes (Neni 228/1/b).

Për fat të keq, në shumicën e rasteve, seancat e vleftësimit të arrestimit, ndalimit dhe caktimit të masave të sigurimit janë kthyer thjesht në seancë formale. Në vlerësimin tonë, gjykatat në keqinterpretim të Vendimit unifikues Nr: 07, datë: 14.10.2011, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, vendosin caktimin e masës së sigurimit arrest me burg bazuar në hamendësime, supozime dhe elemente të paqartë.

Në Vendimin unifikues nr.07²³⁰, datë 14.10.2011, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, ndër të tjera, kanë parashikuar se: *“Rreziku i largimit”, krahas elementeve të tjerë, mund të lidhet e të rezultojë edhe nga vetë natyra e akuzave në ngarkim të të gjykuarit, nga rëndësia e faktit, e sanksionit për veprën penale dhe lloji e shkalla e pasojave të ardhura prej saj. Prej tyre mund të arrihet në përfundimin logjik juridik, në trajtën e probabilitetit të arsyeshëm apo edhe të sigurisë, mbi mundësinë apo përgatitjen reale dhe efektive të ikjes, nëse nuk ndërhyhet për ta izoluar të pandehurin. Po kështu, shqyrtohet edhe sjellja e të pandehurit para dhe pas kryerjes së veprës (post delictum), personaliteti dhe pozita e tij etj.*

Gjithsesi, caktimi i masës së sigurimit sipas nenit 128, pika 1, shkronja “b” nuk mund të motivohet mbi baza thjesht hipotetike, në prezumime të përgjithshme apo imagjinare mbi probabilitetin e ikjes së personit, pasi kjo do të vinte ndesh me ligjin penal, si dhe jurisprudencën e GJEDNJ-së.²³¹

Bazuar në këtë kuadër ligjor, vlerësojmë se, duke qenë rreziku i ikjes një ngjarje-pasojë e ardhme dhe e pasigurt, gjykata në vendimin e saj duhet të analizonte elementet

²²⁸ Ergadoz kundër Turqisë

²²⁹ Vendimi Nr.489, datë 12.12.2000, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

²³⁰ Vendimi Unifikues nr. 07, datë 14.10.2011, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

²³¹ Vendimi i vitit 2000, Caballero kundër Mbretërisë së Bashkuar.

provues të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë mbi të cilët bazohet dyshimi i arsyeshëm rreth ikjes.

Si pikënisje për vlerësimin e rrezikut të ikjes, nga njëra anë, duhet të ishte prania e “elementeve konkretë dhe specifikë” tek të cilët bazohen dyshimet e arsyeshme dhe, nga ana tjetër, prania e indicieve dhe provave të rëndësishme që dalin kundër personit që kërkohet të caktohet masë sigurimi.

Gjykata duhet të shqyrtojë në mënyrë sa më konkrete rrezikun e ikjes duke përmendur elementet objektivë dhe specifikë, pra shkaqet konkretizuese, prej të cilave duhet të rezultojë jo thjeshtë mundësia hipotetike e largimit, as siguria e plotë, por një probabilitet i arsyeshëm që personi, po të mos ndërhyhet, do të largohet duke humbur gjurmët.

Për sa i përket pyetjes: “A mund të ndikojë vetëm masa e dënimit të veprës penale për caktimin e masës së sigurimit arrest me burg, e pa shoqëruar me prova që vërtetojnë nevojën e caktimit të masës së dënimit (neni 228/3), si kriter jo vetëm për përcaktimin e rrezikshmërisë shoqërore të veprimeve ose mosveprimeve të kryera, por dhe në krijimin, formimin e bindjes së brendshme të gjykatës se personi që kërkohet caktim masë sigurimi do t’i shmanget hetimit dhe më pas gjykimin?”

Shpreh bindjen se rreziku i ikjes nuk duhet dhe nuk mund të vlerësohet në mënyrë të përgjithshme dhe abstrakte në raport me llojin e krimit dhe natyrën e rëndë të tij, pasi, në të kundërt, do të konkludohej se për krimet jo të lehta, për çdo rast apriori, do të prezumohet rreziku i ikjes.

Në lidhje me dyshimin e arsyeshëm dhe provat që përdoren nga gjykata gjatë seancave për vlefësimin e arrestimit - ndalimit dhe caktimin e masave të sigurimit duhet pasur parasysh parashikimi që bën ligjvënësi në lidhje me provat e marra gjatë këtyre seancave, pasi ato konsiderohen si prova të marra në gjykim, por me kërkesën e palëve ato mund t’i nënshtrohen debatit të palëve gjatë shqyrtimit të çështjes në themel (neni 259/2 i K. P. Penale).

Në këtë kontekst-debat në lidhje me këto prova që i nënshtrohen procesit gjatë caktimit të masës mund të ketë në të dyja fazat, por gjithsesi ato prova konsiderohen si të marra në gjykimin e themelit dhe i shërbejnë gjykatës për të vendosur në lidhje me caktimin e një mase sigurimi, për të provuar dyshimin e arsyeshëm në lidhje me ekzistencën e faktit dhe të lidhjes së faktit juridiko-penal me personin ndaj të cilit vendoset masa e sigurimit.

*Forca e këtyre provave në këtë fazë të procedimit është e pamohueshme dhe, si të tilla, janë të përdorshme gjatë caktimit të masës së sigurimit.*²³²

Ndërkohë, në gjykim, duke iu lënë mundësia palës që të kërkojë nënshttrimin e debatit gjatë shqyrtimit gjyqësor, ligjvënësi ka marrë parasysh dy pozicionet proceduriale të marrjes së provës në shqyrtim nga gjykata, që kanë të bëjnë me faza të ndryshme të procedimit, periudha kohore gjatë të cilave janë marrë dhe grumbulluar edhe prova të tjera, me cilësi të ndryshme të personit që i atribuohet dyshimi i arsyeshëm ose bindja se ai është autor i veprës penale.

²³² Vendimi nr. 165, dt.01.07.2009, i Gjykatës së Lartë.

PROVAT DHE PROCESI I TË PROVUARIT NË PROCESIN PENAL

Një fakt shumë i rëndësishëm është tashmë ai që, për efekt të garantimit të mosabuzimit me të dhe garantimin e zhvillimit të një procesi sa më të rregullt të paanshëm dhe jo paragjykses, po merret në shqyrtim nga një gjykatë me trup tjetër gjykses, siç mund të jetë gjyqtari i seancës paraprake ose trupi gjykses që shqyrton çështjen në themel, që është edhe i ndryshëm nga ai që vleftësoi arrestin ose ndalimin e caktoi masën e sigurimit.

Në këtë fazë ia vlen të ndalemi në trajtimin e disa specifikave të ashtuquajturave prova që merren në këtë fazë dhe të vlerës së tyre provuese në raport me fakte të caktuara.

Ka disa akte shkresore procedurale që provojnë faktin juridik, por ka akte shkresore, dokumente që pasqyrojnë informacione në lidhje me të dhëna për personin, autor ose viktimë të veprës penale, si dhe dokumente që nuk lidhen me rastin që trajtohen nga organi procedues në vendosjen e një kufizimi të tillë të lirisë së personit apo kufizimit të të drejtave pasurore mbi një send apo të drejtë reale të individit.

Në vetvete, këto të dytat kanë të bëjnë me rastet e vlerësimit të kushteve dhe kritereve personale të caktimit të masës së sigurimit ndaj një personi të caktuar, sigurisht që vëmendja më e madhe drejtohet nga individët dhe masat shtrënguese që merren ndaj tyre, por më shumë te kufizimi ekstrem i lirisë së personit që është dhe arresti me burg. Në fakt, këto parime duhet të ndjekin si procedurat e marrjes së masave shtrënguese dhe ndaluese, si masat me karakter personal, ashtu dhe ato me karakter pasuror.

Së dyti, në këndvështrimin tim, në marrjen e vendosjen e masave të sigurimit personal shtrënguese dhe ndaluese, apo atyre me karakter pasuror, nuk duhet që të kemi patjeter një gjendje të caktuar juridike procedurale që të vendosim një masë sigurimi ndaj një personi të caktuar. Në këtë kuptim, e kam fjalën për aktin e njoftimit të akuzës që, si rregull, duhet të jetë një vendim përfundimtar i prokurorit i arritur mbi bazën e një procesi të rregullt ligjor të grumbullimit të provave dhe respektimit të parimit të procesit të rregullt ligjor, ku palës tjetër i është dhënë mundësia e mbrojtjes efektive, si dhe kjo vendimmarrje të jetë sintezë e analizimit dhe çmuarjes së këtyre provave të marra gjatë hetimit paraprak.

E them këtë fakt, sepse deri sa u mor vendimi i Kolegjeve të Bashkuara nr.3, i vitit 2002 (për një rast praktik ku unë kam ushtruar funksionin si Prokuror), Gjykata e Apelit Durrës mbante qëndrimin se nuk mundet të vendoset masë sigurimi ndaj një personi që nuk është marrë si i pandehur, në këtë përfundim të gabuar, gjykata kishte arritur nisur nga përcaktimi i bërë në nenin 228 të K. Pr. Penale, ku ligjvënësi ka përdorur termin i pandehur dhe jo person. Ky interpretim i ngushtë gramatikor i termit i pandehur tashmë është kaluar dhe ligjvënësi ka bërë ndërhyrjen përkatëse në nenin 34 të K. Pr. Penale, pavarësisht se në nenin 228 nuk e ka bërë një gjë të tillë.

Së treti, vlen të theksohet se tashmë, bazuar edhe në nenin 259/2 të K. Pr. Penale, por edhe në përputhje me dispozita të tjera të këtij Kodi, ato procesverbale të pyetjes së personave që tregojnë rrethanat e hetimit që janë përdorur si prova gjatë procesit të vleftësimit të arrestimeve dhe ndalimeve, apo në caktimin e masave të sigurimit në mungesë, janë marrë si prova.

Kodi ynë i Procedurës Penale me institutet e reja të përfshira pas ndryshimeve të vitit 2017, si gjykimi me marrëveshje apo urdhëri penal, na ka bërë të pranojmë se provat

PROVAT DHE PROCESI I TË PROVUARIT NË PROCESIN PENAL

formohen dhe marrin fuqi provuese që gjatë hetimit praparak, dhe, në rast se ka shqyrtim gjyqësor, ato i nënshtrohen debatit mbi kërkesën e palëve.

Në nenin 362/2 dhe 3 të Kodit të Procedurës Penale përcaktohet se ato thënie, të dhëna të dobishme për hetimin, të marra gjatë fazës së hetimit praparak nuk janë prova dhe vërtetojnë besueshmërinë e personalitetin e dëshmitarit, ndërkohë që në paragrafin e tretë parashikohet se ato përdoren si prova kur janë në përputhje me provat e tjera që merren në proces.

Pra, në këtë mënyrë dhe në përputhje me interpretimin që rrjedhin nga nenet 8/a, 149/2, 259/2, 362, 369 të K. Pr. Penale vlen të përmendet se gjykata i përdor ato në dhënien e vendimit, vetëm se cilësia procedurale e tyre mbetet si akte që, në përputhje me provat e tjera të marra në proces, vërtetojnë një fakt të caktuar. Pyetja logjike që lind në këtë fazë është se “A mundet gjykata që të marra prova me dëshmitarë në këtë fazë në qoftë se njëra nga palët ia kërkon?”.

Së katërti: a ka vlerë deklarata noteriale e njërit prej dëshmitarëve që është pyetur në proces që tregon ngjarjen në mënyrë krejt të ndryshme nga ajo e paraqitur në procesverbalin e pyetjes si person që tregon rrethana të hetimit nga ana e oficerit të policisë gjyqësore.

Sipas mendimit tim, një gjë e tillë është e lejueshme, pra qoftë pyetja e një dëshmitari që nuk është arritur që të pyetet nga ana e organit procedues deri në atë moment, qoftë edhe marrja e deklaratave noteriale, pasi në këtë rast ato janë formalizuar në një akt të shkruar dhe shërbejnë si provë shkresore. Marrja ose jo e dëshmisë së individit është një proces kohor objektiv që, ndoshta, nuk është arritur ose ka qenë i vështirë, dhe në rrallë raste i pamundur deri në fazën kur do të merret një vendim caktimi masë sigurimi. Përfundimisht, neni 259/2 i K. Pr. Penale kur parashikon që palët këto prova mund t’ia nënshtrorinë debatit gjyqësor në fazat e mëtejshme të procesit, ka lejuar marrjen dhe fuqinë e tyre provuese gjatë shqyrtimit të kërkesave për caktimin e masave të sigurimit. Në këtë drejtim, në aspektin teorik, na vlen të mbajmë parasysh edhe faktin se gjatë fazës së hetimit praparak, kur caktohet një masë sigurimi ose edhe gjatë hetimit gjyqësor tashmë, gjykata, kur cakton një masë sigurimi, vepron mbi bazën e një dyshimi të arsyeshëm të krijuar mbi provat e paraqitura, ndërkohë që në përfundim të hetimit gjyqësor, gjykata, kur deklaron fajtor ose të pafajshëm një të pandehur, ajo ka krijuar bindjen bazuar në prova dhe në analizën e çmuarjen e tyre, ndryshim shumë i madh esencial në të kuptuarit e fazave të procesit, nga të gjithë zbatuesit e ligjit procedural penal në praktikë.

E drejta për proces të drejtë zbatohet që në momentin e investimit të gjykatës e deri në ekzekutimin e vendimit përfundimtar të saj. Në çështjen Pellegrin kundër Francës, GJEDNJ-ja shprehet se: *E drejta për proces të rregullt është një e drejtë shumë e gjerë dhe në çdo rast duhet të shqyrtohet me kujdes nga gjykatat kombëtare, duke analizuar në detaje të gjitha faktet që në një formë apo tjetër do të cenonin të drejtat materiale dhe procedurale të të akuzuarit.*²³³

²³³ Vendim nr. 28541 i GJEDNJ-ja Pellegrin kundër Francës, vendimi nr. 28541.

PROVAT DHE PROCESI I TË PROVUARIT NË PROCESIN PENAL

Në lidhje me fajësinë e personit duhet mbajtur parasysh parashikimi i bërë në nenin 4/2 të K. Pr. Penale, ku parashikohet shprehimisht se: *Gjykata jep vendim fajësie kur i pandehuri rezulton fajtor për faktin penal që i atribuohet përtej çdo dyshimi të arsyeshëm.*

Gjykata nuk duhet të paragjykojë çështjen deri sa nuk ka dëgjuar çdo pohim, kërkesë apo marrë ndonjë provë që e vë sadopak në dyshim bindjen se një i pandehur është jo autor i kryerjes së një vepre penale.

Çdo provë që zhvillohet gjatë një hetimi dhe pastaj paraqitet në gjykatë ka cilësi të brendshme që ndërlidhen me prova të tjera, me pohime, me konkluzionet e përkohshme dhe me objektivat përfundimtare të çështjes. Secila pjesë e provave ka cilësi të ndryshme. Ato cilësi mund të ndryshojnë në varësi të asaj se çfarë nevojitet të vërtetohet dhe provave të tjera të rastit. Këto tri cilësi, në përgjithësi, emërtohen relevanca, besueshmëria dhe fuqia provuese.²³⁴

Gjykata ka rolin e arbitrit në proces dhe duhet të veprojë si e tillë, sepse palët, nga vetë mënyra se si i kanë të ndara rolet në ligj e në praktikë, e kanë paragjykimin pjesë të bindjes së tyre të brendshme dhe punojnë në drejtim të vërtetimit të faktit sipas bindjes që ata kanë arritur gjatë përbaljes në hetimin praparak apo edhe atë gjyqësor.

²³⁴ Jon Smibert, J. D., LL. M. (Lond.) <http://www.brrln.org/uploads/documents/219/alb.pdf>

KAPITULLI III

LLOJET E PROVAVE PENALE DHE BURIMET E TYRE

3.1. Llojet e provave penale sipas ndarjeve doktrinale

Doktrina e procedurës penale, por dhe jurisprudenca në studimin që i ka bërë provave të parashikuara në Kod, në përputhje me karakteristikat që ato përfaqësojnë gjatë procesit të provuarit, i ka klasifikuar ato si prova **direkte-indirekte, atipike, provë materiale-personale, provë e plotë dhe provë jo e plotë.**

❖ **Prova direkte-indirekte. Prova indiciare**

Për të kuptuar nëse një provë është direkte apo indirekte duhet të nisemi nga marrëdhënia që ka një provë ndaj faktit juridiko-penal.

Provë direkte konsiderohet ajo provë e cila ka lidhje të drejtpërdrejtë me ekzistencën e rrethanave dhe fakteve të veprës penale, të cilat subjekti i ka perceptuar drejtpërsëdrejti nëpërmjet shqisave. Si e tillë, konsiderohet dëshmia e dëshmitarit, pohimi i të pandehurit, mendimi i ekspertit etj.

Ndërsa provë indirekte konsiderohet ajo provë e cila, në mënyrë të tërthortë, kontribuon në vërtetimin e ndonjë rrethane ose fakti të veprës penale të kontestuar. Këto prova quhen ndryshe dhe indicie.²³⁵ Sikurse e cituam dhe më lart, ky është një koncept i ri në të drejtën procedurale shqiptare i huazuar nga Kodi i Procedurës Penale Italiane, por që gjendet tashmë i trajtuar nga disa autorë.

Provat indirekte japin të dhëna që shërbejnë për të konstatuar jo drejtpërsëdrejti një fakt, por që, shpeshherë, përdorimi i tyre është mënyra e vetme për përforcimin e bindjes së plotë të gjyqtarit rreth vërtetimit të veprës penale dhe autorësisë së saj. Megjithatë, një provë e vetme indirekte nuk mundet kurrsesi të shërbejë për përcaktimin e fajësisë të të pandehurit.

Provat direkte dhe indirekte nuk duhen vënë përballë njëra-tjetrës, por duhen shfrytëzuar në lidhje dhe varësi reciproke. Asnjëra nuk ka ndonjë vërtetësi apo vlerë të paracaktuar, ndaj ato duhet të verifikohen me kujdes.²³⁶

Një nga veçoritë më karakteristike të provave indirekte është edhe karakteri i tyre i kushtëzuar.²³⁷

Një fakt që ka vlerën e provës indirekte mund të nxirret nga një burim ose shumë burime.

Provat indirekte janë fakte të njohura dhe të sigurta, prej të cilave mund të vërtetohet ekzistenca e një fakti të panjohur. Ato duhet që të interpretohen në mënyrë që të përjashtohet çdo alternativë tjetër.²³⁸

²³⁵ “Argumentimi në procedurën penale”, Prof. Ejup Sahiti, faqe 108, paragrafi 3.

²³⁶ Ejup Sahiti, “Argumentimi në procedurën penale, fq. 110.

²³⁷ Prof dr. Altin Shegani, Provat atipike, fq. 18.

²³⁸ Halim Islami, Artan Hoxha, Ilir Panda, “Procedura penale”, 2007, fq. 328.

Kështu, në lidhje me rëndësinë dhe vlerën që kanë provat indirekte gjatë procesit të të provuarit në procesin penal, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në vendimin Nr. 162²³⁹, datë 02.07.2014 është shprehur se: *Gjykata mund të mbështesë vendimin në lidhje me përgjegjësinë penale dhe në prova indirekte, por vetëm atëherë kur nga analiza e tyre mund të arrihet në një zgjidhje të sigurt. Por, rindërtimi i ngjarjeve dhe përgjegjësi përkatëse të tre të pandehurve, në bazë të provave indirekte, duhet të jetë aq i sigurt sa të përjashtojë çdo mundësi tjetër të arsyeshme. Ato duhet të interpretohen në mënyrë të tillë që të përjashtojnë çdo alternativë tjetër të mundshme. Në rastin e përdorimit të provave indirekte nuk njafton vetëm vërtetësia e tyre, por dhe siguria që ato të kenë lidhje me ngjarjen objekt gjykimi.*

Si rregull, prova indirekte apo e quajtur ndryshe indiciare është një provë kritike dhe i referohet atij vlerësimi se nga një fakt i provuar (rrethana inziçiare) rrjedh ekzistenca e një fakti tjetër për t'u provuar. Lidhja midis rrethanave indiciare dhe faktit për t'u provuar, qëndron në konkluzionin e arritur nga përvoja maksimale ose nga një provë tjetër.

*Indiciet duhet të veprojnë si rreth i fortë i mbyllur, i cili lejon vetëm një përfundim në raport me faktin relevant dhe të përjashtojë objektivisht dhe plotësisht mundësinë e përfundimit të ndryshëm në raport me faktin e njëjtë*²⁴⁰.

Objekti për t'u provuar në rastin e provave indirekte mund të jetë si fakti juridik që është i akuzuar i pandehurit (që është e shprehur në praktikë dhe si fakti kryesor), ashtu dhe një rrethanë tjetër indiciare, e cila përcaktohet si fakt sekondar, nga e cila, me një konkluzion të mëtejshëm, mund të përftohet ekzistenca e faktit kryesor.

Kodi i Procedurës Penale nuk na jep një përkufizim të indicieve, por parashikohet rregullisht se ekzistenca e një fakti nuk mund të nxirret nga indiciet përveçse kur këto janë të rëndësishme, të sakta dhe në përputhje me njëra-tjetrën.

Kjo është hera e vetme kur në Kod përmenden indiciet, ndërsa interpretimin e indicieve e ka kryer doktrina dhe praktika gjyqësore.

Kështu është interpretuar se me termin “të rëndësishme” duhet kuptuar qëndrueshmëria ose rezistenca e saj ndaj prapësimeve, pra si sinonim i besueshmërisë dhe bindjes, ndërsa “të sakta” janë indiciet jo gjenerike e jo ekuivoqe, pra që nuk lejojnë interpretim tjetër. “Të lidhura me njëra-tjetrën”, është interpretuar se është kushti që kërkon që disa indicie të mos kundërshtojnë njëra-tjetrën dhe, mbi të gjitha, të mos jenë në kundërshtim me rrethana dhe fakte të tjera tashmë të provuara.

Gjykata Lartë në Vendimin Nr. 698²⁴¹, datë 09.12.2009, është shprehur se: *Gjykata mund të arrijë në përfundime për dhënien e vendimit e përgjegjësinë penale edhe mbi bazën e një indicie, mbasi ato mund të luajnë rol vendimtar për zgjidhjen e çështjes, por kur ato janë të tilla, që vërtetojnë ekzistencën e faktit, pa dyshuar në këtë drejtim, gjë që në rastin në shqyrtim nuk mund të pranohet, pasi dhe indiciet nuk ndihmojnë për të arritur në përfundimin që ka arritur Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda.*

²³⁹ Vendimi Nr. 162, datë 02.07.2014, i Gjykatës së Lartë.

²⁴⁰ H. Sijerçiq-Çoliq, M. Haxhiomeragiq, M. Jurçeviq, D. Kaurinoviq, M. Simoviq, M. 2005, fq. 716.

²⁴¹ Vendimi Nr.698, datë 09.12.2009, i Gjykatës së Lartë.

Gjithashtu, Gjykata e Lartë në Vendimin Nr.31²⁴², datë 31.01.2013, është shprehur se: *Kolegji Penal vlerëson se dallimi midis provës dhe indicies qëndron në atë që: nëse e para vërteton në mënyrë të drejtpërdrejtë ekzistencën ose jo të një fakti, e dyta është një rrethanë nga e cila mund të arrihet në një deduksion të logjikshëm, një konkluzion i përafërt mbi ekzistencën ose jo të një fakti.*

Dhe në vendimin Nr. 751²⁴³, datë 16.12.2009, Kolegji i Gjykatës së Lartë është shprehur se: *Në rastin konkret në ngarkim të të gjykuarit D. B, ka vetëm një indicie, të pa shoqëruar me ndonjë provë tjetër që të vërtetonte akuzën, prandaj dhe me të drejtë Gjykata e Shkallës së Parë nëpërmjet një analize të hollësishme ka arsyetuar se kjo indicie nuk lidhet me asnjë provë tjetër për të provuar akuzën në ngarkim të të gjykuarit D. B.*

Pra, indiciet sipas parashikimit të K. Pr. Penale dhe interpretimit të Gjykatës së Lartë, nuk janë provë në vetvete, por njoftojnë një fakt nga i cili rrjedh ekzistenca e një fakti tjetër për t'u provuar. Ato mund të shërbejnë si provë vetëm në qoftë se përmbushin kriteret ligjore, pra të jenë të rëndësishme, të sakta dhe në harmoni me njëra-tjetrën.

Këto karakteristika janë rrjedhojë logjike e karakterit të provave indirekte ku, në shumë raste, nga prova indirekte rrjedhin dy ose më shumë fakte të panjohura alternative. Pikërisht për këtë është e nevojshme që, pasi të shqyrtohet me kujdes secila nga provat indirekte, të vërtetohet se, në përputhje dhe në unitet me njëra-tjetrën, ato përcaktojnë një fakt të vetëm që përjashton dykuptimësinë e provave indirekte të veçanta. Provat indirekte vërtetojnë fakte të veçanta të ngjarjes. Kur kemi prova indirekte nuk mjafton vetëm vërtetësia e tyre, por edhe siguria se prova indirekte ka lidhje me ngjarjen.²⁴⁴

*Njohja e dy rrethanave ose fakteve nëpërmjet provës indirekte, sipas arsytimit logjik që lejon si deduktim, të përfitohet njohja e ekzistencës së faktit objekt i të provuarit, i cili zakonisht quhet prezumim i thjeshtë.*²⁴⁵

Provat direkte dhe provat indirekte mund të përdoren bashkë jo vetëm për të vërtetuar minimalisht elementet e veprës penale, por edhe për ta bërë provën më të besueshme. Secila pjesë e provave mund të ketë burime të ndryshme dhe mund të provojë gjëra të ndryshme. E njëjta provë mund të sigurojë fakte direkte të një objektivi përfundimtar, si një element i një veprë penale, por, nga ana tjetër, mund të mbështesë fakte të përkohshme dhe kështu është provë indirekte. Sidoqoftë, secila pjesë direkte ose indirekte e provave mund të ketë cilësi të ndryshme, që i bëjnë pak a shumë të vlefshme si fakte. Disa raste janë të thjeshta dhe mund të vërtetohen direkt ose shpejt. Të tjera raste janë më komplekse dhe kërkojnë një rrjetë më të gjerë me prova dhe konkluzione përfundimtare, në mënyrë që të demonstrojnë fajësinë ose përgjegjësinë.

❖ **Prova personale dhe materiale**

Bazuar në mjetin nga rrjedh prova, është bërë edhe ndarja në prova personale dhe materiale.

²⁴² Vendimi Nr.31, datë 31.01.2013, i Gjykatës së Lartë.

²⁴³ Vendimi Nr.751, datë 16.12.2009, Kolegji i Gjykatës së Lartë.

²⁴⁴ Prof dr. Altin Shegani, Ylli Pjetërnikaj, Valbona Nano, fq. 57.

²⁴⁵ Dhimitër Lara, "Koment mbi Kodin e Procedurës Penale". Pjesa e parë, Tiranë 2010, fq. 503.

*Prova personale janë njohuritë e drejtpërdrejta ose të tërthorta të individit ose të shumë personave në lidhje me faktin juridiko-penal, si p.sh.: dëshmitarët, ekspertimet e bëra nga ekspertët, pyetja e ekspertëve, i pandehuri në disa legjislacione të ndryshme me pohimet e tij.*²⁴⁶

Provat personale duhen parë të lidhura ngushtë me cilësitë individuale të personit, si dhe me njohuritë e posaçme që gëzon ky individ.

Ndërmjet faktit të njohur (deklarimit të bërë nga ana e dëshmitarit) dhe faktit të panjohur (fakti për t'u provuar) është në mes vlerësimi i besueshmërisë së burimit dhe besueshmërisë së rrethanave të njoftuara, sinqeriteti i deklaruesit, sa ka qenë i vëmendshëm për rrjedhojat e faktit; sa është në gjendje për të kuptuar kuptimin e elementeve që deklararon.

Tregimi i një fakti do të thotë rindërtimi i një ekuivalenti, imazhe, fjalë, gjeste apo tinguj, në mënyrë që të bëhet i njohur kur nuk është më i pranishëm. Prandaj, prova personale është mënyra me të cilën një fakt mund të bëhet i njohur nga njerëzit e tjerë. Gjithashtu, në vlerësimin e provave personale, duhet marrë në konsideratë dhe njohuritë e posaçme që këta persona gëzojnë siç është rasti i ekspertit.

❖ **Kuptimi i provës materiale**

Në kërkim të gjetjes së të vërtetës për zbulimin e fakteve dhe rrethanave në rastin e zgjidhjes së një çështje penale, sot theksi po vihet gjithnjë e më shumë tek provat materiale, të cilat shikohen si një mjet efikas provues. Për sa i përket provave materiale, në analizë dhe të nenit 187, në kushtet që K. Pr. Penale nuk parashikon ndonjë përcaktim të saktë ose shterues të provave materiale, apo të objekteve që mund të shërbejnë si prova materiale, provë materiale do të konsiderohen:

Sende që kanë shërbyer si mjete për realizimin e veprës penale.

Sende mbi të cilat gjenden gjurmët e saj.

Sende që kanë qenë objekt i veprimeve të të pandehurit.

Sende që përbëjnë objektin e përfitimit nga vepra penale.

*Çdo send tjetër që mund të ndihmojë në sqarimin e rrethanave të çështjes.*²⁴⁷

Gjatë kryerjes së veprimeve të kundraligjshme, autorët e këtyre veprimeve në një mënyrë apo në një tjetër, lënë gjurmë ose shenja, të cilat shërbejnë për të orientuar fillimisht organin procedues, pra për të krjuar tek ata një ide për ngjarjen e ndodhur.

Ecuria e hetimit dhe kujdesi i treguar gjatë veprimtarisë hetimore për zbulimin dhe fiksimin e gjurmëve, janë baza e detyrës për të zbuluar autorin, rrethanat, mënyrën, kohën e kryerjes së veprës penale. Këto gjurmë ose sende të gjetura janë provat materiale.

Provat materiale janë sende të ndryshme që në pamjen e jashtme, me cilësitë dhe shenjat e veçanta të tyre mund të vërtetojë fakte të caktuara që kanë rëndësi për zgjidhjen e një konflikti midis palëve. Si provë materiale janë edhe dokumentet (provat shkresore), por jo për përmbajtjen e tyre, por për pamjen e tyre të jashtme, i tillë mund

²⁴⁶ Ejup Sahiti, "Argumentimi në procedurën penale", botim I, 2006, fq. 113.

²⁴⁷ Kodi i Procedurës Penale, neni 187.

*të jetë rasti i falsifikimit material të tij, mënyra e të shkruarit e përdorur, të gërvishurat dhe të shuarat.*²⁴⁸

Provat materiale, në disa raste, mund të shërbejnë dhe si prova indirekte të veprës penale që është kryer, që zbulojnë personin që ka kryer veprën ose që shërbejnë për shfajësimin e tij, për të konstatuar alibinë e tij.

Për sa i përket definicionit të provave materiale, pavarësisht se i referohet kuptimit procedural civil, prof. Stavri Çeço, në librin “E drejta procedurale civile e RPSSH-së”, jep këtë përkufizimi në lidhje me provat materiale: “Provat materiale janë sendet e realitetit objektiv që shërbejnë si mjet për vërtetimin e rrethanave që kanë rëndësi për çështjen”²⁴⁹.

Por megjithatë, që prova materiale të ketë fuqi ligjore duhet të shoqërohet me informacion shtesë për të shpjeguar relevancën e saj.

*Provat materiale mund të jenë relevante, të besueshme dhe bindëse, mirëpo kërkojnë informacion shtesë për të shpjeguar se çfarë janë, pse janë relevante dhe sa të besueshme duhet të jenë. Nëse ky informacion shtesë mungon, atëherë mjeti i vrasjes është thjesht një tjetër thikë kuzhine.*²⁵⁰

Rëndësia e provave materiale, si lloj i veçantë i provave është rritur shumë me paraqitjen dhe zhvillimin e kriminalistikës. Janë ekzaminimet e ndryshme kriminalistike, të cilat mundësojnë përdorimin e disa provave materiale, si provë në procedurën penale.

Këto prova janë të shumta dhe të shumëllojshme. Sendet e ndryshme që kanë lidhje me veprën penale dhe autorin e saj janë indicie të cilat janë në gjendje që në mënyrë graduale të çojnë tek vendi i ngjarjes, tek fajtori, nga i dyshuari tek i pandehuri, nga probabiliteti tek e vërteta.

Këto sende ose gjurmë, në varësi edhe nga situata, mund të jenë të dukshme për syrin e njeriut ose të atilla sa për shfrytëzimin e tyre nevojiten pajisje teknike të posaçme. Kështu, gjurmët e ndryshme që mundësojnë vërtetimin e fakteve juridike relevante mund të jenë grimca të vogla që mbeten nga veprimi i jashtëm mekanik midis dy objekteve ose janë sasi aq të vogla lëndë, të cilat nuk shihen me sy të lirë.

Meqenëse vepra penale kryhet me objekte ose mbi objekte të caktuara, autori i veprës penale, kundër dëshirës së vet, lë në vendin e kryerjes së veprës penale gjurmë të ndryshme ose, duke qëndruar në vendin e ngjarjes, ai u ekspozohet gjurmëve të ndryshme që e shoqërojnë edhe pasi largohet nga vendi i ngjarjes.

Provat materiale zbulohen, administrohen nga organet proceduese nëpërmjet aplikimit të mjeteve të kërkimit të provave penale të parashikuara nga kreu III i titullit IV të K. Pr. Penale, kryesisht nëpërmjet këqyrjeve, kontrollit, sekuestrimit, por edhe përgjimit. Duhet thënë që provat materiale administrohen edhe kur ato dorëzohen nga subjektet e tjera procedurale, si dhe të dëmtuarit, dëshmitarët etj.

Sipas përcaktimeve që bën Kodi i Procedurës Penale, provë materiale mund të jetë çdo send, objekt dhe çdo materie që jep njoftim apo ka rëndësi për sqarimin e

²⁴⁸ Altin Shegani, Ylli Pjetërmikaj, Valbona Nano, “Provat atipike”, fq. 55.

²⁴⁹ Stavri Çeço, “E drejta procedurale civile e RPSSH-së, Shtëpia Botuese e Librit Universitar, fq. 107.

²⁵⁰ Jon Simbert, “Parimi i provave” <http://www.brrln.org/uploads/documents/219/alb.pdf> fq 34

rrethanave të çështjes, ato mund të jenë të llojeve e natyrave të ndryshme.

Për sa u përket objekteve dhe fenomeneve, për njohjen e të cilave kërkohet dijeni ose mjeshhtëri e posaçme profesionale, ku rruga për nxjerrjen e njohurisë realizohet nëpërmjet ekspertimit, vlen të përmendet se objekte të tilla, si dhe vetë procesin e ekspertimit në i konsiderojmë mjet provues, ndërsa përmbajtjen e këtij mjeti provues, të shprehur nëpërmjet mendimit të ekspertit, do ta konsiderojmë provë.

Të provuarit me ndihmën e provave materiale, mund të kombinohen edhe me dëshminë e dëshmitarit dhe nëpërmjet procesit të njohjes²⁵¹, duke i kërkuar këtij të fundit ta përshkruajë atë dhe të paraqesë karakteristikat dalluese të tij sipas rregullave procedurale.

Që provat materiale të konsiderohen të vlefshme duhet të plotësohen dy kushte kumulative:

1. Zbatimi i rregullave të Kodit të Procedurës Penale.
2. Zbatimi i rregullave kriminalistike.

Rregullat e parashikuara në Kodin e Procedurës Penale zbatohen në fiksimin, marrjen, dhe ruajtjen e provës materiale, si dhe ato të parashikuara nga nenet: 151, 356, 357, 367 dhe 368 të K. Pr. Penale.

Kështu, provat materiale përshkruhen hollësisht në procesverbalin për këqyrjen dhe marrjen e provës materiale, në të përshkruhet në mënyrë të hollësishme të gjitha të dhënat identifikuese të saj, si dhe ato që konstatohen në këtë provë materiale.

Rregullat procedurale të marrjes dhe administrimit të provave materiale parashikohen nga neni 188 të K. Pr. Penale, ku parashikohet se: *Provat materiale përshkruhen hollësisht në procesverbal; kur ka mundësi fotografohen ose filmohen dhe me urdhër të organit procedues i bashkohen fashikullit gjyqësor.*

Provat materiale me urdhër të organit procedues i bashkohen fashikullit gjyqësor. Sendet dhe provat materiale, të cilat rrezikojnë të prishen, kur nuk është e mundur kthimi personave që u përkasin, u kalohen në përdorim ose ruajtje enteve të caktuara, të cilat kanë detyrimin t'i kthejnë ato ose vlerën e tyre.

Ndërsa respektimi i rregullave dhe teknikave kriminalistike lidhet me vlefshmërinë faktike, me vlerën provuese të provave, pra me vlerën konkrete të tyre. Në hetimin e çdo çështje, sidomos atyre me vendngjarje, në çdo kontroll e këqyrje duhet të kërkohen provat materiale që do të jenë objekt i ekspertimit, duhet të zbatohen mirë teknikat kriminalistike në të gjitha fazat e procedimit. Kur ky proces realizohet mirë, sigurohet fiksimi në mënyrë të saktë i të gjitha mjeteve të provave të rëndësishme për vërtetimin e të vërtetës në çdo çështje.

Oficerët dhe prokurorët duhet të kërkojnë provat materiale, t'i fiksojnë dhe t'i marrin ato në përputhje me rregullat e kriminalistikës. Provat materiale dhe gjurmët duhen zbuluar me mjete të përshtatshme, pa shkaktuar dëmtimin e tyre, duhen fiksuar dhe paketuar në mënyrë të tillë që të mos dëmtohen gjatë lëvizjes dhe dërgimit për ekspertim. Shumë i rëndësishëm është edhe sigurimi i modeleve të cilat nevojiten për ekzaminimin krahasues.

²⁵¹ Ejup Sahiti, "E drejta procedurale penale", fq. 284.

PROVAT DHE PROCESI I TË PROVUARIT NË PROCESIN PENAL

Për gjetjen, fiksimin, përshkrimin dhe marrjen e gjurmëve dhe provave materiale gjatë realizimit të këqyrjeve dhe kontrolleve, një ndihmesë të veçantë japin dhe specialistë të fushave të ndryshme, ekspertët.

Në këqyrje marrin pjesë: ekspert kriminalist, për këqyrjen e kufomave, një ekspert mjeko-ligjor; për dokumentet financiare, ekspert kontabël etj. Pra marrin pjesë specialistë që mbulojnë fushën apo objektin në të cilin realizohet këqyrja.

E kundërta ndodh kur gjatë këqyrjeve dhe kontrolleve nuk tregohet kujdes për zbulimin e gjurmëve dhe të provave materiale, kur nuk respektohen rregullat për fiksimin, marrjen dhe ruajtjen e tyre nga çdo dëmtim i mundshëm. Në këto raste, edhe ekspertimi bëhet i pasaktë ose i pamundur. Janë oficerët e policisë gjyqësore, prokurorët dhe gjyqtarë të cilët përcaktojnë për çdo rast të procedimit penal objektin e ekspertimit duke u bazuar në të dhënat që ata disponojnë.

Gjykata, në vendimin përfundimtar, duhet detyrimisht të disponohet edhe për fatin e provave materiale të marra e sekuestruara gjatë procesit penal. Në nenin 190 të K. Pr. Penale janë përcaktuar në mënyrë të qartë kushtet dhe kriteret ligjore në lidhje me disponimin e provave materiale, dhe konkretisht:

Sendet që kanë shërbyer si mjete për kryerjen e veprës penale, çdo produkt, qoftë edhe i premtuar nga vepra penale, kalojnë në favor të shtetit, me përjashtim të rasteve kur ato u përkasin personave të cilët nuk kanë marrë pjesë në kryerjen e veprës penale, në këtë rast ato u kthehen pronarëve të ligjshëm.

Sendet, mbajtja ose qarkullimi i tyre është i ndaluar, u dorëzohen enteve të caktuara dhe, nëse nuk kanë asnjë vlerë, ato asgjësohen.

Sendet, provat materiale që nuk kanë vlerë asgjësohen.

Sendet që u përkasin personave të tjerë pa lidhje me veprën penale, kthehen nëse nuk ka konflikt për pronësinë e tyre, në të kundërt ato mbahen në ruajtje deri në zgjidhjen e këtij konflikti nga gjykata.

Në paragrafin e dytë të kësaj dispozite, ligjvënësi ka parashikuar të drejtën e prokurorit dhe gjykatës që, para përfundimit të procesit penal, të vendosin kthimin e sendeve që u përkasin personave që nuk kanë lidhje me veprën penale, me kusht që nga kthimi i tyre mos të dëmtohet zgjidhja e çështjes.

Lidhur me zbatimin e këtij neni, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin Nr. 49²⁵², datë 23.01.2001, i ka bërë vërejtje Gjykatës së Apelit Vlorë, duke u shprehur se: *Në lidhje me administrimin e një pjese të provave materiale (lëndës narkotike) dhe disa provave të tjera materiale të bllokuara (pasaportë, telefon celular etj.), si Gjykata e Shkallës së Parë dhe ajo e Apelit nuk kanë zbatuar urdhërimet e nenit 190 të Kodit të Procedurës Penale për disponimet mbi provat materiale. Në vend që sasia e lëndës narkotike që ishte dërguar si mostër për ekspertim kimik, pas përfundimit të çështjes të asgjësohej, jo që nuk u asgjësua, por vazhdon të qëndrojë me aktet.*

Në një situatë të tillë ndodhemi edhe në rastin e këqyrjes. Në këtë rast, gjykata, kur e çmon të nevojshme që një person ose një send të këqyren drejtpërdrejt prej saj, kryesisht ose me kërkesën e palëve, vendos që të bëhet këqyrja me ose pa ekspert.

²⁵² Vendimi nr. 49, datë 23.01.2001, i Gjykatës së Apelit - Vlorë.

Por në këtë rast, pavarësisht se mund të këqyren sende, nuk ndodhemi përpara provës materiale, sepse këqyrja është një mjet provues i veçantë me anë të të cilit gjykata ka mundësi të marrë dëgjimin për gjendjen dhe cilësinë e personave dhe të sendeve, madje ky mjet provues ka një karakter të *sui generis*, pasi përdoret edhe si veprim hetimor, ndërsa provat materiale nuk kanë një karakter të tillë.

Një dallim i tillë tregohet qartë tek K. Pr. P., i cili ka parashikuar provat materiale në një nen të veçantë (neni 187), ndërsa këqyrjen e ka parashikuar si mjet për kërkimin e provës (nenet 198-202). Pra, në këto nene shprehet qartë se provat materiale janë sende, objekte materiale, ndërsa këqyrja është veprim procedural, ku gjykata merr njohuri për fakte dhe rrethana që kanë rëndësi për zgjidhjen e çështjes.

Pra, në të dyja këto raste, si në rastin e marrjes së provave nga një person i tretë (edhe në këtë rast kemi të bëjmë me një veprim dhe jo me një send) edhe në rastin e këqyrjes nuk kemi të bëjmë me prova materiale, pasi provat materiale janë një mjet i veçantë provues, por që në legjislacionin tonë procedural civil, një mjet i tillë provues, nuk njihet.

Është e vlefshme të bëhet dallimi edhe ndërmjet provave materiale dhe dokumenteve. Thamë që provat materiale janë sende të ndryshme që në pamjen e jashtme, me cilësitë dhe shenjat e veçanta të tyre mund të vërtetojnë fakte të caktuara që kanë rëndësi për zgjidhjen e një konflikti midis palëve (p.sh., si provë materiale mund të shërbejë gruri në konfliktet për kualitetin e këtyre sendeve).

Si provë materiale janë edhe dokumentet (provat shkresore), por jo për përmbajtjen e tyre, por për pamjen e tyre të jashtme, i tillë mund të jetë rasti i falsifikimit material të tij, mënyra e të shkruarit e përdorur, të gërvishurat dhe të shuarat.

❖ Prova atipike

Provat atipike janë një inovacion në legjislacionin tonë procedural penal po të marrim parasysh se Kodet e Procedurës Penale të viteve 1954 dhe 1979 nuk kishin një parashikim të tillë duke nënkuptuar kështu një “taksativitet të mjeteve provuese”.

Lejimi i provave atipike ka si logjikë kryesore mosngushtimin e mjeteve me anë të së cilave mund të arrihet tek e vërteta gjyqësore.

Procedura e marrjes së provës atipike rregullohet nga neni 149/2 i K. Pr. Penale, i cili bën dhe parashikimin për marrjen e kësaj prove: *Kur kërkohet një provë që nuk rregullohet me ligj, gjykata mund ta marrë në qoftë se ajo vlen për të vërtetuar faktet dhe nuk cenon lirinë e vullnetit të personit. Gjykata vendos për marrjen e provës pasi dëgjon palët mbi mënyrën e marrjes së saj.*

Neni 149/2 i K. Pr. Penale ka parashikuar tre kushte për marrjen e provave atipike, dy të natyrës substanciale dhe një e natyrës procedurale. Këto kushte kanë të bëjnë me garantimin e vërtetësisë dhe besueshmërisë së mënyrës dhe provës që kërkohet të përfitohet.

Para së gjithash, në përputhje me parashikimin që është bërë nga ana e legjislatorit se *gjykata mund ta marrë një provë që nuk parashikohet në ligj në qoftë se ajo vlen për të vërtetuar faktet*, prova atipike duhet të jetë e përshtatshme për krijimin e faktit, që do

PROVAT DHE PROCESI I TË PROVUARIT NË PROCESIN PENAL

të thotë se ajo duhet të jetë në gjendje të njoftojë elemente konkrete që lejojnë një vlerësim të besueshmërisë së burimit të provave.

Një vlerësim i tillë për provat tipike tashmë është bërë nga legjislatori duke i kodifikuar, prandaj, për këtë të fundit, konstatimi i përshtatshmërisë është një karakteristikë e parashikuar nga ligji.

Kushti tjetër substancial është respektimi i lirisë morale të personit. Mosrespektimi i parimit të mësipërm çon automatikisht në papërdorshmërinë e njoftimit të përfutur. Në përputhje me këtë kusht nuk mund të konsiderohen prova atipike ato njoftime të marra nëpërmjet torturës, hipnozës, poligrafi etj. Ajo që duket e çuditshme është parashikimi se marrja e provës nuk duhet të cenojë *vullnetin* e personit.

Në qoftë se do ta interpretonim në mënyrë literale dispozitën, pra marrja e provës do të lidhej me vullnetin e personit, do të arrinim në përfundimin se, në qoftë se i pandehuri nuk dëshiron që të administrohet një provë atipike, pasi e vendos atë jashtë vullnetit personal, atëherë kjo provë nuk mund të merret dhe administrohet.

Jo vetëm kaq, por edhe në qoftë se vullneti do të ishte pozitiv, përsëri ky nuk mund të mjaftojë si kusht i mjaftueshëm për marrjen e provës, pasi nuk mund të përdoren as me pëlqimin e të pandehurit metoda apo teknika që do të çonin në cenimin e të drejtave të cilat janë absolute personale dhe nuk mund ti transferohen dikuj tjetër, (të paderogueshme).

Në këndvështrimin tonë, dispozita e nenit 149/2 të K. Pr. Penale duhet interpretuar në mënyrë logjike vetëm lidhur me të drejtat e të pandehurit në një proces të provuari, të drejta të cilat jo domosdoshmërisht janë të lidhura me vullnetin. Duhet të ketë qenë pikërisht ky qëllimi i ligjvënësit në disiplinimin e provave atipike.

Së fundmi, kushti procedural ka të bëjë me nevojën për të dëgjuar palët mbi mënyrën e marrjes së provës. Ky duket të jetë dhe një parashikim specifik i normës, i cili imponon një procedurë kontradiktore jo vetëm në fazën e administrimit të provës siç ndodh me provat tipike, por paraprakisht një procedurë dialektike për mënyrën e marrjes së saj.

Pyetja që natyrshëm ngrihet në këtë moment është: “Si do të përcaktohet papërdorshmëria e një prove atipike?”

Është e qartë se evidentimi i papërdorshmërisë në këto prova është pak më i komplikuar, kjo pasi Kodi i Procedurës Penale nuk parashikon rregula specifike për marrjen e këtyre provave dhe gjithashtu nuk ka qartësuar rolin e palëve dhe të gjyqtarit në përcaktimin e procedurave të marrjes së provës. Mosparashikimi i një procedure për marrjen e këtyre provave, bën shumë të vështirë kontrollin e një fushe, e cila, për vetë karakteristikat që mbart, duhet të jetë imtësisht e kontrollueshme. Për të evidentuar rastet e papërdorshmërisë së provës atipike do të ishte e nevojshme të kuptonim vetë karakteristikat e saj.

Provë atipike do të konsiderojmë ato prova të cilat merren në përputhje me standardet strikte të përcaktuara nga neni 149/2²⁵³, e padisiplinuar nga ligji, e re dhe e ndryshme nga ato të tipizuarat, por dhe një provë e cila synon një rezultat normalisht përkatës dhe

²⁵³ Nenet, 149/2 dhe 151/3 të Kodit të Procedurës Penale.

PROVAT DHE PROCESI I TË PROVUARIT NË PROCESIN PENAL

të një prove tipike. Atipikja karakterizon, pra, rezultatin e përfuar dhe jo mënyrën e marrjes së provës. Në këtë kuptim do të ishte më e përshtatshme të përkufizohej si provë “pa emër”, në kushtet që nuk korrespondon me asnjë nga mjetet tipike të parashikuara nga Kodi.

Megjithatë, po të kthehemi te Kodi i Procedurës Penale, ai përmban dy parashikime, të cilat, në këndvështrimin tonë, vijnë në kundërshtim me njëra-tjetrën. Kështu, ndërsa nga njëra jepet parimi i pranimit dhe të atyre provave të paparashikuara nga ligji, pra prova atipike, nga ana tjetër jepet një përkufizim dukshëm shterues i provave.

Ky nen përcakton se:

1. Prova janë njoftimet mbi faktet e rrethanat që lidhen me veprën penale, që merren prej burimeve të parashikuara në ligjin procedural penal, në përputhje me rregullat e caktuara prej tij dhe që shërbejnë për të vërtetuar kryerjen ose jo të veprës penale, pasojat e ardhura prej saj, fajësinë ose pafajësinë e të pandehurit dhe shkallën e përgjegjësisë së tij.

2. Kur kërkohet një provë që nuk rregullohet me ligj, gjykata mund ta marrë nëse prova vlen për të vërtetuar faktet dhe nuk cenon lirinë e vullnetit të personit. Gjykata vendos për marrjen e provës pasi dëgjon palët mbi mënyrën e marrjes së saj.

Një përcaktim i tillë mbyll dukshëm llojet e provave duke pranuar si të tilla vetëm ato të marra prej burimeve të parashikuara në ligjin procedural penal, në përputhje me rregullat e caktuara prej tij.

Dhe në fakt, ky parashikim, jo rrallëherë, ka çuar në një praktikë në mohim të atyre të dhënave të cilat do të ishin të pranueshme për vërtetimin e fakteve.

Në vendimin Nr. 145, datë 28.02.2007, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë,²⁵⁴ duke u nisur pikërisht nga një përkufizim që neni 149 i bën provës, është shprehur: *Siç rezulton nga aktet e administruara në gjykim, të gjykuarit kanë kërkuar të procedohet me gjykim të shkurtuar dhe Gjykata e Rrethit Durrës, pasi ka çmuar që çështja mund të zgjidhet në gjendjen që ishin aktet, ka pranuar kërkesën duke vazhduar gjykimin me rregullat e parashikuara në nenin 403 e vijues të K. Pr. Penale. Në dhënien e vendimit, gjykata e rrethit është mbështetur mbi provat që ndodheshin në fashikullin e hetimit dhe ka çmuar si prova ato që janë marrë sipas rregullave të caktuara në K. Pr. Penale nga organi i akuzës.*

Provohet së gjatë fazës së hetimeve paraprake, nga ana e mbrojtjes së të gjykuarit Hamdi Kodra, është paraqitur si provë një shkresë e lëshuar nga një spital i shtetit turk, sipas të cilit ky i gjykuar, ditën e ngjarjes, ka qenë i shtruar në këtë spital. Ndërkohë që Gjykata e Rrethit Durrës këtë shkresë nuk e ka përmendur fare si provë, nga ana e Gjykatës së Apelit Durrës, shkresa është çmuar si e tillë edhe pse ajo nuk është marrë në formën e kërkuar nga ligji.

Sipas parashikimeve të nenit 151/1 të K. Pr. Penale, provat gjatë hetimeve paraprake merren nga organi që procedon, sipas rregullave të caktuara në këtë Kod dhe në nenin 509 të këtij Kodi është përcaktuar si mënyra për marrjen e provave nga autoritete të huaja, letërporosia.

²⁵⁴ Vendim nr. 145, datë 28.02.2007, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë.

PROVAT DHE PROCESI I TË PROVUARIT NË PROCESIN PENAL

Sipas kësaj dispozite, si gjykata, ashtu edhe prokuroritë, letërporositë janë të detyruara t'ia drejtojnë Ministrisë së Drejtësisë, e cila merr masa për ta nisur. Ndërkohë rezulton se shkresa e lëshuar nga spitali turk nuk është marrë sipas rregullave të caktuara në Kod. Nga detyrimet që rrjedhin prej parashikimeve të nenit 151/4 të K. Pr. Penale, kjo shkresë nuk mund të përdoret si provë.

Duke qenë një provë e papërdorshme, por e përdorur dhe e çmuar në vendimin e Gjykatës së Apelit Durrës, kjo e bën këtë vendim të pavlefshëm, pasi vjen ndesh me kërkesat e nenit 152 dhe 380 të K. Pr. Penale.

Gjithashtu, në vendimin e tij Nr.148, datë 28.12.2005, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka arsyetuar se:

Arsyetimin e përmendur rreth gjendjes shëndetësore të kërkuesit, Gjykata e Apelit e bazoi vetëm në epikrizën, lëshuar nga mjeku ortoped i qendrës spitalore, dokument ky i cili nuk plotëson kërkesat e dispozitës së nenit 149 të K. Pr. Penale për të qenë provë në kuptimin që duhet të këtë ajo për t'u përdorur si e tillë në marrjen e vendimit gjyqësor.

...Kështu, për të marrë vlerën e provës, pro apo kundër vendimit për ndryshimin e masës së sigurimit personal që është caktuar për kërkuesin nga Gjykata e Shkallës së Parë është e nevojshme që ajo t'i nënshtrohet ekspertimit mjeko-ligjor, që është dhe një nga llojet e provave, parashikuar në seksionin VI të kreut II të K. Pr. Penale.²⁵⁵

Pavarësisht parashikimit të nenit të sipërcituar është vetë Kodi i Procedurës Penale, i cili ka lejuar paraqitjen e provave atipike në qoftë se ato kanë vlerë për vërtetimin e fakteve dhe nuk cenojnë lirinë e personit.

Minimalisht, Gjykata e Lartë, në vendimet e cituara, duhet të kishte analizuar nëse raporti i paraqitur nga palët plotëson apo jo kushtet për t'u administruar në proces si provë atipike, pasi fakti se një e dhënë nuk është marrë nga burimet e parashikuara në Kod, ashtu sikundër arsyetuar, nuk është shkak i mjaftueshëm për ta konsideruar si provë të përdorshme.

Një provë atipike do të jetë e papërdorshme vetëm kur cenon kushtet e vendosura nga legjislatori në nenin 151/3, si dhe kur synon nëpërmjet një mënyre atipike shmangien nga ato ndalime ligjore, të cilat janë të vendosura për një provë tipike.

Në të gjitha rastet e tjera, sipas nesh, kjo provë do të jetë e përdorshme. Në këtë rast duhet bërë dallimi mes provës së paligjshme, që merret në kundërshtim të hapur me parashikimet ligjore dhe asaj që nuk rregullohet me ligj, që merret sipas parashikimeve të bëra në nenin 149/2 të K. Pr. Penale. E them këtë gjë pasi edhe pasojat që vijnë në proces janë të ndryshme.

Nëse thamë që prova atipike është ajo provë e paparashikuar nga sistemi juridik, prova e paligjshme është provë tipike, por që është marrë në shkelje të një dispozite ligjore.

Në rastin e një prove të marrë në mënyrë të paligjshme, ligji parashikon papërdorshmërinë e tyre, duke kaluar fillimisht në fazën e pavlefshmërisë formale të aktit me të cilin ajo është pasqyruar dhe më pas edhe në rezultatin provues të saj, nëpërmjet papërdorshmërisë së provës.

²⁵⁵ Vendimi nr.148, datë 28.12.2005, i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

Në këtë kontekst, praktika gjyqësore e huaj, kryesisht italiane dhe amerikane, nëpërmjet vendimeve gjyqësore të Gjykatave të tyre të Larta, kanë arritur në konkluzionin se ekziston e ashtuquajtura papërdorshmëri e prejardhur edhe në lidhje me provat e tjera të marra në reaksion zinxhir në lidhje me provën e parë të marrë në mënyrë të paligjshme.

P.sh., sasia e lëndës narkotike e marrë dhe e sekuestruar në kundërshtim me rregullat procedurale, nuk e bën të vlefshëm rezultatin e aktit të ekspertimit në lidhje me verifikimin e saj se çfarë lloj lënde është dhe çfarë përqendrimi të principit aktiv të saj ka ajo.

Teoria e së të drejtës procedurale penale parashikon edhe të ashtuquajturën provë jokushtetuese, dhe pikërisht provën atipike, që në nenin 149/2 të K. Pr. Penale parashikohet si e tillë.

Në aspektin e Kushtetutës ku ne jemi një Republikë Parlamentare Demokratike, ku shteti dhe e drejta përbëjnë bazën dhe kufijtë e veprimtarisë së shtetit, normat ligjore duhet të bëjnë dhe parashikimin e mënyrës së marrjes së provave. Në fakt, dispozitat ligjore procedurale janë të papërcaktuara dhe nuk kanë karakter konkret, duke lënë mundësinë e një interpretimi zgjerues e ngushtues në varësi të interesit të palëve pjesëmarrëse në proces, por gjithsesi duke vendosur disa parime të cilat rrjedhin që nga kushtetuta, konventat e aktet ndërkombëtare, si dhe vetë ligji procedural, duke bërë të mundur që me atë të interpretimit e analogjisë të arrihet në një konkluzion për çdo rast që paraqitet për zgjidhje.

❖ **Prova të plota dhe prova jo të plota**

*Ky klasifikim bëhet në bazë të faktit e peshës me të cilën njoftohet e vërteta e faktit konstatues. Provë e plotë, konsiderohet ajo provë e cila, në tërësi, provon të vërtetën e faktit konstatues, kurse provë jo e plotë do të konsiderohet ajo provë e cila faktin konstatues e vërteton pjesërisht.*²⁵⁶

Sipas këtij klasifikimi, ligjvënësi që më parë me ligj përcaktonte vlerën provuese të çdo prove dhe në momentin që prova gëzonte epitetin e provës së plotë, duhej të konsiderohej e zbuluar e vërteta e faktit konstatues.

❖ **Prova origjinale dhe të prejardhura**

Kjo ndarje e provave është bërë në bazë të burimit të të dhënave me të cilat vërtetohen faktet. Provë origjinale është ajo provë e cila merret drejtpërsëdrejti nga burimi i saj, p.sh., një dokument origjinal ose faktet e veprës penale janë perceptuar drejtpërdrejt nga shqisat, p.sh., dëshmia e dëshmitarit okular.

Por disa prova nuk mund të sillen gjithmonë në sallën e gjykimit, pasi mund të jenë shumë të mëdha, shumë të rrezikshme, si eksplozivë, materiale kimike apo biologjike,

²⁵⁶ Ejup Sahiti, "Argumentimi në procedurën penale", botim I, 2006, fq. 113.

PROVAT DHE PROCESI I TË PROVUARIT NË PROCESIN PENAL

*ose për shkak se provat origjinale mund të mos jenë në dispozicion. Prandaj krijohen prova të prejardhura apo, siç i përkufizon ndryshe Jon Simbert, prova zëvendësuese*²⁵⁷. Pra, provë e prejardhur konsiderohet prova e cila rrjedh nga ndonjë burim tjetër jo i drejtpërdrejtë dhe shërbejnë për zbulimin e provave origjinale.

Por ashtu sikurse provat materiale, edhe provat zëvendësuese mund të trajtohen me të njëjtin besim dhe siguri si origjinali, vetëm nëse ka informacion të mjaftueshëm shtesë në lidhje me burimin e tyre dhe nëse është një paraqitje e saktë e dokumentit apo skenës origjinale.

3.2. LLOJET E PROVAVE PENALE NË PROCESIN PENAL

Kodi i Procedurës Penale ka normuar si provat kryesore në procesin penal: **dëshminë, thëniet e të pandehurve dhe palëve private, ballafaqimet, njohjet, eksperimentin, ekspertimin, provat materiale dhe dokumentet.**

Ajo çka duhet të theksohet është se standardi i vendosur nga ligjvënësi në trajtimin me kujdes të veçantë në respektimin e të drejtave dhe detyrimeve të subjekteve të procedimit penal në marrjen, administrimin dhe vlerësimin e njoftimeve objekt provë në procesin penal, në përputhje me standardet kushtetuese dhe aktet ndërkombëtare, dhe dispozitat e Kodit të Procedurës Penale.

Siç u tha më sipër, provat janë mjete të parashikuara në ligj, të cilat shërbejnë për të konstatuar faktet gjatë procesit civil/penal dhe për të zgjidhur në bazë të ligjit mosmarrëveshjet juridike - civile/penale. Provat janë të ndryshme dhe, si të tilla, mund të klasifikohen sipas kriterëve të ndryshme, në disa kategori.

Duke u nisur nga ndarja më e përgjithshme dhe të drejtës procedurale civile, provat ndahen sipas burimeve të tyre të parashikuara në ligj: **pohimet e palëve, dëshmitarët, shkresat, eksperti, këqyrja, eksperimenti.**

Teoria ka bërë ndarjen e provave sipas disa kriterëve për efekt studimi dhe për të lehtësuar vlerësimin e tyre. Kështu, një kriter i ndarjes së tyre është cilësia e burimit të tyre. Sipas këtij kriteri, provat ndahen në prova që e kanë prejardhjen nga personat fizikë ose juridikë, si palët, personat e tretë, thëniet e dëshmitarëve, ekspertët dhe që janë quajtur prova personale dhe në prova, burimi i të cilave janë sendet e botës materiale që ruajnë mbi vete gjurmë të fakteve, ngjarjeve me vlerë për gjykatë dhe që janë quajtur prova materiale.

Mbi provat materiale, gjykata merr njoftim të drejtpërdrejtë, ndërsa provat personale i njoftohen gjykatës nga persona të tjerë.

Sipas kohës së formimit, provat ndahen në prova të formuara më përpara procesit gjyqësor, siç është shkresa, dhe prova që formohen gjatë procesit gjyqësor, siç është dëgjimi i dëshmitarëve.

Sipas kriterit të mënyrës së formimit, provat ndahen në kryesore dhe të thjeshta. Kryesore janë ato prova që dalin nga burimi i parë, si p.sh. thëniet e dëshmitarëve që e kanë parë ngjarjen me sy, shkresa zyrtare origjinale etj.

²⁵⁷ Jon Simbert, "Parimi i provave" <http://www.brrln.org/uploads/documents/219/alb.pdf> fq 39

Të thjeshta ose të tërthorta janë ato prova kur lidhja midis faktit që kërkohet të provohet dhe provës nuk është e drejtpërdrejtë, por e tërthortë.

Një kriter tjetër është ai që bën ndarjen në provë direkte dhe të kundërt. Prova direkte është ajo që ka për qëllim të provojë vërtetësinë e një fakti, ndërsa prova e kundërt është ajo që ka për qëllim të provojë inekzistencën e një fakti të tillë.

3.2.1. DËSHMIA

Dëshmia si provë parashikohet në dispozitat e kreut II (sek. I) të Titullit IV të K. Pr. Penale, neni 150 e vijues i tij duke përcaktuar objektin, kufijtë, llojet, zotësinë për të dëshmuar, si dhe të drejtat e detyrimit e dëshmitarit.

Së pari, kur flasim për dëshmi të dëshmitarëve, duhet të kuptojmë se dëshmitari nuk është as kompjuter dhe as segment automatikisht i vërtetë që prokurori thjesht mund ta thërrasë në gjykatë të dëshmojë. Ndonjëherë, kujtimet nuk funksionojnë ashtu. Disa ngjarje apo fakte janë shumë të mëdha për t'u harruar, mirëpo vijnë me pengesa. Disa ngjarje janë rutinore ose shumë të zakonata për t'u mbajtur mend.²⁵⁸

Sipas prof. Ejup Sahiti: *Me deklaratë të dëshmitarit kuptohet deklarimi i personit fizik përkitazi me perceptimet shqisore në lidhje me faktet e rëndësishme nga e kaluara para organit kompetent në formë të caktuar procedurale.²⁵⁹*

Ndërsa në të drejtën procedurale franceze, dëshmia si provë në procesin penal paraqitet me një rol kyç, duke e konsideruar si një provë të shkëlqyer²⁶⁰. Dëshmitari është i detyruar të dëshmojë para gjykatës për atë që di. Refuzimi i dhënies së dëshmisë konsiderohet kundravajtje.

Sipas të drejtës angleze, dëshmia e dëshmitarit para gjykatës merret nën formulën e betimit (*must be given to oath*), refuzimi i së cilës e bën këtë dëshmitar jo kompetent dhe, si i tillë, nuk pranohet nga gjykata.

Dëshmia është proces i të provuarit të faktit penal nëpërmjet të thënit gojarisht të asaj çfarë ai ka parë apo perceptuar dhe që ka lidhje me akuzën, me subjektin që po procedohet dhe që ndikon në përcaktimin e normës procedurale që do të zbatohet.

Të dhënat që jep dëshmitari kanë karakter subjektiv, pasi lidhen me aftësinë e tij të perceptimit, shkallën e intelektit, aftësitë psiko-fizike të kujtesës etj.

Objekti i dëshmisë përcaktohet nga parashikimet e përgjithshme të nenit 150 dhe ato specifike të nenit 153 të K. Pr. Penale. Kështu, dëshmitari mund të pyetet e të dëshmojë për:

- a - njoftime të rrethanave të faktit juridik-penal të perceptuara drejtpërdrejt nga ai dhe që nuk janë rezultat i vlerësimit të tij subjektiv;*
- b - për rrethana të cilat lidhen me vërtetësinë dhe besueshmërinë e dëshmisë së tij;*
- c - fakte që shërbejnë për përcaktimin e personalitetit të të pandehurit në lidhje me veprën penale dhe shkallën e rrezikshmërisë së tij shoqërore;*

²⁵⁸ Jon Simbert, "Parimi i provave" <http://www.brrln.org/uploads/documents/219/alb.pdf>

²⁵⁹ Ejup Sahiti, fq. 233.

²⁶⁰ Kodi i Procedurës Penale franceze.

PROVAT DHE PROCESI I TË PROVUARIT NË PROCESIN PENAL

d - njoftime të rrethanave të faktit juridik të perceptuara dhe të mësuara nga persona të tjerë.

Gjithashtu, objekt i dëshmisë mund të jetë dhe çdo fakt që ka lidhje me personalitetin e të pandehurit, rrezikshmërinë shoqërore që ai paraqet dhe që ka lidhje të drejtpërdrejtë me veprën penale për të cilën akuzohet.²⁶¹

Sipas Kodit të Procedurës Penale, dëshmia e dhënë, në referim të rrethanave dhe fakteve që njoftohen nga dëshmitari, mund të klasifikohet si provë direkte apo indirekte.

Dëshmia konsiderohet provë direkte atëherë kur personi dëshmon mbi atë çfarë ai ka parë apo dëgjuar personalisht vetë - drejtpërdrejt lidhur me faktin dhe autorin e veprës penale. Prova dëshmuar përbëhet nga pohime me shkrim ose me gojë nga dëshmitari. Dëshmitari duhet t'i deklarojë faktet dhe rrethanat e perceptuara në mënyrë të saktë dhe jo kontradiktore me deklaratimet e dhëna gjatë fazës së hetimeve paraprake, në të kundërt gjykata duhet të vlerësojë besueshmërinë e thënies dhe dëshmitarit. Kështu, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në vendimin Nr. 240²⁶², datë 28.05.2008, është shprehur se: *Vihet re se, kryesisht, fajësia e të gjykuarve dhe ndërtimi i ngjarjes në tërësi, është bërë mbi deklaratimet e së dëmtuarës R. K., edhe se kjo dëshmitare nuk ka qenë konsekuente në shpjegimet e saj dhe në gjykim ka mohuar deklaratimet e bëra para oficerit të policisë gjyqësore dhe me vendimin nr. 1163, datë 30.11.2006, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, është deklaruar fajtorë dhe dënuar për veprën penale të dëshmisë së rreme, parashikuar nga neni 306/1 i K. Penal, pikërisht për dëshmitë e dhëna në procesin gjyqësor që lidhet me të gjykuarit A. T. e L. B. Duke mos hyrë në analizën dhe çmuarjen e provave, ky Kolegji konstaton se, megjithë rishqyrtimet e bëra, gjykatat nuk kanë mundur të mënjanojnë kontradiktat që ekzistojnë midis thënies e deklaratimeve të gjithë dëshmitarëve të pyetur rreth çështjes, të cilët, sikurse edhe e dëmtuara R. K., kanë ndryshuar herë mbas here dëshmitë e tyre...*

Ndërsa në rastet kur dëshmitari dëshmon mbi bazën e të dhënave të njohura nëpërmjet të të tretëve konsiderohet si provë indirekte. Në këto raste, që kjo lloj prove të marrë fuqi ligjore duhet patjetër që personi të tregojë dhe burimin e kësaj prove.

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë në vendimin Nr. 60, datë 06.02.2008, arsyeton se: *me të drejtë nga gjykatat është vlerësuar si provë fajësie dëshmia indirekte e bashkëshortes së viktimës, dëshmitares D. B., e cila ka dëshmuar duke iu referuar thënies të dëshmitarëve burim i parë, E. D. dhe N. U., të cilët kanë dëshmuar dhe njëkohësisht kanë konfirmuar dëshminë indirekte të D. B.*²⁶³

Për këtë arsye, gjykata dëshminë e dhënë dhe rëndësinë e njoftimeve të përfuara, duhet ta vlerësojë në unanimitet me provat e tjera të shqyrtuara gjatë procesit gjyqësor.

*Formimi i kësaj prove mbetet i vakët dhe nuk posedon energji të mjaftueshme për të krijuar bindje për ekzistencën e faktit, dhe, në rast se dëshmitari që e relatton atë refuzon apo nuk është në gjendje të tregojë personin a burimin nga i cili ka marrë dijeni për faktin, sjell si pasojë papërdorshmërinë e saj.*²⁶⁴

²⁶¹ Dhimitër Lara, Koment mbi Kodin e Procedurës Penale, fq. 529.

²⁶² Vendimi nr. 240, datë 28.05.2005, i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

²⁶³ Vendimi Nr. 60, datë 06.02.2008, i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

²⁶⁴ Dhimitër Lara, fq. 531.

PROVAT DHE PROCESI I TË PROVUARIT NË PROCESIN PENAL

Në praktikën e saj të konsoliduar, GJEDNJ-ja²⁶⁵ thekson se një provë e marrë nëpërmjet dëshmisë indirekte nuk mund të jetë determinante pa marrë dëshminë e dëshmitarit burim i parë.

Të njëjtin qëndrimin ka mbajtur dhe Gjykata e Lartë duke cituar se: *dëshmia e dëshmitarit R. B., me të drejtë, nuk është vënë nga Gjykata e Apelit në themel të arsyetimit dhe vendimit të saj, pasi nga kjo gjykatë, në bazë të nenit 154/4 të K. Pr. Penale, ajo dëshmi nuk mund të përdoret si provë, pasi ky dëshmitar nuk ishte në gjendje të tregojë personin ose burimin nga të cilët ka marrë dijeni për faktet që pyetet e dëshmon.*²⁶⁶

Prova dëshmuuese mund të jetë e besueshme nëse dëshmitari ka baza të ketë vëzhguar ngjarjen; është i besueshëm, objektiv, konsistent dhe mbështetet në kushte të qarta për të vëzhguar dhe mbajtur mend ngjarjen.

*Besueshmëria e dëshmitarit mund të kundërshtohet duke e pyetur për bazën e deklaratës, nëse ai ka mundur të perceptojë ngjarjen që përshkruan, nëse ka ndonjë paragjykim, saktësinë e kujtesës së tij ose gjasat që gënjen. Fuqia provuese e dëshmitarit ose provat mund të varen nga përputhja e tyre me pritsshmëritë normale, konsistencën e brendshme, provat vërtetuese ose nëse konkluzioni është logjik.*²⁶⁷

Marrja e dëshmisë si provë në procesin penal dhe vlefshmëria e saj është e kushtëzuar nga zbatimi me rigorozitetin i normave procedurale në lidhje me vendin, kohën e marrjes në pyetje, organin i cili merr dëshminë, përgjegjësinë penale për deklaram të rremë etj. Gjatë marrjes në pyetje të dëshmitarit është i ndaluar përdorimi i pyetjeve sugjестive, përdorimi i dhunës, kanosjes apo mashtrimit. GJEDNJ-ja ka çmuar se provat materiale të siguruara me anë të akteve të dhunës nuk duhet asnjëherë, cilado qoftë vlera e tyre bindëse, të merren si referencë për të provuar fajësinë e personit.

Në çështjen Gäfgen kundër Gjermanisë – GJEDNJ-ja shprehet se: *Për përdorimin në proces të provave materiale të siguruara drejtpërdrejt me anën e keqtrajtimit, GJEDNJ-ja ka çmuar se provat materiale të siguruara me anë të akteve të dhunës nuk duhet asnjëherë, cilado qoftë vlera e tyre bindëse, të merren si referencë për të provuar fajësinë e personit.*²⁶⁸

Në çështjen Jalloh vs Germany - Gjykata është shprehur se ka pasur shkelje të Nenit 3 dhe 6 të KEDNJ-së lidhur me mënyrën e marrjes së provës, pasi çdo ndërhyrje në integritetin fizik të një personi të kryer me qëllim të marrjes së provave duhet të ishte subjekt i shqyrtimit të rreptë. *Autoritetet gjermane e kishin nënshtruar kërkuesin para një ndërhyrje të rëndë të integritetit të tij fizik dhe mendor kundër vullnetit të tij. Ata e kishin detyruar atë të merrte substanca psikotrope jo për shkaqe terapeutike, por për të marrë dëshmi që mund të merrnin me të njëjtën vlerë provuese me metoda më pak të rrezikshme.*²⁶⁹

Standardet e vendosura nga legjislati procedural shqiptar, burojnë nga garancitë kushtetuese të parashikuara nga neni 32/1 i Kushtetutës, garanci këto të cilat janë më të

²⁶⁵Vendimi i GJEDNJ-së, datë 17.11.2005, në çështjen Haas kundër Gjermanisë.

²⁶⁶ Vendimi Nr. 886, datë 20.10.2010, i Kolegjit Penal i Gjykatës së Lartë.

²⁶⁷ Jon Simbert, Parimi i provave.

²⁶⁸ Në çështjen Gäfgen kundër Gjermanisë – GJEDNJ.

²⁶⁹Vendimi i GJEDNJ-së Jalloh vs Germany.

gjera, sepse ato përfshijnë edhe të drejtën që ka individit për të mos dëshmuar ndaj familjarëve të tij.

Gjithashtu, pala e cila ka kërkuar thirrjen e dëshmitarit, me qëllim të mbështetjes së dëshmisë mund t'i paraqesë edhe provën materiale (dokumente, tabela, përmbledhje procesverbalesh, videokaseta, audiokaseta apo prova të tjera materiale), për ta identifikuar dhe për të shpjeguar si është krijuar prova, dhe të vërtetojë se prova është e vërtetë e bazuar dhe paraqet saktësisht provën e pranueshme origjinale.

Baza për një dëshmitar që të dëshmojë përfshin aftësinë dhe kufizimet e dëshmitarit për të vëzhguar ngjarje, shpejtësinë apo konfuzionin e ngjarjeve, ose vëmendjen që dëshmitari i ka kushtuar ngjarjeve. Dëshmitarët mund të ofrojnë informacion të shkëlqyer për veprën penale, rrethanat lehtësuese ose rrethanat rënduese, asetet që do të konfiskohen, dëmet apo çështje të tjera me rëndësi.

*Thëniet e bëra më parë nga dëshmitari para prokurorit ose policisë gjyqësore dhe që ndodhen në fashikull të prokurorisë mund të përdoren në gjykim për ta kundërshtuar pjesërisht ose tërësisht dëshminë, por vetëm pasi dëshmitari ka dëshmuar për faktet që i kundërshton. Pas marrjes së drejtpërdrejtë në pyetje të dëshmitarit, palës e cila ka paraqitur provën, i jepet mundësia në fund që të sqarojë përgjigjet me dëshmitarin ose të rehabilitojë besueshmërinë e dëshmitarit.*²⁷⁰

Sidoqoftë, është me rëndësi të njihen kufizimet e dëshmisë së dëshmitarëve. Neni 155²⁷¹ i Kodit të Procedurës Penale, parashikon se çdo person ka zotësi për të dëshmuar, me përjashtim të atyre që, për shkak të të metave mendore ose fizike, nuk janë në gjendje të dëshmojnë.

Në nenin 156²⁷² të Kodit të Procedurës Penale, ndryshuar me ligjin 35/2017, përcaktohet se:

1. *Nuk mund të pyeten si dëshmitarë:*

- a) *personat që, për shkak të aftësive të kufizuara fizike ose psikike, nuk janë në gjendje të bëjnë dëshmi të rregullt;*
- b) *të pandehurit në një veprë penale të përbashkët ose në një procedim të lidhur, kur ndaj tyre është dhënë vendimi i mosfillimit të procedimit, i pushimit të akuzës ose çështjes, ose i dënimit, duke përfshirë edhe rastet e gjykimit me marrëveshje dhe të urdhrit penal të dënimit, me përjashtim të rasteve kur vendimi i pafajësisë ka marrë formë të prerë;*
- c) *ata që në të njëjtin procedim kryejnë ose kanë kryer funksionin e gjyqtarit, ose të prokurorit;*
- ç) *i padituri civil dhe personi civilisht përgjegjës për dëmin e shkaktuar nga i pandehuri.*

2. *Rregulli i parashikuar në shkronjën "b", të paragrafit 1, nuk gjen zbatim për bashkëpunëtorin e drejtësisë, i cili pyetet në çdo rast në cilësinë e dëshmitarit, sipas nenit 36/a të këtij Kodi.*

²⁷⁰ Prof. dr. sc. Ejup Sahiti; Prof. dr. sc. Rexhep Murati; Mr. Xhevdet Elshani, fq. 799.

²⁷¹ Kodi i Procedurës Penale, neni 155.

²⁷² Kodi i Procedurës Penale, neni 156.

Në këtë rast, Gjykata, kur e çmon të arsyeshme, urdhëron të bëhen verifikimet për aftësitë fizike dhe mendore të tij për të dhënë dëshmi. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në vendimin Nr. 630, datë 25.11.2011 ka arsyetuar se: *Për verifikimin e zotësisë për të dëshmuar, aftësi mendore të dëshmitarit për të bërë dëshmi, gjykata, edhe kryesisht, mund të urdhërojë verifikimet përkatëse duke kërkuar konkluzione nga specialistët përkatës (ekspertët) dhe jo të nxjerrë vetë konkluzione mbi gjendjen shëndetësore të dëshmitarit...*

Edhe nëse këta persona kanë dëshmuar përpara gjykatës dhe shkaqet e papajtueshmërisë nuk janë njohur, dëshmia e dhënë prej tyre është e papërdorshme. Papajtueshmëria e parashikuar nga pika "a" e kësaj dispozite, lidhet me parashikimet e nenit 155/1 të K. Pr. Penale për shkak të mungesës së zotësisë për të dëshmuar.

Pranimi apo refuzimi nga ana e gjykatës për të thirrur në cilësinë e dëshmitarit këtë kategori personash nuk duhet të mbështetet vetëm në përcaktimet ndaluese ligjore, por edhe në faktin se sa këta persona mund të ofrojnë të dhëna të dobishme për çështjen penale. *Prova dëshmuuese mund të jetë e besueshme nëse dëshmitari ka baza që të ketë vëzhguar ngjarjen, është i besueshëm, objektiv, konsistent dhe mbështetet në kushte të qarta për të vëzhguar dhe mbajtur mend ngjarjen.*²⁷³

Në përcaktimin e nenit 156/1 pika "a": *...për shkak të të metave fizike ose psikike... nuk përfshihen shurdhmemecët, pasi ata deklarimet dhe dëshminë e tyre e japin në përputhje me kërkesat e parashikuara në nenin 107 të K. Pr. Penale.*

*Në këtë rast, Gjykata ka të drejtë dhe diskrecionin që, mbi bazën e besueshmërisë së burimit të provës, të përshtatë bindjen e tij mbi rrethanat e faktit mbi të cilat është dhënë kjo dëshmi.*²⁷⁴

Në marrjen e deklarimeve apo dëshmisë nga personi që nuk njih gjuhën shqipe, respektohen kërkesat e parashikuara nga neni 8/2 dhe 126 i K. Pr. Penale, mbi praninë dhe ndihmën e specializuar të përkthyesit të gjuhës që njih dëshmitari.

Gjykata Kushtetuese në Vendimin nr. 57, datë 21.12.2012, citon: *Konkretisht, mbrojtësit kanë kërkuar deklarimin si të pavlefshëm të vendimeve "Për caktimin e përkthyesit", të datave 01.10.2007 dhe 02.10.2007, pasi janë marrë në shkelje të neneve: 123, 125, 126, 138, 179/2, 183 të KPP-së. Sipas tyre, në fashikullin hetimor nuk gjendet e depozituar asnjë deklaratë me shkrim e shtetasit të huaj që nuk njih gjuhën shqipe dhe asnjë dokument që të vërtetojë identitetin e personave të caktuar si përkthyes dhe faktin që ata e gëzojnë të drejtën ligjore për të ushtruar një detyrë të tillë. Në këto kushte, kërkesit i është privuar e drejta e njoftimit dhe, për rrjedhojë, e drejta e paraqitjes së kërkesës për përjashtimin e përkthyesit.*

Që të ketë vlerë ligjore, prova e përfutur nga përkthyesi kërkon detyrimisht që përkthimi të realizohet nga përkthyes të licencuar dhe subjekti i cili po hetohet të njoftohet për caktimin e këtij përkthyesi.

Për sa i përket moshës, ligjvënësi nuk ka parashikuar asnjë kufizim për të dëshmuar, dhe për këtë arsye, edhe fëmijët e vegjël mund të dëshmojnë. Në këtë rast, ligjvënësi ka parashikuar procedura të veçanta të pyetjes së tyre, si dhe rregulla për pjesëmarrjen

²⁷³ Jon Simbert, Parimi i provave.

²⁷⁴ Dhimitër Lara, Koment mbi Kodin e Procedurës Penale, fq. 535.

PROVAT DHE PROCESI I TË PROVUARIT NË PROCESIN PENAL

e tyre në proces me ndihmë të kualifikuar psikologjike, mjekësore apo praninë e personave të caktuar të familjes, si dhe shmangien e kontaktit me personat, qofshin këta edhe anëtarët e trupit gjykues.

*Por ky përcaktim nuk duhet parë i pakushtëzuar nga disa faktorë të tjerë, si zhvillimi i tij mendor dhe shpirtëror, sa i aftë është ai të perceptojë rëndësinë e faktit dhe sa i aftë është për të treguar të vërtetën.*²⁷⁵

Konventa Evropiane për të Drejtat e Fëmijëve²⁷⁶ në Nenin 13 përcakton shprehimisht se:

1. Fëmija ka të drejtën e lirisë së shprehjes; kjo e drejtë përfshin lirinë për të kërkuar, për të marrë dhe për të përcjellë informacione dhe ide të çdo lloji, pa marrë parasysh kufijtë, në formë gojore, të shkruar, të shtypur ose artistike, ose me çdo mjet tjetër komunikimi të zgjedhur nga fëmija.
2. Ushtrimi i kësaj të drejte mund t'i nënshtrohet disa kufizimeve, por vetëm kur përcaktohen me ligj dhe janë të domosdoshme për:
 - a) respektimin e të drejtave ose të reputacionit të të tjerëve; ose
 - b) mbrojtjen e sigurimit kombëtar, të rendit publik, të shëndetit ose të moralit publik.Gjithashtu, Konventa e Këshillit të Evropës për “Mbrojtjen e Fëmijëve nga Shfrytëzimi Seksual dhe Abuzimi Seksual”²⁷⁷ përcakton se:
 - 1 Çdo palë merr masat e nevojshme legjislative ose masa të tjera për të mbrojtur të drejtat dhe interesat e viktimave, duke përfshirë dhe nevojat e tyre të veçanta si dëshmitarë në të gjitha etapat e hetimeve dhe proceseve penale.

Neni 35 – Intervistimi i fëmijëve.

1. Çdo palë merr masat e nevojshme legjislative ose masa të tjera për t'u siguruar që:
 - a) intervistat me fëmijët zhvillohen pa vonesa të pajustificuar pas raportimit të fakteve tek organet përkatëse;
 - b) intervistat me fëmijët zhvillohen, kur është e nevojshme, në ambiente të projektuara ose të përshtatura për këtë qëllim;
 - c) intervistat me fëmijët kryhen nga profesionistë të trajnuar për këtë qëllim;
 - d) nëse është e mundur dhe e përshtatshme, intervistat me fëmijët kryhen nga të njëjtët persona;
 - e) numri i intervistave është sa më i kufizuar të jetë e mundur dhe aq sa është absolutisht i nevojshëm për qëllimet e proceseve penale;
 - f) fëmija mund të shoqërohet nga përfaqësuesi i tij/saj ligjor, ose, kur shihet e përshtatshme, nga një i rritur i përzgjedhur prej tij/saj, me përjashtim të rasteve kur merret një vendim i arsyetuar i ndryshëm për përfaqësimin e tyre.Çdo palë siguron se informacioni që u jepet viktimave në përputhje me dispozitat e këtij neni ofrohet në mënyrë të tillë që është e përshtatshme për moshën dhe pjekurinë e tyre dhe në një gjuhë që është e kuptueshme për ta.²⁷⁸

Në paragrafin e dytë të nenit 157 të KPP-së është përjashtuar nga detyrimi për të dëshmuar personi, dëshmia e të cilit mund të sjellë përgjegjësi penale për të. E drejta

²⁷⁵ Ejup Sahiti, “Argumentimi në procedurën penale”, fq. 240.

²⁷⁶ Konventa Evropiane për të Drejtat e Fëmijëve / RSH. Kuvendi - Tiranë: Qendra e Publikimeve Zyrtare, 2016.

²⁷⁷ Konventa e Këshillit të Evropës për “Mbrojtjen e Fëmijëve nga Shfrytëzimi Seksual dhe Abuzimi Seksual”.

²⁷⁸ CETS 201 – Mbrojtja e Fëmijëve nga Shfrytëzimi Seksual dhe Abuzimi Seksual, 25.X.2007.

për të mos dëshmuar për fakte që mund të sjellin përgjegjësi për deklaruesin përbën një parim kushtetues, sanksionuar në Nenin 32/1 të Kushtetutës: *Askush nuk mund të detyrohet të dëshmojë kundër vetes ose familjes së vet dhe as të pohojë fajësinë e tij*²⁷⁹, si dhe nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Sipas GJEDNJ-së²⁸⁰: *e drejta për të mos u vetëkriminaluar përbën thelbin e nocionit të procesit të rregullt ligjor dhe ka si qëllim respektimin e vullnetit të personit për të mos folur. Gjykata është shprehur se e drejta për seancë të drejtë gjyqësore në çështjet penale përfshin “të drejtën e gjithsecilit të akuzuar për një kundravajtje penale...të mos flasë dhe të mos kontribuojë në vetinkriminimin e tij.*

Në çështjen e Saunders kundër Mbretërisë së Bashkuar, gjykata deklaroi se: *Gjykata kujton se, megjithëse jo specifikisht është përmendur në Nenin 6 të Konventës, e drejta për të mos folur dhe e drejta për të mos u vetëkriminaluar janë zakonisht standarde të njohura ndërkombëtare që qëndrojnë në thelbin e nocionit të një procedure të drejtë sipas Nenit 6. Parimi i tyre bazë ndërmjet të tjerave qëndron në mbrojtjen e të akuzuarit kundrejt detyrimit të padrejtë nga autoritetet duke kontribuar në shmangien e gabimeve të drejtësisë dhe në përmbushjen e synimeve të Nenit 6... E drejta për të mos inkriminuar vetveten, në veçanti, presupozon që gjyqi në një çështje penale kërkon që të provojë akuzën kundër të pandehurit pa u mbështetur në provat e përfuara nëpërmjet metodave të detyrimit apo dominimit në mbrojtje të vullnetit të të akuzuarit. Në këtë sens, e drejta është e lidhur ngushtë me prezumimin e pafajësisë në përmbajtje të Nenit 6 (2) të Konventës. E drejta për të mos kontribuar në vetinkriminim ka lidhje kryesisht me respektimin e vullnetit të një të akuzuari për të mos folur.*²⁸¹

*Rolit të dëshmitarit nuk mund t'i bashkëngjitet kurrfare roli tjetër përveç roli i të dëmtuarit në një procedim penal apo dhe civil.*²⁸²

I dëmtuari, në këtë rast, paraqitet si dëshmitar okular dhe, si rrjedhojë, dëshmia e tij ka një rol kyç në zhvillimin e hetimeve, pasi percepton në mënyrë të plotë ngjarjen dhe aftësia e tij për të mbajtur mend detajet është më e madhe. Megjithatë, kjo nuk duhet perceptuar si një e vërtetë absolute, pasi deklarimi i tij në cilësinë e të dëmtuarit shpeshherë mund të jetë dhe joobjektive.

Dispozita e Kodit të Procedurës Penale ka normuar dhe të drejtën e një rrethi personash, të cilët nuk janë të detyruar për të dëshmuar. Kështu, Neni 158²⁸³ i Kodit të Procedurës Penale parashikon se nuk janë të detyruar të dëshmojnë: *a) gjinia ose krushqia e afërt e të pandehurit, sipas përcaktimeve të nenit 16, me përjashtim të rasteve kur kanë bërë kallëzim ose ankim, ose kur ata, apo një i afërm i tyre, janë të dëmtuar nga vepra penale; b) bashkëshorti për faktet e mësuara nga i pandehuri gjatë jetës bashkëshortore; c) bashkëshorti i ndarë nga i pandehuri; ç) ai që, edhe pse nuk është bashkëshort i të pandehurit, bashkëjeton ose ka bashkëjetuar me të; d) ai që është i lidhur me të pandehurin me marrëdhënie birësimi.*

²⁷⁹Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.

²⁸⁰ Vendimi i GJEDNJ-së, Funke kundër Francës, 25 shkurt 1993.

²⁸¹ Saunders kundër Mbretërisë së Bashkuar, 17 dhjetor 1996.

²⁸² Ejup Sahiti, fq. 234.

²⁸³ Kodi i Procedurës Penale, neni 158.

Me ndryshimet e pësuara nga ligji nr. 35/2017, datë 30.3.2017, është shtuar pika 1/1. Përjashtimi nga detyrimi për të dëshmuar nuk zbatohet kur personat e përmendur në paragrafin 1, të këtij neni, kanë bërë kallëzim ose ankim, ose kur ata, ose një anëtar i familjes së tyre, është viktimë e veprës penale.

E drejta për të dëshmuar ose jo ushtrohet nga këta dëshmitarë, bazuar në qëndrimin dhe vullnetin e tyre për të dëshmuar në seancë gjyqësore. Në rast se këta dëshmitarë heqin dorë nga kjo e drejtë për të mos dëshmuar, atëherë ai barazohet me dëshmitarët e tjerë për nga pozita procedurale. Lidhur me ushtrimin e kësaj të drejte, Gjykata e Lartë, në praktikën e saj, ka arsyetuar se: *Në seancë gjyqësore, nga ana e gjykatës, ata janë njoftuar mbi të drejtën për të mos dëshmuar dhe, pasi nuk kanë dashur të përfitojnë nga kjo e drejtë, gjykata ka proceduar me marrjen e dëshmisë.*²⁸⁴

Detyrimet dhe kërkesat e kësaj dispozite të përgjithshme rrjedhimisht zbatohen edhe në fazën e hetimit paraprak në marrjen e deklarimeve nga policia gjyqësore dhe prokurori.

Ligjvënësi, duke iu njohur një status të veçantë bashkëshortit, ish-bashkëshortit, bashkëjetuesit apo personit të lidhur në birësim me të pandehurin, e ka bërë të detyrueshme për organin procedues që në çdo rast, edhe kur kallëzimi i veprës penale të jetë kryer nga këto subjekte, në momentin e administrimit të dëshmisë, atyre duhet detyrimisht t'i bëhet e njohur e drejta për të mos dëshmuar.

Në praktikën gjyqësore, problem në aspektin procedural përbën rrethi i personave që jetojnë dhe bashkëjetojnë me të akuzuarin, si dhe rastet e veprave penale të përbëra, ku të dy personat shfaqen me cilësitë e të akuzuarve dhe viktimave në procesin penal. Në lidhje me këtë fakt, duhet mbajtur parasysh edhe parashikimi i bërë në Kodin e Familjes²⁸⁵ nga pikëpamja juridike dhe regjimi juridik që parashikon bashkëjetesa, ndërkohë, në procesin penal, bashkëjetesë fizike dhe marrëdhëniet reciproke mes bashkëjetuesve në kuptimin e plotësisimit të nevojave të kësaj gjendjeje juridike nuk janë gjithmonë në sinkronë me parashikimet e Kodit të Familjes.

Për të bërë përcaktimin e pjesëtarëve të familjes po i referohemi ligjit nr. 9669, datë 18.12.2006,²⁸⁶ "Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", ndryshuar me ligjin 47 të vitit 2018, ku ndërmmjet të tjerash, në nenin 3, pikat 7 dhe 8 të tij, përcakton se:

7. "Pjesëtarë të familjes" janë:

a) bashkëshorti/ja ose bashkëjetuesi/ja apo ish-bashkëshorti/ja apo ish-partneri/ja bashkëjetues; b) vëllezërit, motrat, përfshirë, sipas rastit, edhe bashkëshortin/en ose bashkëjetuesin/en e tyre, si dhe nipin e mbesën, nëse këta të fundit janë anëtarë të njësisë shtëpiake;

c) paraardhësit dhe pasardhësit në vijë të drejtë, pa kufizime, përfshirë edhe rastet kur kjo marrëdhënie krijohet nëpërmjet birësimit; ç) prindërit e bashkëshortit/es ose të bashkëjetuesit/es, përfshirë dhe thjeshtrin/ thjeshtrën, edhe sikur kjo lidhje të burojë nga birësimi;

²⁸⁴ Vendimi Nr. 147, datë 01.04.2009, i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

²⁸⁵ Kodi i Familjes, neni 163.

²⁸⁶ Ligji nr. 9669, datë 18.12.2006.

- d) gjinia në vijë të drejtë, përfshirë edhe prindërit, edhe fëmijët e birësuar të bashkëshortit /es ose bashkëjetuesit/es;
- dh) vëllezërit dhe motrat e bashkëshortit, bashkëshortes, bashkëjetuesit/es;
- e) fëmijët e bashkëshortëve ose partnerëve bashkëjetues;
- ë) personat, të cilët janë ose kanë qenë në marrëdhënie intime, jo domosdoshmërisht të shoqëruar me bashkëjetesë, gëzojnë të njëjtën mbrojtje;
- f) kujdestari dhe personi që ndodhet në kujdesin e tij gjatë kohës që vazhdon kujdestaria, sipas përcaktimeve të kujdestarisë mbi të miturit dhe kujdestarisë për personat me aftësi të kufizuar dhe personit që i është hequr ose kufizuar zotësia për të vepruar sipas dispozitave të Kodit të Familjes.

8. "Marrëdhënie intime" është marrëdhënia ndërpersonale që përfshin intimitet fizik ose emocional.

Sipas mendimit tim, ky është përcaktimi më i saktë ligjor i rrethit të personave që përfshihen në termin familje, në ndryshim nga përcaktimet e bëra nga Kodi i Familjes, Kodi i Procedurës Penale, Kodi Civil në pjesën e trashëgimisë etj., pavarësisht se në rangun e hierarkisë së akteve juridike, ky ligj është më poshtë sesa këto kode, neni 81/2 i Kushtetutës së R. Shqipërisë.

Për këtë arsye, rregullat proceduriale të marrjes së dëshmisë së këtyre personave duhet të zbatohen në çdo rast si në fazën e hetimeve paraprake, ashtu dhe gjatë fazës së shqyrtimit gjyqësor. Mosrespektimi i njohjes me të drejtën për të mos dëshmuar edhe në këtë rast sjell pavlefshmëri të kësaj prove. Në respektim të këtij detyrimi ligjor, të njëjtin qëndrim ka mbajtur dhe Gjykata e Lartë në disa vendime të saj, ku, ndër të tjera, përmendim: *ka qenë në detyrimin e Gjykatës së Shkallës së Parë që në momentin kur mori dijeni për marrëdhënien e dëshmitares me të pandehurin sipas nenit 158/ç/2 të K. Pr. Penale, të mos përdorte dëshminë e saj në sigurimin e provës, por ta thërriste në gjykim dhe të respektonte kërkesat e nenit 158/ç/2 të K. Pr. Penale.*²⁸⁷

Megjithatë, GJEDNJ-ja, në çështjen Ankerl kundër Zvicrës u shpreh se: *Kjo çështje, gjithashtu, kishite të bënte me thirrjen e dëshmitarëve dhe kërkuasi u ankimua se refuzimi i gjykatës për të mos lënë bashkëshorten e tij të jepte prova, duke qenë nën betim për të mbështetur pretendimin e tij në procedimet civile, përbënte shkelje të parimit të barazisë në mjete, duke u bazuar në faktin se kundërshtari i kërkuasit ishte në gjendje që të jepte dëshmimtar për të dhënë prova nën betim.*²⁸⁸

Në respektim të nenit 159²⁸⁹ të Kodit të Procedurës Penale, përjashtohen nga detyrimi për të dëshmuar dhe: *përfaqësuesit e besimeve fetare, statutet e të cilëve nuk janë në kundërshtim me rendin juridik shqiptar; b) avokatët, përfaqësuesit ligjorë dhe noterët; c) mjekët, kirurgët, farmacistët, obstretët dhe kushdo që ushtron një profesion shëndetësor; ç) ata që ushtrojnë profesione të tjera, të cilëve ligji u njeh të drejtën të mos dëshmojnë për ato që lidhen me sekretin profesional.*

Kodi i Procedurës Penale, nëpërmjet përcaktimeve të mësipërme është vënë në mbrojtje të të drejtave që gëzojnë personat gjatë ushtrimit të funksionit dhe shërbimit që ata

²⁸⁷ Vendimi Nr. 841, datë 22.09.2010, i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

²⁸⁸ Ankerl kundër Zvicrës, 23 tetor 1996.

²⁸⁹ Kodi i Procedurës Penale, neni 159.

PROVAT DHE PROCESI I TË PROVUARIT NË PROCESIN PENAL

ofrojnë. Kjo e drejtë vjen në harmoni dhe me Ligjin Nr. 8517, datë 22.07.2009, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, si dhe ligjet specifike që rregullojnë veprimtarinë e ushtrimit të profesionit nga këto subjekte.

P.sh., për avokatët, kjo e drejtë është e sanksionuar në ligjin nr. 55/2018 “Për profesionin e Avokatit në Republikën e Shqipërisë”²⁹⁰: *1. Avokati ruan sekretin profesional dhe konfidencialitetin e të dhënave, për të cilat është vënë në dijeni nga klienti ose nga dokumentet, që ky i fundit i ka vënë në dispozicion, në funksion të mbrojtjes së kërkuar, me përjashtim të rastit kur klienti ka dhënë miratim me shkrim. 2. Avokati kërkon respektimin e konfidencialitetit edhe nga avokatët e tjerë të së njëjtës studio avokatie dhe stafi administrativ i punësuar pranë saj.*

Ligji Nr.7829, datë: 1.6.1994, “Për Noterinë”, neni 23, përcakton: *Të ruajë të dhënat me të cilat është njohur gjatë kryerjes së veprimtarisë së tij dhe që përbëjnë sekret profesional.*²⁹¹

Këtyre subjekteve i njihet e drejta të mos përgjigjen në rast se konkludojnë se pyetjet ndaj tyre janë provokuese dhe që të çojnë në zbulimin e të dhënave që përbëjnë sekret profesional. Kjo e drejtë është e kushtëzuar dhe nga vullneti i të pandehurit. Nëse ai jep pëlqimin e tij, atëherë këta persona mund të paraqesin në dëshminë e tyre dhe të dhëna të cilat i kanë mësuar si rezultat i ushtrimit të profesionit.

Gjykata, sipas parashikimeve të bëra në nenin 159/2 të Kodit të Procedurës Penale, mund të urdhërojë verifikimet e nevojshme nëse ekzistojnë apo jo kushtet dhe kriteret e ruajtjes së një sekreti profesional.

Megjithatë, personat e mësipërm privohen nga kjo e drejtë, kur ata janë të detyruar që këto të dhëna t’ia referojnë autoritetit procedues.

Nëse në dispozitën e mësipërme parashikohet mungesa e detyrimit për të dëshmuar për shkak të sekretit profesional, K. Pr. Penale ka përcaktuar dhe rastet e detyrimit të nëpunësit shtetëror, për të mos dëshmuar për fakte e të dhëna që përbëjnë sekret shtetëror.

Më konkretisht, neni 160²⁹² i K. Pr. Penale përcakton se: *Nëpunësit shtetërore, nëpunësit publikë dhe të ngarkuarit me një shërbim publik janë të detyruar të mos dëshmojnë për faktet që janë sekret shtetëror.*

Klasifikimi i të dhënave si sekret shtetëror përcaktohet në bazë të ligjit Nr. 8457,²⁹³ datë 11.02.1999, “Për informacionin e klasifikuar ‘sekret shtetëror’” dhe është kompetencë e organit shtetëror që e disponon dhe administron që të japë miratimin për përdorimin e kësaj prove. Por, ky miratim është i kushtëzuar dhe nga fakti nëse kjo provë është thelbësore në zbardhjen e çështjes penale. Ky qëndrim ka gjetur zbatim dhe në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, dhe, ndonëse në raste të rralla, edhe në praktikën gjyqësore të vendit tonë.

²⁹⁰ Neni 10 i ligjit nr.55/2018, Për profesionin e Avokatit në Republikën e Shqipërisë.

²⁹¹ Ligji Nr.7829, datë 1.6.1994, “Për Noterinë”.

²⁹² Kodi i Procedurës Penale, neni 160.

²⁹³ Ligji nr. 8457, datë 11.02.1999, “Për informacionin e klasifikuar ‘sekret shtetëror’”.

Detyrimi i parashikuar nga ligjvënësi për të mos dëshmuar lidhet vetëm me të dhënat të cilat janë klasifikuar si sekret shtetëror dhe jo çdo e dhënë me natyrë të rezervuar apo të klasifikuar.²⁹⁴

Nevoja e ruajtjes së sekretit shtetëror zyrtar apo ushtarak shihet si pengesë absolute për pyetjen e dëshmitarit derisa nga gjykata të kërkohet konfirmimi nga organi shtetëror kompetent nëse pretendimi i ngritur përbën apo jo sekret shtetëror. Në të kundërt, kjo përbën vepër penale.²⁹⁵

Risia që vjen me ndryshimet e fundit të Kodit të Procedurës Penale është se është shtuar pika 6 e nenit 160, ku është parashikuar se informatorët pranojnë të dëshmojnë, dhe dëshmia e tyre merret duke respektuar rregullat mbi ruajtjen e fshehtësisë së identitetit të tyre.

Neni 160²⁹⁶

Ruajtja e sekretit shtetëror

(Shtuar pika 6 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

Kur informatorët pranojnë të dëshmojnë, dëshmia merret duke respektuar rregullat mbi ruajtjen e fshehtësisë së identitetit të tyre. Zbatohen, për aq sa është e mundur, parashikimet e neneve 165/a dhe 361/b të këtij Kodi.

Para miratimit të ndryshimeve të këtij kodi parashikohej marrja e dëshmisë së Presidentit të Republikës dhe nëpunësve të lartë të shtetit, dispozitë tashmë e shfuqizuar me ligjin 35/2017.

Parashikimet e pikës “1” të nenit 163²⁹⁷ të K. Pr. Penale lidhen me procedurën e marrjes së dëshmisë së subjekteve me mision diplomatik, si dhe të shtetasit shqiptar në një shtet tjetër. Për shkak të vendndodhjes së tyre, si dhe statusit të tyre në lidhje edhe me aktet ndërkombëtare, ligjvënësi ka parashikuar një formë të veçantë për marrjen e tyre në pyetje.

Marrja e dëshmisë si provë nga një nëpunës diplomatik me mision jashtë shtetit, organi procedues ka detyrimin që para thirrjes së tij në cilësinë e dëshmitarit t’i drejtohet me kërkesë Ministrisë së Drejtësisë, organit diplomatik ose konsullor, me përjashtim të rasteve kur marrja në pyetje vlerësohet e domosdoshme me paraqitjen e tyre para gjykatës.

Megjithatë, kur nga gjykata vlerësohet e domosdoshme, procedohet në format e zakonshme. Ndërsa për marrjen e dëshmisë nga personat shtetas të huaj, me status diplomatik, procedohet sipas konventave dhe zakoneve ndërkombëtare, kjo sipas përcaktimeve të bëra.

Sipas Konventës së Vjenës, diplomatët e huaj nuk mund të dëshmojnë dhe as të ofrojnë ekspertizën e tyre, me përjashtim të rasteve kur ata heqin dorë vetë nga imuniteti diplomatik dhe kjo miratohet nga shteti i tyre ose kur u kërkohet, dhe ata, si dhe shteti i tyre, japin pëlqimin.²⁹⁸

²⁹⁴ Vendimi Nr. 42, datë 22.01.2003, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

²⁹⁵ Dhimitër Lara, Koment mbi procedurën penale.

²⁹⁶ Kodi i Procedurës Penale, neni 160.

²⁹⁷ Kodi i Procedurës Penale, neni 163.

²⁹⁸ Ferdinand Elezi, punim doktore, fq. 63.

Thirtja e dëshmitarit bëhet nga ana e gjykatës, duke përcaktuar saktë dhe qartë modalitet lidhur me orën, vendin dhe ditën e paraqitjes së tij për dhënien e dëshmisë.

Me ndryshimet e KPP-së, neni Neni 164²⁹⁹ka pësuar këtë formulim.

Shoqërimi i detyrueshëm

(Ndryshuar me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Kur dëshmitari, i thirrur rregullisht, nuk paraqitet në vendin, ditën dhe orën e caktuar, pa pasur pengesa të ligjshme, gjykata mund të urdhërojë shoqërimin e detyrueshëm ose të vendosë gjobë deri në masën 30 000 lekë.

2. Gjykata mund të revokojë vendimin e dhënë sipas paragrafit 1, të këtij neni, ose të pakësojë masën e gjobës, kur rezulton se ka pasur shkaqe të arsyeshme.

3. Personi i shoqëruar me detyrim nuk mund të mbahet në dispozicion tej kohës së nevojshme për praninë e tij dhe, sidoqoftë, jo më shumë se njëzet e katër orë.

4. Parashikimet e pikave 1, 2 dhe 3, të këtij neni, vlejnë edhe për ekspertin dhe përktihyesin.

5. Parashikimet e pikave 1, 2 dhe 3, të këtij neni, nuk zbatohen për dëshmitarët e mitur. Nga kjo dispozitë duhet të veçojmë disa elemente të praktikës gjyqësore që kanë të bëjnë me faktin se gjykatat duhet të saktësojnë disa detaje shumë të rëndësishme për një proces të rregullt ligjor gjatë marrjes së dëshmisë, sigurimit të kushteve dhe rrethanës për marrjen e dëshmimeve. Vlen të theksohet se shoqërimi i detyrueshëm vendoset në rastet kur dëshmitari, pa pasur pengesa të ligjshme, nuk paraqitet ndonëse ka marrë dijeni rregullisht.

Gjykata, pasi ka verifikuar marrjen dijeni të dëshmitarit për orën dhe datën e seancës, si dhe mospasjen e pengesave të ligjshme për t'u paraqitur vendos shoqërimin e detyrueshëm ose vendos gjobitjen e tij në masën e sipërpërshtkruar. Shoqërimi i detyrueshëm bëhet nga policia gjyqësore dhe në afate deri në 24 orë, duke e vendosur dëshmitarin në dispozicion të gjykatës.

Problemet që lindin në praktikë janë: *Kush i përballon shpenzimet për ardhjen e dëshmitarit në seancë, transportin, ndërprerjen e procesit të punës, edukimit, trajtimit mjekësor etj? Kur përballohen këto shpenzime, pra si moment procedural? A është shkak i ligjshëm pamundësia ekonomike për të përballuar shpenzimet e udhëtimit ose mosmarrja e lejes nga punëdhënësi për të ndërprerë punën? A konsiderohet shkak për përjashtimin e masës së gjobës gjendja ekonomike e dëshmitarit, pamundësia objektive e përballimit të shpenzimeve të transportit, papunësia etj?*

Në praktikë, ndryshimet e reja proceduriale kanë bërë të mundur lehtësimin e procesit të të provuarit dhe shmangien në përgjithësi të debatit gjyqësor, nisur nga fakti se materiali hetimor i prokurorit tashmë mund t'i shtohet edhe kryerja e veprimeve të tjera me kërkesë të të pandehurit dhe mbrojtësit të tij, pas përfundimit të hetimeve, si dhe plotësimi i hetimeve në rastin kur gjyqtari i seancës paraprake vendos plotësimin e hetimeve me kryerjen edhe të disa veprimeve të tjera brenda një afati të caktuar kohor.

²⁹⁹ Kodi i Procedurës Penale, neni 164.

Por, në rast se ndodhemi përpara një procesi gjyqësor që nuk ndjek rastet e gjykimit të posaçëm, marrëveshjen ose miratimin e urdhërit penal, në vetvete këto janë vështirësi reale dhe sjellin zvarritje të mëdha të procesit.

Pavarësisht se ardhja e dëshmitarit është kosto reale për të, ky shpenzim pothuajse nuk matet në praktikë dhe nuk llogaritet si shpenzim gjyqësor, por, edhe sikur të llogaritet deri sa vendimi të bëhet i ekzekutueshëm, ai nuk arkëtohet; ose, edhe nëse bëhet i ekzekutueshëm për shkak paaftësie paguese, kjo gjë nuk realizohet.

Në këndvështrimin e realizimit të një procesi të rregullt, këto shpenzime duhet të parapagohen nga ana e organeve proceduriale dhe të llogariten në mënyrë të saktë me shpenzimet gjyqësore në fund të procesit.

Në nenin 165 të KPP-së sanksionohet përgjegjësia për dëshmi të rreme duke reflektuar përjashtimin nga përgjegjësia penale e dëshmitarit të mitur dhe mënyra e pyetjes së tij, si dhe rasti kur dëshmitari kërkon të merret në mbrojtje.

Neni 165³⁰⁰

Përgjegjësia për dëshmi të rreme ose refuzim për të dëshmuar

(Ndryshuar me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Kur gjatë pyetjes dëshmitari bën thënie kontradiktore, jo të plota ose që janë në kundërshtim me provat e marra, gjykata ia vë në dukje duke e paralajmëruar për përgjegjësinë penale për dëshmi të rreme.

2. Të njëjtin paralajmërim gjykata i bën edhe dëshmitarit që refuzon të dëshmojë. Kur dëshmitari ngul këmbë në mospranimin për të dëshmuar, gjykata i kërkon prokurorit që të procedojë sipas ligjit.

3. Kur dëshmitari refuzon të dëshmojë, pasi kërkon masa mbrojtjeje apo kërkon të vihet në programin e mbrojtjes së dëshmitarëve, sipas legjislacionit në fuqi, prokurori nuk regjistron procedimin penal për dëshmi të rreme, derisa të vendoset për kërkesën e tij.

4. Kur me vendimin përfundimtar gjykata çmon se dëshmitari ka bërë dëshmi të rreme, gjykata i përcjell aktet prokurorit për të proceduar sipas ligjit.

Përgjegjësia penale e dëshmitarit në rastet kur ai bën ose jep dëshmi të rreme para gjykatës apo refuzon dhënien e dëshmisë, gjen parashikim në nenet 306 dhe 307 të K. Penal. Gjukata, para marrjes së dëshmisë, e paralajmëron dëshmitarin për përgjegjësinë penale në rastin e dëshmisë së rreme apo refuzimit për të dëshmuar. Praktika gjyqësore e ka pasur gjithmonë problem ndërprerjen e procesit gjyqësor me kërkesën e përfaqësuesit të akuzës, me qëllim ngritjen e akuzës për dëshmi të rreme të dëshmitarit, ose arrestimi i tij në sallë, ndërkohë që, në vijim, ligjvënësi ka qenë i qartë se këtë paralajmërim e bën gjykata që shqyrton çështjen.

Duke qenë se rëndom në praktikën gjyqësore, edhe pse ligjvënësi nuk përcakton radhën e marrjes së provave, është filluar me provat me dëshmitarë, por ka pasur realisht shumë probleme të ndërthurura proceduriale në lidhje me këtë iniciativë të prokurorit në seancë për të thënë se jemi përpara dëshmisë së rreme, vazhdimi të procesit ndaj dëshmitarit për veprën penale të dëshmisë së rreme, në mënyrë të pavarur nga procesi

³⁰⁰ Kodi i Procedurës Penale, neni 165.

për të cilin ky person është dëshmitar, si dhe përdorja e vendimit të dënimit të tij si provë, me qëllim përforsimin e leximit të deklarimeve të bëra nga dëshmitari gjatë hetimeve paraprake.

Në kuptim të plotë të ligjit, një fakt i tillë duhet të bëhet vetëm pasi gjykata e konstaton se dëshmitari po bën deklarime kontradiktore, jo të plota, të cilat bien në kundërshtim me provat e marra.

Natyrshtëm lind pyetja: “Çfarë ndodh me dëshmitarin e parë në një proces gjyqësor, që është edhe prova e parë që po merret, por që në thëniet e tij bie në kundërshtim me deklaratimet e dhëna gjatë fazës së hetimit paraprak?”.

Mënyra më e saktë e të vepruarit ndaj tij do të ishte që të kërkohej leximi i thënieve nga ana e prokurorit në seancë, ndërkohë që gjykata nuk do të mund të bënte asgjë me iniciativë në këtë fazë. Do të ishte e nxitur dhe e pa bazë juridikisht ushtrimi i ndjekjes penale nga ana e prokurorit, ndërkohë që kjo provë e parë po i nënshtrohet marrjes në proces përpara gjykatës.

Neni 165/a³⁰¹ (Ndryshuar me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

Dëshmitari me identitet të fshehur

1. Kur dhënia e dëshmisë mund të vendosë dëshmitarin ose anëtarët e familjes së tij në rrezik serioz për jetën apo shëndetin dhe i pandehuri akuzohet për veprat penale të parashikuara nga nenet: 230, 230/a, 230/b, 230/c, 230/ç, 231, 232, 232/a, 232/b, 234, 234/a, 91 234/b, 265/a, 265/b, 265/c, si dhe nuk zbatohet programi i mbrojtjes së dëshmitarëve, gjykata, me kërkesën e prokurorit, mund të vendosë zbatimin e teknikave të veçanta të marrjes në pyetje, sipas nenit 361/ b të këtij Kodi.

2. Kërkesa e prokurorit i paraqitet kryetarit të trupit gjykues në një zarf të mbyllur, me shënimin: “Konfidenciale: dëshmitar me identitet të fshehur”. Në kërkesë, prokurori parashtron arsyet për nevojën e përdorimit të një ose disa prej teknikave të veçanta të marrjes në pyetje.

3. Në zarfin me shënimin e mësipërm, prokurori depoziton edhe zarfin e mbyllur që përmban identitetin e plotë të dëshmitarit me identitet të fshehur. Vetëm kryetari i trupit gjykues njihet me identitetin e vërtetë të dëshmitarit me identitet të fshehur dhe verifikon zotësinë dhe papajtueshmërinë me detyrën e dëshmitarit, sipas parashikimeve të këtij Kodi. Në çdo rast, mbi zarf shënohen në mënyrë të dukshme data, emri, nënshkrimi dhe funksioni i personave që kanë hapur zarfin dhe atyre që janë njohur me të dhënat që përmban zarfi. Pas kryerjes së verifikimeve, zarfi me identitetin e vërtetë të dëshmitarit me identitet të fshehur i kthehet prokurorit.

4. Gjkata shqyrton kërkesën e prokurorit në dhomë këshillimi dhe vendos me vendim të arsyetuar brenda dyzet e tetë orëve nga paraqitja e kërkesës.

5. Prokurori mund të ushtrojë ankim kundër vendimit të gjykatës brenda dyzet e tetë orëve nga njoftimi i vendimit. Gjkata e Apelit shqyrton ankimin në dhomë këshillimi dhe vendos mbi ankimin brenda dyzet e tetë orëve nga marrja e akteve. Ky vendim është i paankimueshëm.

³⁰¹ Kodi i Procedurës Penale, neni 165/a.

6. Kur pranon kërkesën e prokurorit, gjykata vendos pseudonimin e dëshmitarit dhe procedurat e fshehjes së identitetit, njoftimit, paraqitjes dhe pjesëmarrjes në procedim. Pyetja e dëshmitarit kryhet sipas rregullave të parashikuara në nenin 361/b të këtij Kodi.

7. Dëshmitari merr pjesë në të gjitha fazat e gjykimit vetëm me pseudonimin e vendosur nga gjykata, përveç rastit të parashikuar nga paragrafi 8 i këtij neni.

8. Pyetja e dëshmitarit me identitet të fshehur dhe caktimi i pseudonimit të tij gjatë fazës së hetimeve bëhen nga prokurori. Aktet ku ai merr pjesë, nënshkruhen me pseudonimin e caktuar.

Në rastin konkret është shtuar neni 165/a, në të cilin parashikohen rastet e dëshmitarëve anonimë, duke parashikuar rastet dhe procedurën e ndjekur për situatat kur dëshmitari ose një i afërm i tij mund të jenë në rrezik serioz për jetën e shëndetin e tyre për shkak të dëshmisë.

Krijimi i këtij instituti siç referon neni 165/a, atë të dëshmitarit me identitet të fshehur, nuk është një institut krejtësisht i ri në procedurën penale shqiptare. Paragrafi 2 i nenit 361/a të Kodit të Procedurës Penale, tashmë i ndryshuar, normonte rregullat e pyetjes së personit (natyrisht, edhe dëshmitarit) me identitet të ndryshuar, gjeneralitetet e vërteta të të cilit nuk njiheshin nga i pandehuri dhe mbrojtja.

Kjo normë mbështetej edhe nga dispozitat e ligjeve Nr. 9110, date 24.7.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave për krime të rënda" dhe Ligjin Nr.10173, datë 22.10.2009, "Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë".³⁰²

Risia që sjell instituti i dëshmitarit me identitet të fshehur zbatohet vetëm në rastin kur ndaj tij nuk zbatohet program i mbrojtjes sipas ligjit të posaçëm, së dyti, fusha e veprimit të këtij instituti është kufizuar dhe, së treti, janë vendosur rregulla më të forta që kufizojnë përdorimin e dëshmisë së dëshmitarit anonim si provë kundër të pandehurit.

Qëllimi parësor i këtij instituti është zgjerimi i mundësive për efektivitet të drejtësisë penale, nëpërmjet garantimit të vërtetësisë të dëshmisë së dëshmitarit, në rastin e disa krimeve që paraqesin rrezikshmëri për shoqërinë, duke e mbajtur atë jashtë ndikimit dhe trysnisë së ushtruar nga autorët e këtyre veprave ose bashkëpunëtorët e tyre.³⁰³

*Sikurse e kemi cituar dhe më lart, marrja e dëshmisë mund të kryhet dhe kryesisht nga gjykata gjatë zhvillimit të procesit gjyqësor. Kjo realizohet kur gjatë gjykimit të çështjes del domosdoshmëria e marrjes së një prove (dëshmie) të re, qenia e së cilës del gjatë shqyrtimit gjyqësor, dhe vlen për të vërtetuar faktet që pretendohen.*³⁰⁴

*Mospranimi nga ana e gjykatës për marrjen e një dëshmie si prove e re gjatë procesit penal, e cila mund të jetë me karakter thelbësor në zgjidhjen e çështjes konsiderohet si shkelje e barazisë për një proces të rregullt ligjor.*³⁰⁵

³⁰² Ligji Nr.10173, datë 22.10.2009, "Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë".

³⁰³ Vendimi datë 23.04.1997, në çështjen Van Mechelen kundër Holandës.

³⁰⁴ Vendimi Nr. 62, datë 14.02.2007, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

³⁰⁵ Vendim i Gjykatës Kushtetuese Nr. 7, datë 27.04.2005.

Në çështjen Kostovski kundër Vendeve të Ulëta³⁰⁶, GJEDNJ-ja ka theksuar se: *....kërkuesi ishte identifikuar nga dy persona që dëshironin të mbeteshin anonimë në polici, se kishte marrë pjesë në vjedhjen e një banke. Deklaratat e bëra nga këta dëshmitarë u lexuan në gjyq gjatë procesit gjyqësor, ku kërkuesi u dënua për vjedhje me armë.*

3.2.2. KUNDËRSHTIMI I DËSHMISË

Instituti i kundërshtimit të dëshmisë parashikohet në nenin 362 të Kodit të Procedurës Penale. Qëllimi kryesor i këtij instituti ka qenë instrumentalizimi i fenomenit të kundërshtimit të dëshmisë, për të rikuperuar një vlerë provuese në favor të deklarimeve të bëra gjatë hetimeve, duke i vënë ato në të njëjtin raport provues me deklaratimet e bëra gjatë hetimeve në procedurën e pyetjes së dëshmitarit, duke qenë se kjo e fundit përbën një nga mjetet provuese për ato fakte dhe rrethana të rëndësishme për çështjen konkrete. Gjatë procesit të kundërshtimit të dëshmisë nga palët, gjykata verifikon besueshmërinë e dëshmitarit dhe vërtetësinë e kësaj prove, në raport me provat e tjera.

Sipas vendimit Nr. 92, datë 04.03.2009, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, *deklarimet e të dëmtuarës para o.p. gjyqësore, nga gjykata janë vlerësuar si provë me të drejtë dhe në zbatim të kërkesave të nenit 362/3 të K. Pr. Penale..ato lidhen me provat e tjera të administruara nga gjykata në gjykimin e çështjes.*

Kuptohet qartë që sanksionimi i institutit të kundërshtimit të dëshmisë përbën një element inkuizitor brenda një sistemi në thelb akuzator, siç është sistemi ynë. Por kjo nuk do të thotë që kjo është bërë për arsye të përmendura më sipër, pasi arsyet kanë qenë shumë më pragmatiste dhe pozitive sesa të rivendosjes së një pozite më të fortë të prokurorit apo policisë gjyqësore.

Kështu, në praktikë ndodh që dëshmitari i pyetur gjatë hetimeve paraprake nga prokurori ose policia gjyqësore, si person që ka dijeni për veprën penale dhe autorin e saj, i ndryshon deklaratimet ose i përgënjeshtrohet ato gjatë gjykimin.

Në këto kushte, i gjithë procesi mund të dështojë, për shkak të ndikimit të jashtëm për të ndryshuar thëniet e bëra më parë apo për të ndryshuar padrejtësisht pozitën e të pandehurit. Për këto arsye, prania e këtij elementi inkuizitor në procesin tonë penal është shumë e nevojshme dhe e domosdoshme, duke patur parasysh dhe kushtet në të cilat vepron sistemi ynë i drejtësisë.

Që kundërshtimi i dëshmisë të pranohet me vendim të ndërmjetëm nga gjykata, në interpretim të nenit 362 të Kodit të Procedurës Penale³⁰⁷ duhet të ekzistojnë në mënyrë kumulative tre kushte:

Së pari, dëshmitari që po pyetet para gjykatës, duhet të ketë bërë deklaratime të mëparshme gjatë hetimeve paraprake para organeve përkatëse. Kjo do të thotë se, nuk mund të bëhet kundërshtim i dëshmisë së një dëshmitari, i cili nuk ka bërë asnjë deklaratim më parë dhe është hera e parë për të që vjen të bëjë deklaratime rreth çështjes.

³⁰⁶ Kostovski kundër Vendeve të Ulëta, 20 nëntor 1989.

³⁰⁷ Kodi i Procedurës Penale, neni 362.

Kjo shpjegon dhe faktin tjetër, që nuk mund të kundërshtohet dëshmia e një dëshmitari me deklarinimet që janë bërë më parë nga një dëshmitar tjetër, edhe sikur të vijnë në kontradiktë me dëshminë e të parit.

Së dyti, deklarinimet e bëra më parë nga dëshmitari duhet të kenë kontradikta apo të vijnë në kundërshtim me deklarinimet që bën gjatë debatit gjyqësor. Për mungesën e pajtueshmërisë midis dy deklarinimeve, duhet që ajo të jetë thelbësore, edhe sikur të lidhet me një detaj, me kusht që ai të jetë i rëndësishëm në aspektin provues.

Natyrisht që, i mbetet kryetarit të seancës të vendosë nëse është e dallueshme mospërputhja midis deklarinimeve para se të vendosë lejimin e kundërshtimit të dëshmisë dhe këtë ai e realizon duke i kërkuar prokurorit të parashtrojë se ku konsiston kundërshtia.

Sigurisht, nëse pas kundërshtimit të dëshmisë rezulton se kundërshtimi nuk rezulton të ketë ose ato i referohen fakteve krejt të parëndësishme, gjyqtari mund të revokojë vendimin e tij duke mos lejuar që deklarinimet t'i bashkëlidhen fashikullit të gjykimit.

Kushitë i tretë lidhet me faktin që këto deklarime duhet të ndodhen në fashikullin e prokurorit. Gjatë procedimit me gjykim të zakonshëm nga ana e gjykatës, deklarinimet e bëra gjatë fazës së hetimeve paraprake, bazuar në nenin 332 të K. Pr. Penale, nuk ishin të detyrueshme dhe pjesë e fashikullit gjyqësor.

Në parashikimet e reja të Kodit të Procedurës Penale, nenet 327, 331, 332, është bërë i detyrueshëm formimi i fashikullit që shqyrtohet nga gjyqtari i seancës paraprake i të gjitha rezultateteve të hetimeve, dhe, në këto kushte, kur dëshmia merret në gjykim, në rastet e gjykimit të zakonshëm, deklarinimet e personit të marra gjatë fazës së hetimit paraprak ndodhen në fashikullin e gjykatës dhe të prokurorit, si dhe palët janë njohur me të gjitha aktet e fazës së hetimit.

Lejimi i kalimit të deklarinimeve të bëra gjatë hetimeve paraprake nga fashikulli i prokurorit në fashikullin e gjykimit (neni 362/2 i Kodit të Procedurës Penale) përbën përjashtim nga rregulli dhe na shfaq natyrën inkuizitore të këtij elementi. Megjithatë, ky nuk përbën përjashtimin e vetëm nga rregulli, pasi janë parashikuar dhe disa institute të tjera, të cilat përbëjnë provë nëse plotësohen kushtet për marrjen e tyre.

Në Kodin e Procedurës Penale, kundërshtimi i dëshmisë është rregulluar dhe në dispozita të tjera përveç nenit 362, duke iu referuar subjekteve të tjera që mund të pyeten në proces. Kështu, kur lejohet pyetja e palëve private, përmbajtja e paragrafit 2 të nenit 365, mundëson kundërshtimin e deponimit të tyre me anë të deklarinimeve të bëra gjatë hetimeve paraprake. Po e njëjta gjë rregullohet dhe në nenin 370/1 lidhur me deklarinimet që bën i pandehuri në çdo moment që ai e çmon të nevojshme dhe gjykata ia lejon.

Por, ndërsa në nenin 362/1, 365/2 bëhet fjalë për kundërshtim të përmbajtjes së dëshmisë të dëshmitarëve/palëve private, gjatë procesit *cross-examination*, në nenin 370/1 bëhet fjalë për kundërshtim të përmbajtjes së deklarinimeve, deklarime që mund të bëhen në çdo moment nga i pandehuri gjatë debatit gjyqësor.

Lidhur me vlerën e thënieve të marra gjatë hetimeve paraprake, kur ato përdoren për të kundërshtuar dëshminë, neni 362/3 dhe 4 parashikon se mund të vlerësohen si provë kur plotësohet njëri prej kushteve të mëposhtme:

Së pari, kur thënie e mëparshme lidhen me prova të tjera që konfirmojnë vërtetësinë e tyre (paragrafi 3 i nenit 362). Ky institut që, në të drejtën anglosaksone njihet me emrin *Corroboration*, e ka zanafillën në të drejtën romake dhe shprehet me lokucionin: *Cuae singula non probant, coniuncta probant*.

Së dyti, kur rezulton se dëshmitari, qoftë dhe gjatë pyetjes në seancë, i nënshtrohet dhunës, kanosjes, premtimit për t'i dhënë para apo përfitime të tjera me qëllim që të mos dëshmojë ose të bëjë dëshmi të rreme (paragrafi 4 i nenit 362).

Dhe, **së fundmi**, kur rezultojnë rrethana të tjera që kanë dëmtuar sinqeritetin e përgjigjeve të tij (paragrafi i 4 i nenit 362).

Siç shihet, bëhet fjalë për provueshmëri të plotë dhe të pjesshme të kundërshtimit të dëshmisë. Provueshmëria e pjesshme është atëherë kur kundërshtimi i dëshmisë nuk lidhet me asnjë nga rastet e mësipërme e, për pasojë, mbetet vetëm në kuadrin e çmuarjes së besueshmërisë së dëshmitarit.

Në këtë aspekt, provueshmëria e plotë e kundërshtimit të dëshmisë, si një ndërhyrje me vend e ligjvënësit, përbën një shmangie nga parimet e procesit akuzator, pasi i njeh prokurorit të drejtën e formimit të provës. Megjithatë, ajo është shumë e rëndësishme po të kihet parasysh fakti se shumë dëshmitarë, për shkak të kërcënimeve, rrethanave të ndryshme, ndryshojnë thëniet që kanë bërë gjatë hetimeve.

Duke qenë se sistemi ynë është një sistem i përzier, ai përmban brenda vetes elemente të dallueshëm inkuizitor, siç është dhe dhënia e vlerës së provës së plotë deklarimeve të bëra gjatë hetimeve paraprake, kur ato përdoren gjatë kundërshtimit të dëshmisë, me kushtin që ato të jenë të lidhura me prova të tjera që konfirmojnë vërtetësinë e tyre.

Informacioni për akuzën duhet **të jetë në një gjuhë që i akuzuari e kupton**. Në çështjen e *Brozicek kundër Italisë*,³⁰⁸ i akuzuari ishte gjerman dhe qartë shprehu vështirësitë e tij gjuhësore për gjykatën vendase. Gjykata Evropiane u shpreh se autoritetet italiane duhet të kishin përkthyer njoftimin, përveçse nëse ato do të ishin në pozitë të tillë që të konkludonin se ai e zotëronte mirë gjuhën italiane, që nuk ishte e vërtetë në këtë rast. Po kështu, gjykata u shpreh në *Kamasinski kundër Austrisë*³⁰⁹, ku i pandehuri që nuk e fliste gjuhën e gjykatës mund të ishte vënë në pozita në disavantazh nëse nuk do t'i ishte siguruar një përkthim me shkrim i padisë në gjuhën që ai kuptonte. Është thelbësor fakti që **vepra penale për të cilën është dënuar një person është ajo për të cilën ai është akuzuar**. Në *Pelissier dhe Sassi kundër Francës*³¹⁰, i akuzuari u akuzua vetëm për aktin e falimentimit penal, por u dënua për komplot për kryerje të falimentimit penal. Gjykata u shpreh se, meqë thelbi i *dëshmisë së të dy oficerëve ndryshonte*, kjo përbënte shkelje të Konventës.

3.2.3. PYETJA E TË PANDEHURIT

Deklarimet e të pandehurit merren nga gjykata, në shqyrtimin gjyqësor sipas kërkesave të përgjithshme, si dhe të kërkesave të parashikuara nga nenet 166, 167 dhe 167/a të K. Pr. Penale³¹¹, mbi kërkesë të vetë të pandehurit, palëve apo edhe kryesisht.

³⁰⁸ Vendim i GJEDNJ-së Brozicek kundër Italisë.

³⁰⁹ Vendim i GJEDNJ-së Kamasinski kundër Austrisë.

³¹⁰ Vendim i GJEDNJ-së Pelissier dhe Sassi kundër Francës.

³¹¹ Kodi i Procedurës Penale, neni 166-167.

Sipas nenit 166 të K. Pr. Penale, në gjykim, i pandehuri pyetet nga palët dhe gjykata, nëse e kërkojnë vetë marrjen në pyetje ose kur u kërkohet dhe japin pëlqimin, sigurisht në respektim rigoroz të rregullave të përgjithshme të marrjes në pyetje të parashikuara nga ligji.

Deklarimi i të pandehurit shërben për vërtetimin e fakteve që kanë të bëjnë me ekzistencën ose jo të veprës penale, me vërtetimin e fakteve që kanë të bëjnë me përgjegjësinë e tij dhe gjendjen psikologjike, por dhe për përcaktimin e sanksionit penal.

Thëniet, shpjegimet, përgjigjet apo deklaramet e bëra nga i pandehuri, megjithëse kanë vlerën e provës në gjykimin e çështjes, ato nuk konsiderohen si burim themelor për zbardhjen e veprës penale dhe të fajësisë së tij.

Të pandehurit në respektim të parimeve kushtetuese, por dhe të qëndrimeve tashmë të konsoliduara të GJEDNJ-së i njihet e drejta që të mos deklarojë duke sanksionuar dhe papërdorshmëria e kësaj prove në rast se nuk është respektuar e drejta e informimit të të ndaluarit për këtë të drejtë.

Megjithatë, e drejta e të akuzuarit për të heshtur nuk duhet parë gjithmonë si një e drejtë absolute. Kur provat e paraqitura nga organi i akuzës kërkojnë detyrimisht një shpjegim nga ana e të pandehurit, atëherë refuzimi i tij për të dhënë shpjegime nuk është konsideruar nga Gjykata e Strasburgut si cenim i prezumimit të pafajësisë.

*Gjatë marrjes në pyetje, të pandehurit duhet t'i drejtohen pyetje të qarta, të kuptueshme, në mënyrë që të perceptojë korrekt qëllimin e pyetjeve. Është e ndaluar marrja e deklarameteve të të pandehurit nën efektin e dhunës, kanosjes apo pyetjeve sugjestive.*³¹²

*Deklaratat e dhëna nga i pandehuri në çfarëdo konteksti, nëse janë dhënë në mënyrë vullnetare dhe pa shtrëngim, janë prova të pranueshme gjatë shqyrtimit kryesor kundër të pandehurit, por jo edhe kundër të bashkëpandehurve. Por, deklaratat e tilla nuk mund të shërbejnë si provë e vetme fajësuese apo vendimtare për dënimin e të pandehurit*³¹³.

*Marrja e deklarameteve qoftë nga personi nën hetim gjatë fazës së hetimeve paraprake, ashtu dhe nga i pandehuri duhet detyrimisht të bëhen në prani të mbrojtësit dhe në respektim të kriterëve ligjore proceduriale. Gjykata Kushtetuese ka theksuar se mosrespektimi i këtij detyrimi sjell për pasojë pavlefshmërinë e deklarameteve të marra nga ky subjekt.*³¹⁴

Deklarimi i të pandehurit shpeshherë shërben si mjet provues edhe në rastet e mohimit apo përdorimit të gënjeshtërsë gjatë marrjes në pyetje, të cilat mund ta orientojnë veprimtarinë hetuese apo të ndikojnë në bindjen e gjyqtarit për autorin e veprës penale. I pandehuri shërben si mjet provues pasiv dhe aktiv. *I pandehuri shërben si mjet provues pasiv në raste kur ndaj tij, me qëllim verifikimin e të dhënave të rëndësishme për gjendjen e tij shëndetësore apo sigurimin e provave materiale, bëhet verifikimi i tij personalisht apo i sendeve të tij. Ndërsa, në rastet kur marrja apo zbullimi i provave*

³¹² Gjykata Kushtetuese, vendimi Nr. 14, datë 03.05.2011.

³¹³ Vendimi Nr. 205, datë 06.04.2005, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

³¹⁴ Vendimi Nr. 7, datë 28.02.2000, i Gjykatës Kushtetuese.

*bëhet vetëm nëpërmjet pjesëmarrjes aktive të të pandehurit me veprimet e tij, atëherë konsiderohet një provues aktiv*³¹⁵.

Vlerën e provës kanë dhe deklaratimet e të pandehurit dhënë në seancë gjyqësore. Thëniet e të pandehurit çmohen për atë që vlerëson gjykata, duke mos i dhënë përparësi në raport me llojet e tjera të provave. Ky qëndrim bazohet në nenin 152/1 të K. Pr. Penale, ku përcaktohet se ... *Asnjë provë nuk ka vlerë të paracaktuar nga ligji. Gjykata, pas shqyrtimit të provave në tërësi, çmon vërtetësinë dhe fuqinë provuese të tyre, duke argumentuar arsyet ku është mbështetur për të krijuar bindjen e saj - ndryshuar me ligjin 35/2017.*³¹⁶ Në respektim të kësaj dispozite, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në vendimin Nr. 850, datë 29.09.2010, është shprehur se: *.....nga Gjykata e Apelit, në mënyrë të gabuar, i është dhënë vlerë e paracaktuar thënieve të të gjykuarës në gjykim, me të cilat ka mohuar atë çka kishte deklaruar në hetim, thëniet në gjykim nuk janë çmuar në harmoni me një sërë provash të tjera të shqyrtuara gjatë gjykimit në shkallë të parë, prova të cilat vërtetohin fajësinë e të gjykuarit.*

Nga kuptimi i kësaj dispozite, thëniet e të pandehurit si provë penale sipas legjislacionit tonë, kanë të njëjtën vlerë në raport me provat e tjera. Në Vendimin Nr. 205,³¹⁷ datë 06.04.2005, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka arsyetuar se: *Procesi i të provuarit nuk është pranimit ose jo i fajësisë nga i pandehuri, por vërtetimi i fakteve nëpërmjet grumbullimit të provave të njafueshme për të bindur gjykatën lidhur me fajësinë e tij.* Në deklaratimet e tyre gjatë hetimit apo gjykimit të çështjes të pandehurit bëjnë thënie duke mohuar autorësinë apo fajësinë në kryerjen e veprës penale, ose duke e pohuar atë. Pohimi i të pandehurit për kryerjen e veprës penale jo gjithmonë është një e vërtetë absolute, pasi, në shpesh raste, i pandehuri ka rezultuar se ka marrë përsipër autorësinë e krimit me qëllim për të mbuluar apo shfajësuar një person tjetër apo i ndikuar nga rrethana subjektive.

Si çdo provë tjetër në procesin penal, edhe pohimi i të pandehurit nuk ka vlerë paracaktuese, por gjithmonë duhet parë në harmoni me provat e tjera, duke iu nënshtruar shqyrtimit gjyqësor. Verifikimi i mohimit apo pohimit të të pandehurit realizohet nëpërmjet mjeteve të tjera provuese, si eksperimenti, ballafaqimi apo ekspertimi etj.

Në vendimin Nr. 101, datë 11.04.2012, Kolegji Penal shprehet: *Në analizë të të gjitha fakteve të provuara nga provat e shqyrtuara, Kolegji Penal vlerëson se deklarimi i të gjykuarës si bashkëfajtorë në vrasje nuk është në përputhje me vlerësimin e provave të tjera të shqyrtuara. Pohimi i fajësisë prej të gjykuarës Nurije Facaj është kontradiktor dhe nuk përputhet me provat e tjera të shqyrtuara gjatë gjykimit. Nga procesverbalet e përgjimit ambiental, të zhvilluar midis të gjykuarës Nurije dhe vajzës së saj Vjollca Facaj, si dhe përgjimit të kryer gjatë bisedës midis vetë të gjykuarve, rezulton se e gjykuara Nurije Facaj ka pranuar autorësinë e krimit të vrasjes pa e kryer atë me qëllimin që të shpëtojë nga përgjegjësia penale të gjykuarin tjetër Brahim Facaj.*

³¹⁵ Ejup Sahiti, fq. 206.

³¹⁶ Ligji nr. 35/2017, "Për disa shtesa dhe ndryshime të Kodit të Procedurës Penale", neni 152/1.

³¹⁷ Vendimi nr. 205, datë 06.04.2005, i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

Pyetje që me të drejtë shtrojmë për diskutim është “nëse do të merren, shqyrtohen, konsiderohen dhe vlerësohen si provë deklarimet e dhëna nga i pandehuri gjatë gjykimit të shkurtuar, të cilat janë të ndryshme nga ato të dhëna gjatë fazës së hetimeve paraprake?”.

Për këtë rast, mendimet e studiuesve të së Drejtës Procedurale Penale janë të ndryshme. Në vlerësimin tonë, në kushtet që Kodi i Procedurës Penale parashikon se i pandehuri mund të japë deklarime në çdo fazë të gjykimit, gjykata, pavarësisht faktit se po gjykon me gjykim të veçantë, në kushtet që plotësohen kushtet e vendosura nga neni 149 i Kodit të Procedurës Penale, duhet t’i administrojë si prova deklarimet e dhëna. Por, sigurisht, këto deklarime duhet të vlerësohen me shumë rezervë dhe në unison me provat e tjera të administruara gjatë gjykimit.

*Si çdo provë tjetër, deklarimi i të pandehurit lidhur me rrethanat e ngjarjes i nënshtrohet verifikimit dhe vlerësimit kritik sipas bindjes së lirë të gjyqtarit.*³¹⁸

3.2.4. THËNIET E PALËVE PRIVATE

Paditësi civil dhe i padituri civil janë subjekte të procedimit penal në rastet e kushtet e përcaktuara në nenin 58 të K. Pr. Penale.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor, ata pyeten dhe u përgjigjen pyetjeve të bëra nga palët dhe gjykata në përputhje me parashikimet e nenit 168/1. Neni 168/1 i K. Pr. Penale, përcakton se për pyetjen e palëve private respektohen dispozitat procedurale që rregullojnë dëshminë si provë.

Neni 168³¹⁹ (Ndryshuar referenca me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

Pyetja e palëve private:

1. Në pyetjen e palëve private zbatohen dispozitat e parashikuara nga nenet: 153,154,157, paragrafi 2 dhe 361.

2. Kur pala refuzon t’i përgjigjet një pyetjeje, bëhet shënim në procesverbal.

Në procesin e pyetjes së palëve private, respektohen rregullat procedurale të parashikuara nga dispozitat e KPP-së që rregullojnë marrjen e dëshmisë si provë në procesin penal.

*Karakteristikë e këtij procesi është lidhja e këtyre palëve me pasojën civile të ardhur nga veprimet apo mosveprimet e të pandehurit në procesin penal, siç mund të jetë cenimi i pronës apo dëmshpërblimi në forma të caktuara.*³²⁰

Ashtu sikurse i pandehuri, edhe palët private gëzojnë të drejtën të refuzojnë t’u përgjigjen pyetjeve që iu bëhen në gjykim nga palët apo gjykata, dhe ky qëndrim i tyre pasqyrohet në procesverbalin e seancës gjyqësore. Por, nëse palët private pranojnë të pyeten e të dëshmojnë para gjykatës, gjykata duhet t’i pyesë ata brenda objektit dhe kufirit që ka parashikuar K. Pr. Penale për dëshminë si provë në nenin 153 të K. Pr. Penale. *Dëshmia e palëve në çdo rast i nënshtrohet vlerësimit subjektiv të*

³¹⁸ Ejup Sahiti, fq. 220.

³¹⁹ Kodi i Procedurës Penale, neni 168.

³²⁰ Vendimi nr. 357, dt.04.04.2007, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë.

*besueshmërisë si çdo dëshmitar tjetër, në harmoni me të gjitha faktet dhe rrethanat e tjera që garantojnë rezultat korrekt*³²¹.

Palët private, gjatë marrjes në pyetje në fazën e hetimeve paraprake, gëzojnë cilësitë e të dëmtuarit penal dhe i nënshtrohen procesit të marrjes në pyetje nga prokurori apo oficeri i policisë gjyqësore, ndërsa gjatë procesit gjyqësor i nënshtrohet procesit të marrjes në pyetje nga të gjitha palët, duke respektuar dëshirën dhe vullnetin e tij për dhënien e dëshmisë. Radha e pyetjes palëve private bëhet si për çdo provë tjetër. Gjatë pyetjes së palëve private në gjykim, thëniet e tyre mund të kundërshtohen, duke iu referuar deklarimeve të bëra gjatë hetimeve paraprake (neni 365 K. Pr. Penale). Sa i takon mënyrës procedurale të marrjes e administrimit të dëshmisë së palëve private në gjykim, nga gjykata respektohen dispozitat procedurale mbi pyetjen e dëshmitarëve dhe të gjitha këto veprime pasqyrohen në procesverbale.

Në dëshminë e tyre, këta persona i referohen fakteve dhe ngjarjeve të perceptuara drejtpërsëdrejti, por, nëse palët private në dëshminë e tyre u referohen thënieve të personave të tjerë, duhet detyrimisht të respektohet procedura dhe kërkesat e parashikuara nga neni 154 i K. Pr. Penale duke treguar dhe burimin si provë e parë.

*Në përgjigjet deklaruese të palëve private, për shkak të pozicionit të tyre delikat vepron parimi i veçueshmërisë, që lejon në mënyrë të arsyeshme që nga përgjigjet e tyre të dalin në formë të shkëputur të vërteta apo gënjeshtra, të cilat gjykohen në unison me provat e tjera të marra apo të verifikuara gjatë shqyrtimit gjyqësor.*³²²

3.2.5. BALLAFAQIMET

Në nenin 169 të K. Pr. Penale janë parashikuar si prova ballafaqimet. Ballafaqimi, si rregull, lejohet vetëm ndërmjet personave që kanë dhënë deklaratimet e tyre më parë dhe për të njëjtin fakt apo rrethanë, e cila konsiderohet thelbësore për zgjidhjen e çështjes penale ka mospërputhje në atë çfarë kanë deklaruar.

*Neni 169*³²³

Kushtet e ballafaqimit

(Shtuar pika 2 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Ballafaqimi lejohet vetëm ndërmjet personave që janë pyetur, kur ka mospërputhje midis tyre për fakte dhe rrethana të caktuara.

2. Ndalohet ballafaqimi i të pandehurit të rritur me viktimën ose dëshmitarin e mitur.

Ballafaqimi realizohet si në fazën e hetimeve paraprake, ashtu dhe nga ana e gjykatës në seancë gjyqësore, mbi kërkesën e palëve apo kryesisht, sipas rregullave të parashikuara nga neni 170 i këtij kodi. Procesi i ballafaqimit gjatë fazës së hetimeve paraprake realizohet nga organet proceduese, prokurori apo o.p.gj. Gjatë këtij procesi realizohet përballja e fakteve dhe rrethanat e kryerjes së veprës penale me burimet e provave.

³²¹ Dhimitër Lara, Koment mbi Kodin e Procedurës Penale, fq. 551.

³²² Dhimitër Lara, Koment mbi Kodin e Procedurës Penale, fq. 552.

³²³ Kodi i Procedurës Penale, neni 169.

PROVAT DHE PROCESI I TË PROVUARIT NË PROCESIN PENAL

*Në këtë fazë, ballafaqimi zhvillohet në praninë e drejtpërdrejtë të personave me deklaramë apo thënie të kundërta, duke i pyetur më pas ata nëse i konfirmojnë apo ndryshojnë ato. Personat e ballafaquar më pas ftohen të deklarojnë shpjegimet dhe qëndrimin e tyre, të cilat pasqyrohen në procesverbalin e ballafaqimit, i cili firmoset nga prokurori dhe personat e ballafaquar.*³²⁴

Nga ky proces, shpeshherë, ka rezultuar se janë marrë e administruar prova penale të rëndësishme, të cilat kanë provuar ose rrëzuar një deklaramë apo dëshmi të pavërtetë, duke ndikuar për zgjidhjen e drejtë të çështjes penale. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë në vendimin Nr. 811, datë 15.09.2010, ka arsyetuar se: *Kryerja e ballafaqimit ndërmjet personave që kanë dhënë deklaramë për fakte e rrethana që nuk përputhen me njëra-tjetrën, është detyrim që rrjedh nga neni 169 i K. Pr. Penale.*³²⁵

Marrja e provës nëpërmjet ballafaqimit mund të kryhet dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor të çështjes. Për këtë arsye, gjykata, për kryerjen e ballafaqimit, duhet të disponojë me vendim të ndërmjetëm, detyrim i cili parashikohet për marrjen e çdo prove në gjykimin e çështjes, sipas nenit 357 dhe 367 të K. Pr. Penale.

Ballafaqimi zhvillohet në seancën gjyqësore të marrjes së provave, midis dëshmitarëve, dëshmitarit e të pandehurit, apo midis të pandehurve, me dëshmi apo thënie të kundërta duke zbatuar parimin e kontradiktoritetit. Nga gjykata, këtyre personave i lexohen deklaramet e dhëna më parë dhe pyeten nëse i konfirmojnë apo ndryshojnë ato. *Ata, gjithashtu, ftohen të shpjegojnë qëndrimin dhe mospërputhjen, si dhe të bëjnë kundërshtime nëse kanë.*³²⁶

*Në zbatim të kësaj procedure, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë shprehet: ...gjykata duhet të verifikojë, analizojë dhe arsyetojë çdo kontraditë dhe mospërputhje në dëshminë e të dëmtuarës, duke çmuar këtë provë në përputhje me nenin 152 të K. Pr. Penale, nëpërmjet...*³²⁷.

Gjatë këtij procesi, palët kanë të drejtën t'i bëjnë pyetje personave që ballafaqohen. I gjithë ky proces dokumentohet në procesverbalin e seancës gjyqësore, në të cilin shënohen me hollësi: referenca ligjore, gjeneralitetet e personave që ballafaqohen, deklaramet që kanë dhënë deklaramet e mëparshme, si dhe të gjitha pyetjet, përgjigjet dhe shpjegimet e dhëna në ballafaqim nga të ballafaquarit.

Procesi i ballafaqimit nuk duhet kuptuar vetëm si përballje e deklaramëve dhe shpjegimeve të dhëna më parë nga palët në ballafaqim, por ai në përmbajtje të tij ka verifikimin e hollësishëm të çdo njoftimi kontradiktor që është dhënë më parë nga të ballafaquarit, duke evidentuar shpjegimet dhe kundërshtimet e drejtpërdrejta të palëve në këtë proces.

Verifikimi i dëshmisë si pjesë e rëndësishme e procesit të provuarit është trajtuar nga praktika gjyqësore, sikurse dhe në rastin e Vendimit Nr. 23, datë 20.01.2010, Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, sipas të cilit: *Është i domosdoshëm ballafaqimi kallëzues, dëshmitares D. C. me dëshmitarët (babain, nënën, tezen e saj), të cilëve i referohet*

³²⁴ Ferdinand Elezi, Punim doktore, fq. 100.

³²⁵ Vendimi Nr. 811, datë 15.09.2010.

³²⁶ Vendimi Nr. 660, datë 24.10.2007, i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

³²⁷ Vendimi Nr. 811, datë 15.09.2010, i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

*kallëzuesja në dëshminë e saj, por me kontradita dhe ndryshime thelbësore, nga ato çka ajo ka parashtruar në kallëzim.*³²⁸

Gjithashtu, sipas arsyetimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë: *Duke qenë se dëshmia e dëshmitarit G. Xh. dhënë para gjykatës ka mospërputhje me dëshminë e të dëmtuarës, në zbatim të nenit 169 të K. Pr. Penale, del i nevojshëm ballafaqimi i tyre, për t'i dhënë mundësi gjykatës që të krijojë bindjen në lidhje me ekzistencën e veprës penale dhe fajësinë e të pandehurit.*³²⁹

Ajo çka paraqet rëndësi në procesin e ballafaqimit është detyrim i organit procedues që rezultatet e ballafaqimit t'i verifikojë në lidhje me provat e tjera, për të vërtetuar përputhshmërinë e tyre. Në arsyetimin e vendimit të saj, Gjykata e Lartë është shprehur se: *Për verifikimin e provave dhe indicieve që ishin administruar është kryer edhe ballafaqimi midis të pandehurit dhe dëshmitarit R. S., i cili kishte marrë pjesë në kapjen në flagrancë të të pandehurit...në këtë rast shpjegimet e dëshmitarit përputheshin nga aktet e tjera...*³³⁰

Procesi i ballafaqimit duhet të realizohet kur kryerja e këtij veprimi procedural, çmohet e nevojshme për verifikimin e rrethanave të rëndësishme për objektin e të provuarit. Gjatë këtij procesi duhet të tregohet kujdes i veçantë të mos cenohen të drejtat, integriteti dhe siguria e personave me të cilët realizohet ballafaqimi.

3.2.6. NJOHJET

Për të realizuar vërtetimin e plotë të rrethanave të faktit të veprës penale mund të lindë si domosdoshmëri nga ana e organit procedues realizimi i njohjes së personave, të sendeve, të kufomave, të zërave, tingujve etj. (*nenet 171-175 dhe 313 të Kodit të Procedurës Penale*).

Kjo njohje realizohet duke u mbështetur në pasqyrimet që merren me anë të shqisave dhe që ruhen në kujtesën e njeriut, i cili ka patur kontakte me veprën penale të ndodhur. *Pra, njohja si mjet provues nuk ka lidhje me faktin penal, por me identifikimin e subjektit të veprës penale apo të provave materiale që lidhen me veprën penale. Shkak për njohje bëhet pikërisht dyshimi mbi dallimin, identifikimin e personit apo sendit.*³³¹

Kështu, personi mund të jetë dëshmitar, i dëmtuar, i pandehur etj., persona këta të cilët, me kërkesë të organit procedues ose me iniciativën e tyre, japin njoftime që mund të realizojnë njohjen dhe më pas konfirmimin e një rrethane juridike që mund të jetë njohja e një njeriu, sendi ose kufome që kanë parë në të kaluarën dhe që ka lidhje me veprën penale të kryer.

Çdo njeri, çdo send, ka shenjat e veta, të cilat, në shumicën e rasteve, nuk janë tek njerëz ose tek sende të tjera të ngjashme. Megjithatë, jo gjithnjë ndodh që të ketë një pasqyrim të saktë nga ana e dëshmitarit, të të pandehurit apo të të dëmtuarit për realitetin objektiv dhe shenjat që kanë objektet e ndryshme. Prandaj, në këto lloj njohjesh marrin vlerë të madhe faktorët objektivë dhe subjektivë. Praktika ka vërtetuar se njohja sipas

³²⁸ Vendimi Nr. 23, datë 20.01.2010.

³²⁹ Në vendimin Nr. 46, datë 30.01.2008.

³³⁰ Vendimi Nr. 216, datë 14.05.2008, i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

³³¹ Dhimtër Lara, Koment mbi procedurën penale, fq. 559.

PROVAT DHE PROCESI I TË PROVUARIT NË PROCESIN PENAL

përfytyrimeve që ruan një njeri mbi shenjat e personit ose të sendit është plotësisht e mundshme.

Në kategorinë e faktorëve objektivë përmendim:

- Ndrëimi i pamjaftueshëm në mjedisin ku është kryer vepra penale, i cili pengon perceptimin e plotë të shenjave të njeriut apo të sendit.
- Vëzhgimi i ngjarjes në një kohë të shkurtër, si rezultat i së cilës nuk realizohet shikimi i dukurisë me të gjitha anët e saj.
- Koha e gjatë që mund të ketë kaluar që nga momenti i ngjarjes e deri në momentin e paraqitjes për njohje, gjë që vështirëson të mbajturit mend të shenjave dalluese të njeriut apo të sendit.
- Largësia e vëzhgimit të objekteve të ngjarjes.

Ndërsa në kategorinë e faktorëve subjektivë hyjnë:

- Gjendja e njeriut në momentin e vëzhgimit të objektit të njohjes.
- Aftësia individuale e secilit për riprodhimin e këtyre shenjave.
Zbatimi dhe sqarimi i këtyre faktorëve është kusht i domosdoshëm për të marrë rezultate të bazuara dhe shkencore në procesin e paraqitjes për njohje.
Përveç njohjes me anë të të perceptuarit të shqisës së shikimit të drejtpërdrejtë në objektin e njohjes përfshihet dhe çdo gjë tjetër e perceptuar nëpërmjet të dëgjuarit, të prekurit apo dhe të nuhatjes.

Çdo objekt i botës materiale ka shenja të shumta, njerëzit e ndryshëm i perceptojnë këto objekte me mënyra të ndryshme. Paraqitja për njohje është një veprim mjaft i rëndësishëm.

Paraqitja për njohje ndryshon nga pyetja në disa drejtime:

- Në pyetje, dëshmitari jep njoftime mbi fakte të ndryshme, të cilat i ka perceptuar vetë ose është vënë në dijeni të tyre nga persona të tretë. Në paraqitjen për njohje, personi nuk mbështetet asnjëherë në njoftimet e personave të tretë.
- Në pyetje, dëshmitari riprodhon në formën e thënieve atë që ka perceptuar dhe mbajtur mend. Në paraqitjen për njohje, dëshmitari jo vetëm riprodhon atë që ka perceptuar dhe mbajtur mend mbi shenjat e objektit, por bën krahasimin e tyre me shenjat që ka objekti, i cili paraqitet për njohje dhe mbi bazën e këtij krahasimi njofton vetëm mbi një rrethanë: mbi identitetin, ngjashmërinë ose dallimin.
- Në pyetje, dëshmitari njofton për fakte, të cilat i ka njohur më parë, ndërsa për paraqitjen në njohje, personi nuk di nëse do të përcaktohet identiteti, ngjasimi apo dallimi, për arsye se kjo mund të bëhet vetëm në kohën e paraqitjes për njohje. Pikërisht për këto arsye dhe për vetë rëndësinë e paraqitjes për njohje, ajo është parashikuar si një veprim i pavarur në Kodin e Procedurës Penale.

Paraqitja për njohje ka si qëllim të përcaktojë nëse objekti i paraqitur për njohje është po ai objekt që është parë nga njohësi më parë dhe që ka lidhje me çështjen. Por, në disa raste, ajo mund të përcaktojë përkatësinë grupore, si p.sh., llojin e veshjes etj. Në të tilla raste ngushtohet rrethi i objekteve që kërkohen ose disa prej këtyre objekteve përjashtohen nga organi procedues.

Gjatë zhvillimit të njohjes, rëndësi paraqet dhe procedura e realizuar për marrjen e kësaj prove, si dhe dokumentimi i këtyre veprimeve procedurale në akte shkresore. Çdo

veprim i kryer nga organet proceduese, qoftë gjatë zhvillimit të hetimeve paraprake, ashtu dhe gjatë procesit gjyqësor, duhet detyrimisht të fiksohen në mënyrë analitike në procesverbale, formalitet ky i cili ndikon në vlefshmërinë apo pavlefshmërinë e këtij akti si mjet provues.

Gjykata Kushtetuese³³² në praktikën e saj në lidhje me respektimin e kërkesave detyruese në procesin e paraqitjes për njohje ka arsyetuar se *procedura e paraqitjes për njohje është zhvilluar në kundërshtim me nenet 171 e 172 të K. Pr. Penale, pasi, në aktin e njohjes nuk janë pasqyruar kushtet paraprake specifike për të realizuar njohjen si burim i ligjshëm prove.*

*Hetimi paraprak kryhet nga policia gjyqësore dhe prokurori, dhe se janë këto organe të procedimit penal që kanë detyrimin në këtë fazë të procedimit të zbatojnë dispozitat e këtij kodi lidhur me marrjen e provave, në këtë rast edhe njohjen e personave dhe sendeve.*³³³

Praktika gjyqësore ka mbajtur qëndrimin se gjatë zhvillimit të procesit të njohjes duhet të jetë i pranishëm edhe mbrojtësi i të pandehurit. Ligjshmëria e përfutimit të rrethanave të faktit nëpërmjet këtij veprimi procedural është e lidhur ngushtë si me respektimin e të drejtës së mbrojtjes, ashtu edhe me vetë procedurën e kryerjes së saj. Kështu, në vendimin Nr. 19,³³⁴ datë 02.04.2012, Gjykata Kushtetuese është shprehur se:

Në rastin në shqyrtim, e drejta e mbrojtjes së kërkuesit në lidhje me veprimin procedural “të njohjes së personit” rrjedh nga përcaktimi i pozitës juridiko-procedurale penale të tij përpara dhe gjatë kryerjes së këtij veprimi procedural. Ndërsa procedura e kryerjes së këtij veprimi duket të jetë konform parashikimeve ligjore të neneve 171-172 të Kodit të Procedurës Penale.

Ashtu sikurse dhe provat e tjera, edhe njohja i nënshtrohet parimit të besueshmërisë dhe objektivitetit të organit procedues në unison me provat e tjera. Njohja konsiderohet pozitive kur individualizimi i personit apo sendeve materiale bëhet në mënyrë të qartë nga subjekti të cilit i paraqiten për njohje, por nuk janë të rralla dhe rastet kur njohja rezulton negative. Ky proces i njohjes me rezultat negativ nuk mund të shërbejë as si provë dhe as si kundërprovë në procesin penal.

❖ **Përgatitja për paraqitjen për njohje**

Procesi i njohjes së personit apo të sendit përbëhet nga dy veprime hetimore të pavarura: nga pyetja e njohësit mbi shenjat e personit ose të sendit që do të njihet dhe nga paraqitja e këtij personi ose sendi për njohje.

Secili prej këtyre veprimeve hetimore mund të kryhet në kohë dhe në vende të ndryshme, por burim i një prove të re është vetëm akti i njohjes së personit apo të sendit.

Kryerja e këtij veprimi procedural brenda një afati kohor të arsyeshëm, është kusht i domosdoshëm dhe me rëndësi thelbësore në disa raste, pasi moskryerja në kohë e tij jo vetëm që mund të rezultojë me pasoja për objektin e të provuarit, por ai nuk mund të realizohet më në kohë dhe kushte të tjera.

³³² Vendimi Nr. 7, datë 27.04.2005, i Gjykatës Kushtetuese.

³³³ Vendimi Nr. 865, datë 21.12.2005, i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

³³⁴ Vendimi nr. 19, datë 02.04.2012, i Gjykatës Kushtetuese.

Ky kusht është sanksionuar dhe në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, konkretisht në Vendimin datë 27.05.2010, në çështjen Berhani kundër Shqipërisë: *Edhe po të supozohet se dëshmitarët okularë e identifikuan aplikantin si autor të krimit, Gjykata vëren se gjykatat kombëtare nuk iu përgjigjën ankesës së tij për pamundësinë e identifikimit të tij kur sulmuesi pretendohet se kishte veshur kokore. Nga aktet e dosjes rezultoi se nuk u zhvillua asnjë paraqitje për njohje, qoftë edhe me anë të fotografisë, megjithëse K. Pr. Penale e rregullonte qartë në kohën përkatëse organizimin e njohjes së personave dhe të sendeve.*³³⁵

Të njëjtin qëndrim ka mbajtur dhe Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë duke arsyetuar se: “megjithëse ka qenë rasti dhe të gjitha mundësitë për kryerjen e paraqitjes për njohje me fotografi të të gjykuarit, ky veprim nuk është kryer në një kohë që e dëmtuara ka dhënë vetëm emrin dhe karakteristika të të gjykuarit”.³³⁶

Në procesin e pyetjes së personit që do të bëjë njohjen merren njoftime me iniciativën e tij ose të organit procedues, se ai ka mundësi të bëjë njohjen e personit ose të sendit në bazë të shenjave që ka perceptuar në të kaluarën.

Në procesin e paraqitjes për njohje, njohësi bën krahasimin e shenjave të objektit (njeri, send, kufomë) me përfytyrimin e shenjave që ruhen në kujtesën e tij dhe në bazë të këtij krahasimi njofton se ka njohur personin ose sendin që ka parë në të kaluarën dhe që ka lidhje me ngjarjen.

Në paraqitjen për njohje qëndron gjithnjë rreziku i lindjes së dukurive të sugjestionimit. Metodatat taktike ndihmojnë pikërisht për ta mënjeluar këtë rrezik dhe për të nxjerrë rezultate të sakta. Një nga metodatat taktike më të rëndësishme është metoda sipas së cilës bëhet dallimi i personit ose sendit që është parë në të kaluarën vetëm atëherë kur ata ndodhen mes personash ose sendeve të tjera.

Për vlerën provuese të rezultateve të njohjes nuk ka rëndësi vetëm paraqitja e personit ose e sendit që do të njihet midis personash ose sendesh të tjera, por ndërmjet tyre duhet të ketë ngjashmëri.

Dallimi i theksuar midis objektit që do të njihet dhe objekteve të tjera do të tërhiqte vëmendjen e njohësit dhe do të krijonte kushte për sugjestionim. Në praktikë, Kolegji Penal ka prishur vendime të gjykatave kur dëshmitarët ose të dëmtuarit i është paraqitur për njohje një i pandehur i vetëm. Prandaj, organi procedues para zhvillimit të paraqitjes për njohje përgatitet për të zgjedhur objekte që ngjajnë me objektin që paraqitet për njohje.

Me rritjen e vlerës provuese të paraqitjes për njohje, si dhe me mënjanimin e dukurisë së sugjestionimit lidhet edhe zbatimi i një rregulli tjetër taktik. Njohësi nuk duhet t'i shohë në asnjë mënyrë objektet që paraqiten para procesit të njohjes.

Kjo sepse, një veprim i tillë do të zhvlerësonte fuqinë provuese të rezultatit të nxjerrë, për shkak se krijohen kushte për sugjestionim. Këtë del edhe rregulli se paraqitja për njohje nuk duhet të përsëritet (megjithëse ka edhe mendime se ajo duhet përsëritur).

Zakonisht, paraqitja për njohje zhvillohet në vendin ku kryhen hetimet. Por ajo mund të zhvillohet edhe në vendin ku njohësi ka perceptuar shenjat e objektit.

³³⁵ Vendimi datë 27.05.2010 i GJEDNJ-së.

³³⁶ Vendimi nr.23, datë 20.01.2010, i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

PROVAT DHE PROCESI I TË PROVUARIT NË PROCESIN PENAL

Procesi i njohjes në gjykim drejtohet dhe nga gjykata, dhe pasqyrohet në procesverbalin e seancës gjyqësore, duke pasqyruar në mënyrë analitike të gjitha veprimet proceduriale dhe rezultatet e saj.

❖ Paraqitja për njohje e personave

1. Paraqitja për njohje e personave parashikohet në nenin 171 të K. Pr. P.)³³⁷ (Ndryshuar me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

Njohja e personave

1. Kur lind nevoja për të proceduar në njohjen e një personi, organi procedues fton atë që duhet të bëjë njohjen që të përshkruajë personin, duke treguar të gjitha shenjat që mban mend dhe e pyet nëse ka qenë thirrur më parë për të bërë njohjen, si dhe për rrethana të tjera që mund të ndikojnë në vërtetësinë e njohjes.
2. Në procesverbal shënohen veprimet e parashikuara nga paragrafi 1 dhe deklaratimet e bëra nga personi që bën njohjen. Kur është e mundur, procedura e njohjes fotografohet ose regjistrohet.
3. Kur njohja bëhet nga një i mitur ose ndaj një të mituri, prania e psikologut është e detyrueshme. Organi procedues kryen njohjen në një mënyrë të tillë që personi që do të njihet të mos e shohë ose dëgjojë të miturin.
4. Njohja bëhet në praninë e mbrojtësit.
5. Mosrespektimi i rregullave të parashikuara nga ky nen përbën shkak për pavlefshmërinë e njohjes.

Neni 172/a³³⁸

Detyrimi për të marrë pjesë në njohje

(Shtuar me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

1. Personat e thirrur janë të detyruar të marrin pjesë në procedurën e njohjes.
2. Organi procedues mund të urdhërojë shoqërimin e detyrueshëm të personit të thirrur rregullisht që nuk paraqitet në vendin, ditën dhe orën e caktuar për njohje pa pasur shkaqe të arsyeshme.
3. Ndalohet shoqërimi i detyrueshëm i të miturit kur procedohet sipas paragrafit 3, të nenit 171, të këtij Kodi.

Njohja e personit ka për qëllim kryesisht përcaktimin e fajtorit. Por në praktikë ka raste kur ajo bëhet nga i pandehuri për të njohur dëshmitarin ose të dëmtuarin kur duhet verifikuar, p.sh., pohimi i tij. Njohja e personit bëhet:

- ❖ sipas shenjave të pamjes së jashtme;
- ❖ sipas veçorive të zërit, të fjalës dhe të ecjes.

Marrja e kësaj prove në bazë të këtyre kritereve i referohet dhe kushteve objektive në të cilat ndodhej personi, si dhe mundësinë reale që ka patur njohësi për të përfutur nëpërmjet organeve të shqisave të dhëna të mjaftueshme për identifikimin dhe njohjen e personit, zërit të tij apo sendit.

³³⁷ Kodi i Procedurës Penale, neni 171.

³³⁸ Kodi i Procedurës Penale, neni 172.

Rregullat e përgatitjes dhe të zhvillimit të njohjes së personit sipas shenjave të jashtme janë:

- Për njohje paraqitet personi të cilin njohësi nuk e ka njohur më parë. Në rast të kundërt nuk do të kishim paraqitje për njohje, por ballafaqim.
- Njohja e personit bëhet në bazë të shenjave të pamjes së jashtme, që ruhen në kujtesën e dëshmitarit, të të dëmtuarit dhe të të pandehurit. Në perceptimin e figurës së personit në plan të parë dalin shenjat, siç janë: shtati, mosha, seksi, tiparet e fytyrës, veshja etj. E palejueshme është paraqitja e personave me sekse të ndryshme.
- Procesi i njohjes përfshin dhe faktin që personat që do të njihen të jenë të veshur me atë veshje që ka patur i pandehuri në kohën e kryerjes së veprës penale. Në disa raste janë vetë veprimet e organit procedues që mund të shkaktojnë sugjestionim. Kështu, përbën rrezik për sugjestionim tregimi i fotografisë së personit që do të njihet, përmendja e emrit të tij, gjeste të ndryshme të organit procedues, paraqitja vetëm pa praninë e personave të tjerë të të pandehurit etj. Këto veprime janë shkak për zhvlerësimin e rezultateve të paraqitjes për njohje si provë.
- Personat e paraqitur për njohje qëndrojnë të gjithë së bashku. Personi që do të njihet ka të drejtë të zgjedhë vetë vendin se ku do të qëndrojë. Kjo është një veçori e rëndësishme për objektivitetin e paraqitjes për njohje. Në paraqitjen për njohje ka rëndësi dhe vëzhgimi ndaj qëndrimit që mban personi që do të njihet. Ai mund të pasqyrojë ndryshimet psikologjike të cilat nuk janë prova, por e orientojnë organin procedues të tregojë kujdes, sidomos kur personi shfaq shenja nervozizmi.

Sikurse përcakton në mënyrë eksplicite dispozita procedurale penale e sipërcituar në këtë procedurë duhet të respektohen në mënyrë kumulative të gjitha kërkesat e nenit 171, pasi mungesa e një prej kushteve të mësipërme, si dhe mospasqyrimi i tyre në proces verbal e bën aktin e njohjes të pavlefshëm si provë dhe, si rrjedhojë, të papërdorshëm.³³⁹

*Në procesin e njohjes është kusht ligjor që të bëhet në praninë e të paktën dy personave të ngjashëm me personin që njihet*³⁴⁰. Vlerësimi i vlefshmërisë të rezultateve të njohjes e ngarkon gjykatën jo vetëm me respektimin e kërkesave të ligjit, por edhe të metodikës dhe taktikës së ndjekur gjatë procesit të njohjes.

Shpeshherë, në praktikë është e vështirë realizimi i njohjes së drejtpërdrejtë, pasi personi që do t'i nënshtrohet njohjes është në mungesë ose mund t'i fshihet organeve të drejtësisë. Në të tilla kushte pamundësie objektive për të realizuar njohjen e drejtpërdrejtë të personit, K. Pr. Penale ka parashikuar mundësinë e organit procedues të realizojë njohjen nëpërmjet fotografisë.

Një njohje tjetër është njohja e personit nëpërmjet zërit. Njohja nëpërmjet zërit bëhet nga ana e organit procedues duke paraqitur njohësit persona me elemente dhe dialekt të ngjashëm, dhe jo lehtësisht të dallueshëm.

Në vendimin Nr. 688, datë 12.10.2005, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë citohet se: *Në paraqitjen për njohje nëpërmjet zërit, e dëmtuara ka deklaruar se zëri i ngjan*

³³⁹ Vendimi Nr. 7, datë 27.04.2005, i Gjykatës Kushtetuese.

³⁴⁰ Vendimi Nr. 7, datë 27.04.2005, i Gjykatës Kushtetuese.

shumë, me përqindje të lartë me zërin e një prej autorëve, me atë që është afruar tek dera e makinës...

Në praktikë shpesh ka lindur pyetja nëse “ka mundësi që, sipas përfytyrimit mendor që ruan personi në kujtesën e tij (njohësi) të identifikohet sendi, zëri i personit, apo personi nëpërmjet ecjes së tij?”.

Mendimet në radhët e juristëve janë të ndryshme, por, edhe sikur njoftimet e përfuara të vlerësohen si provë detyrimisht, sipas mendimit tonë, duhen vlerësuar në unanimitet me njoftimet e tjera të përfuara dhe rezultati i arritur nëpërmjet këtij mjeti të provës të çmohet si përforcim i rezultateve të tjera të njoftuara nga provat e administruara gjatë procesit gjyqësor.

❖ **Paraqitja për njohje të kufomave**

Paraqitja për njohje e kufomës ka këto veçori:

- Për njohje paraqitet vetëm një kufomë.
- Njohësi, po të jetë kallëzues i deklaramit të personit si të pagjetur, pyetet për shenjat e pamjes së jashtme para paraqitjes për njohje, ndërsa po të mos jetë i tillë pyetja paraprake është e panevojshme.
- Kufoma paraqitet për njohje pasi i bëhet pastrimi.
- Kufoma paraqitet për njohje me ato rroba që ka patur kur ndodhi vepra penale.
- Si njohës thirren dëshmitarë që banojnë në afërsi të vendit ku u zbulua kufoma e panjohur. Këta persona nuk pyeten paraprakisht.

❖ **Paraqitja për njohje e sendeve**

Paraqitja për njohje e sendeve është parashikuar si lloj i veçantë njohje në nenin 173 të K. Pr. Penale. Objekt i kësaj njohje mund të jenë:

- sende të ndryshme, të cilat kanë qenë objekt i kryerjes së veprës penale nga autori;
- mjetet e kryerjes së veprës penale të përdorura nga autori në kryerjen e veprës penale të fiksuara këto nga të dëmtuarit apo nga dëshmitarët okularë.

Rregullat procedurale që parashikohen për njohjen e personave, respektohen edhe sa i takon njohjeve të sendeve dhe njohjeve të tjera, duke garantuar që rezultati i njohjes të jetë produkt i njoftimeve të pavarura dhe të vërteta të njohësit.

Kështu, organi procedues përpara se të zhvillojë procesin e paraqitjes për njohje të sendit, duhet detyrimisht të gjejë e sigurojë jo më pak se dy sende të ngjashme me sendin që do të njihet dhe i vendos ato në kushte të njëjta, në ambiente ku nuk është prezent njohësi.³⁴¹

Më pas thirret njohësi dhe pyetet nëse njeh ndonjë prej sendeve, provave materiale, dhe e fton atë të shpjegojë e deklarojë rreth sendeve. Nëse ai deklaron se njeh dhe identifikon ndonjë send, provë në këtë njohje, ai duhet të tregojë se cilin send identifikon, duke shpjeguar me hollësi rreth këtij sendi. Ky proces njohje në cilësinë e

³⁴¹Vendimi Nr. 97, datë 04.04.2012, i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

provës penale, konsiderohet i rëndësishëm jo vetëm për faktin e realizimit të tij si mjet procedural, por ai i jep vlerë edhe vetë provës materiale të sekuestruar të pandehurit dhe që mund të ketë shërbyer për kryerjen e veprës penale.

Së fundmi, në çdo rast mbi kërkesat dhe kundërshtimet e palëve për marrjen e njoftimeve nga njohja, gjykata duhet të disponojë me vendim në lidhje me vlefshmërinë e rezultatit të njohjes si provë në procesin penal. Akti i njohjes, që të ketë fuqinë e provës, duhet të nënshkruhet nga të gjitha palët pjesëmarrëse në proces.

3.2.7. EKSPERIMENTI

Gjatë procedimit penal, shpesh, lind nevoja për të vërtetuar mënyrën si ka ndodhur një fakt. Eksperimenti ka në përmbajtje të tij riprodhimin, për aq sa është e mundur, të gjendjes si ka ndodhur fakti, duke përsëritur rrethanat e zhvillimit të faktit, kjo e bazuar në njoftimet dhe të dhënat që disponon organi i procedurës. Rezultatet e eksperimentit kanë karakter teknik, në mjaft raste edhe shkencor, pasi, gjatë kryerjes së eksperimentit, në riprodhimin e faktit, të ngjarjes, përdoren mjete teknike dhe shkencore nga specialistët e caktuar nga ana e organit procedues.

Eksperimenti përdoret për të provuar nëse ngjarja mund të shihej nga një vend i caktuar, nëse mund të dëgjohej biseda apo një zhurmë nga një distancë e caktuar, nëse gjurmët e frenimit të lëna në vendin e ngjarjes janë të automjetit që dyshohet dhe çfarë shpejtësie ka pasur automjeti etj.

Një eksperiment i plotë e shkencor, i jep mundësinë organit procedues për të krijuar një përfytyrim të qartë se si ka ndodhur fakti, ngjarja me të gjithë elementet e saj. Ai, gjithashtu, shërben edhe për të verifikuar saktësinë reale të fakteve e rrethanave që organi procedues disponon për ngjarjen, si dhe për të përcaktuar vërtetësinë e tyre.

Për shkak të rëndësisë dhe karakterit teknik që ka eksperimenti, për kryerjen e tij gjatë gjykimit të çështjes, gjykata duhet të disponojë me vendim të veçantë sipas nenit 177 të K. Pr. Penale, në të cilin përcaktohet objekti dhe kushtet e kryerjes së eksperimentit në gjykim.

Në gjykim, kryerja e eksperimentit drejtohet nga gjykata, i gjithë ky proces dokumentohet në procesverbalin përkatës të mbajtur nga sekretaria gjyqësore, në të cilin shënohen me hollësi: vendimi që ka disponuar kryerjen e tij, kushtet konkrete në të cilat ai realizohet, datën, orën, vendin, mjetet dhe pajisjet që përdoren, personat që marrin pjesë, specialistët dhe veprimet e tyre, mënyra e zhvillimit, rezultatet që dalin nga ky eksperiment, çdo njoftim që lidhet me objektin e eksperimentit dhe procesin e të provuarit. Këtij procesverbali i bashkëlidhen skicimet, fotografimet dhe filmimet e kryera gjatë eksperimentit.

Ligjvënësi në nenin 316/d të K. Pr. Penale, ndër të tjera, i ka njohur të drejtën prokurorit dhe të pandehurit të kërkojnë kryerjen e eksperimentit nga gjykata edhe gjatë hetimeve paraprake.

Në praktikën hetimore ka mjaft raste që, si rezultat i shkaqeve objektive, një provë e caktuar send, objekt apo edhe vendi i kryerjes së krimit etj., pëson ndryshime apo transformohet në mënyrë të pashmangshme. Këto ndryshime e bëjnë të pamundur edhe

riprodhimin e mënyrës si ka ndodhur vepra penale e çdo rrethane tjetër me interes për çështjen dhe objektin e të provuarit.

3.2.8. EKSPERTIMI

Qëllimi i procedimit penal është vërtetimi i fakteve që lidhen me veprën penale, rindërtimi i ngjarjes kriminale dhe identifikimi i personit që dyshohet për kryerjen e saj. Ky qëllim arrihet nëpërmjet: zbulimit, fiksimit, administrimit dhe çmuarjes së provave, sipas rregullave të caktuara në Kodin e Procedurës Penale.

Gjykata, gjatë fazës së hetimit gjyqësor, ndeshet në shumë raste me probleme për zgjidhjen e të cilave kërkohen njohuri të posaçme ose përvojë e caktuar në fushën e shkencës, teknikës, artit. Këto probleme kanë të bëjnë me konstatimin ose sqarimin e fakteve që kanë lidhje me çështjen në gjykim, kjo pasi palët janë të detyruara të paraqesin dhe të provojnë faktet mbi të cilat mbështesin pretendimet e tyre.

Në këtë proces të ndërlikuar njohjeje dhe vërtetimi, një rol të veçantë luan ndihma dhe ekspertiza e specialistëve të fushave të ndryshme. Ekspertimi është një provë e rëndësishme që synon të konstatojë, të sqarojë ose të vërtetojë faktet që kanë rëndësi për çështjen penale.

Ekspertimi si proces tekniko-shkencor, kryhet nga ana e specialistit (ekspertit, i cili, duke zotëruar njohuri apo mjeshtëri të posaçme teknike, profesionale dhe shkencore, arrin të verifikojë apo vërtetojë nga ana teknike e shkencore një fakt juridik-penal.

Mendimet e ekspertëve ndihmojnë në zbulimin e fakteve që kanë rëndësi për zbulimin e së vërtetës në procedimin penal, që nga hetimi paraprak deri tek shqyrtimi gjyqësor, dhe janë pikërisht ata që i konstatojnë faktet dhe japin mendimin për to, si rezultat i aftësive specifike që kanë në fushën e teknikës, të shkencës ose kulturës. Madje, në disa raste, marrja e kësaj prove (caktimi i ekspertit) është e domosdoshme, në të kundërt, kjo përbën premisë për prishjen e vendimit.

Në nenin 178/1 të K. Pr. Penale është përcaktuar objekti i ekspertimit dhe janë parashikuar rastet se kur mund të lejohet kryerja e tij, ndërsa në paragrafin e dytë të tij është parashikuar se nuk lejohet kryerja e tij për të përcaktuar profesionalizmin e të pandehurit në kryerjen e veprës penale, prirjet e tij kriminale, karakterin, personalitetin e tij dhe, në përgjithësi, cilësitë psikike që nuk varen nga shkaqe patologjike.

Në lidhje me definicionin e ekspertit, teoricienët kanë dhënë një definicion pothuaj të njëjtë. Kështu, eksperti është një person që zotëron njohuri të posaçme ose përvojë të caktuar në fushat e shkencës, teknikës, artit dhe që, në bazë të kësaj njohurie, kanë mundësi që para gjykatës të bëjnë përshkrimin e vërtetë të një gjendje të fakteve ose të nxjerrin përfundimin e saktë që pasojat derivojnë nga një gjendje e caktuar e fakteve.

Gjykata e thërret ekspertin për të dhënë mendimin e tij profesional lidhur me ndonjë fakt që ka ekzistuar në të kaluarën ose që ekziston në të tashmen. Fakti i tillë mund të jetë pjesë përbërëse e ndonjë ngjarje, e një veprimi të kryer, ose të jetë e lidhur me cilësinë a gjendjen e njerëzve apo të sendeve.

Ekspertiza është procesi i studimit nga ekspertët e objekteve që i janë vënë në dispozicion të tyre për të dhënë mendimin lidhur me probleme që kërkojnë njohuri të veçantë, sipas detyrës së caktuar nga gjykata.

Ekspertët sigurojnë dëshmi të fuqishme në gjykatë. Ata shpesh shihen si palë neutrale që janë të arsimuar mirë, me përvojë dhe i japin gjykatës përgjigje të rëndësishme, shpesh vendimtare.

Në mënyrë që të japë opinion të ekspertit për ndonjë çështje, zakonisht eksperti duhet të ekzaminojë dhe prova të tjera. Një ekzaminues mjekësor bën autopsinë e trupit, siguron mostra nga trupi dhe bën teste laboratorike. Ekzaminuesi financiar rishikon shënimet financiare, dokumentet bankare dhe transaksionet për të përcaktuar nëse paratë janë shpëlarë apo jo. Eksperti i shenjave të gishtërinjve duhet të studiojë me kujdes shenjat e gishtërinjve të të dyshuarit dhe ato që janë marrë nga skena e krimit. Eksperti i kompjuterave merr ‘shtëpizën’ e kompjuterit dhe tërheq të dhënat prej saj.

*Me përjashtim të rasteve kur eksperti dëshmon në mënyrë të përgjithshme për praktikën normale ose informacionin teknik, atij i duhet krijuar mundësia të shqyrtojë provat bazë. Nëse ekspertja ka bërë raport me shkrim, ky raport duhet të shpjegojë përzgjedhjen e analizës, si dhe metodologjinë dhe rezultatet. Nga ekspertja kërkohet të japë opinion specifik për gjykatën në bazë të ekspertizës së vet. Ky opinion duhet të jetë rezultat i kohës dhe përpjekjeve për të shqyrtuar provat dhe për të vënë në zbatim shkathësi shkencore dhe teknike. Ekspertët nuk duhet të japin opinionin e tyre personal.*³⁴²

Ekspertimet janë të shumëllojshme, dhe një kriter të përgjithshëm që mund të marrim për të bërë klasifikimin është dega e shkencës, e teknikës, e artit, njohuritë e së cilës përdoren për të bërë konstatimin ose sqarimin e faktit.

Në praktikën gjyqësore përdoren këto lloje ekspertimesh:

- ekspertimi mjekësor,
- ekspertimi psikiatrik,
- ekspertimi kimik,
- ekspertimi teknik,
- ekspertimi i dokumenteve,
- ekspertimi kontabël etj.

Kryerjen e ekspertimit, K. Pr. Penale e ka kushtëzuar me nevojën që mund të ketë procesi i të provuarit në zhvillimin e kërkimeve, marrjen e të dhënave dhe kryerjen e vlerësimeve nga ana e specialistëve me njohuri të posaçme teknike, shkencore dhe kulturore, të cilat lidhen me objektin e të provuarit.

Rezultatet dhe konkluzionet e ekspertimit, si provë penale në procesin penal, kanë një rëndësi mjaft të madhe. Ato në të shumtën e rasteve përcaktojnë: autorësinë e të pandehurit në kryerjen e veprës penale, ekzistencën ose jo të elementeve të figurës së veprës penale, cilësimin juridik të saj, dhe në tërësi me gjithë objektin e të provuarit.

Në pikën “1” të nenit 179³⁴³ është përcaktuar edhe kategoria e personave me njohuri të posaçme teknike, të specialistëve, të cilët mund të caktohen nga organi procedues për

³⁴² Jon Smibert, Parimi i provave.

³⁴³ Kodi i Procedurës Penale, neni 179.

kryerjen e ekspertimit në procesin penal. Kështu: *Caktimi i ekspertit bëhet duke e zgjedhur atë ndërmjet personave që janë regjistruar në librat e caktuar për këtë qëllim ose ndërmjet atyre që kanë njohuri të posaçme në degën përkatëse. Kur ekspertimi shpallet i pavlefshëm ose duhet të bëhet ekspertim i ri, organi procedues merr masa, kur është e mundshme, që detyra e re t'i besohet një eksperti tjetër.*

Ndërsa në doktrinën procedurale civile kanë ekzistuar pikëpamje të ndryshme për sa i përket natyrës së ekspertimit gjyqësor, por më të spikatura kanë qenë tri pikëpamje të cilat janë³⁴⁴:

Ekspertimi është vendim shkencor dhe eksperti gjykatës shkencor.

Ekspertimi është një dëshmi shkencore dhe eksperti një dëshmitar shkencor.

Ekspertimi është një këqyrje shkencore ose këqyrje direkte.

Pikëpamja se ekspertimi është një vendim shkencor dhe eksperti një gjyqtar shkencor është në kundërshtim me parimin themelor procedural të bindjes së lirë të brendshme të gjyqarit, sepse, po të jetë eksperti gjyqtar shkencor, atëherë gjyqtari e humb pavarësinë e tij, pasi, në këtë rast, vendimi i gjyqarit është krejt formal, pasi termi vendim shkencor tregon detyrim për zbatim, por kjo bie në kundërshtim me faktin që eksperti jep mendim dhe jo vendim.

Pikëpamja që e quan ekspertin si dëshmitar shkencor dhe ekspertimin si dëshmi shkencore sjell konfuzion mes dëshmitarit dhe ekspertit lidhur me funksionet dhe natyrën e tyre, duke mos marrë parasysh ndryshimet që ekzistojnë mes tyre.

Kështu, dëshmitari e njofton gjykatën për atë që ka parë, dëgjuar, pra për atë që ka njohuri, duke mos shfaqur mendimin e tij. Kurse eksperti nuk dëshmon mbi faktet, por ai i analizon faktet në kuadrin e njohurive të posaçme duke shfaqur mendimin e tij.

Pikëpamja e tretë që quan ekspertimin si këqyrje shkencore nisat nga fakti se ekspertimi është vetëm një mjet në duart e gjyqarit që bën ekspertimin, një lloj këqyrje direkte. Por kjo nuk është e vërtetë, pasi ekspertimi kryhet edhe pa bërë këqyrjen në vend, kur ai jep mendim vetëm në bazë të marrjes njohuri për rrethanat e çështjes, duke i njoftuar gjykatës elementet shkencorë të nevojshme për të siguruar rrethana të caktuara, por edhe sikur ekspertimi të bëhet me këqyrjen e një sendi, këqyrjen e bën eksperti dhe jo gjykata.

Në literaturën juridike ka patur debate, pavarësisht se ekspertimi është radhitur në legjislacionin procedural civil, krahas llojeve të provave, nëse ai është mjet që i shërben hetimit apo është provë.

Shumica e autorëve përkrahin mendimin se ai është mjet që i shërben hetimit. Unë mendoj se ekspertimi ka një natyrë të veçantë, pasi ky përdoret si mjet për të hetuar fakte (prova të sjella nga palët, p.sh., për të hetuar nëse dokumenti është i falsifikuar), por është njëkohësisht edhe burim nga i cili merren të dhëna për ekzistencën ose jo të fakteve të caktuara që kanë rëndësi për zgjidhjen e mosmarrëveshjes dhe, për më tepër, K. Pr. P e ka parashikuar ekspertimin si një nga llojet e provave.

Nga ky arsytim nxjerrim konkluzionin se ekspertimi ka karakteristika edhe si mjet që i shërben hetimit, por, pa diskutim, që i plotëson edhe kushtet për të qenë provë.

³⁴⁴ Alqiviadh Lamani, Procedura Civile e Republikës Popullore. Tiranë 1962, fq. 147.

Iniciativa për të caktuar ekspertin i takon, para së gjithash, gjykatës, pasi ajo më mirë se çdo subjekt tjetër i procesit civil mund të gjykojë për domosdoshmërinë e nevojës së caktimit të tij. Në këtë rast, përveç vlerësimit të kërkesave të palëve në proces, gjykata, kryesisht bazuar në nenin 367 të K. Pr. Penale, mund të veprojë vetë me iniciativë dhe të caktojë ekspertë me njohuri të posaçme kur vlerëson se mendimi i tyre i kualifikuar shkencor i shërben zbulimit të së vërtetës.

Si çdo lloj tjetër i provave, edhe ky burim i provave i duhet nënshtruar verifikimit dhe çmuarjes së faktit të konstatuar për saktësinë dhe vërtetësinë e tij, duke e vlerësuar bashkë me provat e siguruar nga burimet e tjera procedurale. Dy veçori, karakteristike vetëm për këtë burim prove, janë: e para, se për çdo rast konkret, mendimi i dhënë nga eksperti, është rezultat i ekzaminimit të një fakti, të një rrethane apo një dukurie; së dyti, kur ky mendim nuk mund të jetë gjë tjetër veçse rezultat i kërkesave të shtrëna për zgjidhje nga organi që procedon, nga i pandehuri apo mbrojtësi i tij. Të dyja këto veçori përcaktojnë natyrën juridike të tij, përmbajtjen konkrete³⁴⁵.

Edhe në Procedurën Civile parashikohet mënyra e caktimit të ekspertit, ku eksperti caktohet nga gjykata vetë, kryesisht, si rast përjashtimor dhe bazuar në kërkesat e palëve në proces për të kërkuar thirrjen e ekspertit.

Mirëpo, edhe në rastin e fundit, është gjykata ajo që gjykon mbi mundësinë e thirrjes së ekspertit dhe, kur e sheh të nevojshme një gjë të tillë, merr vendim pozitiv. Kështu, neni 225 i K. Pr. C. ka parashikuar që caktimi i ekspertit bëhet nga gjykata duke marrë edhe mendimin e palëve e të pjesëmarrësve në gjykim. Vendimi për emërimin e ekspertit i bëhet i ditur këtij prej sekretarit gjyqësor, duke iu njoftuar edhe data për t'u paraqitur në seancën e caktuar.

Për marrjen e të dhënave ose vlerësimeve nga specialistë të teknikës dhe të shkencës, organet proceduese në çdo fazë të procesit duhet të disponojnë me vendim për kryerjen e ekspertimit. Ky vendim detyrimisht i njoftohet ekspertit të caktuar, të pandehurit dhe mbrojtësit të tij.

Sipas nenit 179/2 të K. Pr. Penale, organi procedues në njoftimin që i bën të pandehurit dhe mbrojtësit të tij, i bën të ditur edhe të drejtën që ata kanë për të kërkuar përjashtimin e ekspertit, pjesëmarrjen e ekspertëve të tjerë, të marrë pjesë në kryerjen e ekspertimit (kur kjo gjë është e mundur) apo edhe të shtrojë pyetje të tjera veç atyre që janë përcaktuar në vendim, në të kundërt, në referim të nenit 129 të K. Pr. Penale, rezultatet e përfutuara nga akti i ekspertimit do të konsiderohen relativisht të pavlefshme. Problemi praktik që haset më shpesh në gjykim është rasti i caktimit të ekspertëve në procesin e hetimeve paraprake kur akoma nuk është regjistruar emri i personit dhe as nuk dihet se nëse mbi objektin e ekspertimit ka gjurmë ose të dhëna që e lidhin ngjarjen që po hetohet me një individ të caktuar, në mënyrë që t'i jepet e drejta për të marrë pjesë në procesin e kryerjes dhe realizimit të ekspertimit si një nga provat e parashikuara në Kodin e Procedurës Penale.

Problematika shfaqet në disa drejtime:

³⁴⁵ Fatmir Tartale, "Ekspertimi".

Së pari, në lidhje me caktimin e ekspertit nga lista e ekspertëve privatë ose nga Instituti i Policisë Shkencore ose Instituti i Mjekësisë Ligjore.

Së dyti, me caktimin e ekspertit dhe vlerësimin për objektivitetin e paanshmërinë e tij, si dhe mundësinë e përjashtimit ose dorëheqjen e ekspertit.

Së treti, me deklaratën e betimit nga ana e ekspertit si pjesë e procedurës së kërkuar nga ligji për të pasur një ekspertim të vlefshëm dhe rezultatin e tij të përdorshëm.

Në lidhje me caktimin e ekspertëve nga listat private të miratuara nga organet përkatëse, si dhe të licencuar, është e detyrueshme që ekspertët të vijnë dhe të marrin detyrën e të caktohen nominalisht nga ana e organit procedues.

Në lidhje me caktimin e ekspertëve nga institucione të posaçme, të cilat janë organike e Ministrisë së Brendshme ose Ministrisë së Drejtësisë, në praktikë haset problemi që në këto institucione dërgohet vendimi nga ana e organit procedues pa emër përkatës të një eksperti që do të kryejë ekspertimin dhe eksperti caktohet nga ana e titullarit të institucionit në varësi të ngarkesës së tij të punës.

Ky ekspert nuk vjen të bëjë betimin dhe të njihet nga subjektet e procedimit qoftë vendimmarrëse, qoftë kërkuese ose kontestuese në procedurë.

Në këtë mënyrë, edhe vetë organi procedues, por edhe pala nuk marrin pjesë në një fazë të rëndësishme të procesit të kryerjes së ekspertimit, pasi ata njihen me emrin e ekspertit vetëm kur akti i ekspertimit është realizuar.

Në këtë mënyrë, e drejta e caktimit të ekspertit nominalisht nga organi procedues, e përjashtimit të ekspertit nga palët ose gjykimi mbi pajtueshmërinë e tij me detyrën, apo paanshmërinë e tij në kryerjen e detyrës, është një e drejtë procedurale e parashikuar në ligj, por jo efektive.

Në çdo rast, nga ana e institucioneve përkatëse duhet të dërgohet ngarkesa e secilit prej ekspertëve dhe organi procedues të caktojë ekspertin nominalisht, si dhe eksperti të paraqitet e të marrë detyrën, pasi rrezikojmë që, me normalizimin e sistemit gjyqësor në drejtim të cilësisë së gjyqimit, këto akte të shpallen të pavlefshme dhe rezultati i tyre të bëhet i papërdorshëm, dhe, në fund të fundit, do të dëmtohet vetë procesi, pasi në mjaft raste objekti i ekspertimit, si rezultat i ndërhyrjes gjatë përpunimit shkencor, nuk i ruan më të dhënat e dobishme të hetimit. Procedura në praktikë është në kundërshtim të hapur me parashikimet procedurale, pasi kjo fazë e procesit është ezauruar pa u marrë mendim ose pa dhënë vendim vetë organi procedues mbi këto detaje që përshkruam më lart.

Procedura e kryerjes së betimit dhe marrjes së detyrës nga eksperti në rastin konkret është evituar, sepse, në institucionet përkatëse, ekspertët kanë bërë një betim të tyre si ekspertë kur janë emëruar ose përzgjedhur në ato detyra dhe betimin në aspektin procedural e konsiderojnë një anormalitet, rast pas rasti, kur detyra e tyre e përditshme është pikërisht kryerja e ekspertimeve në sektorin ose fushën që ata mbulojnë.

Neni 179³⁴⁶

Caktimi i ekspertit

³⁴⁶ Kodi i Procedurës Penale, neni 179.

PROVAT DHE PROCESI I TË PROVUARIT NË PROCESIN PENAL

(Shtuar fjalë në pikat 1 dhe 4 me ligjin nr. 8813, datë 13.6.2002; ndryshuar pika 3 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

Kur kërkimet dhe vlerësimet paraqiten shumë komplekse ose kërkojnë njohuri të ndryshme në disa degë, organi procedues i ngarkon kryerjen e ekspertimit disa ekspertëve. Në raste të veçanta, kur ekspertimi nuk mund të kryhet nga lista e ekspertëve të regjistruar pranë gjykatës, organi procedues, pasi merr paraprakisht mendimin e palëve, cakton ekspertë të tjerë, vendas ose të huaj, jashtë kësaj liste.

Rrethanat dhe faktet që duhet të vërtetohen e provohen në procesin penal nëpërmjet ekspertimit, në raste të caktuara, janë të vështira e komplekse. Në këto raste, bazuar në nenin 179/3 të K. Pr. Penale, organi procedues mund të caktojë disa ekspertë me njohuri në fusha të ndryshme, të cilëve u ngarkohet kryerja e ekspertimeve komplekse.

Njëkohësisht, risia e ndryshimeve të reja në Kodin e Procedurës Penale është mundësia e caktimit të ekspertëve të huaj jashtë listës së ekspertëve të regjistruar pranë Gjykatës. Në lidhje me këtë rast duhet cituar vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë të RSH-së, vendimi nr. 8, datë 17.06.2012, në të cilin janë marrë në shqyrtim kriteret e caktimit të ekspertëve të huaj në një ekspertim në territorin e RSH-së për efekt të një procedimi penal. Këtë vendim do e citojmë disa herë, pasi ka vlerë edhe tek ekspertimi dhe prova materiale si prova, por edhe tek përgjimi si mjet për kërkimin e provës.

Ndërmjet të tjerash, Gjykata e Lartë për këtë fazë të trajtimit të temës tonë shprehet se: *Pranimin e kërkesës paraprake për pavlefshmërinë relative dhe papërdorshmërinë, përkatësisht, të akteve procedurale dhe të akteve të ekspertimit të përpiluar nga eksperti amerikan Glenn Bard dhe eksperti nga Mbretëria e Bashkuar Adrian Philips, me arsyetimin se ishin kryer në shkelje të neneve 151 pika 4, 183 pika 1 dhe 509 të Kodit të Procedurës Penale. Në rastet kur eksperti është shtetas i huaj, përveç referimit në dispozitat e këtij Kodi, duhet vepruar në përputhje edhe me “Konventën Evropiane për Ndihmë Juridike në Fushën Penale”.*

Caktimi i ekspertit në një procedim penal rregullohet nga dispozitat e seksionit VI të K. Pr. Penale me titull “ekspertimet”. Në rastet kur eksperti është shtetas i huaj, përveç referimit në dispozitat e Kodit të Procedurës Penale, duhet vepruar në përputhje edhe me “Konventën Evropiane për Ndihmë Juridike në Fushën Penale”, ratifikuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me ligjin nr.8498, datë 10.06.1999. Detyrimi për t’iu referuar Konventave Evropiane është vetëm për ata ekspertë që janë shtetas të atyre vendeve që janë palë në këtë Konventë.

Konventa në titullin VII të saj rregullon, ndër të tjera, edhe thirrjen e ekspertëve të huaj nga dhe në shtete palë të kësaj konvente.

Nga ana e prokurorëve nuk janë respektuar dispozitat e seksionit II “Letërporositë për jashtë shtetit”, parashikuar nga neni 509 e vijues, si dhe dispozitat ligjore të parashikuara në kreun II Seksioni VI (Ekspertimi), nenet 179-183/1 të Kodit të Procedurës Penale në lidhje me caktimin e ekspertit amerikan dhe atij anglez, ndërsa për këtë të fundit nuk janë respektuar as detyrimet që rrjedhin nga dispozitat ligjore të Konventës Evropiane për Ndihmë Juridike në Fushën Penale, ratifikuar me ligjin nr.8489, datë 10.06.1999, si dhe të ligjit nr.10193, datë 03.12.2009, “Për Marrëdhënien Juridiksionale me Autoritetet e Huaja në Çështjet Penale”.

Duke pranuar si ekspertë persona privatë të huaj, si dhe duke u ngarkuar detyra e marrë mendimin e tyre në rrugë jo zyrtare, jashtë detyrimeve ligjore të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale dhe në Konventën Evropiane për Ndihmë Juridike në Fushën Penale, organi i akuzës i ka përjashtuar ekspertët realisht nga çdo përgjegjësi, aq më tepër nga përgjegjësia penale që mund të mbajnë sipas ligjeve përkatëse në rastin e veprës penale të ekspertimit të rremë.

Nëse organi i akuzës do të kishte ndjekur rrugën ligjore të përcaktuar në Kodin e Procedurës Penale, në Konventën Evropiane për Ndihmë Juridike në Fushën Penale, si dhe në ligjin nr.10193, datë 03.12.2009, “Për Marrëdhëniet Juridiksionale me Autoritetet e Huaja në Çështje Penale”, ekspertët e huaj duhej të bënin betimin dhe të merrnin përgjegjësinë përpara organit kompetent të shtetit të tyre, gjë që do të shërbente si garanci që ekspertimet do të ishin të sakta.

Sipas nenit 509/1 të Kodit të Procedurës Penale, i cili nuk vjen ndesh me asnjë dispozitë të Konventave të mësipërme apo me aktet e tjera ndërkombëtare, kërkesat e gjykatave dhe prokurorive për letërporosi jashtë shtetit, të drejtuara autoriteteve të huaja, për njoftimet dhe marrjen e provave, i dërgohen Ministrisë së Drejtësisë, e cila merr masa për t’i nisur ato. Vetëm në rastet e ngutshme, sipas pikës 5 të këtij neni, autoriteti procedues mund të vendosë nisjen direkt të akteve duke informuar Ministrinë e Drejtësisë. Pra, edhe në rastet përjashtimore, në rastet e ngutshme, organi procedues ka detyrimin ligjor që patjetër të informojë Ministrinë e Drejtësisë. Siç rezulton nga dosja, këto dokumente, këto veprime nuk kanë kaluar nëpërmjet këtij institucioni të ngarkuar me ligj, gjë që konfirmohet në përgjigjen e ministrit të Drejtësisë me shkresën nr.821/1, datë 31.01.2011.

Paragrafi i fundit i kësaj dispozite ka parashikuar detyrimin që ka eksperti i caktuar për kryerjen e ekspertimit, me përjashtim të rasteve kur ai ka papajtueshmëri ose nuk është kompetent dhe nuk ka mundësi të kryejë ekspertimin e ngarkuar.

Në nenin 180³⁴⁷ të K. Pr. Penale, është përcaktuar kategoria e personave, të cilët nuk mund të caktohen dhe nuk mund të kryejnë detyrën e ekspertit, dhe më konkretisht: a) i mituri, ai që ka ndalim ligjor ose i është hequr zotësia juridike për të vepruar ose vuan nga një sëmundje mendore; b) ai që është pezulluar, qoftë edhe përkohësisht, nga detyrat publike ose nga ushtrimi i një profesioni; c) ai, ndaj të cilit janë marrë masa sigurimi personal; ç) ai që nuk mund të pyetet dëshmitar apo të merret përkthyes, ose që ka të drejtë të mos bëjë dëshmi ose përkthim.

Në përputhje me nenin 181 të K. Pr. Penale, përjashtimi i ekspertit mund të bëhet mbi kërkesën e palëve apo kryesisht nga organi i procedurës kur konstaton rast papajtueshmërie sipas parashikimeve të mësipërme.

Nga organi procedues merren masat e nevojshme duke njoftuar e pyetur ekspertin mbi ekzistencën apo jo të shkaqeve që lidhen me papajtueshmërinë me detyrën e ekspertit, sikurse vetë eksperti është i detyruar të deklarojë atë sipas detyrimeve që rrjedhin nga neni 181/2 i K. Pr. Penale.

³⁴⁷ Kodi i Procedurës Penale, neni 180.

PROVAT DHE PROCESI I TË PROVUARIT NË PROCESIN PENAL

Paraqitja e shkakut për përjashtimin e ekspertit, nga palët apo dhe eksperti, duhet të bëhet përpara caktimit të tij, ose kur ato kanë lindur më pas, përpara se eksperti të ketë dhënë konkluzionet.

Bazuar në nenin 181/4 të këtij Kodi, organi procedues, për përjashtimin ose jo të ekspertit të caktuar, vendos me vendim të arsyetuar. Nëse vendoset përjashtimi i ekspertit, caktohet ekspert tjetër për kryerjen e ekspertimit.

Në mënyrë të tillë që akti i ekspertimit të ketë vlerë dhe të merret si provë duhet që eksperti të jetë i paanshëm, të mos ketë interes për çështjen dhe të mos jetë i lidhur me palët në marrëdhënie personale ose gjaku (kusht i cili është i vlefshëm edhe për gjyqtarin).

Në respektim të parashikimeve të nenit 182 dhe 183, organi procedues disponon ekspertimin me vendim të motivuar, i cili përmban caktimin e ekspertit, paraqitjen e përmbledhur të rrethanave të faktit, tregimin e ditës, të orës dhe të vendit të caktuar për paraqitjen e ekspertit.

Së dyti, eksperti thirret nga organi i procedurës të paraqitet për verifikimin e identitetit të tij para se të marrë detyrën, të pyetet nëse ekziston shkak papajtueshmërie apo të mungesës së detyrimit për të kryer detyrën, paralajmërohet për përgjegjësinë penale në kryerjen e ekspertimit, si dhe marrjen e deklaratës me shkrim nga eksperti sipas parashikimeve të nenit 183/1 të K. Pr. Penale.

Në këtë moment procedural përfshihet edhe marrja nga eksperti i akteve apo materialeve të nevojshme që disponohen nga organi procedues. Në referim të nenit 184 të K. Pr. Penale, eksperti ka të drejtë të jetë prezent në kryerjen e veprimeve të caktuara procedurale që lidhen me ekspertimin e ngarkuar.

Për qëllime të ekspertimit, ai mund të autorizohet të jetë i pranishëm në pyetjen e palëve apo marrjen e provave të tjera. Në rastet kur ekspertimit do t'u nënshtrohen disa persona, organi procedues merr masa për të siguruar paraqitjen e tyre dhe respektimin e detyrimeve që lidhen me veprimet e ekspertit.

Në nenin 185 të K. Pr. Penale, parashikohet se rezultatet dhe konkluzionet e ekspertimit të kryer, ekspertët i japin në aktin e ekspertimit në formë të shkruar, të cilin e paraqesin përpara gjykatës.

Paraqitja e aktit të ekspertimit, njohja e rezultateve të tij nga palët në proces, si dhe pyetja e ekspertëve rreth mendimit e konkluzioneve të nxjerra nga ekspertimi apo për rrethana të tjera që çmohen të nevojshme, shërbejnë për vlerësimin e verifikimin e rezultateve të ekspertimit. Në gjykim, ekspertët pyeten nga palët dhe gjykata rreth aktit të ekspertimit të kryer dhe rezultateve të tij, duke respektuar kërkesat e ligjit mbi pyetjen e dëshmitarëve.

Rezultatet dhe konkluzionet e ekspertimeve të dhëna nga ekspertët, në mënyrë që të pasqyrojnë në mënyrë të qartë rrethana dhe fakte që lidhen me veprën penale, duhet të jenë të plota, kategorike dhe jo të mundshme.

Të njëjtin qëndrim ka mbajtur dhe Kolegji i Gjykatës së Lartë në Vendimin Nr.235³⁴⁸, datë 19.09.2012, ku, ndër të tjera, janë shprehur se:

³⁴⁸ Vendimi nr. 235, datë 19.09.2012, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

Nga ana e Gjykatës së Apelit, në respektim të parimit të kontradiktorialitetit dhe barazisë së palëve në proces, ka qenë e domosdoshme thirrja e ekspertëve apo ngritja e një grupi tjetër mjekësh, për më shumë që çështja në fjalë ka plotësisht përmbajtje teknike mjekësore, kështu që njohuritë e gjykatës në këtë fushë janë të kufizuara.

...Në këto rrethana, vendimi i mësipërm do të priset duke e kthyer çështjen për rigjykim me një tjetër trup gjykues, duke i lënë për detyrë Gjykatës së Apelit Gjirokastër të riçelë hetimin gjyqësor, duke rithirrur ekspertët mjeko-ligjorë, të cilët kanë përgatitur aktin e ekspertimit për t'u dhënë përgjigje të gjitha çështjeve të mësipërme apo dhe të tjerave, të cilat mund të lindin gjatë gjykimit apo ato që do të dojë vetë gjykata për të trajtuar. Gjykata e Apelit, në çmim të saj, mund të thërrasë dhe ekspertë të tjerë apo një grup ekspertësh mjeko-ligjorë, për të përcaktuar në mënyrë të saktë e pa ekuivoke lidhjen ndërmjet veprimeve apo mosveprimeve të të gjykuarës me pasojën e ardhur...

Në fund, vlen të theksojmë se, pavarësisht se mendimi i ekspertëve ka karakter shkencor dhe vërtetimi i fakteve (ekzistenca ose jo e një fakti e rrethane), në përgjithësi, është kategorik, kjo provë nuk mund të ketë në asnjë rast vlerë më të madhe apo të paracaktuar në raport me provat e tjera.

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë në Vendimin Nr.885³⁴⁹, datë 06.10.2010, është shprehur se: *Për sa më lart, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë e gjen të bazuar në ligj vendimin e Gjykatës së Apelit Shkodër në lidhje me fajësinë e të gjykuarit Darushi për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 290/1 i Kodit Penal.*

..Gjykata e Apelit Shkodër ka parashtruar qëndrimin e saj në lidhje me faktin se përse nuk i merr në konsideratë konkluzionet e arritura në aktin e ekspertimit auto-teknik, duke radhitur, së pari, kontradiktat e këtij akti me atë të administruar gjatë fazës së hetimeve paraprake, sikundër duke çmuar provat e tjera të administruara gjatë gjykimit (dëshmi) dhe përfundimet që ajo vetë (gjykata) ka arritur në lidhje me dinamikën e kryerjes së veprës penale...

Dhe në Vendimin Nr.1031³⁵⁰, datë 07.12.2010, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë është shprehur se: *Ndryshe nga ky arsyetim logjik dhe që Kolegji e konsideron të drejtë, Gjykata e Apelit për Krime të Rënda, në të gjithë arsyetimin e vendimit të saj, duke i dhënë vlerë të paracaktuar aktit të ekspertimit daktiloskopik, e ka deklaruar të gjykuarin fajtor, duke përmendur si prova në favor të akuzës, të tilla, si këqyrja e vendit të ngjarjes, procesverbali i kapjes në flagrancë, apo shpjegimet e dhëna nga punonjësit e policisë, edhe pse këto prova tregojnë faktin se ka ndodhur një vepër penale, por kurrësi nuk mund të konsideroheshin si prova që gjykata të krijonte bindjen në fajësinë e të gjykuarit H. B., ndërkohë që në asnjërën prej tyre, përveç aktit të ekspertimit daktiloskopik, nuk përmendet apo figuron emri i të gjykuarit Hajri Buci.*

³⁴⁹ Vendimi nr. 885, datë 06.10.2010, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

³⁵⁰ Vendimi nr.1031, datë 07.12.2010, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

3.2.9. DOKUMENTET

Në nenet 191-197 të Kodit të Procedurës Penale, përcaktohen llojet e dokumenteve që marrin cilësinë e provës penale dokumentare, rregullat procedurale në lidhje me marrjen, administrimin dhe vlerësimin e tyre në procesin penal.

Në varësi të paraqitjes së fakteve, personave, vendeve dhe sendeve, dokumentet mund të jenë grafike, të shkruara ose të natyrave të tjera (filmim, fotografi, shirita të regjistruar) etj. Dokument me cilësinë e provës penale konsiderohet çdo dokument që përmban të dhëna apo që shërben për të dhënë njoftime që lidhen me fakte dhe rrethana të veprës penale, identifikimin e autorëve dhe fajësinë e tyre, pasojën e ardhur, si dhe njoftime të tjera që shërbejnë për zgjidhjen e drejtë të çështjes penale, të marra në përputhje me kërkesat e ligjit procedural penal.

Neni 193³⁵¹

Marrja e procesverbaleve të procedimeve të tjera

(Ndryshuar me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)

- 1. Lejohet marrja e procesverbaleve të marrjes së provës të procedimeve të tjera penale që kanë të bëjnë me sigurimin e provës ose me provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor.*
- 2. Lejohet marrja e procesverbalit të provës në një gjykim civil të përfunduar me vendim të formës së prerë.*
- 3. Në rastet e parashikuara në paragrafët 1 dhe 2, procesverbalet e deklarimeve mund të përdoren kundër të pandehurit vetëm nëse mbrojtësi i tij ka qenë i pranishëm në marrjen e tyre.*
- 4. Lejohet marrja e akteve të veprimeve që nuk mund të përsëriten, përfshirë edhe deklaratimet e të pandehurit, kur provohet pamundësia objektive e marrjes, e pa parashikueshme në kohën e kryerjes së veprimit.*
- 5. Përveç rasteve të parashikuara në paragrafët e mësipërm, procesverbalet e provës mund të përdoren në shqyrtimin gjyqësor vetëm kur i pandehuri jep pëlqimin. Në rast të kundërt, ato mund të përdoren për bërjen e kundërshtimeve të parashikuara nga nenet 362 dhe 365 të këtij Kodi.*
- 6. Palët kanë të drejtë të kërkojnë pyetjen e personave, deklaratimet e të cilëve janë marrë sipas parashikimeve të këtij neni.*
- 7. Vendimet e formës së prerë mund të merren për qëllime të provës lidhur me ekzistencën e faktit, duke u vlerësuar në unitet me provat e tjera.*

Këto ndryshime të pasqyruara në nenin 193 ishin të nevojshme për rregullimin e rasteve të përdorimit të deklarimeve të dhëna gjatë fazës së hetimeve paraprake edhe nga i pandehuri, duke u lejuar përdorimi i tyre vetëm kur këto deklaratime janë marrë në praninë e mbrojtësit, ose në rastin kur i pandehuri jep pëlqimin e tij.

³⁵¹ Kodi i Procedurës Penale, neni 193.

PROVAT DHE PROCESI I TË PROVUARIT NË PROCESIN PENAL

Këto ndryshime garantojnë mbrojtjen e të drejtave të të pandehurit në proces, duke rregulluar problematikën aktuale mbi përdorimin e deklarimeve të dhëna gjatë fazës së hetimeve paraprake.

Dokumentet merren në proces zakonisht me kërkesën e palëve dhe, në disa raste, edhe me iniciativën e gjyqtarit. Edhe në këtë rast, për marrjen dhe administrimin e provave shkresore, respektohen me rigorozitet kërkesat e përgjithshme për marrjen dhe administrimin e provave materiale, si dhe ato që lidhen me administrimin e provave gjatë gjykimit të çështjes.

Parashikimet e bëra në nenin 191 të K. Pr. Penale përcaktojnë se dokumentet lejohen të merren kur ato përfaqësojnë fakte dhe japin njoftime në lidhje me objektin e të provuarit, si dhe veprimet që kryen në marrjen e tyre.

Referuar kërkesave të përgjithshme për marrjen dhe administrimin e provave, edhe provat shkresore lejohet të merren kur kanë lidhje me objektin e të provuarit sipas kërkesave dhe prej burimeve të njohura nga ligji.

Provat shkresore merren e administrohen nga ana e gjykatës me vendim, mbi kërkesën e palëve ose edhe kryesisht. Në këtë rast, provat shkresore të marra nga gjykata në gjykim kanë vlerën e provës gjyqësore. Në lidhje me këto prova shkresore nga ana e palëve në seancë gjyqësore bëhen vlerësimet dhe kundërshtimet e nevojshme për cilësitë, lidhjen që ato kanë me objektin e të provuarit, njoftimet që ato japin, vlefshmërinë e tyre etj.

Provat dokumentare, shkresore, sipas parashikimeve të legjislationit tonë procedural penal, mund t'i klasifikojmë sipas grupimeve të mëposhtme:

1. Dokumentet që përbëjnë në vetvete provë materiale, të cilat sigurohen nëpërmjet mjeteve të kërkimit të provave ose kur paraqiten nga palët në proces. Këto janë dokumente të cilat merren, administrohen dhe vlerësohen nga organi procedues në cilësinë e provës materiale dhe në to gjenden elemente dhe gjurmë që provojnë kryerjen e veprës penale, autorësinë e saj e rrethana të tjera në lidhje me objektin e të provuarit.
2. Dokumentet që japin njoftime dhe lidhen me gjendjen gjyqësore, personalitetin e të pandehurit, të dëmtuarit apo edhe të dëshmitarit, kur fakti për të cilin procedohet duhet të vlerësohet në lidhje me sjelljen ose cilësitë morale të këtyre personave. Gjendja gjyqësore e këtyre personave verifikohet nga ana e subjekteve procedurale, bazuar në të drejtën e njohur nga ligji në nenin 484 të K. Pr. Penale.
3. Procesverbalet e sigurimit të provës, si dhe ato të marrjes së provave të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor penal apo edhe civil. Sikurse kemi shpjeguar më lart, njoftimet e dhëna nga provat pasqyrohen dhe dokumentohen në procesverbale të mbajtura nga organi procedues gjatë marrjes së këtyre provave. Në mjaft raste, njoftimet e dhëna nga këto prova lidhen me objektin e të provuarit në çështje të tjera dhe kanë rëndësi për zgjidhjen e drejtë të tyre.
4. Procesverbalet e veprimeve të papërsëritshme të kryera nga policia gjyqësore dhe prokurori gjatë fazës së hetimit paraprak. Gjatë fazës së hetimit paraprak nga ana e policisë gjyqësore dhe prokurorit kryen veprime procedurale në kuadër të ushtrimit të ndjekjes penale sipas kërkesave të ligjit. Një pjesë e tyre janë konsideruar si

veprime të papërsëritshme, për shkak se ato më pas nuk mund të përsëriten dhe realizohen në kushte e rrethana të tjera nga këto subjekte apo subjekte të tjera procedurale. Veprimet procedurale, si policia gjyqësore dhe prokurori i dokumentojnë në procesverbalet përkatëse, të cilat, në përmbajtje, kanë njoftimin sipas veprimit të kryer, njoftim ky i cili lidhet me objektin e të provuarit në procesin penal.

5. Vendimet gjyqësore të formës së prerë. Këto vendime mund të konsiderohen dhe të shërbejnë si prova dokumentare për të provuar ekzistencën e një fakti (*që është përcaktuar nga vendimi civil apo penal i formës së prerë*), në këtë rast vlera e tyre si provë vlerësohet në unitet me provat e tjera.
6. Çdo dokument që pasqyron fakte dhe jep njoftime për objektin e të provuarit, për persona apo sende, njoftime këto të cilat merren dhe administrohen nëpërmjet fotografimit, filmimit, fonografimit ose çdo mjete tjetër. Nëse dokumenti rezulton se është prishur apo zhdukur, kopje të këtij dokumenti. Këto dokumente janë marrë, administruar dhe vlerësuar nga gjykata sipas vlerës dhe njoftimit që ato kanë dhënë në lidhje me çështjet objekt gjykimi.

Dokumentet për t'u pranuar si provë duhet të kenë qartësi dhe prejardhje të sigurt. Jo çdo dokument apo provë shpresore mund të merret në cilësinë e provës penale nëse ai nuk përmban cilësitë dhe elementet e saj përbërës dhe që e lidhin atë me objektin e të provuarit në procesin penal. Organet proceduese kanë të drejtë të marrin dokumente që përfaqësojnë fakte, persona ose sende. Ato që i kanë dokumentet detyrohen t'i dorëzojnë ato. Dokumentet që përbëjnë provë materiale duhet të merren cilido qoftë personi që i ka krijuar ose i mban.

3.2. Dokumenti elektronik

“Dokument elektronik” është informacioni i regjistruar në atë mënyrë që kërkon një kompjuter dhe/ose pajisje dhe programe të tjera elektronike për t'u përdorur, për t'u interpretuar, shfaqur dhe përpunuar në mënyrë të kuptueshme nga një individ.

Dokumentet elektronike mund të kenë “lindur” në formë elektronike apo të jenë konvertuar në formë të tillë si pasojë e proceseve të dixhitalizimit dhe përfshijnë dokumente në tekst, në imazhe, në zë dhe video.

Ligji nr.10273³⁵², datë 29.04.2010, “Për dokumentin elektronik” .

Ky ligj është miratuar në vitin 2010 dhe është hartuar nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit me asistencë të ekspertëve ndërkombëtarë. Ligji ka përkufizime të qarta për dokumentin elektronik dhe pjesët e tij përbërëse.

Në të përcaktohen gjithashtu edhe kriteret e vlefshmërisë ligjore, të cilat kërkojnë në mënyrë të domosdoshme shoqërimin e dokumenteve elektronike me nënshkrimin elektronik dhe metadatat korresponduese. Sipas tij:

“Dokument elektronik” është çdo informacion i krijuar me “cilësi dokumentare”, i dërguar, i marrë ose i ruajtur në formë elektronike nga një sistem kompjuterik apo nga një mekanizëm i ngjashëm dhe që plotëson kushtet për vlefshmërinë, në përputhje me

³⁵² Ligji nr.10273, datë 29.04.2010, “Për dokumentin elektronik” .

PROVAT DHE PROCESI I TË PROVUARIT NË PROCESIN PENAL

nenet 5 deri në 9 të këtij ligji. Përmbajtja e dokumentit elektronik përfshin të gjitha format e të dhënave, pasqyruar me shkronja, numra, simbole, zë dhe imazh. “Cilësi dokumentare” është informacioni detyrues që i bashkëlidhet ose shoqëron dokumentin elektronik, të tillë si: nënshkrimi elektronik, koha e krijimit, emri i krijuesit dhe të dhëna të tjera që krijohen së bashku me dokumentin elektronik, me qëllim regjistrimin, ruajtjen e autenticitetit, tërësinë dhe vlefshmërinë e dokumentit elektronik përgjatë ciklit të dokumentimit.

Në nenin 5 të këtij ligji përcaktohet dhe vlefshmëria ligjore e dokumentit elektronik: Dokumenti elektronik ka vlefshmëri ligjore vetëm në ato raste kur ai krijohet, dërgohet, merret, mbahet dhe ruhet, duke zbatuar teknologjitë e informacionit, nëpërmjet kompjuterëve, sistemeve kompjuterike, pajisjeve të ngjashme dhe programeve elektronike, duke përmbushur plotësisht kërkesat e përcaktuara në nenet 6, 7 dhe 8 të këtij ligji.

Në nenin 6 të këtij ligji përcaktohen, kritere të dokumentit elektronik:

Përgjatë ciklit të dokumentit, në veprimet e përfshira në të, dokumenti elektronik duhet të sigurojë:

- a) nënshkrim elektronik, sipas legjislacionit për nënshkrimin elektronik;
- b) të dhënat e krijuesit të dokumentit elektronik;
- c) pacenueshmërinë e dokumentit elektronik;
- ç) akses në përmbajtjen e dokumentit elektronik përgjatë gjithë ciklit të dokumentimit;
- d) qartësi në leximin e përmbajtjes së tij.

Në nenin 12 të këtij ligji përcaktohet se kur mund të përdoret si provë dokumenti elektronik :

1. Dokumenti elektronik, që plotëson kriteret e nenit 6 të këtij ligji, përdoret si provë.
2. Organi që merr dokumentin elektronik si provë, përcakton vlefshmërinë e tij, duke mbajtur parasysh të dhënat për përgatitjen, ruajtjen, transmetimin, sigurinë dhe autenticitetin e nënshkrimit elektronik të tij, si dhe rregullat e përcaktuara nga legjislacioni në fuqi.

Gjithashtu, në këtë ligj, në nenin 18, pika 3, përcakton arkivin e dokumentit elektronik si vijon: Arkivi i dokumentit elektronik duhet të sigurojë që:

- a) dokumenti elektronik të arkivohet në formën që është krijuar, dërguar, marrë dhe ruajtur, duke mos ndryshuar tërësinë e tij, përfshirë të dhënat e nënshkrimit elektronik, si dhe të dhënat për vërtetimin e tij;
- b) dokumenti elektronik, së bashku me nënshkrimin elektronik të përfshirë, të ruhet nëpërmjet procedurave dhe teknologjive, që sigurojnë garanci për pacenueshmërinë dhe tërësinë e tij përgjatë gjithë kohës së ruajtjes, si dhe mosfshirjen pa autorizimin përkatës;
- c) dokumenti elektronik, gjatë kohës së përcaktuar të ruajtjes, të jetë në formë të lexueshme, në dispozicion të personave që kanë të drejtën e aksesit në të;
- d) të mundësojë përcaktimin në mënyrë të besueshme të çdo dokumenti elektronik, të origjinës së tij, krijuesit, kohës, mënyrës dhe formën e marrjes në sistemin e ruajtjes;
- e) procedura e mirëmbajtjes së sistemit të ruajtjes së dokumentit elektronik të mos cenojë paprekshmërinë e dokumentit elektronik.

Deri më tani mungojnë akte nënligjore të cilat të krijojnë udhëzime konkrete se si do të realizohen proceset kryesore që kanë të bëjnë me dokumentet elektronike, të tilla si regjistrimi, komunikimi i tyre brenda dhe jashtë institucionit, ruajtja, klasifikimi dhe aksesimi në to.

Ligji Nr.9060, datë 8.5.2003, “Për Aderimin e Republikës së Shqipërisë në ‘Konventën për Heqjen e Kërkesës për Legalizimin e Dokumenteve Zyrtare të Huaja’” (Konventa e Hagës së 5 tetorit 1961).

Kjo Konventë zbatohet për dokumentet zyrtare që ekzekutohen në territorin e një Shteti Palë dhe lëshohen (prodhohen) në territorin e një Shteti tjetër Palë.

Në kuptim të kësaj Konvente konsiderohen zyrtare:

a) dokumentet e lëshuara nga një autoritet ose funksionar i lidhur me gjyqësorin e shtetit, përfshi edhe dokumentet e lëshuara nga prokuroritë, sekretariatitë e gjykatave dhe zyrat përmbartimore;

b) dokumentet administrative;

c) aktet noteriale;

d) vërtetimet zyrtare, vendosur mbi një dokument dhe firmosur nga një person në cilësinë e tij si individ, që dëshmojnë regjistrimin e këtij dokumenti ose ekzistencën e tij në një datë të caktuar, si edhe vërtetimin zyrtar e noterial të vërtetësisë së firmave.

Kjo Konventë nuk zbatohet:

a) për dokumentet e ekzekutuara nga agjentë diplomatikë ose konsullorë;

b) për dokumentet administrative që lidhen drejtpërdrejt me veprime tregtare ose doganore.

Bazuar në dispozitën e mësipërme vlen të themi se “Vula Apostile”, apo më saktë *Apostille* (fjalë belge), e lindur nga një marrëveshje ndërkombëtare, të quajtur Konventa e Hagës, nuk është tjetër veçse një vulë e standardizuar në përmasa e përmbajtje nga vetë konventa.

Është një lloj legalizimi që autoriteti kompetent i një shteti i bën dokumentit publik duke e kthyer dokumentin në të vlefshëm edhe për shtetet e tjera që kanë nënshkruar konventën.

Në rastin konkret, mes Shqipërisë e Italisë, duhet thënë që të dyja shtetet e kanë nënshkruar me kohë këtë konventë: Shqipëria e ka ratifikuar më 3 shtator 2003 dhe e ka futur në fuqi më 9 maj 2004, ndërsa Italia e ka ratifikuar Konventën më 13 dhjetor 1977 dhe e ka futur në fuqi më 11 shkurt 1978. Por Italia kishte paraqitur “rezervë” ndaj Shqipërisë më 9 mars 2004, ndaj mes këtyre dy vendeve nuk ishte e vlefshme Konventa. Pikërisht, këtë rezervë tërhoqi Italia më 26 maj 2011.

Ndaj Shqipërisë vazhdojnë të kenë rezervë: Spanja, Belgjika, Gjermania dhe Greqia. Pra, me këto vende, Shqipëria nuk aplikon konventën në fjalë, por përdor për njohjen e ndërsjellë të dokumenteve legalizimin e tyre në konsullata.

Praktikisht janë një sërë dokumentesh për të cilat, falë konventës, nuk është i nevojshëm legalizimi në konsullatë, nëse u vihet e ashtuquajtura *Apostille* drejtpërdrejt nga autoriteti i vendit që ka i ka lëshuar. Zakonisht, bëhet fjalë për certifikata të ndryshme të Gjendjes Civile, që dëshmojnë: lindje, vdekje, lidhje familjare, që herët a vonë u interesojnë thujse të gjithë emigrantëve.

PROVAT DHE PROCESI I TË PROVUARIT NË PROCESIN PENAL

Duke u nisur nga këto kufizimi, arrihet në konkluzionin që dokumente të tilla, që të shërbejnë si prova të ligjshme në një proces penal, duhet domosdoshmërisht që të jenë të legalizuara sipas këtyre parashikimeve. Në rast të kundërt, këto akte do të bëheshin të papërdorshme dhe nuk shërbenin si provë.

Së fundmi: të gjitha provat dokumentare, të cilat janë pranuar e marrë nga gjykata, gjatë procesit penal të marrjes së tyre në gjykimin e çështjes, i bashkëlidhen procesverbalit dhe akteve të tjera të gjykimit. Ato futen në fashikullin e gjykatës, sipas përcaktimit të nenit 371 të K. Pr. Penale.

Në rastet kur nga prokurori dhe gjykata është marrë në cilësinë e provës materiale një dokument, palëve u lind e drejta sipas nenit 197 të këtij kodi të kërkojnë kopje të këtyre dokumenteve.

Pavarësisht se në këtë seksion nuk bëhet parashikim në lidhje me ruajtjen dhe disponimin mbi këto prova, në këtë rast vlerësojmë se duhet të respektohen parashikimet e ligjit mbi provat materiale në seksionin VII të këtij kapitulli, këtë qëndrim ka mbajtur edhe praktika gjyqësore.

KAPITULLI IV

MJETET E KËRKIMIT TË PROVAVE DHE PROCESI I ÇMUARJES DHE VLERËSIMIT TË TYRE NË PROCESIN PENAL

**4. MJETET E KËRKIMIT TË PROVAVE DHE PROCESI I ÇMUARJES DHE VLERËSIMIT TË TYRE NË PROCESIN PENAL. LLOJET DHE RËNDËSIA E TYRE NË TË DREJTËN PROCEDURALE PENALE DHE PROCESIN PENAL.
MËNYRAT E MARRJES SË PROVAVE DHE PËRSHKRIMIT TË TYRE NË AKTET PROCEDURIALE**

Kodi i Procedurës Penale përcakton si mjete të kërkimit të provave: *këqyrjet, kontrollet, sekuestrimet dhe përgjimet*. Ndryshimi me provat qëndron në faktin se provat i ofrojnë gjykatës rezultate provuese, të cilat përdoren drejtpërsëdrejti në marrjen e vendimit. Ndërsa në ndryshim nga provat, mjetet për kërkimin e provës nuk janë në vetvete burim i bindjes provuese, por krijojnë mundësinë që, nëpërmjet përdorimit të tyre, të merren objekte, materiale, gjurmë ose deklarime që shërbejnë si rezultate provuese të rrethanave të faktit, ose, sipas rastit, e të fajësise apo pafajësisë së të pandehurit.

Të njëjtin qëndrim në lidhje me mjetet për kërkimin e provës kanë mbajtur dhe Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë në vendimin Nr.124³⁵³, datë 28.04.2014, ku ndër të tjera janë shprehur se:

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, duke e gjetur të pabazuar në ligjin procedural vendimin e Gjykatës së Apelit Korçë çmon se shkaqet e rekursit janë të bazuara në ligj, ndaj ai duhet pranuar dhe vendimi i Gjykatës së Apelit duhet të priset për shkaqet dhe arsyet e mëposhtme.

Në Kodin e Procedurës Penale janë përkufizuar “mjetet e kërkimit të provës”, kategori në të cilën bëjnë pjesë, ndër të tjera, edhe përgjimet. Dallimi me llojet e provës, qëndron në faktin se, këto të fundit, karakterizohen nga aftësia për t’i ofruar gjykatës rezultate provash, të cilat janë drejtpërsëdrejti të përdorshme gjatë procesit të vendimmarrjes së gjykatës. Aftësia provuese e llojeve të provës, krijohet në momentin e formimit dhe të përfimit të llojit të provës. Ndërsa, mjetet e kërkimit të provës, sikundër janë edhe përgjimet, nuk janë në vetvete burim bindjeje, porse ato mundësojnë përfitim të deklarimeve që kanë aftësi provuese për procesin penal. Nëpërmjet mjeteve të kërkimit të provës, futen në proces elemente të provave që kanë ekzistuar më parë, në raport me momentin e formimit apo të përfimit të llojit të provës...

Për sa parashtroam më sipër, mund të thellojmë dhe më shumë ndryshimet e dy koncepteve që shpeshherë ngatërrohen nga praktika gjyqësore. Kështu, së pari, elementi provues formohet nëpërmjet përdorimit të mjetit të provës; për shembull, dëshmitari dëshmon fakte të cilat i ka perceptuar. Anasjelltas, nëpërmjet mjetit të kërkimit të provës bëhet pjesë e procedimit një element provues që ekziston (merret) nga përdorimi

³⁵³Vendimi Nr.124, datë 28.04.2014, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

i vetë mjetit; për shembull, nëpërmjet kontrollit synohet të merren sende që lidhen me veprën penale.

Së dyti, provat mund të merren vetëm nga gjykata në gjykim, ndërsa mjetet për kërkimin e provës mund të përdoren si nga gjykata, ashtu dhe nga prokurori gjatë fazës së hetimeve paraprake dhe në disa raste sipas parashikimeve të K. Pr. Penale, nga policia gjyqësore me urdhër për delegim kompetencash të prokurorit ose me iniciativën e vet.

Dhe, së treti, mjetet për kërkimin e provës bazohen si rregull në faktorin “surprizë”, pra që nuk parashikojnë lajmërimin paraprak të personit ose mbrojtësit të tij kur realizohen gjatë fazës së hetimeve paraprake. Anasjelltas, mjetet e provës mund të merren (edhe pse në vijë përjashtimore dhe me shumë limite) gjatë fazës së hetimeve paraprake me garancinë e pjesëmarrjes dhe njoftimit të të pandehurit dhe mbrojtësit të tij.

4.1. KËQYRJA

Këqyrja konsiston në vëzhgimin dhe përshkrimin e personave, kufomave, vendeve dhe sendeve, me qëllim për të individualizuar gjurmët dhe efektet e tjera materiale të veprës penale. Këqyrja është një mjet për kërkimin e provës që ka kryesisht një funksion (qëllim) “përshkrues”, që vendoset si rregull nga organi procedues kur vlerëson të nevojshme se, nëpërmjet tij, mund të individualizohen gjurmët ose efektet e tjera materiale të veprës penale.

Zbulimi, mbledhja, fiksimi, studimi i gjurmëve dhe pasojave materiale të veprës penale është në vetvete një proces i vështirë dhe kompleks. Kjo për shkak të faktorëve të ndryshëm, si: sipërfaqja e vendit ku bëhet këqyrja, larmia e objekteve ku mund të lihen gjurmë, dukuritë atmosferike dhe veprimet njerëzore kryesisht të personit të dyshuar si autor i mundshëm i veprës penale, por jo vetëm, të cilët mund të shkaktojnë prishjen e njoftimeve të rrethanave të faktit juridik penal.

Legjislatori, duke marrë në konsideratë arsyet e lartpërmendura dhe faktin që vendet janë mjedise të paqendrueshme, në nenin 198, paragrafi i dytë të K. Pr. Penale, ka parashikuar se, pavarësisht faktit që vepra penale nuk ka lënë gjurmë ose pasoja materiale, ose kur këto janë zhdukur, kanë humbur, janë ndryshuar a lëvizur, organi procedues përshkruan gjendjen dhe, kur është e mundur, duhet të verifikojë se si ka qenë ajo para ndryshimeve. Gjithashtu, organi procedues, po sipas përcaktimeve të kësaj dispozite, merr masa që të saktësojë mënyrën, kohën dhe shkaqet e ndryshimeve që mund të kenë ndodhur. Po sipas kësaj dispozite, organi procedues mund të urdhërojë dhe fotografime, filmime dhe çdo veprim tjetër teknik.

Kuptimi i këqyrjes në procesin civil, në fazën e hetimit gjyqësor paraqiten një numër i madh rastesh, mosmarrëveshesh për zgjidhje dhe larmia e problemeve që shfaqen janë të mëdha, madje mund të shkojnë deri atje sa gjykata e ka të nevojshme kryerjen e këqyrjes së drejtpërdrejtë të sendeve, vendeve dhe personave për të marrë njohuri për vërtetimin e vërtetësisë së fakteve. Përpara se të trajtojmë procedurën që ndiqet për të relizuar këqyrjen si mjet prove në mënyrë efikase, por mbi të gjitha në përputhje me ligjin do të ishte më racionale që në fillim të japim përkufizimin e këqyrjes. Në lidhje

me këtë, autorë të ndryshëm janë shprehur pak a shumë në mënyrë të njëjtë. Kështu, Faik Brestovci thekson se: “Këqyrja është një nga llojet e mjeteve provuese që shërben për të vënë gjykatën në mundësi për të marrë dënimin vetë për gjendjen dhe cilësitë të personave dhe sendeve.”³⁵⁴. Ndërsa Alban Brati jep këtë definicion: “Këqyrja është veprimtaria procedurale hetimore që zhvillon gjykata për të shqyrtuar, analizuar dhe eksperimentuar në vend një send ose një person, me qëllim që të marrë njohuri për karakteristikat e tij.”³⁵⁵.

Në nenin 199 të K. Pr. Penale, *këqyrja e personit*, parashikohet se kjo formë këqyrjeje si mjet për kërkimin e provës, ka si objekt trupin e një qenie njerëzore të gjallë ose pjesë të tij, dhe ka të bëjë me këqyrjen e çdo pjese të trupit, si që mund të shikohet ashtu dhe që nuk mund të shikohet. Kjo lloj këqyrje është normuar në mënyrë të veçantë nga legjislatori dhe parashikon se i interesuari mund të asistohet nga një i besuar, me kusht që ky mund të gjendet menjëherë dhe të jetë i përshtatshëm. Ky veprim procedural realizohet duke respektuar dinjitetin dhe, sa është e mundur, mbrojtjen e atij që do të këqyret. Në referim të nenit 199, paragrafi i tretë, këqyrja mund të bëhet edhe me anën e një mjeku dhe në këtë rast organi procedues mund të mos marrë pjesë në veprimin e këqyrjes. Kur është e nevojshme për konstatimin e fakteve që kanë rëndësi për çështjen, në përputhje me nenin 199, paragrafi i katërt, lejohet marrja e gjakut dhe ndërhyrje të tjera trupore, edhe pa vullnetin e personit, nëse nuk ka rrezik për shëndetin.

Në nenin 286³⁵⁶ të Kodit të Procedurës Civile sanksionohet se, kur çmohet e nevojshme nga gjykata që një person ose një send të këqyren drejtpërdrejt prej saj, kryesisht ose me kërkesën e palëve vendos të bëhet këqyrja në vend e tyre me ose pa ekspert. Pra, këqyrja kryhet aty ku ndodhet sendi, dokumenti.

Pasi bëmë analizën e paraqitjes dhe këqyrjes mendoj se është momenti t’i japim përgjigje pyetjes së mësipërme. Ndryshimet konsistojnë në dy drejtime: së pari, në ndryshim nga paraqitja me anë të këqyrjes nuk bëhet paraqitja e sendit, dokumentit apo personit në proces, por vëzhgimet dhe eksperimentet e bëra nga gjykata (ose eksperti) të pasqyruara në procesverbal, ose në raportin me shkrim të ekspertit, të paraqitura në proces. Pra, paraqitja është një mjet për të marrë provat në proces, ndërsa këqyrja është vetë provë e drejtpërdrejtë. Ndryshimi i dytë konsiston në legjitimitimin aktiv për investimin e gjykatës, në rastin e paraqitjes janë palët ato që kërkojnë paraqitjen e dokumentit, sendit. Në rastin e këqyrjes, përveç palëve, edhe gjykata kryesisht mund të urdhërojë këqyrjen e personave, sendeve.

Pyetja tjetër që lind natyrshëm është: “Kur përdoret njëra dhe kur përdoret tjetra?”. Pse në vend të këqyrjes gjykata nuk urdhëron që sendi ose personi të paraqiten në gjykim dhe anashjelltas? Mendoj se përgjigjja e këtyre pyetjeve nuk mund të jepet e prerë, pasi ky problem zgjidhet rast pas rasti, pra ka karakter kauzal, rastësor. Është gjykata ajo që vlerëson, në varësi të kushteve konkrete në të cilat ndodhet, në varësi të natyrës së çështjes, se cila do të përdoret dhe cila jo.

³⁵⁴ Faik Brestovci, *Procedura Civile*, 2005, fq. 278.

³⁵⁵ Alban Brati, *Procedura Civile*, botimet DUDAJ, 2005, fq. 341.

³⁵⁶ Kodi i Procedurës Civile, neni 286.

Me rëndësi është trajtimi i një problemi tjetër në lidhje me karakterin e këqyrjes, duke e shtruar atë në formën e një pyetjeje: **“Këqyrja është mjet për kërkimin e provës, pra mjet për hetimin e provës apo provë?”**.

Këqyrja ka karakter *sui generis*, pasi, nëpërmjet këqyrjes së eksperimentit, gjykata heton vërtetësinë e fakteve, por nga ana tjetër plotëson edhe kushtet për të qenë provë, pra një ndërthurje karakteristikash. Kam mendimin se ky debat ka vlerë vetëm teorike, pasi Kodi i Procedurës Civile ka zgjidhur këtë problem duke e radhitur në radhët e provave. Duke shkuar më tej, theksoj që, duke u nisur nga natyra e këqyrjes, gjykata mund ta urdhërojë atë vetëm për vëzhgimin e sendeve, vendeve, pra fakteve të çështjes, të cilat janë parashtruar nga palët dhe jo për të shkuar e për të kërkuar mjete prove për t’u paraqitur në proces.

Në nenin 200³⁵⁷ të K. Pr. Penale është parashikuar *këqyrja e kufomës*. Referuar parashikimeve të kësaj dispozite, këqyrja e kufomës bëhet nga organi procedues në prani të mjekut ligjor. Për të bërë këqyrjen e kufomës, gjyqtari ose prokurori mund dhe të urdhërojnë zhvarrimin, duke njoftuar një pjesëtar të familjes së të vdekurit për të marrë pjesë, me përjashtim të rasteve kur kjo pjesëmarrje mund të dëmtojë qëllimin e këqyrjes.

Neni 201³⁵⁸ i K. Pr. Penale parashikon *këqyrjen e vendeve dhe sendeve*. Të pandehurit dhe atij që ka në dispozicion vendin ku do të bëhet këqyrja ose sendin që do të këqyret u dorëzohet në fillim kopja e vendimit për kryerjen e këqyrjes. Këqyrja e vendeve është një veprim procedural, me anë të cilit organi procedues percepton drejtpërsëdrejti mjedisin ku ka ndodhur vepra penale, zbulon, mbledh, fikson gjurmë e prova materiale dhe sqaron rrethana që kanë rëndësi për çështjen.

Gjykata e Apelit Tiranë në Vendimin Nr.799³⁵⁹, datë 20.07.2012, ndër të tjera është shprehur se: *Nga procesverbali i këqyrjes së vendit të ngjarjes është arritur të fiksohen në cilësinë e provave materiale edhe mjetet e posaçme për vjedhjen e bankës, si: bombula me oksigjen, që shërbejnë për prerje metalesh, dalta, çekiçe, trapane, aparate fotografike për të parë në brendësi të vrimës së hapur etj..... Për shkak se, veprimtaria e të pandehurve është pikasur nga policia; vjedhja e bankës nuk është kryer, pasi këta shtetas janë kapur në flagrancë nga policia e shtetit, duke tentuar vjedhjen e bankës.*

Në këqyrjen e vendeve, organi procedues mund të urdhërojë, për arsye të motivuara, që të pranishmit të mos largohen para se të ketë përfunduar këqyrja dhe t’i kthejë forcërisht ata që largohen. Nga pikëpamja taktike, këqyrja e vendeve mund të kryhet në të gjitha rastet kur në mjedisin ku ka ndodhur vepra penale janë shkaktuar ndryshime. Si rregull, nuk ka vepër penale që të mos lërë shenja materiale.

Në literaturën kriminalistike gjenden formulime të ndryshme teorike lidhur me nocionin “vendngjarje”. Vendi i ngjarjes është jo vetëm vendi ku ka ndodhur vepra penale (ndërtesa, territori, vendi i hapur), por dhe vendi ku janë zbuluar njoftime mbi rrethana që lidhen me të dhe pasojat e tij, pavarësisht nga distanca ndërmjet dy vendeve.

³⁵⁷ Kodi i Procedurës Penale, neni 200.

³⁵⁸ Kodi i Procedurës Penale, neni 201.

³⁵⁹ Vendimi Nr.799, datë 20.07.2012, Gjykata e Apelit Tiranë.

Ky përcaktim ka rëndësi të madhe praktike, pasi në disa raste këqyrja e vendit të ngjarjes bëhet vetëm në qendrën ku ka ndodhur vepra penale dhe, në këtë mënyrë, kërkimet e provave kufizohen vetëm në një zonë, duke lënë kështu jashtë vëmendjes njoftime mbi rrethana të faktit penal që mund të ndodhen përtej kësaj zone.

Këqyrja si mjet për kërkimin e provës parashikuar në nenet 198 e vijues të K. Pr. Penale, krahas funksionit për evidentimin, zbulimin dhe fiksimin e njoftimeve të rrethanave të faktit juridik penal ka dhe funksionin e ndërtimit të vendit të ngjarjes dhe sqarimin e rrethanave që kanë rëndësi për vërtetimin e elementeve të figurës së veprës penale.

Kështu, në Vendimin Nr.3385³⁶⁰, datë 09.10.2015, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ndër të tjera, në pasqyrimin e rrethanave të faktit është shprehur se:

Menjëherë është formuar grupi hetimor dhe është shkuar në vendin e ngjarjes ku është konstatuar se në katin e dytë të banesës së shtetasit F. Y., dhe pikërisht në derën e hyrjes së dhomës së gjumit, ndodhej i shtrirë në dysheme trupi i pajetë i një personi dhe pranë tij një pellg me ngjyrë të kuqe si ajo e gjakut. Pranë këtij personi ndodheshin dy armë zjarri: njëra ishte e markës BROWING dhe një armë tjetër automatike e kalibrit 7.65 me silenciator. Nga këqyrja e vendit të ngjarjes vërehet se brenda në dhomën e gjumit, në anën lindore, gjendet një kufomë tjetër e shtrirë mbi krahun e djathtë. Gjatë këqyrjes në vendin e ngjarjes u gjetën dhe fiksuan si prova materiale 4 gëzhoja të kalibrit 7.65, në korridorin e katit të dytë u gjend një gëzhojë e kalibrit 7.62, një predhë e padeformuar e kalibrit të madh dhe dy predha të tjera të deformuara. Nga verifikimi i kufomave të gjetura në vendin e ngjarjes rezultoi se kufoma e gjetur në afërsi të derës hyrëse të dhomës së gjumit të shtetasit F. Y. ishte shtetasi A. L., biri i Gëzim dhe i Haxhire, i datëlindjes 02.01.1992, lindur në Shkodër dhe banues në Tiranë, lagjja Selitë, dhe kufoma tjetër i përkiste shtetasit E. Sh., i biri i Gëzim dhe i Lule, i datëlindjes 31.01.1989, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë lagjja Selitë. Nga këqyrja e kufomës së shtetasit A. L. vërehen plagë të shumta në trup e në kokë, plagë të cilat janë shkaktuar nga armë zjarri; nga trupi i këtij shtetasi u nxorën dhe u sekuestruan 2 predha metalike, gjithashtu, dhe në kufomën e shtetasit E. Sh. u vërejtën shumë dëmtime në kokë dhe në trup, nga trupi i të cilit u nxorën dhe sekuestruan 3 predha metalike si ato të armëve të zjarrit.

Prof. Skënder Begeja, në librin e tij “Kriminalistika”,³⁶¹ është shprehur se: *Këqyrja e vendit të ngjarjes është themeli i hetimit penal; sa më të forta e të fuqishme të jenë këto themele, aq më i shëndetshëm, i plotë dhe i shpejtë do të jetë hetimi penal.*

Në analizë të këtij përfundimi mund të themi se këqyrja e vendit të ngjarjes është veprimi procedural hetimor i parë dhe më i rëndësishëm me anë të të cilit organi procedues fillon të ngrëjë themelet e hetimit të veprës penale. Në librin e tij “Kriminalistika”, prof. dr. Skënder Begeja është shprehur se këqyrja e vendit të ngjarjes, ndryshe nga veprimet e tjera hetimore, konsiderohet një veprim hetimor i pazëvendësueshëm dhe i papërsëritshëm.

Është veprim hetimor i pazëvendësueshëm për arsye se organi procedues percepton drejtpërsëdrejti gjurmët e sendet që ka lënë vepra penale dhe autori i mundshëm i saj

³⁶⁰Vendimi Nr.3385, datë 09.10.2015, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

³⁶¹ Prof. dr. Skënder Begeja, “Kriminalistika”, viti 1992.

dhe, ç'është më e rëndësishme, ndihmon dhe në zbulimin e lidhjes shkakore ndërmjet veprimeve ose mosveprimeve të kryera e pasojës së ardhur.

Është veprim hetimor i papërsëritshëm për arsye se, kur këqyrja e vendit të ngjarjes kryhet me cilësi të dobët, të metat nuk mund të ndreqen plotësisht, meqenëse, me kalimin e kohës, mjedisi ku ka ndodhur vepra penale ndryshon dhe gjurmët e saj e të fajtorit mund të zhduken për shkaqe të ndryshme. Megjithatë, praktika ka vërtetuar se dhe këqyrja e vendit të ngjarjes mund të përsëritet në rastet kur këqyrja e parë për arsye objektive është ndërprerë, kur gjatë hetimit dalin fakte të reja ose kur këqyrja e vendit të ngjarjes është kryer me cilësi të dobët.

Gjithashtu, edhe në vendimin Nr. 25, datë 09.02.2011³⁶² të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë është arsyetuar elementi i këqyrjes së vendit të ngjarjes: *Kështu, nga këqyrja e vendit të ngjarjes, të datës 02.05.2008, është pasqyruar vendi ku ka ndodhur ngjarja, vendi ku janë gjetur dhe fiksuar gëzhojat e armës së zjarrit që është qëlluar i dëmtuari, autovetura me të cilën ka qenë duke lëvizur i dëmtuari etj. Në vendngjarje janë fiksuar me një procesverbal për këqyrjen dhe marrjen e provave materiale 13 (trembëdhjetë) gëzhoja metalike, dhe një pjesë këmishe predhë e sekuestruar më datë 03.05.2008 në trupin e të dëmtuarit, shtetasit M. M. më datë 02.05.2008. Nga procesverbali dhe tabela fotografike përshkruhen dhe dëmtimet e automjetit veturë tip "Audi", me targë LIPBF242, me të cilën ka qenë duke lëvizur i dëmtuari Marin Mandi në momentin kur është qëlluar me armë zjarri. Me procesverbalin e këqyrjes dhe marrjes së një telefoni celular të markës "TIM", i cili më pas i është sekuestruar shtetases I. C. më datë 03.05.2008, është përshkruar përmbajtja e të dhënave të gjetura brenda tij dhe në kartën SIM të cilën mbante etj.*

Në mënyrë krahasuese, edhe në Kodin e Procedurës Civile është parashikuar procedura dhe rregullat që duhen respektuar për të realizuar një këqyrje të ligjshme dhe në përputhje me të drejtat e liritë themelore të njeriut. Kështu, këqyrja e personave, vendeve, sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme bëhet me vendim të gjykatës, në të cilin caktohet koha, vendi dhe mënyra e këqyrjes. Kur gjykata çmon se këqyrja duhet bërë, vendimin ua njofton palëve, personave të tretë që disponojnë, posedojnë sendin, në përputhje me rregullat e njoftimit të akteve.³⁶³

Këqyrja bëhet nga gjykata, gjyqtari i deleguar prej saj, kurse në rastet kur sendi, personi ose vendi ndodhen në territorin që përbën kompetencën territoriale të një gjykate tjetër të ndryshme nga ajo që gjykon çështjen, zbatohen dispozitat e neneve: 215, 216, 217 të Kodit të Procedurës Civile³⁶⁴ që flasin për letërporosinë, ku kjo letërporosi duhet të ekzekutohet nga gjykata ku ndodhet sendi, vendi dhe personi.

Mund të ndodhë që për këqyrjen të jetë e nevojshme ekzistenca e njohurive të posaçme në fushën e shkencës, teknikës, artit. Në këtë rast, gjykata cakton ekspertin në përputhje me rregullat e përcaktuara të K. Pr. C.

Gjatë këqyrjes, gjykata mund të vendosë që të kryejë edhe riprodhime fotografike të objekteve, dokumenteve, sendeve, dhe, kur është e nevojshme apo e mundshme,

³⁶² Vendim nr. 25, datë 09.02.2011, i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

³⁶³ Për më tepër shih nenin 287 të Kodit të Procedurës Civile.

³⁶⁴ Kodi i Procedurës Civile, neni 215 e vijues.

filmime, ose të përdorë edhe mjete a veprime të tjera mekanike. Gjithashtu, gjatë këqyrjes, gjykata kur e shihet të nevojshme mund të dëgjojë dëshmitarë për të marrë të dhëna, për të siguruar paraqitjen e sendeve dhe të marrë masa për të hyrë në vende që duhen të ekspozohen ose të shqyrtohen nga gjykata. Ajo mund të urdhërojë edhe futjen në vende që janë pronësi ose në posedim të personave që nuk lidhen me procesin gjyqësor; mund të dëgjojë këta të fundit duke marrë masat e nevojshme që të mos dëmtojnë interesat e tyre.

Kur këqyrja bëhet nga gjykata mbahet një procesverbal, në të cilin tregohen palët që kanë marrë pjesë, pretendimet dhe vërejtjet e tyre rreth këqyrjes dhe përfundimi i këqyrjes. Procesverbali nënshkruhet sipas rastit nga të gjithë gjyqtarët ose nga një gjyqtar i vetëm, si dhe palët e personat e tjerë të ndodhur gjatë këqyrjes. Ndërsa kur bëhet nga eksperti kemi relacionin ose raportin e tij në përputhje me rregullat e përcaktuara në kod.

Gjykata mund të urdhërojë këqyrjen mbi personin e palës ose të të tretit, apo mbi sende që ndodhen në posedim të tyre nëse ajo është e domosdoshme për të njohur faktet e çështjes, por me kusht që të mund të kryhet pa shkaktuar dëme, që mund të jetë dëm material ose moral për palën a të tretin, ose pa i shtrënguar ata që të cenojnë sekretin profesional e shtetëror.³⁶⁵

Nëpërmjet këqyrjes arrijmë tek verifikimi i provave, sepse ky mjet për kërkimin e provës shërben edhe për verifikimin e vërtetësisë dhe fuqisë provuese të njoftimeve, si dhe të provave të tjera. E thënë ndryshe, rezultati i këqyrjes (vendit, sendit, kufomës, personit etj.) konfirmon ose jo vërtetësinë e dëshmisë, thëniet e të pandehurit duke konkluduar përfundimisht nëse alibia apo thëniet e dhëna nga ana e të pandehurit rreth ngjarjes janë apo jo të vërteta.

Në vendimin Nr. 56, datë 22.02.2012³⁶⁶ të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë arsyetohet se: *Megjithëse i gjykuari nuk ka paraqitur asnjë provë në lidhje me alibinë e drejtimit dhe distancën, Gjykata e Apelit ka pranuar se dëmtimi mekanik i shkaktuar në makinë nga predha e qitur prej të gjykuarit është shkaktuar nga një distancë e afërt pas largimit të të dëmtuarve në inat e sipër.*

Duhet të vlerësojmë padiskutim ndryshimet e fundit të këtyre dispozitave, p.sh.: *Neni 201/a*,³⁶⁷ *Marrja me detyrim e kampionëve biologjikë ose kryerja e procedurave mjekësore të detyruara (Shtuar me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)* kanë sjellë një frymë të re në lidhje me të gjitha paqartësitë e krijura në praktikë nga këto çështje, pasi lidhen në mënyrë direkte me procedurat mjekësore që mund të ndikojnë në liritë themelore, si liria personale, e drejta për jetën dhe integriteti fizik.

Së pari,³⁶⁸ është parashikuar se marrja e mostrës në mënyrë detyruese apo procedurat detyruese mjekësore mund të kryhen vetëm në përputhje me dispozitat e këtij Kodi dhe në vazhdim kërkon detyrimisht kërkesën e prokurorit për marrjen e mostrës apo kryerjen e procedurës mjekësore mbi të pandehurin ose person tjetër me pëlqimin e

³⁶⁵ Për më tepër, shih nenet 288 dhe 290 të K. Pr. C.

³⁶⁶ Vendim Nr. 56, datë 22.02.2012, i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

³⁶⁷ Kodi i Procedurës Penale, me ndryshimet e reja me ligjin nr.35/2017.

³⁶⁸ Relacioni “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 35 /2017”, Kodi i Procedurës Penale.

këtij personi. Parashikimi i detajuar në këtë dispozitë i llojeve të mostrave që mund të merren (si p.sh., nga: flokët, lëkura, qelizat në pjesën e brendshme të gojës, pështyma, gjaku dhe urina), të cilat janë përcaktuese dhe duhet të përdoren vetëm me qëllimin e përcaktimit të profilin të ADN-së apo për të krahasuar gjurmët e gjetura me profilin e ADN-së së marrë.

Sigurisht që për rindërtimin e kësaj dispozite janë marrë parasysh disa standarde të reja, duke parashikuar në këtë mënyrë edhe miratimin me shkrim të personit nga i cili është marrë mostra e ADN-së, e cila nënshkruhet para prokurorit që e ka urdhëruar atë. Qëllimi i këtij standardi është vendosur për arsye të mosabuzimit me anë të rregullave procedurale që zhvillohen gjatë hetimit dhe kërkesave të prokurorit të çështjeve. Gjithashtu, është parashikuar edhe marrja e mostrës apo kryerja e procedurës mjekësore në rast se personi është minoreni, por duke marrë pëlqimin e prindërit ose kujdestarit ligjor.

Çfarë ka parashikuar kjo dispozitë sipas paragrafëve të saj:

- marrja e mostrës apo procedurën mjekësore pa pëlqimin e personit të përfshirë. Një procedurë e tillë mund të kryhet me kërkesën e prokurorit dhe me urdhër të gjykatës, nëse nuk arrihet të jepet pëlqimi i personit;
- parashikon që procedurat e tjera mjekësore që ndikojnë mbi lirinë e personit mund të kryhen vetëm me urdhër të gjykatës. Është e rëndësishme të theksohet se mund të kryhen vetëm ndërhyrjet që shkaktojnë cenimin minimal në marrjen e mostrës. Në çdo rast, këto lloj aktesh nuk mund të merren në qoftë se ato mund të rrezikojnë jetën e personit ose nëse ato mund të shkaktojnë vuajtje të padëshiruar;
- parashikon përmbajtjen e vendimit të gjykatës, ndërsa paragrafi 7 i të njëjtit nen siguron që të paktën 3 ditë para se të merret mostra, të njoftohet personi përkatës objekt i marrjes së mostrës apo procedurës mjekësore dhe personat e tjerë të lidhur me të;
- parashikon paraqitjen me detyrim për personat të cilët janë objekt i marrjes së mostrës ose procedurës detyruese mjekësore të përcaktuar me vendim të gjykatës, të cilët nuk paraqiten në vendin e caktuar për t'u marrë këto mostra;
- gjithashtu, për qëllim sigurimin e marrjes së mostrës në rast se ka një arsye për të besuar se informacioni që kërkohet mund të humbasë ose mund të humbasë vlerën. Në raste të tilla, marrja e mostrës do të kryhet pa vendim të gjykatës dhe vetëm me urdhër të prokurorit. Në këto raste, prokurori i kërkon gjykatës të vlerësojë urdhërin e dhënë brenda 48 orëve. Qëllimi i këtij vlerësimi është shmangia e çdo keqpërdorimi të mostrës së marrë. Procedura mjekësore nuk është lënë jashtë në këto raste për të shmangur mundësinë që, për p.sh., droga e gëlltitur të absorbohet apo të humbasë në mënyra të ndryshme. Janë parashikuar afatet për gjykatën për të vendosur lidhur me kërkesën e prokurorit, pasi marrja e mostrës së ADN-së apo procedura mjekësore është një çështje delikate;
- parashikon rregullat të cilat duhet të ndiqen në rast të marrjes së mostrës ose procedurës mjekësore;
- është parashikuar prania e detyrueshme e avokatit mbrojtës nëse mostra duhet të merret nga i pandehuri sipas paragrafit 11 të këtij neni, ndërsa paragrafi 12

parashikon praninë e detyrueshme të kujdestarit ligjor, të prindit ose personit të besuar në rast se personi është i mitur;

- rregullon rastet kur marrja e mostrës dhe rezultatet e analizave janë të pavlefshme. Në këtë aspekt është për t'u përmendur vendimi i GJEDNJ-së³⁶⁹ Jalloh v. Gjermanisë³⁷⁰ (Aplikimi nr. 54810/00), në të cilin Gjykata është shprehur se: ... 69. Për sa i përket ndërhyrjeve mjekësore të cilave një person i ndaluar u nënshtrohet kundër vullnetit të tij apo të saj, neni 3 i Konventës vendos një detyrim mbi shtetin për të mbrojtur mirëqenien fizike të personave të privuar nga liria, për shembull, duke u ofruar atyre ndihmën e nevojshme mjekësore. Prapëseprapë, personat në fjalë mbeten nën mbrojtjen e nenit 3, kërkesat e të cilit nuk lejojnë përjashtime (Mouisel, cituar më lart, § 40, dhe Naumenko, cituar më lart, § 112). Një masë e cila është e nevojshme nga ana terapeutike nga pikëpamja e parimeve të përcaktuara të mjekësisë, në parim nuk mund të konsiderohet si çnjerëzore dhe degraduese (shih, në veç Kundër, Herczegfalvy v. Austrisë, 24 Shtator 1992 § 82, Seria A nr. 244, dhe Naumenko, cituar më lart, § 112). Kjo mund të thuhet, për shembull, në lidhje me të ushqyerin me zor që bëhet me qëllim për të shpëtuar jetën e një të burgosuri, i cili, me vetëdije, refuzon të marrë ushqim. Megjithatë, Gjykata duhet të sigurohet se ekziston një domosdoshmëri mjekësore e shfaqur në mënyrë bindëse dhe se ekzistojnë garancitë procedurale për vendimin, për shembull për të detyruar të ushqyerin dhe se ato janë respektuar (shih Nevmerzhitsky v. Ukrainës, nr. 54825/00, § 94, GJEDNJ 2005-II). 70. Edhe kur nuk është e motivuar nga arsyet e nevojës mjekësore, nenet 3 dhe 8 të Konventës, si të tilla, nuk e ndalojnë rekursin ndaj një procedure mjekësore në kundërshtim me vullnetin e një të dështuarit, për të marrë prej tij prova të përfshirjes së tij në kryerjen e një veprë penale. Kështu, institucionet e Konventës kanë parë në disa raste se marrja e mostrave të gjakut apo pështymës kundër vullnetit të të dështuarit me qëllim për të hetuar një veprë penale nuk ka sjellë shkelje të këtyre neneve në rrethanat e rasteve të shqyrtuara prej tyre (shih, ndër të tjera, X v. Holandës, nr. 8239/78, vendimi i Komisionit i datës 4 dhjetor 1978, Vendime dhe Raporte (DR) 16, f. 187-89, dhe Schmidt v. Gjermanisë (vendim), nr. 32352/02, 5 Janar 2006). 71. Megjithatë, çdo rekurs ndaj një ndërhyrjeje të detyrueshme mjekësore për të marrë prova për një krim duhet të justifikohet në mënyrë bindëse mbi faktet e një rasti të veçantë. Kjo është veçanërisht e vërtetë, **kur procedura ka për qëllim të marrë nga brenda trupit të individit provën e vërtetë të krimit për të cilin ai dyshohet**. Natyra veçanërisht e bezdisshme e një akti të tillë kërkon një shqyrtim të rreptë të të gjitha rrethanave përreth. Në lidhje me këtë, duhet patur parasysh rëndësia e veprës penale në fjalë. Gjithashtu, autoritetet duhet të demonstrojnë se kanë marrë në konsideratë edhe metodat alternative të mbledhjes së provave. Për më tepër, procedura nuk duhet të passjellë ndonjë rrezik të ndonjë dëmtimi të qëndrueshëm për shëndetin e një të dështuarit (shih, mutatis mutandis, Nevmerzhitsky, cituar më lart, §§ 94 dhe 97, dhe Schmidt, cituar më lart). 72. Për më tepër, për sa i përket ndërhyrjeve të kryera për qëllime terapeutike, mënyra në të cilën një person i nënshtrohet një procedure të detyrueshme mjekësore në mënyrë që të merret provë nga trupi i tij nuk

³⁶⁹ Relacioni për disa shtesa dhe ndryshime në Kodin e Procedurës Penale.

³⁷⁰ Jalloh v. Gjermanisë.

duhet të kalojë nivelin minimal të ashpërsisë përshkruar nga praktika gjyqësore e Gjykatës në nenin 3 të Konventës. Në veç Kundër, duhet marrë parasysh nëse personi në fjalë ka përjetuar dhimbje të rënda fizike apo vuajtje si rezultat i ndërhyrjes së detyrueshme mjekësore (shih Peters v. Holandës, nr. 21132/93, vendim i Komisionit i datës 6 prill 1994, DR 77 -B, Schmidt, i cituar më lart, dhe Nevmerzhitsky, i cituar më lart, §§ 94 dhe 97). 73. Në raste të tilla, një konsideratë tjetër substanciale është nëse procedura e detyrueshme mjekësore urdhërohet dhe administrohet nga mjekët dhe nëse personi në fjalë është vënë nën mbikëqyrje të vazhdueshme mjekësore (shih, për shembull, Ilijkov v. Bullgarisë, nr. 33977/96, vendim i Komisionit i 20 tetorit 1997, i paraportuar)

Në vijim të kësaj tabloje që paraqet ndryshimet në këtë seksion për mjetet e kërkimit të provave dhe specifikisht për këqyrjet vlen të theksohet fakti se është shtuar neni 201/b, i cili përcakton procedurën e asgjësimit të kampionëve biologjikë të marrë në përputhje me parashikimet e vendimit kuadër 2008-977 për mbrojtjen e të dhënave personale të përpunuara në kuadër të bashkëpunimit policor dhe gjyqësor në çështjet penale dhe Direktivën e BE-së 95/46 / KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të 24 tetorit 1995 mbi mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin e të dhënave personale dhe lëvizjen e lirë të këtyre të dhënave.

4.2. KONTROLLET

Kontrolli si mjet për kërkimin e provës konsiston në kërkimin e të gjitha atyre njoftimeve që do të ndihmonin në zbulimin dhe vërtetimin e rrethanave të faktit juridik penal ose të autorit të mundshëm të kryerjes së veprës penale për t'u arrestuar ose, sipas rastit, për t'u ndaluar. Në referim të dispozitave të Kodit të Procedurës Penale që normojnë dhe parashikojnë rregullat për kryerjen e kontrollit, kontrollet përfshijnë kontrollin e personave dhe kontrollin e vendeve.

Si rregull, kontrolli kryhet në rastet kur nga ana e organeve të procedimit disponohen të dhëna të mjaftueshme, që tek personi ndodhen apo fshihen prova të cilat lidhen dhe i shërbejnë procesit penal ose përgjegjësinë e autorit të mundshëm të veprës penale. Ekzistenca e arsyeve të bazuara është kusht i domosdoshëm i parashikuar nga legjislatori në nenin 202³⁷¹ të Kodit të Procedurës Penale për të kryer kontrollin.

Gjithashtu, vlen të trajtojmë disa elemente kyç të “Kontrolleve”, *siç janë kushtet dhe mënyra e kryerjes së kontrollit, ndaj kujt ushtrohet kontroll dhe, së fundi, koha e kryerjes së kontrollit.*

Në analizë të dispozitave procedurale të Kodit të Procedurës Penale edhe të mëparshmet, edhe me ndryshimet e fundit, e vënë theksin në garantimin, respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve që kontrollohen apo të vendeve që kontrollohen gjithmonë pas miratimit nga gjykata.

Në nenin 204³⁷² të Kodit të Procedurës Penale, parashikohen dhe dy kushtet që duhet të ekzistojnë në mënyrë kumulative para se të bëhet kontrolli i personit. Më konkretisht,

³⁷¹ Kodi i Procedurës Penale, neni 202.

³⁷² Kodi i Procedurës Penale, neni 204.

kjo dispozitë parashikon se kontrolli personal kryhet duke respektuar dinjitetin dhe mbrojtjen e atij që do të kontrollohet, dhe këtij personi i dorëzohet një kopje e vendimit të kontrollit, duke i bërë të ditur të drejtën për të kërkuar praninë e një personi të besuar, me kusht që ai të gjendet shpejt dhe të jetë i përshtatshëm.

Ashtu siç parashtrua më lart, krahas kontrollit personal, në Kodin e Procedurës Penale është parashikuar dhe kontrolli i vendeve. Kontrolli i vendeve kryhet kur ekzistojnë dyshime të arsyeshme se sende - objekt prove procedimi penal ndodhen në një vend të caktuar. Të pandehurit, kur është i pranishëm, dhe atij që ka në dispozicion vendin u dorëzohet kopja e vendimit të kontrollit, duke i sqaruar të drejtën për të kërkuar praninë e një personi të besuar. Kur mungojnë personat e treguar, kopja e vendimit i dorëzohet një të afërmi, një fqinji ose një personi që punon bashkë me të. Në çdo rast, organi procedues mund të kontrollojë personat e pranishëm, kur çmon se këta mund të fshehin provën materiale ose sendet që i përkasin veprës penale.

Në nenin 206 të K. Pr. P. Është parashikuar dhe kryerjes së kontrollit të banesës ose të çdo ambienti të mbyllur. Kryerja e kontrollit mund të bëhet vetëm në intervalin kohor ora 07:00 deri në orën 20:00, me përjashtim të rasteve të ngushtshme, ku detyrimisht organi procedues urdhëron dhe argumenton, pse pikërisht shkelet ky afat i përcaktuar në këtë dispozitë.

Në Kodin e Procedurës Penale janë bërë parashikimet në nenet 202-207, ku janë pasqyruar garancitë kushtetuese, si dhe standardet e vendosura nga aktet ndërkombëtare. Në nenin 37/1 të Kushtetutës, parashikohet dhe garantohet paprekshmëria e banesës, ndërsa në paragrafin e dytë, detyrimi i organit procedues që për kryerjen e kontrollit të vendeve e personit të respektohen kërkesat e ligjit, të njëjtat parashikime bëhen edhe në nenin 8³⁷³ të KEDNJ-së.

Me qëllim respektimin e drejtave dhe liritë themelore të shtetasve që kontrollohen apo të vendeve që disponohen nga ata, duhet patjetër që kryerja e kontrollit të miratohet nga gjykata në mënyrë që të jetë i rregullt. Pra, është gjykata i vetmi organ që parashikon K. Pr. Penale për të disponuar për aplikimin e këtij mjete të kërkimit të provës.

Por ndodh që, sipas parashikimit në dispozitat 202/3 dhe 298 të K.Pr. Penale, të drejtën e oficerëve të policisë gjyqësore që, në kushtet e flagrancës, të kryejnë kontroll pa vendim të gjykatës. Këto janë raste që objektivisht dhe subjektivisht nuk mund të pritët deri në marrjen e një vendimi gjyqësor për kryerjen e kontrollit, në gjendje flagrante sipas përcaktimit të bërë nga neni 252 të K.Pr.Penale. Si rregull, në respektim të parashikimeve të nenit 116³⁷⁴ të K. Pr. Penale, në procesverbalin e kontrollit duhet të tregohet dita, ora, vendi, identiteti i atij që kontrollohet, arsyet e kontrollit, njoftimet mbi rrethana të faktit juridik penal (nëse ka), përshkrimin e tyre, kohën e fillimit dhe mbarimit të kontrollit, nënshkrimin e personit që është kontrolluar dhe atij që ka kryer kontrollin e të tregohen pasojat që mund të vinin nga vonesa.

³⁷³ KEDNJ, neni 8/2 “Autoriteti publik nuk mund ndërhyrjë në ushtrimin e kësaj të drejte, përveçse në shkallën e parashikuar nga ligji dhe kur është e nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik, shëndetit ose.....”

³⁷⁴ Kodi i Procedurës Penale, neni 116.

Në respektim të parashikimeve të nenit 298,³⁷⁵ paragrafi 3, procesverbali i kontrollit i dorëzohet brenda dyzet e tetë orëve prokurorit të vendit ku është bërë kontrolli, i cili brenda dyzet e tetë orëve në vazhdim vleftëson kontrollin. Vleftësimi i kontrollit nga ana e prokurorit bëhet me vendim, në të cilin tregohet nëse kontrolli ka qenë i ligjshëm ose jo.

Sigurisht, rast nga praktika, i cili ka ngjallur diskutime në radhët e studiuesve të të Drejtës Procedurale Penale është rasti nëse mund të përdoret si provë në procesin penal një njoftim mbi rrethana të faktit i marrë nga oficerë të policisë gjyqësore gjatë një kontrolli për njoftime mbi rrethana të faktit ose të autorit të mundshëm të një vepr penale tjetër.

Për këtë rast, mendimet dhe vlerësimet e gjykatave kanë qenë të ndryshme, por në vlerësimin tonë, këto njoftime nuk mund të përdoren për të deklaruar fajtor një person i cili nuk është kontrolluar sipas parashikimeve të Kodit të Procedurës Penale.

Neni 37³⁷⁶ i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ashtu siç kemi cituar më lart, sanksionon “papekshmërinë e banesës” dhe nenet: 202/1-3, 205, 206, 298/1, 116 e 122 të K. Pr. Penale parashikojnë jo vetëm formën dhe procedurën se si duhet të realizohet kontrolli, por garantojnë respektimin e këtij parimi kushtetues.

Në rastin objekt diskutimi, kontrolli i banesës realizohet pa autorizim/vendim gjyqësor, që parashikon neni 202/1 i K. Pr. Penale, as në kushtet rastet e flagrancës apo në ndjekje të personit që është duke ikur, siç parashikojnë nenet 202/3 e 298/1 të K. Pr. Penale.

Neni 2³⁷⁷ i K. Pr. Penale përcakton se:

Dispozitat procedurale caktojnë rregullat për mënyrën e ushtrimit të ndjekjes penale, të hetimit dhe gjykimit të veprave penale, si dhe të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore. Këto rregulla janë të detyrueshme për subjektet e procedimit penal, për organet shtetërore, personat juridikë dhe shtetasit.

Në nenin 151,³⁷⁸ pika 1 normohet se: *...gjatë hetimeve paraprake, provat merren nga organet që procedojmë, sipas rregullave të caktuara në këtë kod..., ndërsa në pikën 4 normohet se: ...provat e marra nga shkeljet dhe ndalimet e parashikuara nga ligji nuk mund të përdoren. Papërdorshmëria mund të ngrihet edhe kryesisht në çdo gjendje e shkallë të procedimit.*

Nga analiza e mësipërme ligjore, në kuptim e zbatim të Kushtetutës, neneve 27/1, 28/5, 37, të saj dhe të neneve: 1, 2, 4, 116, 122, 151/1, 202/3, 206, 298/1, 300/2, 301/1-2, të K. Pr. Penale, vlerësojmë se kontrolli i banesës është i kundraligjshëm dhe procesverbalet “Për kontrollin e banesës”, “Për këqyrjen, marrjen dhe fiksimin e provave materiale” dhe “Për sekuestrimin e provave materiale”, janë të pavlefshme dhe, për rrjedhojë, njoftimet e fiksuara në to janë të papërdorshme.

Të njëjtin qëndrim ka mbajtur dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë në Vendimin Nr.2027³⁷⁹, datë 31.12.2012 ku, ndër të tjera, është shprehur se:

³⁷⁵ Kodi i Procedurës Penale, neni 298.

³⁷⁶ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 27.

³⁷⁷ Kodi i Procedurës Penale, neni 2.

³⁷⁸ Kodi i Procedurës Penale, neni 151.

³⁷⁹ Vendimi Nr.2027, datë 31.12.2012, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Duke qenë se rezulton se kontrolli që i është bërë banesës, si pasojë e të cilit është gjetur pistoletë, është kryer në kundërshtim me kërkesat e K. Pr. Penale dhe pikërisht të SEKSIONIT II, KONTROLLET, nenet 202-207, për rrjedhojë, rezultatet e kontrollit nuk mund të përdoren, bazuar në pikën 4 të nenit 151 të K. Pr. Penale.

Si pasojë e kontrollit të paligjshëm, të argumentuar më sipër, është gjetur pistoletë, por, duke qenë se ajo është marrë në kundërshtim me rregullat e përcaktuara në K. Pr. Penale (frut i hidhur), atëherë kjo provë, në bazë të pikës 4 të nenit 151 të K. Pr. Penale, nuk mund të përdoret dhe në këtë rast gjykata çmon se çështja penale në ngarkim të të pandehurit Klajdi Gjeçi duhet pushuar, pasi ndjekja penale ndaj tij nuk mund të vazhdojë.

Po ashtu, edhe në vendimin nr. 252,³⁸⁰ datë 17.03.2010, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë është arsyetuar “kontrolli” si mjet për kërkimin e provave:

Kontrolli i banesës së të gjykuarit pa pasur vendim gjykate është kryer në kundërshtim me dispozitat e nenit 151/4 dhe 251 dhe nenit 32 të Kushtetutës, e si rrjedhojë, rezultati i dalë prej saj është i papërdorshëm. Ky kontroll është një akt procedural i papërdorshëm dhe nga fakti se ai, nga pikëpamja formale, nuk është realizuar konform dispozitave ligjore procedurale. Kështu, sipas procesverbalit të kontrollit të banesës rezulton se ai është bërë në datën 20 të vitit 2007, por nuk është pasqyruar muaji kur është realizuar ky veprim hetimor.

Në kundërshtim me ligjin është vepruar nga ana e organit të akuzës edhe sa i përket fiksimit dhe marrjes së provave. Siç rezulton nga procesverbali i këqyrjes dhe marrjes së provës materiale, i datës 20.12.2006, është bërë e mundur fiksimi dhe marrja e provës materiale.

Kjo provë materiale është rezultat i një kontrolli të paligjshëm dhe i një këqyrje të realizuar në kundërshtim me ligjin, duke mos qenë i pranishëm pronari i vendit të këqyrur. Në të njëjtën kohë, kjo provë materiale është gjetur, marrë, e fiksuar në kundërshtim me dispozitat ligjore.

Në vendimin Nr. 618,³⁸¹ datë 16.06.2010, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë është arsyetuar kontrolli i personit në momentin e arrestimit të tij.

Në momentin e arrestimit, dy të gjykuarit janë ndodhur në kompleksin Mak-Albania në Golem-Kavajë. Nga kontrolli i ushtruar në momentin e arrestimit të gjykuarve u janë gjetur e më pas sekuestruar shuma prej 600 000 mijë lekë e përbërë dhe nga kartëmonedha të huaja euro, dollarë, një automjet të cilin sapo e kishin blerë dhe bizhuteri të ndryshme.

Legjislatori dhe ekspertët e fushës kanë parashikuar se ishte i nevojshëm edhe ndryshimi i disa dispozitave në këtë seksion, me synimin e përgjithshëm për të parashikuar dispozita më të qarta në kryerjen e kontrolleve të tilla, si: ***parashikimi i qartë dhe i saktë i përmbajtjes së urdhërit të kontrollit, mundësinë për avokatin që të jetë i pranishëm në rastin e këqyrjes së vendit, dispozitë të qartë për kontroll në rast flagrance (të cilat kryhen pa urdhër të gjykatës) dhe dispozitë të qartë për kryerjen e***

³⁸⁰ Vendimi Nr. 252, datë 17.03.2010, i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

³⁸¹ Vendim Nr. 618, datë 16.06.2010, i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

kontrollit kur është lëshuar vendimi i gjykatës, por nuk është e nevojshme apo nuk ka mundësi për t'u paraqitur për shkak të rrethanave të veçanta.

- Neni 202³⁸² është riformuluar duke parashikuar përmbajtjen e vendimit të kontrollit, afatin e kryerjes së tij, rastin e ankimit në Gjykatën e Apelit, si shqyrtimin nga ana e kësaj gjykate të ankimit brenda 24 orëve.
- Në paragrafin e parë të nenit 203 është vendosur kufizimi i kryerjes së kontrollit pas dorëzimit të sendit vetëm në rastet kur, edhe pas dorëzimit, ekziston dyshimi se nga kontrolli mund të zbulohen gjurmë apo sende të tjera që lidhen me veprën penale.
- Në paragrafin e dytë të nenit 204 është parashikuar garancia për zhvillimin e kontrollit nga një person i të njëjtës gjini për të garantuar mbrojtjen e dinjitetit të personit.
- Në paragrafët 2, 3 dhe 4 të nenit 205 është parashikuar procedura e ndjekur në rastet e kontrollit të vendeve, duke u përcaktuar prania e detyrueshme e mbrojtësit të zgjedhur dhe në mungesë të tij, e një mbrojtësi të caktuar kryesisht nga organi procedues. Parashikimi i kësaj procedure garanton mënyrën e zhvillimit të kontrollit dhe të drejtat e personit ndaj të cilit kryhet kontrolli. Gjithashtu, në paragrafin 6 të dispozitës është parashikuar rasti kur personi, pronari a poseduesi i sendit në të cilin do të kryhet kontrolli nuk gjenden, duke u kërkuar në mënyrë të detyrueshme prania e mbrojtësit.
- Neni 207 është riformuluar, për të qenë në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe praktikën e GJEDNJ-së. Konkretisht, kjo dispozitë parashikon sekuestrimin e sendeve të gjetura gjatë kontrollit në 3 situata të ndryshme:
 - a) sekuestrimin e sendeve të gjetura gjatë kontrollit, me kushtin që ato të jenë sende të përcaktuara në vendimin për lejimin e kontrollit;
 - b) lejimin e sekuestrimit edhe të sendeve të tjera të gjetura gjatë kontrollit, që nuk përfshihen në vendimin përkatës, por që lidhen me të njëjtën vepër penale vetëm duke respektuar dispozitat për sekuestrimet;
 - c) lejimin e sekuestrimit edhe të sendeve të gjetura gjatë kontrollit, të cilat as nuk janë të përcaktuara në vendimin për lejimin e kontrollit dhe as nuk lidhen me veprën penale, por që lidhen me një vepër tjetër penale që ndiqet kryesisht.

Në dy rastet e fundit, kriteret që zbatohen për kryerjen e sekuestrimit janë ato të parashikuara nga neni 301 i kodit. Në praktikën gjyqësore shpeshherë ka pasur keqkuptime në lidhje me kontrollet e ushtruara nga forcat e policisë për sa i përket pajisjes me një vendim për kryerje kontrolli dhe orarit të kryerjes së këtij kontrolli. Keqkuptimet kanë bërë që të fillohen edhe procedime penale ndaj efektivëve të policisë dhe rezultatet kanë qenë shpeshherë jo të ligjshme.

E themi këtë, pasi kontrolli në vende të ndryshme nga ana e policisë gjyqësore për gjetjen e një personi ndaj të cilit po bëhet ndjekja në flagrancë, ose ndaj të cilit ka një kufizim të lirisë personale me një nga institutet e kufizimit të lirisë sipas parashikimeve

³⁸² Relacioni për disa shtesa dhe ndryshime në Kodin e Procedurës Penale.

PROVAT DHE PROCESI I TË PROVUARIT NË PROCESIN PENAL

të Kodit të Procedurës Penale (urdhër ndalimi, vendim caktim mase sigurimi, vendim dënimi për ekzekutim), është krejt i ndryshëm nga kontrolli si mjet për kërkimin e provës.

Në rastin e kërkimit të personit nuk ka rëndësi orari i kryerjes së kontrollit dhe as akti procedural (në rastet e flagrancës) që e motivon këtë kontroll, ndërsa në zbatim të urdhrave dhe vendimeve që e kufizojnë lirinë personale duhet të jetë prezent akti përkatës, ndërsa orari nuk është i kufizuar.

Tek pjesa e dokumentimit të procesverbaleve të kontroleve dhe këqyrjeve dua të ndalem pak edhe në aspektin praktik se si mund të kryhet një kontroll apo këqyrje.

Në vendin ku do të bëhet këqyrja ose kontrolli duhet të jenë të pranishëm vetëm personat që e bëjnë këqyrjen dhe nënshkruajnë procesverbalin përkatës dhe jo çdo person tjetër përfaqësues i çfarëdolloj agjencie ligjzbatuese që nuk ka asnjë cilësi procedurale në procedim.

E them këtë, pasi kontrolli objektivisht realizohet nga agjentët e policisë gjyqësore dhe procesverbali mbahet e nënshkruhet vetëm nga Oficeri i Policisë Gjyqësore.

Në praktikë është shkaktuar problem në marrëdhënie me personat dhe vendet që ata posedojnë ose zotërojnë si pasuri, si dhe personat e tjerë të pranishëm që duhet të nënshkruajnë në procesverbalin që dokumenton veprimin.

Pjesëmarrja e laborantit ekspert ose ekspertit kriminalist ndihmon në rastin e marrjes së provës për efekte ekzaminuese shkencore dhe mosdëmtimin e saj, si dhe plotësimin e procesverbalit të shkruar edhe me fotografim, që nuk është një akt i veçantë procedural, por pjesë plotësuese e procesverbalit të këqyrjes ose kontrollit.

Në praktikë, mjaft herë është gabuar duke gjetur shprehje e risi procedurale në formulimin e titullimit e akteve procedurale, duke parashikuar të ashtuquajturin procesverbal të verifikimit të thënieve, ku merret personi i ndaluar ose i arrestuar, dhe dërgohet nëpër vendet ku ai ka qenë e ka kryer elemente të veprës penale, apo gjenden të dhëna për ekzistencën e përgjegjësisë penale për vepra të tjera penale të personave të tjerë dhe ky procesverbal është shoqëruar me fotografimin e këtyre vendeve.

Në të vërtetë, ky procesverbal është një procesverbal i mirëfilltë këqyrjeje të një vendi ose sendi, ku rezultatet e kësaj këqyrjeje shoqërohen, përveç formës së shkruar, me fotografim dhe filmim.

4.3. SEKUESTRIMET

E shoh të rëndësishëm faktin të trajtoj fillimisht terminologjinë nga ana gjuhësore dhe më pas në trajtimin juridik të saj, pasi duhet të kuptojmë se nuk kemi të bëjmë me prova të mirëfillta, por me mjete të kërkimit të provave. Kështu, sipas fjalorit të gjuhës shqipe, folja “sekuestroj” ka si definicion këtë kuptim: **sekuestroj**: “*sekuestr/ój kal., -óva, -úar drejt. ndaloj me rrugë ligjore përdorimin e shfrytëzimin e një prone a të një pasurie vetjake; vjet. kthej në pronë të shtetit pasurinë e një të dënuari ose diçka të siguruar në mënyrë të paligjshme: sekuestruan bagëtitë. / pës. sekuestróhet v. III.*” **sekuestrim**: *sekuestrím,-i m. sh. -e(t) veprimi sipas foljes: sekuestrimi i pasurisë.*

PROVAT DHE PROCESI I TË PROVUARIT NË PROCESIN PENAL

Ky mjet i kërkimit të provave është normuar nga dispozitat 208-220 të K. Pr. Penale. Është trajtuar në këtë dispozitë se kush është **objekti i sekuestrimit, subjektet që disponojnë për kryerjen e tij, të drejtat e palëve në këtë proces, mënyra e kryerjes, ruajtja dhe administrimi i sendeve e objekteve të sekuestruara.**

Sekuestrimi është një nga mjetet e rëndësishme të kërkimit të provës, me anë të të cilit realizohet kufizimi i përkohshëm - deri në një vendim përfundimtar të prokurorit ose gjykatës - i të drejtave pasurore të një personi mbi një send të caktuar, objekt konkret i luajtshëm, i paluajtshëm apo shumë të hollash, nëpërmjet marrjes së sendit apo shumës së të hollave, ose nëpërmjet detyrimit për të mos i ushtruar të drejtat kur sendi nuk mund të merret, apo nëpërmjet detyrimit të të tretëve të mos i japin mundësi personit të gëzojë sendin apo të hollat. Nga ana e organit procedues mund të vendoset sekuestrimi i çdo sendi të luajtshëm ose të paluajtshëm, i cili lidhet me objektin e të provuarit në procesin penal dhe jep njoftime për zgjidhjen e drejtë të çështjes penale.

Objekti i sekuestrimit është i lidhur ngushtë me kuptimin e provës materiale, neni 187 i K. Pr. Penale dhe sendeve që lidhen me veprën penale. Kështu, objekt i sekuestrimit janë:

1. *sendet që kanë shërbyer si mjet për realizimin e veprës penale, siç mund të jenë: një armë; një dozë/sasi helmi; mjete motorik tokësor apo detar që ka transportuar klandestinë, drogë, mallra kundrabandë etj.;*
2. *sendet mbi të cilat gjenden gjurmët e veprës penale, siç mund të jenë: veshjet e viktimës ose automjeti mbi të cilat gjenden njolla gjaku, faktor të qitjes dhe dëmtimit me armë zjarri; objekte/sende ku gjenden gjurmë daktiloskopike etj.;*
3. *sendet që kanë qenë objekt i veprimtarive të të pandehurit, siç mund të jenë: sendet e vjedhura etj.;*
4. *sendet që përbëjnë objektin e përfimit nga vepra penale, siç mund të jenë: të ardhurat apo objektet e siguruara nga veprimtaria kriminale, trafikimi njerëzor, i drogës, shfrytëzimi i prostitucionit, shitja e sendeve të vjedhura etj.;*
5. *përfitimet që realizohen nga shmangia e detyrimeve fiskale etj., si dhe;*
6. *sende që lidhen me veprën penale, siç mund të jenë ato sende që ndihmojnë në sqarimin e rrethanave të çështjes dhe për individualizimin e fajtorit, si pasaporta ose fotografi të autorit/bashkautorëve të veprës penale etj.*

Kodi i Procedurës Penale parashikon se sekuestrimi mund të kryhet në rrethana që kërkojnë:

1. *procedurë normale, mbështetur në nenet: 208 - 220, 309, 310 e 315 të K. Pr. Penale;*
2. *procedurë të ngutshme, mbështetur në nenet: 300/2, 301 e 303/ç të K. Pr. Penale.*

Për shkak të rëndësisë së madhe që ka sekuestrimi si mjet për kërkimin e provës, i cili kufizon ushtrimin e të drejtave individëve, në nenin 208, është parashikuar procedura normale e sekuestrimit. Sipas kësaj dispozite, gjyqtari ose prokurori disponojnë me vendim të arsyetuar sekuestrimin e provave materiale dhe të sendeve që lidhen me veprën penale kur ato janë të domosdoshme për vërtetimin e fakteve.

Krahas rregullit të përgjithshëm, procedurës normale, në nenin 300 është parashikuar dhe procedura e ngutshme. Sipas kësaj dispozite, në kushtet kur ka rrezik që gjurmët dhe sendet të ndryshojnë ose të humbasin, dhe prokurori nuk mund të ndërhyjë

urgjentisht, është kompetencë e policisë gjyqësorë që të marrë masa për fiksimin, sekuestrimin dhe ruajtjen e këtyre sendeve. Nga ana e oficerëve të policisë gjyqësore përpilohet procesverbal, një kopje e të cilit i jepet personit të cilit i janë sekuestruar sendet.

Në respektim të parashikimeve të nenit 301³⁸³ të Kodit të Procedurës Penale, ky procesverbal i dërgohet pa vonesë, dhe sidoqoftë jo më vonë se dyzet e tetë orë, prokurorit të vendit ku është zbatuar sekuestroja. Prokurori, brenda dyzet e tetë orëve të ardhshme, me vendim të motivuar, vleftëson sekuestron nëse ekzistojnë kushtet ose vendos kthimin e sendeve.

Në praktikë, jo në pak raste, ka ndodhur që nga ana e oficerëve të policisë gjyqësore të mos dërgohen procesverbalet e sekuestrimit të sendeve ose i dërgohen me vonesë prokurorit. Ose, nga ana e prokurorit, nuk bëhet vleftësimi i këtyre procesverbaleve ose bëhet me vonesë. Edhe për këtë rast, pavarësisht qëndrimit që ka mbajtur gjykata, vlerësimet e studiuesve të së Drejtës Procedurale Penale, nëse këto akte janë ose jo të pavlefshme, janë të ndryshme.

Në analizë dhe të elementeve të vlefshmërisë së një akti, vleftësimi me vonesë ose mosvleftësimi i procesverbaleve të sekuestros e bën aktin e vesuar, të parregullt, por jo të pavlefshëm.

Neni 128 i Kodit të Procedurës Penale parashikon rastet kur një akt është absolutisht i pavlefshëm, ndërsa në nenin 129 është përcaktuar se pavlefshmëritë e ndryshme nga ato të përcaktuara në nenin 128 mund të deklarohen me kërkesë të palëve. Që një akt të jetë i pavlefshëm kërkon detyrimisht të jetë shkelur një nga katër elementet kumulativë të vlefshmërisë së tij, të cilët janë:

- 1) kompetenca;
- 2) procedura;
- 3) përputhja e aktit me përmbajtjen e ligjit;
- 4) përputhja e aktit me qëllimin e ligjit.

Në rastin objekt diskutimi, nuk jemi përpara shkeljeve të elementeve të mësipërm që të shkaktojnë pavlefshmëri. Pavlefshmëria e aktit, ashtu siç parashikohet dhe në të drejtën administrative, nuk duhet të lidhet domosdoshmërisht me parregullsinë e tij. Në parregullsinë e një akti mund të ndikojë vlerësimi i padrejtë ose i papërshtatshëm i situatave, rrethanave, kushteve, momentit, kohës ose mënyrës së nxjerrjes së aktit nga organi. Jemi të mendimit se parregullsia e aktit nuk është e njëjtë me kundërligjshmërinë e tij dhe se parregullsia përbën më tepër çështje oportuniteti se çështje ligji, dhe për këtë arsye vlerësojmë se nuk cenohet vlefshmëria e tij.

Në nenin 208/a, është parashikuar e drejta e organeve proceduese për zbulimin- marrjen e administrimitin e provave për veprat penale, të cilat kryhen në fushën e teknologjisë, rrjeteve informatike dhe internetit, apo kanë lidhje me to.

Neni 36³⁸⁴ i Kushtetutës parashikon se: *Liria dhe fshehtësia e korrespondencës ose e çdo mjeti tjetër të komunikimit janë të garantuara.* Ndërsa neni 8 i Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut parashikon se: *Çdo njeri ka të drejtë*

³⁸³ Kodi i Procedurës Penale, neni 301.

³⁸⁴ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 36.

të respektohet në jetën e tij private dhe familjare, t'i respektohet banesa dhe korrespondenca e tij. Në respektim të parimeve të sipërcituara, jo pak i rëndësishëm është dhe sekuestrimi i korrespondencës, parashikuar nga neni 209 i Kodit të Procedurës Penale.

Sekuestrimi i korrespondencës postare është veprim hetimor dhe, si i tillë, ai është sekret si për personin e proceduar, ashtu dhe për të tjerët. Prandaj, si ata që urdhërojnë, dhe ata që zbatojnë, përfshirë dhe personelin e shërbimit postar, janë të detyruar të ruajnë fshehtësinë e sekuestrimit dhe mbajnë përgjegjësi ligjore për shkeljen e këtij detyrimi. Si rregull, korrespondenca është e drejta e personit për të komunikuar lirisht nëpërmjet shërbimit postar dhe mjeteve të telekomunikacionit dhe, për sa më lart, me termin 'korrespondencë' kuptohen të gjitha format e komunikimit që realizohen nëpërmjet postës. Objekt sekuestrimi janë: letrat, zarfet, pakot, vlerat monetare e pasurore, telegramet dhe mjetet e tjera të korrespondencës.

Sekuestrimi i korrespondencës kryhet nga oficerët e policisë gjyqësore, të cilët, bashkë me vendimin apo urdhrin duhet t'iu tregojnë punonjësve të shërbimit postar dhe dokumentin që vërteton se ata janë kompetentë për ushtrimin e sekuestrimit. Oficeri i policisë gjyqësore është i detyruar të dorëzojë sendet e sekuestruara në organin procedues, pa i hapur dhe pa u njohur me përmbajtjen e tyre. Përrjashtimisht, në rastet kur ka shkaqe të bazuara për të menduar se plikot përmbajnë të dhëna që mund të humbasin për shkak të vonesës, oficeri i policisë, me autorizim të prokurorit, mund të hapë plikon.

Oficerët e policisë gjyqësore, në raste të ngutshme, kanë të drejtë të urdhërojnë pezullimin e dërgimit të korrespondencës për një afat deri në dyzet e tetë orë. Urdhëri i tyre duhet të jetë i shkruar dhe të përmbajë shkaqet që tregojnë karakterin e ngutshëm në rastin konkret. Personeli i shërbimit postar duhet të sigurohet për personin që ka nxjerrë urdhërin dhe të shënojë orën e saktë të dorëzimit të tij. Me plotësimin e dyzet e tetë orëve, pezullimi humbet fuqinë dhe, në qoftë se prokurori nuk ka urdhëruar sekuestrimin, objektet e korrespondencës dërgohen në destinacion.

Në nenin 210³⁸⁵ është parashikuar e drejta që ka organi procedues për të sekuestruar pranë bankave dokumente, letra me vlerë, shuma të depozituara në llogari rrjedhëse dhe çdo gjë tjetër, dhe nëse ndodhen në kasetat e sigurisë kur ka arsye të bazuara për të menduar se ato kanë lidhje me veprën penale.

Për të gjitha rastet e sekuestrimit, ligjvënësi ka parashikuar që i pandehuri apo personi që ka lidhje me sendin e sekuestruar, kanë të drejtën e ankimit të veçantë në gjykatë, e cila vlerëson nëse janë respektuar kërkesat e ligjit në sekuestrimin e sendit, objektit apo provave materiale. Ankimi në gjykatë ndaj vendimit të sekuestrimit, nuk pezullon zbatimin e sekuestros.

Në bazë të neni 211³⁸⁶ të Kodit të Procedurës Penale, personat e detyruar për ruajtjen e sekretit profesional ose shtetëror nuk e kanë detyrimin e dorëzimit kur deklarojnë se aktet dhe dokumentet, si dhe çdo gjë që ruhet pranë tyre është sekret shtetëror ose sekret që lidhet me detyrën e profesionin e tyre. Në rastet që konstatohet se deklarimi është i

³⁸⁵ Kodi i Procedurës Penale, neni 210.

³⁸⁶ Kodi i Procedurës Penale, neni 211.

pubazuar, organi procedues urdhëron sekuestrimin. Kur sekreti shtetëror konfirmohet nga organi kompetent dhe prova është thelbësore në zgjidhjen e çështjes, organi procedues vendos marrjen e saj. Në rast se brenda tridhjetë ditëve organi kompetent nuk jep konfirmimin e sekretit, organi procedues urdhëron për sekuestrimin e provës. Vendimi nr.50³⁸⁷, datë 18.02.2009, i Gjykatës së Lartë, jep arsytetime të vlefshme lidhur me respektimin e dispozitave që lidhen me administrimin e provave të sekuestruara nga organet e hetimit.

Më datë 20.09.2001, gjatë një kontrolli në banesën e shtetasit Luigj Mandreja, në ambientet e kësaj banese, në oborrin e shtëpisë, policia ka gjetur një armë zjarri mod.56, kal.7.62, me numër 12113702. Pasi i është bërë akt-ekspertimi dhe arma ka rezultuar e aftë për të bërë qitje, në ngarkim të Luigj Mandresë ka filluar çështja penale për “armëmbajtje pa leje”, parashikuar nga neni 278.2 të K. Penal dhe ndaj tij është vendosur masa e sigurimit personal “arrest në burg”.

Meqenëse para vitit 2000, në Rrethin e Mirditës kishin ndodhur disa ngjarje dhe kishin mbetur të pazbuluara, u bë ekspertimi i kësaj arme dhe i disa gëzhgojave të gjetura në vendngjarje të ndryshme, ndër të cilat edhe ato të vrasjes së Arben Gjokës.

Nga akti i ekspertimit nr.2271, datë 24.09.2001, ka rezultuar se 12 gëzhgojat që pretendohet se janë gjetur në vendngjarjen e vrasjes së Arben Gjokës janë qitur nga arma automatik me nr.12113702, por me shul tjetër.

Në këto rrethana, i gjykuari Luigj Mandreja është akuzuar edhe për veprën penale të vrasjes në bashkëpunim të viktimit Arben Gjoka, parashikuar nga neni 78 e 25 të K. Penal. Ndërkohë, gjatë gjykimit dhe rigjykimit të çështjes në Gjykatën e Shkallës së Parë Mirditë, familjarët e viktimit: vëllai, nëna, babai etj., ndryshe nga sa kishin deklaruar në vitin 1998, kanë deklaruar se gjatë kohës kur Arben Gjoka ishte ende gjallë, u kishte treguar se vrasjen e tij e kishte kryer Luigj Mandreja.

Nga ana e Gjykatës së Shkallës së Parë janë evidentuar dhe çmuar drejt provat, në zbatim të nenit 152 të K. Pr. Penale, e për rrjedhojë, edhe përfundimi i arritur nga Gjykata e Apelit, pa bërë përsëritjen e hetimit gjyqësor, por vetëm duke çmuar ndryshe provat e administruara në Gjykatën e Shkallës së Parë, e duke u mbështetur sidomos në thëniet kontradiktore e të ndryshuara në gjykim e rigjykim të familjarëve dhe të të afërmeve të viktimit dhe në provat (gëzhgojat) e gjetura në Komisaratin e Policisë Mirditë më datë 26.04.2006, 8 vjet pas ngjarjes, të cilat janë siguruar, janë marrë, ruajtur dhe administruar jo në përputhje me kërkesat procedurale, në vështrim të nenit 152 të K. Pr. Penale, është rezultat i zbatimit jo të drejtë të kriterëve ligjore mbi çmuarjen e provave.

Vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë bëhet i cenueshëm edhe në lidhje me zbatimin jo të drejtë të kriterëve ligjore për çmuarjen e provave materiale, konkretisht të 11 gëzhgojave të gjetura në një kasafortë në Komisaratin e Policisë Rrëshen më datë 25.04.2006, e për rrjedhojë, edhe të akt-ekspertimit balistik që ka ekzaminuar këto gëzhgoja, ndonëse konkluzionet e të cilit bien ndesh me konkluzionet e ekspertëve të mëparshëm, që edhe ai akt është konstatuar i pavlefshëm.

³⁸⁷ Vendim nr.50, datë 18.02.2009, i Gjykatës së Lartë.

PROVAT DHE PROCESI I TË PROVUARIT NË PROCESIN PENAL

Konkluzionin e Gjykatës së Shkallës së Parë se gëzhojat e gjetura në Komisaratin e Policisë më datë 25.04.2006, 8 vjet pas ngjarjes, në një kasafortë të hapur që mbanin mbishkrimin se i përkasin ngjarjes së datës 24.02.1998 dhe tre prej tyre që mbajnë mbishkrimin u gjetën në banesën e shtetasit Agustini (Luigj) Mandreja më datë 18.06.1998, kanë të bëjnë me një provë të siguruar në mënyrë të jashtëligjshme, Kolegji Penal, e gjen të drejtë. Ky konkluzion, ashtu siç me të drejtë arsyetohet kjo gjykatë, është bindës për faktin se nga provat e administruara nuk rezultoi se më datë 24.02.1998 të jetë bërë ndonjë këqyrje e vendit të ngjarjes dhe se dyshimi që mund të jetë ndonjë gabim (lapsus) në vendosjen e datës, bie poshtë edhe për faktin se në këtë letër, veç datës, thuhet se u gjetën dhe tek lulet, në një kohë që këqyrja e vendit të ngjarjes, datë 15.02.1998, është bërë menjëherë pas ngjarjes, ka filluar në orën 22:00 dhe ka përfunduar në orën 24:00, është bërë me shumë saktësi sa që janë të shënuara dhe gjurmë këpucësh etj., duke u bërë dhe fotografime, ndërsa lule nuk figurojnë, mbasi realisht nuk ekzistonte mundësia e vendosjes së tyre në kohën e këqyrjes, sepse viktima akoma ishte gjallë dhe familjarët bashkë me mjekun po e transportonin drejt Spitalit Ushtarak Tiranë.

Edhe shënimi tjetër në letrën që mbështille tri gëzhoja, se ato u gjetën në banesën e shtetasit Agustini (Luigj) Mandreja më datë 18.06.1998, tregon qartësisht se këto janë marrë në mënyrë të jashtëligjshme dhe nuk i përgjigjen realitetit, mbasi kontrolli në banesën e tij është bërë vetëm më datë 20.09.2001, kohë kur i është gjetur arma pa leje për të cilën është filluar çështja penale dhe është akuzuar i gjykuari.

*Gjithashtu, pavlefshmërinë e marrjes së këtyre provave dhe papërdorshmërinë e tyre, ashtu siç me të drejtë arsyetohet Gjykata e Shkallës së Parë, e tregon dhe fakti se nuk ka procesverbal për këqyrjen e vendit të ngjarjes më datë 24.02.1998, nuk ka procesverbal për fiksimin dhe marrjen e provave dhe as vendim për sekuestrimin e tyre (gëzhojave), përveç procesverbalit të ditës së ngjarjes datë 15.02.1998, ku janë fiksuar e marrë 9 gëzhoja. Edhe procesverbali i sekuestros së provës, i mbajtur nga prokurori datë 25.04.2006 në Komisaratin e Policisë, është veprim që i takon fazës së gjykimit të çështjes e, për rrjedhojë, duhet të respektoheshin kërkesat e nenit 321.1 të K. Pr. Penale, pra duhet të ishte e domosdoshme pjesëmarrja e mbrojtjes së të pandehurit etj. Kolegji Penal konstaton se në marrjen, ruajtjen dhe sekuestrimin e provave të gjetura në Komisaratin e Policisë Mirditë, më datë 25.04.2006, nuk janë zbatuar kërkesat e nenit 149 e 208 të K. Pr. Penale, po kështu nuk janë zbatuar as kërkesat e neneve **214, 215 e 216 të këtij Kodi, që kanë të bëjnë me ruajtjen e provave.***

Për rrjedhojë, ashtu siç ka arritur në përfundim Gjykata e Shkallës së Parë Mirditë, edhe Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë çmon se, jo vetëm akt-ekspertimi balistik nr.2271, datë 22.09.2001, që ka arritur në konkluzionin se 12 gëzhojat e dërguara për ekspertim, të ndryshme nga ato që janë fiksuar në vendngjarje, janë qitur nga arma me nr.12113702, e gjetur në shtëpinë e të gjykuarit, por edhe akt-ekspertimi balistik nr.2516, datë 17.05.2006. që përcakton se 4 gëzhoja, nga 11 gëzhojat e paraqitura për ekspertim, janë qitur nga arma e gjetur në shtëpinë e të gjykuarit, ku ka përputhje vetëm me gjurmën e jashtëqitësit, por nuk janë qitur me shulin që mban arma në momentin e ekspertimit, janë akte që nuk provojnë se arma me nr.12113702, e gjetur në shtëpinë e

të gjykuarit Luigj Mandreja, ka qitur gëzhojat e gjetura në vendngjarjen e vrasjes së viktimës Arben Gjoka.

Vendimi Unifikues Nr. 01, datë 25.01.2007,³⁸⁸ e përcakton qartë se: **për zbatimin e masave pasurore ndaj personave të tjerë në gjykim nuk është e njaftueshme të vertetohet thjesht fakti i lidhjes familjare, gjinore, të krushqisë etj., për të provuar ekzistencën e zotërimit në fakt të pasurisë nga personi i dyshuar dhe vendosjen fiktive të saj në emër të personave të tjerë.**

Gjykata, përpara se të vendosë masën pasurore, duhet të verifikojë dhe të arrijë në përfundime të mbështetura në prova se ekziston një shfaqje e jashtme, formale, e zotërimit, titullit të pronësisë së pasurisë në emër të personave të tjerë, ndërkohë që nga tërësia e rrethanave, disponimi autonom, efektiv, i pjesshëm a i plotë, direkt a i tërthortë, sikur të ishte pronar i tyre është i personit të dyshuar. **Këto prova duhet të përmbajnë të dhëna të njaftueshme, jo thjesht në trajtën e dyshimeve, indicieve, por edhe fakte e rrethana konkrete, të sakta, të cilat, në harmoni me njëra-tjetrën, përbëjnë prova indirekte që mbështesin këtë prezumim të parashtruar nga prokurori në kërkesën e tij drejtuar gjykatës së procedimit preventiv.**

GJEDNJ-ja, në çështjen DENISOVA dhe MOISEYEVA³⁸⁹ kundër Rosisë (4 tetor 20120), është shprehur se: *Kërkesa e parë dhe më e rëndësishme e nenit 1 të Protokollit nr. 1 është që çdo ndërhyrje nga autoriteti publik në gëzimin e pasurisë duhet të jetë “e ligjshme”.*

GJEDNJ-ja ka mbajtur qëndrimin se nuk cenohet neni 1 i protokollit 1 i KEDNJ-së vetëm në rastet se përmbushen kërkesat e ligjshmërisë dhe kufizimi i tagrave të pronarit nuk është arbitrar (*Baklanov kundër Rosisë*³⁹⁰, nr. 68443/01, § 39, 9 qershor 2005 dhe *Frizen kundër Rosisë*, nr. 58254/00, § 33, 24 mars 2005.).

Në respektim të praktikës, tashmë të konsoliduar, të GJEDNJ-së, në vlerësimin tim, duke disponuar me vendim për vënien e sekuestros preventive pa realizuar një hetim të plotë për vërtetimin e rrethanave të faktit, gjykatat cenojnë ekuilibrin e drejtë që është vendosur midis kërkesave të interesit të përgjithshëm të komunitetit dhe kërkesave të mbrojtjes së të drejtave themelore të individit.

Për sa i përket ndryshimeve që lidhen me rregullimin e veprimeve të prokurorit në rastet e sekuestrimit të dokumenteve apo akteve me karakter sekret, afatet e kundërshtimit të vendimit të sekuestrimit, si dhe mënyrën e ruajtjes së kampionëve të sendeve të sekuestruara, vlen të theksojmë disa momente. Konkretisht:

- Në nenin 211³⁹¹ janë riformuluar paragrafët 2 dhe 3 duke parashikuar kërkimin e konfirmimit mbi karakterin sekret të dokumenteve apo akteve të kërkuara për t'u sekuestruar dhe procedimin e organit për sekuestrimin vetëm pas dhënies së konfirmimit, ose moskthimit të përgjigjes nga organi kompetent.

³⁸⁸ Vendimi Unifikues Nr. 1, datë 25.01.2005, i Kolegjeve të Bashkuara Penale.

³⁸⁹ Vendim i GJEDNJ-së Denisova & Moiseyeva vs Rosisë.

³⁹⁰ Vendim i GJEDNJ-së Baklanov vs Rosisë.

³⁹¹ Relacioni për disa shtesa dhe ndryshime në Kodin e Procedurës Penale.

PROVAT DHE PROCESI I TË PROVUARIT NË PROCESIN PENAL

- Është shtuar neni 211/a, i cili rregullon rastin e sekuestrimeve në zyrat e shërbimeve informative, procedurë kjo e nevojshme për t'u parashikuar në mënyrë të detajuar nga kodi.
- Në nenin 212 është parashikuar kundërshtimi i vendimit të sekuestrimit brenda afatit 10 ditor në Gjykatën e Apelit dhe afati i shqyrtimit të ankimit nga kjo gjykatë, po brenda 10 ditësh, duke u parashikuar pezullimi i procedurës në çdo rast deri në marrjen e këtij vendimi.
- Në paragrafët 4, 5 dhe 6 të nenet 215 është parashikuar për herë të parë në kod mënyra e marrjes dhe ruajtjes së kampionëve të sendeve të sekuestruara, për të shmangur mbajtjen e të gjithë materialit të sekuestruar, veçanërisht në rastet kur sendet apo lëndët janë të rrezikshme, duke u autorizuar ministria përkatëse për nxjerrjen e akteve nënligjore për miratimin e detajuar të procedurës.

Te sekuestrimet si mjete për kërkimin e provës duhet të mbajmë parasysh edhe sekuestron preventive dhe atë konservative, si masa sigurimi pasuror, krejt të ndryshme nga sekuestrimet e përshkruara më lart si mjete të kërkimit të provave në një procedim penal.

4.4. PËRGJIMET

Emri ose fjala “përgjim” vjen nga folja “përgjoj”, që do të thotë “rri i fshehur diku e dëgjoj, a vëzhgoj diçka për të marrë vesh çfarë thotë, çfarë bën etj. - ndjek fshehurazi veprimet e dikujt, vëzhgoj pa më parë kush”³⁹². Pra, brenda kuptimit të fjalës “përgjim” që vjen nga folja “vëzhgoj” e që do të thotë “e ndjek me sy dikë a diçka, e vështroj me vëmendje që ta njoh mirë, përgjoj veprimet e dikujt, gjurmoj lëvizjet e tij, e ruaj nga vete e çfarë bën”.

Përgjimi është një mjet, me anë të të cilit mund të arrihet në zbulimin e veprave dhe kundravajtjeve penale. Ai nuk përbën një provë juridike, pasi nuk përfshihet në provat ligjore, por në mjetet për kërkimin e provës. Si i tillë, përgjimi duhet të përdoret në rastet kur ai zbulon këto vepra penale, të cilat, nga lloji i tyre, është shumë e vështirë të zbulohen. Sigurisht që ky mjet prove nuk duhet të arrijë në cenimin e të drejtave themelore kushtetuese në Shqipëri, pasi përndryshe, nga një mjet prove, do të shndërrohej në një mekanizëm presioni dhe frike për personat që do binin preh e këtij mjeti.

Komunikimi nëpërmjet telefonit dhe mjeteve të tjera të telekomunikacionit është një e drejtë e individit për të komunikuar lirisht, me të gjitha format dhe mjetet e kësaj teknologjie, si: biseda telefonike, fakse, telegrame, e-mail etj. Çdo ndërhyrje e paligjshme që cenon këtë të drejtë, nga cilido që të bëhet është një veprim arbitrar i dënueshëm. Prandaj, në shtetet me teknologji të zhvilluar në fushën e telekomunikacioneve, e cila krijon mundësi të shumta për të ndërhyrë në jetën private dhe në sekretet e shtetit, si në rastin e internetit, po përmirësojnë legjisllacionin me synimin që të pengohet çdo ndërhyrje e paligjshme.

³⁹² Fjalori i Gjuhës së Sotme Shqipe, fq. 14,37, Tiranë 1980.

Kuptimi juridik, roli dhe rëndësia e përgjimit

Si përmbajtje juridike, përgjimi është një mjet i posaçëm hetimi i fshehtë, mjet për kërkimin e provës me një teknikë që përdoret gjatë veprimtarisë hetimore nga organet e ndjekjes penale, sidomos në fushën e krimit të organizuar, të krimit ekonomik etj., pra në rrafshin e krimeve të rënda në përgjithësi. Përgjimi nuk bëhet vetëm me një teknikë, por kryhet nëpërmjet disa teknikave. Përgjimi përdoret gjatë fazës hetimore. Hetimet kalojnë në dy faza.

Faza e parë. është faza e fshehtë, ku bën pjesë përgjimi, d.m.th. që personi nën hetim nuk ka dijeni për faktin se po hetohet nga organet proceduese. Ky hetim bëhet publik, pasi organet hetimore shpërndajnë të gjithë veprimet e nevojshme për hetim.

Kjo është dhe ***faza e dytë*** e hetimit, ku personit nën hetim i bëhen të njohura të gjitha teknikat që përdoren në fshehtësi. Pra, përgjimi është një mjet delikat, përdorimi i tij duhet të bëhet me shumë kujdes.

Në vështirim të telekomunikimeve, me fjalën përgjim kuptohet ndërhyrja e fshehtë për të kapur, dëgjuar e regjistruar përmbajtjen e komunikimit dhe të dhëna që lidhen me të ndërmjet pikës së nisjes e pikës së mbërritjes³⁹³.

Objekt përgjimi janë: sinjalet, shkrimet, fotografitë, të dhënat audiovizuale, ose lloj tjetër informacioni, për të marrë ose transmetuar nëpërmjet pajisjeve të telekomunikacionit.

Sukseset e arritura në zbulimin e krimit, sidomos të krimeve të rënda dhe krimit të organizuar, siç janë, p.sh.: trafikimi i lëndëve narkotike, armëve apo qenieve njerëzore, vrasjet me pagesë, shfaqjet korruptive, shpërdorimet ekonomike etj., që organizohen e kryhen me mënyra të stërholluara, saqë, në shumë raste, nuk lënë as gjurmë prove, sepse realizohen nëpërmjet mjetesh teknike nga më modernet e të sofistikuar, flasin për rolin dhe rëndësinë e përgjimit si mjet për kërkimin e provës, për hetimin dhe vërtetimin e veprimtarisë kriminale, që, përgjithësisht, mjetet e tjera të kërkimit të provës do të ishin të pamjaftueshme, jo efektive dhe, për pasojë, nuk do të mund të provonin asnjë fakt kriminal. Sidomos përgjimet telefonike dhe ambientale që përbëjnë metoda hetimore të reja, duke përdorur edhe mjete teknike moderne e duke ndryshuar edhe vetë pamjen e mënyrat e hetimit kriminal për grumbullim të dhënash që, me mënyrat e zakonshme të hetimit të një çështje, do të mbeteshin të pazbuluara e që, në të njëjtën kohë, i japin përgjimit vlerën e përparësisë dhe të domosdoshmërisë në rendin e mjeteve të kërkimit të provës.

Në Khan kundër Mbretërisë së Bashkuar,³⁹⁴ kërkuesi kishte mbërritur në Mbretërinë e Bashkuar në të njëjtin avion si kushëriri i tij, i cili u zbulua se kishte në zotërim heroinë. Nuk u zbulua ndonjë heroinë te kërkuesi. Pesë muaj më vonë, kërkuesi i bëri vizitë një mikut të tij që ishte nën hetim se ishte marrë me heroinë. Një pajisje përgjimi ishte instaluar në shtëpinë e mikut pa dijeninë e tij. Policia, si pasojë, regjistroi në manjetoфон bisedën midis kërkuesit dhe mikut të tij, ku i pari pranoi se ishte marrë me

³⁹³ Ligji nr.9157, datë 14.12.2003, "Për përgjimin e telekomunikimeve", neni 3.

³⁹⁴ Khan kundër Mbretërisë së Bashkuar, 12 maj 2000.

kontrabandë droge. Ai u arrestua dhe u akuzua dhe, së fundmi, u dënua për krim për kontrabandë droge. Përpara Gjykatës Evropiane, ai pretendoi shkelje të nenit 8, të drejtën për respektimin e jetës private dhe nenit 6. Në lidhje me pretendimin për shkelje të nenit 6, gjykata vërejtë se kërkuesi kishte pasur mundësi të njaftueshme për të kontestuar si vërtetësinë, ashtu edhe përdorimin e regjistrimit. Kërkuesi nuk kontestoi vërtetësinë, por në fakt ai kontestoi përdorimin e tij. Fakti se ai nuk ishte i suksesshëm, theksoi gjykata, nuk përbënte ndryshim në vlerësimin e çështjes nga ana e gjykatës. Kështu, gjykata konstatoi se përdorimi i materialit që u mor duke shkelur nenin 8, nuk llynte në konflikt me kërkesat e drejtësisë së përfshirë në nenin 6.

Përgjimi i komunikimeve në përmbytje të tij ka si qëllim cenimin e të drejtave e lirive themelore të njeriut, të drejta këto të garantuara nga Kushtetuta, KEDNJ-ja dhe aktet e tjera ndërkombëtare, të cilat janë bërë pjesë e të drejtës së brendshme. Për këtë arsye, është parashikuar se, mbi bazën e kërkesës së organit procedues, në kushtet e ekzistencës së një procedimi penal në lidhje me veprat penale të përcaktuara nga ligji (objekt procedimit), përgjimi i nënshtrohet një procesi paraprak vlerësimi gjyqësor, që ka në optikën e kontrollit kriteret kushtetuese dhe ligjore.

E drejta për të respektuar korrespondencën e një personi është një e drejtë që ka lidhje me komunikimet e pandërprera e të pacensuruara me të tjerët. Gjykata e të Drejtave të Njeriut është shprehur se te korrespondenca përfshihen materialet që nisen me postë, komunikimet telefonike dhe teletekstet, si dhe metodat e reja të komunikimit që mund të lindin gjatë zhvillimit të vazhdueshëm të teknologjisë.³⁹⁵

Në çështjen e Domenichini kundër Italisë, gjykata u shpreh se monitorimi i letrave të kërkuetit për avokatin e tij nga ana e autoriteteve të burgut përbënte shkelje si të nenit 8, ashtu edhe të nenit 6 (3) b, veçanërisht për shkak të një vonese në dërgimin e një prej letrave të tij avokatit. Konventa kërkon që çdo ndërhyrje në të drejtën e të akuzuarit ose personit të ndaluar për të komunikuar me avokatët e tyre duhet të parashikohet me ligj, i cili është “i qartë dhe i siguri” dhe që parashtron qartë rrethanat në të cilat lejohen ndërhyrje të tilla.³⁹⁶

Por, ashtu si dhe të drejtat e tjera të njeriut, fshehtësia e korrespondencës nuk lejohet të përdoret për arritjen e qëllimeve kriminale ose në dëm të interesave të shoqërisë. Prandaj, në Konventë është parashikuar mundësia e cenimit me ligj të fshehtësisë së korrespondencës në interes të sigurimit kombëtar, sigurimit publik ose mirëqenies ekonomike të vendit etj.

Një kërcënim i veçantë për të drejtën e respektimit të korrespondencës buron nga ekzistenca e mjeteve sekrete për kontrollimin e saj. Në çështjen “**Klass dhe të tjerë kundër Gjermanisë**”,³⁹⁷ gjykata vendosi: “me vetë ekzistencën e dispozitave është i lidhur kërcënimi për personat që mund të kontrollohen mbi këtë bazë. Kjo gjendje ndikon në mënyrë të pashmangshme negativisht në lirshmërinë e komunikimit të përdoruesve të shërbimeve postare dhe të telekomunikacionit, duke qenë, në këtë

³⁹⁵ Udhëzuesi për zbatimin e nenit 8 të KEDNJ-së me autor Ursula Kilkelly, Këshilli i Evropës.

³⁹⁶ Vendim i GJEDNJ-së Domenichini kundër Italisë.

³⁹⁷ Vendim i GJEDNJ-së Klass dhe të tjerë vs Gjermanisë.

mënyrë, ndërhyrje e autoriteteve publike në ushtrimin e së drejtës së respektimit të jetës private dhe familjare apo të korrespondencës³⁹⁸.

Fuqia e mbikëqyrjes sekrete të qytetarëve, që karakterizon një shtet policor tolerohen nga konventa vetëm në rast nevojë për të mbrojtur institucionet demokratike³⁹⁹.

Në përputhje me këtë përcaktim të konventës, shtetet e Evropës kanë zbatuar sisteme të ndryshme për mbrojtje ligjore të së drejtës së korrespondencës. Gjermania dhe Mbretëria e Bashkuar kanë nxjerrë ligje të veçanta për përgjimet e komunikimeve, kurse Franca, Italia dhe vende të tjera, ku përfshihet dhe Shqipëria, kanë dispozita të shpërndara në kode, ligje dhe akte nënligjore. E rëndësishme është që rregullimi ligjor i këtij problemi që përfaqëson një ndërhyrje serioze në jetën private, të jetë i qartë dhe i përcaktuar mirë, sidomos lidhur me qëllimin dhe mënyrën e ushtrimit të së drejtës që u është njohur organeve kompetente, që çdo njeri të jetë në gjendje të parashikojë pasojat dhe të përshtasë sjelljen e tij me ligjet në fuqi. Duhet të sigurohet ruajtja e balancës midis interesit të shtetit dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut për t'i dhënë individit mbrojtjen e përshtatshme kundrejt ndërhyrjeve arbitrare.

Kodi i Procedurës Penale, për lejinin e mjetit procedural të përgjimeve në procedimin penal, ka përcaktuar kushtet themelore *sine qua non* të nevojshme për t'u respektuar, të cilët janë: përcaktimi i qartë i kufirit të dënimit penal të veprës penale për të cilën procedohet; pra, nëse kemi të bëjmë me një vepër penale, e cila është e parashikuar shprehimisht në kufirin e lejit të këtij lloji mjeti të kërkimit të provës nga ligji, subjekti i legjitimuar për të kërkuar disponimin e përgjimeve, subjekti që disponon përgjimet, subjekti pasiv i interesuar, akti i motivuar që disponon mbi përgjimet, përcaktimi i llojit të përgjimeve dhe i objektit të tyre, parashtrimi i arsyeve të domosdoshmërisë së përgjimit për vazhdimin e hetimeve dhe prania e provave të mjaftueshme për vërtetimin e akuzës, procedura e përgjimit, kohëzgjatja, ekzekutimi i tyre, dokumentimi përkatës i veprimeve interceptive, si dhe, eventualisht, ankimi dhe e drejta e palëve për t'u konsultuar me rezultatet e përgjimeve.

Kufijtë e lejit të përgjimit janë përcaktuar nga neni 221 i K. Pr. Penale. Në këtë dispozitë parashikohen llojet e përgjimit, rastet e parashikuara nga ligji për të cilat lejohet aplikimi i këtij mjeti kërkimi prove, e kushtëzuar kjo nga subjekti që përgjohet dhe nga lloji i veprës penale për të cilën procedohet. Kuptohet se përgjimi i komunikimeve në përmbajtje të tij ka cenimin e të drejtave e lirive themelore të individit, të drejta këto të garantuara nga Kushtetuta, KEDNJ-ja dhe aktet e tjera ndërkombëtare, të cilat janë bërë pjesë e të drejtës së brendshme⁴⁰⁰.

Këto të drejta jo vetëm mbrohen me ligj, por çdo ndërhyrje e paligjshme apo arbitrare, konsiderohet si vepër penale në dispozita të veçanta të ligjit penal material. Përgjimet

³⁹⁸ Rreth KEDNJ-së, komentar i shkurtër mbi KEDNJ-në me autor Marek Antoni Nowicki, fq. 271.

³⁹⁹ Të drejtat e njeriut në Evropë (jurisprudencë dhe komente) me autor Ledi Bianku, çështja Klass dhe të tjerë vs Gjermanisë, fq. 156.

⁴⁰⁰ Në nenin 36 të Kushtetutës parashikohet se: "Liria dhe fshehtësia e korrespondencës ose e çdo mjeti tjetër të komunikimit janë të garantuara". Në nenin 88/1 të KEDNJ-së parashikohet se: "Çdokush ka të drejtën e respektimit të jetës së tij private dhe familjare, banesës dhe korrespondencës", ndërsa në nenin 17/1 të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike parashikohet se: "Askush nuk mund të jetë objekt i ndërhyrjeve arbitrare ose të paligjshme në jetën e tij private, në familjen, banesën ose letërkëmbimin, as duhet të cenohet në mënyrë të paligjshme në nderin dhe reputacionin e tij.

telefonike kanë qenë shumë herë objekt i jurisprudencës së Gjykatës së Strasburgut. Ato dhe çdo formë tjetër përgjimi karakterizohen nga ndërhyrje e madhe në të drejtën për respektimin e jetës private dhe të korrespondencës, e për këtë shkak, atyre i është kushtuar vëmendje e veçantë nga kjo gjykatë⁴⁰¹.

GJEDNJ-ja në vendimin e saj Malone kundër Anglisë, ndër të tjera ka arsyetuar se “ligji duhet të tregojë në mënyrë të mjaftueshme rrethanat dhe kushtet konkrete në të cilat autoritetet kanë kompetencë të urdhërojnë përgjimin dhe mbikëqyrjen sekrete, duke përcaktuar mjaft qartë shtrirjen dhe modalitetet e kësaj kompetence, duke patur parasysh qëllimin e ligjshëm që do të arrihet, për t’i dhënë individit mbrojtjen e përshtatshme kundër arbitraritetit”. Në këtë kuadër, ligjvënësi në nenin 221 të K. Pr. Penale ka parashikuar kufijtë e lejimit të përgjimit, kushte dhe kritere të veçanta procedurale për aplikimin e këtij mjeti të kërkimit të provës, duke vënë edhe kufizimet e nevojshme dhe duke përcaktuar rastet kur lejohet e vendoset përgjimi i bisedave e çdo komunikimi tjetër.

Neni 221/1 i K. Pr. Penale lejon përgjimin e komunikimeve dhe të bisedave në vende private. Në vështrim të terminologjisë juridike, togfjalëshi “vend privat”, përdorur në nenin 221/1 të KPP-së ka kuptim të barazvlefshëm me termin “banesë”, përdorur në Kushtetutë (neni 37) dhe në Kodin Penal (nenet 122 dhe 254), që nuk përdoret vetëm thjesht në kuptimin semantik, gjuhësor të saj - ndërtesë ku banojnë njerëzit, shtëpi banimi⁴⁰², por ka një kuptim shumë më të gjerë. Krahasuar me termat “home” në anglisht dhe “domicile” në frëngjisht, fjala “banesë” që përdoret në terminologjinë juridike të Shqipërisë ka kuptimin e “vendbanimit” dhe e përaftron me të barazvlefshmen “domicile” në frëngjisht, ku përfshihen vendet e ushtrimit të veprimtarisë profesionale apo personat juridikë, si: shoqëritë tregtare, organizatat joqeveritare, institucionet fetare etj. (subjekte më vete)⁴⁰³. Pra me “vend privat” dhe “banesë” që përdoren në vështrimin juridik duhet kuptuar vendbanimi: a) që përdoret, qoftë në mënyrë të përhershme, qoftë dhe përkohësisht apo kalimthi për zhvillimin e jetës private, përfshirë, p.sh., edhe një studio, vend për tregti apo për ushtrim profesional, ai për kalimin e kohës së lirë etj.,⁴⁰⁴ dhe b) që përdoruesi ka të drejtën e përjashtimit të të tjerëve.

Kështu, togfjalëshi “vend privat”, në kuptimin juridik, nuk mund të shtrihet deri atje sa të kuptohet, p.sh., si vend privat (banesë) edhe vendndodhja e një autoveture që nuk është strukturuar si vend për banim njerëzish. Duke mos qenë e pajisur me konfortet

⁴⁰¹ Këtu mund të përmendim vendimin e GJEDNJ-së, datë 06.09.1978, Klass kundër Gjermanisë, datë 02.08.1984 Malone kundër Anglisë, datë 25.03.1998 Kopp kundër Zvicrës.

⁴⁰² Fjalori i Gjuhës së Sotme Shqipe, fq. 94, Tiranë 1980.

⁴⁰³ Çështja Colas Est dhe të tjerë kundër Francës dhe Niemetz kundër Gjermanisë, L. Bianku, jurisprudencë e Gjykatës së Strasburgut, fq.475-477, Tiranë 2005.

⁴⁰⁴ Jurisprudenca e Gjykatës së Strasburgut në çështjen Colast Est dhe të tjerë kundër Francës e shtrinë zbatimin e termit “vendbanim” deri në përfshirjen e ambienteve të aktiviteteve tregtare si një rrjedhojë logjike, por nuk ofron asnjë shpjegim në lidhje me këtë shtrirje interpretuese dhe e lë në gjykim të vetë Gjykatës së BE-së në Luksenburg dhe të gjykatave të brendshme, ku këto zbatohen drejtpërdrejt të drejtën komunitare në këtë fushë. Jurisprudenca italiane, p.sh., në interpretimin e kësaj të drejte, një supermarket me produkte mishi, ku hyjnë e dalin lirisht dhjetëra njerëz për sa kohë ai është i hapur, në shërbim publik nuk mund të trajtohet si vendbanim, por, kur pronari e mbyll atë dhe vepron për hesap të vet, pa praninë e të tjerëve, të jashtëm, supermarket konsiderohet si vend privat, paprekshmëria e të cilit mbrohet me Kushtetutë (vendim i Gjykatës së Kasacionit, nr. 5032, dt. 11.03.1992).

minimale të nevojshme për plotësim të kërkesave të jetës private, si dhe duke mos u lidhur me një raport funksional të pajisjeve ose të shërbimeve të një shtëpie banimi apo veprimtarie profesionale, aq më pak kjo vendndodhje në kuptimin gjuhësor.

Siç edhe u përmend më sipër (kushti a), me vend privat duhen kuptuar, përveç banesës në kuptimin e mirëfilltë të përdorimit të përditshëm (shtëpi), edhe ato vende ku zgjidhen mirëfilli dhe konkretisht, funksione të mbrojtjes së jetës private dhe plotësohen kërkesa të tjera jetësore (ushqimi, çlodhja, administrimi, ushtrimi profesional, argëtimi etj.) të atyre që posedojnë vendin privat, të cilët kanë edhe të drejtën e përjashtimit të të tjerëve (kushti b). Kështu, p.sh., një lokal privat tregtimi apo shërbimi, ku poseduesi ka të drejtën të përjashtojë personat e padëshiruar prej tij, nuk mund të quhet vend privat (banesë), sepse *ius excludenti alios*,⁴⁰⁵ që prezupozohet në neniN 254 të Kodit Penal, nuk është një gjë në vetvete, as një kusht i vetëm që e shteron plotësisht kërkesën e nenit 37 të Kushtetutës, që garanton paprekshmërinë e banesës dhe të jetës private të personit.

Në interpretim të kërkesave të nenit 221/1 të Kodit të Pr. Penale, që lejon përgjimin e komunikimeve e të bisedave midis të pranishmëve në vende private, ka rëndësi të marrin përgjigje dy pyetje:

- Kur lejohet përgjimi?
- Ku (për ç`vend) lejohet përgjimi?

Pyetja e parë merr përgjigje në nenin 221/1, ku përcaktohen kufijtë e lejimit të përgjimit dhe në nenin 222/1 të Kodit të P. Penale, me formulimin: "... është i domosdoshëm (përgjimi) për vazhdimin e hetimeve të filluara dhe kur ka prova të mjaftueshme për vërtetimin e akuzës"⁴⁰⁶. Ndërsa, pyetja e dytë merr përgjigje në nenin 254 të Kodit Penal, që shprehet për paprekshmërinë e banesës. Realizimi i përgjimit, i bisedave midis të pranishmëve në një banesë, pavarësisht mbrojtjes kushtetuese që kjo gëzon (neni 37 i Kushtetutës), lejohet, sepse interesi i mosdhunimit të banesës merr një rëndësi të dorës së dytë ndaj interesit të përgjithshëm publik, i cili edhe ky garantohet kushtetueshmërisht me kërkesat e dallueshme të nenit 17 të Kushtetutës, sipas të cilit kufizimet e të drejtave dhe lirive të njeriut mund të vendosen vetëm me ligj, për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve.

Në kuptim të lejueshmërisë dhe të përdorimit të përgjimeve, ndërmjet të pranishmëve (neni 221/1 i Kodit të P. Penale), qelia e një burgu nuk mund të konsiderohet banesë private⁴⁰⁷, sepse, si e tillë, kuptohet ajo ku ushtrohen aktivitete që çdokush ka të drejtë t'i zhvillojë lirisht dhe ligjërisht pa u shqetësuar nga të jashtëm. Pra, si banesë private

⁴⁰⁵ Latinisht, "E drejta e përjashtimit të të tjerëve".

⁴⁰⁶ Me shprehjen "prova të mjaftueshme për vërtetimin e akuzës", neni 221/1 i KPP-së, duhet të nënkuptohet shprehja "dyshime të arsyeshme mbështetur në prova", përdorur në tekst, sepse prova, në kuptimin juridik, merr rëndësinë dhe vlerën e provës vetëm kur është bërë pjesë e shqyrtimit gjyqësor dhe administrator nga gjykata, pra vërtetohet si e tillë.

⁴⁰⁷ Kështu mendon një grup autorësh. Por ka autorë që qelinë e burgut e konsiderojnë banesë private të një lloji të veçantë. Këta të fundit, edhe pse nuk ekzistojnë kushte bazë-posedimi dhe drejta e përjashtimit- duke u mbështetur në disa manifestime të tejskajshëm intime që i duhen siguruar e mbrojtur një të burgosuri apo paraburgosuri, i konsiderojnë ato të një karakteri aq të domosdoshëm sa ta quajnë edhe qelinë vendbanim, i cili nuk mund të cenohet pa dijeninë e të burgosurit dhe që në këtë mënyrë i burgosuri të kufizohet në të drejtat kushtetuese të jetës private dhe mosdhunimit të banesës (qelisë) edhe pse këtë nuk e zgjedh me dëshirën e tij. Sidoqoftë, edhe pse është vepruar sipas mendimit të grupit të parë të autorëve, nuk mund të thuhet se diskutimi ka mbaruar.

duhet të trajtohen ato vende ku zhvillohen, aktualisht dhe konkretisht, funksionet që mbrojnë jetën private të atyre që i posedojnë, të cilët janë titullar dhe gëzojnë *ius excludenti alios*, në funksion të mbrojtjes dhe të sigurimit të së drejtës për zhvillime dhe manifestime të jetës private nga persona që neni 37 i Kushtetutës i garanton duke shpallur paprekshmërinë e banesës.

Kështu, qelia nuk mund të quhet banesë private, sepse nuk posedohet nga të dëmtuarit. Këta nuk kanë asnjë të drejtë të *ius excludenti alios*, përkundrazi, poseduese dhe disponuese është administrata e burgut, e cila mund të disponojë qelinë në çdo orë të ditës apo të natës, dhe, për çfarëdolloj nevoje apo edhe për ta zhvendosur të dënuarin në një qeli tjetër. Gjithashtu, kuptohet se edhe salla e bisedimeve (takime me familjarë) të një burgu nuk mund të quhet vend privat, por përfshihet brenda kuptimit të vendit publik, i cili është nën kontrollin direkt dhe të njëkohshme të autoritetit të burgut, që ushtron mbikëqyrjen që i takon vetëm atij, *ius excludenti*, ndërsa të burgosurit i mbetet vetëm e drejta për të pritur vizita të caktuara dhe të autorizuar nga administrata e burgut, në përputhje me rregulloren e mbështetur në ligj. Kjo do të thotë se përgjimi, në këtë rast, nuk mund të kryhet me vendim të prokurorit, ndërsa, për sa i përket përgjimit të bisedave mund të përdoren, kur autorizohen dhe kryhen duke zbatuar rregullat e sigurisë dhe mënyrat e parashikuara në ligj. Sepse bisedat që i dënuari bën me familjarët e vet apo personat e tjerë që shkojnë e vizitojnë, kryhen nën “kontrollin pamor dhe jo dëgjues të rojes përkatëse”⁴⁰⁸.

Prandaj, edhe përgjimi në funksion të hetimeve, i bisedave apo përdorimi i rezultateve të tyre lejohen vetëm kur autorizohen nga gjyqtari në pajtim me ligjin⁴⁰⁹, si përgjime ambientale (neni 221/1 dhe 222/1 të Kodit të P. Penale). Pra, në rast se paraqitet ankesë ndaj vendimit të mësipërm të përgjimit ambiental të prokurorit nga i burgosuri për cenim të së drejtës për fshehtësi të komunikimeve nuk duhet pranuar me arsyetimin se nuk mbështetet në ligj dhe se përgjimi në këtë rast bazohet në nenin 221/2 të Kodit të Procedurës Penale mbi përgjimet ambientale.

Në paragrafin e parë të kësaj dispozite janë përcaktuar rastet dhe kufijtë e lejimit të përgjimit dhe çdo komunikimi tjetër në vende private dhe konkretisht:

- Për krime të kryera me dashje, për të cilat ligji penal parashikon dënim me burgim jo më pak se 7 vjet (Përpara ndryshimeve të bëra me ligjin Nr. 9187, datë 12.02.04, marzhi i dënimit ishte 5 vjet burgim.).
- Për kundravajtjet penale të fyerjes e kanosjes të kryera me mjete të telekomunikacionit.

Ligjvënësi ka parashikuar që, për të disponuar me këtë mjet kërkimi prove, duhet detyrimisht që të disponohen prova të tjera për vërtetimin e akuzës dhe përgjimi të jetë i domosdoshëm për vazhdimin e mëtejshëm të hetimeve, pavarësisht se jemi para kufijve që lejojnë kryerjen e përgjimit. Kjo nënkupton atë që jo nëpërmjet përgjimit të shkohet tek provat⁴¹⁰.

⁴⁰⁸ Ligji Nr. 832, datë 16.04.1998 “Për të drejtat e të dënuarëve me burgim” neni 41.

⁴⁰⁹ Ligji nr. 832, datë 16.04.1998. “Për të drejtat e të burgosurve me burgim”, neni 55.

⁴¹⁰ Nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në vendimin nr. 24, datë 14.07.2010, është konstatuar se autorizimi i prokurorit për kryerjen e përgjimit është dhënë në kundërshtim me kërkesat e nenit 221/1 të Kodit të Procedurës

PROVAT DHE PROCESI I TË PROVUARIT NË PROCESIN PENAL

Mungesa e provave dhe të dhënave ndaj një personi, të ndalon ta përdorësh përgjimin si mjet kërkimi prove ndaj tij. Ky përcaktim i dispozitës së mësipërme bie në kundërshtim me kufijtë e përgjimit parashikuar nga neni 221/3 i K. Pr. Penale. Në këtë rast vlerësojmë se garancitë e vendosura nga ligjvënësi për aplikimin e këtij mjete të kërkimit të provës është mjaft i lartë dhe në mjaft raste bëhet pengesë për organet proceduese në realizimin e misionit të luftës kundër kriminalitetit dhe sidomos atij të organizuar.

Do të vlerësoja si më të përshtatshëm që ky përkufizim të ndryshohej, duke u riformuluar, dhe konkretisht "...kur ai është i domosdoshëm për vazhdimin e hetimeve dhe kur ka dyshime të arsyeshme, të bazuara në prova se është autor i veprës penale". Në këtë rast, për kryerjen e përgjimit do të vendosej me të drejtë i njëjti standard me atë të caktimit të masës së sigurimit, sipas parashikimit të bërë në nenin 228/1 të K. Pr. Penale. Duhet të nënvizojmë këtu faktin se, edhe qëndrimet e praktikës gjyqësore, si dhe të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, në këtë drejtim, kanë qenë të ndryshme, mjafton të përmendim vendimet Nr. 33, datë 13.10.2010 dhe Nr. 129, datë 12.10.2011. Ky përcaktim i ligjvënësit në nenin 222/1 të K. Pr. Penale ka patur si qëllim mënjanimin e abuzimit nga ana e organeve të ndjekjes penale gjatë hetimeve paraprake në mbrojtje të të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve, të saksionuara në Kushtetutë dhe KEDNJ⁴¹¹. Në kundërshtim me kërkesat e nenit 222/1 të K. Pr. Penale, ku kërkohet ekzistenca e provave të mjaftueshme për vërtetimin e akuzës për lejimin e përgjimit, gjykatat kanë konsideruar si prova të mjaftueshme për vërtetimin e akuzës, rezultatet e përgjimit parandalues, të cilat, sipas nenit 221/5 të K. Pr. Penale nuk mund të përdoren si provë⁴¹².

Duhet thënë se vlerësim të ndryshëm ka bërë Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë në vendimin Nr. 129, datë 12.10.2011, ku, ndër të tjera, ka vlerësuar se "pretendimi i të gjykuarit se informacioni i ardhur nga SHISH-i në asnjë rast nuk mund të shërbejë si provë për të filluar procedimin, për më tepër për të vendosur lejimin e përgjimit procedural, jo vetëm që është inkoherent me objektin e gjykimit, por gjendet haptazi i paligjshëm... pasi informacioni i SHISH-it nuk mund të shërbente dhe nuk ka shërbyer si provë fajësie për të gjykuarin". Kur nga organet e ndjekjes penale, disponohen prova që vërtetojnë se një person është autor i dyshuar për kryerjen e veprës penale, vetëm atëherë ato mund të kërkojnë të përdorin përgjimin si mjet për kërkimin e provave të tjera. "Sipas nenit 221/1 pikat 'a,b' të K. Pr. Penale, me të drejtë, është vendosur lejimi i përgjimit për të gjykuarin, mbasi organi i akuzës ishte duke proceduar për një krim jo më pak se 5 vjet burgim. Gjithashtu, në përputhje me kërkesat e nenit 222/2 të K. Pr. Penale, për të parandaluar dëmtimin e hetimeve, vendimi i marrë nga prokurori për

Penale, pasi nuk ka patur prova të mjaftueshme për vërtetimin e akuzës, ai është bazuar në informacionet policore të padokumentuara në cilësinë e provës penale sipas kuptimit që i jep neni 149 i Kodit të Procedurës Penale.

⁴¹¹ Neni 17 i Kushtetutës dhe neni 8 i KEDNJ-së.

⁴¹² Mbi kërkesat e nenit 222/1 të K. Pr. Pn., ekzistencën e provave për vërtetimin e akuzës, për të kërkuar dhe marrë miratimin nga gjykata për përgjimin e bisedave telefonike, arsyetuar në vendimin nr.33, datë 13.10.2010, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

lejimin e përgjimit, i është njoftuar dhe kërkuar gjykatës brenda afatit ligjor, e cila, nga ana e saj, ka vendosur që ta vlerësojë atë të ligjshëm”⁴¹³.

Në nenin 222⁴¹⁴, paragrafi i parë përcaktohet se përgjimet, si mjet për kërkimin e provës duhen përdorur vetëm atëherë ... *kur ai është i domosdoshëm për vazhdimin e hetimeve të filluara dhe kur ka prova të mjaftueshme për vërtetimin e akuzës*. Në respektim të urdhërimit ligjor të parashikuar në nenin 222/1, duhet që organi i akuzës të ketë grumbulluar prova të tjera, të cilat jo vetëm njoftojnë rrethana të faktit juridik penal, por i krijojnë dhe bindjen se personi që do të përgjohet është autor i mundshëm i veprës penale. Në interpretim të dispozitës së sipërcituar, mungesa e provave dhe të dhënave ndaj një personi, ndalon organin e akuzës të përdorë përgjimin si mjet kërkimi prove ndaj tij.

Duhet të nënvizojmë këtu faktin se qëndrimet e studiuesve të së Drejtës Procedurale Penale dhe praktikës gjyqësore në këtë drejtim kanë qenë të ndryshme, pasi ka nga ata që mendojnë se parashikimi aktual i dispozitës cenon dhe pengon hetimet e procedimit penal. Në analizë sistematike të dispozitave procedurale penale mbi “përgjimet”, ne vlerësojmë se respektimi i kushteve dhe kriterëve kumulative të përcaktuara në nenin 221 dhe 222, është i rëndësishëm, për të justifikuar ndërhyrjen dhe kufizimin shtetëror në sferën e të drejtës për jetë private të individit, për shkak të ekzistencës së një interesi më madhor, të materializuar në nevojën e mbrojtjes së rendit dhe sigurisë publike.

Në respektim të nenit 42 të Kushtetutës, nenit 6 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut, neneve: 1, 2, 3, 4, 11, 221, 222 të K. Procedurës Penale, gjatë gjykimit të kërkesës për lejimin e përgjimeve, gjykata është e detyruar të bëjë një vlerësim të provave të paraqitura nga prokurori ose nga i dëmtuari akuzues. Në këtë mënyrë, gjykata jo vetëm respekton parimet për një proces të rregullt ligjor, por krijon dhe bindjen se ato janë të mjaftueshme në kuptimin që tregojnë se procedimi penal i iniciuar është i mbështetur në prova, të cilat kanë nevojë të plotësohen me rezultatet e përgjimit.

Kur gjykata, pas një hetimi të plotë të provave të paraqitura nga organi i akuzës bindet se ekzistojnë kushtet dhe kriteret e lartpërmendura, vendos pranimin e kërkesës për lejimin e përgjimit. Vendimi i Gjykatës për lejimin e përgjimeve duhet të tregojë mënyrën dhe kohëzgjatjen e saktë të përgjimit, e cila nuk mund të kalojë afatin pesëmbëdhjetë. Pavarësisht këtij përcaktimi, legjislatori, në nenin 222, pika 3, ka parashikuar se ky afat, me kërkesë të prokurorit mund të zgjatet nga gjykata sa herë është e nevojshme, për një periudhë prej njëzet ditësh kur procedohet për krime dhe dyzëtditësh.

Krahas gjykatës, legjislatori, në nenin 222 të K. Procedurës Penale ka parashikuar dhe të drejtën e organit të akuzës për të vendosur përgjimin e bisedave, kur ka arsye të bazuara për të menduar se vonesa mund të shkaktojë një dëm hetimeve. Ky veprim

⁴¹³ Mbi respektimin e kërkesave të nenit 222/1 të K.Pr.Pn., në rastet e kryerjes së përgjimit me vendim të prokurorit dhe vlerësimi i tij nga ana e gjykatës, arsyetim në vendimin nr. 536, datë 13.07.2005, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

⁴¹⁴ Kodi i Procedurës Penale, neni 222.

PROVAT DHE PROCESI I TË PROVUARIT NË PROCESIN PENAL

realizohet me urdhër të motivuar, në të cilin parashtrohen arsyet e përgjimit dhe rrethanat që tregojnë urgjencën, e cila e bën të pamundur ndjekjen e procedurave klasike, atë të vendimit gjyqësor. Në mbështetje të nenit 222 pika 2, paragrafi dy, prokurori njofton gjykatën menjëherë, por jo më vonë se njëzet e katër orë dhe kërkon vlefhtësimin e aktit.

Gjykata, në referim të parashikimeve të kësaj dispozite, detyrohet të shqyrtojë kërkesën brenda dyzet e tetë orëve dhe të marrë vendim të arsyetuar për pranimin ose jo të kërkesës. Kur vlefhtësimi nuk bëhet brenda këtij afati, përgjimi nuk mund të vazhdojë dhe rezultatet nuk mund të përdoren.

Nisur dhe nga problematikat e hasura në praktikë, vlerësojmë se me rëndësi është dhe analizimi i pikës 5 të nenit 221 të Kodit të Procedurës Penale dhe evidentimi i dallimeve që ekzistojnë me përgjimin procedural penal. Në këtë dispozitë parashikohet se: *Përgjimi parandalues rregullohet me ligj të veçantë. Rezultatet e tij nuk mund të përdoren si provë.*

Referuar përcaktimeve të kësaj dispozite të Kodit të Procedurës Penale, përgjimi parandalues rregullohet në bazë të ligjit Nr.9157⁴¹⁵, datë 04.12.2003, "**Për përgjimin e komunikimeve elektronike**", të ndryshuar. Në analizë sistematike të dispozitave të këtij akti normativ, arrijmë në përfundimin se me këtë lloj përgjimi kuptohet ndërhyrja e fshehtë për të kapur, dëgjuar e regjistruar përmbajtjen e komunikimit dhe të dhëna që lidhen me të në mënyrë që të parandalohet kryerja e një veprë penale. Qëllimi kryesor, pra, është parandalimi i kryerjes së veprave penale, nëpërmjet marrjes së informacioneve për parandalimin e saj dhe kryhen jashtë kontekstit të ekzistencës të një procedimi penal. Miratimi i kërkesës për përgjim parandalues bëhet nga Prokurori i Përgjithshëm dhe nuk paraqet lidhje me aktet e procedimit penal të filluar.

Ndërsa përgjimet procedurale realizohen sipas kushteve dhe mënyrë së parashikuar nga dispozitat e Kodit të Procedurës Penale, dhe rezultatet e tyre janë të afta për t'u përdorur në procesin penal.

Rezultatet e përfuara gjatë veprimtarisë përgjuese janë të vlefshme për të gjithë komunikuesit (neni 221/1 i K.Pr.P.). Kjo do të thotë që rezultatet e përgjimit kanë vlerë për përdorim në funksion të vërtetimit të akuzës, jo vetëm për personin ndaj të cilit është urdhëruar përgjimi, por edhe ndaj personave me të cilët ai komunikon.

Karakteri parandalues

Përgjimi parandalues rregullohet me ligj të veçantë⁴¹⁶. Rezultatet e tij nuk mund të përdoren si provë (neni 221/5 I K. Pr.P.). Me anë të përgjimit parandalues synohet të rritet efektiviteti i punës së institucioneve informative shtetërore, për zbulimin e veprimtarisë antikushetuese, kriminale dhe keqbërëse, si dhe të parandalojë pasojat që mund të vijnë nga kjo veprimtari⁴¹⁷. Por rezultatet e përgjimit të marra në bazë të ligjit "Për përgjimin e telekomunikimeve" nr. 9157, datë 04.12.2003, nuk kanë vlerën e

⁴¹⁵ Ligji nr. 9157 date 04.12.2003

⁴¹⁶ Ligji "Për përgjimin e telekomunikimeve" nr.9157, datë 4.12.2003

⁴¹⁷ Neni 2 I ligjit "Për përgjimin e telekomunikimeve" nr.9157, datë 4.12.2003

PROVAT DHE PROCESI I TË PROVUARIT NË PROCESIN PENAL

provës në një proces penal, me përjashtim të rasteve kur merren sipas Kodit të Procedurës Penale.

Në këtë ligj përcaktohen kritere në favor të autoritetit të shtetit, në pajtim me nenet 8/2 të KEDNJ-së si nevojë e pranisë si një bazë ligjore konkrete të përshtatshmërisë dhe propocialitetit me masat që merren, për mënyrat e përgjimit dhe të mbikëqyrjes, për procedurën e autorizimit, për zgjedhjet efektive dhe që lidhen, ndër të tjera, me ruajtjen e fshehtësisë së korrespondencës⁴¹⁸.

Në radhën e përgjimeve parandaluese mund të futen edhe veprimtaria e Shërbimit Informativ Shtetëror, ajo e Shërbimit Informativ të Ministrisë së Brendshme, mbrojtjes, si dhe veprimtaria e çdo shërbimi tjetër informativ, informativ/polikor krijuar me ligj⁴¹⁹, që kanë të drejtë të kërkojnë përgjimin për të siguruar të dhëna të domosdoshme për realizimin e detyrave të tyre ligjore. Në lidhje me përgjimin parandalues ka rëndësi të mbahet parasysh se rezultatet që përftohen nga ky lloj përgjimi nuk mund të shërbejnë si burim prove në qoftë se nuk janë marrë në respektim të dispozitave që parashikohen në seksionin IV të përgjimeve të K. Pr. P. (nenet 221-225).

Neni 223 i Kodit të Procedurës Penale, parashikon se veprimet e përgjimit, mund të kryhen me anë të pajisjeve të instaluar në vende të caktuara, të autorizuar dhe të kontrolluara nga prokurori i rrethit. Rezultatet e përgjuara regjistrohen dhe transkriptohen dhe për veprimet e kryera mbahet procesverbal.

Në nenin 222/a të Kodit të Procedurës Penale, është parashikuar dhe ankimi ndaj vendimit që lejon përgjimin. Ankimi, referuar nenit 223/a, pika 2, shqyrtohet nga Gjykata e Apelit ose nga Prokurori i Përgjithshëm kur autorizimi është dhënë nga prokurori. Kur ankimi gjendet i drejtë, gjykata duhet të anulojë aktin që autorizon përgjimin dhe të urdhërojë fshirjen e çdo materiali të marrë nga përgjimi. Në të kundërt, njoftohet kërkuesi se ankimi i tij nuk është i bazuar në ligj.

Në fund, vlen të përmendim se përgjimet e realizuara në kundërshtim me kriteret e mësipërme ligjore, që *de facto* konstituojnë dhe shkelin të drejtën kushtetuese për jetë private, konsiderohen të kundraligjshme dhe rezultat e tyre nuk mund të përdoren në një proces penal përkundërt personit që i drejtohen.

⁴¹⁸ Këto parime të përgjimit gjenden të pasqyruara në nenin 4 të ligjit "Për përgjimin e telekomunikimeve" nr.9157, datë 4.12.2003

⁴¹⁹ Shërbimi Informativ Shtetëror është krijuar me ligjin Nr. 8391, datë 28.10.1998. Qëllimi i veprimtarisë së këtij organi është të sigurojë informacionin e domosdoshëm nga zbulimi dhe kundërzbulimi për problemet që lidhen me sigurimin kombëtar. SHISH-i ushtron veprimtarinë e vet duke përdorur mënyra dhe mjete të ligjshme (neni 2). Një ndër to është përgjimi. Shërbimi Informativ Usharak është krijuar me ligjin nr. 9074, datë 29.06.2003. Qëllimi i këtij ligji është të grumbullojë, analizojë dhe administrojë të dhëna për veprimtaritë që cenojnë sigurinë kombëtare, kërcënime të mundshme ose rreziqe ndaj Forcave të Armatosura që vijnë nga jashtë ose shfaqen brenda vendit, për t'i paraqitur tek autoritetet e drejtimit dhe të komandimit strategjik të Forcave të Armatosura për t'i mbështetur gjatë ushtrimit të përgjegjësive të tyre (neni 2). Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm në Ministrinë e Rendit Publik (tani Ministria e Brendshme) e krijuar me ligjin nr.8749, datë 01.03.2001. Objekt i veprimtarisë së këtij organi është parandalimi, zbulimi dhe dokumentimi i veprimtarisë kriminale që kryhet nga punonjësit e Policisë së Shtetit dhe të strukturave të tjera të kësaj ministrie.

Policia kriminale është krijuar me ligjin nr. 8293, datë 26.02.1998, dhe ka si qëllim që, me anë të veprimtarisë së vet të realizojë në mënyrë të hapur ose të fshehtë mbrojtjen e jetës, shëndetit dhe pasurisë, të drejtat dhe liritë e njeriut, sigurinë sociale e shtetërore nga veprimtaria kriminale në të gjithë territorin e Shqipërisë. Konkretisht, ajo ka për detyrë:

- zbulimin, parandalimin dhe ndërprerjen e veprimtarisë kriminale, evidentimin dhe kapjen e personave që kanë kryer, kryejnë apo përgatiten të kryejnë krime me dashje;
- gjurmimin policor për krimet e kryera me dashje;
- kërkimin e personave që u fshihen hetimeve.

Ky konkluzion sanksionohet në nenin 226 të Kodit të Procedurës Penale, i cili parashikon: *Rezultatet e përgjimit nuk mund të përdoren kur janë bërë jashtë rasteve të lejuara nga ligji dhe kur nuk janë respektuar dispozitat e këtij seksioni.*

Nga analizimi literal i kësaj dispozite, në mënyrë që të respektohen parimet e sipërpërmendura, legjislatori ka parashikuar se papërdorshmëria aktivizohet në këtë rast jo vetëm si shkak i shkeljes së ndalimeve ligjore (pra, kur janë bërë jashtë rasteve të lejuara nga ligji), por dhe si shkak i mosrespektimit të disa kriterëve formale në administrimin e përgjimeve (kur nuk janë respektuar dispozitat e Seksionit IV).

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, lidhur me papërdorshmërinë e rezultateve të përgjimit, në vendimin Nr. 33⁴²⁰, dt 13.10.2010, ndër të tjera është shprehur se:

Rezultoi nga shqyrtimi gjyqësor se transkriptet e siguruara nga përgjimi telefonik sipas vendimit nr. 100 Akti, dt 12.09.2009, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, të cilësuar si më lart nga gjykata “të papërdorshme”, janë përdorur si provë për lejimin e përgjimit vijues telefonik sipas vendimit nr. 100./1 Akti, dt. 18.09.2009, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, fakt i provuar nga analiza e përmbajtjes së vendimit gjyqësor dhe tërësia e akteve të paraqitura si provë nga organi i akuzës. Në të njëjtën mënyrë është vepruar dhe në të gjitha vendimet e tjera gjyqësore, ku transkriptet e përgjimeve paraardhëse telefonike, kanë shërbyer si provë për të zgatur përgjimet e lejuara më parë ose për të lejuar përgjimin e të pandehurve të tjerë (R. P.) që rezultoni të kishin komunikime me të pandehurit e vënë më parë në përgjim...

Përgjimi i komunikimeve telefonike të të pandehurve të lejuara me vendimin nr. 100 Akti, dt. 12.09.2009, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është i kundraligjshëm, pra një përgjim i lejuar në kundërshtim me dispozitat procedurale penale (neni 222/1 e K.Pr.P.), pasi është autorizuar gjyqësisht përgjimi i fshehtë i komunikimeve telefonike hyrëse dhe dalëse në kushtet kur nuk ekzistonin prova të mjaftueshme në drejtim të vërtetimit të akuzës. Sa më sipër, në bazë të nenit 226 të K.Pr.P. të gjitha rezultatet e përgjimit, konkretisht transkriptet e bisedave të përgjuara telefonike të të pandehurve të lejuara në vendimin nr. 100, Akti, dt. 12.09.2009, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë cilësohen nga gjykata të përdorshme...

... Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë vlerëson se vendimet e mësipërme të gjykatave duhet të prishen dhe të rrëzohet kërkesa e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë për lejimin e përgjimit të komunikimeve telefonike hyrëse dhe dalëse në numrat telefonikë celularë të shtetasve I. Sulo, J. Gjergjeji dhe B. Murati. Ky Kolegj konstaton se vendimet e gjykatave të të dyja shkallëve të gjyqimit janë marrë në kundërshtim me dispozitat procedurale penale, e konkretisht me nenet 221/5 e 222/1 të Kodit të Procedurës Penale. Kështu, sipas nenit 221/5 të Kodit të Procedurës Penale: “Përgjimi parandalues rregullohet me ligj të veçantë. Rezultatet e tij nuk mund të përdoren si provë”. Në kundërshtim me këtë urdhërim, gjykatat kanë vënë në themel të arsyetimit dhe vendimit të tyre, duke i konsideruar dhe përdorur si prova rezultatet e përgjimeve parandaluese të pasqyruara në informacionin e SHISH-it. Në këtë mënyrë, gjykata ka konsideruar si “prova të mjaftueshme për vërtetimin e akuzës” (siç kërkon

⁴²⁰Vendimi Nr. 33, dt 13.10.2010, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë.

neni 222/1 i K. Pr. Penale), rezultatet e përgjimit parandalues, të cilat, siç theksuam më lart, në bazë të nenit 221/5 të K. Pr. Penale, nuk mund të përdoren si provë. Madje, në vendimet e tyre, të dyja gjykatat i konsiderojnë këto rezultate të përgjimeve parandaluese si “dyshime të forta e të bazuara”, pra as formalisht ato nuk pohojnë se ka prova të mjaftueshme për vërtetimin e akuzës, siç urdhëron neni 222/1/b i K. Pr. Penale, për rastet e lejimit të përgjimit të thirrjeve dhe komunikimeve telefonike. Edhe gjatë gjykimit në Gjykatën e Lartë, organi i akuzës pretendoi se “ekziston dyshimi i bazuar”, kur sipas dispozitës së mësipërme për lejimin e përgjimit duhen “prova të mjaftueshme”.

Në përfundimet e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, e cila ka çmuar se respektimi me rigorozitet i dispozitave të mësipërme të K. Pr. Penale (dhe kritereve që kërkohen në to) është një detyrim ligjor që buron, në radhë të parë, nga raporti që ato krijojnë me nenin 17 të Kushtetutës së Shqipërisë, sipas të cilit: *Kufizimet e të drejtave të njeriut mund të bëhen vetëm me ligj dhe këto kufizime nuk mund të cenojnë thelbin e lirive dhe të të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.*

Neni 8 i Konventës Evropiane i të Drejtave të Njeriut⁴²¹ gjithashtu sanksionon se: *Çdokush ka të drejtën e respektimit të jetës së tij private dhe familjare. Autoriteti publik nuk mund të ndërhyjë në ushtrimin e kësaj të drejte, përveçse në shkallën e parashikuar nga ligji dhe kur është e nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik, shëndetit ose moralit, ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të tjerëve.*

Në rastin konkret, në kundërshtim me ligjin, janë kufizuar të drejtat kushtetuese të shtetasve, siç është ajo e sanksionuar nga neni 36 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Siç arsyetua më lart, personave nën hetim, B. Murati, I. Sulo dhe J. Gjergjefti, u janë kufizuar të drejtat dhe liritë e tyre kushtetuese në kundërshtim me ligjin, pasi lejimi i përgjimit të tyre është bërë në kundërshtim me nenet 221/5 e 222 të Kodit të Procedurës Penale, **duke përdorur si “prova” akte, të cilat janë konsideruar e përdorur si të tilla në kundërshtim me ligjin dhe kërkesat e nenit 149 të K. Pr. Penale.**

Ndryshimet në këtë seksion lidhen me rregullimin e veprimeve të prokurorit në rastet e sekuestrimit të dokumenteve apo akteve me karakter sekret, afatet e kundërshtimit të vendimit të sekuestrimit, si dhe mënyrën e ruajtjes së kampionëve të sendeve të sekuestruara. Konkretisht:

- Në nenin 221⁴²² janë ndryshuar shkronjat a) dhe b) të pikës 1, si dhe pika 2. Risia kryesore e këtij neni është zgjerimi i objektit të zbatimit me qëllim që të lejohet kryerja e përgjimeve për veprat penale të kryera me dashje që dënohen me më pak se shtatë vjet.

⁴²¹ KEDNJ, neni 8.

⁴²² Relacioni për disa shtesa dhe ndryshime në Kodin e Procedurës Penale.

PROVAT DHE PROCESI I TË PROVUARIT NË PROCESIN PENAL

- Në këtë kontekst, germa 'a', paragrafi 1, i këtij neni është ndryshuar për të ulur dënimin për veprat penale nga shtatë vjet, në katër vjet në maksimum, për të cilat lejohet përgjimi.

- Ndryshimi i bërë në këtë nen është në pajtim me konstatimet e raportit të Task-Forcës së KPP-së, i cili shprehet si më poshtë: "Pragu i dënimit prej shtatë vjetësh për lejimin e përgjimeve duhet të ulet në katër vjet". Maksimumi i shtatë vjetëve, siç ishte i parashikuar më parë, ishte tepër i lartë dhe përgjimet nuk mund të lejoheshin në hetimin e krimeve të caktuara të rëndësishme dhe të rënda, si për shembull, korrupsioni. Ulja e dënimit në maksimum jo më pak se katër vjet është në pajtim dhe i referohet kuptimit të krimeve të rënda të parashikuara në Konventën e Palermos kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar dhe dy protokolleve të saj, të ratifikuara nga Shqipëria me ligjin nr. 8920, datë 11.7.2002, i cili parashikon në nenin 2, germa b, të tij: "*Krime të rënda*" janë sjellje që përbëjnë një vepër penale të dënueshme me heqje lirie maksimalisht prej të paktën katër vjet ose një dënim më i rëndë.

- Në Kodin Penal shqiptar janë parashikuar dënime të ndryshme për veprat penale të korrupsionit, të cilat çojnë drejt dy standardeve për të lejuar përgjimet gjatë hetimeve. Në këtë kontekst, për disa vepra penale të korrupsionit, përgjimi lejohet dhe për disa të tjerë jo.

- Konkretisht, përgjimi, së fundmi, lejohet për "*Korrupsionin pasiv të personave që ushtrojnë funksione publike*" të parashikuar në nenin 259, që dënohet me burgim nga dy deri në tetë vjet; "*Korrupsioni pasiv nga zyrtarët e lartë shtetërorë ose zyrtarët vendorë të zgjedhur*" (Neni 260) dënohet me burgim nga dy deri në dymbëdhjetë vjet; "*Korrupsioni pasiv për gjyqtarët, prokurorët dhe punonjësit e tjerë të sistemit të drejtësisë*" (Neni 319/ç) dënohet me burgim nga tre deri në dhjetë vjet.

- Nga ana tjetër, sipas dispozitave të tashme të Kodit Penal, përgjimi nuk lejohet për "*Korrupsionin pasiv të personave që ushtrojnë funksione publike*" (Neni 244), që dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në tre vjet; "*Korrupsioni aktiv në sektorin privat*" (Neni 164/a), që dënohet me burgim nga tre muaj deri në tre vjet; "*Korrupsioni pasiv në sektorin privat*" (Neni 164/b) dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në pesë vjet; "*Korrupsioni aktiv i zyrtarëve të lartë shtetërorë dhe përfaqësuesve vendorë*" (Neni 245) dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet.

- Për më tepër, në Kodin Penal shqiptar janë parashikuar vepra të tjera penale, për të cilat nuk lejohet përgjimi duke patur parasysh dënimin përkatës të dhënë, si: "*Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm mbi nëpunësit publikë*" (Neni 245/1) që dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në katër vjet; "*Fshelja e të ardhurave*" (Neni 180), paragrafi i parë, që dënohet me një gjobë ose deri në tre vjet burgim; "*Falimentim i provokuar*" (Neni 193), që dënohet me gjobë ose deri në tre vjet burgim.

Sa më sipër, me qëllim që të kryhet një hetim i suksesshëm dhe shkelësit të nxirren para gjykatës, përgjimi, si një nga veprimet më të rëndësishme procedurale, duhet të lejohet për veprat penale që dënohen me jo më pak se katër vjet në maksimum.

Ulja e dënimit të veprave penale jo më pak se katër vjet në maksimum është në pajtim dhe parashikohet me ligjet e tjera, si Ligji nr. 10173, datë 22.10.2009, "Mbi mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorët e drejtësisë". Neni 2 i këtij ligji parashikon që

“Dispozitat e këtij ligji janë të zbatueshme për veprat penale të kryera me qëllim për të cilat ligji parashikon një dënim me burgim jo më pak se katër vjet...”.

- Shkronja b) e paragrafit 1 të këtij neni është ndryshuar me qëllim që të lejohet që ky instrument të përdoret në rast se vepra penale është kryer me dashje nëpërmjet mjeteve të telekomunikimit ose përdorimit të informacionit apo teknologji ve kompjuterike.

- Ndërsa përgjimi procedural është i parashikuar në nenet e mësipërme, procedurat, autoritetet dhe shkaqet bazuar, në të cilat zhvillohet përgjimi parandalues në Republikën e Shqipërisë janë parashikuar në Ligjin e veçantë nr. 9157, datë 4.12.2003, “*Mbi përgjimin e telekomunikimit*”.

Në lidhje me përgjimin parandalues, praktika gjyqësore e GJEDNJ-së thekson sa më poshtë, në çështjen Bykov⁴²³, datë 10 mars 2009: 78. *Gjykata ka konsideruar vazhdimisht që, kur bëhet fjalë për përgjimin e komunikimeve për qëllimet e një hetimi policor, ligji duhet të jetë i qartë në masë të mjaftueshme, në kuptimin që t’u japë qytetarëve një tregues të përshtatshëm në lidhje me rrethanat dhe kushtet në të cilat autoritetet publike janë të autorizuar t’i kthehen kësaj ndërhyrjeje të fshehtë dhe potencialisht të rrezikshme në të drejtat e jetës private dhe korrespondencës. 79. Sipas mendimit të Gjykatës, këto parime zbatohen në mënyrë të njëjtë për përdorimin e një mjete të transmetimit radiofonik, i cili, në kuptimin e natyrës, dhe shkallës së ndërhyrjes përkatës, është virtualisht e njëjtë me përgjimin telefonik.*

Në nenin 222 është parashikuar detyrimi i gjykatës për të lejuar përgjimin me vendim të arsyetuar vetëm në rastet kur në ngarkim të personit ekziston një dyshim i arsyeshëm dhe i bazuar në prova se ka kryer një vepër penale (pika 1), shqyrtimin e kërkesës së prokurorit në Dhomë Këshillimi brenda 24 orëve, si dhe e drejta e ankimit dhe shqyrtimi nga Gjykata e Apelit brenda 48 orëve (pika 3). Këto rregullime synojnë të shmangin çdo procedurë abuzive të përgjimit, si dhe shqyrtimin e këtyre kërkesave në një afat sa më të shkurtër nga gjykata mbi bazën e shkaqeve të paraqitura në mënyrë të shkruar nga prokurori.

Është shtuar neni 226/a. Ky nen është propozuar për të bërë të mundur dhe lehtësuar mbledhjen e të dhënave përkatëse për qëllime të procedimit. Gjatë viteve është vënë re se përgjimi nuk është i vetmi mjet që nevojitet për të kryer hetime të suksesshme. Për më tepër, ajo çka nevojitet nuk është vetëm ndjekja e komunikimeve ndërmjet dy ose më shumë personave, por duhet të dihet edhe vendndodhja e pajisjeve me të cilat është komunikuar ose frekuencën e komunikimeve. Mbledhja e këtyre të dhënave mund të lehtësojë hetimin dhe të çon tek autori i veprës penale ose tek vendi në të cilin është kryer veprimi penal dhe se si ka ndodhur. Deri tani, mbledhja e të dhënave ka qenë e paqartë e parashikuar në nenin 222. Është e paqartë sikundër i referohet vendeve publike, ndërkohë që vendosja e pajisjeve zbuluese mund të parashikohet jo ekskluzivisht për vende publike. Për më tepër, nuk është parashikuar mundësia për të kërkuar pjesën tjetër të të dhënave të nevojshme për hetime të mëtejshme, duke qenë se teknologjia si e tillë po përmirësohet çdo ditë.

⁴²³ Vendim i GJEDNJ-së, Bykov vs Ruisisë, datë 10 mars 2009.

Për këtë arsye, në paragrafin e parë të këtij neni është parashikuar që prokurori mund të nxjerrë një vendim për të mbledhur të dhënat. Sikundër të dhënat që supozohen të mblidhen janë të përgjithshme dhe nuk përfshijnë përmbajtjen e bisedimeve ose të email-eve, ato janë më pak intruzive, çka përbën edhe arsyen që autorizimi duhet të jepet vetëm nga prokurori. Mënyra se si është parashikuar është në përputhje me nenin 101 të Ligjit për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë⁴²⁴. Sipas dispozitës së përmendur të këtij ligji është parashikuar se sipërmarrësit e rrjeteve dhe të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike detyrohen të ruajnë dhe të administrojnë, për një afat 2-vjeçar. Është parashikuar, gjithashtu, që këto të dhëna duhet t'i jepen autoritetit të procedurës sipas kërkesës.

Një problem praktik mjaft i rëndësishëm ka qenë dhe mbetet edhe inicimi i të ashtuquajturave hetime proaktive, ku, në bazë të informacioneve të servirura nga agjenci të ndryshme ligjzbatuese, vihen numra telefonikë dhe komunikimet e tyre në përgjim ose dhe vetë persona të ndryshëm, me qëllim zbulimin e një veprimtarie ose aktivitetit kriminal. Në fakt, fillimi i një procedimi penal dhe vendosja në përgjim e këtyre komunikimeve nuk është praktike e ligjshme dhe as e logjiksme. Vetë ligjvënësi e ka zgjidhur këtë problem me ligjin për përgjimin parandalues, ku u jep mundësinë të gjitha agjencive ligjzbatuese që kanë për detyrë të parandalojnë kryerjen e veprave penale dhe të identifikojnë veprat penale që t'i referojnë në organin e ushtrimit të ndjekjes penale, prokuroria, që të kërkojnë vendosjen në përgjime parandaluese. Në këto kushte, këto përgjime duhet t'i shërbejnë këtyre agjencive ligjzbatuese që të bëjnë të mundur kapjen në flagrancë ose parandalimin e veprimtarive kriminale, duke i goditur ato në fazën e përgatitjes dhe, më së pakti, duke i lënë ato të mbeten në tentativë. Përfshirja në shumë raste për shkak të rutinës së ardhjes së një materiali nga këto agjenci, dhe trysnisë së zgjidhjes dhe përpunimit të tyre, shpeshherë i ka bërë prokurorët dhe gjyqtarët e fazës së hetimit paraprak që të gabojnë proceduralisht, duke harruar që detyra e tyre është të rindërtojmë ngjarjen që ka ndodhur dhe jo të parandalojmë një ngjarje që do të ndodhë specifikisht. Pra, në momentin që hyn në veprim organi i ushtrimit të ndjekjes penale dhe gjykata që vleftëson kërkesat e këtij organi, duhet patjetër që të ketë ndodhur një vepër penale ose të ekzistojë dyshimi i arsyeshëm i bazuar në provë që kjo vepër ka ndodhur.

Problem tjetër në mënyrën e të konceptuarit si provë të rezultatit të përgjimit ka pasur debate dhe interpretime të ndryshme në radhët e juristëve. Pra, përgjimi është mjeti për kërkimin e provave, ndërsa rezultati që përftohet nga ky përgjim është provë. Unë personalisht ndaj një mendim të ndryshëm në lidhje me sa më sipër, duke u nisur nga disa faktorë realë objektivë, si dhe disa konceptualë juridikë. Pavarësisht se krahasimi nuk ka forcën e argumentit, po e filloj së pari me një anomali objektive praktike. Çfarë ndodh me dy persona që komunikojnë duke bërë shaka njëri ndaj tjetrit se kanë transportuar ose transportojnë një sasi lëndë narkotike. Kjo sasi lëndë nuk është kapur asnjëherë nga forcat e policisë dhe as nuk provohet se ka ekzistuar me prova të tjera, por biseda e dy personave flet hapur për një fakt të tillë. Si rregull, rezultati i përgjimit

⁴²⁴Ligji për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë.

PROVAT DHE PROCESI I TË PROVUARIT NË PROCESIN PENAL

duhet të na bëjë që të mendojmë për kryerjen e një kontrolli e më pas të shoqërohet me sekuestrim në rast se gjendet një lëndë e dyshuar si lëndë narkotike.

Ky është rasti klasik që e bën të dyshimtë teorinë se rezultati që përftohet nga përgjimi i komunikimit të disa subjekteve është provë.

Nga pikëpamja konceptuale - procedurale, mjeti për kërkimin e provës, lidhet me ato lloj provash të parashikuara shprehimisht në Kodin e Procedurës Penale dhe jo me provat atipike, siç parashikon neni 149 i K. Pr. Penale, i shtjellur gjatë trajtimit të kësaj teme.

Ithtarët e teorisë se rezultati që përftohet nga përgjimi është provë, shpeshherë në linjën e abstraksionit të mendimit të tyre, kanë pohuar edhe fakin se procesverbali për transkriptimin e bisedave të përgjuara është provë e llojit dokument.

Në këtë rast, unë kam objeksionet e mia që rrjedhin nga fakti se mjetet e kërkimit të provës, siç është përgjimi, mund të na ofrojnë të dhëna në lidhje me burime provash si dëshmitarë, na sugjerojnë përdorimin e mjeteve të tjera të kërkimit të provës, me qëllim fiksimit e provave materiale, dokumenteve etj., por kurrësi që rezultati i përgjimit të shërbejë, vetëm nisur nga forma e përshkrimit në një akt procedural siç është procesverbali i transkriptimit të bisedave në një akt të shkruar, të barasnjehsohet me provën dokument.

Së fundmi, dua të ndalem tek të ashtuquajturat përgjime të bëra nga ana e subjekteve të ndryshme në jetën private dhe shoqërimi i tyre edhe me filmime audiovizive. Me çfarë cileëie vijnë ato tek organet procedurale dhe çfarë vlere provuese kanë ato. Në lidhje me këto fakte, gjykatat tona vetëm nisur nga parashikimi se nuk janë marrë në formën e kërkuar procedurale, i kanë konsideruar ato si prova të papërdorshme, pra duke vendosur si kusht formën, organin që i merr ato, pavarësisht rezultatit të tyre. Në raste të tjera, ato janë marrë dhe i janë nënshtruar ekspertimeve teknike dhe, në varësi të mendimit të ekspertit përkatës janë çmuar dhe analizuar si prova në proces. Ndryshimi i vetëm në perceptimin tim ka qenë vetëm koha përpara ndryshimeve të Kodit të Procedurës Penale dhe ndryshimet e reja që përfshijnë mundësinë e përdorimit të çdo lloj prove që provon një fakt, njafton që të mos cenojë lirinë dhe vullnetin e palëve dhe palët të shprehin mendim përpara se ato të merren në proces nga gjykata. Pra, përpara ndryshimeve procedurale të gushtit 2017, këto nuk mund të shërbenin si prova, ndërkohë që, pas këtyre ndryshimeve ato mund të shërbejnë si prova, por duhen marrë dhe trajtuar në përputhje me parashikimet e neneve 8/a dhe 149/2 të K. Pr. Penale (duhen trajtuar rastet e Qazim Gjonaj, Fariz Xhurxhit, avokate, Ilir Metës).

***Në vendimin nr. 8⁴²⁵, datë 17.06.2012, të Gjykatës së Lartë të RSH-së, është** sqaruar ndërmjet, të tjerash, shprehimisht se videopërgjimi është konsideruar si provë materiale në kuptim të nenit 187 të K. Pr. Penale lidhur me pajisjen në të cilin gjendej i regjistruar ky videopërgjimi dhe në lidhje me vlefshmërinë e tij i është nënshtruar ekspertimit teknik.*

- Rrëzimin e kërkesës paraprake për papërdorshmërinë e videoregjistrimit të realizuar nga shtetasi Dritan Prifti, sepse është bërë në shkelje të nenit 221 e vijues të Kodit të

⁴²⁵ Vendim nr.8, datë 17.06.2012, i Gjykatës së Lartë.

Procedurës Penale mbi “Përgjimet”, me arsyetimin se videoregjistrimet e realizuara jo nga organet e procedimit, por nga subjektet private nuk përfshihen në rastet dhe kriteret që përmbahen në Titullin IV, Kreu III, Seksioni IV “Përgjimet” (nenet 221 e vijues) të Kodit të Procedurës Penale.

- Lidhur me kërkesën paraprake për papërdorshmërinë e provave materiale, duke filluar nga ora audio e videoregjistruese me të cilën pretendohet se është bërë regjistrimi, si dhe të mjeteve të tjera teknike të transferimit e riprodhimit të regjistrimit, duke vijuar me disqet elektronike, ku përmbahen të dhënat e regjistrimit, për shkak se sipas mbrojtjes mungon prova origjinale e bisedës në vetë orën regjistruese, Kolegji Penal vlerësoi se, në kuptim e zbatim të dispozitave procedurale, në atë moment të procedimit, nuk mund të kishte qëndrimin e tij dhe as të dispononte për pranimin apo rrëzimin e kërkesës, pra për papërdorshmërinë ose jo të këtyre provave.

Kërkesa paraprake mbështetet në konkluzionet shkencore të arritura me aktet e ekspertimit teknik të realizuara nga ana e organit të prokurorisë në fazën e hetimit paraprak, sipas të cilave, videoregjistrimi nuk gjendej në orën audio e videoregjistruese. Por, ky Kolegj Penal, në përgjigje edhe të vetë kërkesës paraprake të paraqitur nga mbrojtësit e të pandehurit Ilir Meta, u shpreh e disponoi më lart për pranimin e asaj kërkesë lidhur me pavlefshmërinë e akteve procedurale të caktimit të ekspertit dhe për papërdorshmërinë e akteve të ekspertimit të realizuara prej tyre.

Në rrethana të tilla, Kolegji Penal, nuk gjente më në fashikullin e gjyqimit asnjë akt ekspertimi me konkluzione shkencore lidhur me natyrën, autenticitetin, mënyrën e përdorimit dhe të dhënat që përmbajnë apo mund të përmbajnë provat materiale që nga mbrojtja pretendohet e kërkohej se ishin të papërdorshme, sepse, sipas tyre, mungon prova “origjinale”.

- Së fundi, Kolegji Penal vendosi të rrëzojë kërkesën paraprake të mbrojtjes së të pandehurit Ilir Meta për sa i përket papërdorshmërisë së deklarimeve të shtetasit Dritan Prifti, me pretendimin se është person i akuzuar në një procedim të lidhur, me arsyetimin se nga të dhënat që përmbahen në fashikullin e gjyqimit nuk jemi përpara rasteve të parashikuara nga neni 156, pika 2, të Kodit të Procedurës Penale.

4.5. Një vështrim mbi Ligjin Nr. 10 192, datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë” (ndryshuar me ligjin nr. 24/2014, datë 20.3.2014, nr. 70/2017, datë 27.4.2017), dhe barra e provës sipas këtij ligji

Barra e provës është detyrimi që kanë palët, subjektet apo organet e ngarkuar me ligj për të vërtetuar të drejtën apo kërkesat që ata pretendojnë. Barrën e provës e gjejmë në të tre procedimet: administrativ, penal, ashtu edhe në atë civil, por ajo ndryshon nga një procedim në tjetrin.

Kështu, në procedimin penal, barra e provës nënkupton detyrimin e organit të akuzës, prokurorisë, që të provojë akuzën e ngritur ndaj personit që dyshohet se ka konsumuar veprën penale.

Kjo do të thotë që organi i akuzës ka detyrimin të hetojë, të mbledhë prova nga ato që parashikon neni 149 i K. P. Penale dhe, pasi të ketë krijuar bindjen që personi mbi bazën e këtyre provave do të deklarohet fajtor, të provojë para gjykatës akuzën që ai pretendon.

Kjo është rrjedhojë e parimit të prezumimit të pafajësisë, i parashikuar në nenin 4 të K. P. Penale, i cili sanksionon se: “Çdokush prezumohet i pafajshëm deri në një vendim gjyqësor të formës së prerë që e deklaron atë fajtor.”.

Për këtë arsye, personi i dyshuar, për shkak të këtij prezumimi, nuk duhet të vërtetohet asgjë, pasi ai prezumohet i pafajshëm. Roli dhe pozicioni i personit të dyshuar është pasiv dhe jo aktiv, si roli i prokurorisë, ai nuk duhet të provojë pafajësinë e tij, pasi ai i tillë është. Ndërsa në procedimin civil, barra e provës është ana tjetër e medaljes.

Barra e provës në procedimin parandalues paraqitet interesante për vetë natyrën e këtij lloj procedimi. Ky lloj procedimi miks për nga natyra zbaton në mënyrë të kombinuar normat e ligjit anti-mafia, Kodin e Pr. Penale dhe disa rregulla administrative, për këtë arsye edhe barra e provës ndryshon. Nuk kemi zbatimin e barrës së provës në procedimin penal, por as edhe barrën e provës në procedimin civil në formën e tyre më të kulluar, por një kombinim të këtyre 2 formave të barrës së provës nëse mund ta quanim kështu.

Në procedimin parandalues, fillimisht kemi një barrë prove që merr elemente të dy procedimeve, pasi fillon me nenin 4 të Kodit të Procedurës Penale, ku barrën e provës e ka prokurori, vazhdon dhe mbaron me nenin 8 dhe 12 të Kodit të Procedurës Civile, ku barrën e provës e ka personi i dyshuar për veprimtari kriminale (përpara ndryshimeve të ligjit), pasi, me ndryshimet e pësura në ligj, procedimi pasuror ka mbështetje vetëm në dispozitat e Kodit të Procedurës Penale.

Pra, barra e provës në procedimin parandalues lëviz ose transferohet nga organi i akuzës në fillim të procedimit parandalues dhe në vazhdim kalon tek personi i dyshuar për pjesëmarrje në veprimtari kriminale nga ato të parashikuara në nenin 3 të ligjit anti-mafia.

Dallimi thelbësor është se, në bazë të këtij ligji, mjafton të kemi dyshime mbi indicie dhe jo mbi prova që të fillohet një i ashtuquajtur procedim pasuror dhe barra e të provuarit për mënyrën e krijimit të pasurisë t'i ngarkohet personit që i sekuestrohet e konfiskohet pasuria.

Kjo përmbysje e barrës së provës nuk është diçka e re, trillim apo një risi e parashikuar vetëm në sistemin ligjor shqiptar. Njëkohësisht, kjo ka qenë ndër pjesët më të diskutueshme në media dhe në publikun e gjerë, e cila më vonë u shqyrtua edhe nga Gjykata Kushtetuese. Por çfarë parashikojnë aktet ndërkombëtare në lidhje me këtë përmbysje të barrës së provës?

Për të konkretizuar barrën e provës në procedimet pasurore analizojmë vendimin nr. 2, datë 16.03.2011⁴²⁶ të GJSHPKR-së, me objekt konfiskimin e pasurive të shtetasit nën hetim M. K. dhe shtetasve N. K. dhe B. K.

⁴²⁶ Vendimi nr. 2, datë 16.03.2011, i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime e Rënda.

PROVAT DHE PROCESI I TË PROVUARIT NË PROCESIN PENAL

Gjykata në këtë vendim ka arsyetuar edhe barrën e provës të organit të prokurorisë, por edhe të personit nën hetim pasuror. Në vendosjen e sekuestrimit, gjykata ka arsyetuar qenien e shtetasit M. K. dhe personave të tretë, babait të tij, shtetasit N. K., dhe bashkëshortes së tij, B. K., si subjekte të zbatimit të Ligjit Nr. 10192, datë 03.12.2009, në referim të nenit 3, pika 1, shkronja "d" dhe pika 2, shkronja "a" të tij. Gjykata ka konstatuar prej saj ekzistencën e kriterëve të përgjithshme për vendosjen e masës së sekuestrimit dhe që lidhen me ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm të bazuar në indicie për pjesëmarrje të shtetasit M. K. në veprimtari kriminale që përfshihet në fushën e zbatimit të këtij ligji, si dhe e zotërimit të pasurive që nuk i përgjigjeshin dukshëm nivelit të të ardhurave (të parashikuara si të tilla në nenin 11 pika "a" dhe "b"). Gjithashtu, është arsyetuar edhe ekzistenca e kriterit të veçantë që lidhet me praninë e rrezikut të tjetërsimit apo humbjes së pasurive (e parashikuar në shkronjën "a" të pikës 1 të nenit 11 të Ligjit).

Kjo barrë prove i përkiste prokurorit, i cili, në rastin konkret, ka vërtetuar para gjykatës se personi është person nën hetim për ato vepra penale të parashikuara në nenin 3 të ligjit, niveli i shpenzimeve nuk i përgjigjej dukshëm nivelit të të ardhurave, dhe se pasuritë janë nën zotërimin e drejtpërdrejtë të personit. Këtu mbaroi barra e provës për organin e akuzës.

Pas kësaj, kjo barrë prove transferohet tek personi ndaj të cilit do të caktohen masat me karakter pasuror. Gjykata arsyeton se: *Në kushtet kur barra e provës, në zbatim të këtij ligji, i përket personit, pasuria e të cilit kërkohet të konfiskohet (pika 3 e nenit 21 të Ligjit) gjatë gjykimit, nga ana e përfaqësuesit të posaçëm të shtetasit nën hetim dhe personave të tretë, u paraqitën me cilësinë e provës deklaratat e të ardhurave vjetore të shtetasve M. K. dhe N. K., të përpiluara në Drejtorinë e Shërbimeve Ekonomike, Bashkia Pire, për periudhën nga viti 2000 deri në vitin 2009. Këto deklarata u paraqitën me vulën apostile të Ambasadës së Republikës së Shqipërisë në Athinë, të përkthyer dhe noterizuara, duke patur në këtë mënyrë formën e kërkuar ligjore. Në funksion të provueshmërisë së realizimit faktik të këtyre të ardhurave u paraqitën gjithashtu me cilësinë e provës edhe dokumente të Institutit të Sigurimeve Shoqërore IKA në Greqi, për periudhën në fjalë për shtetasit M dhe N. Kuqi.*

Në një tjetër vendim të GJSHPKR-së, gjykata ka konkluduar se⁴²⁷: *Me këtë rast, gjykata çmon se nga ana e akuzës u arrit që të realizohej barra e provës ose "onus probandi" që nenet 3 dhe 24, shkronja "a" e ligjit të mësipërm, i ngarkojnë akuzës për të provuar dyshimin e arsyeshëm të bazuar në indicie që personi është pjesëmarrës në një nga veprat penale të parashikuara nga neni 3 i ligjit të mësipërm.*

Kjo barrë prove, i është ngarkuar akuzës, jo vetëm nga dispozitat e cituara të ligjit, por edhe nga vendimi nr. 4, datë 23.02.2011, i Gjykatës Kushtetuese⁴²⁸, në të cilin ajo Gjykatë, ndër të tjera, ka arsyetuar se: *Gjykata, në ligjin objekt shqyrtimi vlerëson se, veçanërisht formulimet e nenit 11, paragrafi 1 (kriteret për sekuestrim), ku parashikohet se prokurori bën kërkesë të motivuar dhe nenit 21 (kërkesa për konfiskim dhe barra e provës), ku prokurori përsëri duhet t'i paraqesë gjykatës arsyet ku bazohet*

⁴²⁷ Vendimin e dt. 03.02.2012, kërkesa me nr. regjistri 1/09 të GJSHPKR-së.

⁴²⁸ Vendimi nr. 4, datë 23.02.2011, i Gjykatës Kushtetuese.

kërkesa, barra e provës fillimisht i takon prokurorit për të argumentuar dyshimin e arsyeshëm bazuar në indicie, se një person është pjesëmarrës në krimin e organizuar dhe trafikim sipas veprave të parashikuara në nenin 3.

Mbështetur në verifikimet e kryera, prokurori ka detyrimin për të parashtruar kërkime të motivuara dhe të dhëna mbështetëse përpara gjykatës për identifikimin e pasurive të personit të dyshuar dhe të personave të tjerë; të tregojë nga ana e tij se ka baza për dyshim të arsyeshëm dhe të dhëna të mjaftueshme për efekt të gjykimit parandalues, se ato nuk janë pasuri të fituara në rrugë të ligjshme, çka motivon ekzistencën e prezumimit të paligjshmërisë së tyre dhe si rezultat, kalimin e barrës së provës personit të dyshuar.

Pas kësaj, barra e provës kalon te personi i dyshuar për të justifikuar origjinën e ligjshme të pasurive të tij, për të argumentuar mungesën e lidhjes së pasurisë me cilësimin si produkte të veprave penale ose investim të tyre. Më pas është detyrë e gjykatës që të sigurojë zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor, të kryejë një hetim të gjithanshëm dhe të plotë, për dhënien e një vendimi të drejtë dhe të mbështetur në ligj.

Pra, në dallim nga procedimi penal, gjykimi parandalues mbështetet në dyshimin e arsyeshëm bazuar në indicie, duke iu ngarkuar barra e provës personit të dyshuar dhe personave të tjerë, për të vërtetuar ligjshmërinë, për justifikimin e origjinës së pasurisë. Pra, në këtë procedim, barra e provës është e ndarë ndërmjet prokurorit dhe personit të cilit do t'i sekuestrohet ose konfiskohet pasuria.

Këtë qëndrim mban edhe Gjykata e Lartë- Kolegjet e Bashkuara të saj në vendimin unifikues⁴²⁹ në lidhje me barrën e provës duke pohuar se: *Vendosja e masës pasurore ka në themel të saj mundësinë, dyshimin e arsyeshëm të mbështetur në të dhëna të mjaftueshme që rezultojnë nga tërësia e provave të marra dhe të verifikuara gjatë shqyrtimit të çështjes, çka prezumon edhe paligjshmërinë e kësaj pasurie.*

Ndryshe nga procedimi penal, ku personi prezumohet i pafajshëm dhe barrën e provës e ka organi i akuzës, në procedimin parandalues ekziston prezumimi për zotërim dhe prejardhje të paligjshme të pasurisë e lidhur kjo me veprimtarinë kriminale të personit. Kjo është edhe arsyeja pse barra e provës zhvendoset nga organi i akuzës tek vetë personi apo personat e tretë që kanë lidhje me të.

Marrëdhënia mes dy llojeve të procedimeve parashikohet në nenin 5 të këtij ligji që parashikon shprehimisht se:

Neni 5-Marrëdhënia me procedimin penal (ndryshuar pika 2, me ligjin nr. 70/2017, datë 27.4.2017).

1. Procedura e caktimit dhe e zbatimit të masave parandaluese, sipas këtij ligji, është autonome nga gjendja, shkalla apo përfundimi i procedimit penal që zhvillohet në ngarkim të personave, subjekte të këtij ligji.

2. Verifikimi, hetimi dhe gjykimi, sipas këtij ligji, mbështeten në rregullat procedurale të këtij ligji dhe plotësohen nga rregulla të përcaktuara në Kodin e Procedurës Penale, sipas rastit. Të dhënat e marra nga procesi penal përdoren në procedurën e parashikuar nga ky ligj.

⁴²⁹ Vendimi unifikues i Gjykatës së Lartë.

PROVAT DHE PROCESI I TË PROVUARIT NË PROCESIN PENAL

3. Në rastet kur pasuritë e sekuestruara apo të konfiskuara, sipas këtij ligji, i nënshtrohen, 3 gjithashtu, sekuestrimit apo konfiskimit, sipas Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale, gjykata urdhëron pezullimin e pasojave të zbatimit të masave të sekuestrimit dhe konfiskimit, sipas këtij ligji. Pezullimi përfundon me dhënien e një vendimi gjyqësor penal për revokimin apo shuarjen e këtyre masave.

Në këtë dispozitë shikohet mjaft qartë procedimi gjyqësor për qëllime të zbatimit të këtij ligji, ligji i aplikueshëm dhe marrëdhënia mes dy procedimeve.

Nga kjo dispozitë lindin disa kontradikta ligjore që meritojnë të përmenden. Së pari, ky ligj bazuar në nenin 81 të Kushtetutës së RSH-së nuk është nga ato ligje që kërkojnë një shumicë të cilësuar, siç është Kodi i Procedurës Penale, dhe në asnjë rast nuk mund të plotësohet nga dispozitat e tij, pasi dispozitat e Kodit bazuar në nenet 81 dhe 11 të Kushtetutës prevalojnë në hierarkinë e akteve ligjore.

Së dyti, vihet re se një procedim pasuror, edhe pse mund të vazhdojë i vetëm, në rastet e marrjes së një mase nga organet proceduese në një procedim penal duhet të pezullohet për efekt të zbatimit të efekteve të masës së sekuestrimit ose konfiskimit të marrë në bazë të këtij ligji specifik.

Në këtë rast, ky ligj, nga vetë emri ka karakter parandalues dhe ekziston më vete edhe bazuar në dyshime të mbështetura në indicie dhe i lë barrën e provës atij ndaj të cilit dyshohet se merret me veprimtari kriminale objekt i këtij ligji ose personave të lidhur me të, pra lë mundësinë e ndërhyrjes edhe kur nuk ka një procedim penal, dhe pikërisht ku duhet të jetë edhe efekti i tij në praktikë, pavarësisht se praktika jonë ka treguar se është abuzuar në këtë drejtim.

Pra, atë që procedimi penal nuk e vërteton me prova dhe e pushon ndjekjen penale, ose akuzën në ngarkim të një personi, ne e kemi vazhduar bazuar në indicie të hedhura poshtë nga provat dhe kemi sjellë pasoja në dëm të pasurisë së personave ndaj të cilëve është filluar procedimi pasuror.

Në nenin 3, pika 6 e këtij ligji parashikohet shprehimisht se:

Ky ligj zbatohet edhe për pasuritë e personave, të vëna përpara hyrjes në fuqi të tij, me kusht që të ekzistojnë indicie të rëndësishme për përfshirjen e tyre në veprimtari kriminale, në kohën e vënies së pasurisë.

Në këtë mënyrë vihet re se ky ligj i jep vetes fuqi prapavepruese, në ndryshim nga ligjet e tjera përveç ligjit penal që ka një fuqi prapavepruese që funksionon në bazë të parimit të subsidiaritetit dhe vetëm në drejtim të favorizimit të pozitës së të pandehurit, dhe jo përkeqësimit të pozitës së tij.

KAPITULLI V

VESHTRIM KRAHASUES I LEGJISLACIONEVE TË HUAJA LIDHUR ME
PROVAT DHE PROCESIN E TË PROVUARIT

5.1. VËSHTRIM KRAHASUES ME LIGJIN ITALIAN

❖ Vështrim i përgjithshëm

Kodi i Procedurës Penale aktuale i miratuar në vitin 1995, në kohën e miratimit të tij, si dhe në kontekstin historik të zhvillimit të legjislacionit penal në Shqipëri, përfaqëson një hap përpara dhe me rëndësi në drejtim të demokratizimit të ligjit procedural penal, në garantimin e të drejtave dhe lirive të individit në procesin penal, në krijimin e themeleve të qëndrueshme të shtetit të së drejtës, si dhe në garantimin e një procesi të rregullt gjyqësor të personave që i nënshtroheshin procesit penal. Sigurisht, që në kohën e hartimit dhe të miratimit të K. Pr. Penale ishte e nevojshme që hartuesit e këtij kodi të bazoheshin në modele të sprovuara të legjislacioneve të shteteve të huaja, në mënyrë që të sigurohej krijimi i një legjislacioni procedural penal sa më bashkëkohor dhe që t’ju përgjigjej kërkesave të kohës.

Në këtë drejtim, hartuesit e K. Pr. Penale në krijimin e ligjit të ri Nr. 35/2017 procedural penal janë mbështetur në një masë të konsiderueshme në legjislacionin procedural penal italian. Praktika gjyqësore aktuale, jo në pak raste, ka krijuar problematika të ndryshme në disa momente të procesit penal, për zgjidhjen e të cilave shpesh i referohemi legjislacionit procedural penal italian, si dhe praktikës gjyqësore të këtij shteti, duke u munduar kështu për të gjetur zgjidhje të këtyre problematikave, të cilat jo në pak raste janë krijuar edhe për shkak të mosimplementimit të saktë dhe të plotë të normave procedurale të legjislacionit në fjalë, por edhe për shkak të një praktike të pakonsoliduar dhe kryesisht të varfër gjyqësore.

Për këtë qëllim, në këtë punim kemi menduar që t’i kushtojmë vëmendje ligjit procedural penal italian duke u ndalur në evoluimin e provave dhe procesit të provuarit në procesin penal, duke u munduar kështu që të bëjmë një krahasim midis dy procedurave në lidhje me provat dhe procesin e të provuarit në procesin penal, por edhe duke u përpjekur për të gjetur zgjidhje të mundshme të problematikave të krijuara nga praktika jonë aktuale gjyqësore.

❖ **SISTEMI PROCEDURAL PENAL NË ITALI**

*Kodi i Procedurës Penale në Itali ka hyrë në fuqi më datë 24.10.1989, duke zëvendësuar Kodin e Procedurës Penale të vitit 1930, i njohur me emrin “Kodi Rocco”.*⁴³⁰

Kodi i Procedurës Penale i vitit 1989, në vend të sistemit procedural penal të përzier, që karakterizonte K. Pr. Penale të mëparshëm, krijoi një sistem procedural të tipit akuzator. *Tiparet e këtij sistemi bëjnë dallimin e qartë midis rolit të prokurorit dhe të*

⁴³⁰Francesco Caringella, Francesca Della Valle Michelle de Palma “Manuale di Diritto Penale” Parte generale.

*gjyqtarit, formimin e provës dhe çmuarjes së tyre nga gjyqtari, theksimin e të drejtave të palëve dhe në barazinë e tyre, në vlerësimin e rolit e të zhvillimit të debatit gjyqësor oral para gjyqtarit*⁴³¹.

Edhe sipas ligjit procedural penal italian, hetimet paraprake fillojnë me marrjen e provave nga prokurori dhe vazhdon me marrjen e atyre provave të kërkuara nga palët e tjera, i pandehuri dhe palët private të pranishme në gjykimin e çështjes. Në përfundim të hetimeve paraprake, prokurori ka detyrimin që të depozitohet pranë gjykatës fashikullin përkatës të akteve të procedimit penal, bashkë me kërkesën për gjykimin. *Prova formohet përpara gjykatës dhe administrohet prej saj në seancë gjyqësore. Gjyqtari nuk mund të mbështet në prova që janë marrë në mënyrë të kundraligjshme, por ai duhet të gjykojë vetëm mbi bazën e provave që merren sipas ligjit.*⁴³²

Sipas nenit 187 të KPPI:

1. Janë objekt i të provuarit të gjitha faktet që lidhen me fajësinë, ndëshkueshmërinë dhe me përcaktimin e dënimit ose masave të sigurimit.
2. Janë gjithashtu prova faktet nga të cilat varet zbatimi i dispozitave procedurale.
3. Janë gjithashtu objekt prove faktet që lidhen me përgjegjësinë civile që rrjedh nga konsumimi i veprës penale.

*Gjatë zhvillimit të seancës paraprake, gjykimi çelet me leximin nga prokurori të akuzës penale, duke treguar rrethanat e faktit që do të synojë që të provojë para gjykatës, që sipas tij përbëjnë kryerjen e veprës penale dhe provojnë fajësinë e të pandehurit që është duke u gjykuar, si dhe provat që kërkojnë prej tij të shqyrtohen gjatë shqyrtimit gjyqësor*⁴³³.

Në këtë fazë, i pandehuri ka të drejtën që të japë edhe deklaratimet e tij të lira dhe me kërkesë të palëve, gjyqtari mundet që të disponojë edhe me pyetjen e të pandehurit nga palët. Më pas, edhe mbrojtësit tregojnë faktet që kërkojnë të provojnë dhe kërkojnë pranimin e provave.

Gjithashtu, kryetari i seancës gjyqësore mund t'u drejtojë pyetje dëshmitarëve, ekspertëve, konsulentëve teknikë dhe palëve private. *Sipas nenit 507 të K. Pr. Penale*⁴³⁴, pasi të ketë përfunduar marrja e provave të kërkuara nga palët, gjyqtari, nëse rezulton e nevojshme, mund të disponojë edhe kryesisht marrjen e mjeteve të reja të provës.

*E veçanta e ligjit procedural italian është fakti se depozitimi i listës së dëshmitarëve apo të ekspertëve duhet të bëhet brenda afatit 7-ditor nga fillimi i gjykimit*⁴³⁵. Nëse brenda këtij afati, listat e dëshmitarëve që do të pyeten, të pandehurve në një procedim të lidhur apo të ekspertëve, nuk janë depozituar në sekretarinë e gjykatës, pyetja e tyre nuk mundet që të kërkohej në momentet e mëtejshme të gjykimit.

Depozitimi i listës së dëshmitarëve, me pasojë pranueshmërie, ka funksionin dhe njëkohësisht synimin për të evituar futjen nga çdo lloj ane i provave surprizë. Synon, pra, për "të informuar", brenda afateve të fiksuara mirë, kundërpalën dhe për të siguruar

⁴³¹Mirela Shameti, punim doktore, "Sistemi Gjyqësor Penal Shqiptar i parë në planin krahasues me atë italian".

⁴³² Altin Shegani, "E drejta penale e krahasuar", botim i vitit 1999, fq. 195.

⁴³³ Altin Shegani, "E drejta penale e krahasuar", botim i vitit 1999, fq. 191.

⁴³⁴ Kodi i Procedurës italiane.

⁴³⁵ Altin Shegani, "E drejta penale e krahasuar", botim i vitit 1999, fq. 191.

një përdorim korrekt të kontradiktoritetit në gjykim. Depozitimi i listës duhet të lidhet edhe me tregimin e rrethanave rreth të cilave “do të bëhet marrja në pyetje”, duke bërë kështu të mundur që pala tjetër t’i njohë paraprakisht këto rrethana.

Në Kodin e Procedurës Penale italiane, në nenin 188, është e parashikuar “Liria morale e personit në marrjen e provës”: *Nuk mund të përdoren, as me pëlqimin e personit në fjalë, metoda ose teknika të përshtatshme që ndikojnë në lirinë e vetëvendosjes ose që ndryshojnë kapacitetin për të kujtuar dhe vlerësuar faktet.*⁴³⁶

Në nenin 189 - KPPI, provat që nuk parashikohen nga ligji: *Kur kërkohet të merret një prove që nuk parashikohet nga ligji, gjykata mund ta marrë atë nëse është e mundshme për të siguruar përcaktimin e fakteve dhe nëse nuk ndikon në lirinë morale të të pandehurit. Gjykatësi vendos për marrjen e provës pasi dëgjon palët më parë.*

Në nenin 190 - E drejta për të kërkuar marrjen e provës: *1. Provat merren me kërkesë të palëve. Gjykata vendos pa vonesë me urdhër për marrjen e provave, duke përfshirë provat e ndaluara nga ligji dhe ato që janë haptazi të panevojshme ose të parëndësishme.*

2. Ky ligj përcakton rastet në të cilat provat merren dhe kryesisht nga gjykata.

3. Urdhri për pranimin e provave mund të revokohet pas dëgjimit të palëve në proces.

Në nenin 190- Kërkesat për marrjen e provave në raste të veçanta: *1. Për procedimet për cilindo nga krimet e parashikuara në nenin 51, paragrafi 3-bis, kur është kërkuar pyetja një dëshmitari ose të personit të përcaktuar në nenin 210 dhe ata kanë bërë tashmë deklaramë në polici apo prokurori të ndryshme me deklaramet që japin në gjykim ndaj të pandehurit, do të përdoren deklaramet e dhëna në përputhje me nenin 238, marrja në pyetje është e lejueshme vetëm nëse ka të bëjë me fakte apo rrethana të tjera nga ato të dhëna më parë dhe nëse gjyqtari ose ndonjë nga palët e vlerëson të nevojshme të pyetet.*

1-bis. E njëjta dispozitë zbatohet kur procedohet për një nga krimet e parashikuara në nenet 600-bis, paragrafi i parë, 600/3, 600/4, edhe në lidhje me materiale pornografike të përmendur në nenet: 600/4, 1, 600/5, 609/2, 609/3, 609/5 dhe 609/8 të Kodit Penal, nëse kërkohet të merret në pyetje një i mitur nën moshën gjashtëmbëdhjetë vjeç dhe, në çdo rast, kur kërkohet të merret në pyetje një dëshmitar i fyer në mënyrë vulgare.

Në nenin 191-të KPPI-së, *1. Provat e marra në shkelje të ndalimeve të përcaktuara me ligj nuk mund të përdoren. 2. Papërdorshmërisë që konstatohet dhe kryesisht në çdo nivel dhe fazë të procedimit.*

Vlerësimi i provave bëhet nga gjykata në bazë të rezultateve të arritura dhe kriterëve të miratuara. *Sipas nenit 193 të KPPI-së: Ekzistenca e një fakti nuk mund të nxirret nga indiciet vetëm nëse këto janë të rëndësishme, të sakta dhe të qëndrueshme.*

Mjetet e kërkimit të provës, gjenjë parashikim në nenin 194 e vijues të legjislacioni penal⁴³⁷ italian. Si mjete të kërkimit të provës citojmë:

Dëshmia e cila mund të jetë direkte apo indirekte.

Dëshmitari pyetet për faktet që përbëjnë objekt prove. Ai nuk mund të dëshmojë në lidhje me moralin e të pandehurit, përveçse kur dëshmia lidhet me fakte specifike, të

⁴³⁶ Neni 188 e vijues i Kodit të Procedurës Penale italiane.

⁴³⁷ Kodi i Procedurës Penale italiane.

tilla që kualifikojnë personalitetin e të pandehurit në lidhje me krimin dhe me rrezikshmërinë shoqërore/sociale. Ai nuk mund të deklarojë për fakte që ka dëgjuar në publik as të shprehet për vlerësime personale vetëm nëse këto vlerësime lidhen me faktet që do të dëshmojë.

Dëshmia indirekte është atëherë kur dëshmitari i referohet fakteve të mësuara nga personat e tjerë, gjyqtari, me kërkesë të palëve, vendos që ata të thirren për të dëshmuar.

Thëniet e të pandehurit: I pandehuri në procedim të lidhur mund të dëgjohej si dëshmitar gjithmonë nëse kundër tij është dhënë një vendim përfundimtar pafajësie, dënimi ose është aplikuar dënim alternativ në përputhje me nenin 444.

Ballafaqimet - Ballafaqimi lejohet vetëm ndërmjet personave që janë pyetur, kur ka mospërputhje midis tyre për fakte dhe rrethana të caktuara.

Njohja e personave dhe sendeve për të proceduar në njohjen e një personi qoftë dhe nëpërmjet fotografisë, organi procedues fton atë që duhet të bëjë njohjen që të përshkruajë personin duke treguar të gjitha shenjat që mban mend dhe e pyet nëse ka qenë thirrur më parë për të bërë njohjen, si dhe për rrethana të tjera që mund të ndikojnë në vërtetësinë e njohjes. Njohja e sendeve që lidhen me veprën penale, organi procedues vepron duke respektuar rregullat për njohjen e personave.

Eksperimentet gjyqësore - Eksperimenti lejohet kur është e nevojshme të vërtetohet nëse një fakt ka ndodhur ose mund të ketë ndodhur në një mënyrë të caktuar. Eksperimenti është riprodhimi, për aq sa është e mundur, i gjendjes në të cilën fakti ka ndodhur ose çmohet se ka ndodhur, duke përsëritur mënyrat e zhvillimit të vetë faktit.

Ekspertimi - Ekspertimi lejohet kur është e nevojshëm zhvillimi i kërkimeve ose marrja e të dhënave, ose e vlerësimeve që kërkojnë njohuri të posaçme teknike, shkencore ose kulturore.

Provat dokumentare - Lejohet marrja e dokumenteve që përfaqësojnë fakte, persona ose sende nëpërmjet fotografimit, filmimit, fonografimit ose çdo mjeti tjetër.

Kur origjinali i një dokumenti është prishur, ka humbur ose është zhdukur, mund të merret kopja.

Këqyrjet - Këqyrja e personave, e vendeve dhe e sendeve vendoset nga organi procedues kur është e nevojshme të zbulohen gjurmët dhe pasojat e tjera materiale të veprës penale.

Sekuestrimet - Sendet e zbuluara gjatë kontrollit mund të sekuestrohen duke respektuar dispozitat për sekuestrimet.

Përgjimet e bisedave dhe komunikimeve janë përcaktuar në Kodin Italian të Procedurës Penale në pjesën që i referohet mjeteve në kërkim të provës. Ato janë instrumente të domosdoshme për kërkimin e provës, por që mund të sjellin pasoja të rënda mbi të drejtat kushtetuese të garantuara për çdo individ. Përgjimet (telefonike, ambientale dhe ato të lidhura me sistemin informatik apo telematik) nuk mund të vinë në kundërshtim me nenet 15 e 24 të Kushtetutës.

Në bazë të nenit 15 të Kushtetutës Italiane:⁴³⁸ *Liria dhe fshehtësia e korrespondencës dhe e çdo forme tjetër komunikimi nuk mund të dhunohen. Kufizimi i tyre mund të bëhet*

⁴³⁸ Kushtetuta italiane.

vetëm me akt të autoritetit gjyqësor me garancitë e përcaktuara me ligj. Sipas këtij neni, përgjimet duhen të autorizohen vetëm në qoftë se ato janë të domosdoshme për përfundimin e hetimeve dhe për mbledhjen e të dhënave të rëndësishme mbi krimin, i cili nuk duhet të jetë në dukje një krim i supozuar. Përgjimet duhet të bëhen me vendim të arsyetuar të gjyqtarit bazuar në kërkesën e prokurorit për zhvillimin e hetimeve paraprake. Gjyqtari duhet të vlerësojë dhe arsyetojë nëse ka tregues të padiskutueshëm për një krim dhe se përgjimi është absolutisht i nevojshëm për zhvillimin e mëtejshëm të hetimeve. Në rast mospranimi nga gjykata, përgjimi ndërpritet dhe të dhënat e mbledhura nuk mund të përdoren.

Përgjimi konsiston në dëgjimin, regjistrimin e bisedave dhe komunikimeve që zhvillohen në distancë, nëpërmjet telefonit apo mjeteve të tjera të telekomunikacionit, ose ndërmjet personave të pranishëm në të njëjtin ambient, nga dikush që nuk është pjesëmarrës në diskutim dhe me të cilin bisedat nuk kanë asnjë lidhje.

*Nuk përbën një veprim përgjimi dhe nuk ka nevojë për autorizim sipas nenit 267 të Kodit të Procedurës Italiane, regjistrimi i një bisede të bërë qëllimisht nga një prej pjesëmarrësve në të. Ajo është një nga format e regjistrimit të një fakti historik, të cilit autori i përket*⁴³⁹.

Kodi i Procedurës Penale Italiane nuk jep një përkufizim të qartë të përgjimit, për më tepër, në nenin 266 të tij, në vend që të japë një përkufizim të përgjimit, liston taksativisht rastet kur lejohet të përdoret ky mjet i veçantë i kërkimit të provës, dhe në nenet pasues janë radhitur: veprimet, format dhe mënyrat e zbatimit të përgjimit, ruajtja e dokumentacionit, për më tepër, ia lë interpretuesit të individualizojë hollësitë thelbësore, me qëllim për të bërë një përcaktim më të qartë të fushës së aplikimit të kësaj disipline.

Në lidhje me dëgjimin e bisedave ose komunikimeve, neni 271 i Kodit të Procedurës Penale parashikon që:

1. *Rezultatet e përgjimeve nuk mund të përdoren nëse përgjimet janë kryer jashtë rasteve të autorizuar nga ose nëse dispozitat e neneve 267 [përcaktimi i kushteve dhe formave të autorizimit] dhe 268 (1) dhe (3) [rregullat e zbatimit] nuk janë plotësuar.*

2. *Dëgjimi i bisedave ose komunikimeve të personave të përmendur në nenin 200 (1) [personat e lidhur me sekretin profesional] nuk mund të përdoren nëse lënda e tyre është e njohur për shkak të punës së tyre, zyrës ose profesion, përveç nëse të njëjtët persona kanë dëshmuar për këto fakte ose nëse i kanë shpërndarë ato në ndonjë mënyrë tjetër.*

3. *Në çdo shtet dhe në rast të gjykimit, gjyqtari duhet të sigurojë që dokumentacioni i përgjimeve të parashikuara në paragrafët 1 dhe 2 do të shkatërrohet, përveç nëse është subjekt i veprës penale.*⁴⁴⁰

Sipas nenit 267 të Kodit të Procedurës Penale, përgjimi duhet të autorizohet nga gjyqtari i hetimeve paraprake. Vetëm në raste urgjente, prokurori publik mund ta rregullojë

⁴³⁹ Vendimi nr. 12189, datë 29.03.2005, i Gjykatës Italiane të Kasacionit.

⁴⁴⁰ Opinion on the status of illegally obtained evidence in criminal procedures in the Member States of the European Union https://sites.uclouvain.be/cridho/documents/Avis_CFR.../CFR-CDF.opinion3-2003.pdf

PROVAT DHE PROCESI I TË PROVUARIT NË PROCESIN PENAL

ekzekutimin e dëgjimit. Megjithatë, gjyqtari duhet ta vërtetojë dekretin e prokurorit publik brenda 48 orëve.

Në pajtim me nenin 268 të Kodit të Procedurës Penale, përgjimi mund të kryhet vetëm nëpërmjet objekteve të pranishme në zyrat e Prokurorisë Publike ose, në raste të jashtëzakonshme, nëpërmjet ambienteve të shërbimit publik ose policisë gjyqësore. Nëse kjo përfshin komunikimin e dëgjuar nga kompjuteri, operacionet gjithashtu mund të kryhen duke përdorur objekte private.

Që të autorizohet përgjimi është e nevojshme prania e fakteve të mjaftueshme mbi kryerjen e një krimi. Fakte të mjaftueshme, në kuptim të nenit 267/1 të Kodit të Procedurës Penale, bëjnë të nevojshme kryerjen e përgjimit duke u mbështetur në ekzistencën e një krimi dhe jo në fajësimin e një personi të caktuar. Funksionimi i përgjimit është pikërisht ai i individualizimit të personit përgjegjës për një krim, duke u nisur nga një krim i kryer apo që është duke u kryer.

Në bazë të nenit 103/5 të Kodit të Procedurës Penale⁴⁴¹, të ndryshuar nga neni 1 i ligjit nr. 397, datë 7.12.2000, nuk lejohet përgjimi mbi bisedat dhe komunikimet e mbrojtësve, hetuesve privatë të autorizuar dhe të ngarkuar me detyra që lidhen me procedimin, të këshilltarëve teknik dhe ndihmësve të tyre, si dhe ndërmjet këtyre dhe personave të asistuar prej tyre.

Është me rëndësi të theksohet që neni 103/5 i Kodit të Procedurës Italiane, ndalon përgjimin e bisedave dhe komunikimeve të mbrojtësve, pasi ka për qëllim të sigurojë ushtrimin e të drejtës së mbrojtjes. Kjo e drejtë i referohet vetëm bisedave dhe komunikimeve që lidhen me çështjet në të cilat avokatët ushtrojnë veprimtarinë e tyre mbrojtëse, duke mos u shtrirë kështu mbi bisedat që i përfshijnë vetë ata në krime.

5.2. LEGJISLACIONI SIPAS TË DREJTËS PROCEDURELE PENALE ANGLOSANKSON MBI PROVAT DHE PROCESIN E TË PROVUARIT

❖ COMMON LAW DHE E DREJTA STATUTORE ANGLEZE

Në ndryshim nga vendet e tjera evropiane, të cilat bazoheshin në sistemin romak të drejtësisë, Anglia së bashku me Wellsin, aplikuan një sistem tjetër në drejtësi, i quajtur sistemi Common Law dhe e drejta statutore.

Common Law, apo ndryshe e drejta zakonore, përfshinte të gjitha zakonet dhe rregullat e mëparshme, të cilat ishin të trashëguara si ligje për shekuj me radhë. Common Lawka, në bazë ka precedentin gjyqësor, ndërsa e drejta statutore përfshin tërësinë e ligjeve të miratuara nga Parlamenti në funksion të veprimtarisë së shtetit⁴⁴².

Shumica e normave që rregullojnë provat në Common Law janë si rezultat i përpjekjeve të gjyqësorit në vitet në vazhdim me qëllim për të lehtësuar ashpërsinë e ligjit dhe procedurat penale për të akuzuarit.

Ligji i provave të Common Law nuk është hartuar në mënyrë sistematike dhe të qëndrueshme, por provat janë bazë e të gjithë praktikave ligjore në çdo proces gjyqësor.

⁴⁴¹ Kodi i Procedurës Penale Italiane.

⁴⁴² Altin Shegani, "E drejta penale e krahasuar", botim i vitit 1994, fq. 171.

PROVAT DHE PROCESI I TË PROVUARIT NË PROCESIN PENAL

Sistemi anglez⁴⁴³ bën një klasifikim të normave që rregullojnë provën duke i ndarë në:

- *Norma strukturore, që aplikohen për trajtimin e provave në gjyq.*
- *Norma preferenciale, të hartuara për të shmangur provat e cilësisë së dobët në rastet kur disponohen prova me cilësi më të mirë.*
- *Norma analitike, të hartuara për të shmangur përdorimin e provave të dyshimta.*
- *Norma profilaktike, të cilat shmangim përdorimin e provave të cilat nuk janë në gjendje të vlerësojnë objektivisht çështjen.*
- *Norma thjeshtëzuese, që lejojnë përmbledhjen e dokumenteve voluminoze, me qëllim për t'i ardhur në ndihmë jurisë për njohjen e problematikës.*
- *Norma sasiore, të cilat kërkojnë vërtetim.*
- *Norma të bazuara te politika që pengojnë disa fakte provuese bazuar në disa parime politike, si ruajtja e sekretit shtetëror etj.*
- *Norma diskrecionale, të hartuara për të lejuar gjyqtarin të refuzojë normat që rregullojnë provat në interes të drejtësisë.*

Provat klasifikohen në:

- *Prova direkte dhe indirekte. Provat direkte nuk kërkojnë ndonjë proces përpunimi mendor nga ana e gjykatës për arritjen e një konkluzioni, ndërsa indirekte janë ato prova të cilat e bëjnë gjykatën jo vetëm ta pranojë si provë, por dhe të nxjerrë një konkluzion prej saj.*
- *Prova kryesore dhe dytësore. Provë kryesore është dokumenti origjinal apo pohimi nga kundërshtari për përmbajtjen e dokumentit, ndërsa dytësore është kopja e dokumentit e bërë në përputhje me dokumentin origjinal.*
- *Prova të supozuara dhe të pakundërshtueshme. Prova të supozuara apo prima facie janë ato prova që deklarohen të mjaftueshme për të vërtetuar një fakt. Prova të pakundërshtueshme janë ato të cilat barazohen me një normë ligjore dhe asnjë palë nuk mund t'i kundërshtojë.*

Llojet e provave në procesin penal anglez:

- 1- *Provat gojore apo "Dëshmitë" që thuhet gjatë procedimit gjyqësor nga dëshmitarët, deklaratimet e të akuzuarit, pohimet.*
- 2- *Provat dokumentare, të cilat mund të jenë origjinale ose të riprodhura identik me origjinalin.*
- 3- *Provat reale që përfshin të gjitha objektet e paraqitura para gjykatës për verifikim, i cili nxjerr konkluzion nëpërmjet përdorimit të shqisave të saj.*

Këto prova merren nëpërmjet këqyrjes së personave apo objekteve, kaseta, fotografi, filma etj.

Në çështjet penale, gjyqtari ka diskrecionin të refuzojë pranimin e provave mbi të cilat mbështetet akuzë nëse, sipas saj, pranimi i tyre do të kishte efekt dëmtues mbi rregullsinë e procedimeve. E kundërta ndodh me provat e paraqitura nga i akuzuari. Në Common Law është e mirëpërcaktuar se i akuzuari ka të drejtë t'i pranohen të gjitha llojet e provave, pavarësisht paragjykitimit të mundshëm. Në një procedim penal, barra ligjore e provimit të çdo elementi të akuzës dhe të fajësisë së të pandehurit i takon

⁴⁴³ Murfý për provën , botim i vitit 2010.

prokurorisë, i vetmi rast në Common Law, ku i pandehuri ka barrën e provës është mbrojtja për paaftësi mendore⁴⁴⁴.

Prokuroria duhet të përdorë një standard shumë të lartë të barrës së provës me qëllim që të konsiderohen si të pranueshme nga gjykata e ligjit. Ky standard i provës duhet të mbështetet në dy parime thelbësore: ***Përtej çdo dyshimi të arsyeshëm dhe i sigurt për fajësinë.***

*Veçori e sistemit anglez gjatë procedimit penal është dhe paraqitja e provave të personalitetit të mirë dhe personalitetit të keq*⁴⁴⁵. I akuzuari, ashtu sikurse thamë më lart, që ka të drejtë të paraqesë çdo lloj prove për të provuar pafajësinë e tij, i njihet dhe e drejta për të paraqitur prova të personalitetit të tij të mirë, me qëllim për të provuar se kishte pak mundësi që vepra për të cilën akuzohet të jetë kryer prej tij. Në rastin e personalitetit të keq i takon prokurorisë të provojë lidhur me personalitetin e të akuzuarit apo të pandehurit.

Një risi që vlen të krahasohet me legjislacionin shqiptar në përcaktimin e rrethit të provave në procesin penal është dhe fakti që Anglia ka një legjislacion shumë të përparuar dhe lejon dhe marrjen elektronike⁴⁴⁶ e kompjuterike, duke hequr pengesat, të cilat deri më tani kanë penguar pranimin e provave të tilla.

Legjislacioni anglez i ka kushtuar një rëndësi të veçantë dizpozitive që parashikojnë provat dhe fokusohet ***në pranueshmërinë dhe jo në zbulim.*** Sa i përket një hetimi penal, nuk duket se ka ndonjë problem në lidhje me konfiskimin, ekzaminimin dhe prodhimin në gjykatë të çdo pajisjeje apo kompjuteri të përdorur për kryerjen e ndonjë vepre penale.

Miratimi i legjislacionit të tillë si Akti i provave (dispozita të veçanta) nuk mund të jetë i mjaftueshëm për t'u marrë me problemet që dalin nga zhvillimet në teknologji. Është parë gjithashtu e nevojshme që të zhvillohen aftësitë e nevojshme midis hetuesve, ekspertëve të kompjuterëve mjeko-ligjorë, avokatëve dhe gjyqtarëve për t'u marrë me çështjet që dalin nga evidencat elektronike dhe kompjuterike për të siguruar pajisjet dhe infrastrukturën e nevojshme për gjykatat që të përballen me sfidat e ofruara nga kjo fushë e re e provave.

*Shumica e ndjekjeve penale bëhen nga policia, Shërbimi i Prokurorisë së Kurorës dhe autoritetet lokale e të tjera publike. Çdo ndjekje penale e ngritur nga një individ apo organ privat fillon me një kërkesë për gjykatën për të lëshuar një thirrje të pandehurit për të marrë pjesë në gjykatë.*⁴⁴⁷

Aktualisht, kërkesat procedurale të hollësishme për një kërkesë për të lëshuar një thirrje janë të përfshira në praktikën gjyqësore dhe jo në Rregullat e Procedurës Penale.

⁴⁴⁴ M. Murfy, për provën, botim i vitit 2010.

⁴⁴⁵ Murfy, për provën, botim i vitit 2010.

⁴⁴⁶ 49Cf. Neni 7 i Projektligjit për Dëshmi Elektronike, Sekretariati i Komonuelthit - LMM (02) 12 Shih për shembull Seksionet: 29, 68, 112 (1), 116 (3) dhe 124 të Kodit të Procedurës Penale.

⁴⁴⁷ Procedura Penale (Amendamenti nr. 2). Rregullat 2016, S. I. 2016/705, <http://www.bailii.org/w/cases/EWCA/Crim/2017/281.html>.

Neni 127 i Ligjit për Drejtësi Penale 2003 (Dëshmi e Ekspertëve)⁴⁴⁸ parashikon edhe dëshmitarin e ekspertëve. Rregulli 19.4 i Rregullave të Procedurës Penale përcakton që dëshmitari i ekspertit duhet të përfshijë në një raport me shkrim të gjetjeve të veta dhe të mendimit të tij. Sipas raportit duhet të *thotë se kush ka kryer ndonjë provim, matje, test apo eksperiment, të cilin eksperti ka përdorur për raportin, jep kualifikimet, përvojën relevante dhe akreditimin e atij personi, nëse testimi, matja, testimi ose eksperimenti është kryer apo jo nën mbikëqyrjen e ekspertëve dhe përmbledh gjetjet në të cilat eksperti mbështetet*. Kjo korrespondon me Rregullën e njëjtë të Procedurës Civile dhe drejtimin e praktikës.

*Në sistemin e Common Law, gjykata nuk e kërkon dhe as e krijon provën, por kjo është detyrë e organit të akuzës, pasi mbi të bie barra e provës. I akuzuari ka të drejtë të hetojë provat e akuzës nëpërmjet debatit gjyqësor.*⁴⁴⁹

5.3. STUDIMI I LEGJISLACIONIT SIPAS TË DREJTËS PROCEDURIALE PENALE FRANCEZE

Sistemi gjyqësor i Francës ka shërbyer për shekuj me radhë si model ideal dhe në përshtatjen e legjislacionit tonë penal dhe procedural penal. Kodi i Napoleonit është modeli i kodit të parë penal që në kohën e pushtimit otoman. Por jo vetëm për shtetin tonë, për shumë shtete evropiane me të drejtë është quajtur djepi i së drejtës penale evropiane. Kodi i Procedurës Penale Franceze është pasardhës i Kodit të Hetimit Kriminal të vitit 1808 dhe ka karakter të pastër inkuizitor.

Procedura penale franceze udhëhiqet nga *parimi i ligjshmërisë, oportunitetit, i lirisë së provës, prezumimi i pafajësisë, parimi i kontradiktoritetit, të drejtat e mbrojtjes* etj.⁴⁵⁰. Prokuroria, asnjëherë nuk mund të fillojë ndjekjen penale nëse nuk ka një denoncim apo ankesë, si dhe të gjitha provat e mbledhura gjatë hetimit konsiderohen të pranueshme nga gjyqtari nëse nuk vijnë në kundërshtim me etikën e sistemit procedural francez. Palët në një procedim penal gëzojnë të drejtën për t'u dëgjuar drejtpërsëdrejti nga gjyqtarët e çështjes krahas provave të paraqitura dhe të grumbulluara gjatë fazës së hetimit paraprak, si dhe gëzojnë të drejtën për t'u asistuar nga avokati që në fazën e parë të ndalimit.

Kodi i Procedurës Penale, në pjesën hyrëse të tij, e quajtur ndryshe dhe pjesa legjislative, citon parimet themelore mbi bazën e të cilave është hartuar ky kod dhe të cilat janë të detyrueshme për zbatim gjatë zhvillimit të një procesi penal.⁴⁵¹

I. Procedura penale duhet të jetë e drejtë, kontradiktore dhe të ruajë ekuilibrin e të drejtave të palëve. Ai duhet të garantojë ndarjen e autoriteteve përgjegjëse për veprim publik dhe autoriteteve të gjykimit.

Personat në rrethana të ngjashme dhe të ndjekur penalisht për të njëjtat vepra penale duhet gjykohe sipas rregullave të njëjta.

⁴⁴⁸Neni 127 i Ligjit për Drejtësi Penale, 2003 (Dëshmi e Ekspertëve: Puna përgatitore.

⁴⁴⁹ Procedura penale, Halim Islami, Artan Hoxha, Ilir Panda, botim 2010, fq. 18.

⁴⁵⁰ Altin Shegini, "Modeli i procesit të rregullt ligjor në të drejtën franceze".

⁴⁵¹Code de procédure pénale.

II. Autoriteti gjyqësor siguron informacionin dhe garancinë e të drejtave të viktimave gjatë gjithë kohës së procedimit penal.

III. Çdo person i dyshuar ose i akuzuar konsiderohet i pafajshëm derisa të jetë dëshmuar fajtor.

Shkeljet e prezumimit të pafajësisë pengohen, korrigjohen dhe ndëshkohen nën kushtet e parashikuara me ligj.

Në ndryshim nga legjislacionet e tjera, sipas sistemit të drejtësisë franceze organi më i lartë që ushtron të drejtën e ndjekjes penale është **prokurori publik**, ndërsa organi më i lartë i hetimit është **gjyqtari hetues**. Procedimi fillon me paraqitjen zyrtarisht të kërkesës së prokurorit drejtuar gjyqtarit të hetimit paraprak të çështjes. Gjyqtari hetues ka të drejtë të kryejë vetë hetime ose t'ja delegojë këtë policisë gjyqësore. Qëllimet e shqyrtimit para një gjyqtari përfshijnë:

- Vlerësimin nëse ekzistojnë arsye të mjaftueshme ligjore për arrestimin.
- Nëse është i nevojshëm, ndalimi para gjyqimit.
- Ruajtjen e mirëqenies së të ndaluarit.
- Parandalimin e shkeljes së të drejtave të të ndaluarit.⁴⁵²

Palet në procesin penal francez janë: prokurori, i pandehuri dhe viktimat.

Gjetja e provave është objekti dhe detyra kryesore e organit të akuzës publike.

Prokurori publik kryen të gjitha veprimet procedurale dhe kërkon zbatimin e ligjit, në respektimin e parimit paanshmëri, në të cilën ai është i lidhur.

Ai përfaqësohet në çdo gjykatë represive. Ai merr pjesë në debatet e gjykatave gjyqësore, të gjitha vendimet shqiptohen në praninë e tij. Ai siguron ekzekutimin e vendimeve gjyqësore.

Ai kërkohet të bëjë kërkesa me shkrim në përpunje me udhëzimet që i janë dhënë atij të parashikuara në nenet 36, 37 dhe 44 të KPPF⁴⁵³. Ai zhvillon lirshëm vëzhgimet gojore që ai beson të përshtatshme për të mirën e drejtësisë.

Një krim ose një vepër flagrante përkufizohet si vepër penale që momentalisht po kryhet ose ka qëllim për t'u kryer. Ekziston gjithashtu një krim i paligjshëm ose një vepër penale kur, në një kohë shumë afër veprimit, personi dyshohet ose gjendet në posedim të sendeve ose gjurmëve, të cilat të krijojnë bindjen se ka marrë pjesë në kryerjen e veprës penale, krim ose kundërvajtje.

Pas gjetjes së një krimi apo një shkelje flagrante, hetimi kryhet nën kontrollin e prokurorit të Republikës, në kushtet e parashikuara në këtë kod mund të vazhdojnë pa ndërprerje për një periudhë prej tetë ditësh.

Në rast të një krimi flagrant, zyrtari i policisë gjyqësore, i cili ka detyrimin, do të informojë menjëherë prokurorin, duhet të shkojë pa vonesë në vendin e krimit dhe të bëjë të gjitha verifikimet e dobishme.

Siguron ruajtjen e të dhënave që mund të zhduken dhe gjithçka që mund të përdoret për zbardhjen e së vërtetës. Sekuestron armët dhe instrumentet që përdoren për të kryer

⁴⁵² Dr. Altin Shegini, Evisa Kambellari Sajmir Fekolli, "Modeli i procesit të rregullt ligjor në të drejtën franceze", fq. 76. Botim i departamentit të së drejtës publike të Fakultetit të Drejtësisë - UT.

⁴⁵³Code de procédure pénal.

krimin ose që ishin me qëllim për të kryer atë, si dhe çdo gjë që duket të ketë qenë produkt i drejtpërdrejtë ose i tërthortë i atij krimi. Ai paraqet objektet e konfiskuara, për njohtë, personave që duket se kanë marrë pjesë në krim, nëse ata janë të pranishëm.

Nëse natyra e krimit është e tillë, që dëshmia mund të merret me sekuestrimin e dokumenteve, të dhëna kompjuterike ose objekte të tjera në posedim të personave që duket se kanë marrë pjesë në krim, posedimi i dokumenteve, informacionit ose objekteve që lidhen me faktet e inkriminuara, zyrtari i policisë gjyqësore ka të drejtë të shkojë në vendbanimin e këtij të fundit për të kryer një kërkim të detajuar të këtyre provave.

Gjithashtu, zyrtari i policisë gjyqësore mund të udhëtojë në çdo vend, me qëllim që të kërkojë dhe konfiskojë pasurinë, konfiskimi i të cilave është parashikuar në nenin 131-21 të Kodit Penal. Për qëllimin e sekuestrimit të një pasurie të tillë, ai duhet të autorizohet paraprakisht nga prokurori publik.

Të gjitha objektet dhe dokumentet e sekuestruara menjëherë inventarizohen dhe vendosen nën vulë. Megjithatë, nëse inventarizimi i tyre në terren paraqet vështirësi, ato u nënshtrohen vulave të mbyllura përkohësisht, deri në momentin e inventarit të tyre përfundimtar dhe nënshkrimin në prani të personave që morën pjesë në mbledhjen e këtyre provave sipas nenit 57.

Të dhënat kompjuterike të nevojshme për manifestimin e së vërtetës - bëhet marrja fizike e këtyre të dhënave, ose një kopje e bërë në prani të personave të cilët ndjekin kërkimin.

Me pëlqimin e prokurorit publik, zyrtari i policisë gjyqësore mban vetëm sekuestrimin e objekteve, dokumente dhe të dhëna kompjuterike të dobishme për shfaqjen e së vërtetës, si dhe mallrat, konfiskimi i të cilëve është parashikuar në Nenin 131-21 të Kodit Penal.⁴⁵⁴

Prokurori publik, gjithashtu, mundet, aty ku konfiskimi ka të bëjë me para të gatshme, shufra, efekte ose vlerat, ruajtja e të cilave në natyrë nuk është e domosdoshme për shfaqjen e së vërtetës apo ruajtjen, të drejtat e personave të interesuar, autorizojnë depozitimin e tyre në depozitat e çështjeve dhe në dërgimin e tyre Banque de France, ose një llogari të hapur me një institucion bankar nga agjencia e menaxhimit dhe rikuperimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara.

Kur sekuestrimi ka të bëjë me kartëmonedha ose monedha të falsifikuara euro, oficeri i policisë gjyqësore duhet të transmetojë, për analizë dhe identifikim, së paku një kopje të çdo lloji kartëmonedhe apo monedhe të falsifikuara të dyshuara në Qendrën Kombëtare të Analizës të autorizuar për këtë qëllim.

Si mjete të kërkimit të provës, Kodi i Procedurë Penale Franceze ka parashikuar dhe kontrollin në zyrën e një avokati në ambientet e një kompanie të gazetave, një kompani komunikimi industrial-audiovizuale, një kompani e komunikimit publik në internet, një agjenci lajmesh në automjetet profesionale të këtyre kompanive apo agjencive, ose në shtëpinë e një gazetari, kur hetimet kanë të bëjnë me veprimtarinë e tij profesionale. Këto kërkime kryhen me vendim të shkruar dhe të motivuar të gjyqtarit, i cili tregon

⁴⁵⁴ Kodi Penal Francez.

natyrën e veprës ose veprave penale që do të hetohen, si dhe arsyet për të cilin bëhet ky hetim dhe objektin e saj.

Kur një kërkim është parashikuar në një vend të saktë të identifikuar, duke strehuar elemente të mbuluara nga fshehtësia e mbrojtjes kombëtare, kërkimi mund të kryhet vetëm nga një gjyqtar në praninë e Kryetarit të Komitetit Këshillëdhënës për Sekretin e Mbrojtjes Kombëtare.

Prokurori publik ose zyrtari i policisë gjyqësore mundet, në çdo mënyrë, t'i kërkojë çdo personi, çdo institucioni apo organi privat apo publik, ose i ndonjë administrate publike që ka të ngjarë të ketë informata relevante për hetimin, duke përfshirë informacionin nga përpunimi i të dhënave, ose përpunimin e të dhënave personale, për t'i dhënë atij këtë informacion, në veçanti në formë numerike, pa qenë në gjendje ta kundërshtojë atë, pa arsye të ligjshme, detyrimin ndaj sekretit profesional.

Nga prodhimi dhe diskutimi i provave gjatë procedurës së gjykimit, kryetari i seancës urdhëron dëshmitarët të dalin në seancë publike për të dhënë dëshminë e tyre.

Kur një dëshmitar i cituar nuk paraqitet, gjykata mund të kërkojë, me kërkesë të prokurorit publik ose edhe *ex officio*, të urdhërojë që ky dëshmitar të sillet menjëherë nga forca publike përpara gjykatës për t'u dëgjuar, ose ta dëgjojë rastin përsëri në seancën tjetër.

Dëshmitarët dëshmojnë vetëm për faktet e pretenduara kundër të akuzuarit, për personalitetin e tij dhe për moralin.

*Në praktikën procedurale franceze, precedenti nuk mund të luajë një rol shumë të madh. Megjithatë, vendimet gjyqësore, veçanërisht ato të sektorit penal të Gjykatës së Kazacionit, luajnë një rol të rëndësishëm në procedurën penale.*⁴⁵⁵

Në seksionin e dytë të Kodit të Procedurës Penale Franceze⁴⁵⁶ trajtohen edhe përgjimet, nenet 100-110/7, të cilat parashikojnë përgjimin si mjet të kërkimit të provës me emërtimin "kapia e korrespondencës me anë të telekomunikacionit".

Në këtë nënseksion përfshihet vetëm një lloj përgjimi: Kapia e korrespondencës vetëm me anë të telekomunikacionit. Pra, të gjitha mjetet për realizimin e kapjeve, përsihen në telekomunikacione dhe nuk përcaktohen mjetet e përgjimit. Gjithashtu, nuk specifikohen llojet e kapjeve dhe mënyrat e përgjimit, si dhe vendet në të cilat do të kryhet përgjimi. Gjithçka përfshihet brenda termit "korrespondencë".

Në Kodin e Procedurës Penale Franceze përcaktohet se gjyqtari i hetimeve, kur është e nevojshme, urdhëron kapjen, regjistrimin dhe transkriptimin e korrespondencës së telekomunikimeve. Përgjimi sipas këtij Kodi lejohet për ato vepra penale që parashikohet dënim prej ose mbi 2 vjet burg, që është shumë më poshtë se kufiri prej 7 vjet burg, i cili parashikohet në Kodin e Procedurës Penale Shqiptare, çka do të thotë se Procedura Penale Franceze përcakton kufij shumë më të ulët garancie dhe mbrojtje të të drejtave të njeriut dhe se i jepet më tepër rëndësi mbrojtjes së interesit të përgjithshëm sesa interesit personal. Është gjyqtari i hetimeve ai që ka autoritetin për të vendosur për natyrën dhe shkallën e rëndësisë së veprës penale për të cilën

⁴⁵⁵ Dr. Altin Shegani, "E drejta penale e krahasuar", fq. 138.

⁴⁵⁶ Kodi i Procedurës Penale Franceze.

PROVAT DHE PROCESI I TË PROVUARIT NË PROCESIN PENAL

procedohet, ndërsa për prokurorin në nënseksionin e përgjimeve nuk përmendet e drejta për autorizimin e përgjimit, qoftë edhe në rastet e urgjencës.

Në vendimin autorizues të përgjimit përfshihen hollësi identifikuese, si kapja (përgjimi), vepra penale që justifikon përdorimin e përgjimit, si dhe kohëzgjatjen e përgjimit. Vendimi autorizues që lëshon gjyqtari i hetimeve jepet për një periudhë në maksimum prej 4 muajsh. Ky vendim mund të lëshohet edhe për zgjatjen e afatit të përgjimit, kur vazhdojnë të njëjtat kushte. Për të vënë në jetë këtë vendim, gjyqtari i hetimeve ose oficeri i policisë gjyqësore, i caktuar prej tij, mund të urdhërojë një agjent shërbimi, ose të një institucioni nën autoritetin, ose kontrollin e ministrisë që mbulon telekomunikacionin, ose operator i specializuar në këtë fushë për të përdorur pajisjet teknike specifike.

Gjyqtari i hetimeve ose oficeri i policisë gjyqësore, i caktuar prej tij, harton një procesverbal të kapjeve dhe të veprimeve të regjistrimit. Procesverbali përmban ditën dhe orën kur fillojnë e mbarojnë veprimet. Regjistrimet ruhen të mbyllura me vula. Në lidhje me transkriptimin, gjyqtari i hetimeve ose oficeri i policisë gjyqësore i caktuar prej tij, transkripton çdo korrespondencë, e cila është e dobishme (me vlerë) për zbulimin e të vërtetës. Për këtë transkriptim mbahet një procesverbal. Procesverbali futet në dosje.

Ndërsa kur korrespondenca është në gjuhë të huaj, transkribohet në frëngjisht me ndihmën e një përkthyesi të caktuar për këtë qëllim. Në mbarim të afatit të hetimeve, regjistrimet e papërdorshme ose të panevojshme asgjësohen me kërkesë të prokurorit të rrethit ose të prokurorit të përgjithshëm. Për asgjësimin e regjistrimeve mbahet procesverbal. Për sa i përket ndalimeve të përgjimeve përcaktohet një kategori personash për të cilët, për shkak të profesionit e detyrave që kryejnë, me një natyrë specifike, kërkohet autorizim i veçantë. Kështu gjyqtari nuk mund të autorizojë asnjë përgjim me linja telefonike:

- *Për anëtarët ose senatorët e parlamentit pa lejen e kryetarit të parlamentit.*
- *Në zyrat ose vendbanimin e avokatit pa lejen e kryetarit të dhomës së avokatëve.*
- *Në zyrat dhe vendbanimin e gjyqtarit ose prokurorit pa lejen e kryetarit të gjykatës ose prokurorit të përgjithshëm.*

5.4. STUDIMI I LEGJISLACIONIT SIPAS TË DREJTËS PROCEDURIALE PENALE KOSOVARE MBI PROVAT DHE PROCESIN E TË PROVUARIT

Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës⁴⁵⁷ me dispozitat e tij ka bërë një lëvizje përpara në të gjitha fazat e procedurës penale, si: roli prokurorit të shtetit në hetim; masat e fshehta dhe teknike të hetimit dhe vëzhgimit; marrëveshja për pranimin e fajësisë; transformimi i shqyrtimit gjyqësor në pajtim me eksperiencat e sistemit adversial; forcimi i rolit të palëve në marrjen e provave; pyetja kryqëzore etj.

Procesi i të provuarit në procedurën penale kosovare konsiston në kërkimin dhe kostatimin e së vërtetës, e cila është dhe motoja e të gjitha veprimeve që ndërmarrin

⁴⁵⁷ Prof. dr. sc. Ejup Sahiti / Prof. dr. sc. Rexhep Murati /Mr. Xhevdet Elshani - Komentari, Kodi i Procedurës Penale.

organet proceduese. Kjo nënkupton vërtetimin e plotë të të gjitha fakteve relevante juridike, nga e cila varet dhe zbatimi i së drejtës penale materiale.

Procesi i të provuarit zë një vend kryesor në procedurë dhe, si e tillë, legjislativi procedural penal kosovar ka përcaktuar rregulla të qarta rreth paraqitjes, fiksimit dhe përdorimit të provave për vërtetimin e fakteve⁴⁵⁸.

Sipas procedurës penale kosovare bëhet dallimi ndërmjet faktit dhe provës-argumentimit.

Nocioni fakt ka kuptimin e ndonjë ngjarje, ndodhi apo send konkret, të cilat duhen vërtetuar gjatë procesit penal. Kjo detyrë i përket organeve proceduese dhe gjykatave. Ndryshe këto quhen fakte juridike ose relevante. Faktet vërtetohen me prova.

Ndërsa me nocionin provë-argument në procedurë penale nënkupohet çdo e dhënë, e cila në një procedurë gjyqësore flet për saktësinë e ndonjë fakti relevant. Provat merren gjatë fazës së hetimeve dhe në shqyrtimin gjyqësor. Gjykata ka për detyrë që të vlerësojë me ndërgjegje çdo provë një nga një dhe, në lidhje me provat e tjera dhe në bazë të vlerësimit të tillë, të nxjerrë konkluzionin nëse është provuar një fakt.⁴⁵⁹

Si burime të provës, në KPPK⁴⁶⁰ paraqiten: 1. Personat (I pandehuri, dëshmitari), eksperti, të cilët, nëpërmjet dëshmiave dhe deklaratimeve të tyre kanë krijuar prova rreth një fakti; 2. sende (shkresa, gjurmë, shirit magnetik dhe objekte të ndryshme); 3. veprime të tjera të ndryshme (marrja në pyetje, tortura, këqyrja etj.).

Provat në procesin penal kosovar klasifikohen në:

1. Prova akuzuese dhe mbrojtëse, të tilla konsiderohen provat që janë në favor të palës akuzuese ose në favor të mbrojtjes së të pandehurit.

2. Prova të drejtpërdrejta dhe të tërthorta. Provë e drejtpërdrejtë konsiderohet ajo e cila provon ekzistencën ose jo të faktit kontestues. Ndërsa prova e tërthortë, e quajtur ndryshe indicie, ndihmon në vërtetimin e faktit.⁴⁶¹ Provat indirekte njihen ndryshe dhe si material provues, të cilat shpeshherë paraqiten dhe si prova të vetme për zbulimin e çështjes penale. Dallimi ndërmjet provave direkte dhe indirekte bëhet në raport me faktin juridik për të cilin kërkohet kjo provë. Provat indirekte normal që paraqesin më shumë vështirësi, pasi ato i nënshtrohen veprimtarisë mendore të konkludimit nga ana e gjyqtarit, duke sqaruar jo vetëm saktësinë e tyre, por dhe lidhjen me faktin juridik. Si të tilla, ato duhet të jenë aq të besueshme sa të përjashtojnë çdo alternativë tjetër, por gjithsesi, një provë indirekte e vetme, e pashoqëruar me prova të tjera nuk mund të shërbejë si bazë e fortë ligjore për vërtetimin e fajësisë së të pandehurit për veprën penale për të cilën akuzohet.

Procesi penal i të provuarit për vërtetimin e faktit kalon në një zinxhir veprimesh procedurale, si faza e marrjes së provës, shqyrtimi dhe verifikimi i saj, si dhe çmuarja e provave.

Marrja e provës: nënkupton gjetjen dhe fiksimin procedural të tyre. Fiksimi procedural bëhet pasi të jetë zbuluar prova nëpërmjet pasqyrit me shkrim të tyre në

⁴⁵⁸ Ejup Sahiti, "E drejta procedurale penale".

⁴⁵⁹ Prof. dr. sc. Ejup Sahiti / Prof. dr. sc. Rexhep Murati / Mr. Xhevdet Elshani - Komentar, Kodi i Procedurës Penale.

⁴⁶⁰ Kodi i Procedurës Penale Kosovare.

⁴⁶¹ Ejup Sahiti dhe Rexhep Murati, "E drejta procedurale penale".

një dokument zyrtar (procesverbal), një mënyre e re e fiksimit të provave, me zhvillimet e teknikës konsiston dhe në regjistrimin me audioincizim apo vizual të momentit të marrjes së provës. Marrja e provave mund të bëhet jo vetëm gjatë procesit, por dhe gjatë fazës së hetimeve paraprake nga prokurori dhe policia gjyqësore. Pas fillimit të hetimit, prokurori i shtetit procedon provat me vetiniciativë, urdhëron zbatimin e masave të fshehta dhe teknike të hetimit dhe vëzhgimit. Sipas kërkesës së të pandehurit ose të mbrojtësit të tij prokurori i shtetit merr ose ruan provat shfajësuese dhe, sipas kërkesës së të dëmtuarit, merr ose ruan provat që do të tregonin dëmin e shkaktuar nga vepra penale.⁴⁶²

Por, legjislati kosovar ka parashikuar dhe një mënyrë tjetër të marrjes së provës, siç është instituti i “sigurimit të provës”.⁴⁶³ Në ndryshim nga procesi i marrjes së provave gjatë fazës së hetimit paraprak, sigurimi i provës merret drejtpërdrejt nga gjyqtari gjatë gjykimit të çështjes.

Shqyrtimi i provës: procesi i shqyrtimit të provës gjendet i trajtur në dispozitat e KPPK-së, nenet: 150, 311, 350 etj. Kjo fazë paraqet rëndësi të madhe provuese, pasi, nëpërmjet tyre arrihet në vërtetimin e fakteve relevante në procedurë penale. Sikurse është normuar në dispozitat e KPPK-së, që prokurori ushtron të drejtën e ndjekjes penale, si dhe e drejta e palëve për t’u mbrojtur duke provuar, shqyrtimi i provës në proces bëhet duke hulumtuar dhe analizuar përmbajtjen e se cilës provë, përcaktimin e raportit të saj me faktin juridik të kontestuar.

Çmuarja e provave: faza e fundit, por jo më pak e rëndësishme për nga pikëpamja procedurale paraqet çmuarja e provave. Ndërsa mbledhja dhe verifikimi i provave paraqet anën e jashtme të procesit penal të të provuarit, çmuarja e tyre është një proces operimi mendor, logjik, e cila merret me studimin e ligjshmërive rreth formimit të vetëdijes së personave pjesëmarrës procedural, e cila paraqet dhe anën e brendshme të këtij procesi. Në të drejtën procedurale kosovare, çmuarja e provave bëhet sipas teorisë progresive. Është detyrë e gjykatës që me ndërgjegje, bazuar në parimin e bindjes së gjyqtarit, të bëjë vlerësimin një nga një të të gjitha provave, si dhe në harmoni me njëra-tjetrën dhe në bazë të vlerësimit të arrijë në konkluzionin nëse është vërtetuar ose jo një fakt juridik.

Si provë në procedurën penale kosovare paraqiten: *deklarimi i të pandehurit, dëshmia e dëshmitarit, deklarimi i ekspertit, të dhënat që i përmbajnë shkresat, regjistrimet e fituara nëpërmjet incizimit teknik, sendet, si dhe indiciet.*

Për sa i përket deklarimit të të pandehurit dhënë policisë ose prokurorit të shtetit, ai mund të jetë provë e pranueshme në gjykatë vetëm kur është marrë në pajtim me dispozitat e nenit 73, parag. 1, nenit 131 ose 132 dhe në pajtim me nenet 151 deri 155. Deklarimet e tilla mund të përdoren për ta kundërshtuar deklarinin e të pandehurit në gjyq ose si provë e drejtpërdrejtë në pajtim me nenin 262, parag. 2 (neni 261, parag. 1). Deklaratat e dhëna nga i pandehuri në çfarëdo konteksti, nëse janë dhënë në mënyrë vullnetare dhe pa shtrëngim, janë prova të pranueshme gjatë shqyrtimit kryesor kundër

⁴⁶² Prof. dr. sc. Ejup Sahiti / Prof. dr. sc. Rexhep Murati / Mr. Xhevdet Elshani - Komentar, Kodi i Procedurës Penale.

⁴⁶³ Dhimitër Lara, Koment mbi Kodin e Procedurës Penale, botimi 2010.

të pandehurit, por jo edhe kundër të bashkëpandehurve. Deklaratat e tilla nuk mund të shërbejnë si provë e vetme fajësuese apo vendimtare për dënimin e të pandehurit (neni 123, paragraf. 5). Neni 123 i KPP-së rregullon çështjen e marrjes në pyetje (intervistimit), çështjen e marrjes së deklaratës në procedurë paraprake 493 dhe çështjen e mundësisë hetuese të veçantë, të cilat, sipas nenit 261, paragrafët 2, 3 dhe 4, mund të përdoren si provë në shqyrtim kryesor si vijon: - Provat e siguruar nëpërmjet marrjes në pyetje (intervistimit) në procedurë paraprake, në shqyrtimin kryesor mund të përdoren gjatë marrjes së tërthortë në pyetje për vënien në dyshim të dëshmitarëve nëse dëshmitari ka dëshmuar ndryshe nga dëshmia e dhënë gjatë intervistimit në procedurë paraprake. - Deklarata e siguruar gjatë procedurës paraprake pranohet gjatë shqyrtimit kryesor për marrjen e tërthortë në pyetje të dëshmitarit të njëjtë dhe mund të përdoret si provë e drejtpërdrejtë gjatë shqyrtimit kryesor nëse dëshmitari nuk është në dispozicion për shkak të vdekjes, sëmundjes, privilegjeve apo mungesës së pranisë së tij në Kosovë, por nuk mund të përdoret si provë e vetme apo vendimtare fajësuese për dënimin e të pandehurit.

Dëshmia e dëshmitarit: Me qëllim që të realizohet detyra themelore, organet procedurale mund të mbledhin informacione nga personat që janë në gjendje t'i ofrojnë të dhënat e caktuara, informatat dhe provat për veprën penale dhe kryerësin e saj. Dëshmia është deklarimi i personit fizik lidhur me perceptimet shqisore për fakte të rëndësishme që lidhen me veprën penale, autorin e saj apo rrethana të tjera⁴⁶⁴. Në KPPK gjejmë të përcaktuar nocionet e dëshmitarit të privilegjuar, i cili, për shkak të profesionit, nuk mund të deklarojë të dhëna që lidhen me të pandehurin dhe dëshmitar të liruar, të cilët janë rrethi i atyre personave që, për shkak të lidhjes së gjakut apo gjinisë, nuk janë të detyruar për të dhënë dëshmi.

Gjithashtu, kemi një ndarje në dëshmitar okular, dëshmitar dëgjimi, dëshmitar bashkëpunues. Njohja e personit ose e sendit është veprim hetimor dhe veprim kriminalistik. Ajo mund të realizohet drejtpërdrejt, duke i treguar dëshmitarit personin e dyshuar së bashku me persona të tjerë, të cilët nuk kanë lidhje me veprën penale apo sendin që ka lidhje me veprën penale (sendi është fituar me vepër penale ose është përdorur për kryerje të veprës penale, këtu nuk është fjala për sende të humbura) së bashku me sendet e tjera. Konform me nenin 120, njohja mund të bëhet edhe në mënyrë të tërthortë nëpërmjet fotografisë.⁴⁶⁵

Ekspertimi: kjo lloj prove, ashtu si dhe në legjislacionin tonë procedural, kërkohet në raste kur gjykatës i nevojiten njohuri të posaçme në fusha të caktuara, të cilat, ai si jurist, nuk i zotëron. Eksperti caktohet nga gjykata me kërkesë të palëve në procesin penal, i cili është i detyruar të paraqesi mendimin e tij profesional me shkrim. Llojet e ekspertimit janë: *ekspertim medicinal gjyqësor, që ka të bëjë me vërtetimin e shkakut të vdekjes apo lëndimit trupor, si dhe gjendjes fizike të individit. Ekspertimi toksikologjik*

⁴⁶⁴ Ejup Sahiti, "E dr. procedurale penale".

⁴⁶⁵ Prof. dr. sc. Ejup Sahiti / Prof. dr. sc. Rexhep Murati /Mr. Xhevdet Elshani - Komentari, Kodi i Procedurës Penale.

*kur dyshohet për helmin dhe kërkohet kryerja e analizave, ekspertim psikiatrik, ekspertimi molekular gjenetik dhe analizat e ADN-së dhe kontrolli financiar.*⁴⁶⁶

Rëndësi, për nga pikëpamja procedurale e vërtetimit të faktit juridik, paraqesin dhe provat materiale, të cilat tashmë, sikurse e kemi cituar dhe më lart, e kanë zgjeruar rrethin e tyre me përparimin e teknologjisë. Si të tilla paraqiten dokumente dhe shkresa të ndryshme të marra në formën e kërkuar nga ligji, objekte apo sende fizike, regjistrimet teknike, ku bëjnë pjesë fotografia, filmimi, incizimi magnetofik, videofonik, magnetoskopik etj.

Mjete të kërkimit të provës parashikohen: Këqyrja dhe rikonstruksioni, kontrollet, sekuestrot e provës, përgjimet. Këto mjete të kërkimit të provës në procesin penal të të provuarit shërbejnë për të vërtetuar saktë dhe me objektivitet rrethanat materiale, të cilat kanë të bëjnë me veprën penale.

Gjykata ka autorizim të pranojë dhe të marrë çdo provë të pranueshme, të cilën e konsideron të nevojshme për procedurë penale konkrete. Përcaktimin për provat që do të procedohen, gjyqtari e bën në bazë të propozimit të palëve ose sipas detyrës zyrtare. Gjykata mund të ndalojë marrjen e provave kur:

a) marrja e provës së tillë për të plotësuar procesin e të provuarit është e panevojshme dhe e tepërt, meqë çështja është sqaruar mjaftueshëm;

b) fakti që synohet të provohet është i parëndësishëm për vendimin apo ai tanimë është provuar;

c) prova është tërësisht e papërshtatshme, e pamundshme ose e paarrtshme dhe

ç) kërkesa bëhet për të zgjatur procedurën.

Përveç që mund të ndalojë marrjen e provës së caktuar, sipas paragrafit 3, gjykata mund edhe të përjashtojë provën (nëse ajo është marrë).

Neni 262 i KPPK-së përcakton se: *gjykata nuk e shpall të akuzuarin fajtor duke i dhënë rëndësi vendimtare një dëshmie apo një prove, e cila nuk mund të kundërshtohet nga i pandehuri ose mbrojtësi përmes marrjes në pyetje gjatë ndonjë faze të procedurës penale.*

⁴⁶⁶ Ejup Sahiti, Rexhep Murati "E dr. procedurale penale".

KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Në përfundim të këtij punimi doja të nënvizoja se, në respektim të qëllimit kryesor dhe më të rëndësishëm që karakterizon legjislacionin penal, që është konstatimi dhe zbulimi i të vërtetës, vlerësojmë se është e nevojshme që K. Pr. Penale të ndryshohet apo pasurohet në disa dispozita të caktuara.

Kështu, **së pari**, mendoj se është e nevojshme të specifikohet detyrimi që duhet të ketë prokurori në përpilimin dhe mbajtjen e procesverbalit të këqyrjes së vendit të ngjarjes. Sipas vlerësimit tonë, këqyrja e vendit të ngjarjes përbën fazën më të rëndësishme hetimore, në të cilin jo vetëm bëhet fiksimi i të gjithë elementeve të provës që konstatohen në vendngjarje nga organi i akuzës, por gjithashtu arrihet të rindërtohen rrethanat e faktit juridik penal të ndodhur. Për këtë arsye, në kushtet që është një veprim procedural, në vlerësimin tonë i papërsëritshëm, mendojmë se duhet të jetë një tagër (i paderogueshëm) i prokurorit.

Në këtë drejtim duhet theksuar se, në mungesë të ndërhyrjes në Kodin e Procedurës Penale duhet ndërhyrë tek Ligji për Policinë Gjyqësore, pasi sistemi i hetimit paraprak nëpërmjet Policisë së Shtetit dhe jo seksioneve të veçanta të hetimit pranë kësaj strukture, në përputhje me policinë gjyqësore, ka pasjellë dhe do të passjellë pasoja negative në drejtim të sigurimit të provave dhe marrjes së tyre konform normave procedurale.

Së dyti, mendojmë se është e nevojshme që në Kodin e Procedurës Penale të mos jetë më kompetencë e prokurorit për të disponuar me vendim mosfillimi procedimi, pushim procedimi ose pushim çështje, por të jetë kompetencë e gjykatës. Ky mendim lind duke vlerësuar problematikën që haset shpeshherë në praktikë me abuzimin e organit të akuzës me të drejtën për të disponuar me vendim, duke zvarritur në këtë mënyrë procedimet. Caktimi i një gjyqtari që të kontrollojë veprimet proceduralo-hetimore të organit të akuzës lind gjithashtu dhe si nevojë e respektimit të parimit “prova formohet në gjykatë”, karakteristikë e sistemit akuzator. Gjithashtu, kryerja e një praktike të tillë passjell edhe mungesën e zvarritjeve si rezultat i ankimeve të palëve ndaj vendimeve të dhëna në këtë fazë nga prokurori, kohëzgjatjen e procesit, rrezikimin e humbjes së efektivitetit të zbatimit të ligjit penal, si dhe në mjaft raste edhe mundësinë e vënies në rrezik të provave dhe rëndësisë së tyre, p.sh., vendim mosfillimi i prokurorit për një vepër çfarëdo, që kundërshtohet në gjykatë nga kallëzuesi. Gjykata e Rrethit Gjyqësor vendos të regjistrohët procedimi penal dhe më pas të kryhen hetime në drejtimet që ajo përcakton. Prokurori e ankimon dhe Gjykata e Apelit vendos që të lihet në fuqi vendimi i prokurorit. Kallëzuesi bën rekurs dhe Gjykata e Lartë vendos lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor.

Së treti, mendojmë se është e nevojshme të saktësohen, me qëllim që të klasifikohen dhe përcaktimet e bëra nga legjislatori në nenin 149 të K. Pr. Penale dhe në nenin 149/2 të K. Pr. Penale. Vlerësojmë se parashikimi i nenit 149 i K. Pr. Penale: *Në përputhje me rregullat e caktuara në ligj, është një parashikim shterues dhe bie në kundërshtim me parashikimin e nenit 149/2 të K. Pr. Penale që parashikon se: Kur kërkohet një provë që nuk rregullohet me ligj, gjykata mund ta marrë në qofitë se ajo vlen për të vërtetuar*

faktet dhe nuk cenon lirinë e vullnetit të personit. Gjykata vendos për marrjen e provës pasi dëgjon palët mbi mënyrën e marrjes së saj.

Së katërti, vlerësojmë, edhe pse në praktikën gjyqësore qëndrimi tashmë është i konsoliduar, se është e nevojshme që në K. Pr. Penale të përcaktohet më saktë momenti procedural i kërkesës së palëve për marrjen e provës. Neni 355 i K. Pr. Penale parashikon se gjykata, pasi kryen veprimet procedurale të parashikuara nga neni 354 i K. Pr. Penale, deklaron të hapur shqyrtimin gjyqësor. Neni 356 parashikon se, pasi shqyrtimi gjyqësor deklarohet i hapur nga gjykata sipas radhës, prokurori dhe i pandehuri parashitrojnë rrethanat e faktit të pretenduara dhe kërkojnë marrjen e provës. Ndërsa neni 359 i K. Pr. Penale përcakton se hetimi gjyqësor fillon me marrjen e provave të kërkuara nga prokurori ose i dëmtuari akuzues dhe vazhdon me marrjen e atyre që kërkohen nga i pandehuri, mbrojtësi dhe palët e tjera. Nga parashikimet e këtyre tri dispozitave është e paqartë nëse kërkesa për prova ose për deklarimin e papërdorshëm të tyre nga palët, proceduralisht kërkohet para ose pas deklarimit të hapur të shqyrtimit gjyqësor nga gjykata. Tashmë, një fazë e rëndësishme është seanca paraprake, ku këto kërkesa gjejnë zgjidhje, ndërkohë që në gjykimin, në themel të çështjes, përsëri i lind e drejta palëve që të bëjnë një kërkesë të tillë. Kjo logjikë përforcohet edhe nga praktika e rasteve konkrete kur, edhe pse është vendosur mospranimi i kërkesës për gjykimin e shkurtuar, para hapjes së hetimit gjyqësor, vendos përsëri mbi kërkesën e palës që të procedojë me gjykimin e posaçëm të shkurtuar, pasi shikon që nga kërkesat e palëve dhe vendimi i saj për marrjen e provave nuk ka prova të reja veç atyre që janë përfshirë në fashikull.

Së pesti, në vlerësimin tonë është i nevojshëm ndryshimi dhe saktësimi i përcaktimit të bërë nga legjislatori në nenin 369/3 të K. Pr. Penale, në të cilin parashikohet se:

Leximi i deklarimeve të bëra nga shtetasi shqiptar ose i huaj, banues jashtë shtetit, mund të bëhet në qoftë se ai është thirrur dhe nuk është paraqitur, ose kur nuk gjendet, me gjithë kërkimet e bëra nga policia gjyqësore, si dhe kur refuzon të dëshmojë. Në këtë rast, akti vlerësohet duke u lidhur me provat e tjera.

Ky parashikim aktual i pikës 3 të kësaj dispozite të K. Pr. Penale bie ndesh me qëndrimin e mbajtur nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut në vendimin që i përket çështjes “*Breukhoven kundër Republikës Çeke*”, Nr. 44438/06, datë 21.07.2011, GJEDNJ, ku, ndër të tjera, është shprehur se:

Sipas jurisprudencës së krijuar nga gjykata, të gjitha provat duhet të merren në një seancë publike, në prani të të akuzuarit, me qëllim të mundësisë së kundërshtimit të tyre. Ka përjashtime nga ky parim, por ato nuk duhet të shkelin të drejtat e mbrojtjes, që, sipas rregullit të përgjithshëm, të përcaktuar në paragrafët 1 dhe 3 (d) të nenit 6, kërkojnë që të pandehurit t’i jepet një mundësi e përshtatshme dhe e duhur, për të paraqitur kundërshtimet e rastit dhe për t’i bërë pyetje dëshmitarit, si në fazën e deklarimeve ose në një fazë të mëvonshme. Në veçanti, të drejtat e mbrojtjes kufizohen, në një masë që është në kundërshtim me kërkesat e nenit 6, nëse dënimi është i bazuar vetëm, ose në një mënyrë vendimtare, në deklaratim e një dëshmitari, për të cilat i akuzuari nuk ka pasur mundësi të vijë, në dijeni, dhe t’i kundërshtojë gjatë hetimit ose gjykimin (A. M. kundër Italisë, 1999).

PROVAT DHE PROCESI I TË PROVUARIT NË PROCESIN PENAL

Në vazhdim të qëndrimit të saj, GJEDNJ-ja:... *arrin në përfundimin se gjykatat vendase e bazuan dënimin e kërkuesit për trafikimin, vetëm në dëshminë e dëshmitarëve, të cilët nuk paraqiten në gjyq dhe, ndaj të cilëve, as kërkuesi, as avokati i tij nuk kishin pasur mundësinë t'i pyesnin, në çdo fazë tjetër të procedimit...*

Në vendimin që i përket çështjes “Balliu kundër Shqipërisë”, nr.74727/01, datë 30.11.2005, midis të tjerave, GJEDNJ-ja ka treguar standardet e vendosura në mbrojtje të prezumimit të pafajësisë. Kështu:

Gjykata rithekson se pranimi i provave rregullohet kryesisht nga rregullat e legjislacionit të brendshëm dhe se, si rregull, janë gjykatat kombëtare që duhet të vlerësojnë provat para tyre. Detyra e institucioneve të Konventës është të sigurojë që procesi, në tërësinë e tij, përfshirë dhe mënyrën se si janë marrë provat, të ketë qenë i rregullt. Si rregull, këto të drejta kërkojnë që të akuzuarit t'i jepet mundësia e nevojshme dhe e përshtatshme për të kundërshtuar dhe pyetur një dëshmitar kundër tij, qoftë në momentin kur ai bën deklaratat, ose dhe në një fazë të mëvonshme të procedimeve (Gjithashtu, dhe Saïdi vs Francë, vendim i 20 shtatorit 1993)...

Duke i konsideruar arritjet e GJEDNJ-së në praktikën e cituar, me vlera të jurisprudencës, mendojmë se administrimi në cilësinë e provës, i deklarimeve të dhëna gjatë fazës së hetimeve paraprake, në përputhje me parashikimet e nenit 369/3 të K. Pr. Penale, sidomos në përcaktimin e fajësisë, përbën jo vetëm një vlerësim dhe zbatim të keq të dispozitave të K. Pr. Penale, por dhe mosrespektim të kërkesave për një proces të rregullt ligjor të mbrojtura nga neni 6 i Konventës Evropiane “Për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut”. Për sa më sipër, ky vlerësim i joni, gjendet i bazuar jo vetëm në rregullimin e Konventës, por edhe në praktikën e GJEDNJ-së dhe të Gjykatës Kushtetuese.

Së gjashtë, mendojmë se problematikë është dhe aplikimi i masave të sigurimit, veçanërisht, asaj me burg. Mendojmë se aplikimi i masës së sigurimit arrest me burg, bazuar vetëm në masën e dënimin që parashikon vepra penale që personi dyshohet dhe në hamendësime apo dyshime që në çdo rast duhet të provohen, përbën një praktikë të rrezikshme të gjykatës. Për aplikimin e masave të sigurimit, gjykatat, në analizë dhe me provat e paraqitura nga organi i akuzës, duhet të vlerësojnë rast pas rasti nëse ekzistojnë apo jo kushtet e parashikuara në nenet 228, 229 dhe 230 të K. Pr. Penale, duke respektuar në këtë mënyrë të drejtat e individit të parashikuara në Kushtetutë dhe në KEDNJ. Pavarësisht se ndryshimet e fundit të Kodit të Procedurës Penale parashikojnë në nenin 259/2 të saj se provat e marra në gjykimin e këtyre kërkesave janë të njëvlefshme me ato të marra në gjykim, por ato i nënshtrohen debatit gjyqësor në gjykim, përsëri nuk është zgjidhur plotësisht hapësira subjektive abuzuese e deklarimeve të personave që paraqiten që në momentin e parë, duke marrë vlerën e dëshmisë, si dhe duke njehsuar procedurën e nenit 369/3 të K. Pr. Penale, pasi personat që japin të dhëna të dobishme të hetimit në rastin e masave të sigurimit, nuk janë prezent në seancë dhe nuk u lejohet të jenë pjesë në proces në këtë fazë, e në këto kushte, të dhënat që mund të merren prej tyre nga organet proceduese, por dhe vetë i arrestuari ose i ndaluari, janë të cingëruara dhe ngelen vetëm në fazën e pyetjeve të bëra nga Oficeri i Policisë Gjyqësore, që ka përpiluar procesverbalin në momentet e para të hetimit.

Së shtati, mendojmë, gjithashtu, se në Kodin e Procedurës Penale duhet të shtohet dhe një parashikim në lidhje me disponimin e gjykatës në rast se shpall të pavlefshme aktet procedurale të përpiluara nga organi i akuzës, si vendimi i njoftimit të akuzës dhe vendimit të dërgimit të çështjes për gjykim. Ashtu siç jemi shprehur në seksionin e trajtimit të pavlefshmërive të akteve, pushimi i çështjes nga ana e gjykatës, në referim të nenit 387/1 të K. Pr. Penale është një zgjidhje e sforcuar. Ligjvënësi duhet të parashikojë si zgjidhje për këtë rast, në Kodin e Procedurës Penale, disponimin me vendim nga ana e gjykatës për kthimin e akteve prokurorit, pra ndërhyrja në nenin 377 të K. Pr. Penale duhet të bëhet duke pasur në konsideratë edhe këtë ekzigjencë të lindur nga rastet praktike.

Së fundmi, pavarësisht marrjes së masave legislative në drejtim të përmirësimit dhe të përsosjes së sistemit të drejtësisë penale, në përgjithësi, një rol përcaktues në ndërtimin e një sistemi gjyqësor efikas, të paanshëm, që të shërbejë si garant për respektimin e shtetit të së drejtës, kanë sigurisht Shkolla e Magjistraturës me trajnimet që organizon, Kryeinspektori i Lartë i Drejtësisë në inspektimet që do të bëjë, Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë në standardet e gjykimit të shkeljeve të referuara ndaj gjyqtarëve ose prokurorëve, si dhe vetë personat konkretë që ushtrojnë funksionet e tyre në organet e drejtësisë.

Krijimi dhe funksionimi i një sistemi karriere të drejtë për funksionarët e drejtësisë, të bazuar vetëm mbi meritat dhe vlerat e tyre profesionale, të pandikuar nga faktorë të tjerë, do të ishte garancia më e madhe për ngritjen e themeleve të një sistemi gjyqësor të besueshëm për shoqërinë dhe shtetin, si dhe garancia më e mirë për përmirësimin e vazhdueshëm të këtij sistemi, në drejtim të arritjes së standardeve bashkëkohore të drejtësisë penale.

Në përmbyllje të këtij punimi, duke iu referuar dhe konkluzioneve të sipërcituara, e gjej me vend të citoj disa thënie të disa personaliteteve:

Ligji duhet të jetë i qëndrueshëm, por edhe s' duhet të mbetet i pandryshuar.

Roscoe Pound

Moraliteti nuk mund të shkruhet në ligje, por sjellja mund të rregullohet. Dekretet ligjore mund të mos e ndryshojnë zemrën, por ato mund të kufizojnë sjelljen e pashpirt.

Martin Luther King

Në përfundim, doja të falënderoja për zemërsisht të gjithë ata juristë me të cilët kam pasur kënaqësinë të diskutoj rreth problematikave të caktuara të kësaj teme! Pavarësisht faktit se kam ndarë apo jo mendime të njëjta, debati juridik ka qenë shumë frytdhënës dhe konstruktiv.

Falënderim i veçantë shkon dhe për Fakultetin e Drejtësisë - Universiteti i Tiranës, për mundësinë që më dha për të qenë pjesë e tij!

BIBLIOGRAFIA

➤ LITERATURA	AUTORËT
Historia e Shqipërisë, vëll. II. “E drejta zakonore shqiptare”, botim i vitit 1989.	Tiranë, 1965 Koço Nova
Autonomia lokale e krahinave shqiptare gjatë pushtimit osman, botim i vitit 1965.	Doc. Vangjel Meksi
Zhvillimi historik i legjislacionit penal në shqipëri, botim 1997.	Dr. Prof. Ismet Elezi
Demokratizimi i legjislacionit penal, botim i vitit 2000.	Dr. Prof. Halim Islami
Institucionet osmane dhe pashallëqet feudale shqiptare, botim 2001.	Doc. Grigor Gjika
Organizimi i shtetit të parë shqiptar. Drejtësia popullore, Nr. 5, botim i vitit 1962.	Nonda Papuli
Historia e Shtetit dhe e së Drejtës në Shqipëri, Luarasi 2001, Tiranë Kanuni i Zhurisë, 10 maj 1913.	
Mbi hetimet fillmtare, Mbrothësia, Kristo P. Luarasi.	Josif Haxhimima
Komentari i Procedurës Penale. Halim Islami, Ilir Panda	Prof. as. dr. Artan Hoxha,
Argumentimi në procedurën penale, Prishtinë 2006.	Prof. dr. Ejup Sahiti
Kodi i Procedurës Penale i Kosovës. Il Diritto delle Prove Penali La valutazione e la costruzione delle prove penali.	Paulo Tonini Riziero Angeletti
Mufphy për provën, Oxford University Press, 2005 Përkth. Erjon Shehi - UET Pres 2010.	Peter Murphy
Logika i naucna metodologjase. E drejta e procedurës penale (2013). Rexhep Murati	Dr. Bogdan Sesic Ejup Sahiti
Le Altre Procedure Penali. Ekspertimi si provë në procedimin penal (2008).	Berislav Pavisic – Davide Bertaccini Fatmir Tartale

PROVAT DHE PROCESI I TË PROVUARIT NË PROCESIN PENAL

Codice Penale e di Procedura penale e leggi complementari (L. 23/6/2017 n. 103).	Luigi Alibrandi Piermaria Corso
Manuale di Diritto Penale	Francesco Caringella Francesca Della Valle Michele de Palma
Commetario breve al Codice di Procedura penale CEDAM. Criminal Law and it Processes.	Giovanni Conso Vittorio Grevi Sanford H. Kadish Stephen J. Schulhofer
Procedure penale, Dexieme Edition refundue PUF Paris 1995.	Michele-Laure Rassat
Scinza e processo penale Linne guida për l'Acquisizione della prova scientifica , Insituto Superiore Internazionale di Scienca Criminali a cura di Luisella de Cataldo, Neuburger, CEDAM, 2010.	Cherif Bassiouni
Sistemi kushtetues dhe sfidat e tij (29 janar 2010).	Universiteti i Tiranës Fakulteti i Drejtësisë
Mekanizmat Mbrojtës të të drejtave të individëve në kuadër të procesit të rregullt ligjor (Departamenti i së Drejtës Publike 2012).	Universiteti i Tiranës Fakulteti i Drejtësisë
Criminal Law Between Tradition and Challenges of Actuality (Criminal Law Departament International Scientific Conferenc 7 december 2017).	University of Tirana Faculty of Law
Disertacion "Provate dhe procesi i të provuarit".	Ferdinand Elezi

➤ LEGJISLACIONI

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.

Konventa Evropiane e Mbrojtjes së të Drejtave të Njeriut.

Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë.

Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë.

Kodi Pr. Penale i vitit 1878, Procedura Penale Otomane në fuqi në Shqipni (përkthim), Biblioteka Kombëtare.

Ligji Nr.8737, datë 12.2.2001, "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë.

Ligji Nr. 8457, datë 11.02.1999, "Për informacionin e klasifikuar 'sekret shtetëror'".

➤ **VENDIME TË GJYKATËS KUSHTETUESE**

Vendimi Nr. 07, datë 27.04.2005, i Gjykatës Kushtetuese.
Vendimi Nr.19, datë 18.09.2008, i Gjykatës Kushtetuese.
Vendimi Nr. 19, datë 02.04.2012, Gjykata Kushtetuese.
Vendimi Nr. 04, datë 10.02.2012, Gjykata Kushtetuese.
Vendimi Nr. 7/2015, Gjykata Kushtetuese.
Vendimi Nr. 57, datë 21.12.2012, Gjykata Kushtetuese.
Vendimi Nr. 47, datë 07.11.2011, Gjykata Kushtetuese.
Vendimi Nr. 12, datë 13.04.2007, Gjykata Kushtetuese.
Vendimi Nr. 13, datë 10.06.2005 i Gjykata Kushtetuese.
Vendimi Nr. 07, datë 19.02.2007, Gjykata Kushtetuese.
Vendimi Nr. 05, datë 04.03.2008, Gjykata Kushtetuese.
Vendimi Nr. 06, datë 16.01.2012, Gjykata Kushtetuese.

➤ **VENDIME TË GJYKATËS EVROPIANE PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE TË NJERIUT**

Çështja Schenk kundër Zvicrës.
Çështja Castravet kundër Moldavisë, 2007.
Çështja Schiesser kundër Zvicrës, 1979.
Çështja Ektabani kundër Suedisë, 1988, Vaundelle kundër Francës 2003.
Çështja T and V kundër Mbretërisë së Bashkuar.
Çështja Poitrimol kundër Francës, 1993.
Çështja Spinatto kundër HMP Brixton dhe Italisë, 2001.
Çështja Geysseghem kundër Belgjikës, 1999.
Çështja Zyfli kundër Shqipërisë, 2005.
Çështja Mariani kundër Francës, 2005.
Çështja Allent de Ribemont kundër Francës, 1995.
Çështja Laska dhe Lika kundër Shqipërisë.
Çështja Hermi kundër Italisë.
Çështja Hany kundër Italisë.
Çështja Scoppola kundër Italisë.
Çështja Saïdi vs Francë, vendim i 20 shtatorit 1993.
Çështja Breukhoven kundër Republikës Çeke”, Nr.44438/06, datë 21.07.2011.
Çështja A. M. kundër Italisë, 1999.
Çështja Bykov kundër Ruisë, datë 10.03.2009.
Çështja Patrimol kundër Francës, datë 23.11.1993.
Çështja Belziuk kundër Polonisë, datë 25.03.1998.
Çështja Ascitutto kundër Italisë, datë 27.11.2007.
Çështja Stoichokov kundër Bullgarisë.
Çështja Hauschild kundër Danimarkës, datë 24.05.1989.

➤ **VENDIME UNIFIKUES TË KOLEGJEVE TË BASHKUARA TË GJYKATËS SË LARTË**

Vendimi Unifikues, Nr.6, datë 11.10.2002, i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

Vendimi Unifikues, Nr.2, datë 29.01.2003, i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

Vendimi Unifikues nr.07, datë 14.10.2011, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

Vendimi Unifikues Nr.2, datë 20.06.2013, i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

Vendimi Unifikues Nr.01, datë 10.03.2014, i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

➤ **VENDIME TË KOLEGJIT PENAL TË GJYKATËS SË LARTË**

Vendimi Nr.876, datë 21.12.2005, i Kolegji Penal të Gjykatës së Lartë.

Vendimi Nr.291, datë 15.03.2007, i Kolegji Penal të Gjykatës së Lartë.

Vendimi Nr. 218, datë 14.05.2008, i Kolegji Penal të Gjykatës së Lartë.

Vendimi Nr.190, datë 05.06.2013, i Kolegji Penal të Gjykatës së Lartë.

Vendimi Nr.90, datë 13.03.2013, i Kolegji Penal të Gjykatës së Lartë.

Vendimi Nr.489, datë 12.12.2000, i Kolegji Penal të Gjykatës së Lartë.

Vendimi Nr.162, datë 02.07.2014, i Kolegji Penal të Gjykatës së Lartë.

Vendimi Nr.698, datë 09.12.2009, i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

Vendimi Nr.31, datë 31.01.2013, i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

Vendimi Nr.751, datë 16.12.2009, i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

Vendimi Nr.148, datë 28.12.2005, i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

Vendimi Nr.97, datë 20.03.2013, i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

Vendimi Nr.240, datë 28.05.2008, i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

Vendimi Nr. 205, datë 06.04.2005, i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

Vendimi Nr.235, datë 19.09.2012, i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

Vendimi Nr.885, datë 06.10.2010, i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

Vendimi Nr.13, datë 03.02.2016, i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

Vendimi Nr.43, datë 18.03.2015, i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

Vendimi Nr.103, datë 10.06.2015, i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

Vendimi Nr.14, datë 23.01.2013, i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

Vendimi Nr.68, datë 27.02.2013, i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

Vendimi Nr.509, datë 29.10.2008, i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

Vendimi Nr.124, datë 28.04.2014, i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

Vendimi Nr.571, datë 17.12.2008, i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

Vendimi Nr.37, datë 08.04.2004, i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

Vendimi Nr.33, datë 13.10.2010, i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

Vendimi Nr.37, datë 08.04.2004, i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

Vendimi Nr.104, datë 27.02.2008, i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

PROVAT DHE PROCESI I TË PROVUARIT NË PROCESIN PENAL

Vendimi Nr.237, datë 15.03.2007, i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.
Vendimi Nr.64, datë 14.02.2007, i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.
Vendimi Nr.85, datë 20.05.2015, i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.
Vendimi Nr.125, datë 15.07.2015, i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.
Vendimi Nr.05, datë 12.12.2008, i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.
Vendimi Nr.145, datë 28.02.2007, i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.
Vendimi Nr.447, datë 18.07.2002, i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

➤ **VENDIME TË GJYKATËS SË APELIT**

Vendimi Nr.1292, datë 07.12.2012, i Gjykatës së Apelit Tiranë.
Vendimi Nr.21, datë 16.01.2013, i Gjykatës së Apelit Tiranë.
Vendimi Nr.345, datë 05.04.2013, i Gjykatës së Apelit Tiranë.
Vendimi Nr365, datë 02.07.2015, i Gjykatës së Apelit Vlorë.

➤ **VENDIME TË GJYKATËS SË RRETHIT GJYQËSOR**

Vendimi Nr.147, datë 01.04.2015, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë.

Abstrakt

Qëllimi kryesor dhe më i rëndësishëm i legjislacionit penal është padyshim vërtetimi i të gjitha rrethanave të faktit juridik penal në mënyrë të saktë dhe të plotë nga subjektet e së Drejtës Procedurale Penale, për konstatimin dhe zbulimin e të vërtetës, nepermjet garantimit të një procesi të rregullt ligjor dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

E vërteta, në procedurë penale, nënkupton vërtetimin e plotë të të gjitha rrethanave të faktit juridik, nga të cilat varet zbatimi i së drejtës penale materiale dhe procedurale, duke e përputhur gjendjen faktike të vërtetuar në procedurën penale me ngjarjen reale nga e kaluara, e cila kualifikohet si vepër penale.

Për gjetjen e së vërtetës në procedurë penale, gjykata, por dhe organi i akuzës (në rastet e mosfillimit, kërkesës për pushimin e çështjes, ose akuzës për kundravajtjet, vendimin e pezullimit), duhet që, nëpërmjet një analize gjithëpërfshirëse të provave, duke respektuar formën e parashikuar procedurale, të bëjë përpjekjet maksimale që me saktësi të plotë t'i vërtetojë faktet, të cilat janë të rëndësishme për zbardhjen dhe zgjidhjen e çështjes.

Zbulimi i së vërtetës, që arrihet gjatë fazës së hetimeve paraprake ose gjatë gjykimit, nëpërmjet procesit të kërkimit, marrjes, shqyrtimit dhe çmuarjes së provave është i domosdoshëm për procesin, pasi ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në vlerësimin dhe krijimin e bindjes së brendshme të prokurorit ose gjyqtarit në vendimmarrjen e tyre.

Mënyra se si arrihet tek e vërteta objektive përbën një ndarje të madhe konceptuale në të drejtën procedurale penale, pasi, nga kjo mënyrë që aplikohet për të arritur tek e vërteta, përcaktohet disiplinimi i procesit të të provuarit.

Fjalë kyçe :fakti juridik, vepër penale, cmuarja e provave, proces I te provuarit.

Abstract

The main and most lenient purpose of the criminal legislation, which is taken and in its content, is undoubtedly the confirmation of all the circumstances of the criminal legal fact, in an accurate and written way by the submission of the Director of Criminal Procedure, for ascertainment and discovery of certified, by guaranteeing that a due process of law and respect for human rights and fundamental freedoms.

Truth, in criminal proceedings, means the determination of all the circumstances of the legal fact, from which they will be applied in order to apply material and procedural criminal, being proved by the factual situation to prove in criminal proceedings with real events from the past, which qualifies as a criminal offense.

In order to find a proof in criminal proceedings, the court, but also the body of the prosecution (in cases of non-initiation, request for their termination, or charges for minor offenses, suspension of sales), must, if an analysis of the comprehensiveness of evidence, respecting the foreseen procedural form, to make maximum effort that

PROVAT DHE PROCESI I TË PROVUARIT NË PROCESIN PENAL

clarifies my speech to prove the fact, that are in accordance with the clarification and resolution of issues.

Disclosure of evidence, which arrives during the preliminary investigation phase or during the trial, through the process of seeking, obtaining, reviewing and pricing evidence is necessary for the process, as it affects a fair way to be evaluated and is mandatory for now or the judge in their decision-making.

The way he arrives at the objective truth constitutes a great conceptual division in the criminal procedural direction, since, from this way that is applied to reach the truth, the discipline and the process of proving are determined.

Keywords: legal fact, criminal offense, evaluation of evidence, trial process.